Me Emrin e Tij të Cilit i takon Lavdërimi

Ashtu siç kanë nevojë besimtarët dhe mësuesit e shkollave moderne, në këtë shekull të çuditshëm, për koleksionin “Shkopi i Musait”, po ashtu dijetarët dhe hafizët e Kur’anit Kerim kanë nevojë të madhe për koleksionin “Dhul Fikar”.

Sepse në trajtesën mbi mrekullitë e Kur’anit, për shembull, shumë vërsete, të cilët patën qenë zbuluar para dyshimeve dhe kundërshtimeve, janë treguar se përmbajnë shkreptimat e mrekullisë dhe shumë pika të holla e të larta.

Në emrin e të gjithë studentëve të Risale-i Nurit.

Said Nursi

* * *

Me Emrin e Tij të Cilit i takon Lavdërimi

وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

"Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij".

Paqja, mëshira dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ju gjithmonë e përherë!

Duke parë se Risale-i Nuri ka nisur tashmë të shumëfishohet nëpërmjet makinës së shtypit dhe duke parë kthimin e studentëve dhe të mësuesve, të cilët lexojnë filozofinë moderne në shkolla, drejt Risale-i Nurit, duhet të shpjegohet e vërteta vijuese:

Ajo filozofi të cilën e sulmon Risale-i Nuri dhe që e godet fuqishëm është vetëm lloji i filozofisë së dëmshme dhe jo filozofinë në mënyrë absolute.

Sepse lloji i filozofisë dhe i urtësisë që i shërben jetës së shoqërisë njerëzore, moralit, arritjeve humane, industrisë dhe përparimit, -ajo filozofi- është në harmoni dhe në pajtim me Kuranin; madje një filozofi e tillë i shërben urtësisë së Kur'anit dhe nuk e kundërshton atë. Prandaj, Risale-i Nuri nuk e kundërshton dhe nuk konfrontohet me këtë llojë filozofie.

Sa për llojin tjetër të filozofisë, meqenëse ajo e shtyn njeriun në çudhëzim, në ateizëm dhe në moçalin e Natyrës, si dhe është shkaku i së keqes, i shthurjes, i pakujdesisë dhe i çudhëzimit; dhe meqenëse me çudirat e saj magjepsëse ajo kundërshton të vërtetat e mrekullueshme të Kur'anit, Risale-i Nuri e sulmon dhe i jep asaj goditje me provat më të fuqishme në krahasimet e përfshira në shumicën e pjesëve të tij. Risale-i Nuri nuk sulmon filozofinë e dobishme dhe të orientuar drejt. Prandaj, antarët e shkollave laike, -sekulariste- mund ta përqafojnë -dhe duhet ta përqafojnë- Risale-i Nurin pa ngurim dhe pa kundërshtim.

Por në mënyrë krejtësisht të pakuptimtë dhe të padrejtë, hipokritët, shtiracakët e fshehtë po kthejnë një numër hoxhallarësh kundra Risale-i Nurit, vepër e cila është një pronë e vërtetë e hoxhallarëve dhe e njerëzve të medreseve -shkollave fetare-; dhe gjithashtu ata shfrytëzojnë edhe krenarinë diturore, egon, tek disa filozofë duke i bërë të dalin kundra Risale-i Nurit; Prandaj e shoh të përshtatshme përfshirjen e kësaj të vërtete, e kësaj pjese, në fillimin e secilit prej këtyre koleksioneve, "Shkopi i Musait" dhe "Dhul Fikar".

Said Nursi

* * *

FJALA E NJËZET E PESTË

TRAJTESA E MREKULLISË SË KUR'ANIT

Kur ke në dorë një mrekulli të përjetshme, si Kur'ani, të kërkosh provë të mëtejshme, për mendjen time, duket si e tepërt.

Ndërsa kur ke në dorë një provë realiteti si Kur'ani, t'i bësh të heshtur ata që e mohojnë, nuk do të më jepte siklet në zemrën time.

KUJTESË

[Në fillim të kësaj Fjale, ne synuam ta shkruanim këtë fjalë si pesë drita, por në fund të dritës së parë, ne u detyruam ta shkruanim shumë shpejt me qëllim që ta shtypnim atë me alfabetin e vjetër Osman. Në disa ditë, madje ne shkruam njëzet deri në tridhjetë faqe në dy ose tre orë. Prandaj duke i shkruar këto tri drita, në mënyrë të shkurtuar e të përmbledhur, ne tani i kemi lënë dy të fundit. Unë

shpresoj se vëllezërit e mi do t'i shikojnë me drejtësi e me tolerancë të metat, mangësitë, vështirësitë e gabimet të cilat mund të më atribuohen.]

Shumica e vërseteve në këtë trajtesë të mrekullisë së Kur'anit, ose kanë qenë shkak kritike nga ateistët, ose janë kundërshtuar nga shkencëtarët, ose kanë qenë subjekt dyshimi e mosbesimi nga shejtanët midis xhindeve e njerëzve.

Kështu, **"Fjala e Njëzet e Pestë"** ka shpjeguar të vërtetat dhe pikat e holla të atyre vërseteve në një mënyrë të tillë, saqë çështjet të cilat ateistët e shkencëtarët i imagjinojnë të jenë gabime, janë provuar sipas parimeve shkencore të jenë shkreptimat e mrekullisë dhe burimet e plotësimeve të elokuencës së Kur'anit. Me qëllim që të mos shkaktohet neveri, janë dhënë përgjigje vendimtare pa përmendur dyshimet e tyre. Vetëm në *"Stacionin e Parë të Fjalës së Njëzetë,"* dyshimet e tyre janë pohuar në lidhje me tre ose katër vërsete si:

وَالشَّمْسُ تَجْرِي ۞ وَالْجِبَالَ أَوْتَادًا

"Edhe dielli rend në rrugën e tij."[1] *"Dhe malet (i bëmë) si shtylla mbështetëse?"*[2]


Gjithashtu, ndonëse kjo **"Trajtesë e Mrekullisë së Kur'anit"** u shkrua në mënyrë shumë të përmbledhur e me shpejtësi shumë të madhe, në lidhje me shkencën e retorikës dhe shkencat e Arabishtes, ajo është shpjeguar në një mënyrë aq shkencore të thellë e të fuqishme, saqë i ka habitur edhe dijetarët. Megjithëse jo gjithkush që e studion atë do t'i kuptojë të gjitha çështjet e diskutuara, ndodhet një pjesë kuptimplote për gjithësecilin në kopshtin e saj. Pavarësisht të gjitha mangësive në frazeologji dhe në mënyrën e të shprehurit, për shkak se u shkrua shumë shpejt e në rrethana të ngatërruara, ajo shpjegon të vërtetën dhe realitetin e çështjeve më të rëndësishme, nga këndvështrimi i njohjes.

Said Nursi

[1] Kur'an, 36; 38
[2] Kur'an, 78: 7

* * *

TRAJTESA E MREKULLISË SË KUR'ANIT



Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Thuaj: Nëse njerëzimi dhe xhindet do të mblidheshin të gjithë bashkë të nxirrnin ngjasimin e këtij Kur'ani, ata nuk do ta bënin dot përngjasimin e tij, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin."[3]

[Njërin nga afërsisht dyzet aspektet e shpjegimit të mrekullueshëm të Kur'anit të gjithurtë, thesarin e mrekullive dhe mrekullinë më të madhe të Muhammedit a.s.m., unë e kam treguar në trajtesat e mia të arabishtes, në Risale-i Nur arabisht, tek komenti im Kur'anor, i quajtur* "Isharatul-Ixhaz - *Shenjat e mrekullisë", dhe tek "Njëzet e Katër Fjalët"e kaluara, të cilat e paraprinë këtë. Tani, unë do të shpjegoj deri diku vetëm pesë nga ato aspekte, dhe brenda tyre, në mënyrë të shkurtuar, do t'i përfshij aspektet e tjerë. Ndërsa tek parathënia do të jap një përkufizim të Kur'anit të mrekullueshëm e të natyrës së tij.]

[3] Kur'an :17:88

PARATHËNIE

Parathënia përbëhet nga **"Tri pjesë"**

■ PJESA E PARË: Ç'është kur'ani? Si përkufizohet ai?

Përgjigjja: Siç është shpjeguar në *Fjalën e Nëntëmbëdhjetë*, dhe siç provohet tek Fjalët e tjera, **KUR'ANI:**

• Është interpretues parapërjetësie i librit të madh të universit...

• Dhe interpretuesi i paspërjetësisë i gjuhëve të ndryshme që recitojnë vërsetet e krijimit...

• Është komentuesi i librit të botëve të dukshme e të padukshme...

• Është zbuluesi i thesareve jolëndorë të Emrave Hyjnorë të fshehura në faqet e tokës e të qiejve...

• Është çelësi i të vërtetave të fshehura poshtë këtyre rreshtave të ngjarjeve...

• Është gjuha e botës së padukshme në botën e dukshme...

• Është thesari i mirësive të Krijuesit Mëshirëplotë dhe i adresimit Hyjnor të parapërjetësisë, i cili vjen nga bota e padukshme matanë perdes së kësaj bote të dukshme...

• Është dielli, themeli dhe plani i botës shpirtërore të Islamit...

• Është harta e shenjtë e botëve të Ahiretit...

• Është komentuesi i shquar, shpjeguesi i qartë, prova përcaktuese dhe interpretuesi i saktë i Esencës Hyjnore, i Atributeve, i Emrave dhe i Veprave...

• Është Edukatori i kësaj bote të humanizmit...

• Dhe drita e humanizmit më të madh i cili është Islami...

• Dhe është urtësia e vërtetë e llojit njerëzor...

• Dhe është udhëzuesi dhe drejtuesi i vërtetë që e çon njerëzimin në lumturi...

• Dhe ai për njeriun është: **Një libër urtësie, libër ligji, libër duaje, libër adhurimi, libër urdhëri e thirrjeje, libër përmendjeje dhe libër mendimi...**

• Është **një libër i vetëm gjithëpërfshirës i shenjtë** dhe burim për të gjithë librat që përmbushin të gjitha nevojat shpirtërore të njerëzimit.

• Dhe **është një libër qiellor**, si një bibliotekë e shenjtë, që jep libra të përshtatshëm për metodat e evlijave, të sinqertëve dhe të dijetarëve, rrugët dhe metodat e të cilëve janë të gjitha të ndryshme dhe, është i përshtatshëm të ndriçojë çdo rrugë e metodë.

■ PJESA E DYTË Dhe Plotësimi i Përkufiimit

Siç është shpjeguar e provuar tek ***"Fjala e Dymbëdhjetë",*** meqenëse ka ardhur nga Froni Sublim, nga Emri më i Madh dhe nga shkalla më e lartë e çdo Emri, **Kur'ani** është fjala e All-llahut, me cilësinë e Tij, Krijuesi i të gjitha botëve;

• Është Urdhri i All-llahut. xh.sh., me cilësinë Zoti i të gjitha qënieve;

• Është fjalimi i Tij me cilësinë e Tij, Krijuesi i qiejve e i tokës;

• Është një ligjëratë e lartë nga këndvështrimi i Hyjnisë Absolute;

• Është një fjalim parapërjetësie në Emrin e Sovranitetit universal Hyjnor.

• Ai gjithashtu është një regjistër i mirësive të të Gjithëmëshirshmit të Vetëm, nga këndvështrimi i Mëshirës së Tij gjithëpërfshirëse e që rrethon gjithçka.

• Ai është një koleksion i mesazheve Hyjnore që shpjegojnë Madhështinë e Hyjnisë meqë në fillimet e disave ndodhen simbole e shifra.

• Dhe **ai është libri i shenjtë** plot urtësi dhe duke zbritur nga gjithëpërfshirja e *"Emrit më të Madh"* shikon e inspekton të gjitha anët e Fronit Sublim.

Për shkak të këtij misteri, me përshtatshmërinë më të plotë, i është dhënë Kur'anit titulli **"Kelamull-llah"** *Fjala e All-llahut,* dhe ky emër i jepet vazhdimisht.

Pas Kur'anit vjen niveli i librave dhe i fletëve të shenjta të profetëve të tjerë. Sa për Fjalët e tjera Hyjnore të cilat janë të pafund, disa prej tyre janë biseda në formë inspirimi, që burojnë e bëhen të dukshme nëpërmjet një nderimi e vlerësimi të veçantë, një titulli të pjesshëm, nëpërmjet një manifestimi të veçantë, të një Emri të veçantë, me një akt të veçantë Hyjnor e një sovraniteti të veçantë Hyjnor dhe përmes një Mëshireje të veçantë. Inspirimet -frymëzimet- e engjëjve, e njerëzve dhe inspirimet e kafshëve ndryshojnë shumë për sa i përket tërësisë dhe veçantisë.

■ PJESA E TRETË:

Kur'ani i shenjtë, është një libër qiellor, i cili përfshin në mënyrë të përmbledhur librat e të gjithë profetëve, që kohët e të cilëve ishin të gjitha të ndryshme, si dhe veprat e të gjithë Evlijave dhe të dijetarëve të pastër që rrugët dhe metodat e të cilëve janë të gjitha të ndryshme. Gjashtë aspektet e Kur'anit janë të gjitha të shndritshme e të pastruara prej errësirës së dyshimeve dhe të skepticizmit; pika e tij e mbështetjes është shpallje e vërtetë qiellore dhe fjalë parapërjetësie; synimi e qëllimi i tij, në mënyrë të vetëkuptueshme, është lumturia e përjetshme; aspekti i tij i brendshëm, në mënyrë të qartë, është udhëzim i pastër; aspekti i tij i sipërm, domosdoshmërisht, janë dritat e besimit; aspekti i poshtëm është dëshmi e pamohueshme dhe provë me shkallën e njohjes së sigurisë; aspekti i tij i djathtë, në mënyrë të provuar, është dorëzimi i zemrës dhe i ndërgjegjjes; aspekti i tij i majtë, me shkallën e shikimit të sigurisë, është nënshtrimi i arsyes dhe i mendjes me bindje të plotë; fruti i tij, me shkallën e sigurisë absolute, është Mëshira e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm, dhe bota e Parajsës;rangu dhe këndshmëria e tij, sigurisht, pranohen nga engjëjt, njerëzit dhe xhindet.

Secili nga atributet, në këto tre pjesë që lidhen me përkufizimin e Kur'anit, janë provuar në mënyrë vendimtare në pjesët e tjera, ose do të provohen. Pretendimet tona nuk janë thjesht pretendime pa argumente, por secili mund të provohet me argumente të qarta.

● **DRITA E PARË:** Kjo Dritë përbëhet nga "Tri Rreze"

❑ **RREZJA E PARË:** Kjo është elokuenca e Kur'anit, e cila është në shkallën e mrekullisë. Elokuenca e tij është një elokuencë e mrekullueshme që buron nga bukuria e mirërenditjes së fjalës së tij, nga bukuria e plotësimit të thukëtisë së tij, mahnitja e stilit, veçantia e këndshmëria e tij, epërsia e qartësia e shpjegimit të tij, fuqia dhe vërtetësia e kuptimeve të tij dhe nga pastërtia e rrjedhshmëria e gjuhës së tij. Ai për njëmijë e treqind vjet ka sfiduar letrarët e oratorët më të shquar, shkollarët e dijetarët më të mëdhenj dhe gjenitë më të ndritur të njerëzimit, dhe u bëri ftesë ta kundërshtojnë atë. Ai i ka provokuar shumë ata. Dhe megjithëse u ka bërë ftesë për ta kundërshtuar, ata gjeni, kokat e të cilëve preknin qiejt me krenarinë e mendjemadhësinë e tyre, nuk kanë qenë në gjendje as edhe të hapnin gojët e tyre për ta kundërshtuar dhe kanë ulur krejtësisht kokën e tyre.

Kështu, ne do ta tregojmë mrekullinë në elokuencën e tij në dy aspekte.

Aspekti i parë: Ai posedon mrekulli dhe mrekullia e tij ekziston për arsyet e mëposhtme: Shumica e banorëve të Gadishullit Arabik në atë kohë ishin analfabetë. Për shkak të saj, në vend të shkrimit, ata i ruajtën burimet e krenarisë së tyre, ngjarjet e tyre historike, proverbat e tyre dhe urtësitë që do t'i ndihmonin ata për moralet e bukura të tyre, nëpërmjet poezisë dhe elokuencës. Përmes joshjes së poezisë dhe elokuencës, thëniet kuptimplote do të mbeteshin në kujtesën e njerëzve e do t'u përcilleshin brezave vijues. Kjo nevojë e bashkëlindur tek ata, i shtyu që elokuenca dhe oratoria të ishin artikujt më të dëshirueshëm në tregjet e tyre shpirtërore. Madje një person letrar elokuent i një fisi ishte si heroi më i madh kombëtar dhe simboli i lavdisë së tij, dhe për shkak të tij ata fituan krenarinë e tyre më të madhe. Kështu, ai popull inteligjent, i cili sundoi botën me anë të inteligjencës së tij pas ardhjes së Islamit të tyre, ishte midis popujve të botës në shkallën më të avancuar e më të lartë të elokuencës. Elokuenca ishte gjëja më e kërkuar midis tyre, ishte shkaku i krenarisë së tyre dhe gjëja për të cilën ata kishin nevojën më të madhe. Elokuenca kishte një vlerë të tillë të lartë, saqë dy fise do të bënin luftë për fjalën e një personi letrar, dhe do të bënin paqe po prej fjalës së tij. Ata, madje, shkruan me flori në murin e Qabesë shtatë kasidet (poemat) e shtatë poetëve të cilat u quajtën *"el-Mual'leka es-Seb'a"* dhe ishin simbol i krenarisë së tyre.

Kështu, në një kohë të tillë, kur elokuenca ishte gjëja më e kërkuar, u shpall Kur'ani, ashtu si në kohën e Musait a.s. kur magjia ishte gjëja më e kërkuar dhe, ashtu si në kohën e Isait a.s. -Jezusit- që ishte mjekësia ajo që kërkohej më tepër.Prandaj më të rëndësishmet e mrekullive ishin në ato fusha. Dhe pikërisht atëherë, Kur'ani i ftoi oratorët arabë ta kundërshtonin, edhe sikur me më të shkurtrën e sureve. Ai i sfidoi ata me dekretin e:

وَإِنْ كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِمَّا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِنْ مِثْلِهِ

"Dhe nëse ju dyshoni për atë (Kur'anin) që Ne i kemi zbritur robit Tonë, atëherë bëni edhe ju një sure të ngjashme si ajo."[4]

Kur'ani gjithashtu thotë: "Por nëse nuk e besoni atë, do të mallkoheni! Do të hyni në Xhehennem!" Ai e theu krenarinë e tyre në mënyrën më të frikshme dhe përbuzi mendjemadhësinë e tyre. Ai i dënoi ata së pari me zhdukje të përhershme, dhe pastaj me zhdukje të përjetshme në Xhehennem bashkë me zhdukjen e kësaj bote. Ai thotë: "Ose më kundërshtoni mua, ose ju dhe pronat tuaja do të zhdukeni për shkak se po insistoni në mohim!"

Atëherë, po të kishte qenë i mundur kundërshtimi, a do të ishte e mundur të zgjidhej lufta dhe shkatërrimi kur kjo ishte rruga më e rrezikshme e më e vështira; ndërsa para tyre ishte një zgjidhje e lehtë, si kundërshtimi i Kur'anit me një ose dy rreshta duke shfuqizuar pretendimin e tij e duke e sfiduar atë? Po, a do të ishte e mundur për atë popull të zgjuar, atë komb të mençur politikisht, të cilët në një kohë qeverisën botën me politikat e tyre, të linin rrugën më të gjatë e më të shkurtër, të kollajtë e më të lehtë, e të zgjidhnin rrugën më të vështirë e cila do t'ua flakte jetën dhe pasuritë e tyre në rrezik? Sepse, në qoftë se letrarët e tyre do të mundnin ta kundërshtonin me pak fjalë, Kur'ani do të kishte hequr dorë nga pretendimi i tij dhe kështu, do të kishin shpëtuar nga katastrofa materiale e morale. Ndërsa ata zgjodhën një rrugë të frikshme e të gjatë, si lufta. Kjo do të thotë se ishte e pamundur të kundërshtohej Kur'ani me fjalë; vërtet, kjo ishte e pamundur. Prandaj ata u detyruan ta luftonin atë me shpatë.

[4] Kur'an, 2:23

Për më tepër, ka dy motive shumë të fuqishëm për ta kundërshtuar Kur'anin dhe për të prodhuar si ai.

I Pari: Ambicia e armiqve të tij për ta kundërshtuar.

I Dyti : Kënaqësia e miqve të tij për ta imituar.

Për shkak të këtyre dy motiveve detyruese, janë shkruar me miliona libra në arabisht, por asnjëri nga ato nuk i ngjason Kur'anit, sepse cilido që i shikon ato libra dhe Kur'anin –qoftë i ditur apo i paditur– sigurisht thotë: "Kur'ani nuk u ngjason këtyre." Askush nga ata nuk ka qenë në gjendje ta imitojë atë." Atëherë Kur'ani ose është më i ulët se ato të gjithë, por kjo është e padenjë dhe krejtësisht e pamundur sipas konsensusit të miqve e të armiqve njëlloj, ose Kur'ani është sipër të gjithë atyre librave të shkruar.

Në qoftë se ti thua: "Si ta dimë se askush nuk ka bërë përpjekje për ta kundërshtuar dhe se askush nuk ka patur besim të mjaftueshëm tek vetja e tij për ta sfiduar Kur'anin, dhe se ndihma e ndonjërit për dikë tjetër ka qenë pa dobi?"

Përgjigjja: Në qoftë se kundërshtimi do të kishte qenë i mundur, padyshim përpjekja do të kishte qenë bërë, sepse ajo ishte çështje nderi e krenarie dhe jeta e pasuria ishin në rrezik. Dhe në qoftë se do të kishte patur vërtet përpjekje, sigurisht do ta kishin mbështetur shumë një përpjekje të tillë, sepse ata që e kundërshtojnë të vërtetën me kryeneçësi kanë qenë gjithmonë shumë. Në qoftë se ajo do të kishte pasur shumë mbështetës, ata sigurisht do të ishin bërë të famshëm me të, sepse madje edhe diskutimet e parëndësishme tërheqin çudinë e njerëzve dhe gjejnë famë në histori e tregime. Kështu, një diskutim a kundërshtim i jashtëzakonshëm dhe një ngjarje e tillë si ajo, nuk do të kishte mbetur sekret. Gjërat më të shëmtuara e të ulëta kundra Islamit janë treguar e janë bërë të famshme. Ndërsa përveç një ose dy tregimeve rreth Musejleme Gënjeshtarit, asgjë tjetër nuk është njoftuar. Musejleme ishte shumë elokuent, por kur krahasohet me komentimin e Kur'anit i cili ka një bukuri të pafund, fjalët e atij gënjeshtari kalonin në faqet e historisë si fjalë boshe e absurditete.

Kështu, mrekullia e elokuencës së Kur'anit është aq e sigurtë sa, dy edhe dy bëjnë katër. Dhe kështu është çështja.

Aspekti i dytë: Ne tani do të shpjegojmë në **"Pesë pika"** urtësinë e mrekullisë së Kur'anit që përfshihet në elokuencën e tij.

Pika e parë*: Në renditjen e fjalëve të Kur'anit ka një elokuencë të mrekullueshme dhe një pastërti stili.* Nga fillimi gjer në fund, **Isharatul I'xhaz** *"Shenjat e mrekullisë"* e demonstrojnë këtë elokuencë e thukëti në renditjen e fjalëve.

Ashtu si akrepat e një sahati që tregojnë sekondat, minutat dhe orët ku secili prej tyre plotëson rregullin e të tjerëve, po kështu veprojnë strukturat në format e çdo fjalie të Kur'anit të Gjithurtë, rregulli që është në fjalët e tij dhe rendi në marrëdhënie midis fjalive. Dhe kjo u shpjegua me qartësi të plotë tek **"Isharatu-l I'xhaz".** Cilido që dëshiron le ta hedhë vështrimin e ta shohë këtë elokuencë të mrekullueshme në renditjen e fjalëve. Këtu ne do të përmendim një ose dy shembuj, me qëllim që të demonstrojmë rendin e fjalëve në pjesët e një fjalie si një e tërë.

Shembulli i parë:

وَلَئِن مَّسَّتْهُمْ نَفْحَةٌ مِّنْ عَذَابِ رَبِّكَ

"Dhe në qoftë se vetëm një frymë e ndëshkimit të Mbështetësit (Zotit) tënd do t'i prekte ata..."[5]

Në këtë fjali dëshiron të tregojë dënimin si të tmerrshëm përmes shfaqjes së rreptësisë në sasinë më të vogël. Domethënë, ajo shpreh *pakicë* ose *zvogëlim* dhe të gjitha pjesët e fjalisë, gjithashtu, e shikojnë këtë pakicë dhe e përforcojnë atë.

Kështu fjalët, لَئِنْ *"Dhe në qoftë se"* tregojnë *dyshim* dhe dyshimi shikon pakicën.

Fjala مَسَّ *"Do t'i prekte"* do të thotë, *me prek lehtë, me të lehtë*, dhe shpreh një sasi të vogël. Fjala نَفْحَةٌ *"frymë"*, lënda e saj është një erë e lehtë dhe tregon pakicë. Ashtu siç tregon forma e saj numrin njëjës "një frymë", i cili tregon pakicë, gjithashtu *tenvini* duke treguar

[5] Kur'an, 21:46

trajtë të pashquar tek fjala نَفْحَةٌ *"një frymë"* shpreh pakicë ose zvogëlim dhe do të thotë se është aq i vogël saqë zor se mund të njihet. Fjala مِنْ *"...prej (prej, i dënimit)..."* tregon *ndarje* ose *pjesë*; ajo do të thotë, *pak, një thërrime,* gjë që tregon pakicë. Fjala عَذَابِ *"...dënim"* tregon një lloj të lehtë dënimi në lidhje me ndëshkimin (*nekal*) ose dënimin (*ikab*), dhe sugjeron një sasi të vogël. Fjala رَبِّكَ *"e Mbështetësit (Zotit) tënd"* që aludon *mëshirë* e *dhembshuri* dhe duke u përdorur në vend të Atributeve Hyjnore: **El-Kahhar, El-Xhebbar, El-Muntekim**, *Nënshtrues, Detyrues ose Hakmarrës,* tregon gjithashtu pakicë.

Kështu fjalia tregon: ***"Në qoftë se dënimi është i rreptë e me efekt të tillë përmes më të voglës (më të paktës pjesë të tij), atëherë mund ta krahasosh se sa i tmerrshëm do të ishte dënimi Hyjnor."*** Kështu, sa shumë e shikojnë dhe e ndihmojnë njëra-tjetrën këto pjesë të vogla të kësaj fjalie, dhe si e përforcon secila pjesë me gjuhën e saj qëllimin e të tërës. Ky shembull që dhamë i shikon fjalët dhe qëllimin në një shkallë.

Shembulli i dytë:

وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ

"...Dhe shpenzojnë (japin në rrugë të Zotit) nga ajo që (çfarë) Ne u kemi dhuruar atyre si ushqim."[6]

Pjesët e kësaj fjalie tregojnë pesë kushte që e bëjnë të pranueshme dhënien e sadekasë, lëmoshës.

Kushti i parë: Është të jepet aq lëmoshë sa që dhënësi të mos bëhet vetë i nevojshëm për të marrë lëmoshë. Ajo e shpreh këtë kusht nëpërmjet ndarjes ose pjesëve të nënkuptuara me anë të وَمِمَّا *"nga ajo"* tek fjalët e vërsetit مِنْ *"nga ajo që"*.

[6] Kur'an, 2: 3

Kushti i dytë: Është jo t'ia marrë Aliut e t'ia japë Veliut, por të japë nga pasuria e vet. Fjalët, رَزَقْنَاهُمْ *"Që Ne u kemi dhuruar atyre si ushqim"* e shprehin këtë kusht. Ajo do të thotë: *"Jep nga ushqimi që është i yti."*

Kushti i tretë*:** Është të mos vendosë detyrim për marrësin; të mos e bëjë marrësin borxhli ndaj tij. Fjala نَا "Ne" tek fraza رَزَقْنَا *"Që Ne u kemi dhënë atyre si ushqim"* e pohon këtë kusht. Domethënë: "Unë ua jap juve ushqimin; kur ju u jepni shërbëtorëve të Mi diçka nga pasuria Ime, ju nuk mund t'i vendosni ata nën ndonjë obligim."***

Kushti i katërt: Ju duhet t'ia jepni lëmoshën një njeriu, i cili do ta shpenzonte atë për nevojat më të domosdoshme të jetesës së tij, sepse lëmoshat që u jepen atyre që i prishin kot, janë të papranueshme. Fjala يُنْفِقُونَ *"Dhe shpenzojnë"* e tregon këtë kusht.

Kushti i pestë: Është të japë në Emrin e Zotit xh.sh. Fjalët رَزَقْنَاهُمْ *"Që Ne u kemi dhënë atyre si ushqim"* e shprehin këtë. Domethënë. ***"Pasuria është e Imja." "Ju duhet ta jepni atë në Emrin Tim."*** Këto kushte mund të zgjaten. Domethënë, çfarë forme duhet të marrë dhënia e lëmoshës dhe me çfarë pasurish; ajo mund të jepet në formë mësimi e njohurie, mund të jepet me fjalë ose nëpërmjet të vepruarit, ose si këshillë. Fjala, مَا *"Ajo që (çfarë)"* tek fraza مِمَّا *"nga ajo që"* i tregon këto lloje të ndryshme nëpërmjet përgjithësisë së sajë; dhe për më tepër, ajo vetë i tregon ato në këtë fjali, sepse ajo është absolute dhe shpreh përgjithësimin.

Kështu, në këtë fjali të shkurtër, duke përshkruar dhënien e lëmoshës, ajo i hap mendjes një sferë të gjërë me këto pesë kushte, dhe ia dhuron atë asaj përmes pjesëve të saj. Dhe kështu, në fjalinë si një e tërë, renditja e fjalëve ka shumë aspekte. Në të njëjtën mënyrë, midis fjalëve, renditja e fjalëve është brenda një sfere të gjërë dhe ka shumë pamje.

Edhe midis frazave, për shembull tek, قُلْ هُوَ اللهُ اَحَدٌ *"Thuaj: Ai është All-llahu, Një i Vetëm"*[7], ndodhen gjashtë fjali, tre nga ato janë pohore, dhe tre janë mohore. Ajo provon gjashtë shkallët e Njësisë Hyjnore, dhe në të njëjtën kohë mohon gjashtë mënyrat e të përshkruarit ortakë me Zotin xh.sh.**.** Secila fjali është edhe provë e fjalive të tjera, edhe rezultat, sepse çdo fjali ka dy kuptime. Përmes një kuptimi ajo bëhet rezultati, dhe përmes tjetrit bëhet prova. Domethënë, brenda sures *Ihlas* përfshihen tridhjetë sure të përbëra nga prova, që demonstrojnë njëra-tjetrën aq të mirërenditura si sureja *Ihlas*. Për shembull:

قُلْ هُوَ اللهُ لِاَنَّهُ اَحَدٌ ، لِاَنَّهُ صَمَدٌ ، لِاَنَّهُ لَمْ يَلِدْ ، لِاَنَّهُ لَمْ يُوْلَدْ
لِاَنَّهُ لَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا اَحَدٌ

"Thuaj: Ai është Zoti" sepse Ai është Një, sepse Ai është i Përjetshmi, sepse Ai nuk lindi, sepse Ai nuk është i lindur, sepse Atij nuk i ngjason asgjë."

Kështu:

وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا اَحَدٌ ، لِاَنَّهُ لَمْ يُوْلَدْ ، لِاَنَّهُ لَمْ يَلِدْ ،
لِاَنَّهُ صَمَدٌ ، لِاَنَّهُ اَحَدٌ ، لِاَنَّهُ هُوَ اللهُ

"Dhe asgjë nuk është e ngjashme me Të, sepse Ai nuk është i lindur, sepse Ai nuk ka lindur askënd, sepse Ai është i Përjetshëm, sepse Ai është Një, sepse Ai është Zoti."

Po kështu:

هُوَ اللهُ فَهُوَ اَحَدٌ ، فَهُوَ صَمَدٌ ، فَاِذَا لَمْ يَلِدْ ، فَاِذَا لَمْ يُوْلَدْ ، فَاِذَا لَمْ يَكُنْ
لَهُ كُفُوًا اَحَدٌ

"Ai është Zoti, kështu Ai është Një, kështu Ai është i Përjetshëm, kështu Ai nuk ka lindur, kështu Ai nuk është i lindur, kështu asgjë nuk është e ngjashme me Të."

Ju mund të vazhdoni në të njëjtën mënyrë...

[7] Kur'an : 112: 1

Një shembull tjetër:

الٓمٓ ۝ ذَٰلِكَ ٱلْكِتَٰبُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ *"Elif. Lam. Mîm. Ky është libri rreth të cilit nuk ka dyshim, një udhëzim për ata që kanë frikë Zotin xh.sh.."*[8]

Secila nga këto katër fraza ka dy kuptime: Me një kuptim ajo është një provë e frazave të tjera, me tjetrin ajo është rezultati i tyre. Nga gjashtëmbëdhjetë fijet e lidhjeve të tyre prodhohet një qëndisje e mrekullueshme renditje fjalësh. Kjo është përshkruar në atë mënyrë tek **Isharatul Ixhaz** "S*henjat e mrekullisë."*

Gjithashtu siç shpjegohet në "*Fjalën e Trembëdhjetë",* sikur secili nga vërsetet e Kur'anit të kishte një sy që shikon shumicën e vërseteve të tjera dhe një fytyrë të orientuar drejt tyre, në një mënyrë, që secili u shtrin të tjerëve fijet jolëndore të lidhjes. Secili thur një qëndisje të mrekullueshme. **Isharatul Ixhaz** "Shenjat e mrekullisë" e shpjegojnë këtë bukuri dhe elokuencë të renditjes së fjalëve nga fillimi gjer në fund.

Pika e dytë*: Kjo është elokuenca e mrekullueshme në kuptimin e saj.* Shqyrtoje këtë shembull, që është shpjeguar në *"Fjalën e Trembëdhjetë."* Për shembull, në qoftë se ti dëshiron të shijosh elokuencën e vërsetit,

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَٰوَٰتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

"Gjithçka që është në qiej e në tokë madhërojnë e lëvdojnë Zotin, sepse Ai është i Gjithëfuqishmi, i Gjithurti"[9]*,*

përfytyroje veten tënde para ardhjes së Dritës së Kur'anit, në atë periudhë të injorancës në shkretëtirën e mizorive. Atëherë, në atë moment kur çdo gjë ishte mbështjellur me errësirën e injorancës e të shkujdesjes dhe ishte e mbuluar me perdet e pajeta të natyrës, dëgjo vërsetet nga gjuha qiellore e Kur'anit si:

[8] Kur'an: 2, 1-2

[9] Kur'an. 57: 1; 59: 1; 61: 1

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَالْأَرْضِ

"Gjithcka që është në qiej dhe në tokë madhërojnë e lëvdojnë Zotin", ose;

تُسَبِّحُ لَهُ السَّمٰوٰتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ

"Shtatë qiejt dhe toka, dhe gjithcka që ndodhet brenda tyre e madhërojnë dhe e lëvdojnë Atë."[10]

Tani sodit! Shiko se si krijesat e shtrira, ose të pajeta në botë ngjallen në mendjet e dëgjuesve tek jehona e سَبَّحَ تُسَبِّحُ *"... e madhëruan dhe e lëvdojnë Atë"*; si bëhen ato të vetëdijshme dhe ngrihen e recitojnë Emrat e Zotit xh.sh. dhe si tek jehona dhe drita e تُسَبِّحُ *"...e madhëruan dhe e lëvdojnë Atë"*, yjet që patën qenë të pajeta e blloqe zjarri në qiejt e zinj, secili u shfaq në shikimin e atyre që e dëgjojnë atë, si një urtësi duke shfaqur fjalën në gojën e qiellit dhe secili prej tyre duke përhapur nga një dritë të vërtetë, dhe në vend të shkretimit, globi transformohet me atë jehonë qiellore e me dritën e tij si një kokë e madhe; toka e deti si gjuhë, dhe të gjitha kafshët e bimët si fjalët e lavdërimit e të madhërimit duke shfaqur në këtë mënyrë Bukurinë.

Dhe tani shqyrtoje këtë shembull, i cili është provuar në "Fjalën e Pesëmbëdhjetë." Dëgjoji këto vërsete. Çfarë thonë ato?

يَا مَعْشَرَ الْجِنِّ وَالْإِنْسِ إِنِ اسْتَطَعْتُمْ أَنْ تَنْفُذُوا مِنْ أَقْطَارِ السَّمٰوٰتِ وَالْأَرْضِ فَانْفُذُوا لَا
تَنْفُذُونَ إِلَّا بِسُلْطَانٍ ۝ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ۝ يُرْسَلُ عَلَيْكُمَا
شُوَاظٌ مِنْ نَارٍ وَنُحَاسٌ فَلَا تَنْتَصِرَانِ ۝ فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ۝
وَلَقَدْ زَيَّنَّا السَّمَاءَ الدُّنْيَا بِمَصَابِيحَ وَجَعَلْنَاهَا رُجُومًا لِلشَّيَاطِينِ

"O grupimi i xhindeve dhe i njerëzve! Po patët fuqi për të kaluar përtej hapësirës së qiejve e të tokës, atëherë i kaloni! Por ju kurrë nuk

[10] Kur'an : 17; 44

do të mundeni t'i kaloni, përveç me fuqi (nga All-llahu)!""Atëherë pra, cilën nga Mirësitë e Zotit tuaj ju (njerëz dhe xhinde) e mohoni?""Do të çohet kundër jush flakë zjarri pa tym dhe tunxh (i shkrirë) dhe nuk do të mundeni të mbroni veten tuaj."[11] *"Atëherë pra, cilën nga Mirësitë e Zotit tuaj ju (njerëz dhe xhinde) e mohoni?""Dhe vërtet që Ne e kemi zbukuruar qiellin më të afërt me drita dhe Ne i kemi bërë drita të tilla gjuajtëse për të larguar shejtanët."*[12]

Dhe shiko çfarë thonë këto vërsete? ato thonë: "O njerëz e xhinde të pabindur e kryeneçë në pafuqinë e në poshtërsinë tuaj, rebelë e kokëfortë në dobësinë e varfërinë tuaj! Në qoftë se ju nuk u bindeni urdhërave të Mia, kaloni përtej kufijve të pushteteve të Mia –nëse keni fuqi për të vepruar! Si mund të guxoni të kundërshtoni urdhrat e Atij Sulltani të Tillë të Vetëm, urdhërave të të Cilit u binden yjet, hënat e diejt sikur të ishin ushtarë të gatshëm për të zbatuar detyrat? Në kryengritjen tuaj ju po kundërshtoni Sunduesin e Gjithurtë e të Gjithëlavdishëm, i Cili ka ushtarë të bindur që janë kaq madhështorë. Supozoni nëse demonët tuaj do të ishin të fuqishëm të duronin, atëherë këta ushtarë do të lëshonin mbi ta predha si male. Dhe në pafesinë tuaj ju rebeloheni në mbretëritë e Pronarit të Gjithëlavdishëm Absolut, i Cili është i Tillë, saqë ai ka forca që nuk janë krijesa të pafuqishme e të dobëta si ju, por, duke supozuar të pamundurën, në qoftë se secili nga ju do të ishte armik i pafe me madhësinë e malit ose të globit tokësor, ato do të hidhnin yjet dhe raketat flakëruese me hekur të skuqur po me ato madhësi mbi ju dhe do t'ju dërrmonin. Dhe ju shkelni një ligj tek i cili janë lidhur qënie të tilla si ato, dhe po të ishte e nevojshme ato do ta hidhnin globin tokësor në fytyrën tuaj dhe do të lëshonin mbi ju yjet dhe trupat qiellorë sikur të ishin raketa, me lejen e Zotit xh.sh.". Ju mund t'i krahasoni me këto, fuqinë, elokuencën dhe mënyrën e lartë të shprehjes së kuptimeve të vërseteve të tjera...

Pika e tretë: ***Kjo është veçantia e mrekullueshme e stilit të tij.*** Po, në të vërtetë, stili i Kur'anit është i çuditshëm e origjinal, i mrekullueshëm dhe bindës. Ai nuk ka imituar asgjë dhe askënd, dhe askush nuk ka qenë dhe nuk është i mundur ta imitojë atë. Stili i tij ka ruajtur gjithmonë freskinë, rininë dhe veçantinë që ai ka poseduar qysh

[11] Kur'an, 55:33-36
[12] Kur'an, 67:5

kur u shpall, dhe vazhdon ta ruajë atë; si për shembull, stili i veçantë i shifrave **"*Mukata-at"*** (shkronjat e shkëputura), si:

(Elif. Lam. Mim.) (Elif. Lam. Ra.) (Ta. Ha.) (Ja. Sin.)
(Ha. Mim.) (Ajn. Sin. Kaf.)

الٓمٓ ۞ الٓرٰ ۞ طٰهٰ ۞ يٰسٓ ۞ حٰمٓ ۞ عٓسٓقٓ

në fillimet e disa sureve. Ne kemi përmendur pesë ose gjashtë nga shkreptimat e mrekullisë që ato përfshijnë në trajtesën **"Isharatul-Ixhaz."**

Për shembull: Këto shkronja në krye të disa sureve kanë marrë gjysmën e çdo kategorie prej shumë kategorive të mirënjohura të shkronjave emfatike, bashtingëlloreve fishkëllore, shkronjave të theksuara, shkronjave ose tingujve të butë, bashkëtingëlloreve buzohundore dhe shkronjave "*kalkale"* (*Kaf, dal, ta, xhim, ba*). Duke marrë më shumë se gjysmën nga shkronjat e lehta dhe më pak se gjysmën nga shkronjat e rënda, ku asnjëra prej të dyjave nuk janë të ndashme, ai ka ndarë përgjysmë çdo kategori. Megjithëse mendja njerëzore nuk do ta kapte atë, përgjysmimi i atyre kategorive, duke qenë të mbuluara njëra brenda tjetrës, ngurruese midis dyqind mundësive a probabiliteteve, në të vetmen mënyrë të mundur, e cila i ishte fshehur mendjes njerëzore dhe ishte e panjohur për të, dhe duke organizuar të gjitha shkronjat në atë mënyrë, mbi atë distancë të gjërë, natyrisht ajo nuk ishte puna e mendjes njerëzore, dhe rastësia nuk mund të kishte ndërhyrë në të.

Kështu, përveç këtyre shkronjave në fillimet e sureve –Shifrat Hyjnore– duke shfaqur pesë ose gjashtë shkreptima të tjera të mrekullisë si kjo, dijetarët e mirëfilltë në misteret e shkencës së shkronjave dhe autoritetet midis evlijave kanë nxjerrë shumë sekrete nga këto*"mukata-at,"* dhe kanë zbuluar të vërteta të tilla, saqë sipas tyre, këto shkronja në vetvete formojnë mrekullinë më brilante. Meqenëse ne nuk jemi pjesë a grup i sekreteve të tyre dhe, gjithashtu ne nuk mund të japim prova që t'i shikojnë të gjithë sytë, ne nuk mund ta hapim atë derë.

Kështu, ne do të mjaftohemi duke i referuar lexuesit tek pesë ose gjashtë shkreptimat e shpjeguara të mrekullisë, që lidhen me "*Mukata-at"* në trajtesën **"Isharatu-l I'xhaz."**

Tani ne do të tregojmë stilet Kur'anore në lidhje me suren, qëllimin, vërsetin, frazën dhe fjalën: Për shembull, në qoftë se sureja عَمَّ *(Nebe'ë)* do të studiohej me vëmendje, do të vërehej se ajo i tregon kushtet e Ahiretit, ringjalljen e të vdekurve, dhe Parajsën dhe Ferrin me një stil të tillë të mrekullueshëm e të veçantë, saqë ajo i provon aktet e Hyjnisë dhe veprat Hyjnore në këtë botë sikur t'i shikonte secilin nga ato gjendje të Ahiretit dhe, me këtë e bind zemrën. Për të shpjeguar plotësisht stilin e kësaj sureje do të zgjateshim shumë, prandaj ne do të tregojmë vetëm një ose dy pika, siç vijon:

Në fillimin e sures, për të provuar Ditën e Kijametit, ajo thotë: **"*Ne e kemi bërë tokën si një djep të stolisur bukur për ju, dhe malet si shtylla mbështetëse të mbushura plot thesare për shtëpitë tuaja e për jetët tuaja. Dhe Ne ju bëmë ju në çifte, duke e dashur e duke iu afruar njëri-tjetrit. Ne e kemi bërë natën një mbulesë për gjumin e për lehtësimin tuaj, e kemi bërë ditën arenën, prej të cilës për të fituar mjetet tuaja të jetesës, e kemi bërë diellin si një llambë dritëdhënëse e për të sjellë nxehtësi, dhe nga retë Ne lëshojmë ujë, sikur ato të ishin burime që prodhojnë ujin e jetës. Ne krijojmë lehtë e shpejt nga uji i thjeshtë gjëra të ndryshme që mbajnë lule e fruta, të cilat transportojnë të gjithë ushqimin tuaj. Dhe këto i bëjmë kollaj, dhe me një kohëzgjatje të shkurtër. Meqenëse është kështu, Dita e ringjalljes, Dita e ndarjes së të mirës nga e keqja, ju pret ju. Prandaj nuk është e vështirë për Ne që ta shkaktojmë atë Ditë."*** Kështu, ajo sure tregon në mënyrë të mbuluar e me nënkuptim provat se, pas kësaj, në Ditën e Kijametit, malet do të thërrmohen, qiejt do të shkallmohen, Ferri do të jetë i bërë gati dhe njerëzve të Parajsës do t'u jepen kopshte e lulishte. Ajo, në kuptim, sikur thotë! **"Meqenëse Ai i bën këto gjëra në lidhje me malet dhe tokën përpara syve tuaj, Ai gjithashtu do të bëjë gjëra të ngjashme me këto në Ahiret."** Domethënë, "Malet" në fillimin e sures shohim gjendjen e maleve në Kijamet, dhe "kopshtet" në fillimin e sures tregojnë kopshtet e Parajsës në botën tjetër. Kështu, ju mund t'i krahasoni pikat e tjera me këtë dhe shihni se çfarë stili të bukur e të lartë ka kjo.

Dhe për shembull:

قُلِ اللَّهُمَّ مَالِكَ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَنْ تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمُلْكَ مِمَّنْ تَشَاءُ

"Thuaj: O All-llah! Zotëruesi i mbretërimit! Ti ia jep mbretërimin atij që Ti do, dhe ia merr mbretërimin atij që Ti do..."[13] Deri në fund...

Këto vërsete përshkruajnë aktet Hyjnore në llojin njerëzor, përshkruajnë treguesit Hyjnorë në ndryshimet e natës e të ditës, aktivitetet Hyjnore të sistemimit në stinët e vitit, aktet Hyjnore në jetën dhe vdekjen në sipërfaqen e tokës dhe në ringjalljet në këtë botë në një stil kaq të lartë, saqë nënshtron mendjet e njerëzve të vëmendshëm. Meqenëse stili i tij brilant, i lartë e i gjërë është i qartë edhe me pak studim, ne nuk do ta hapim tani atë thesar. Për shembull:

إِذَا ٱلسَّمَآءُ ٱنشَقَّتْ ۞ وَأَذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ۞ وَإِذَا ٱلْأَرْضُ مُدَّتْ ۞ وَأَلْقَتْ
مَا فِيهَا وَتَخَلَّتْ ۞ وَأَذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ۞

"Kur qielli të çahet. Dhe dëgjon e i bindet Zotit të tij, dhe duhet të bëjë kështu. Dhe kur toka të shtrihet në gjërësinë e saj. Dhe të ketë nxjerrë gjithçka që ka pasur dhe të mbetet bosh. Dhe dëgjon e i bindet Zotit të tij, dhe duhet të bëjë kështu.."[14]

Kjo shpjegon shkallën e nënshtrimit dhe të bindjes së qiejve dhe të tokës ndaj urdhrit të Zotit të Gjithëfuqishëm në stilin më të lartë siç vijon:

Ashtu si një komandant madhështor, i cili formon e hap dy zyra për të përshtatur e koordinuar kërkesat e domosdoshme për luftim, njëra prej të cilave shërben për strategji dhe tjetra për të rekrutuar ushtarët. Kur ato kërkesa dhe luftimi të kenë përfunduar, ai vetë u drejtohet atyre dy zyrave, me qëllim që t'i transformojë ato në diçka tjetër dhe i përdor për disa çështje të tjera. Secila nga ato dy zyra do të shprehej, ose përmes gjuhës së atyre që janë punësuar në të, ose përmes gjendjes së saj, nëse do të bëhej të flasë: "O Komandant! Na jep një shtyrje afati, me qëllim që të pastrojmë copat e thërrimet e punëve tona të mëparshme e t'i flakim ato jashtë, dhe atëherë Ti na ndero me praninë Tënde! Dhe pastaj thotë: Ja! Ne i hodhëm ato e tani ne po presim urdhrin Tënd! Urdhëro, bëj çfarë të duash! Sepse ne i bindemi

[13] Kur'an, 3 : 27
[14] Kur'an, 84 :1-5

komandës Tënde! Gjithçka që Ti bën është e vërtetë, e bukur dhe e dobishme.

Në të njëjtën mënyrë, qiejt dhe toka u hapën si dy arena obligimi, provimi e testimi. Pasi të ketë mbaruar afati i caktuar, ato do t'i lënë mënjanë gjërat që lidhen me arenën e provimit, dhe thonë: O Krijuesi ynë! Urdhri është i Yti, na përdor për çfarëdo që Ti dëshiron. E drejta jonë është që të të bindemi Ty. Gjithçka që Ti bën është e drejtë.

Shqyrtoje me shumë vëmendje madhështinë e stilit në ato fjali!

Dhe për shembull:

يَا أَرْضُ ابْلَعِي مَاءَكِ وَيَا سَمَاءُ أَقْلِعِي وَغِيضَ الْمَاءُ وَقُضِيَ الْأَمْرُ وَاسْتَوَتْ
عَلَى الْجُودِيِّ وَقِيلَ بُعْدًا لِلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ

"U tha: O tokë! gëlltite ujin tënd! dhe o qiell përmbaje (shiun tënd)" dhe uji u ul (u bë që të qetësohet) e urdhri (i All-llahut) u përmbush, ndërsa ajo (barka) pushoi në (malin) Xhudi dhe u tha:larg nga populli mizor!"[15]

Me qëllim që të tregojmë vetëm një pikë nga deti i elokuencës së këtij vërseti, ne do të shfaqim një aspekt të stilit të tij në pasqyrën e krahasimit. Gjatë fitores në një luftë të përgjithshme, komandanti i thotë: "Ndërpriteni zjarrin!" një ushtrie që është duke hapur zjarr, ndërsa e urdhëron ushtrinë tjetër të tij duke u thënë: "Ndaloni sulmin!" Ai me të dhënë komandën, zjarri pushon dhe sulmi ndërpritet. Ndërkohë ai u drejtohet ushtarëve duke u thënë: "Gjithçka mbaroi, ne i shpartalluam ata. Flamuri ynë është ngritur në majën më të lartë të kështjellës, mu në qendrën e armikut." Ata tiranë të paedukuar e morën shpërblimin e tyre dhe kanë rënë në ultësirën më të ulët.

Në të njëjtën mënyrë, Mbreti i Pashoq u dha urdhër qiejve e tokës që të asgjësonin popullin e Nuhut a.s.**.** Dhe kur ato kishin zbatuar detyrat e tyre, Ai lëshoi dekretin: "Gëlltite ujin tënd o tokë! Ndaloni nga puna juaj o qiej! Misioni juaj mbaroi. Tani ujërat po tërhiqen. Arka -anija- e cila është një nëpunëse e urdhëruar Hyjnore, duke kryer

[15] Kur'an ; 11 : 44

detyrën e saj si një çadër, u vendos në një majë të malit. Keqbërësit e morën shpërblimin e tyre." Ja, shikoje lartësinë e Këtij stili! Kështu, stili këtu aludon për faktin se universi zemërohet nga kundërshtimi i njeriut. Qiejt dhe toka bëhen të zemëruara. Dhe permes këtij nënkuptimi ai u thotë: **"Ai i Vetëm, urdhrave të të Cilit u binden qiejt e toka, si dy ushtarë të bindur, nuk duhet të kundërshtohet..."**, dhe shpreh një ndalesë në një mënyrë madhështore. Kështu, vërseti përshkruan një ngjarje universale, "përmbytjen e gjithësisë" me të gjitha pasojat e të vërtetat në pak fjali, në një mënyrë të përmbledhur, të mrekullueshme, të bukur e me stil të njohur. Ju mund ta krahasoni këtë pikë me pikat e tjera nga ky oqean. Tani shqyrtoje stilin që tregon Kur'ani nga dritarja e fjalëve.

Për shembull, shqyrtoje fjalinë

كَٱلْعُرْجُونِ ٱلْقَدِيمِ

"Si një kërcell i vjetër i tharë hurme" tek vërseti Kur'anor:

وَٱلْقَمَرَ قَدَّرْنَٰهُ مَنَازِلَ حَتَّىٰ عَادَ كَٱلْعُرْجُونِ ٱلْقَدِيمِ

"Edhe hënës Ne i kemi përcaktuar asaj vendbanime (faza që t'i përshkojë) derisa ajo të kthehet si (të ishte) një kërcell i vjetër i tharë hurme (hëna e re)."[16]

Shiko se çfarë stili të hollë tregon ai, stili është si ky: Një nga pozicionet e Hënës është në sferën e plejadave. Kur'ani e krahason hënën kur ajo është e re me degën e vjetër e të bardhë e të harkuar të hurmës. Ai, përmes këtij krahasimi, i tregon syrit të përfytyrimit se ajo është sikur të ishte një pemë prapa perdes jeshile të qiejve dhe njëra nga degët e saja, e bardhë, e harkuar dhe ndriçuese të kishte grisur perden dhe të kishte nxjerrë kokën, ndërsa plejadat janë si një bistak në degë dhe se secili nga yjet e tjerë janë fruta të ndritshëm të asaj peme të fshehur të krijimit. Në qoftë se je dallues, ti do të kuptosh se sa stil i përshtatshëm, i hijshëm, i hollë, i lartë dhe çfarë mënyre shprehjeje është kjo në pikëpamjen e banorëve të shkretëtirës, për të cilët hurmat ishin mjetet më të rëndësishme të jetesës.

[16] Kur'an ; 36: 39

Dhe për shembull, siç provohet tek fundi i *"Fjalës së Nëntëmbëdhjetë"*, fjalia تَجْرِي *"...rend në rrugën e tij"* tek vërseti, وَالشَّمْسُ تَجْرِي لِمُسْتَقَرٍّ لَّهَا *"Edhe dielli rend në rrugën e tij për një kohë të përcaktuar për të"*[17], hap një dritare për një stil të lartë, siç vijon: Përmes fjalëve: تَجْرِي *"Rend në rrugën e tij"*, domethënë, ***"Dielli rrotullohet",*** ai bën të ditur Madhështinë e Krijuesit nëpërmjet sjelljes ndërmend të vendosjeve të mirorganizuara të Fuqisë Hyjnore në ndryshimet e dimrit e të verës, të ditës e të natës dhe tërheq shikimet për tek letrat e të Përjetshmit të Vetëm të shkruara nga Pena e Fuqisë në faqet e stinëve, si dhe bën të ditur urtësinë e Krijuesit të Gjithëlavdishëm.

Përmes fjalës *"llambë"* te vërseti, وَجَعَلَ الشَّمْسَ سِرَاجًا *"Dhe e bëri diellin si një llambë"*[18], ai hap me fjalën "llambë" një dritare për stilin si ky: Duke bërë të njohur Madhështinë e Shpikësit Absolut dhe Mirësinë e Krijuesit nëpërmjet të sjellurit ndërmend se bota është një pallat dhe gjërat brenda saj janë stolitë, ushqimi dhe gjërat më të domosdoshme të përgatitura për njeriun dhe për krijesat e gjalla; dielli, gjithashtu është një llambë e nënshtruar, ai tregon se dielli është një dëshmi e Njësisë së Zotit xh..sh.. Pra dielli, të cilin idhujtarët e imagjinojnë objektin më të rëndësishëm e të shndritshëm të adhurimit të tyre, është vetëm se një fanar i dobishëm, i nënshtruar dhe një krijesë e pashpirt. Domethënë, fjala سِرَاجٌ *"llambë"* i kujton mendjes mëshirën e Krijuesit brenda Madhështisë së Hyjnisë së Tij. Ai bën të njohur mirësinë Hyjnore brenda gjërësisë së mëshirës dhe, duke bërë kështu, njofton për bujarinë e dorëgjërësinë brenda Madhështisë së Sovranitetit të Tij. Prandaj duke njoftuar Njësinë Hyjnore, dhe në kuptim thotë: **"Një llambë e pashpirt dhe e dobishme, kurrësesi nuk është e denjë për t'u adhuruar."** Pastaj lëvizja e diellit me fjalën تَجْرِي ***"Rend"*** i kujton mendjes sistemimet e çuditshme të mirëvendosura të Fuqisë Hyjnore në ndryshimet e natës e të ditës, të

[17] Kur'an ; 36:38
[18] Kur'an; 15:94

dimrit e të verës dhe duke bërë kështu, njofton madhështinë e Fuqisë së Krijuesit të Vetëm në Hyjninë e Tij.

Domethënë, ajo e kthen mendjen e njeriut nga dielli e hëna për tek fletët e natës dhe të ditës dhe të dimrit e të verës si dhe tërheq vëmendjen tek rreshtat e ngjarjeve të shkruara në ato fletë. **Po, në të vërtetë, Kur'ani nuk bën fjalë për diellin apo për hir të diellit, por për Atë të Vetmin, i Cili e ndriçon atë. Gjithashtu ai nuk flet për natyrën e diellit për të cilën njeriu nuk ka nevojë, por për detyrën e diellit që është ajo e burimit për rregullsinë e artit Hyjnor, qendra për rregullin e krijueshmërisë Hyjnore, një sovajkë për harmoninë dhe rregullin e artit Hyjnor në gjërat, të cilat Skalitësi i parapërjetësisë i thur me fijet e ditës e të natës.** Ju mund t'i krahasoni fjalët e tjera të Kur'anit me këto. Ndërsa secila fjalë e Kur'anit duket e thjeshtë dhe e zakonshme, por ajo kryen detyrën e çelësit të thesareve të kuptimeve të holla.

Dhe kështu, për shkak të lartësisë së stilit të Kur'anit, –ashtu si në mënyrat brilante për pjesën më të madhe që u përshkruan–, në një rast një nomad Arab u robërua nga një frazë e vetme, dhe pa qenë musliman do të binte në sexhde. Një nomad ra në sexhde vetëm me dëgjimin e frazës: فَاصْدَعْ بِمَا تُؤْمَرُ *"Atëherë shpalle hapur atë që je urdhëruar,"*[19] dhe kur ai u pyet: A je bërë musliman? Ai u përgjigj: "Jo, unë po bëj sexhde për elokuencën e këtyre fjalëve."

Pika e katërt: ***Kjo është elokuenca e mrekullueshme në përpilimin e tij, domethënë përmes fjalëve të përdorura.*** Në të vërtetë, ashtu si Kur'ani që në mënyrë të jashtëzakonshme është elokuent për sa i përket stilit të tij dhe mënyrës së shpjegimit, po ashtu ka një elokuencë shumë të rrjedhshme në formulimin e tij. Dëshmi e qartë për ekzistencën e kësaj elokuence është se Kur'ani nuk na shkakton lodhje e mërzi. Dëshmia e dijetarëve brilantë të shkencës së retorikës formon një provë vendimtare të urtësisë së elokuencës. Po, në të vërtetë, Kur'ani madje nuk të mërzit edhe sikur të përsëritet me mijëra herë; përkundrazi, ai të jep kënaqësi. Ai nuk është i rëndë as për kujtesën e vogël e të thjeshtë të një fëmije; fëmijët mund ta mësojnë përmendësh lehtë Kur'anin. Ai nuk është i mërzitshëm as për veshin e një njeriu të

[19] Kur'an; 15:94

goditur nga një sëmundje e rëndë, i cili do të shqetësohej dhe nga fjala më e vogël; përkundrazi ai do të kënaqej e ndjehej i lehtësuar prej tij. Ai është si një sherbet për shijen e hollë të dikujt në grahmë të vdekjes. Recitimi i Kur'anit i jep kënaqësi të ëmbël veshit dhe mendjes së njeriut si kënaqësia e shijes së ujit të *Zemzemit* për gojën. Arsyeja e mosshkaktimit mërzi dhe urtësia e saj është kjo: **Kur'ani është ushqim e furnizim për zemrën, fuqi e pasuri për mendjen, ujë e dritë për shpirtin dhe shërim e ilaç për nefsin.** Shembulli i i tij është si buka të cilën ne e hamë çdo ditë dhe nuk na jep mërzi, ndërsa në qoftë se do të hanim çdo ditë frutin më të shijshëm, ai do të na jepte mërzi. Kjo do të thotë: **Për shkak se Kur'ani është i vërtetë, është realiteti, vërtetësia, udhëzimi dhe elokuenti i mrekullueshëm, ai nuk shkakton lodhje e mërzi dhe e ruan freskinë e këndshmërinë sikur të ruante rininë e përjetshme.** Madje një nga udhëheqësit e Kurejshit –një orator me përvojë– u dërgua nga idhujtarët për ta dëgjuar Kur'anin. Ai shkoi dhe e dëgjoi atë dhe kur u kthye, u tha atyre: "Këto fjalë kanë një ëmbëlsi e freski të tillë, saqë ato nuk u ngjasojnë atyre të njerëzve." Unë i njoh poetët e falltarët; këto fjalë nuk u ngjasojnë aspak fjalëve të tyre. Dhe më e mira që ne mund të bëjmë për t'i mashtruar njerëzit tanë është të themi se ai është magji." Kështu pra, edhe armiqtë më zemërgurë kundra Kur'anit të gjithurtë habiteshin nga elokuenca e tij.

Do të zgjatej shumë në qoftë se ne do të shpjegonim burimet e elokuencës së Kur'anit të gjithurtë në vërsetet, në fjalët e në fjalitë e tij, prandaj ne do të bëjmë një shpjegim të shkurtër dhe do të shfaqim një shkreptimë të vetme të mrekullisë që ndriçohet nga vendosja e shkronjave të alfabetit, dhe mënyrën e tyre në një vërset të vetëm, me anë të shembullit. Ai vërset është:

ثُمَّ أَنزَلَ عَلَيْكُم مِّن بَعْدِ الْغَمِّ أَمَنَةً نُّعَاسًا يَغْشَىٰ طَائِفَةً مِّنكُمْ

"Mandej, pas asaj tronditjeje të rëndë, Ai u lëshoi sa për qetësim, një kotje (gjumi të lehtë) që i kaploi një grup prej jush…"[20] deri në fund.

[20] Kur'an, 3: 154

Në këtë vërset, të gjitha shkronjat e alfabetit arab janë të pranishme. Por, shiko! Megjithëse të gjitha kategoritë e shkronjave emfatike janë së bashku, kjo nuk e ka prishur apo humbur rrjedhshmërinë e ëmbëlsinë e stilit. Në të vërtetë, kjo i ka shtuar një shkëlqim dhe melodi harmonike e të pajtueshme elokuence që buron nga fije të ndryshme.

Gjithashtu, shikoje me kujdes shkreptimën e mëposhtme të mrekullisë: Nga shkronjat e alfabetit**,** ***Elifi*** dhe ***Jeja,*** meqenëse janë më të lehtat e shkronjave dhe janë transpozuar, ndërkëmbyer me njëra-tjetrën si motra, secila nga ato të dyja është përsëritur njëzet e një here. Meqenëse م *(mim)* dhe ن *(nun)*[21] janë motra e mund të këmbehen e të zënë vendet e njëra-tjetrës, secila nga ato është përsëritur tridhjetë e tre herë. Meqenëse ش *(shin),* س *(sin)* dhe ص *(sad),* janë motra, për sa i pëket nyjëtimit, cilësisë dhe tingullit, secila është përmendur tre herë; Meqenëse غ *(gajn)* dhe ع *(ajn)* janë motra, por meqenëse ع *(ajn)* është më i lehtë, është përmendur gjashtë herë; ndërsa për shkak se غ *(gajn)* është më i rëndë përmendet tre herë; domethënë sa gjysma e tij.

Meqenëse ز *(Ze)* ذ *(Dhe)* ظ *(Dha), dhe* ط *(Ta)* janë motra në lidhje me artikulimin, cilësinë dhe tingullin, secila nga ato përmendet dy herë, ndërsa ل *(Lam)* dhe ا *Elif* në formën e لا (***La***-së) janë bashkuar dhe pjesa e Elifit në formën e لا ***La***-së është gjysma e ل ***(Lamit),*** prandaj lami është përmendur dyzet e dy herë, kurse gjysma e saj *(Elif)* njëzet e një herë. Meqenëse ء ***(Hemzeja)*** *me* ه *(He)* janë motra, për sa i përket nyjëtimit, ***Hemzeja*** [22] është përmendur trembëdhjetë herë, ndërsa ه ***Heja*** është përmendur katërmbëdhjetë herë, pasi është një shkallë më e lehtë**.** ق *(Kaf)* ف *(Fe)* dhe ك *(Kef)* janë motra; ق *(Kaf)* është përmendur dhjetë herë meqë ka një

[21] Tenvini gjithashtu është Nuni.

[22] Hemzeja e shqiptuar dhe e pashqiptuar është njëzet e pesë; dhe ajo është tre shkallë më e lartë se sa motra e saj elifi sakineh, sepse zanoret janë tre.

pikë shtesë, ndërsa ف *(Fe)* është përmendur nëntë herë, ك *(Kef)* gjithashtu nëntë herë. ب *(Be)* është përmendur nëntë herë dhe ت *(Te)* meqë vjen e treta është përmendur dymbëdhjetë herë. ر *(Ra)* është motra e *(Lam),* por sipas vlerës së tyre numerike të Ebxhedit, *(Ra)* është dyqind, ndërsa ل *(Lam)* tridhjetë, dhe meqenëse ر *(Ra)* është gjashtë shkallë mbi *(Lam),* ka rënë poshtë tij gjashtë shkallë. Gjithashtu, meqenëse ر *(Ra)* përsëritet shumë në shqiptim, ajo bëhet emfatike dhe është përmendur vetëm gjashtë herë. Dhe për shkak se ض *(dad,)* ث *(The),* ح *(Ha),* خ *(Kha)* janë emfatike (të rënda) dhe posedojnë disa cilësi, në lidhje me shkronjat e tjera, secila nga ato është përmendur vetëm një herë. Meqenëse و *(vav)* është më i lehtë se *(Ha)* dhe se ***Hemzeja,*** dhe më i rëndë se ى *(Je)* dhe *(Elif),* është përmendur shtatëmbëdhjetë herë, katër herë më shumë se ***Hemzeja*** e rëndë, dhe katër herë më pak se *(Elif)* i lehtë.

Kështu, vendosja e jashtëzakonshme e shkronjave tek pjesa e përmendur këtu, dhe lidhjet e tyre të fshehura, renditja e bukur, rregullsia dhe harmonia e hollë tregojnë aq qartë, sa dy edhe dy bëjnë katër, se nuk është brenda limiteve të mendimit njerëzor për ta përpiluar Kur'anin. Sa për rastësinë, është krejtësisht e pamundur që ajo të ketë ndërhyrë. Atëherë, ashtu si rregulli i çuditshëm e i mrekullueshëm dhe rregullsia në vendosjen e këtyre shkronjave që janë mjete për rrjedhshmërinë dhe elokuencën në fjalët, po ashtu mund të ndodhen shumë shembuj të fshehtë të urtësisë. Meqenëse një renditje e tillë si kjo është vëzhguar tek shkronjat, sigurisht tek fjalët, fjalitë dhe kuptimet është vëzhguar një renditje e tillë misterioze dhe një harmoni e tillë brilante, saqë syri që do ta shikonte do të deklaronte: **"*Mashaall-llah*"!** Dhe arsyeja që do ta perceptonte, do të thonte me çudi: **"*Barekall-llah*"!**

Pika e pestë: ***Kjo është përsosmëria në mënyrën e shpjegimit***. Domethënë, epërsia, thukëtia dhe madhështia. Ashtu siç ka elokuencë në renditjen e fjalëve, në përpilim e në kuptim dhe një veçanti në stilin e tij, po ashtu në mënyrën e tij të shpjegimit ka një epërsi e përsosmëri. Në të vërtetë, të gjitha kategoritë dhe nivelet e fjalimit dhe të fjalës si: Inkurajimi e frikësimi, vlerësimi e kritika, demonstrimi e udhëzimi, shpjegimi dhe bërja të heshtur përmes argumentave, janë në shkallën më të lartë tek komentimi i Kur'anit.

Një nga shembuj të shumtë të mënyrës së shpjegimit[23] të tij tek kategoria e **"kurajimit dhe nxitjes"** është në suren *Insan:* هَلْ أَتَىٰ عَلَى الْإِنسَانِ *"A nuk ka qenë mbi njeriun një periudhë e gjatë kohe, kur ai nuk ishte asgjë për t'u përmendur?"* [24]. Kjo është e ëmbël si uji i *Keutherit* dhe ka rrjedhshmërinë e burimit të *Selsebilit*, është i shijshëm si frutat e Xhennetit dhe është aq e bukur sa veshja e *Hurive*.

Një nga shembujt e shumtë në kategorinë e "frikësimit e të kërcënimit" është fillimi i sures *Gashijeh:* هَلْ أَتَيْكَ حَدِيثُ الْغَاشِيَةِ *"A të ka mbërritur ty lajmi i ngjarjes përmbytëse (trishtimi i ditës së kijametit)?"*[25]. Këtu, komentimi i Kur'anit ka një efekt si plumb duke zier në veshët e njerëzve të çudhëzimit, si zjarri duke u djegur në trutë e tyre, dhe si *Zekkumi* duke përvëluar qiellzat -shijet- e tyre, si Ferri duke sulmuar fytyrat e tyre dhe si një pemë e ashpër me gjemba në stomakët e tyre. Sigurisht një nëpunës si Ferri i urdhëruar nga Një i Vetëm për të dhënë mundim e torturim me qëllim që të demonstrojë kërcënimet e tij duke pëlcitur nga mllefi e zemërimi i madh i tij, thotë:

تَكَادُ تَمَيَّزُ مِنَ الْغَيْظِ *"Ai (Ferri) pothuaj shpërthen me vrull e zemërim."*[26] Kjo tregon se sa i tmerrshëm është torturimi i Atij të Vetmi.

Nga mijëra shembuj të kategorisë së "vlerësimit" është mënyra e shpjegimit të Kur'anit në pesë suret që fillojnë me **"*El hamdu lil-lah*",** një shpjegim që është i shndritshëm si Dielli[27], i zbukuruar si yjet, madhështor si qiejt e toka, i dashur si engjëjt, i dhembshur e i mëshirshëm si butësia e dashamirësia ndaj të voglit në këtë botë dhe i bukur si Parajsa në botën tjetër.

Nga mijëra shembuj në kategorinë e "kritikës e të ndalimit" është vërseti: أَيُحِبُّ أَحَدُكُمْ أَن يَأْكُلَ لَحْمَ أَخِيهِ مَيْتًا *"A do të pëlqente ndonjëri prej jush të hante mishin e vëllait të tij të vdekur?"*[28]

---

[23] Stili këtu ka veshur rrobat e kuptimeve të kësaj sureje.
[24] Kur'an; 76:1
[25] Kur'an; 88:1
[26] Kur'an; 67:8
[27] Në këto shprehje aludohet për temat e atyre sureve.
[28] Kur'an; 49:12

Ky vërset e kritikon dhe e ndalon përgojosjen gjashtë herë në mënyrë të rreptë. Është siç vijon:

Siç dihet *hemzeja* në fillim të vërsetit është pjesëz pyetëse. Kjo i përshkon si ujë të gjitha fjalët e vërsetit.

Kështu me hemzen e parë ai thotë: *"*A nuk keni ju arsye, e cila është vendi i pyetjes e i përgjigjjes, që të mos kuptoni se sa gjë e shëmtuar është kjo?"

Me fjalën e dytë: يُحِبُّ *"...A do të pëlqente..."*, hemzeja pyet: "A është zemra juaj, vendi i dashurisë dhe i urrejtjes, kaq e prishur saqë të dëshirojë gjënë më të urryer?"

Me togfjalëshin e tretë: اَحَدُكُمْ *"...ndonjëri prej jush..."*, hemzeja pyet: "Çfarë i ka ndodhur jetës suaj sociale dhe qytetërimit, e cila e merr jetën e saj nga komuniteti, që të gjejë të pranueshme një veprim që helmon kështu jetën tuaj?"

Me togfjalëshin e katërt: اَنْ يَاْكُلَ لَحْمَ *"...të hajë mishin..."*, pyet: "Çfarë i ka ndodhur humanizmit tuaj që ju po e shqyeni shokun tuaj si bishë e egër?"

Me togfjalëshin e pestë: اَخِيهِ *"...e vëllait të tij..."*, hemzeja pyet: "A nuk keni dhembshuri e ndjenjë fisnikërie që ju zhytni dhëmbët tek karakteri i njeriut të lënduar, i cili është vëllai juaj në kaq shumë aspekte? A ka logjikë një njeri i cili kafshon çmendurisht gjymtyrët e trupit të tjetrit?"

Dhe me togfjalëshin e gjashtë: مَيْتًا *"...të vdekur..."*, hemzeja pyet: "Ku është ndërgjegjja juaj? A është kaq e prishur dhe e zhytur në vese natyra juaj, saqë të shpërfillë e të mohojë me kaq babëzi, sa të hajë edhe mishin e vëllait të vdekur, kur ai duhet respektuar?"

Pra, sipas kuptimit të përgjithshëm të vërsetit Kur'anor dhe sipas interpretimit të fjalëve të tij, shpifja dhe përgojimi janë të dënueshme e të urryera nga mendja, zemra, humanizmi, ndërgjegjja, natyra,

patriotizmi dhe nga shoqëria. Atëherë, shikojeni se si ky vërset e ndalon këtë krim në gjashtë shkallë të përmbledhura e në gjashtë nivele të mrekullueshme...

Nga mijëra shembuj të kategorisë së *"provës dhe demonstrimit"* është vërseti që vijon:

فَانْظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا إِنَّ ذَٰلِكَ لَمُحْيِي الْمَوْتَىٰ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

"Atëherë shikoji shenjat e mëshirës së Zotit; se si Ai i jep jetë tokës pas vdekjes së saj. Në të vërtetë është Ai i Cili i ngjall të vdekurit, sepse Ai është i Gjithëfuqishëm mbi gjithçka."[29]

Shpjegimi i tij, me qëllim që të provojë ringjalljen e të heqë dyshimet, është i tillë saqë nuk do të mund të demonstrohej më qartë. Është si më poshtë:

Kështu siç është demonstruar e shpjeguar tek "e Vërteta e Nëntë e Fjalës së Dhjetë" dhe në "Shkreptimën e Gjashtë të Fjalës së Njëzet e Dytë", meqenëse në çdo pranverë jepen shembujt e ringjalljes së tokës me treqindmijë llojet, me rregullsinë më të madhe dhe veç e veç duke dalluar secilën gjallesë, pavarësisht atyre specieve të panumërta duke qenë të gjitha të përziera së bashku në një konfuzion total, kjo është e qartë për vëzhgimin njerëzor se kijameti dhe ringjallja e të vdekurve nuk do të ishte aspak e vështirë për Atë të Vetëm që e bën këtë ringjallje të tokës e të llojeve të saj. Gjithashtu, të shkruash pa gabim e defekt me Penën e Fuqisë qindra e mijëra specie në faqen e tokës, të gjitha së bashku dhe njëra brenda tjetrës, padyshim ajo është vula e të Vetmit në Njësi; kështu së bashku me demonstrimin e Njësisë Hyjnore, në mënyrë aq të qartë si dielli, ajo me vërsetin provon Kijametin dhe ringjalljen e të vdekurve, aq lehtë dhe në mënyrë vendimtare, si lindja e perëndimi i diellit. Kështu, Kur'ani e demonstron këtë të vërtetë nga këndvështrimi i "mënyrës" siç përshkruhet nga fjala كَيْفَ *"si",* ashtu siç ajo e përmend në detaje në shumë sure.

[29] Kur'an; 30:50

Dhe për shembull: Në suren *Kaf* قٓ وَٱلۡقُرۡءَانِ ٱلۡمَجِيدِ *"(Betohem) për Kur'anin e lavdishëm!"*[30]

Ajo e provon ringjalljen me një shpjegim të tillë brilant, të bukur, të ëmbël e të lartë, saqë ajo bind në një mënyrë aq të sigurtë, sa ardhja e pranverës. Shqyrtoje: Në përgjigjjen e Kur'anit ndaj jobesimtarëve, të cilët mohojnë ringjalljen e kockave të kalbura dhe duke thënë: "Kjo është e çuditshme, ajo nuk mund të ndodhë!" Kur'ani dekreton:

أَفَلَمۡ يَنظُرُوٓاْ إِلَى ٱلسَّمَآءِ فَوۡقَهُمۡ كَيۡفَ بَنَيۡنَٰهَا وَزَيَّنَّٰهَا وَمَا لَهَا مِن فُرُوجٖ

"A nuk e kanë parë ata qiellin sipër tyre: si Ne e kemi ndërtuar atë dhe stolisur dhe s'ka asnjë të çarë në të? deri në fund... Dhe vazhdon të sqarojë deri tek كَذَٰلِكَ ٱلۡخُرُوجُ *"Kësisoj do të jetë ringjallja."* [31] Mënyra e shpjegimit të tij rrjedh si ujë dhe shndrit si yjet. Ajo i jep zemrës gëzim e kënaqësi, dhe i jep një ushqim të ëmbël e të mirë si hurma. Kështu që është njëherësh edhe si ushqim dhe si kënaqësi.

Dhe në njërin nga shembujt më të hollë tek kategoria e "demonstrimit dhe e vërtetimit" ai thotë:

يسٓ وَٱلۡقُرۡءَانِ ٱلۡحَكِيمِ إِنَّكَ لَمِنَ ٱلۡمُرۡسَلِينَ

"Jâ-sîn. "(Betohem) në Kur'anin e gjithurtë. Vërtet ti (Muhammed) je njëri prej të dërguarve." [32]

Domethënë, ***"Unë betohem në Kur'anin e gjithurtë që ti je një nga profetët."*** Ky betim tregon se prova e profetësisë është aq e sigurtë dhe e vërtetë, dhe në drejtësi është ngritur në rangun e respektit dhe të nderimit, saqë betohet në të. Kështu, duke e treguar këtë, ai thotë: **"Ti je profet, sepse në dorën tënde është Kur'ani. Sa për Kur'anin, ai është e verteta dhe ai është Fjala e të Vërtetit; sepse në të është urtësia e vërtetë dhe mbi të është vula e mrekullisë."**

[30] Kur'an; 50:1
[31] Kur'an; 50:6-11
[32] Kur'an; 36:1-3

Një nga shembujt e përmbledhur e të mrekullueshëm të kategorisë së **"provës dhe demonstrimit"** është ky,

قَالَ مَنْ يُحْيِ الْعِظَامَ وَهِيَ رَمِيمٌ ۞ قُلْ يُحْيِيهَا الَّذِي أَنْشَأَهَا
أَوَّلَ مَرَّةٍ وَهُوَ بِكُلِّ خَلْقٍ عَلِيمٌ ۞

"(Njeriu mohues)"thotë: Kush do t'u japë jetë këtyre kockave kur të jenë kalbur e të jenë bërë pluhur? "Thuaj: Do t'i ringjallë ato Ai i Cili i krijoi ato për herë të parë, sepse Ai ka njohuri të plotë për çdo llojë krijimi."[33]

Domethënë, ***"Njeriu thotë: Kush do t'i ringjallë kockat e kalbura? Ti thuaj: Ai që i bëri ato për herë të parë e që u dha jetë, Ai do t'i ringjallë ato."*** Siç u përshkrua në Krahasimin e Tretë tek e Vërteta e Nëntë në Fjalën e Dhjetë, në qoftë se dikush riformon apo rindërton një ushtri të madhe në një ditë përpara syve tanë, dhe dikush tjetër thotë: "Ky njeri mund të grumbullojë me rënien e borisë anëtarët e një batalioni që ishin shpërndarë për të pushuar; Ai është i mundur ta sjellë batalionin nën komandë". Ndërsa ti thua: "O njeri! unë nuk e besoj atë", ti do ta shikoje se sa mohim prej budallai do të ishte ai. Në të njëjtën mënyrë, i Gjithëfuqishmi e i Gjithëdituri i Vetëm rekruton e bashkon rishtas me komandën e **"Kun fe jekun",** *"bëhu! dhe ajo bëhet në çast"*, dhe me një rregull perfekt e me balancën e urtësisë, grimcat dhe gjymtyrët e holla të batalionit –si trupat e të gjitha kafshëve– të cilat janë si një ushtri –dhe krijesat e tjera të gjalla dhe krijon në çdo shekull, e madje në çdo pranverë të gjitha qindrat e mijërat e ushtrisë– si speciet dhe llojet e gjallesave në faqen e tokës. Atëherë, a mund të diskutohet se si Ai mund t'i grumbullojë me një të rënë borisë së *Israfilit* grimcat themelore dhe pjesët kryesore të batalionit – si trupi, të cilat tashmë janë njohur me njëri-tjetrin nëpërmjet marrjes së tyre nën urdhër? A mund të konsiderohet e pamundur? Në qoftë se do të konsiderohej e pamundur, ajo do të ishte krejtësisht marrëzi.

Në kategorinë e "*udhëzimit*" mënyra e shpjegimit të Kur'anit është aq prekës, i butë, i këndshëm e i hollë saqë mbush shpirtin me ashk,

[33] Kur'an; 36:78-79

zemrën me kënaqësi, mendjen me interesim dhe sytë me lotë. Një nga mijëra shembuj është ky vërset:

ثُمَّ قَسَتْ قُلُوبُكُمْ مِنْ بَعْدِ ذَٰلِكَ فَهِيَ كَالْحِجَارَةِ أَوْ أَشَدُّ قَسْوَةً

"Edhe pas (fakteve të qarta) zemrat tuaja u bënë gurë madje edhe më të fortë..."[34] Deri në fund...

Siç është provuar e shpjeguar në diskutimin e vërsetit të tretë në stacionin e parë të Fjalës së Njëzetë, ai u thotë bijve të Israilit**: *"Çfarë u ka ndodhur ju, që edhe shkëmbi i fortë derdh lotë nga dymbëdhjetë kroje përpara një mrekullie si Shkopi i Musait a.s., ndërsa ju qëndroni indiferentë përballë të gjitha mrekullive të tij, me sytë tuaj të thatë e të palotë dhe me zemrat tuaja të ngurta e pa nxehtësi e pasion?"*** Meqenëse ky kuptim i udhëzimit është shpjeguar atje, ne ju referojmë tek ajo "Fjalë" dhe këtu mjaftohemi me kaq.

Nga mijëra shembuj në kategorinë e *"shpjegimit dhe të heshtjes me argumente"*, shqyrto vetëm dy shembujt e mëposhtëm:

Shembulli i parë:

وَإِنْ كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِمَّا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِنْ مِثْلِهِ وَادْعُوا شُهَدَاءَكُمْ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ

"Dhe në qoftë se ju jeni në dyshim në lidhje me atë që Ne ia kemi zbritur (shpallur gradualisht) shërbëtorit Tonë, atëherë prodhoni edhe ju një sure si ai (Kur'ani), dhe thirrni dëshmitarët tuaj ose ndihmësat (zotërat nëse ka ndonjë) përveç All-llahut, në qoftë se jeni të vërtetë."[35]

Domethënë, ***në qoftë se ju keni ndonjë dyshim, thirrni të gjithë të parët dhe përkrahësit që t'ju ndihmojnë ju e të dëshmojnë për ju, atëherë prodhoni si shembulli i një sureje të vetme.*** Meqenëse kjo është shpjeguar e provuar në ***"Isharatu-l I'xhaz",*** ne këtu do të japim vetëm një përmbledhje të shkurtër të saj. Ajo është si më poshtë.

[34] Kur'an; 2:74

[35] Kur'an; 2:23

Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm thotë: **"O ju grupi i njerëzve e i xhindeve! Në qoftë se ju keni ndonjë dyshim që Kur'ani është Fjala e Zotit xh. , dhe e imagjinoni atë të jetë fjala e njeriut, atëherë dilni në mejdan, ja ku është, le të shohim! Ju sillni një libër si ky Kur'an nga ndonjë analfabet, i cili nuk di të lexojë as të shkruajë ashtu si personi i Muhammedit "i besuari", dhe bëjeni atë të prodhojë si Kur'ani! Në qoftë se ju nuk mund ta bëni këtë, atëherë ai nuk duhet të jetë i pashkolluar; le të jetë ai më i shquari i letërsisë, apo dijetar. Në qoftë se nuk mund ta bëni edhe këtë, atëherë sillni të gjitha veprat e holla të të gjithë oratorëve tuaj dhe burrave të elokuencës, madje veprat e të gjithë gjenive letrarë të së shkuarës, dhe të gjitha ato të së ardhmes, dhe kërkoni ndihmën e të gjithë zotrave tuaj. Punoni me të gjithë fuqinë tuaj dhe prodhoni si Kur'ani. Dhe në qoftë se nuk mund ta bëni edhe këtë, i lini mënjanë të vërtetat e Kur'anit dhe aspektet e shumta të tij të mrekullisë, të cilat janë të pamundura të imitohen dhe prodhoni një vepër që të jetë e barabartë me Kur'anin vetëm në elokuencë e në renditjen e fjalëve."**

Nëpërmjet fjalëve sfiduese,

فَأْتُوا بِعَشْرِ سُوَرٍ مِثْلِهِ مُفْتَرَيَاتٍ

"Atëherë sillni ju dhjetë sure si ai (Kur'ani), ashtu të trilluara (nga ana juaj)"[36], ai thotë: **"Ejani! Unë nuk dua kuptimin e tij të vërtetë nga ju; le të jenë ato trillime, gënjeshtra e gjëra të sajuara. Dhe ju nuk do të jeni në gjendje ta bëni as këtë; nuk është nevoja të jetë aq i madh sa i gjithë Kur'ani, por sillni** بِعَشْرِ سُوَرٍ *dhjetë sure si të tij***. Por ju nuk do të jeni në gjendje as edhe për këtë; atëherë hajdeni sillni vetëm një sure. Kjo gjithashtu do të jetë shumë e vështirë për ju; atëherë hajdeni e shfaqni një sure të shkurtër... madje ju nuk e bëni dhe nuk do të mund ta bëni, megjithëse nevoja e juaj për ta bërë është shumë e madhe, pasi nderi e sedra juaj, feja, nderi fisnor e krenaria, jeta juaj, pasuria, jetët tuaja në këtë botë dhe në tjetrën do të ishin të gjitha të shpëtuara po të prodhohej një vepër si shembulli i Kur'anit. Përndryshe, në këtë botë ju do të mbeteni të poshtëruar, pa nder, pa dinjitet, pa sedër,**

[36] Kur'an; 11:13

pa fe, pa krenari, dhe jetët e pasuritë tuaja do të shkatërrohen e do të zhduken dhe, në Ahiret, siç tregohet nga vërseti:

فَاتَّقُوا النَّارَ الَّتِي وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ

"Atëherë kini frikë zjarrin (Xhehennemin), lënda djegëse e të cilit janë njerëz e gurë."[37]

Ju do të dënoheni me burgosje të përjetshme në Ferr; së bashku me idhujt tuaj ju do të jeni lënda djegëse për zjarret e tij. Meqenëse nevoja juaj është kaq e madhe, dhe meqenëse ju tani e keni kuptuar pafuqinë tuaj në tetë shkallë, sigurisht ju duhet ta dini tetë herë më shumë se Kur'ani është një mrekulli; prandaj, ose ejani në iman, ose jini të heshtur e shkoni në Ferr! Atëherë shikojeni mënyrën e shpjegimit të mrekullueshëm të Kur'anit që i detyron ata të pranojnë argumentin në këtë kategori të "heshtjes me argumenta"**,** e cila është brenda kategorisë së shpjegimit, dhe thotë: Nuk ka mënyrë më të mirë shpjegimi se sa ajo e Kur'anit."

لَيْسَ بَعْدَ بَيَانِ الْقُرْآنِ بَيَانٌ

"Po, në të vërtetë, nuk mbetet më nevojë për shpjegim të mëtejshëm pas atij të Kur'anit."

Shpjegimi i dytë:

فَذَكِّرْ فَمَا أَنْتَ بِنِعْمَتِ رَبِّكَ بِكَاهِنٍ وَلَا مَجْنُونٍ ۞ أَمْ يَقُولُونَ شَاعِرٌ
نَتَرَبَّصُ بِهِ رَيْبَ الْمَنُونِ ۞ قُلْ تَرَبَّصُوا فَإِنِّي مَعَكُمْ مِنَ الْمُتَرَبِّصِينَ ۞
أَمْ تَأْمُرُهُمْ أَحْلَامُهُمْ بِهَٰذَا أَمْ هُمْ قَوْمٌ طَاغُونَ ۞ أَمْ يَقُولُونَ تَقَوَّلَهُ بَلْ لَا يُؤْمِنُونَ
۞ فَلْيَأْتُوا بِحَدِيثٍ مِثْلِهِ إِنْ كَانُوا صَادِقِينَ ۞ أَمْ خُلِقُوا مِنْ غَيْرِ شَيْءٍ أَمْ هُمُ الْخَالِقُونَ ۞
أَمْ خَلَقُوا السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ بَلْ لَا يُوقِنُونَ ۞ أَمْ عِنْدَهُمْ خَزَائِنُ رَبِّكَ أَمْ هُمُ

[37] Kur'an; 2:24

الْمُصَيْطِرُونَ ۞ أَمْ لَهُمْ سُلَّمٌ يَسْتَمِعُونَ فِيهِ فَلْيَأْتِ مُسْتَمِعُهُمْ بِسُلْطَانٍ مُبِينٍ ۞
أَمْ لَهُ الْبَنَاتُ وَلَكُمُ الْبَنُونَ ۞ أَمْ تَسْأَلُهُمْ أَجْرًا فَهُمْ مِنْ مَغْرَمٍ مُثْقَلُونَ ۞ أَمْ
عِنْدَهُمُ الْغَيْبُ فَهُمْ يَكْتُبُونَ ۞ أَمْ يُرِيدُونَ كَيْدًا فَالَّذِينَ كَفَرُوا هُمُ الْمَكِيدُونَ
۞ أَمْ لَهُمْ إِلَٰهٌ غَيْرُ اللَّهِ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ ۞

Këtu ne do të shpjegojmë vetëm një nga mijëra të vërteta të këtyre vërseteve si një shembull i mëtejshëm i kategorisë së "heshtjes përmes argumentit"; ai është si më poshtë: Me fjalën, أَمْ - أَمْ *(Apo mos..., apo...)*, ai i hesht çdo grup të popullit të çudhëzimit me një pyetje retorike në pesëmbëdhjetë nivele duke shprehur habi dhe i mbyll të gjitha burimet e dyshimeve të tyre. Ai nuk lë plasa djallëzore permes të cilave mund të hyjnë dyshimet e të fshehin vetveten; ai i mbyll ato të gjitha. Ai nuk lë perde çudhëzimi poshtë të cilave ato mund të fshihen; ai i gris të gjitha ato. Ai nuk lë asgjë nga gënjeshtrat e tyre; ai i dërrmon ato. Ai në çdo fjali ose shkatërron esencën e ideve blasfemuese e mallkuese të një grupi permes një fraze të shkurtër, ose meqenëse ajo refuzohet në detaje tek vërsetet e tjera, ai aludon këtu për të shkurtazi.

Për shembull, fjalia e parë aludon për vërsetin:

وَمَا عَلَّمْنَاهُ الشِّعْرَ وَمَا يَنْبَغِي لَهُ

"Dhe Ne nuk i kemi mësuar atij (Muhammedit a.s.m) poezi dhe as që i shkon (kjo gjë atij)." [38]

Ndërsa fjalia e pësëmbëdhjetë tregon këtë vërset:

لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا

"Po të kishte pasur në to (në qiej e në tokë) perëndi të tjera përveç All-llahut, atëherë padyshim që të dyja, toka dhe qiejt, do të ishin shkatërruar..." [39]

[38] Kur'an; 36:69
[39] Kur'an; 21:22

Ju mund të sillni shembuj të tjerë nga fjalitë e tjera si këto: Si më poshtë: Ajo thotë në fillim: “Shpalli urdhëresat Hyjnore. Ti nuk je një falltar, sepse fjalët e falltarit janë të ngatërruara e të supozuara. Ndërsa fjalët e tua janë të vërteta e të sigurta. Dhe ti nuk je i çmendur; madje edhe armiqtë e tu e vërtetojnë dhe e dëshmojnë gjendjen tënde të përsosur mendore.”

أَمْ يَقُولُونَ شَاعِرٌ نَّتَرَبَّصُ بِهِ رَيْبَ الْمَنُونِ

“Ose ata thonë: Ai (Muhammedi a.s.m.) është vjershëtor! Ne po presim kur t’i bjerë ndonjë fatkeqësi ndërkohë!” [40]

“A të thërrasin ty poet, ashtu si mohuesit e paarsyeshëm ordinerë? A presin ata shkatërrimin tënd? Thuaju ti atyre: ‘Pritni! Edhe unë do të pres me ju!’ Sepse të vërtetat e tua të mëdha e të shndritshme janë pa imagjinatat e poezisë dhe të pavarura nga zbukurimet me fantazi të tyre.”

أَمْ تَأْمُرُهُمْ أَحْلَامُهُم بِهَٰذَا

“A mendjet e tyre ua udhëzojnë atyre këtë?”[41]

“Apo si filozofët e paarsyeshëm të cilët mbështeten në mendjet e tyre, që ngurrojnë të të ndjekin ty duke thënë: ‘Aftësitë tona të arsyes janë të mjaftueshme’, ndonëse vetë arsyeja urdhëron që ti të ndiqesh, pasi çdo gjë që ti thua është e arsyeshme? Por megjithatë, përsëri arsyeja nuk mund ta arrijë vetë atë.”

أَمْ هُمْ قَوْمٌ طَاغُونَ

“Apo ata janë njerëz që kalojnë çdo kufi?”[42]

Apo arsyeja e mohimit të tyre është mosnënshtrimi i tyre ndaj Zotit të Gjithëfuqishëm si tiranët e këqinj? Por fundi i Faraonit e i Nimrudit, të cilët ishin udhëheqësit e shtypësve arrogantë, është i njohur.”

---

[40] Kur’an; 52:30
[41] Kur’an; 52:32
[42] Kur’an; 52:32

أَمْ يَقُولُونَ تَقَوَّلَهُ بَل لَّا يُؤْمِنُونَ

"Apo mos thonë: Ai (Muhammedi a.s.m.) e ka shpikur atë (Kur'anin)? Përkundrazi, ata nuk kanë fare qëllim të besojnë."[43] "Apo si hipokritët gënjeshtarë pa ndërgjegje, të cilët të akuzojnë ty duke thënë: Ti e ke shpikur Kur'anin! Por deri tani në këtë kohë ata të kanë njohur ty që je më i vërteti midis tyre e të kanë quajtur ty **'Muhammedi i besuari.'** Por kjo do të thotë se ata nuk kanë qëllim të besojnë. Përndryshe, le të gjejnë ata si shembulli i Kur'anit midis veprave të njerëzve."

أَمْ خُلِقُوا مِنْ غَيْرِ شَيْءٍ

"A u krijuan ata nga asgjë?"[44] "Apo si filozofët absurdë që e besuan universin të ishte kot e i pa qëllim, dhe a e pandehin ata vetveten të jenë pa qëllim, pa urtësi, pa objektiv e detyrë, apo pa Krijues? A janë verbuar ata saqë nuk shikojnë se universi, nga njëri skaj tek tjetri, është zbukuruar me shembuj urtësie dhe mban rezultatin e qëllimeve, dhe se qëniet nga grimcat gjer tek diejt janë të ngarkuara me detyra dhe u janë nënshtruar urdhëresave Hyjnore?"

أَمْ هُمُ الْخَالِقُونَ

"...Apo ata vetë qenë Krijuesit?"[45]

"Ose, a imagjinojnë ata, si Faraonët e si materialistët, se gjërat erdhën vetvetiu në ekzistencë, zhvillojnë vetveten, ushqejnë vetveten dhe krijojnë vetë gjithçka që u nevojitet, dhe nuk besojnë e nuk e adhurojnë All-llahun? Kjo do të thotë, se gjithësecili nga ata ta pandehë vetveten të jetë krijues, në një kohë që krijuesi i një gjëje duhet të jetë krijuesi i gjithçkaje. Me fjalë të tjera, mendjemadhësia dhe kryelartësia e tyre i kanë bërë aq shumë të çmendur, saqë ta përfytyrojnë atë -njeriun- i cili është shumë i pafuqishëm dhe që mund të shpartallohet nga një mizë apo mikrob, të jetë i Plotfuqishmi Absolut. Meqenëse ata e kanë braktisur arsyen dhe humanizmin e tyre

[43] Kur'an; 52:33
[44] Kur'an; 52:34
[45] Kur'an; 52:35

gjer në këtë shkallë dhe kanë zbritur më poshtë se kafshët, madje më poshtë se sa gjërat e pajeta, mos u brengos për mohimin e tyre. Konsideroji ata si një specie e dëmshme kafshësh dhe një lëndë e ndyrë! Injoroji ata e mos u jep rëndësi!

أَمْ خَلَقُوا السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ بَل لَّا يُوقِنُونَ

"Apo mos i krijuan ata qiejt dhe tokën? Por ata nuk kanë aspak besim të qëndrueshëm!"[46]

"Apo si *Muattilet* e pamend e konfuzë, të cilët mohuan Zotin xh.sh. , të gjitha atributet e Tij, dhe mohuan Krijuesin, a e mohojnë ata All-llahun xh.sh. e nuk i kushtojnë vëmendje Kur'anit? Në çdo rast, le ta mohojnë ata ekzistencën e qiejve e të tokës, ose le të thonë: 'Ne i krijuam ato!' Le ta humbasin krejtësisht mendjen e tyre, e le të fillojnë të shprehin fjalë të përçarta e të tërbuara çmendurie; sepse provat e Njësisë në qiell janë aq të qarta, që lexohen, e aq të shumta sa yjet, dhe në tokë janë aq të shumta sa lulet. Kjo do të thotë se ata nuk kanë qëllim të marrin dije të sigurtë e të gjejnë të vërtetën. Përndryshe, si pandehin ata se mos libri i universit është pa shkrues, në një fjalë të të cilit është shkruar një libër i tërë, në një kohë që ata e dinë se 'një shkronjë nuk mund të ekzistojë pa atë që e shkroi atë shkronjë?"

أَمْ عِندَهُمْ خَزَائِنُ رَبِّكَ

"Apo mos kanë ata thesaret e Zotit tënd?" [47]

"Apo si një grup nga filozofët e çudhëzuar të cilët mohuan Dëshirën Hyjnore, apo si *Brahmanët*; a e mohojnë origjinën e Profetësisë që nuk të besojnë ty? Atëherë, le t'i mohojnë të gjitha shenjat e urtësisë e të qëllimit, të gjithë rregullin dhe frutat që janë të dukshëm tek të gjitha qëniet dhe që demonstrojnë vullnet e përzgjedhje; le t'i mohojnë ata të gjitha veprat e mëshirës e të mirësisë dhe të gjitha mrekullitë e të gjithë profetëve! Ose le të thonë: 'Të gjithë thesaret e mirësive që u jepen krijesave janë me ne e nën kontrollin tonë', le të provojnë se ata nuk janë të përshtatshëm për t'iu drejtuar

[46] Kur'an; 52:36
[47] Kur'an; 52:37

adresimi! Atëherë, mos u dëshpëro për mohimin e tyre; thuaj: Kafshët e paarsyeshme të Zotit janë shumë! ”

أَمْ هُمُ الْمُصَيْطِرُونَ

“Apo ata janë tiranët me të drejtë e forcë për të bërë si të duan?”[48]

Apo si *Muëtezilitët* arrogantë, të cilët e bënë sunduese arsyen, a e imagjinojnë veten si rivalë dhe inspektorë për punët e Krijuesit, dhe duan ta bëjnë përgjegjës Krijuesin e Gjithëlavdishëm? Ruhu, mos u ligështo! Asgjë nuk mund të vijë nga mohimet e njerëzve egoistë dhe të tjerëve si ata! As mos u mashtro.”

أَمْ لَهُمْ سُلَّمٌ يَسْتَمِعُونَ فِيهِ فَلْيَأْتِ مُسْتَمِعُهُمْ بِسُلْطَانٍ مُبِينٍ

“Apo mos kanë shkallë për t’u ngjitur (në qiell) me anë të të cilave ata të dëgjojnë (të fshehtat e tij)? Atëherë le të nxjerrin dëgjuesit e tyre ndonjë provë të qartë!” [49]

“Apo si spiritualistët e falltarët shtiracakë e mashtrues, a shkojnë ata pas shejtanëve e xhindeve dhe supozojnë se kanë gjetur një rrugë tjetër për botën e padukshme? Në çdo rast, a kanë ata një shkallë nëpërmjet të cilës të ngjiten në qiejt që janë të mbyllur për shejtanët? A imagjinojnë se ata e përgënjeshtrojnë atë që ti merr nga lajmi i qiellit? Mohimet e sharlatanëve të tillë nuk vlejnë fare.”

أَمْ لَهُ الْبَنَاتُ وَلَكُمُ الْبَنُونَ

“Apo mos Ai (All-llahu) ka vetëm bija e ju keni bijtë?”[50]

“Apo si filozofët politeistë, të cilët i përshkruajnë ortakë Zotit xh.sh. në emrin e “dhjetë mendjeve” dhe “dhjetë zotrave të llojeve”, dhe si *Sabeanët* të cilët u atribuojnë një llojë hyjnie yjeve dhe engjëjve? A fëmijë i përshkruajnë ata Zotit xh.sh.? Dhe si heretikët e të çudhëzuarit, a djalë i përshkruajnë Atij, gjë që është kundra domosdoshmërisë së ekzistencës së Njësisë, përjetshmërisë dhe

[48] Kur’an; 52:37
[49] Kur’an; 52:38
[50] Kur’an; 52:39

vetëmjaftueshmërisë Absolute të Krijuesit të Vetëm? A femëri u përshkruajnë ata engjëjve që është në kundërshtim me adhurimin e engjëjve, me pastërtinë dhe me llojin e natyrës së tyre? A supozojnë ata se ka ndërmjetës për ta, që ata nuk të ndjekin ty? Riprodhimi është mjet shumimi, i ndihmës reciproke, i përjetësimit dhe i jetës për krijesat si njeriu i cili është kalimtar e i përkohshëm, që ka nevojë për përjetësimin e species, që është trupor e i ndashëm, i aftë për t'u shumuar, i pafuqishëm dhe nevojtar për një trashëgimtar për ta ndihmuar atë. Atëherë, t'i përshkruash fëmijë –e sidomos ato që janë të dobëta e të paafta, domethënë vajzat me të cilat nuk kënaqej krenaria e tyre– Krijuesit të Gjithëlavdishëm që ekzistenca e të Cilit është e domosdoshme dhe e përjetshme, i Cili qëndron nga parapërjetësia e paspërjetësia përjetësisht, që esenca e të Cilit është krejtësisht e largët nga trupësia dhe është shumë lart prej nevojave fizike, Qënia e të Cilit është e përjashtuar nga ndarja e shumimi dhe Fuqia e të Cilit është shumë e lartë e nuk mund ta prekë atë pafuqia, do të ishte në të vërtetë një kllapi, një përçartje çmendurie e një marrëzi e tillë, saqë gënjeshtrat dhe mohimet e atyre fatkëqinjve që pajtohen me një ide të tillë nuk vlejnë fare. Ti nuk duhet të mashtrohesh. Gjepurave të mendjelehtëve dhe përçartjeve e kllapive të çdo të çmenduri nuk duhet t'u kushtohet vëmendje."

أَمْ تَسْـَٔلُهُمْ أَجْرًا فَهُم مِّن مَّغْرَمٍ مُّثْقَلُونَ

"Apo mos është se ti kërkon ndonjë shpërblim, kështu që ata janë ngarkuar me barrë të rëndë borxhi?"[51]

"Apo ata i shohin detyrimet e adhurimit të cilat ti ua kërkon si barrë e rëndë mbi ta? Ashtu siç i shohin adhuruesit rebelë e kryelartë të kësaj bote, të cilët e kanë bërë zakon lakminë e kopracinë! A nuk e dinë ata se ti nuk e kërkon shpërblimin tënd veçse nga All-llahu xh.sh.? A është barrë e rëndë për ta që t'u japin të varfërve një të dyzetën nga pasuria ose një të dhjetën, të cilën ua dhuroi atë Zoti i Plotfuqishëm, që t'u shtohej bereqeti i pasurisë dhe të shpëtonin nga smira e mallkimi i të varfërve? A e konsiderojnë të rëndë urdhrin e dhënies së *zeqatit* dhe prandaj ata ikin nga Islami? përgënjeshtrimet e

[51] Kur'an; 52:40

tyre nuk kanë rëndësi, dhe ajo që ata meritojnë është një goditje dhe jo një përgjigje...”

أَمْ عِندَهُمُ الْغَيْبُ فَهُمْ يَكْتُبُونَ

“Apo mos është me ta bota e padukshme dhe ata e shkruajnë?”[52]

“Apo si Budistët[53] që pretendojnë se e njohin të padukshmen, apo si të patrutë që imagjinojnë se hamendjet e tyre në çështje të së padukshmes janë të sakta? A nuk u pëlqejnë atyre ajo që ti merr nga njoftimet e sigurta të së padukshmes? A kanë ata ndonjë libër nga e padukshmja, që nuk pranojnë librin tënd rreth të padukshmes?

Atëherë, bota e padukshme u zbulohet veçse profetëve të cilët marrin shpallje, dhe askush tjetër nuk mundet kurrë të hyjë vetë te ajo. Ata e imagjinojnë botën e padukshme si të ishte e hapur dhe pranë tyre dhe të merrnin njoftime e t’i shkruanin. Prandaj, mos lejo që gënjeshtrat e këtyre mburravecëve arrogantë të cilët kaluan e braktisën orientimin e tyre dhe që tejkaluan limitet, të të shkurajojnë, sepse në një kohë të shkurtër, të vërtetat e tua do t’i dërrmojnë imagjinatat e tyre!

أَمْ يُرِيدُونَ كَيْدًا فَالَّذِينَ كَفَرُوا هُمُ الْمَكِيدُونَ

“Apo mos kanë qëllim ndonjë kurth (kundër teje)? Por ata që nuk besojnë bien vetë në kurth!”[54]

“Ose a dëshirojnë ata të jenë si hipokritët sharlatanë dhe si ateistët dredharakë, natyrat e të cilëve janë të prishura dhe që ndërgjegjet e tyre janë të kalbura, a duan ata t’i mashtrojnë e t’i largojnë njerëzit nga udhëzimi të cilin ata nuk mund ta fitojnë? I mashtrojnë ata duke i bërë që të të thërrasin ty falltar, i çmendur apo magjistar? A duan ata t’i bëjnë të tjerët të besojnë atë çfarë ata vetë nuk besojnë? Mos mendo për këta sharlatanë tinzarë, mos i konsidero ata si qënie humane, mos u brengos për dredhitë e mohimet e tyre dhe mos u ligështo! Përkundrazi, shtoji përpjekjet e tua, sepse ata mashtrojnë vetëm shpirtërat dhe vetveten e tyre. Sukseset e tyre në të keqen janë të

[52] Kur’an; 52:41
[53] Si ata që ndjekin fenë e Budës në Kinë dhe në Indi
[54] Kur’an; 52:42

përkohshme; ajo është një taktikë Hyjnore duke i tërhequr gradualisht ata tek humbja."

أَمْ لَهُمْ إِلَٰهٌ غَيْرُ اللَّهِ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ

"Apo mos ka ndonjë zot tjetër përveç All-llahut? I Lartësuar është All-llahu dhe shumë larg gjërave që ata i përshkruajnë Atij ortakë!"[55]

"Apo si *Mexhusët*, të cilët imagjinuan dy zotra të ndarë të quajtur, krijuesi i të mirës dhe krijuesi i së keqes; apo si idhujtarët dhe si adhuruesit e shkaqeve, të cilët u atribuojnë një llojë hyjnie shkaqeve të ndryshme, dhe secilin nga ato shkaqe e imagjinojnë të jetë burim mbështetjeje për ta? A mbështeten ata në zotra të tjerë e të kundërshtojnë ty? A e konsiderojnë ata vetveten se nuk kanë nevojë për ty?

Kjo do të thotë se ata janë verbuar dhe nuk e shikojnë rregullin aq perfekt dhe harmoninë pa mangësi kudo në univers, që është kaq i dukshëm sa dita. Sepse në përputhje me dekretin Hyjnor

لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا

"Po të kishte pasur në to (në qiej dhe në tokë) perëndi të tjera përveç All-llahut, atëherë padyshim që të dyja (qiejt dhe toka) do të ishin shkatërruar."[56]

Në qoftë se do të ishin dy drejtues në një fshat, ose dy guvernatorë në një qytet, ose dy mbretër në një vend, padyshim rregulli do të përmbysej dhe harmonia do të shkatërrohej. Por, që nga krahu i një mize gjer tek llambat në qiej, një rregull i tillë i hollë është i qartë. Atëherë nuk ka vend as sa krahu i mizës për t'i përshkruar ortakë Zotit xh.sh., por meqenëse këta veprojnë në një mënyrë për të kundërshtuar arsyen, urtësinë, ndjenjat dhe atë që është e qartë, atëherë mos i lër gënjeshtrat e tyre që të të largojnë nga shpallja dhe mesazhi."

Kështu, nga qindra xhevahire të këtyre vërseteve, të cilët formojnë një varg të vërtetash, ne kemi shpjeguar shkurtazi një xhevahir të vetëm të mënyrës së komentimit të Kur'anit në kategorinë e

[55] Kur'an; 52:43
[56] Kur'an; 27:22

"shpjegimit dhe të heshtjes me argumenta." Në qoftë se do të kisha pasur fuqi të tregoja pak më shumë xhevahire, edhe ti gjithashtu do të thoje se "këto vërsete janë mrekulli në vetvete", por mënyra e komentit të Kur'anit në "shpjegimin e në instruktimin" është aq e mrekullueshme, aq e hollë dhe aq e rrjedhshme, saqë edhe njeriu më i thjeshtë e i zakonshëm do ta kuptonte, nëpërmjet atyre shpjegimeve, të vërtetën më të madhe e më të thellë me shumë lehtësi.

Po, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm, thjeshtë e qartë, shpreh e instrukton të vërtetat më të pakapshme në një mënyrë të tillë pa e lënduar ndjenjën e përgjithshme, saqë ledhaton pikëpamjen e përgjithshme të njerëzve dhe as nuk i acaron mendjet e tyre e as nuk i lodh ato. Ashtu sikur flitet me një fëmijë që përdoret fjalë fëmije, po ashtu stilet Kur'anore zbresin tek niveli i atyre që u adresohet dhe quhen

تَنَزُّلَاتٌ إِلٰهِيَّةٌ إِلٰى عُقُولِ الْبَشَرِ '*Të folurit e All-llahut sipas shkallës së të kuptuarit të njerëzve*'.

Me anë të krahasimeve në formën e alegorive, ai i shpjegon një njeriu të zakonshëm e krejtësisht analfabet të vërtetat më të pakapshme Hyjnore dhe misteret Hyjnore, të cilat nuk mund t'i kapë as edhe mendimi i filozofëve më të shquar.

Për shembull, nëpërmjet krahasimit, vërseti:

اَلرَّحْمٰنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوٰى

"*I Gjithëmëshirshmi i Vetëm u vendos në Fron*," [57] tregon Autoritetin Hyjnor sikur të ishte një mbretëri, dhe shkallën e Hyjnisë së Tij në drejtimin e botës dhe sikur të ishte një Mbret i ulur në fronin e sovranitetit të Tij duke udhëhequr qeverinë.

Po, në të vërtetë, si fjala e Krijuesit të Gjithëlavdishëm të universit, Kur'ani ka zbritur nga shkalla më e madhe e Hyjnisë së Tij dhe kalon mbi të gjitha shkallët e tjera, duke i drejtuar ata që të mbërrijnë tek ato shkallë duke kaluar përmes shtatëdhjetë mijë perdeve. Ai e shikon secilin dhe e ndriçon atë. Ai përhap rrezatimin e tij dhe shpërndan dritën e tij për mijëra nivele të

[57] Kur'an; 20:5

atyre që u adresohet, të kuptuarit dhe inteligjenca e të cilëve janë të gjitha të ndryshme. Dhe megjithëse ai ka jetuar midis epokave dhe shekujve, që në lidhje me kapacitetin janë të gjithë të ndryshëm dhe ka përhapur kuptimet e tij me këtë bollëk të madh, ai nuk ka humbur asnjë thërrime nga rinia e tij perfekte, ka ruajtur freskinë e tij të skajshme dhe delikatesën; ai e mëson çdo njeri të zakonshëm në mënyrën më të lehtë, të shkathët e të kuptueshme.

Çdo aspekt i këtij libri të mrekullueshëm, i cili instrukton kështu, bind e kënaq me të njëjtin mësim e me të njëjtat fjalë nivele të shumta të njerëzve, kuptimet dhe gradat e të cilëve janë të gjitha të ndryshme; cilido aspekt të studiohet nga ky libër, padyshim një shkreptimë mrekullie do të shfaqet prej tij.

Shkurtazi: Ashtu si një fjalë e Kur'anit si: ***El'hamdu lil'lah****, i gjithë falënderimi i takon All-llahut,* e cila kur recitohet mbush një shpellë që i ngjason veshit të malit e në të njëjtën mënyrë ajo mbush veshët e vegjël të një mize, po kështu është çështja në kuptimet e Kur'anit. Ai ashtu siç kënaq mendje të mëdha si mali, po ashtu mëson mendje të vogla si miza, mendje shumë të thjeshta duke i qetësuar ato me të njëjtat fjalë. Kjo ndodh se Kur'ani u bën thirrje për besim të gjitha niveleve të xhindeve e të njerëzve dhe u mëson të gjithëve shkencat e besimit duke ua vërtetuar. Prandaj i kushtojnë vëmendje mësimit dhe instruktimit të Kur'anit më i ulëti midis njerëzve të zakonshëm duke qëndruar krah për krah me më të lartin e elitës dhe, gju më gju së bashku ata i dëgjojnë mësimet e Kur'anit dhe përfitojnë prej tij. Me fjalë të tjera, Kur'ani i shenjtë është një tryezë e tillë qiellore në të cilën me mijëra nivele të ndryshme mendjesh, arsyesh, zemrash e shpirtërash gjejnë ushqimin e tyre tek ajo tavolinë; secili sipas asaj që dëshiron dhe përmbush dëshirat e tij. Madje shumë prej dyerve të tij qëndrojnë të mbyllura, me qëllim që t'u hapen atyre që do të vijnë në të ardhmen. Në qoftë se do të donit një shembull të kësaj kategorie, Kur'ani nga fillimet e tij deri në fund formon shembuj të kësaj kategorie. Në të vërtetë, të gjithë studentët e Kur'anit dhe ata që i dëgjojnë mësimet e tij si, interpretuesit e sheriatit, të vërtetët, filozofët Islamë, të urtit, studiuesit e jurisprudencës, teologët, evlijatë, udhëheqësit shpirtërorë, ashikët e Zotit xh.sh., studiuesit e mirëfilltë

dhe masat e muslimanëve.., të gjithë me unanimitet deklarojnë: *"Ne e marrim udhëzimin nga Kur'ani në formën më të mirë."*

Përmbledhja: Shkreptimat e mrekullisë së Kur'anit vezullojnë në kategorinë e "shpjegimit e të instruktimit" ashtu siç bëjnë ato në kategoritë e tjera.

❑ RREZJA E DYTË:

Kjo rreze është gjithëpërfshirja e jashtëzakonshme e Kur'anit. Ajo përbëhet nga **"Pesë shkreptima".**

Shkreptima e parë:

Kjo është gjithëpërfshirja në fjalët e tij. Kjo gjithëpërfshirje është krejtësisht e qartë nga vërsetet e përmendura tek "Fjalët e mëparshme" dhe tek "Kjo Fjalë."

Po, në të vërtetë, ashtu siç tregon hadithi:

لِكُلِّ اٰيَةٍ ظَهْرٌ وَبَطْنٌ وَحَدٌّ وَمُطَّلَعٌ وَلِكُلِّ شُجُوْنٌ وَغُصُوْنٌ وَفُنُوْنٌ

"Çdo vërset ka një kuptim të jashtëm e një kuptim të brendshëm, ka një limit, një qëllim dhe secila ka rrënjë, degë e degëzime", fjalët e Kur'anit janë vendosur në një mënyrë të tillë, saqë çdo frazë, çdo fjali, madje çdo shkronjë, e ndonjëherë edhe një *sukun* -boshllëk- ka shumë aspekte. Ai u jep çdonjërit, prej atyre të cilëve ai u adresohet, pjesën e tij nga një derë e ndryshme.

Për shembull: وَالْجِبَالَ اَوْتَادًا *"Dhe (Ne i kemi bërë) malet si shtylla mbështetëse?* Kjo është një frazë që nënkupton: *"***Unë i bëra malet si shtylla mbështetëse për tokën tuaj."**

Pjesa e një njeriu të zakonshëm nga kjo frazë do të ishte: Ai i shikon malet që duken si shtylla të ngulura në tokë, mendon për dobitë e mirësitë në to dhe i jep falënderime Krijuesit të tij.

Pjesa e një poeti nga kjo frazë do të ishte*:* Ai e përfytyron tokën si një fushë mbi të cilën është ngrehur një hark i gjërë, kupa e qiellit, si

një çadër e madhe jeshile e zbukuruar me llamba elektrike; i shikon majat e maleve si bazat e qiejve e sikur të ishin kunjat e çadrës, ai e adhuron Krijuesin e Gjithëlavdishëm me një çudi të mahnitshme.

Pjesa e një nomadi elokuent (e një banori çadre) nga kjo frazë do të ishte: Ai e përfytyron sipërfaqen e tokës të jetë një shkretëtirë e gjërë; i përfytyron vargmalet si çadra nomadësh të shumta e të shumëllojshme; dhe sikur shtresa e dheut -tokës- të ishte hedhur mbi shtyllat e larta, dhe majat e mprehta të shtyllave të kishin ngritur lart mbulesën e dheut, të cilin ai e shikon si banor i krijesave të ndryshme duke parë njëri-tjetrin. Kështu ai bie në sexhde i mahnitur para Krijuesit të Gjithëlavdishëm, i Cili i vendosi e i nguli kaq lehtë këto qënie madhështore e të fuqishme sikur ato të ishin çadra në faqen e tokës.

Pjesa e një gjeografi me dhunti letrare nga kjo frazë do të ishte: Ai e mendon globin tokësor si një anije duke lundruar në oqeanin e ajrit ose të eterit, ndërsa malet si direkë e pajorë të ngulur në anijen për ekuilibrin dhe qëndrueshmërinë e saj. Ai kështu mendon e pohon përpara madhështisë së të Gjithëfuqishmit Absolut, i Cili e bëri globin e madh tokësor si një anije të mirorganizuar, na vendosi ne në të, dhe e bën atë të udhëtojë në largësitë më të skajshme të universit, duke thënë:

سُبْحَانَكَ مَا اَعْظَمَ شَانَكَ

"Lavdia të takon Ty o Zot. Sa i lartë është Dinjiteti Yt"

Pjesa e një sociologu e filozofi të shoqërisë njerëzore do të ishte: Toka është një shtëpi, dhe shtyllat madhështore të jetës së asaj shtëpie janë jetët e gjallesave, ndërsa shtyllat mbështetëse të jetës së gjallesave janë uji, ajri dhe toka të cilat janë kushtet e jetës. Dhe shtyllat e direkët mbështetëse të ujit, ajrit dhe të tokës janë malet, sepse malet janë rezervuarët për ujë, krëhërit për ajrin –ato shtyjnë e hedhin gazin e dëmshëm dhe e pastrojnë atë;– dhe janë mbrojtësit për tokën nga transformimi në një moçalishte si dhe nga cënimi e shkelja e detit. Për më tepër, ato janë thesaret për domosdoshmëri të jetës njerëzore. Kështu, ai e kupton dhe me nderim e me respekt të plotë i jep lavdërime e falënderime Krijuesit të Gjithëlavdisë e të Mirësisë, i Cili i

bëri këto male të larta si shtylla për tokën –shtëpinë e jetës sonë– në këtë mënyrë dhe i caktoi ato si ruajtësit e thesareve të jetës sonë.

Pjesa e një studiuesi të filozofisë natyrale nga kjo frazë do të ishte kjo: Ai do të mendonte për tërmetet e lëkundjet që ndodhin si rezultat i ngritjeve të shtresave dhe i bashkimit në brendësinë e tokës se ato qetësohen me shfaqjen e maleve, dhe se shkaku i qëndrueshmërisë së tokës në boshtet e saja dhe në orbitën e saj, dhe mosdevijimi në rrotullimin e saj vjetor si rezultat i tronditjes së tërmeteve, është shfaqja e maleve. Është sikur toka të merrte frymë me daljen e maleve, të ulte zemërimin e të qetësohej. Kështu, ai kupton, qetësohet dhe futet plotësisht në besim duke thënë: اَلْحِكْمَةُ لِلّٰهِ *"E gjithë urtësia është e All-llahut xh.sh."*

Një shembull tjetër:

اَنَّ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضَ كَانَتَا رَتْقًا فَفَتَقْنٰهُمَا

"...Se qiejt dhe toka ishin të bashkuara së bashku, si një njësi e vetme krijimi, pastaj Ne i ndamë ato...?"[58]

Një studiues i panjollosur nga studimi i filozofisë do t'i shpjegonte fjalët, رَتْقًا *"të bashkuar së bashku"*, si më poshtë: Ndërsa qiejt shndrisnin dhe ishin pa re dhe toka e thatë, e pajetë dhe e paaftë për të dhënë jetë, atëherë Ai i Cili i hapi dyert e qiellit me shi dhe shtroi tokën me bimësi, është pikërisht Ai që i krijoi të gjitha gjallesat prej atij uji; është sikur qëniet u krijuan përmes një lloji martese dhe një çiftëzimi midis të dyjave. Për t'u realizuar kjo, duhet vepra e një Krijuesi të Vetëm kaq të Fuqishëm e të Githëlavdishëm, saqë faqja e tokës është si një kopsht për Të dhe retë janë si mbulesë e fytyrës së qiellit dhe janë si sfungjerë të atij kopshti. Studiuesi do ta kuptonte kështu e do të binte në sexhde para Madhështisë së Fuqisë së Tij.

Një filozof kozmik do t'i shpjegonte të njëjtat fjalë në këtë mënyrë: Ndërsa në fillim të krijimit qiejt dhe toka ishin masa të paformuara, ku secila përbëhej nga lënda si një brumë i lagësht pa dobi, pa gjallesa e krijesa, Krijuesi i Gjithurtë i shpalosi e i shtriu ato të

[58] Kur'an; 21:30

dyja në një formë të bukur e të dobishme dhe i bëri ato burimin e krijesave të shumta të stolisura. Kështu, filozofi do të qëndronte i habitur përpara gjërësisë së urtësisë së Tij.

Një filozof modern do t'i shpjegonte fjalët kështu: Në fillim, globi ynë dhe planetët e tjerë që formojnë sistemin diellor ishin të bashkuar së bashku me diellin në formën e një brumi të padiferencuar. Atëherë, i Gjithëfuqishmi dhe Vetekzistuesi i Vetëm e shtriu brumin dhe vendosi secilin nga planetët në vendin e vet, duke e lënë diellin atje ku është, lëshoi dritë mbi të dhe duke e sjellë tokën këtu Ai e shtriu dheun mbi globin tokësor, e spërkati me shi nga qiejt dhe e bëri të banueshëm duke na vendosur mbi të. Kështu, filozofi do ta nxirrte kokën prej moçalit të natyrës dhe do të deklaronte:

آمَنْتُ بِاللهِ الْوَاحِدِ الْأَحَدِ

"*Unë besova në Zotin, të Vetmin, të Pashoq."*

Një shembull tjetër:

وَالشَّمْسُ تَجْرِي لِمُسْتَقَرٍّ لَهَا

"Edhe dielli rend në rrugën e tij deri në një kohë (të përcaktuar)."[59]

Atëherë, "Lami" i لِمُسْتَقَرٍّ i përkthyer si, "*deri në, gjer",* shpreh gjithashtu kuptimin e ***"në".*** E kështu besimtarët e zakonshëm e shohin atë si të shprehte kuptimin e ***"gjer në"*** dhe e kuptojnë se dielli, i cili është si një llambë e lëvizshme duke dhënë dritë e nxehtësi për ta, sigurisht do ta përfundojë një ditë udhëtimin e tij dhe do të arrijë vendin e tij të pushimit, atëherë ai merr një formë që s'do të jetë më i dobishëm. Kështu, duke shqyrtuar mirësitë e mëdha që Krijuesi i Gjithëlavdishëm i ka lidhur me diellin, ata deklarojnë: **Subhanall-llah, El-Hamdu lil-lah** *"Lavdia i takon Krijuesit! Gjithë lavdërimet e falënderimet i përkasin Zotit xh.sh. !*

Një studiues i shquar gjithashtu do ta shfaqte "*Lamin"* me kuptimin e "*deri në, gjer"*, por ai do të mendonte për të jo vetëm si një

[59] Kur'an; 36:38

llambë drite, por gjithashtu si një sovajkë duke thurur endje dekorative të Krijuesit në tezgjahun e pranverës e të verës, si një shishe boje, që boja e së cilës është dritë për Letrat e të Përjetshmit të Vetëm të cilat shkruhen në fletën e natës e të ditës. Dhe duke menduar për sistemin dhe rregullsinë e botës, nga e cila lëvizja e jashtme dhe e dukshme e diellit është një shenjë dhe për të cilën ajo tregon, ai do të binte në sexhde përpara urtësisë së Tij duke thënë: **Mashall-llah!** *Çfarë çudirash ka dashur Zoti xh.sh.*!, dhe përpara artit të Krijuesit të Gjithurtë thotë: **Barekall-llah!,** *Sa të mëdha janë bekimet e Tij*!

Një gjeograf e astronom do ta shpjegonin "*Lamin"* me kuptimin **"*në"*** si më poshtë: Nëpërmjet urdhrit Hyjnor, me një sustë e hedhje si një lëvizje në boshtet e tij, dielli rregullon, organizon e vë në lëvizje sistemin diellor. Dhe me habi e çudi përpara Krijuesit të Gjithëlavdishëm, i Cili krijon e vendos kështu në rregull këtë orë të madhe, ai thotë: **"E gjithë madhështia e fuqia janë të Zotit!"** Ai do ta flakte tutje filozofinë e do të përqafonte urtësinë e Kur'anit.

Një dijetar i përpiktë do ta konsideronte këtë "*Lam"* si ***shkakor*** dhe ***ndajfoljor,*** dhe do ta shpjegonte atë si më poshtë: Meqenëse Krijuesi i Gjithurtë i ka bërë shkaqet e jashtme si perde për aktet e Tij, nëpërmjet një ligji të përgjithshëm Hyjnor i quajtur "gravitet", Ai i ka lidhur planetët tek dielli si gurët në një bahe dhe i bën ato nëpërmjet atij graviteti të rrotullohen me lëvizje të ndryshme por të rregullta e të organizuara brenda sferës së urtësisë së Tij; dhe me qëllim që t'i japë lindje gravitetit, Ai e ka bërë lëvizjen e diellit rreth boshtit të tij një shkak të jashtëm. Domethënë, kuptimi i لِمُسْتَقَرٍّ është:

فِي مُسْتَقَرٍّ لَهَا لِاسْتِقْرَارٍ مِنْ مُنْظُومَتِهَا

"Deri në një kohë -vend- të përcaktuar" është një lëvizje në vendin e kohën e përcaktuar për qëndrueshmërinë e sistemit diellor", sepse lëvizja lind nxehtësi, nxehtësia lind fuqi dhe fuqia lind gravitet të jashtëm. Ai është një kanun Hyjnor e një ligj Hyjnor.

Kështu, duke e kuptuar këtë nga një shkronjë e vetme e Kur'anit, ky filozof do të deklaronte: **I gjithë lavdërimi e falënderimi i takojnë Zotit. Sigurisht urtësia e vërtetë gjendet në Kur'an, kurse filozofinë pothuajse e konsideroj asgjë."**

Ideja e mëposhtme do t'i ndodhte **një mendimtari me dhunti poetike** nga ky "*Lam"* dhe nga qëndrueshmëria e përmendur lart: "Dielli është një pemë dritëdhënëse, ndërsa planetët janë frutat e saja të lëvizshme... Por në kundërshtim me pemët, dielli lëkund vetveten që të mos bien frutat. Në qoftë se ai nuk do ta lëkundte vetveten, ato do të binin e do të shpërndaheshin." Atëherë ai do të mendonte me vete: "Dielli është si një udhëheqës shpirtëror i një rrethi *dhikri* -përmendje e Zotit- që po recitojnë Emrat e Zotit xh.sh.. Kështu, ai e përmend Zotin në qendrën e rrethit me një dashuri tepër të zjarrtë dhe i bën të tjerët të recitojnë". Në një trajtesë tjetër, unë e përshkrova këtë kuptim si më poshtë:

"Po, dielli është një pemë që mban fruta; ai tund vetveten që të mos bien planetët, që janë frutat e tij...

Në qoftë se ai do të qëndronte në heshtje, forca tërheqëse do të pushonte.. dhe ata ashikë të mirorganizuar do të bërtisnin nëpër hapësirë në ekstazë."

Një shembull tjetër:

أُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

"...Dhe janë ata që do të jenë më të suksesshmit, të shpëtuarit."[60]

Ky vërset është i përgjithshëm e i papërcaktuar. Ai nuk specifikon se në çfarë mënyre do të jenë ata të suksesshëm, të shpëtuar; kështu çdo person mund të gjejë në të çfarë ai dëshiron. Vërseti e shkurton fjalën me qëllim që të zgjerohet kuptimi, sepse qëllimi i disave prej atyre të cilëve ai u adresohet është të jenë të shpëtuar nga zjarri. Të tjerët mendojnë vetëm për parajsë, disa dëshirojnë lumturi të përjetshme. Një grup kërkon vetëm kënaqësinë e Zotit xh.sh., kurse një grup tjetër kanë synimin më të lartë dhe shpresojnë e dëshirojnë shikimin e Krijuesit Hirplotë, e kështu me radhë.. Në shumë vende Kur'ani i lë fjalët të hapura kështu si kjo, pra që ato mund të jenë të përgjithshme. Ai i lë gjërat të pathëna, lë në heshtje diçka me qëllim që ato të mund të shprehin shumë kuptime. Ai i shkurton e i përmbledh me qëllim që gjithësecili të gjejë pjesën e tij. Kështu, kur thotë:

[60] Kur'an; 2:5

ٱلْمُفْلِحُونَ *"...që do të jenë të suksesshmit*, të shpëtuarit,*"* ai nuk përcakton se si ata do të kenë sukses; është sikur vërseti me heshtjen e tij të thonte:

"O Muslimanë!.. Merrni lajme të gëzueshme. O ju që keni frikë Zotin xh.sh.!.. Ju do të gjeni mbarësi duke shpëtuar nga Ferri. O njerëzit e drejtë!.. Ju do të gjeni shpëtim e begati në Parajsë. O ju që kërkoni njohjen e Zotit xh.sh.!.. Ju do të arrini kënaqësinë e Zotit xh.sh.! O dashuruesit e Bukurisë së Zotit xh.sh.!.. Ju do të përjetoni shikimin e Zotit Hirplotë, e kështu me radhë."

Kështu, nga mijëra shembuj, ne kemi dhënë vetëm një shembull ku secila nga frazat, fjalët, shkronjat, heshtjet dhe përjashtimet, demonstrojnë gjithëpërfshirjen e fjalëve të Kur'anit. Ju mund t'i krahasoni vërsetet dhe tregimet e tij me këto nëpërmjet analogjisë.

Një shembull tjetër, vërseti,

فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا اللَّهُ وَاسْتَغْفِرْ لِذَنۢبِكَ

"...Dije, pra, se padyshim nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, dhe kërko falje për gjynahin tënd..."[61]

Ky vërset përmban aq shumë aspekte e shkallë, saqë të gjithë nivelet e Evlijave kanë parë prej tij nevojat e tyre tek të gjitha shkallët e tyre dhe kanë gjetur prej tij ushqim shpirtëror, kuptim të freskët e të përshtatshëm për nivelet e tyre, sepse, meqenëse Emri **"All-llah"** është Emër Gjithëpërfshirës, ndodhen brenda tij aspekte të Njësisë Hyjnore sa numri i Emrave të Bukur:

لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ ۝ لَا خَٰلِقَ إِلَّا هُوَ ۝ لَا رَحْمَٰنَ إِلَّا هُوَ

"Nuk ka furnizues tjetër përveç Atij! Nuk ka krijues tjetër përveç Atij! Nuk ka të Gjithëmëshirshëm përveç Atij!" Dhe kështu me radhë.

Dhe për shembull, nga tregimet e Kur'anit, historia e Musait a.s. përmban me mijëra dobi e mësime, ashtu si Shkopi i Musait a.s.. Në tregim ka shumë qëllime e aspekte si:

[61] Kur'an; 47:19

Ngushëllimi, lehtësimi e qetësimi i profetit Muhammed a.s.m. dhe si kërcënimi ndaj jobesimtarëve, poshtërimi ndaj hipokritëve dhe qortimi ndaj çifutëve. Për këtë arsye, ajo përsëritet në shumë sure. Megjithëse ajo i shpreh të gjitha qëllimet në secilin vend, vetëm njëri është qëllimi kryesor, ndërsa të tjerët janë dytësorë.

Në qoftë se ti thua: "Si t'i njohim të gjitha kuptimet në shembujt që ti dhe, për të cilat Kur'ani synon e tregon?"

Ne do të përgjigjeshim: Meqenëse Kur'ani është një fjalim parapërjetësie me të cilin Zoti xh.sh. u flet niveleve të ndryshme të njerëzimit të vënë në radhë, mbi e përtej shekujve dhe i mëson ata të gjithë, padyshim ai do të përfshijë e synojë kuptime të shumta sipas atyre aftësive të ndryshme të të kuptuarit dhe do të bëjë aluzione për çfarë ai synon.

Po, kuptimet e shumta në fjalët e Kur'anit të ngjashme me ato të përmendura këtu janë provuar tek **Isharatul-Ixhaz** sipas rregullave të gramatikës arabe, shkencave të retorikës, semantikës –kuptimor–, dhe sipas elokuencës e rregullave të tyre. Sipas konsensusit të atyre që u cilësuan për të interpretuar ligjin e shenjtë, komentatorëve dhe studiuesve të teologjisë e të sheriatit, sipas dëshmisë së ndryshimeve të tyre me kushtet që ato u konsideruan të sakta nga shkencat e arabishtes dhe u vlerësuan të drejta nga parimet e fesë, të gjitha aspektet dhe kuptimet që gjenden të pranueshme nga shkenca e semantikës, të përshtatshme nga shkenca e retorikës dhe të dëshirueshme nga shkenca e elokuencës janë midis kuptimeve të Kur'anit. Kur'ani ka vënë aluzione e nënkuptime për secilin nga ato kuptime sipas shkallës së tij. Ato, ose janë të fjalëpërfjalshme –të mirëfillta- ose domethënëse – kuptimplota. Në qoftë se janë domethënëse, tregohet një aluzion për secilën nga ato ose nga konteksti i mëparshëm, ose pas kontekstit, ose nga një vërset tjetër. Disa nga ato janë shpjeguar në qindra mijëra komente të Kur'anit me njëzet, tridhjetë, dyzet, gjashtëdhjetë e madje me tetëdhjetë vëllime të shkruara nga dijetarë të saktë, të cilët janë të qartë e prova vendimtare për gjithëpërfshirjen e jashtëzakonshme të fjalëve të Kur'anit. Megjithatë, në qoftë se ne do të duhej të demonstronim në këtë Fjalë çdo aluzion që tregon çdo kuptim së bashku me rregullat e tij, Fjala do të bëhej tej mase e zgjatur... Prandaj ne po e shkurtojmë këtu dhe për pjesë të tij ju referojmë ju tek ***Isharatul-Ixhaz*** *"Shenjat e mrekullisë."*

•**Shkreptima e dytë:** *Është gjithëpërfshirja e jashtëzakonshme në kuptimin e tij*. Në të vërtetë, Kur'ani ka derdhur –dhuruar– nga thesaret e kuptimeve të tij burimet për të gjithë interpretuesit e ligjit Hyjnor, ndriçimet –shijet, eksperiencat– e të gjithë atyre që kërkojnë njohjen e Zotit xh.sh., rrugët e të gjithë atyre që kërkojnë lidhje me Zotin xh.sh., metodat e të gjithë të përkryerve midis njerëzimit, dhe medhhebet e të gjithë dijetarëve të përpiktë; Kur'ani në të gjitha kohët ka qenë udhëzuesi i të gjithë atyre, i ka orientuar ata në përparimin e tyre dhe është vërtetuar me unanimitet nga të gjithë ata se Kur'ani ka ndriçuar rrugët e tyre nga thesaret e tij të pashtershme.

•**Shkreptima e tretë:** ***Kjo është gjithëpërfshirja e tij e jashtëzakonshme në njohurinë e tij.*** Në të vërtetë, Kur'ani ka bërë që, nga oqeani i njohurisë së tij të derdhen shkenca të shumta e të ndryshme të sheriatit, shkenca të shumëllojshme të hakikatit dhe shkenca të ndryshme të shumta të tarikatit. Gjithashtu, Kur'ani ka bërë që nga ai oqean të derdhen me bollëk e rregullsi urtësia e vërtetë e sferës së mundësive për të ndodhur, shkencat e vërteta të sferës së domosdoshmërisë dhe e njohurive të fshehura të sferës së Ahiretit. Do të ishte e nevojshme të shkruhej një vëllim i tërë për të sjellë shembuj të kësaj shkreptime, por si shembull, ne po ju tregojmë Njëzet e pesë Fjalët e shkruara deri tani. Po, të vërtetat e sakta të të gjitha Njëzet e pesë Fjalëve janë vetëm njëzet e pesë pika nga oqeani i njohurisë së Kur'anit. Në qoftë se ka mangësi në ato Fjalë, ato burojnë nga kuptimi im i mangët.

Shkreptima e katërt:

Kjo është gjithëpërfshirja e jashtëzakonshme e temave që ai paraqet. Po, në të vërtetë, Kur'ani ka grumbulluar subjekte e gjëra që i përkasin njeriut dhe detyrave të tij, universit dhe Krijuesit të universit, dynjasë dhe Ahiretit, qiejve dhe tokës, të shkuarës e të ardhmes dhe parapërjetësisë e paspërjetësisë; ai i shpjegon të gjitha esencat dhe çështjet e rëndësishme nga krijimi i njeriut prej lëngut të farës deri kur ai futet në varr; nga etika e saktë e të ngrënit dhe e gjumit deri tek çështjet e kaderit Hyjnor dhe të parapërcaktimit; nga krijimi i botës në gjashtë ditë deri tek detyrat e fryrjes së erërave që tregohen nga betimet në Kur'an si: وَٱلۡمُرۡسَلَٰتِ وَالذَّارِيَاتِ *" (Betohem) për erërat që*

shpërndajnë pluhur!"[62]*;* dhe *"(Betohem) për erërat e çuara një pas një!"*[63], nga ndërhyrja e Tij (e Zotit) në zemrën e njeriut dhe në dëshirën e tij të treguara nga vërsetet:

وَمَا تَشَآءُونَ إِلَّآ أَن يَشَآءَ ٱللَّهُ ۞ يَحُولُ بَيْنَ ٱلْمَرْءِ وَقَلْبِهِۦ

"Dijeni se All-llahu ndërhyn ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij"[64], Dhe *"Por ju nuk mund të dëshironi veçse po deshi All-llahu"*[65],

për tek, وَٱلسَّمَٰوَٰتُ مَطْوِيَّٰتُۢ بِيَمِينِهِۦ *"Dhe qiejt do të jenë të mbështjellë në Dorën e Tij të Djathtë."*[66]

Domethënë, është Ai që i përfshin të gjithë qiejt brenda kapjes së Tij, nga lulet, vreshtat dhe hurmat e tokës të përshkruara në:

وَجَعَلْنَا فِيهَا جَنَّٰتٍ مِّن نَّخِيلٍ وَأَعْنَابٍ *"Dhe Ne kemi bërë në të kopshte hurmash dhe vreshta"*[67], deri tek e vërteta e çuditshme e shprehur nga:

إِذَا زُلْزِلَتِ ٱلْأَرْضُ زِلْزَالَهَا *"Kur toka të dridhet me tronditjen e madhe;"*[68], nga gjendja e qiejve te vërseti:

ثُمَّ ٱسْتَوَىٰٓ إِلَى ٱلسَّمَآءِ وَهِىَ دُخَانٌ

"Atëherë Ai drejtoi (vullnetin e Tij) drejt qiellit kur ai ishte tym."[69]

deri tek çarja e tyre me tym dhe yjet duke rënë e duke u shpërndarë në hapësirën e pafund; nga hapja e Dynjasë për provim e testim gjer tek fundi i provimit; varri i cili është banesa e parë prej banesave të Ahiretit, pastaj nga Berzah (bota e ndërmjetme), ringjallja e Ura e Siratit deri tek Xhenneti, deri tek lumturia e përjetshme; nga ngjarjet e

[62] Kur'an; 51:1
[63] Kur'an; 77:1
[64] Kur'an; 8:24
[65] Kur'an; 76:36
[66] Kur'an; 76:30
[67] Kur'an; 36:34
[68] Kur'an; 99:1
[69] Kur'an; 41:11

së shkuarës, që nga krijimi i trupit të Hazreti Ademit e konflikti i djemve të tij deri tek Përmbytja e Gjithësisë, e deri tek mbytja e popullit të Faraonit, ngjarjet e mëdha të shumicës së profetëve, nga kushti –ngjarja– e parapërjetësisë që nënkuptohet nga vërseti:

أَلَسْتُ بِرَبِّكُمْ *"...(duke u thënë atyre): A nuk jam Unë Zoti juaj?"*[70]

deri tek ndodhja e paspërjetësisë e shprehur nga vërseti:

وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَاضِرَةٌ إِلَىٰ رَبِّهَا نَاظِرَةٌ

"Disa fytyra atë ditë do të jenë që shkëlqejnë (Nadirah). Duke parë Zotin e tyre;"[71]

Të gjitha këto subjekte themelore e të rëndësishme janë shpjeguar në një mënyrë që i përshtatet të Gjithëlavdishmit të Vetëm, i Cili administron të gjithë universin sikur të ishte një pallat, e hap dhe e mbyll Dynjanë e Ahiretin si dy dhoma, e rregullon tokën sikur të ishte një kopsht dhe qiejt sikur të ishin një tavan i stolisur me llamba, e shikon të shkuarën e të ardhmen sikur të ishin dy fletë të pranishme përpara shikimit të Tij si nata e dita, e vështron parapërjetësinë e paspërjetësinë sikur të ishin e djeshmja dhe e nesërmja dhe i shikon ato të dyja si kohën e tashme në të cilën janë lidhur dy anët e zinxhirit të akteve Hyjnore.

Ashtu si një mjeshtër, i cili flet për dy shtëpi që i ka ndërtuar e administruar dhe për programet që lidhen me ato të dyja, bën një fletë pune e një indeks organizimi, po kështu Kur'ani në një formë që i përshtatet Krijuesit të Vetëm i Cili e bëri universin dhe e drejton atë, ka shkruar fletën e punëve të Tij, indekset e programeve të Tij –në qoftë se do të lejohej shprehja– dhe i shfaqi ato. Nuk shikohet në të ndonjë shenjë artificializmi apo ndonjë shfaqje e rreme. Ashtu siç nuk ka ndonjë shenjë imitimi apo ndonjë aluzion dredhie, sikur të flisje në emrin e dikujt tjetër apo të supozonte vetveten të jetë në vendin e dikujt tjetër e duke folur mashtrime të tilla si këto, po ashtu me të gjithë seriozitetin e tij, me të gjithë pastërtinë e tij dhe me të gjithë sinqeritetin e tij, komentimi i pastër, i ndritshëm e brilant i Kur'anit,

[70] Kur'an; 7:172
[71] Kur'an; 75:22-23

deklaron: “Unë jam fjala dhe shpjegimi i Krijuesit të botëve”, ashtu siç deklaron drita e ditës duke thënë: “Unë vij nga dielli.”

Po, në të vërtetë, kush përveç Krijuesit, i Cili e stolisi këtë botë me arte antike dhe e mbush atë me mirësi të shijshme dhe ka shpërndarë për bukuri mbi faqen e tokës së bashku me këto çudira të artit të Tij kaq shumë dhurata të çmueshme e duke i renditur ato në rreshta të sistemuara e duke i spërkatur ato mbi faqen e tokës, atëherë përveç Këtij Dhuruesi mirësish kush tjetër është i përshtatshëm për të qenë autori i këtij shpjegimi të mrekullueshëm të Kur’anit që ka mbushur Dynjanë me vlerësim e madhërim, me lavdërime e falënderime e me admirim, saqë e ka transformuar tokën në një vend për të recituar Emrat e Zotit, në një xhami dhe në një vend për të ekspozuar veprat e artit Hyjnor, kush mund të ishte tjetër përveç Autorit të kësaj fjale? Dhe kush tjetër mund të pretendojë të jetë pronari i tij? A do të ishte e përshtatshme për dritën e cila e mbush Dynjanë me dritë që t’i atribuohej diçkaje tjetër përveç diellit!.. Shpjegimi i Kur’anit i cili zgjidhi enigmën e universit dhe ndriçoi botën, atëherë drita e kujt tjetër do të ishte përveç dritës së Diellit të Përjetësisë i Cili krijoi qiejt e tokën? Dhe kush do të guxonte ta imitojë atë dhe të prodhojë si shembulli i tij!.. Po, në të vërtetë, Ky Krijues, i Cili e stolisi këtë botë me artet e Tij, do të ishte e pamundur të mos flasë me njeriun i cili vlerëson artet e Tij. Dhe meqenëse Ai vepron e njeh, padyshim Ai flet; meqenëse Ai flet, sigurisht është Kur’ani i përshtatshëm për të qenë Fjala e Tij. Atëherë Pronari i Mbretërimit, i Cili nuk tregon indiferentizëm edhe për organizimin e një luleje të vogël, si mund të mbetej indiferent ndaj një fjale, e cila e ka transformuar mbretërinë e Tij në një bujë falënderimesh e lavdërimesh? A do të lejonte Ai që kjo Fjalë t’u atribuohej të tjerëve e të bëhej si asgjë?

• **Shkreptima e pestë:** ***Kjo është gjithëpërfshirja e mrekullueshme e stilit të Kur’anit dhe e thukëtisë së tij.***

Ajo përbëhet nga **“*Pesë flakërima.*”**

❍ ***Flakërima e parë:*** Stili i Kur’anit ka një gjithëpërfshirje kaq të mrekullueshme, saqë një sure e vetme përmban oqeanin e Kur’anit i cili përfshin universin. Një vërset i vetëm përmban thesarin e asaj

sureje. Shumica e vërseteve, çdo ajet prej tyre, janë si një sure e vogël, dhe shumica e sureve, secila prej tyre, janë si një Kur'an i vogël. Kështu kjo është një mirësi e madhe, një udhëzim e lehtësim që burojnë nga thukëtia e stilit të tij të mrekullueshëm, sepse çdo njeriu, pavarësisht nga nevoja e tij për të lexuar Kur'anin në të gjithë kohën, nuk i jepet rasti ta lexojë atë ose për shkak të budallallëkut të tij, ose për ndonjë arsye tjetër dhe, me qëllim që të mos privohet askush nga Kur'ani, çdo sure është si një Kur'an i vogël, madje çdo vërset i gjatë ka rangun e një sureje të shkurtër. Madje ata Evlija që depërtojnë në kuptimin e brendshëm të gjërave, janë të një mendimi se Kur'ani përfshihet në suren "**El-Fatiha**", ndërsa sureja "**El-Fatiha**" përfshihet në "***Bis mil-lah***." Prova e këtij fakti është konsensusi i dijetarëve të saktë që e kanë verifikuar.

❍ ***Flakërima e dytë:*** Vërsetet e Kur'anit janë gjithëpërfshirës përmes tregimit e shprehjes së të gjitha kategorive të të folurit, të njohurive të vërteta dhe nevojave njerëzore, si: Urdhëresa e ndalesa, premtimi e kërcënimi, nxitja e frikësimi, përmbajtja e udhëzimi, tregimet e krahasimet, dekretet Hyjnore dhe mësimet, shkencat që lidhen me universin, ligjet e kushtet e jetës njerëzore, individuale, jetës shoqërore, jetës së zemrës, jetës shpirtërore dhe e jetës së Ahiretit.

Kështu e vërteta e thënies: خُذْمَاشِئْتَ لِمَاشِئْتَ "*Merr çfarëdo që ti dëshiron nga Kur'ani për çfarëdo që dëshiron*", është bërë e pranueshme në një shkallë të tillë nga njerëzit e së vërtetës, saqë midis tyre ajo është bërë proverbiale. Ndodhet një gjithëpërfshirje e tillë në vërsetet e Kur'anit saqë ato mund të jenë shërim për çdo sëmundje dhe ushqim për çdo nevojë. Po, ato duhet të jenë si kjo: Për shkak se është esenciale që ai është udhëzuesi absolut i të gjitha niveleve të njerëzve të plotësimit, të cilët vazhdimisht ngjiten në shkallët e progresit –ai Kur'an– duhet të jetë pronari i kësaj veçorie.

❍ **Flakërima e tretë:** Kjo është thukëtia e mrekullueshme e Kur'anit. Ndonjëherë ndodh që Kur'ani përmend dy anët e një zinxhiri të gjatë në një mënyrë që e tregon qartë të gjithë zinxhirin. Ndonjëherë ndodh se ai përfshin qartë, në mënyrë të nënkuptuar (në heshtje), në mënyrë të figurshme (metaforike) dhe me aluzione, shumë prova të një pohimi në një fjalë.

Për shembull, në vërsetin:

وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦ خَلْقُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَٱخْتِلَٰفُ أَلْسِنَتِكُمْ وَأَلْوَٰنِكُمْ

"Dhe nga treguesit e Tij është krijimi i qiejve e i tokës dhe dallimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaja..."[72]

Duke përmendur fillimin dhe fundin e zinxhirit të krijimit të universit, i cili formon zinxhirin e shenjave dhe treguesve të Njësisë Hyjnore dhe pastaj duke treguar zinxhirin e dytë, ai e bën lexuesin të lexojë zinxhirin e parë. Në të vërtetë, shkalla e parë e fletëve të botës të cilat dëshmojnë për Krijuesin e Gjithurtë është krijimi në fillim i qiejve e i tokës, pastaj stolisja e qiejve me yje, pastaj toka u bë të gëzohej me qënie të gjalla; pastaj është ndryshimi e ndërkëmbimi i stinëve nëpërmjet nënshtrimit të diellit e të hënës; pastaj ndryshimi e ndërkëmbimi i ditës e i natës dhe zinxhiri i ngjarjeve brenda këtyre.

Dhe kështu ai vazhdon deri tek tiparet karakteristike dalluese individuale në shprehjet e fytyrës e në zërat, të cilat janë vende të shtrira më gjërësisht në shumësi e shumëllojshmëri... Kështu, meqenëse ndodhet një rregullsi e çuditshme dhe e urtë në tiparet e shprehjeve të fytyrës së njeriut, të cilat janë më të largëtat prej rregullit, dhe duken më të nënshtruarat ndaj ndërhyrjes së rastësisë, në qoftë se shfaqet që Pena e Mjeshtrit të Gjithurtë vepron tek ato, atëherë padyshim, fletët e tjera, rregulli i të cilave është i qartë, do të kuptohen në vetvete e do të tregojnë Skalitësin e tyre. Dhe meqenëse veprat e artit e të urtësisë së Krijuesit të Vetëm janë të dukshme në krijimin origjinal të qiejve madhështorë e të tokës, i Cili i vendos ato me urtësi si gurët themeltarë të pallatit të universit, veprat e Artit të Tij dhe skalitja e urtësisë së Tij, sigurisht do të jenë më të qartat në qëniet e tjera të Tij. Kështu, duke ekspozuar të fshehurën dhe duke fshehur të dukshmen, ky vërset shpreh ngjeshjen më të bukur të stilit.

Dhe gjithashtu në vërsetet:

فَسُبْحَٰنَ ٱللَّهِ حِينَ تُمْسُونَ

"Lavdërojeni lart pra All-llahun kur ju mbërrini në mbrëmje..."

[72] Kur'an; 30:22

Deri tek,

وَلَهُ الْمَثَلُ الْأَعْلَىٰ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

"...Atij i takon krahasimi më i lartë në qiej dhe në tokë. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, i Gjithurti."[73]

Zinxhiri i provave që gjashtë herë fillon me fjalët:

وَمِنْ آيَاتِهِ ۞ وَمِنْ آيَاتِهِ

"Dhe midis shenjave të Tij..., dhe midis treguesve të Tij...,"

është një zinxhir xhevahiresh, një zinxhir drite, një zinxhir mrekullie dhe një zinxhir i mrekullueshëm i ngjeshjes së stilit. Unë do të dëshiroja nga zemra t'i tregoja diamantet e fshehur në këto thesare, por çfarë mund të bëj, diskutimi këtu nuk e mbështet atë. Prandaj, duke e shtyrë për një kohë tjetër, në dashtë Zoti, unë nuk po e hap tani atë derë.

Dhe për shembull:

فَأَرْسِلُونِ ۞ يُوسُفُ أَيُّهَا الصِّدِّيقُ

"*...Prandaj më dërgoni mua." (i foli):"O Jusuf, njeriu i së vërtetës!"*[74],

kështu ndërmjet فَأَرْسِلُونِ *"...prandaj më dërgoni mua",* dhe يُوسُفُ *"O Jusuf!"* janë këto fjalë:

إِلَىٰ يُوسُفُ لِأَسْتَعْبِرَ مِنْهُ الرُّؤْيَا فَأَرْسَلُوهُ فَذَهَبَ إِلَى السِّجْنِ وَقَالَ يُوسُفُ

"...Tek Jusufi që të mund ta pyes atë për të interpretuar ëndrrën. Atëherë ata e dërguan atë, dhe ai shkoi tek burgu dhe tha Jusufi..."

Domethënë, megjithëse pesë fjali janë shkurtuar e përmbledhur në një fjali, ajo nuk e prish qartësinë dhe as nuk e pengon kuptimin e saj.

---

[73] Kur'an; 30:17-27
[74] Kur'an; 12:46

Dhe për shembull:

الَّذِي جَعَلَ لَكُم مِّنَ الشَّجَرِ الْأَخْضَرِ نَارًا

“ (Ai) i Cili nxjerr për ju zjarrin nga pema e gjelbër.”[75]

Këtu Kur’ani përballë mohimeve të njeriut kundërshtar, i cili sikur po sfidon Krijuesin me thënien e tij: *“Kush do t’u japë jetë këtyre kockave kur të jenë kalbur e të jenë bërë pluhur?”* ***Kur’ani thotë: “****Thuaj: Ai do t’u japë jetë, i Cili i krijoi për herë të parë! Dhe Ai është për çdo krijesë i Gjithëditur!****” Për më tepër, ai thotë:* الشَّجَرِ الْأَخْضَرِ *“...nga pema e gjelbër”* [76]***, Ai pra është i aftë t’u japë jetë kockave të kalbura”.*** Kështu, kjo fjali drejtohet tek pretendimi i ringjalljes përmes disa mënyrave dhe e vërteton atë.

Së pari, me këto fjalë Kur’ani fillon zinxhirin e mirësive të cilat Zoti ia dhuroi njeriut duke ia kujtuar e duke e prekur në ndjenja. Dhe meqenëse e përshkruan me hollësi në vërsete të tjera, ai e shkurton përshkrimin këtu, dhe ia referon arsyes. Me fjalë të tjera, ai thotë: “***Ju nuk mund të ikni nga Ai i Vetmi, i Cili ju jep ju fruta e zjarr nga pemët, ushqim e kokrra nga bimët, drithëra e grurë nga toka dhe gjithashtu e bën tokën një djep të mirë për ju të mbushur me të gjithë ushqimin tuaj dhe e bëri botën një pallat të bukur në të cilin gjenden e përmbushen të gjitha nevojat tuaja, ju nuk mund të jeni të pavarur nga Ai, as të shkoni në mosekzistencë e të fshiheni atje. Ju nuk mund të jeni pa detyra e të hyni në varr për të fjetur në rehati pa u marrë në pyetje e pa u zgjuar.”***

Pastaj tregon një dëshmi të këtij pohimi. Me fjalët الشَّجَرِ الْأَخْضَرِ *“pema e gjelbër”* ajo nënkupton: **“O ti që mohon ringjalljen!.. Shikoji pemët!.. Ai që sjell në jetë në pranverë pemë të panumërta pasi ato kishin vdekur në dimër dhe që u ngjasonin kockave dhe madje në secilën pemë Ai tregon tre shembuj të ringjalljes nëpërmjet gjetheve, luleve dhe frutave –Fuqia e Këtij të**

[75] Kur’an: 36:38
[76] Kur’an; 36:80

Gjithëfuqishmi të Vetëm nuk mund të sfidohet me mohimin apo duke e konsideruar të pagjasë ringjalljen."

Pastaj, ai tregon një dëshmi tjetër duke thënë: **"Ai i Vetmi i Cili nxori për ju zjarrin, atë lëndë të lehtë, të hollë e ndriçuese, nga një pemë e dendur, e rëndë dhe e errët, si e vlerësoni ju të pagjasë për Të që t'u japë një jetë të hollë si zjarri dhe një vetëdije si drita kockave që janë si druri!"**

Atëherë ai deklaron qartë një dëshmi tjetër; ajo thotë: **"Ai i Cili krijon pemën e famshme që, ndërsa është e gjelbër prodhon zjarr për nomadët në vend të shkrepseve kur dy nga degët e saja fërkohen së bashku dhe kombinojnë dy të kundërtat, si të gjelbrën e lagështirën dhe të thatën e nxehtësinë, duke i bërë ato burimin e zjarrit – na tregon ne se çdo gjë, madje elementet bazë shikojnë tek urdhri i Tij dhe lëvizin me anë të Fuqisë së Tij. Atëherë nuk mund të jetë e pagjasë për Atë të Vetmin, i Cili demonstron se asnjëra nga këto dukuri nuk është e pavarur apo të veprojë nga vetvetja, që Ai ta ringjallë përsëri njeriun nga toka, të cilin nga toka e krijoi e që më vonë në tokë e rikthen. Ai nuk mund të sfidohet me mosbindje e kundërshtim."**

Pastaj me fjalën *"pema e gjelbër"*, duke sjellë ndërmend Pemën e famshme të Musait a.s., ajo tregon se ky pretendimi i Muhammedit a.s.m. gjithashtu është ai i Musait a.s., e duke aluduar hollë për konsensusin e profetësisë, ajo i shton një pikë të hollë e një bukuri tjetër frazës.

❍ ***Flakërima e katërt:*** Thukëtia e Kur'anit është aq gjithëpërfshirëse dhe e mrekullueshme, saqë kur studiohet me kujdes, ajo bëhet e dukshme përmes ndonjë ngjarjeje të hollësishme apo të veçantë. Ai me dhembshuri u tregon mendjeve të thjeshta e të zakonshme rregullat e shtrira e të zgjatura universale dhe ligjet e përgjithshme si duke treguar një oqean në një kanë uji. Ne do të tregojmë vetëm dy shembuj të kësaj nga mijëra të tillë:

Shembulli i parë: Janë tre vërsetet e shpjeguara në detaje në stacionin e parë të *"Fjalës së Njëzet"* të cilët përshkruajnë nën emrin e **"*të mësuarit të emrave*"** për personin e Ademit a.s.; vërseti tregon të mësuarit e të gjitha shkencave dhe degëve të njohjes me të cilat janë

frymëzuar bijtë e Ademit**. N**ëpërmjet rënies në sexhde të engjëjve për Ademin dhe mosrënies në sexhde të shejtanit, vërseti tregon se shumica e krijesave nga peshqit gjer tek engjëjt i janë nënshtruar llojit njerëzor, ndërsa krijesat e dëmshme nga gjarpërinjtë gjer tek djajtë nuk i binden njeriut e janë armiqësorë ndaj tij. Nëpërmjet ngjarjes së "therrjes së një lope" nga populli i Musait a.s. vërseti sugjeron: Koncepti i adhurimit të lopës u therr me thikën e Musait a.s.; ai koncept u mor nga adhurimi i lopëve në Egjipt dhe dha efektin e vet te ngjarja e viçit. Nëpërmjet shpërthimit të ujit nga shkëmbi, dhe nëpërmjet burimeve duke vërshuar e duke u shpërndarë, vërseti tregon se shtresa e shkëmbit, e cila është nën shtresën e dheut, vepron si burim e si depozita e ujit, që pajis dheun me çfarë i jepë jetë.

Shembulli i dytë: Kjo është e tëra dhe pjesët e tregimit të Musait a.s. i cili përsëritet shpesh në Kur'an, dhe secila nga përsëritjet shfaqet si cep i një rregulli universal, secila përsëritje duke shprehur rregullin në çështje.

Për shembull:

يَاهَامَانُ ابْنِ لِي صَرْحًا

"O Haman! Ndërto për mua një kullë..."[77]

Faraoni po urdhëron ministrin e tij: "Ndërto për mua një kullë të lartë me qëllim që të mund të shikoj qiejt e të vështroj nëse ndodhet atje ndonjë zot i cili sundon e vepron, ashtu siç pretendon Musai a.s.." Kështu nëpërmjet fjalës صَرْحًا *"Kullë"* vërseti tregon një ngjarjeje të pjesshme e një rregull të çuditshëm dominant në traditat e faraonëve të Egjiptit, të cilët pretenduan hyjninë për shkak të mohimit të Krijuesit dhe për shkak të besimit të tyre tek natyra. Duke adhuruar famën, nëpërmjet shfaqjes së veprave të sundimit të tyre, ata përjetësuan emrin e tyre dhe ndërtuan piramidat e famshme –sikur të ishin male– në mes të shkretëtirës ku nuk ka male, që të bëheshin të famshëm me to dhe ruajtën kufomat e tyre me balsamosje duke i vënë në ato varreza të larta, për shkak të besimit të tyre në ritrupëzimin e shpirtërave e në magjinë.

[77] Kur'an; 40:36

Dhe për shembull:

فَالْيَوْمَ نُنَجِّيكَ بِبَدَنِكَ

"Kështu këtë ditë Ne do ta nxjerrim trupin tënd (të vdekur nga deti)."[78]

Kjo thënie i drejtohet Faraonit i cili u mbyt: "Sot Unë do ta shpëtoj trupin tënd, që është mbytur." Vërseti tregon se çfarë rregulli kishin jetët e faraonëve duke u kujtuar vdekjen që ishte mbushur plot mësime, e cila është kalimi i kufomave të të vdekurve të tyre me balsamosje duke i marrë ato nga e shkuara e duke i dërguar për t'u parë nga brezat e së ardhmes, sipas besimit të tyre në ritrupëzimin e shpirtërave; gjithashtu kjo pjesë fjalie e vërsetit tregon një shkreptimë mrekullie të së padukshmes, se trupi që u zbulua në shekullin aktual është pikërisht trupi i Faraonit që u mbyt; dhe ashtu siç u hodh ai në bregdet në vendin tek i cili u mbyt, po ashtu do të hidhej nga deti i kohës mbi valët e shekujve për tek bregu i këtij shekulli.

Dhe për shembull:

يُذَبِّحُونَ اَبْنَاۤءَكُمْ وَيَسْتَحْيُونَ نِسَاۤءَكُمْ

"...Ata therrën (vranë) djemtë tuaj e lanë të gjalla gratë tuaja."[79]

Nëpërmjet një ngjarjeje në kohën e Faraonit, therrjes së bijve të Israilit dhe lënies gjallë të grave dhe vajzave të tyre, vërseti tregon masakrat e shumta që populli çifut ka pësuar në shumicën e vendeve në çdo shekull, dhe rolin që kanë luajtur gratë dhe vajzat e tyre në jetën e shthurur njerëzore,

وَلَتَجِدَنَّهُمْ اَحْرَصَ النَّاسِ عَلٰى حَيٰوةٍ ۝ وَتَرٰى كَثِيرًا مِنْهُمْ يُسَارِعُونَ فِى الْاِثْمِ وَالْعُدْوَانِ
وَاَكْلِهِمُ السُّحْتَ لَبِئْسَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ۝ وَيَسْعَوْنَ فِى الْاَرْضِ فَسَادًا
وَاللّٰهُ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ ۝ وَقَضَيْنَآ اِلٰى بَنِىٓ اِسْرَاۤئِيلَ فِى الْكِتَابِ لَتُفْسِدُنَّ فِى الْاَرْضِ
مَرَّتَيْنِ ۝ وَلَا تَعْثَوْا فِى الْاَرْضِ مُفْسِدِينَ ۝

78 Kur'an; 10:92
79 Kur'an; 2:49; 14:6

"Dhe në të vërtetë ju do t'i gjeni ata (çifutët) të jenë më të eturit nga të gjithë njerëzit në këtë jetë, "[80] *"Dhe sheh shumë prej tyre (çifutëve) të nxitojnë drejt gjynaheve dhe shkeljes së ligjeve (të All-llahut) dhe të hanë prej gjërave të palejuara, me të vërtetë e poshtër është ajo çfarë ata punojnë."*[81] *"...ndërsa ata gjithnjë përpiqen të bëjnë djallëzi në tokë. Dhe All-llahu nuk i do ata që punojnë djallëzi e prapësi në tokë."*[82] *"Dhe Ne shkruam për bijtë e Israilit në libër (Teurat) se vërtet që ju (bijtë e Israilit) do të bëni dy herë padrejtësi në tokë..."*[83] *"Dhe mos punoni të këqia duke bërë ligësi në tokë."*[84]

Këto dy pohime të Kur'anit të drejtuara ndaj çifutëve përfshijnë dy rregulla të rëndësishëm të përgjithshëm se, ai popull kurdis kurthe e intriga në jetën shoqërore njerëzore me mashtrimet e dredhitë e tyre që trondisin shoqërinë njerëzore. Ato pohojnë se ai komb ashtu siç qe shkaku për ndezjen e luftës midis të varfërve e të pasurve duke nxitur punëtorët kundër pronarëve, po ai popull ishte shkak për ngritjen e bankave dhe përdorën kamatën dhe interese të përbëra, si dhe grumbulluan pasuri përmes dredhive e hileve; gjithashtu ishte po ai komb, i cili me qëllim për t'u hakmarrë kundra fitimtarëve dhe qeverive nga të cilët gjithnjë kanë vuajtur shtypjen e mundimin, u ndërlikuan në çdo llojë organizate të korruptuar duke pasur gisht në çdo lloj revolucioni.

Dhe për shembull:

فَتَمَنَّوُا۟ ٱلْمَوْتَ

"...Atëherë dëshirojeni vdekjen nëse jeni të vërtetë. Por ata kurrë nuk do ta dëshirojnë atë..."[85]

Domethënë, ***"Në qoftë se çfarë ju thoni është e vërtetë, kërkojeni vdekjen. Por ju kurrë nuk do ta kërkoni atë!*** Kështu, nëpërmjet një ngjarjeje të pjesshme në një tubim të vogël në prani të Profetit a.s.m., vërseti pohon se ai komb çifut, i cili është më i shquari midis popujve të njerëzimit për lakminë për jetën dhe frikën nga vdekja, ai nuk do ta

[80] Kur'an; 2:96
[81] Kur'an; 5:62
[82] Kur'an; 6:64
[83] Kur'an; 17:4
[84] Kur'an; 2:60
[85] Kur'an; 2:94-95

kërkojë vdekjen gjer Ditën e Kijametit, sipas gjuhës së gjendjes së tij dhe nuk do ta braktisë lakminë e tij për jetën.

Dhe për shembull:

ضُرِبَتْ عَلَيْهِمُ الذِّلَّةُ وَالْمَسْكَنَةُ

"Dhe kështu ata u mbuluan me poshtërim dhe mjerim..."[86]

Përmes kësaj, vërseti përshkruan fatin e ardhshëm të atij kombi në një mënyrë të përgjithshme. Atëherë, meqenëse lakmia dhe korrupsioni depërtuan thellë në karakteret dhe natyrat e atij populli, Kur'ani vepron me shumë rreptësi kundër tyre. Dhe u jep atyre goditje të rënda ndëshkuese. Kështu, në dritën e këtyre shembujve, bëj analogji me ngjarjet e tjera që u ndodhën bijve të Israilit dhe me tregimin e Musait a.s..

Tani ndodhen shumë shkreptima të mrekullisë pas fjalëve të thjeshta dhe subjekteve të veçanta të Kur'anit, ashtu si shkreptima e mrekullisë në këtë flakërimën e katërt. Një njeriu mendjemprehtë e me intuitë do t'i mjaftonte vetëm një shenjë.

❍ ***Flakërima e pestë:*** Kjo është gjithëpërfshirja e jashtëzakonshme e Kur'anit në lidhje me qëllimet e tij, çështjet, temat, kuptimet, stilet dhe me cilësitë e tij të holla e me virtytet e larta. ***Po, në të vërtetë, në qoftë se suret e Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm do të studioheshin me kujdes dhe, veçanërisht hapjet e sureve dhe fillimi e mbarimi i vërseteve, do të shihej se, ndonëse ai grumbullon së bashku të gjitha kategoritë e retorikës, të gjitha pjesët e ligjëratës së hollë, të gjitha klasat e stileve të larta, të gjitha llojet e moralit të lartë, të gjitha përmbledhjet e shkencave që lidhen me universin, të gjitha indekset e njohurisë Hyjnore, të gjitha rregullat e dobishme për jetën njerëzore individuale e shoqërore dhe të gjitha ligjet e ndritshme të shkencave të larta kozmike pavarësisht grumbullimit të këtyre, nuk shfaqet ndonjë shenjë ngatërrimi. Në të vërtetë, të grumbullosh së bashku në një vend kaq shumë kategori të ndryshme të njohjes dhe të mos shkaktosh defekte në sistem apo ngatërrim e vështirësi, padyshim kjo është vepra e një sistemi të mrekullueshëm i***

[86] Kur'an; 2:61

të Gjithëfuqishmit. Dhe së bashku me këtë rregull brenda kësaj gjithëpërfshirjeje, ashtu siç është shpjeguar e provuar në Njëzet e Katër Fjalët e mëparshme, të grisësh perdet e së zakonshmes, me shpjegime të mprehta –të cilat janë burimi i injorancës së përbërë– dhe të nxjerrësh çudirat e fshehura brenda tyre e t'i shfaqësh ato me qartësi; të thyesh me shpatën prej diamanti të provës idhullin e natyrës, i cili është burimi i çudhëzimit; të shpërndash me gjëmime borie si një rrufe shtresat e dendura të gjumit të pakujdesisë, të zbulosh e të zgjidhësh enigmën e ekzistencës dhe problemin e vështirë e të çuditshëm të krijimit të botës para të cilave filozofia njerëzore e shkenca kanë mbetur të pafuqishme..., sigurisht është vetëm vepra e këtij Kur'ani të mrekullueshëm i cili shikon realitetin, vështron të padukshmen, jep udhëzimin dhe shfaq të vërtetën.

Po, në të vërtetë, në qoftë se vërsetet e Kur'anit do të shqyrtoheshin me vëmendje e me drejtësi, do të shihej se ato nuk i ngjasojnë një zinxhiri gradual mendimi duke ndjekur një ose dy qëllime, siç është rasti me librat e tjerë, por mënyra e Kur'anit është e befasishme dhe e çastit; ai inspirohet në çast; ai ka shenjën, që të gjitha aspektet e tij që vijnë së bashku, vijnë në mënyrë të pavarur, më vete, nga një vend i largët brenda një ligjërate tej mase serioze dhe e rëndësishme e cila vjen vetë e në mënyrë të përmbledhur.

Po, kush është atëherë përveç Krijuesit të universit që mund ta bëjë këtë fjalë të lidhet në këtë shkallë serioziteti me universin dhe me Krijuesin e universit? Kush përveç Krijuesit të Gjithëlavdishëm do të mund të kalonte limitin e tij në një shkallë të pafund e të fliste sipas trillës së tij, në Emrin e Krijuesit të Gjithëlavdishëm e në emër të universit, një fjalë të vërtetë si kjo? Po, në Kur'an, Krijuesi i universit shihet të flasë e të bëjë të flasë me seriozitetin e vërtetësinë më të madhe e në një mënyrë të lartë e të vërtetë. Nuk ka fare ndonjë shenjë që sugjeron imitim. Ai flet e bën të flasë. Për të supozuar të pamundurën, në qoftë se dikush, si Musejleme Gënjeshtari, do të kalonte përtej shenjës së tij e të imitonte fjalët e Krijuesit të tij, të Gjithëfuqishmit Absolut, të fliste sipas ideve të tija, gjithashtu edhe për universin, natyrisht do të ishin mijëra shenja imitimi e tregues gënjeshtre, sepse kur më i ulëti të marrë përsipër mënyrën e më të lartit, atëherë çdo veprim i tij tregon shtirje e imitim. Prandaj, shqyrtoji me kujdes këto vërsete të cilët e shpallin këtë fakt me një betim:

وَالنَّجْمِ إِذَا هَوَىٰ ۞ مَا ضَلَّ صَاحِبُكُمْ وَمَا غَوَىٰ ۞ وَمَا يَنطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ
۞ إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ ۞

"(Betohem) për yllin kur ai bie (shuhet)! Shoku juaj Muhammedi a.s.m. as nuk ka humbur rrugën e drejtë, as nuk ka gabuar. As nuk flet ai nga dëshira (e vetë atij). Është vetëm shpallje që i frymëzohet."[87]

❑ **RREZJA E TRETË**:

Kjo është mrekullia e Kur'anit të Shpjegimit të Mrekullueshëm, e cila është njoftimi i tij për të padukshmen, duke ruajtur rininë e tij në çdo shekull dhe duke qenë i përshtatshëm për çdo nivel të njerëzve. Kjo rreze ka **"Tre rrezëllima".**

Rrezëllima e parë*: Janë njoftimet e tij për të padukshmen.*

Kjo përbëhet nga **"*Tre Shkëlqime".***

Shkëlqimi i parë: ***Janë njoftimet e tij për të shkuarën, që lidhen me të padukshmen.*** Në të vërtetë, Kur'ani i gjithurtë përmend nëpërmjet gjuhës së Personit, për të cilin çdo njeri ka pranuar se ai ishte "analfabet dhe i besuari", ngjarjet e rëndësishme dhe faktet kuptimplote në lidhje me profetët nga koha e Ademit a.s. deri tek shekulli i lumturisë, më i miri i shekujve, në një mënyrë që, të vërtetuara edhe nga shkrimet e shenjta si Teurati e Ungjilli, i njofton ato ngjarje me fuqinë më të madhe e me seriozitet. Ai përkon me pikat mbi të cilat librat e mëparshëm si Teurati e Ungjilli kishin rënë dakord, dhe vendos midis tyre e saktëson të vërtetën mbi çështjet rreth të cilave ato kishin mospërputhje duke u treguar atyre të vërtetën e çështjes.

Domethënë; **Pikëpamja e Kur'anit e cila depërton tek e padukshmja, i shikon ngjarjet e së shkuarës më mirë se ato libra, është më lart se të gjithë, i shpreh drejt, i vërteton në çështjet mbi të cilat pajtohen dhe i korrigjon në çështjet në të cilat ato nuk pajtohen**. Megjithatë, faktet që tregon Kur'ani rreth ngjarjeve dhe ndodhive të së shkuarës nuk janë gjëra që mund të kapen duke

[87] Kur'an; 53: 1-4

përdorur logjikën e që mund të komunikohen nga arsyeja, por ato janë njohuri të përcjella, të varura nga qiejt, nga shpallja. Dhe sa për njoftimin e transmetuar, ajo është një sferë e atyre që dinë si të lexojnë e të shkruajnë. Ndërsa Kur'ani iu shpall atij, i cili njihej nga miqtë edhe nga armiqtë e tij njëlloj, se ai nuk dinte as të shkruante e as të lexonte, që njihej si i besuari dhe që përshkruhej si analfabet. Gjithashtu, Kur'ani i tregon ato ngjarje të së shkuarës sikur t'i kishte parë të gjitha, sepse ai merr shpirtin dhe burimin e jetës së një ngjarje dhe i bën ato parathënien e qëllimit të tij. Domethënë, përmbledhjet dhe ekstraktet -esencat- që janë në Kur'an tregojnë se ai që i tregon këto përmbledhje dhe esenca, e shikon të gjithë të shkuarën me të gjitha ngjarjet e saja, sepse, ashtu si dikush që është ekspert në ndonjë shkencë apo profesion, i cili e tregon aftësinë e përvojën nëpërmjet disa fjalëve të ngjeshura, ose nëpërmjet një thënie të shkurtër, po kështu përmbledhjet dhe esencat e ngjarjeve të përmendura në Kur'an tregojnë se ai i cili i tha ato, i përfshin të gjitha ngjarjet dhe i shikon ato, dhe, në qoftë se dikush do të mund të thonte kështu, i tregon ato me aftësi të jashtëzakonshme.

Shkëlqimi i dytë: ***Është dhënia e njoftimeve të tij në lidhje me të ardhmen, e cila është një pjesë tjetër e së padukshmes.*** Ka shumë lloje të kësaj. Lloji i parë është i veçantë e i posaçëm për evlijatë -shenjtorët- dhe për ata që zbulojnë të fshehtat e krijimit. Për shembull: Muhjidin Ibn el-Arabi zbuloi shumë njoftime të së padukshmes në suren *er-Rum* الٓمٓ ۝ غُلِبَتِ ٱلرُّومُ *"Elif, Lam, Mim. Romakët u thyen."*[88]

Dhe Imam Rabbani shikoi shumë shenja të ngjarjeve të së padukshmes dhe njoftimin e tyre përmes ***Muka-taat*** –shkronjave të shkëputura– në fillimin e disa sureve, e kështu me radhë... Për dijetarët e shkollës *Batini* –e dijeve të fshehta–, Kur'ani, nga fillimi gjer në fund, përbëhet nga dhënia e njoftimeve prej të padukshmes. Por ne do të tregojmë pjesë që janë të përgjithshme. Ai gjithashtu ka shumë nivele, njërin prej të cilëve ne do ta diskutojmë. Kështu, Kur'ani i gjithurtë i thotë Profetit të Nderuar a.s.m.,[89]

[88] Kur'an; 30:1-2

[89] Këto ajete që japin njoftime për të padukshmen janë sqaruar në libra të shumtë të komentimit. Ato nuk janë shkruar këtu tani sepse qëllimi për ta botuar librin me

فَاصْبِرْ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ ۞ لَتَدْخُلُنَّ الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ إِنْ شَاءَ اللَّهُ آمِنِينَ
مُحَلِّقِينَ رُءُوسَكُمْ وَمُقَصِّرِينَ لَا تَخَافُونَ ۞ هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ
بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ ۞ وَهُمْ مِنْ بَعْدِ غَلَبِهِمْ
سَيَغْلِبُونَ فِي بِضْعِ سِنِينَ لِلَّهِ الْأَمْرُ ۞ فَسَتُبْصِرُ وَيُبْصِرُونَ بِأَيِّكُمُ الْمَفْتُونُ
۞ أَمْ يَقُولُونَ شَاعِرٌ نَتَرَبَّصُ بِهِ رَيْبَ الْمَنُونِ ۞ قُلْ تَرَبَّصُوا فَإِنِّي مَعَكُمْ
مِنَ الْمُتَرَبِّصِينَ ۞ وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ ۞ فَإِنْ لَمْ تَفْعَلُوا وَلَنْ تَفْعَلُوا ۞
وَلَنْ يَتَمَنَّوْهُ أَبَدًا ۞ سَنُرِيهِمْ آيَاتِنَا فِي الْآفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّىٰ
يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ ۞ قُلْ لَئِنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَىٰ أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ
هَٰذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا ۞ يَأْتِي اللَّهُ
بِقَوْمٍ يُحِبُّهُمْ وَيُحِبُّونَهُ أَذِلَّةٍ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ أَعِزَّةٍ عَلَى الْكَافِرِينَ يُجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ
وَلَا يَخَافُونَ لَوْمَةَ لَائِمٍ ۞ وَقُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ سَيُرِيكُمْ آيَاتِهِ فَتَعْرِفُونَهَا ۞ قُلْ هُوَ
الرَّحْمَٰنُ آمَنَّا بِهِ وَعَلَيْهِ تَوَكَّلْنَا فَسَتَعْلَمُونَ مَنْ هُوَ فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ ۞ وَعَدَ اللَّهُ
الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ
مِنْ قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَىٰ لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُمْ
مِنْ بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا

"Bëj durim pra (o Muhammed), vërtet që premtimi i All-llahut është i vërtetë."[90] *"...Padyshim që ju do të hyni në xhaminë e shenjtë (Mekë), në dashtë All-llahu, të sigurtë, disa me kokën të rruar e disa me flokë të shkurtuar pa pasur aspak frikë."* **"***Ai është i Cili e ka çuar të dërguarin e Tij (Muhammedin a.s.m.) me udhëzim dhe fenë e vërtetë,*

shkronjat e vjetra (arabe) e shtyu autorin në gabimin e nxitimit, prandaj ato thesare të çmueshëm mbetën të mbyllura. Autori.

[90] Kur'an; 30:60

që Ai ta shpallë e ta bëjë atë përmbi të gjitha fetë."[91] *"...Por ata, pas kësaj humbjes së tyre do të jenë fitimtarë; brenda pak vitesh." " Vendosja e çështjes, para dhe pas (këtyre ngjarjeve) është vetëm nga All-llahu."*[92] *"Shpejt ti do ta shohësh dhe ata do ta shohin."*[93] *"Cili prej jush është i çmendur."*[94] *"Apo thonë:" (Muhammedi a.s.m. është) vjershëtor! Ne presim kur t'i bjerë ndonjë fatkeqësi ndërkohë!"* [95] *"Thuaju (o Muhammed a.s.m.): Prisni! Se edhe unë jam nga ata që presin!"*[96] *"Dhe All-llahu do të të mbrojë ty nga njerëzit."*[97]

"Por nëse nuk e bëni dot atë dhe ju kurrë nuk mund ta bëni atë..."[98] *"Por ata kurrë nuk do ta dëshirojnë atë (vdekjen)."*[99] *"Ne do t'u shfaqim atyre shenjat Tona në gjithësi dhe në vetë veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se ky (Kur'ani) është e vërteta."*[100] *"Thuaj: Nëse njerëzimi dhe xhindet do të mblidheshin të gjithë bashkë të nxirrnin ngjasimin e këtij Kur'ani, ata nuk do ta bënin dot përngjasimin e tij, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin."* [101] *"...Atëherë All-llahu do të sjellë një popull të cilin Ai do ta dojë dhe ata do ta duan Atë; të përulur ndaj besimtarëve, të rreptë ndaj jobesimtarëve, që luftojnë në rrugë të All-llahut dhe gjithnjë të pafrikësuar ndaj fajësimeve të fajësuesve."*[102] *"Dhe thuaju: Gjithë lavdërimet dhe falënderimet i takojnë All-llahut, Ai do t'ju tregojë juve shenjat e Tij, dhe ju do t'i dalloni ato."*[103] *"Thuaj: Ai është i Gjithëmëshirshmi, ne Atij i besojmë dhe tek Ai ne mbështetemi, dhe shpejt ju do ta merrni vesh se kush është në gabim e në humbje të qartë."*[104] *"All-llahu u ka premtuar atyre nga mesi juaj që besojnë dhe që punojnë mirësi e drejtësi, se Ai patjetër do t'u sigurojë atyre*

[91] Kur'an; 48:27-28
[92] Kur'an; 68:6
[93] Kur'an; 68:5
[94] Kur'an; 30:3-4
[95] Kur'an; 52:30
[96] Kur'an; 52:31
[97] Kur'an; 5:67
[98] Kur'an; 2:24
[99] Kur'an; 2:95
[100] Kur'an; 41:53
[101] Kur'an; 17:88
[102] Kur'an; 5:54
[103] Kur'an; 27:93
[104] Kur'an; 67:29

vazhdimësinë (e fuqisë) në tokë, ashtu siç ua siguroi Ai këtë atyre përpara tyre dhe se Ai do t'u sigurojë fuqinë për të zbatuar e përmbushur fenë e tyre, atë të cilën Ai e ka zgjedhur për ta; dhe padyshim që Ai do t'u japë atyre në shkëmbim pas frikës së tyre siguri e paqe."[105]

Njoftimet rreth të padukshmes, që japin shumë vërsete si këto, janë bërë plotësisht realitet. Dhe kështu për shkak se ai njoftim u dha nga gjuha e Atij që ishte subjekt kritikash e kundërshtimesh, i cili mund të kishte humbur kauzën e tij edhe për shkak të gabimit më të vogël, dhe ai njoftim u fol pa ngurrim, me seriozitetin më të madh e me mirëbesim, në një mënyrë që vërtetoi saktësinë e tij. Këto njoftime rreth të padukshmes demonstrojnë me siguri se Ai që i dha ato njoftime mori mësim nga Mësuesi i tij i Parapërjetësisë dhe atëherë ai foli.

Shkëlqimi i tretë: ***Është dhënia e lajmeve të së padukshmes rreth të vërtetave Hyjnore, të vërtetave kozmike dhe çështjeve të Ahiretit.*** Në të vërtetë, komenti i Kur'anit rreth të vërtetave Hyjnore dhe shpjegimet e tij rreth kozmosit, të cilat zgjidhin enigmën e universit dhe zbulojnë misterin e krijimit, janë më të rëndësishmet e njoftimeve që lidhen me të padukshmen, sepse nuk do të ishte e arsyeshme të presësh që mendja njerëzore t'i zbulonte ato të vërteta rreth të padukshmes e t'i ndiqte ato pa u shmangur midis rrugëve të panumërta të çudhëzimit. Është e njohur se filozofët më brilantë të njerëzimit nuk kanë qenë të mundur të kapin edhe më të voglën e atyre çështjeve nëpërmjet arsyes. Për më tepër, pasi Kur'ani i ka shpjeguar ato të vërteta Hyjnore dhe të vërtetat kozmike, të cilat i ka shfaqur, dhe pasi zemra të jetë pastruar, nefsi të jetë dëlirësuar, pasi shpirti të ketë përparuar e mendja të jetë plotësuar derisa mendja njerëzore **t'i vërtetojë** e t'i pranojë ato të vërteta, atëherë do të thonte për Kur'anin: **"Barekall-llah,** *Sa të mëdha janë bekimet e Zotit*! Meqenëse kjo është shpjeguar e provuar pjesërisht tek *"Fjala e Njëmbëdhjetë",* atëherë nuk është nevoja që të përsëritet. Sa për faktet që lidhen me botën tjetër dhe me botën e ndërmjetme, mendja njerëzore, sigurisht që, nuk mund t'i kapë e nuk mund t'i shohë; ajo mund t'i pranojë ato në atë shkallë sikur t'i shikonte nëpërmjet mënyrave të treguara nga Kur'ani.

[105] Kur'an; 24:55

Kjo është shpjeguar e provuar te *"Fjala e Dhjetë"* se sa të drejta e të vërteta janë pohimet e Kur'anit në lidhje me të padukshmen. Referojuni asaj fjale.

Rrezëllima e dytë: ***Kjo është rinia e Kur'anit.*** Ai ruan freskinë e rininë e tij në çdo shekull sikur ai të shpallej rishtas. Në të vërtetë, është e domosdoshme për Kur'anin të ketë një rini të përjetshme meqenëse ai është një fjalim parapërjetësie dhe i drejtohet përnjëherësh të gjithë niveleve të njerëzimit në çdo shekull. Ai u shfaq i ri dhe është siç ishte. Madje edhe pse të gjithë shekujt janë të ndryshëm për sa i përket mendimeve dhe aftësive, ai është sikur ta shihte secilin nga ato shekuj në mënyrë të veçantë, bën të shihet dhe i jep mësim atij. Veprat e njeriut dhe ligjet vjetërohen ashtu si njeriu; ato zëvendësohen e ndryshohen. Por rregullat dhe ligjet e Kur'anit janë kaq të qëndrueshme e të forta, saqë ato rrisin fuqinë ndërsa shekujt kalojnë. Në të vërtetë, ky shekull aktual i cili krenohet me veten e është i mbështetur tek vetvetja dhe që i ka mbyllur veshët ndaj dëgjimit të fjalëve të Kur'anit më shumë se çdo shekull i kaluar, sidomos pasuesit e shkrimeve të shenjta, janë më të nevojshmit për udhëzimin e Kur'anit, i cili u adresohet atyre me fjalët:

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ *"O njerëzit e librit! O njerëzit e librit të shenjtë!"* Domethënë është sikur ai t'i adresohej drejtpërdrejtë këtij shekulli, pasi fraza: يَا أَهْلَ الْكِتَابِ *"O njerëzit e librit!"*, gjithashtu përfshin edhe kuptimin يَا أَهْلَ الْمَكْتَبِ *"O njerëzit e shkollave të shkencës moderne!"* Ai lëshon thirrjen e tij në të gjitha vendet e botës:

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَىٰ كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ

"Thuaj (o Muhammed):"O ithtarë të librave të parë! Ejani tek një fjalë që është e drejtë dhe e përbashkët mes nesh dhe jush..."[106]*,...*

gjer në fund të vërsetit, me të gjithë fuqinë e tij, me të gjithë freskinë e të gjithë rininë. Për shembull, qytetërimi modern që është produkt i mendimit të të gjithë njerëzimit dhe ndoshta edhe i xhindeve, gjithashtu ka marrë një qëndrim që kundërshton Kur'anin, gjë që për të

[106] Kur'an; 3:64.

cilën kanë dështuar individë e komunitete për ta kundërshtuar. Ky qytetërim kundërshton Kur'anin me magjinë e tij. Tani, me qëllim që të provojmë pretendimin e mrekullisë së Kur'anit tek vërseti:

قُل لَّئِنِ ٱجْتَمَعَتِ ٱلْإِنسُ وَٱلْجِنُّ

"Thuaj: Nëse njerëzimi dhe xhindet do të mblidheshin të gjithë bashkë..."[107],

ne do të krahasojmë themelet dhe parimet, të cilat qytetërimi i ka vendosur në formën e kundërshtimit të ri të tmerrshëm, me parimet e Kur'anit.

Në shkallën e parë: Krahasimet dhe balancat të cilat formojnë të gjitha fjalët, nga e para gjer tek e njëzet e pesta dhe vërsetet në fillimet e tyre që formojnë të vërtetat e atyre fjalëve, të gjitha provojnë me siguri, si dy edhe dy bëjnë katër, mrekullinë e Kur'anit dhe epërsinë e tij përballë qytetërimit.

Në shkallën e dytë: Ashtu si provat në *"Fjalën e Dymbëdhjetë"*, duhet të përmbledhim një numër parimesh. Për shkak të filozofisë, qytetërimi i sotëm pranon *"forcën"* si pikë mbështetje në jetën shoqërore humane. Dhe ai synon *"përfitimin"* në çdo gjë dhe merr *"konfliktin"* si parim të jetës së tij. Ai e konsideron lidhjen midis popujve të jetë *"racizmi dhe nacionalizmi negativ"*, ndërsa qëllimi i tij është të sigurojë disa *"argëtime"* për të kënaqur dëshirat e nefsit dhe nevojat në rritje të njeriut. Por dihet se shenja e *"forcës"* është *"agresioni."* Dhe meqenëse *"përfitimet"* nuk janë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur çdo nevoje, shenja e tyre është se, gjithësecili grindet e shtyn me bërryla të tjerët. Shenja e parimit të *"konfliktit"* është *"grindja"* dhe shenja e *"racizmit"* është *"agresioni"* meqë ai ngre krye për të gllabëruar të tjerët. Kështu, për shkak të këtyre parimeve të këtij qytetërimi, pavarësisht të gjitha virtyteve të tij, ai ka siguruar një lloj lumturie sipërfaqësore vetëm për njëzet përqind të njerëzve, ndërsa tetëdhjetë përqind i ka flakur në mjerim e varfëri.

Kurse urtësia e Kur'anit merr si pikë mbështetje *"të vërtetën"* në vend të *"forcës",* dhe në vend të *"përfitimeve"* merr si synim e qëllim *"kënaqësinë e Zotit xh.sh. dhe virtytet."* Ai e konsideron themelore në

[107] Kur'an; 17:88

jetë *"parimin e bashkëpunimit të ndërsjellë"* në vend të parimit të *"konfliktit"*. Ai në lidhje me *"komunitetet"* pranon *"lidhjet e fesë, të llojit dhe atdheut"* në vend të *"racizmit dhe nacionalizmit."* Qëllimet e tij janë të vendosë pengesa përpara sulmeve të paligjshme të dëshirave të ulëta të nefsit dhe për të nxitur shpirtin për tek çështjet sublime, për të kënaqur ndjenjat e larta e për t'i shtyrë drejt plotësimeve njerëzore dhe për ta bërë njeriun një qënie të vërtetë humane. Sa për të *"vërtetën",* shenja e saj është *"përputhja e mendimit";* shenja e *"virtytit"* është *"mbështetja e ndërsjellë";* shenja e *"bashkëpunimit reciprok"* është *"nxitimi për të ndihmuar njëri-tjetrin";* shenja e *"fesë"* është *"vëllazëria dhe mbështetja e njëri-tjetrit";* rezultati i kontrollit dhe i pengimit të nefsit urdhërues për të liga është lënia të lirë shpirtin, dhe nxitja e tij drejt plotësimit është lumturia në këtë botë dhe në tjetrën. Kështu, pavarësisht virtyteve që qytetërimi i sotëm ka fituar nga udhëzimi i Kur'anit në veçanti dhe nga fetë e shpallura të mëparshme qiellore, nga këndvështrimi i të vërtetës, qytetërimi aktual është thyer përballë Kur'anit.

***Në shkallën e tretë*:** Nga mijëra çështje, ne do të tregojmë vetëm katër përmes shembullit:

Çështja e parë: Meqenëse principet e Kur'anit dhe ligjet e tij kanë ardhur nga parapërjetësia, ato do të jenë të qëndrueshme e do të kalojnë për tek paspërjetësia. Ato nuk dënohen me plakje e vdekje ashtu si ligjet e qytetërimit. Ato janë gjithmonë të reja e të fuqishme. Për shembull, pavarësisht të gjitha shoqatave për vepra bamirësie, të gjitha bazave e sistemeve për mësimin e etikës dhe të gjitha disiplinave të tyre të rrepta dhe rregullave, qytetërimi nuk ka qenë në gjendje të kundërshtojë Kur'anin e Gjithurtë në dy nga çështjet e tij, madje ai – qytetërimi– është shpartalluar prej tyre.

Këto dy çështje janë:

وَأَقِيمُوا الصَّلَوٰةَ وَآتُوا الزَّكَوٰةَ ۞ وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَوا

"Jini të qëndrueshëm në kryerjen e faljeve dhe jepni zekatin..."[108]; dhe *"...All-llahu ka lejuar tregtinë dhe ka ndaluar kamatën."*[109]

[108] Kur'an; 2: 43

[109] Kur'an; 2: 275

Ne do ta përshkruajmë këtë fitore mrekullie të Kur'anit nëpërmjet një parathënie, ajo është siç vijon:

Siç është provuar në "**Isharatu'l I'xhaz**", ashtu si themeli i tronditjeve dhe i revolucioneve njerëzore që është një frazë, po ashtu një frazë është origjina e shthurjes morale.

Fraza e parë: "Sa kohë që unë jam i ngopur e plot, unë nuk shqetësohem nëse të tjerët vdesin nga uria!"

Fraza e dytë: "Ti puno që unë të ha; ti lodhu që unë të pushoj!"

Po, klasat e larta e të ulëta në shoqërinë njerëzore, domethënë të pasurit e të varfërit, nuk mund të jetojnë në paqe veçse duke ruajtur ekuilibrin. Themeli i këtij ekuilibri është mëshira e mirësia e klasave të larta ndaj atyre të ulëta, dhe respekti e bindja e klasave të ulëta ndaj të lartave. Tani fraza e parë i ka shtyrë klasat e larta te shtypja, imoraliteti dhe te mungesa e mëshirës, ndërsa fraza e dytë i ka shtyrë klasat e ulëta tek urrejtja, smira e lufta kundër klasave të larta. Si rrjedhojë, është plaçkitur qetësia e siguria njerëzore për disa shekuj që kaluan, gjithashtu edhe për këtë shekull, ku në Evropë u shfaqën ngjarje me pasoja shumë të mëdha nga konflikti midis punëtorëve dhe kapitalistëve siç dihet nga të gjithë. Kështu, qytetërimi me të gjitha shoqatat e tij bamirëse, me institucionet e tij morale, me të gjitha masat disiplinuese dhe me rregullat e sistemit, nuk ka mundur t'i pajtojë këto dy klasa të njerëzimit si dhe nuk ka mundur t'i shërojë dy plagët e rënda në jetën njerëzore. Ndërsa Kur'ani e ka shkulur nga rrënjët frazën e parë, me urdhëresat e tij për të ***"dhënë zekatin"*** dhe e kuron atë; dhe e zhduk nga themeli frazën e dytë me ***"ndalesat e tij për kamatën dhe interesat"*** dhe e kuron atë. ***Në të vërtetë, vërsetet Kur'anore qëndrojnë në këmbë te dyert e botës duke u thënë se kamata dhe interesat janë të ndaluara. Ai e urdhëron njerëzimin duke i thënë: "Me qëllim që të mbyllni derën e konfliktit, mbylleni derën e Bankës (kamatës) e të interesit!" Ai i ndalon studentët e tij për të hyrë tek ajo.***

Parimi i dytë: Qytetërimi nuk e pranon poligaminë. Ai e konsideron këtë dekret Kur'anor të jetë kundra urtësisë dhe në

kundërshtim me interesin e njeriut. Në të vërtetë, në qoftë se urtësia e martesës do të ishte vetëm për të kënaqur epshin, atëherë do të bëhej e domosdoshme që çështja të ishte e kundërta. Por siç dëshmohet nga të gjitha kafshët dhe siç vërtetohet nga të gjitha bimët që çiftëzohen, urtësia dhe qëllimi i martesës është riprodhimi e shumimi. Kënaqësia e epshit është një shpërblim i vogël i dhënë nga Mëshira Hyjnore me qëllim që të shkaktojë të kryhet ajo detyrë. Meqenëse, në të vërtetë dhe sipas urtësisë, martesa është për riprodhimin dhe përjetësimin e species; meqenëse gratë mund të lindin veçse një herë në vit e mund të mbeten me barrë vetëm në gjysmën e dytë të muajit dhe pasi të kenë mbushur të pesëdhjetat bien në dëshpërim; ndërsa burrat kanë aftësi të lënë me barrë –në të shumtën e rasteve– deri kur të arrijnë moshën njëqind vjeç, atëherë një grua është e pamjaftueshme për një burrë. Prandaj qytetërimi detyrohet të hapë shtëpi të shumta publike për prostitucion.

Parimi i tretë: Qytetërimi i paarsyeshëm e kritikon vërsetin Kur'anor i cili përpjesëton për gratë një të tretën në trashëgimi. Është e vetëkuptueshme se shumica e rregullave në jetën shoqërore veprojnë sipas shumicës së njerëzve. Atëherë, shumica e grave gjejnë burra të cilët i mbështesin e i mbrojnë ato, kurse shumica e burrave detyrohen të mbështesin gratë e tyre e të marrin përsipër shpenzimet e tyre. Kështu, në qoftë se gruaja merr një të tretën e trashëgimisë nga babai i saj, domethënë, gjysmën e asaj që mori burri nga babai i tij, atëherë burri i saj do ta plotësonte pamjaftueshmërinë e saj. Por në qoftë se burri merr dy pjesë nga babai i tij, një pjesë ai do ta japë për të mbështetur gruan me të cilën është martuar, e kështu realizohet barazia, dhe burri bëhet i barabartë me motrën e tij (në trashëgimi). Drejtësia e Kur'anit e kërkon të jetë kështu. Ai e ka urdhëruar atë në këtë mënyrë. [110]

[110] Kjo është një pjesë nga mbrojtja ime në gjykatë, e cila ishte shtojca e gjykatës së apelit dhe e cila e heshti gjykatën. Kjo ishte e përshtatshme si një shënim në fund të kësaj pjese. "Une i thashë gjykatës së Ministrisë së Drejtësisë: Sigurisht, nëse do të gjendej ndonjë drejtësi në faqen e tokës, ajo do ta mohonte e shfuqizonte një vendim të padrejtë, i cili dënon dikë që shpjegon një rregull më të shenjtë e më të drejtë Hyjnor që sundon në jetën shoqërore për treqind e pesëdhjetë milion njerëz në çdo shekull gjatë një mijë e treqind e pesëdhjetë viteve. Ky komentator në komentimin e tij është mbështetur në konfirmimin dhe konsensusin e treqind e pesëdhjetë mijë komentatorëve, dhe duke ndjekur besimet e të parëve tonë prej një mijë e treqind e pesëdhjetë vjetësh." (Autori)

Parimi i katërt: Ashtu si Kur'ani që ndalon në mënyrë të rreptë adhurimin e idhujve, gjithashtu ai ndalon adhurimin e formave të cilat janë një lloj imitimi i adhurimit të idhujve, ndërsa qytetërimi aktual i konsideron format, fotografitë si një nga veçoritë e virtytet e tij dhe përpiqet të kundërshtojë Kur'anin në këtë çështje. Por format, qofshin imazhe apo konkrete, janë ose tirani e mishëruar, ose hipokrizi e mishëruar, ose një epsh i mishëruar; ato e nxisin epshin dhe e kurajojnë njeriun për tek shtypja, hipokrizia dhe në shthurje morale. Për më tepër, Kur'ani me dhembshuri i urdhëron gratë të veshin një mbulesë modestie, me qëllim që ato të trajtohen me respekt e të mbrojnë dinjitetin, që ato thesare të mëshirës të mos poshtërohen nën këmbët e dëshirave të ulëta dhe të mos bëhen artikuj të pavlefshëm për ngacmimin e epshit.[111] Megjithatë, qytetërimi i ka nxjerrë gratë prej shtëpive të tyre, ka grisur mbulesën e tyre dhe ka prishur njerëzimin. Dihet se jeta familjare vazhdon me dashuri e me respekt të ndërsjellë midis burrit dhe gruas.

Ndërsa zbulimi dhe veshjet eksituese e shkatërrojnë atë dashuri të pastër, respektin e sinqertë dhe helmojnë jetën familjare. Adhurimi i formave në veçanti ka tronditur ndershmërinë në mënyrë të lemerishme dhe ka shkaktuar poshtërimin e shpirtit të njeriut. Kjo mund të kuptohet si më poshtë: Ashtu si të shikuarit me epsh e dëshirë tek kufoma e një gruaje të bukur të vdekur, e cila ka nevojë për mëshirë e keqardhje, që shkatërron moralshmërinë, po ashtu të shikosh me epsh format e grave të vdekura, fotot apo format e grave të gjalla – të cilat janë si kufoma të zvogëluara për to– lëkund pikërisht bazën e ndjenjave njerëzore dhe i shkatërron ato.

Kështu si këto tre shembuj, çdo çështje nga mijëra çështjet e Kur'anit përmban lumturinë njerëzore në këtë botë, si dhe arrin lumturinë e përjetshme në Ahiret. Ju mund t'i krahasoni çështjet e tjera me këto.

Ashtu si qytetërimi i sotëm i cili qëndron i thyer përpara parimeve të Kur'anit që lidhen me jetën shoqërore njerëzore, dhe që nga

[111] Shkreptima e Njëzet e Katërt e Letrës së Tridhjetë e Një rreth mbulimit të grave ka provuar në mënyrë vendimtare se: **"Veshja islame është e natyrshme për gratë, dhe heqja e asaj mbulese është në kundërshtim me natyrën e gruas."**

këndvështrimi i realitetit është një falimentim i tij përpara mrekullisë së Kur'anit, po ashtu filozofia evropiane dhe shkenca njerëzore –të cilat janë shpirti i qytetërimit– kur bëhet balancimi midis tyre dhe midis urtësisë së Kur'anit me peshat e njëzet e pesë fjalëve të kaluara, filozofia shfaqet e pafuqishme, kurse urtësia e Kur'anit shfaqet e provohet prerazi se ajo është mrekulli. Pafuqia dhe falimentimi i filozofisë, dhe mrekullia dhe pasuria e urtësisë së Kur'anit janë provuar në *Fjalët e Njëmbëdhjetë dhe Dymbëdhjetë;* ju mund t'u referoheni atyre.

Për më tepër, ashtu si qytetërimi i sotëm që është i thyer përpara mrekullisë së urtësisë së Kur'anit në lidhje me të mësuarit e të vepruarit, po ashtu letërsia e qytetërimit dhe retorika e tij janë të mposhtura përpara letërsisë e retorikës së Kur'anit. Krahasimi i letërsisë dhe i retorikës së qytetërimit aktual me ato të Kur'anit është si "Ai i brengosjes së zymtë dhe i vajtimit të pashpresë së një jetimi i cili ka humbur prindërit, me këngën e një ashiku të pastër e të dëshpëruar nga një ndarje e përkohshme i cili duke kënduar mbushet me mallëngjim e shpresë...", ose si "krahasimi i këngës së zhurmshme dhe të ulët të një pijaneci, me këngët patriotike të cilat nxisin për fitore, për luftë e vetësakrificë të lartë," sepse në lidhje me efektet e stilit të tij, letërsia dhe retorika prodhojnë ose dëshpërim ose gëzim.

Dëshpërimi është dy llojësh: Ose është dëshpërim që buron nga humbja e të dashurve, domethënë nga mungesa e ekzistencës së miqve dhe të dashurve, i cili është një dëshpërim i errët i prodhuar nga letërsia e qytetërimit që është njollosur nga çudhëzimi, që është e përzier me shkujdesjen dhe me besimin tek natyra, ose është dëshpërimi i dytë. Ky buron nga ndarja e të dashurve, domethënë, të dashurit ekzistojnë, por mungesa e tyre shkakton një dëshpërim që tregon një dëshirë të fortë e të zjarrtë. Dhe këtë dëshpërim e shkakton Kur'ani udhëzues e dritëdhënës.

Gëzimi gjithashtu është dy llojësh: Njëri nxit dëshirat e nefsit. Kjo është shenja e letërsisë së qytetërimit në fushat e teatrit, kinemasë dhe romanit. Ndërsa gëzimi i dytë e hesht nefsin dhe është i hollë, i pastër, i pafajshëm dhe nxit shpirtin, zemrën, mendjen dhe të gjitha aftësitë e holla për të arritur çështjet sublime, për tek atdheu i tyre origjinal, për tek vendqëndrimi i tyre i përjetshëm dhe për tek të dashurit e tyre të Ahiretit; dhe ky është gëzimi të cilin e shkakton Kur'ani i shpjegimit të

mrekullueshëm. Ai e mbush njeriun me dëshirë të papërmbajtur për Parajsën, për jetën e përhershme dhe për shikimin e Bukurisë së Zotit xh.sh.**.** Kështu, kuptimi i gjërë dhe e vërteta madhështore që shpreh vërseti,

قُل لَّئِنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنسُ وَالْجِنُّ عَلَىٰ أَن يَأْتُوا بِمِثْلِ هَٰذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ
وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا

"Thuaj: Nëse njerëzimi dhe xhindet do të mblidheshin të gjithë bashkë të nxirrnin ngjasimin e këtij Kur'ani, ata nuk do ta bënin dot përngjasimin e tij, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin."[112], është imagjinuar prej disave me inteligjencë të pakët se është një supozim për qëllimet e një pjese të ekzagjeruar të elokuencës. Ruajna Zot! Ajo nuk është ekzagjerim, as nuk është një supozim i pamundur; është një pjesë absolutisht e vërtetë e retorikës dhe një supozim i mundur dhe aktual.

Njëri aspekt i supozimit është ky, ai do të thotë: Në qoftë se të gjitha fjalët më të bukura që thotë njeriu e xhindi, të cilat nuk burojnë nga Kur'ani e nuk i përkasin Kur'anit, do të mblidheshin bashkë, ato nuk do mund ta imitonin Kur'anin dhe as nuk kanë qenë në gjendje për ta imituar, pasi nuk kanë qenë të mundur ta tregojnë.

Aspekti i dytë i këtij qytetërimi, urtësia e filozofisë dhe letërsitë e huaja të cilat janë rezultatet e mendimeve dhe të përpjekjeve të njerëzimit dhe xhindit dhe madje të djajve, janë mu tek nivelet e ulëta të pafuqisë përpara rregullave, urtësisë dhe elokuencës së Kur'anit, ashtu siç dhamë shembuj prej tyre.

Rrezëllima e tretë: Kur'ani i gjithurtë sikur i drejtohet çdo klase në mënyrë të veçantë. Në të vërtetë, është esenciale se në çdo shekull Kur'ani i cili fton të gjithë njerëzimin me të gjitha klasat e tij dhe i mëson ata në besim që është dija më e lartë e më e hollë, në njohjen e Zotit xh.sh. që është dega më e shtrirë e më ndriçuese e të mësuarit dhe në ligjet e Islamit të cilat janë më të rëndësishmet dhe më të larmishmet e shkencave, sigurisht Kur'ani do ta instruktonte çdo klasë e çdo grup në mënyrën e duhur. Megjithatë, mësimi që ai jep

[112] Kur'an; 17:88

është i njëjtë, ai nuk ndryshon. Atëherë duhet të gjenden nivele të ndryshme në të njëjtin mësim. Sipas shkallës së vet, çdo klasë merr pjesën e saj nga skena e Kur'anit. Ne kemi dhënë shumë shembuj nga ky fakt dhe mund t'u referohesh atyre. Ne këtu do t'ju tregojmë një ose dy pjesë të vogla dhe pjesën e të kuptuarit të një ose dy klasave.

Për shembull:

لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ

"Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe s'ka asnjë të barabartë apo të krahasueshëm me Të."[113]

Pjesa e të kuptuarit, nga kjo, e njerëzve të zakonshëm të cilët përbëjnë klasën e shumicës absolute, është: **"**Zoti i Gjithëfuqishëm është shumë larg që të ketë baba, fëmi, të ngjashëm apo grua." Ndërsa pjesa e një klase të mesme është: "Mohimi i Hyjnisë së Hazreti Isait a.s.(Jezusit), i engjëjve dhe i gjërave që janë të lindura." Sepse ndonëse mohimi i diçkaje të pamundur është në dukje i pakuptim, por sipas retorikës, një pohim i domosdoshëm është i synuar i cili i jep asaj qëllimin. Kështu, qëllimi i mohimit të birit dhe lindësit (atij që shkakton lindjen), të cilat janë të veçanta për trupësinë, është të mohojë Hyjninë e atyre që kanë fëmijë e prindër dhe që janë të barabartë. Dhe ajo është të tregojë se ato nuk janë të denjë për t'u adhuruar. Për këtë shkak, sureja *Ihlas* është e dobishme për gjithësecilin në çdo kohë.

Pjesa e një klase pak më të avancuar është: "Zoti i Gjithëfuqishëm është larg të gjitha lidhjeve të cilat sugjerojnë Mundësinë e lindjes dhe qënien i lindur. Ai është i përjashtuar nga të gjithë ortakët (nga pasja ortakë), nga ndihmësit e partnerët. Por lidhjet e Tij me të gjitha qëniet janë vetëm lidhje si Krijues. Ai krijon me anë të Vullnetit të Tij të parapërjetësisë me urdhërin e **"Kun fe jekun** *Bëhu!-dhe ajo është bërë (në çast)***".** Ai është përtej çdo lidhje që kundërshton plotësimin si, detyrimi, domosdoshmëria dhe fillimet në mënyrë të pavullnetshme.

Pjesa e të kuptuarit e një klase më të lartë është: "Zoti i Gjithëfuqishëm është i Parapërjetshëm dhe i Paspërjetshëm; Ai është i

[113] Kur'an; 112:3-4

Pari dhe i Fundit. As në esencën e Tij, as në atributet e Tij dhe as në veprat, Ai nuk ka në asnjë aspekt ndonjë të barabartë, ndonjë shok, të njëjtë apo ndonjë gjë të ngjashme, që t'i përngjasojë Atij. Vetëm në veprimet e Tij ka krahasime që shprehin ngjashmëri: وَلِلّٰهِ الْمَثَلُ الْاَعْلٰى *"Dhe për All-llahun është krahasimi më i lartë."*[114] "

Ju mund të bëni analogji me këto klasa për klasat e tjera, të cilat që të gjitha marrin pjesë të ndryshme, si ata që kanë arritur njohjen e Zotit xh.sh. , të dashurit e Zotit xh.sh. dhe të sinqertët e vërtetë.

Shembulli i dytë:

مَا كَانَ مُحَمَّدٌ اَبَآ اَحَدٍ مِّنْ رِّجَالِكُمْ

"Muhammedi nuk është babai i ndonjërit prej burrave tuaj."[115]

Pjesa e të kuptuarit nga kjo e klasës së parë është: Zejdi, shërbyesi i Profetit a.s.m. të cilit ai i drejtohej duke i thënë si "biri im" divorcoi gruan e tij të shkëlqyer e fisnike për shkak se ai nuk e gjeti vetveten të barabartë me të. Me urdhrin e Zotit xh.sh., Profeti a.s.m. e mori atë. Vërseti thotë: Në qoftë se profeti të thërret ty "bir", ajo është në lidhje me profetësinë e tij, kurse në lidhje me personin e tij, ai nuk është babai juaj; saqë të jenë të papërshtatshme për të, gratë që Ai merr."

Pjesa e klasës së dytë është kjo: Një sundimtar i madh i shikon nënshtetasit e tij me dhembshuri atërore, në qoftë se ai është një monark shpirtëror i cili sundon si në anë të jashtme ashtu edhe në anë të brendshme. Atëherë meqenëse dashuria e tij kalon njëqind herë më shumë përtej asaj të babait, nënshtetasit e tij e shikojnë atë si baba dhe e shikojnë vetveten si djemtë e tij të vërtetë. Shikimi i babait nuk mund të transformohet në atë të një bashkëshorti, dhe shikimi i vajzës nuk mund të transformohet lehtë në shikimin e një bashkëshorteje, kështu në këndvështrimin e përgjithshëm martesa e Profetit a.s.m. me vajzat e besimtarëve do të dukej e papërshtatshme. Kur'ani thotë: "Profeti a.s.m. sillet me mirësi ndaj jush me syrin e mëshirës Hyjnore, dhe ju trajton ju në mënyrë atërore. Në emrin e profetësisë së tij, ju jeni si

[114] Kur'an; 16:60
[115] Kur'an; 33:40

fëmijët e tij, por në lidhje me personin e tij human, ai nuk është babai i juaj, saqë martesa e tij me vajzat tuaja të jetë e papërshtatshme."

Grupi i tretë do ta kuptonte këtë si më poshtë: Duhet që ju të mos bëni gjynahe e të mos abuzoni duke u mbështetur në plotësimin e Profetit a.s.m. e duke besuar në dhembshurinë e tij atërore dhe tek lidhja e juaj me të, sepse ka shumë që mbështeten tek të parët e tyre dhe tek udhëzuesit dhe shfaqin dembeli në ibadet e në punë. Madje ata thonë ndonjëherë: Faljet tona janë kryer (siç është rasti me disa *shiitë*).

Pika e katërt: Një grup tjetër do të kuptonte nga ky vërset një shenjë nga e padukshmja siç vijon: Fëmijët meshkuj të Profetit a.s.m. nuk do ta arrinin shkallën e burrave (*rixhal*); si pasojë e ndonjë qëllimi të urtë, pasardhësit e tij nuk do të vazhdonin si burra. Meqenëse përdorimi i termit *rixhal* tregon se ai ishte babai i grave, linja e tij do të vazhdonte përmes grave, dhe lavdi Zotit, pasardhësit e bekuar të hazreti Fatimes *Ez-zehra* si Hasani e Hysejni, hënat dritëdhënëse të të dyja linjave ndriçuese, vazhdojnë linjën materiale e shpirtërore të Diellit të Profetësisë.

اَللّٰهُمَّ صَلِّ عَلَيْهِ وَعَلٰى آلِهِ

O Zot jepi bekime atij dhe familjes së tij!

[Drita e parë përfundon këtu me Tre Rrezet]

● DRITA E DYTË

Drita e dytë përfshin **"Tre Rrezatime."**

❑ Rrezatimi i parë

Sipas dëshmisë së mijëra dijetarëve të ndritur të retorikës dhe shkencës së stilit retorik si: **Zamahsheri, Sakkaki dhe Abdulkahir Xhurxhani,** ndodhet në Kur'anin e shpjegimit të mrekullueshëm, si një e tërë, një rrjedhshmëri e këndshme, një saktësi eprore, një solidaritet i qëndrueshëm i ndërsjellë, një përpjesëtim e përshtatshmëri e përmbledhur, një kooperim i fuqishëm midis fjalive dhe pjesëve dhe një harmoni e lartë midis vërseteve dhe qëllimeve të tyre. Dhe

megjithatë, ndërsa ndodhen tetë apo nëntë shkaqe të rëndësishme të cilat mund ta prishin e shkatërrojnë harmoninë, kooperimin, mbështetjen e ndërsjellë, rrjedhshmërinë e saktësinë, por ato nuk i dëmtojnë, përkundrazi, ato u japin fuqi rrjedhshmërisë, saktësisë dhe mbështetjes së ndërsjellë. Këto shkaqe vetëm kanë ushtruar ndikim në një farë mase dhe kanë nxjerrë kokën e tyre nga pas perdes së rregullit dhe rrjedhshmërisë së stilit. Por, ashtu si numri i gungave dhe i jashtërritjeve (dalëzat, të tepërtat) që shfaqen në një pemë, jo për të prishur harmoninë e pemës, por për të prodhuar fruta me të cilat plotësohet bukuria e pemës dhe përplotësia e stolisë së saj, në të njëjtën mënyrë, këto shkaqe gjithashtu nxjerrin kokat (gungat, dalëzat) e tyre me qëllim që të shprehin kuptime të vlefshme për rrjedhshmërinë e stilit në renditjen e fjalëve të Kur'anit.

Kështu, megjithëse Kur'ani i Qartë u zbulua pjesë pjesë, si yjet, për njëzet e tre vjet në përgjigje të rrethanave dhe nevojave, ai posedon një harmoni të tillë të përkryer dhe shfaq një përshtatshmëri të plotë, sikur ai të ishte shpallur i tëri përnjëherësh. Për më tepër, megjithëse rrethanat të cilat tregojnë shpalljen e Kur'anit për njëzet e tre vjet ishin të gjitha të ndryshme e të gjithfarshme, pjesët e tij e mbështesin njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë aq plotësisht sikur ato të ishin shpallur në përgjigje të një shkaku të vetëm. Gjithashtu ai Kur'an erdhi si përgjigje për pyetje të ndryshme e të përsëritura, edhe pse shfaq përzierjen më të skajshme dhe unitetin më të madh, sikur të ishte përgjigja e një pyetje të vetme. Megjithëse Kur'ani erdhi për të shpjeguar kërkesat e ngjarjeve të shumta e të ndryshme, ai shfaq një rregull të tillë të plotë, sikur t'i përgjigjej një ngjarjeje të vetme. Megjithëse Kur'ani u shpall nëpërmjet begenisë (zbritjes, mirësjelljes) Hyjnore në stile të përshtatshme për shkallën e të kuptuarit për shumë njerëz që ai u drejtohet, rrethanat e të cilëve ishin të ndryshme, ai shfaq një korrespondencë të tillë të hollë dhe një limim të bukur të stilit, sikur rrethanat të ishin një, dhe niveli i të kuptuarit të ishte i njëjti, saqë rrjedhshmëria e tij rrjedh si uji.

Megjithëse Kur'ani u adresohet klasave të shumta të largëta prej njëra-tjetrës, ai posedon një lehtësi të shpjegimit, një elokuencë në renditjen e fjalëve dhe një qartësi të tillë në mënyrën e tij të të shprehurit, sikur t'i drejtohej një klase të vetme, madje çdo klasë mendon se është pikërisht ajo të cilës Kur'ani po i adresohet. Dhe

megjithëse Kur'ani u shpall me qëllim që të drejtojë e të udhëheqë për tek qëllime të ndryshme, ai posedon një integritet të tillë të plotë, një balancë të tillë të kujdesshme dhe një rregull të tillë të bukur sikur qëllimi të ishte një. Kështu, megjithëse këto janë shkaqet e konfuzionit, mirëpo ato janë përdorur në shfaqjen e mrekullisë së shpjegimit të Kur'anit, të rrjedhshmërisë së tij dhe të përshtatshmërisë së tij.

Po, kushdo zemra e të cilit është pa sëmundje, mendja e të cilit është e shëndoshë, ndërgjegjja e të cilit nuk është e sëmurë dhe që shija e të cilit është e padëmtuar, do të shihte në shpjegimin e Kur'anit një lëmim të bukur të stilit, një harmoni të hijshme, një përshtatshmëri të këndshme dhe një elokuencë të rrallë (në llojin e vet). Dhe ai i cili ka një shikim të qartë, padyshim do të shikonte se në Kur'an ekziston një sy i cili vështron me qartësi të plotë të gjithë universin me aspektet e tij të jashtëm e të brendshëm, sikur ai të ishte një fletë e vetme para syve dhe e kthen si të dëshirojë, si dhe i tregon kuptimet e fletës me çfarëdo stili që dëshiron. Disa vëllime do të ishin të domosdoshëm në qoftë se do të duhej të shpjegonim kuptimin e këtij Rrezatimit të Parë së bashku me shembujt; prandaj duke u mjaftuar me shpjegimet që lidhen me provat e këtij fakti në trajtesën time në arabisht, në **"Isharatul ixhaz",** dhe në këto Njëzet e pesë Fjalët deri këtu; madje unë ua paraqes Kur'anin Kerim në tërësinë e tij si shembullin e këtij realiteti.

❑ Rrezatimi i dytë

Ky rrezatim lidhet me cilësitë e mrekullueshme në stilin e veçantë të Kur'anit të Gjithurtë për sa i përket përmbledhjeve dhe Emrave më të Bukur Hyjnorë me të cilët mbarojnë vërsetet e Kur'anit të Gjithurtë.

KUJTESË: Ka shumë vërsete në këtë Rrezatimin e Dytë. Këto nuk janë vetëm shembuj për rrezatimin e dytë, por gjithashtu, për të gjithë shembujt dhe Rrezet e mëparshme. Do të bëhej tej mase e zgjatur po t'i shpjegonim ato të gjitha duke u dhënë tamam hakun që u takon, kështu për tani unë detyrohem që ta shkurtoj e ta përmbledh. Prandaj ne i kemi treguar në mënyrë të përmbledhur vërsetet të cilët janë shembujt e këtij misteri të madh të mrekullisë dhe i kemi lënë për një kohë tjetër shpjegimet e tyre të hollësishme.

Kështu, Kur'ani i Shpjegimit të Mrekullueshëm, në të shumtën e rasteve, përmend disa përmbledhje tek përfundimet e vërseteve të tij,

të cilat ose përmbajnë Emra Hyjnorë, ose kuptimet e tyre, ose ia referojnë çështjet e tyre mendjes dhe e nxisin atë të reflektojë e të meditojë rreth tyre, ose ato përfshijnë një rregull tërësor prej synimeve të Kur'anit me qëllim që të mbështesë e të përforcojë vërsetin. Kështu, në ato përmbledhje ndodhen disa tregues nga Kur'ani i urtësisë së lartë, disa pikla nga uji i jetës së udhëzimit Hyjnor dhe disa shkëndija nga vetëtima e mrekullisë së Kur'anit. Ne tani do të përmendim, në mënyrë të shkurtuar, vetëm dhjetë nga ato tregues të panumërt dhe do të tregojmë në mënyrë të përmbledhur kuptimin e një të vërtete prej të vërtetave të shumta të çdo shembulli. Shumica e këtyre dhjetë treguesve gjenden së bashku në formë të ngjeshur tek shumica e vërseteve dhe formojnë një qëndisje të vërtetë të mrekullisë. Për më tepër, shumica e vërseteve që ne po japim si shembuj janë shembujt e shumicës së treguesve. Ne do të shpjegojmë vetëm një tregues për çdo vërset. Dhe ne vetëm do të tregojmë lehtë kuptimet e atyre vërseteve të dhëna si shembuj, të cilët janë diskutuar te Fjalët e mëparshme.

❍ ***Cilësia e parë e elokuencës:*** Me shpjegimin e tij të mrekullueshëm, Kur'ani i gjithurtë shtron e vendos para syve aktet dhe veprat e Krijuesit të Gjithëlavdishëm. Pastaj ai nxjerr Emrat Hyjnorë në ato vepra e akte, ose ai provon qëllimet themelore të Kur'anit, si ringjalljen e të vdekurve dhe Njësinë Hyjnorë.

Një shembull i kuptimit të parë është ky:

هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُمْ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا ثُمَّ اسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ فَسَوَّاهُنَّ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

"Ai është i Cili krijoi për ju gjithçka që është në tokë, pastaj Ai drejtoi Vullnetin e Tij drejt qiejve dhe i rregulloi ato duke i bërë shtatë qiej. Dhe Ai është i Gjithëdituri për çdo gjë."[116]

Dhe një shembull i kuptimit të dytë:

أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهَادًا ۝ وَالْجِبَالَ أَوْتَادًا ۝ وَخَلَقْنَاكُمْ أَزْوَاجًا

[116] Kur'an; 2:29

"A nuk e kemi bërë Ne tokën si shtrojë dhe (Ne i kemi bërë) malet si shtylla mbështetëse?" "Dhe (a nuk ju kemi) krijuar ju në çifte?" ....

deri tek...

إِنَّ يَوْمَ الْفَصْلِ كَانَ مِيقَاتًا

"Me të vërtetë Dita e Vendimit (ndarjes së banorëve të Xhenetit dhe të Xhehenemit) është kohë e përcaktuar që më parë."[117]

Në vërsetin e parë ai përshkruan në detaje veprat Hyjnore dhe paraqet aktet më të mëdha të tyre të cilat dëshmojnë, nëpërmjet rregullit dhe qëllimeve të tyre, Njohurinë dhe Fuqinë e Krijuesit; ai i përmend ato si parathënie të një rezultati të rëndësishëm dhe të një qëllimi të madh, pastaj nxjerr Emrin e **El-Alimu**, *i Gjithëdituri*.

Dhe në vërsetin e dytë përmend veprat e mëdha dhe aktet madhështore të All-llahut dhe nxjerr si përfundim prej tyre ringjalljen, e cila është Dita e Ndarjes (së banorëve të parajsës e të ferrit), ashtu siç është shpjeguar në Pikën e Tretë të Rrezes së Parë të Dritës së Parë.

❍ **Pika e dytë e elokuencës:** Kur'ani hap pëlhurat e endura të Artit Hyjnor dhe ia shfaq ato shikimit njerëzor. Atëherë ai i përmbledh shkurtimisht dhe i mbulon ato endje brenda Emrave Hyjnorë, ose ndryshe ia referon ato arsyes.

Shembulli i parë i këtyre:

قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَمَّنْ يَمْلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَارَ وَمَنْ يُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ
وَيُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَمَنْ يُدَبِّرُ الْأَمْرَ فَسَيَقُولُونَ اللَّهُ فَقُلْ أَفَلَا تَتَّقُونَ
۞ فَذَٰلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمُ الْحَقُّ

"Thuaju (o Muhammed): Kush ju sjell furnizimin nga qielli dhe nga toka dhe kush është Zotëruesi i të dëgjuarit dhe i të shikuarit? Dhe kush e nxjerr të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Dhe kush është rregulluesi dhe sunduesi i të gjitha çështjeve? Do të thonë të gjithë, "All-llahu." "Thuaju: A nuk do të keni atëherë frikë

[117] Kur'an; 78:6-17

(duke treguar devocion për Të) "Ky është All-llahu, Zoti i juaj, i Vërteti.[118]

Kështu, në fillim ai pyet: "Kush është Ai i Cili përgatiti qiejt e tokën sikur ato të ishin dy depo e magazina për furnizimin tuaj, dhe bëri që njëri të sjellë shi dhe tjetri të prodhojë farërat? A ka ndonjë tjetër përveç All-llahut që mund t'i bëjë qiejt madhështorë dhe tokën si dy magazinierë të nënshtruar e të dobishëm? Atëherë falënderimet dhe lavdërimet duhet t'i jepen vetëm Atij."

Në frazën e dytë ai pyet: "Kush është pronari i syve dhe i veshëve tuaj të cilët janë më të çmueshmit midis gjymtyrëve tuaja? Nga cila fabrikë apo dyqan i keni blerë ju ato? Kështu, Ai i Cili ua ka dhënë ju këto sy e veshë të hollë e të çmueshëm është pikërisht Furnizuesi juaj. Është Ai i Cili ju krijoi, ju zhvilloi dhe jua dha ato juve. Atëherë vetëm Krijuesi është Ai që është i përshtatshëm për t'u adhuruar."

Në frazën e tretë ai thotë: "Kush është Ai i Cili sjell në jetë qindra e mijëra lloje nga qëniet e vdekura, ashtu siç ngjall tokën e vdekur? Kush tjetër përveç Zotit të vërtetë, Krijuesit të universit mund ta bëjë këtë? Sigurisht është Ai që e bën këtë, Ai i sjell ato në jetë. Meqenëse Ai është i Vërteti, Ai nuk do t'i shkelë të drejtat; Ai do t'ju dërgojë ju tek Gjykata më e Lartë. Ai do t'ju sjell në jetë, ashtu siç Ai sjell në jetë tokën."

Në frazën e katërt ai pyet: "Kush tjetër përveç All-llahut mund ta administrojë e rregullojë këtë univers të madh dhe të gjithë trupat e tij qiellorë, sikur ai të ishte një pallat apo një qytet? Meqenëse nuk mund të jetë askush tjetër përveç Zotit, atëherë fuqia që administron me lehtësinë më të madhe universin e madh dhe të gjitha trupat e tij qiellorë është aq e pafund dhe e pa të metë, saqë ajo nuk ka nevojë për asnjë partner e shoqërues, apo për asistencë e ndihmë. Ai i Cili administron universin e madh, nuk do t'ua lërë të tjerëve administrimin e krijesave të vogëla. Kjo do të thotë se ju detyroheni të thoni, **"All-llah**".

Kështu, fraza e parë dhe e katërt thonë, **'All-llah'**; fraza e dytë thotë, **Er-Rab** *Krijuesi Zhvillues*; dhe e treta thotë, **El-Hak** *i Vërteti*. Atëherë, kupto se sa mrekullueshëm e me vend janë fjalët:

---

[118] Kur'an, 10:31-32

فَذٰلِكُمُ اللّٰهُ رَبُّكُمُ الْحَقُّ

"Ky është All-llahu, Furnizuesi juaj, i Vërteti."

Kështu Kur'ani përmend administrimet e sistemimet e mëdha të Kri-juesit të Gjithëfuqishëm, dhe endjet domethënëse të Fuqisë së Tij, dhe thotë:

فَذٰلِكُمُ اللّٰهُ رَبُّكُمُ الْحَقُّ

"Ky është All-llahu, Furnizuesi juaj, i Vërteti."

Domethënë, nëpërmjet përmendjes së Emrave Hyjnorë, ***Krijuesi Zhvillues, i Vërteti*** dhe **All-llah** ai tregon burimin e atyre administrimeve madhështore të Fuqisë Hyjnore.

Një shembull i së dytës:

إِنَّ فِي خَلْقِ السَّمٰوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ الَّيْلِ وَالنَّهَارِ وَالْفُلْكِ الَّتِي
تَجْرِي فِي الْبَحْرِ بِمَا يَنْفَعُ النَّاسَ وَمَا أَنْزَلَ اللّٰهُ مِنَ السَّمَاءِ مِنْ مَاءٍ
فَأَحْيَا بِهِ الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَبَثَّ فِيهَا مِنْ كُلِّ دَابَّةٍ وَتَصْرِيفِ
الرِّيَاحِ وَالسَّحَابِ الْمُسَخَّرِ بَيْنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَعْقِلُونَ

"Padyshim se në krijimin e qiejve dhe të tokës, në këmbimin me radhë të ditës dhe të natës, në anijet që lundrojnë përmes detit me çfarë është e vlefshme për njerëzimin, në ujin që All-llahu derdhi nga qielli duke e bërë tokën pas tij të gjallë pas vdekjes së saj, në lëvizjen (dhe gjallërinë) e të gjitha krijesave të cilat Ai i ka shpërndarë gjithandej, në ndryshimin e drejtimit të erërave dhe të reve që mbahen mes qiellit dhe tokës, të gjitha këto janë me të vërtetë prova për popullin që mendon."[119]

Kur'ani në këtë vërset përmend treguesin e Sovranitetit Hyjnor në Krijimin e qiejve dhe tokës. Ky tregues demonstron fuqinë e plotë të Krijuesit të Gjithëfuqishëm dhe gjërësinë e Hyjnisë së Tij; dëshmon Njësinë e Tij; treguesin e Hyjnisë së Tij në ndryshimin e natës e të

[119] Kur'an, 2:146

ditës; treguesin e mëshirës Hyjnore përmes nënshtrimit të anijeve në det, mjeteve më të rëndësishme të transportit në jetën sociale njerëzore; treguesin e madhështisë së Fuqisë Hyjnore i cili ia dërgon ujin e jetës tokës së vdekur nga qiejt dhe sjell në jetë qindra e mijëra specie dhe e bëri atë si një ekspozitë çudirash; treguesin e mëshirës dhe të fuqisë në krijimin e numrit të pafund të kafshëve të ndryshme nga një dhè i thjeshtë; treguesin e urtësisë dhe të mëshirës në përdorimin e erërave në detyra e funksione të ndryshme, si: ndihmesa në pjalmimin dhe frymëmarrjen e bimëve dhe kafshëve dhe në shtytjen dhe drejtimin e tyre, duke i bërë ato të përshtatshme për t'i kryer ato funksione; manifestimin e Hyjnisë në nënshtrimin e grumbullimin së bashku të reve, mjeteve të mëshirës, që mbahen të varura ndërmjet qiellit e tokës në masa të mëdha të çuditshme dhe, duke i shpërndarë ato sikur të shpërndahej një ushtri për të pushuar dhe pastaj grumbullohen për të marrë urdhëra për detyrat e tyre. Atëherë, pasi i numëron qëndisjet e shfaqjeve të Atributeve Hyjnore me qëllim që të nxisë mendjen që të hulumtojë mbi detajet e tyre dhe mbi të vërtetat esenciale, ai thotë:

لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ

"...Në të vërtetë këto janë prova për popullin që mendon",

dhe me qëllim që ta zgjojë mendjen për shqyrtim, ia referon atë arsyes.

❍ **Cilësia e tretë e elokuencës:** Ndonjëherë Kur'ani shpjegon veprat e Zotit të Gjithëfuqishëm në detaje dhe pastaj i përmbledh me një përmbledhje. Ai me detajet e tij sjell bindje e qetësi dhe i lidh e ia dorëzon memories nëpërmjet përmbledhjes.

Për shembull:

وَكَذَٰلِكَ يَجْتَبِيكَ رَبُّكَ وَيُعَلِّمُكَ مِن تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ وَيُتِمُّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكَ وَعَلَىٰ
آلِ يَعْقُوبَ كَمَا أَتَمَّهَا عَلَىٰ أَبَوَيْكَ مِن قَبْلُ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ إِنَّ رَبَّكَ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

"Kështu Zoti yt do të të zgjedhë ty dhe do të të mësojë shpjegimin e ëndrrave (dhe gjëra të tjera) dhe do ta përsosë mëshirën e Tij mbi ty dhe pasardhësit e Jakubit, ashtu siç Ai e përsosi atë tek baballarët e tu,

te Ibrahimi dhe Is'haku kohë më parë. Padyshim që Zoti është i Gjithëdituri, i Gjithurti."[120]

Me këtë vërset ai tregon mirësitë e dhuruara për Hazreti Jusufin a.s. dhe paraardhësit e tij. Ai thotë: "Duke ju fisnikëruar e lartësuar mes gjithë njerëzimit me rangun e profetësisë e duke e bërë atë dominanten e të gjitha prejardhjeve mes njerëzimit; duke e bërë familjen tuaj një vend edukimi dhe udhëzimi në shkencat Hyjnore dhe në urtësi dhe, duke bashkuar tek ju dominimin e mbarë e të vlefshëm të kësaj bote dhe lumturinë e përjetshme të botës tjetër; dhe të bëri ty me diturinë e urtësinë edhe sundimtar të fuqishëm të Egjiptit, edhe një profet të lartë si dhe një udhëzues të urtë... Mirësia Hyjnore të ka dalluar ty dhe paraardhësit e tu me njohuri e urtësi. Kështu, ai i përmend e i numëron këto Mirësi Hyjnore dhe atëherë ai thotë: *"Padyshim që Zoti yt është i Gjithëdituri, i Gjithurti."* "*Hyjnia e Tij dhe Urtësia kërkuan që Ai të shfaqte te ty dhe tek paraardhësit e tu Atributet Hyjnore, El-Alimu, El-hakimu, i Gjithëdituri, i Gjithurti."* Kështu, ai i përmbledh ato mirësi të detajuara me këtë përmbledhje.

Dhe për shembull:

قُلِ اللَّهُمَّ مَالِكَ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَنْ تَشَاءُ

"Thuaj (o Muhammed): "O All-llah! Zotëruesi i mbretërimit! Ti ia jep mbretërimin atij që Ti do..."[121]

Ky vërset tregon aktet e Krijuesit të Gjithëfuqishëm në jetën shoqërore njerëzore në një mënyrë të tillë, saqë krenaria e poshtërimi, varfëria e pasuria janë të lidhura drejtpërdrejt me Vullnetin e me Dëshirën e Zotit xh.sh.. Kjo do të thotë: "Rregullimet e vendimet tek pjesa më e madhe e niveleve të shumicës është vetëm nëpërmjet Dëshirës së Zotit xh. dhe Paracaktimit të Tij; rastësia nuk mund të ndërhyjë." Pasi e bën këtë pohim, ai përmend çështjen më të rëndësishme në jetën njerëzore, furnizimin me ushqim të njeriut. Ky vërset provon me një apo dy fraza parapërgatitore se furnizimi, rizku i njeriut dërgohet direkt prej thesareve të mëshirës nga ana e Furnizuesit të Vërtetë. Ajo është kështu: ***"Ushqimi juaj lidhet me jetën e tokës;***

[120] Kur'an, 12:6
[121] Kur'an, 3:26

ringjallja e tokës lidhet me pranverën; dhe pranvera është në duart e Atij i Cili ka nënshtruar diellin e hënën dhe ndryshon natën e ditën. Kështu vetëm Ai i Cili e mbush të gjithë faqen e tokës me të gjitha frutat, mund t'i japë dikujt një mollë si furnizim të vërtetë, dhe Ai bëhet Furnizuesi i Vërtetë i Atij."

Pastaj ai thotë:

وَتَرْزُقُ مَنْ تَشَآءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ

"...Dhe Ti i jep begati e mirësi atij që Ti do pa masë e pa kufi"[122]

Ai i përmbledh dhe i provon ato akte të detajuara në këtë fjali. "Domethënë, Ai i Cili ju jep furnizim të pakufishëm është pikërisht Ai që i kryen këto akte."

❍ **Pika e katërt e elokuencës:** Ndonjëherë ndodh që Kur'ani i përmend krijesat Hyjnore përmes një renditjeje të veçantë të fjalisë. Atëherë me anë të shfaqjes, se krijesat janë brenda një rregulli e një balance dhe se ato janë frutat e tyre, ai paraqet një lloj tejdukshmërie e një shndritje. Atëherë, kjo tejdukshmëri e shndritje tregojnë Emrat Hyjnorë shfaqja e të cilëve është nga ajo pasqyrë si renditja. Është sikur krijesat e lartëpërmendura të ishin fjalë, dhe Atributet Hyjnore janë kuptimet e tyre, ose bërthamat e frutave, ose esencat e tyre.

Për shembull:

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ سُلَالَةٍ مِنْ طِينٍ ۞ ثُمَّ جَعَلْنَاهُ نُطْفَةً فِي قَرَارٍ مَكِينٍ
۞ ثُمَّ خَلَقْنَا النُّطْفَةَ عَلَقَةً فَخَلَقْنَا الْعَلَقَةَ مُضْغَةً فَخَلَقْنَا
الْمُضْغَةَ عِظَامًا فَكَسَوْنَا الْعِظَامَ لَحْمًا ثُمَّ أَنْشَأْنَاهُ خَلْقًا آخَرَ
فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ ۞

"Dhe sigurisht që Ne e krijuam njeriun (Ademin) nga një copë baltë (ujë me dhè). Pas kësaj Ne e bëmë atë (njeriun) si nutfah (lëngu i ngjizur i bashkimit të vezëve mashkullore me ato femërore) duke e strehuar atë në një banesë të sigurtë (mitra e nënës). Dhe pastaj Ne e

[122] Kur'an, 3:27

bëmë nutfan në një copë gjaku të mpiksur, pastaj Ne e bëmë gjakun e mpiksur në një xhungë mishi, pas kësaj Ne bëmë prej asaj xhunge mishi eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish, dhe pastaj Ne e nxorrëm jashtë si një krijim të ri (ky është riprodhimi i njeriut). I Lartësuar me Madhështi është pra All-llahu, më i Miri i Krijuesve."[123]

Kështu, Kur'ani i përmbledh dhe i rendit ato faza të mrekullueshme, të çuditshme, të mahnitshme, të mirorganizuara e të mirëbalancuara të krijimit të njeriut duke i shpjeguar në një mënyrë të tillë si pasqyra e فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ *"I Lartësuar me Madhështi është pra All-llahu, më i Miri i krijuesve"*, saqë sikur çdo etapë shpjegon vetveten dhe e bën vetveten të shfaqet. Madje një shkrues i shpalljes, ndërsa po shkruante këtë vërset, i tha fjalët para se të vinte te ato dhe i mahnitur me vete, tha: "*A edhe mua më erdhi shpallja*?" Ishte plotësimi i rregullit, tejdukshmëria paraprirëse dhe koherenca e tyre, të cilat i kishin shfaqur fjalët e fundit para se të vinte tek ato.

Për shembull:

إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى
الْعَرْشِ يُغْشِي اللَّيْلَ النَّهَارَ يَطْلُبُهُ حَثِيثًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ وَالنُّجُومَ مُسَخَّرَاتٍ
بِأَمْرِهِ أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

"Padyshim që Zoti juaj është All-llahu, i Cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë dhe pastaj Ai u vendos në Fronin (e Autoritetit); Ai sjell natën si mbulesë të ditës dhe secila duke synuar tjetrën pandërprerë; dhe Ai krijoi edhe diellin, edhe hënën, edhe yjet të nënshtruar ndaj urdhrit të Tij. Padyshim që i Tij është krijimi dhe komandimi. I Lartësuar me Madhështi është All-llahu, Zoti i të gjitha botëve!"[124]

Në këtë vërset, Kur'ani shfaq madhështinë e Fuqisë Hyjnore dhe Sovranitetin e Hyjnisë në një mënyrë që tregon se i Gjithëfuqishmi Absolut u vendos në Fronin e Sovranitetit të Tij, i Cili i sundon shenjat e krijimit; ndryshon natën e ditën njëra pas tjetrës si dy shirita, njëri i

[123] Kur'an, 23:12-14
[124] Kur'an, 7:54

bardhë dhe tjetri i zi; dhe dielli, hëna dhe yjet janë të gatshme për të marrë urdhërat si ushtarë të bindur. Prandaj çdo shpirt, sapo ta dëgjojë këtë vërset, nxitet të thotë:

بَارَكَ اللهُ ۞ مَاشَآءَ اللهُ ۞ فَتَبَارَكَ اللهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

Barekall-llah, i bekuar është All-llahu! Mashall-llah, Çfarë çudirash ka dashur Zoti! I lartësuar është All-llahu, Zoti i të gjitha botëve"!

Domethënë, fjalia تَبَارَكَ اللهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ *"I Lartësuar me Madhështi është All-llahu, Zoti i të gjitha botëve!"* është si përmbledhja, bërthama, fruti dhe uji i jetës së asaj që e parapriu.

❍ **Cilësia e pestë e elokuencës:** Kur'ani, ndonjëherë përmend çështje të veçanta materiale të cilat i nënshtrohen ndryshimit dhe janë mjete të cilësive të ndryshme, atëherë me qëllim që t'i transformojë ato në formën e të vërtetave të qëndrueshme, i përmbledh ato dhe i lidh me Emrat Hyjnorë, të cilët janë dritëdhënës, universalë dhe të qëndrueshëm, ose ai i përfundon me një përmbledhje, e cila nxit mendimin dhe nxjerrjen e mësimeve.

Një shembull i kuptimit të parë:

وَعَلَّمَ اٰدَمَ الْاَسْمَآءَ كُلَّهَا ثُمَّ عَرَضَهُمْ عَلَى الْمَلٰٓئِكَةِ فَقَالَ اَنْۢبِـُٔوْنِيْ بِاَسْمَآءِ
هٰٓؤُلَآءِ اِنْ كُنْتُمْ صَادِقِيْنَ ۞ قَالُوْا سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَآ
اِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا اِنَّكَ اَنْتَ الْعَلِيْمُ الْحَكِيْمُ ۞

"Dhe Ai ia mësoi Ademit emrat e të gjitha gjërave, pastaj ua paraqiti ato melekëve dhe u tha: Më thoni Mua emrat e tyre nëse jeni të drejtë. (Melekët) thanë: Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti!"[125]

Para së gjithash, ky vërset përmend një çështje të veçantë lidhur me qënien e Hazreti Ademit a.s. *Kalif* (zëvendës) dhe, se ishte *njohja*, dija, ajo që e bëri Hazreti Ademin a.s. të kishte epërsi mbi melekët. Atëherë

[125] Kur'an, 2:31-32

brenda kësaj ngjarjeje ai përmend ngjarjen e mposhtjes së melekëve para Hazreti Ademit a.s. për sa i përket *njohjes*. Pastaj ai i përmbledh këto dy ngjarje me dy Emra universalë, prej Emrave Hyjnorë:

اَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

4*"Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti!."*

Domethënë, meqenëse Ti je *"i Gjithëdituri dhe i Gjithurti,* Ti na trajtove sipas aftësive tona dhe i dhurove Ademit dije me të cilën ai na mundi dhe e preferove mbi ne në përputhje me aftësitë e tij."

Një shembull i kuptimit të dytë:

وَاِنَّ لَكُمْ فِي الْاَنْعَامِ لَعِبْرَةً نُسْقِيكُمْ مِمَّا فِي بُطُونِهِ مِنْ بَيْنِ فَرْثٍ وَدَمٍ لَبَنًا
خَالِصًا سَآئِغًا لِلشَّارِبِينَ deri në fund...
فِيهِ شِفَآءٌ لِلنَّاسِ اِنَّ فِي ذٰلِكَ لَاٰيَةً لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

"Me të vërtetë që edhe te bagëtitë ka mësim për ju. Ne ju japim juve të pini nga ajo që është në barkun e tyre, nga bashkimi i sekrecioneve të gjëndrrave dhe të gjakut, qumësht të pastër, të shijshëm e të përshtatshëm për ata që e pinë."[126]

"Dhe nga frutat e hurmave dhe nga rrushi ju merrni lëng të ushqyeshëm dhe bar të mirë. Padyshim që këtu ka shenjë të qartë për njerëzit që mendojnë."[127]

Kështu, pasi tregon se Zoti i Gjithëfuqishëm i bën krijesat e Tij, si delet, dhitë, lopët, bullicat dhe devetë si burime për qumësht të pastër e të shijshëm për njeriun; i bëri rrushin e hurmat si kazana e tabaka të mbushura me mirësi të holla, të ëmbla e të shijshme për të, dhe e bën mrekullinë e hollë të Fuqisë së Tij, mjaltin e bletës së vogël, ilaç e shërim për njerëzit, përveç shijes dhe ëmbëlsisë së tij; këto vërsete përfundojnë me fjalët:

اِنَّ فِي ذٰلِكَ لَاٰيَةً لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

[126] Kur'an, 16: 66
[127] Kur'an, 16: 69

"Me të vërtetë që këtu ka tregues të qartë për popullin që mendon", me qëllim që të nxisë njeriun për të menduar, për të nxjerrë mësime e për t'i krahasuar këto me gjërat e tjera.

❍ **Cilësia e gjashtë e elokuencës:** Ndonjëherë ndodh që një vërset i shpërndan dekretet Hyjnore mbi një shumësi gjërash, dhe atëherë ai i bashkon ato me një lidhje uniteti e cila është si një pikë bashkimi, ose i vendos brenda një rregulli universal.

Për shembull:

وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضَ وَلَا يَؤُدُهٗ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيْمُ

"...Kursia (Froni) i Tij shtrihet mbi qiej dhe tokë, dhe Ai nuk ndjen aspak lodhje në ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre. Dhe Ai është më i Larti, më Madhështori."[128]

Kështu ky vërset (d.m.th. *ajeti Kursi*) sjell dhjetë fjali që përfaqësojnë dhjetë nivele të Njësisë në forma të ndryshme dhe i vërteton ato, dhe pastaj me frazën:

مَنْ ذَا الَّذِيْ يَشْفَعُ عِنْدَهٗٓ اِلَّا بِاِذْنِهٖ

"E kush është ai që mund të ndërhyjë tek Ai përveç se me lejen e Tij?"


ai hedh poshtë plotësisht e furishëm përshkrimin e ortakëve për Zotin xh.sh. dhe ndërhyrjen e të tjerëve duke i flakur tutje ato. Gjithashtu, meqenëse ky vërset shfaq "Emrin më të Madh", kuptimet e tij që lidhen me të vërtetat Hyjnore, janë në shkallën më të lartë, saqë ai i demonstron aktet Hyjnore të vendimeve tek shkalla më e lartë. Për më tepër, pas përmendjes së administrimit Hyjnor i orientuar përnjëherësh tek të gjithë qiejt dhe toka, ai përmend ruajtjen gjithëpërfshirëse absolute në shkallën më të lartë me të gjitha kuptimet e tyre, pastaj i përmbledh burimet e atyre manifesti-meve më të larta me një lidhje Njësie e një pikë bashkimi përmes frazës,

وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيْمُ

"Dhe Ai është më i Larti, më Madhështori."

[128] Kur'an, 2:255

Dhe për shembull:


اَللّٰهُ الَّذِیْ خَلَقَ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضَ وَاَنْزَلَ مِنَ السَّمَآءِ مَآءً فَاَخْرَجَ بِهٖ
مِنَ الثَّمَرٰتِ رِزْقًا لَّكُمْ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْفُلْكَ لِتَجْرِیَ فِی الْبَحْرِ بِاَمْرِهٖ
وَسَخَّرَ لَكُمُ الْاَنْهٰرَ ۝ وَسَخَّرَ لَكُمُ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ دَآئِبَیْنِ
وَسَخَّرَ لَكُمُ الَّیْلَ وَالنَّهَارَ ۝ وَاٰتٰىكُمْ مِّنْ كُلِّ مَا سَاَلْتُمُوْهُ
وَاِنْ تَعُدُّوْا نِعْمَتَ اللّٰهِ لَا تُحْصُوْهَا ۝

"All-llahu është Ai i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën dhe që dërgon ujin nga qielli duke nxjerrë prej andej fruta si ushqim për ju; është Ai i Cili i ka bërë anijet të nënshtruara ndaj jush që të mund të lundrojnë nëpër det me lejen dhe Vullnetin e Tij; po kështu Ai i ka bërë edhe lumenjtë të jenë të nënshtruar e në shërbimin tuaj. Dhe Ai ka bërë diellin dhe hënën të dy të ndjekin vazhdimisht drejtimin e tyre (për t'ju shërbyer juve), po kështu ka bërë edhe natën, edhe ditën të nënshtruara për ju. Dhe Ai ju dha gjithçka që ju kërkuat dhe po të numëroni mirësitë e All-llahut, ju kurrë nuk do të ishit në gjendje t'i numëroni ato."[129]

Së pari, këto vërsete tregojnë se Zoti i Gjithëfuqishëm e krijoi universin e madh si një pallat për njeriun dhe, duke dërguar ujin e jetës nga qiejt në tokë, i bëri qiejt e tokën dy shërbëtorë duke prodhuar ushqim për të. Ai gjithashtu i bëri anijet të nënshtruara për njeriun me qëllim që të gjithë njerëzit të mund të përfitojnë nga frutat e tokës që gjenden në çdo pjesë të saj dhe, gjithashtu, individët shkëmbejnë midis tyre frutat e përpjekjes e të punëve të tyre, dhe Ai e siguroi jetën e tyre në çdo drejtim. Domethënë, Ai u dha detit, erës dhe pemës një formë të tillë saqë i bëri erërat si kamxhikë, anijet si kuaj dhe detet si shkretëtira poshtë thundrave të tyre. Dhe përveç lidhjes së njeriut me shumë krahina të tokës nëpërmjet anijeve, Ai gjithashtu, sikur ia ka nënshtruar njeriut lumenjtë, të mëdhenj e të vegjël, duke i bërë ato si mjete të natyrshme transporti. Dhe duke i bërë Diellin dhe Hënën të udhëtojnë, Dhuruesi i Vërtetë i Mirësive ndryshon stinët dhe i bën diellin dhe

[129] Kur'an, 14:32-34

hënën dy shërbëtorë me qëllim që t'i ofrojnë njeriut mirësitë e Tij shumëngjyrëshe të cilat ndryshojnë me ndryshimin e stinëve; Ai i bëri ato të dyja –diellin dhe hënën– si dy timonierë që ta kthejnë atë rrotë të fuqishme. I bëri natën dhe ditën të nënshtruara ndaj njeriut; Ai e bëri natën si një mbulesë për gjumin e tij e si pushim, ndërsa ditën si një vend tregtie për mjetet e tij të jetesës.

Kështu, pas renditjes së këtyre mirësive Hyjnore me përmbledhjen e:

وَاٰتٰىكُمْ مِّنْ كُلِّ مَا سَاَلْتُمُوْهُ ۗ وَاِنْ تَعُدُّوْا نِعْمَتَ اللّٰهِ لَا تُحْصُوْهَا

"Dhe Ai ju dha gjithçka që ju kërkuat dhe po të numëroni mirësitë e All-llahut ju kurrë nuk do të ishi në gjendje t'i numëroni ato...",

ai tregon shtrirjen e sferës së pafund të mirësive të All-llahut që ia ka dhuruar njeriut dhe, se ajo sferë është mbushur me mirësi shumëngjyrëshe. "Domethënë, çfarëdo që kërkon njeriu nëpërmjet gjuhës së nevojave të tij të bashkëlindura dhe aftësive të tij, ato të gjitha i janë dhënë atij. Kështu atyre mirësive nuk mund t'u arrihet fundi me të numëruar, as nuk shterojnë kurrë ato mirësi që i janë dhuruar njeriut. Sigurisht, meqenëse qiejt dhe toka janë një tryezë mirësish për njeriun, dhe gjërat si dielli e hëna dhe nata e dita janë disa nga mirësitë në tryezë, atëherë padyshim mirësitë e drejtuara për te njeriu janë të panumërueshme."

❍ **Misteri i shtatë i elokuencës:** Ndonjëherë ndodh që, me qëllim që të hedhë poshtë e të shkarkojë shkaqet e jashtme nga aftësia për të krijuar dhe që të tregojë largësinë e tyre nga kjo, një vërset tregon qëllimet dhe frutat e efekteve që të kuptohet se shkaqet janë vetëm një perde e jashtme, sepse dëshira e qëllimeve më të urta dhe arritja e rezultateve më të rëndësishme bën të domosdoshme veprën e Atij që është i Gjithëdituri dhe i Gjithurti; shkaqet janë të pajeta e të pavetëdijshme. Kështu, duke përmendur qëllimet dhe rezultatet, vërsete të tilla tregojnë se, ndonëse shkaqet duken në pamje të jashtme e në ekzistencë se janë të lidhura me pasojat e tyre, por në realitet është një distancë e madhe midis tyre. Distanca nga shkaku për te krijimi i pasojës është kaq e madhe, saqë dora më e madhe e shkaqeve nuk mund ta arrijë krijimin e pasojës më të vogël. Kështu, brenda kësaj

distance të gjatë midis shkakut dhe pasojës secili nga Emrat Hyjnorë shfaqet e ndriçon si yjet. Vendi i shfaqjes së tyre është kjo distancë jolëndore. Ashtu si në një shikim sipërfaqësor, që malet në horizont duken sikur janë të bashkuar e të puqur me fundet –cepat– e qiellit, ndonëse nga malet për tek qiejt është një distancë shumë e largët në të cilën yjet shfaqen dhe gjëra të tjera vendosen, po kështu distanca jolëndore midis shkaqeve dhe pasojave është e tillë, saqë ajo mund të shikohet vetëm me dritën e Kur'anit përmes teleskopit të besimit.

Për shembull:

فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَىٰ طَعَامِهِ ۞ أَنَّا صَبَبْنَا الْمَاءَ صَبًّا ۞ ثُمَّ شَقَقْنَا الْأَرْضَ شَقًّا
۞ فَأَنْبَتْنَا فِيهَا حَبًّا ۞ وَعِنَبًا وَقَضْبًا ۞ وَزَيْتُونًا وَنَخْلًا ۞ وَحَدَائِقَ غُلْبًا ۞
وَفَاكِهَةً وَأَبًّا ۞ مَتَاعًا لَكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ ۞


"Atëherë le të shohë njeriu tek ushqimi i tij." "Ne derdhim ujë me bollëk", "Dhe Ne e çajmë tokën në plasa", "Dhe Ne e bëjmë drithin (grurin) të rritet në të", "Dhe rrushtë dhe tërfilin (bimët e gjelbra si ushqim për bagë-titë)", "Dhe kopshtet me pemë të dendura, dhe fruta, dhe Ab-ba (barishte e kullotë), (për të qenë) furnizim dhe përfitim për ju dhe për bagëtitë tuaja."[130]

Duke përmendur mrekullitë e Fuqisë Hyjnore në një sekuencë të urtë me një varg kuptimplot, ky vërset i lidh shkaqet me pasojat dhe tregon një qëllim dhe përfundimin e tij me fjalët: مَتَاعًا لَّكُمْ *"Një furnizim për ju."* Ky qëllim provon se brenda sekuencës së të gjitha shkaqeve dhe pasojave është një Rregullator i Fshehur i Cili shikon e ndjek qëllimin, dhe se shkaqet janë një perde për Të. Po, në të vërtetë, me frazën, مَتَاعًا لَّكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ *"Një furnizim e përfitim për ju e për bagëtitë tuaja",* ajo i mohon e i shkarkon të gjitha shkaqet nga aftësia për të krijuar. Në efekt ajo thotë: Shiu vjen nga qielli me qëllim që të prodhojë ushqim për ju e për kafshët tuaja. Meqenëse në atë ujë nuk ekziston dhembshuri ndaj jush dhe ndaj kafshëve tuaja që t'ju mëshirojë dhe nuk ka aftësi për të prodhuar ushqim, kjo do të thotë se shiu nuk vjen vetë, por dërgohet. Dhe toka prodhon bimë dhe ushqimi

[130] Kur'an, 86: 24-32

juaj vjen prej andej, por duke qenë pa vetëdije e pa mend, është përtej aftësisë së tokës të mendojë për ushqimin tuaj e të ketë mëshirë për ju. Prandaj ajo nuk hapet vetë, por është njëri që e hap atë derë dhe ua jep në duart tuaja mirësitë. Për më tepër, meqenëse bimët e pemët nuk janë të afta të mendojnë për ushqimin tuaj e të prodhojnë me dhembshuri fruta e drithëra për ju, vërseti demonstron se ato janë spango e litarë të cilët Krijuesi i Gjithurtë e i Gjithëmëshirshëm i shtrin nga prapa perdes, tek të cilët Ai i var mirësitë e Tij dhe ua dërgoi gjallesave. Kështu, nga ky shpjegim shfaqen shumë Emra Hyjnorë si, "***Er-Rrahimu, Er-Rrezzaku, El-Mun'imu*** dhe ***El-Kerimu*****",** "*I Gjithë-mëshirshmi, Furnizuesi, Mirëbërësi* dhe *Gjithëbujari*."

Dhe për shembull:



"A nuk e shikon se All-llahu i drejton retë me qetësi, pastaj i mbledh ato bashkë, pastaj i kthen ato në stivë shtresa-shtresa dhe veç sheh shiun të dalë nga brendësia e tyre. Ai dërgon nga qielli edhe male me breshër dhe godet me të atë që do Ai ose e largon atë prej kujt të dojë Ai. Drita e shpejtë e shkrepjes së tyre (e reve) sa s'të merr sytë. "All-llahu bën që nata dhe dita të ndjekin njëra tjetrën. Vërtet që në të ka mësim për ata që janë të pajisur me mprehtësi. Dhe All-llahu krijoi çdo lloj gjallese nga uji. Prej tyre ka disa që zvarriten me barkun e tyre, disa ecin mbi dy këmbë dhe disa mbi katër. All-llahu krijon çfarë do Ai. Vërtetë që All-llahu është i Zoti të bëjë çdo gjë."[131]

[131] Kur'an, 24: 43-45

Ky vërset shpjegon vendimet e mrekullueshme në formimin e reve dhe shkaktimin e rënies së shiut që është nga mrekullitë më të rëndësishme të Hyjnisë dhe perdja më e çuditshme e thesarit të mëshirës. Ashtu si ushtarët e shpërndarë për të pushuar që grumbullohen me rënien e borisë, po kështu retë grumbullohen e formohen me urdhrin e Zotit xh. kur pjesët e tyre ishin shpërndarë e fshehur në atmosferë. Atëherë, ashtu si një ushtri e formuar prej grupeve të vogla, copat e reve bashkohen e formojnë masa që janë të mëdha, të ngritura lart, të lagështa e të bardha, dhe përmbajnë borë e breshër si malet lëvizës në Kijamet prej të cilëve dërgohet uji i jetës për të gjitha gjallesat. Por, në atë dërgesë shikohet një dëshirë e një qëllim, sepse ajo vjen sipas nevojës. Kjo do të thotë se shiu dërgohet. Ndërsa qiejt janë të pastër e bosh, copa të mëdha reshë sikur të ishin male. Në të vërtetë, retë nuk grumbullohen vetë me atë grumbullim të mrekullueshëm, por ato dërgohen nga Ai i Vetmi i Cili i njeh qëniet e gjalla dhe që di gjendjen e tyre. Atëherë në këtë distancë jolëndore shfaqen Emrat Hyjnorë si, **"*El-Kadiru, El-Alimu, El-Mutesar-rifu, El-mudeb-biru, El-Murebbi, El-Mugithu* dhe *El-Muhjii*"**, "*I Gjithëfuqishmi, i Gjithëdituri, Rregullatori, Projektuesi, Ushqyesi, Ndihmuesi* dhe *Dhënësi i jetës*."

❍ **Cilësia e tetë e elokuencës:** Ndonjëherë me qëllim që ta bëjë zemrën t'i pranojë veprat e çuditshme që do të ndodhin në të ardhmen e në Ahiret, e që ta bëjë mendjen t'i vërtetojë ato, Kur'ani përmend veprat e Tij të çuditshme në këtë botë si parapërgatitje, ose ai përmend aktet e çuditshme Hyjnore të së ardhmes dhe të Ahiretit në një mënyrë të tillë, saqë ne fitojmë bindje të qëndrueshme nëpërmjet gjërave të ngjashme të cilat i shikojmë këtu.

Për shembull:

أَوَلَمْ يَرَ الْإِنسَانُ أَنَّا خَلَقْنَاهُ مِن نُّطْفَةٍ فَإِذَا هُوَ خَصِيمٌ مُّبِينٌ

"A nuk e sheh njeriu se Ne e kemi krijuar atë nga sperma? Prapëseprapë, kur shih! Ai paraqitet kundërshtar i hapur..."[132] deri në fund të vërsetit...

Në këtë diskutimin e çështjes së ringjalljes së të vdekurve Kur'ani i Gjithurtë e provon ringjalljen në shtatë apo tetë mënyra të ndryshme.

[132] Kur'an, 36:77

Së pari, ai tërheq vëmendjen për tek krijimi i parë, duke thënë: "Ju e shihni krijimin tuaj, nga sperma në një copë gjaku të mpiksur, nga copa e gjakut të mpiksur në një xhungë mishi, dhe nga ajo në krijimin e njeriut. Atëherë, si e mohoni krijimin tjetër i cili është si ky e madje më i lehtë."

Pastaj me fjalët:

الَّذِي جَعَلَ لَكُم مِّنَ الشَّجَرِ الْأَخْضَرِ نَارًا

"(Ai) i Cili nxjerr për ju zjarrin nga pema e gjelbër."[133]

Krijuesi i Gjithëfuqishëm tregon mirësitë e mëdha që Ai i ka dhënë njeriut, duke thënë: "Ai i Cili u ka dhuruar ju mirësi të tilla nuk do t'ju lërë ju në liri të hyni në varr e të flini pa u ngritur përsëri." Dhe me nënkuptim, ai thotë: "Ju i shihni pemët e vdekura duke ardhur në jetë e duke u bërë të gjelbra, por ju nuk nxirrni përfundimin se kockat e tyre, që u ngjasojnë drurëve të thatë të zjarrit, do të vijnë përsëri në jetë, dhe kështu e quani ringjalljen e njeriut të pagjasë. Pastaj, a do të ishte i paaftë Ai i Cili krijoi qiejt e tokën që ta ngjallë e ta vdesë njeriun që është fruti i qiejve e i tokës? A do ishte e mundur për Atë i Cili administron çështjen e një peme dhe që kujdeset për të, që të neglizhojë e të mos i japë rëndësi frutit të saj e t'i lejojë të tjerët ta pretendojnë atë? A supozoni ju se lihet kot *"pema e krijimit"* që të gjitha pjesët e së cilës janë gatuar me urtësi dhe a mund të neglizhohet fruti dhe rezultati i saj?" Ai thotë: "Ai i Cili do t'ju risjellë në jetë te Ringjallja është i Tillë, saqë i gjithë universi është si një ushtar i bindur nën urdhërat e Tij ***"Kun fe jekun"*** *Bëhu! - dhe ajo bëhet në çast.* Krijimi i pranverës për Të është aq i lehtë sa krijimi i një luleje. Ai është i Vetmi që për fuqinë e të Cilit krijimi i të gjitha kafshëve është aq i lehtë sa krijimi i një mize. Një Fuqi e tillë nuk mund të sfidohet me fjalët!...

مَن يُحْيِي الْعِظَامَ

"Kush do t'u japë jetë këtyre kockave kur të jenë kalbur e të jenë bërë pluhur?"[134]

---

[133] Kur'an, 36:80
[134] Kur'an, 36:78

Atëherë me frazën:

فَسُبْحَانَ الَّذِي بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ

"Kështu pra i Lartësuar është Ai, në Dorën e të Cilit është mbizotërimi i çdo gjëje dhe tek Ai ju të gjithë do të ktheheni."[135]

Ai thotë: "Ai është i Gjithëfuqishmi e i Gjithëlavdishmi i Vetëm, që në Duart e të Cilit janë frerët e të gjitha gjërave, me të Cilin janë çelësat për të gjitha gjërat; i Cili ndryshon natën e ditën, dimrin e verën me aq lehtësi sikur të kthente fletët e një libri, dhe e hap dhe e mbyll këtë botë dhe botën tjetër sikur ato të ishin dy shtëpi." Si rrjedhojë, konkluzioni i të gjitha këtyre dëshmive, është:

وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ

"...Dhe tek Ai ju të gjithë do të ktheheni."[136]

Domethënë, "Ai do t'ju sjellë ju në jetë nga varri e do t'ju sjellë ju në ringjallje, ku juve do t'ju bëhet thirrja për të dhënë llogari në prani të të Gjithëfuqishmit." Kështu, të gjitha këto vërsete e kanë përgatitur mendjen për të pranuar ringjalljen, po kështu ato e kanë përgatitur edhe zemrën, sepse ato kanë treguar akte të ngjashme në këtë botë.

Ndonjëherë ndodh që Kur'ani i përmend veprat Hyjnore lidhur me botën tjetër në një mënyrë të tillë, saqë i bën të kuptueshme përmes gjërave të ngjashme me to në këtë botë, ku asnjë mundësi nuk mbetet për t'i mohuar ato, apo t'i quash të pagjasa.

Për shembull: إِذَا السَّمَاءُ انْشَقَّتْ *"Kur qielli të çahet."*[137] deri në fund... edhe إِذَا السَّمَاءُ انفَطَرَتْ *"Kur qielli të plasë."*[138]; deri në fund... dhe إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ *"Kur dielli të mbështillet dhe të humbë dritën dhe të përmbyset."*[139]*;*

---

[135] Kur'an, 36:83
[136] Kur'ani, 36:83
[137] Kur'an, 84:1
[138] Kur'an, 82: 1
[139] Kur'an, 81: 1

Në këto sure, ndryshimet shumë të mëdha dhe aktet Hyjnore të vendimeve në ringjalljen e në tubimin e madh, ai i përmend në një mënyrë të tillë, që meqenëse njeriu shikon gjëra të ngjashme me to në këtë botë, si për shembull në vjeshtë e në pranverë, ai i pranon me lehtësi ato ndryshime e revolucione të cilat i shkaktojnë frikë zemrës dhe nuk mund të kapen nga mendja. Për të dhënë edhe një përmbledhje të këtyre sureve do të zgjatej shumë, kështu për tani, ne do të tregojmë një frazë të vetme përmes shembullit.

Për shembull, fraza:

إِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ

"Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu të hapen."[140] shpreh çka vijon: Tek ringjallja, të gjitha veprat e secilit do të shpallen të shkruara në një fletë. Kjo çështje është shumë e çuditshme, prandaj mendja nuk mund ta kapë. Por siç tregon sureja, në të njëjtën mënyrë, ashtu si ringjallja pranverore dhe ashtu si çështjet e tjera që janë gjëra të ngjashme me to, po kështu hapja e fletëve dhe e gjërave të ngjashme me to janë mjaft të qarta, sepse të gjitha pemët frutore apo bimët lulëzuese kanë vepra, akte, detyra dhe në çdo mënyrë ato shfaqin Emrat Hyjnorë, lavdërojnë Zotin dhe kryejnë adhurimin. Të gjitha këto vepra janë të shkruara në farërat e në bërthamat e tyre së bashku me historitë e jetës së tyre dhe shfaqen në një pranverë në një vend tjetër. Ashtu siç përmendin ato në mënyrën më elokuente veprat e nënave të tyre dhe trungun përmes gjuhëve të trajtave dhe formave që ato shfaqin, po ashtu shpallin e nxjerrin fletët e veprave të tyre nëpërmjet degëve, sythave, gjetheve, luleve e frutave. Kështu, Ai i Cili e realizon këtë vepër Gjithurtësi, Gjithëruajtje, Planifikuese, Ushqyese e Dobiprurëse, është pikërisht Ai i Cili thotë: إِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ *"Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu të hapen."*

Ju mund të bëni analogji me pikat e tjera nga kjo dhe nxirrni përfundime prej tyre nëse mundeni.

Për t'ju ndihmuar, unë do të them ç'ka vijon:

[140] Kur'an, 81:10

Ashtu siç tregon fraza me fjalën *"Tekvir":* إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ *"Kur dielli të mbështillet dhe të humbë dritën dhe të përmbyset"* një metaforë brilante që do të thotë: *"Mbështjellje dhe mbledhje"*, gjithashtu ajo aludon edhe për gjëra të ngjashme me të.

Së pari: Zoti i Gjithëfuqishëm ngriti perdet e mosekzistencës, të eterit dhe të qiejve dhe duke marrë nga thesari i mëshirës së Tij një llambë vezulluese të ndritshme si dielli për të ndriçuar botën, e shfaqi atë në dynja. Kur bota të mbyllet, Ai përsëri do ta mështjellë atë me mbulesat e tij e do ta heqë.

Së dyti: Dielli është një nëpunës i ngarkuar për të përhapur artikujt e dritës së tij dhe duke mbështjellur kokën e tokës në mbrëmje ai mbledh artikujt e tij e i fsheh; ndonjëherë ai bën pak biznes për shkak të mbulesës së resë; ndonjëherë hëna i lëshon një mbulesë në fytyrë dhe pengon në një far mase veprimin e tij, atëherë ai rregullon librat e llogarisë së prodhimeve dhe veprimeve të tij. Gjithashtu, do të vijë një kohë kur ky nëpunës do të japë dorëheqje nga posti i tij. Madje edhe sikur të mos ketë ndonjë arsye për shkarkimin e tij, ndoshta -kjo do të ndodhë- për shkak të të dy njollave të zeza tani të vogla por që janë duke u rritur e zmadhuar në fytyrën e tij, pasi kanë filluar të bëjnë kështu, -siç e shikojnë astronomët- me lejen e Zotit, dielli do ta marrë prapa dritën që ai shpërndau me një urdhër Hyjnor dhe do ta mbështjellë atë rreth kokës së vet. Atëherë, Zoti i Gjithëlavdishëm do t'i thotë: "Asnjë punë nuk mbetet më për ty në tokë. Shko tek Ferri dhe digji ata që të adhuruan ty dhe fyen një nëpunës të bindur si ti!" Si rrjedhojë, ju ishit tradhtarë e të pabesë. Me këtë, dielli lexon urdhrin Hyjnor:

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ

"Kur dielli të mbështillet e të humbë dritën dhe të përmbyset", nëpërmjet fytyrës së tij të njollosur me të zezë.

❍ **Pika e nëntë e elokuencës:** Ndonjëherë ndodh që Kur'ani i Gjithurtë përmend disa qëllime të pjesshme, pastaj me qëllim që ta shtyjë mendjen nëpërmjet tyre, e konfirmon, e vërteton, e verifikon dhe e provon atë qëllim të pjesshëm përmes Emrave Hyjnorë, të cilët janë si rregulla universalë.

Për shembull:

قَدْ سَمِعَ اللَّهُ قَوْلَ الَّتِي تُجَادِلُكَ فِي زَوْجِهَا وَتَشْتَكِي إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ يَسْمَعُ تَحَاوُرَكُمَا إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ

"Vërtet që tashmë All-llahu e dëgjoi fjalën e gruas e cila fjaloset me ty (Muhammed a.s.m.) në lidhje me bashkëshortin e saj dhe ia çon ankimet All-llahut; dhe All-llahu (gjithmonë) i dëgjon argumentet mes ju të dyve. Vërtet që All-llahu është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues."[141]

Këtu Kur'ani thotë: "Zoti i Gjithëfuqishëm është Gjithëdëgjues Absolut, Ai dëgjon gjithçka. Ai madje dëgjon nëpërmjet Emrit Hyjnor ***El-Hak***, *i Vërteti*, një grua duke biseduar me ty e duke u ankuar për bashkëshortin e saj, gjë e cila është një çështje e veçantë dhe e pjesshme. Dhe meqenëse gratë shfaqin treguesit më të hollë të mëshirës dhe janë thesaret më të mëdha të realitetit të mëshirës e të dhembshurisë, Ai dëgjon përmes Emrit ***Er-Rahim***, *Mëshirëploti*, pretendimin e ligjshëm të një gruaje dhe ankesën e saj te Zoti, e dëgjon atë me shumë vëmendje si një çështje të rëndësisë më të madhe dhe nëpërmjet Emrit ***El-Hak***, *i Vërteti*, e konsideron atë me seriozitet të madh." Kështu, me qëllim që ta bëjë universal këtë qëllim të pjesshëm, vërseti tregon se Ai që dëgjon e shikon ngjarjen më të vogël të krijesave, duhet medoemos të jetë Ai i Cili dëgjon e sheh gjithçka; dhe Ai që është Furnizuesi i gjithësisë, domosdoshmërisht shikon brenda universit vuajtjen e krijesave më të vogla, të cilave u është bërë padrejtësi dhe dëgjon ankesat e tyre. Ai që nuk e shikon vuajtjen e tyre dhe që nuk dëgjon ankesat e tyre për ndihmë, nuk mund të jetë Zoti i tyre.

Kështu, fjalia, إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ *"Vërtet që All-llahu është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues"* shpjegon dy të vërteta të mëdha, si dhe qëllimin e pjesshëm e bën universal.

Një shembull i dytë:

[141] Kur'an, 58:1

سُبْحَانَ الَّذِي أَسْرَىٰ بِعَبْدِهِ لَيْلًا مِّنَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ إِلَى الْمَسْجِدِ الْأَقْصَى الَّذِي
بَارَكْنَا حَوْلَهُ لِنُرِيَهُ مِنْ آيَاتِنَا إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ

"Lavdia dhe Madhështia janë për Atë (All-llahun) i Cili mori robin e Tij (Muhammedin) për udhëtimin nga Xhamia e Shenjtë (Qabeja në Mekë) për te Xhamia më e largët (në Jeruzalem), rrethinat e të cilës Ne i bekuam me qëllim që t'i tregojmë atij (Muhammedit a.s.m.) shenjat Tona. Me të vërtetë që Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëvëzhguesi."[142]

Këtu, pas përmendjes së udhëtimit të profetit Muhammed a.s.m. nga Xhamia e Shenjtë në Mekë për te Mesxhidil Aksa -Xhamia më e largët në Jeruzalem, që ishte fillimi i Mi'ëraxhit -ngjitjes- së tij, Kur'ani thotë: إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ *"Me të vërtetë që Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëvëzhguesi."*

Përemri إِنَّهُ *"Ai"* ose i referohet Zotit të Gjithëfuqishëm, ose profetit a.s.m.. Në qoftë se ai i referohet profetit a.s.m., është siç vijon: "Ndodhej brenda këtij udhëtimi të pjesshëm një udhëtim universal dhe një Mi'ëraxh universal, gjatë të cilit shkoi aq larg, saqë arriti tek *Sidreti el Munteha, dhe ishte në largësi sa dy harqe ose edhe më afër*, ai dëgjoi e shikoi shenjat Hyjnore dhe çudirat e artit Hyjnor që u shfaqën të qarta për sytë e veshët e tij në shkallët universale të Emrave Hyjnorë." Ai tregon se ai udhëtim i veçantë e i pjesshëm ishte çelësi për një udhëtim të përgjithshëm, i cili ishte një grumbullim i çudirave.

Në qoftë se përemri i referohet Krijuesit të Gjithëfuqishëm është si më poshtë: "Ai ftoi një prej shërbëtorëve të Vet të udhëtojë për te Prania e Tij, dhe me qëllim që t'i besojë atij amanetin e misionit e dërgoi atë nga Mesxhidi Harami në Mekë për tek Mesxhidi Aksa - xhamia më e largët në Kuds,- ku e bëri të takohet me profetët që u grumbulluan atje. Atëherë pasi tregoi se ai ishte trashëgimtari absolut i parimeve të feve të të gjithë profetëve, e bëri atë të udhëtojë përmes botëve të Tij me aspektet e tyre të brendshme e të jashtme deri te *largësia sa dy harqe ose edhe më afër.* Ai sigurisht ishte një shërbëtor

[142] Kur'an, 17:1

dhe udhëtoi në Mi'ëraxh, që ishte i veçantë, por së bashku me të ishte besimi dhe amaneti që lidhen me të gjithë universin, dhe drita që do të ndryshonte ngjyrën e universit. Dhe meqenëse së bashku me të ishte çelësi për të hapur derën e lumturisë së përjetshme, Zoti i Gjithëfuqishëm e përshkroi këtë qënie me atributet **"e dëgjimit dhe të shikimit të të gjitha gjërave."** Kështu që Ai mund t'ju shfaqte qëllimet gjithëpërfshirëse të botës, shembujt e urtësisë së amanetit, dritën dhe çelësin.

Një shembull tjetër:

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ فَاطِرِ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ جَاعِلِ الْمَلٰٓئِكَةِ رُسُلًا اُولِيْٓ اَجْنِحَةٍ مَّثْنٰى وَثُلٰثَ وَرُبٰعَ
يَزِيْدُ فِي الْخَلْقِ مَا يَشَآءُ اِنَّ اللّٰهَ عَلٰى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيْرٌ

"Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për All-llahun, i Vetmi Krijues i qiejve dhe i tokës, i Cili i bëri melekët (engjëjt) lajmëtarë me fletë- dy, tri a katër. Ai shton në krijim çfarë Ai do. Sepse Zoti xh.sh. është i Gjithëfuqishëm *mbi gjithçka."*[143]

Në këtë sure Kur'ani thotë: "Duke zbukuruar qiejt dhe tokën në një mënyrë të tillë, e duke treguar veprat e plotësimit të Tij, Krijuesi i Gjithëlavdishëm i bën spektatorët e panumërt ta lavdërojnë e ta madhërojnë Atë. Dhe Ai i stolis ato me mirësi të pafund, saqë qiejt e toka e lavdërojnë dhe e madhërojnë pafundësisht Krijuesin Mëshirëplotë nëpërmjet gjuhëve të të gjitha mirësive dhe të atyre që i marrin ato." Pas kësaj ai tregon se, meqenëse Krijuesi u ka dhënë njerëzve, kafshëve dhe zogjve gjymtyrë e fletë me të cilat ato të udhëtojnë përmes qyteteve dhe mbretërive të tokës dhe meqenëse Ai i Gjithëlavdishëm i Vetëm u ka dhënë fletë engjëjve, banorëve të botës së qiejve, me qëllim që të fluturojnë e të udhëtojnë përmes pallateve qiellore të yjeve dhe përmes mbretërive të larta të yjësive, Ai sigurisht është i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat. Atëherë, Ai i Cili i jep një mize krahë për të fluturuar nga fruti në frut, dhe që i jep krahë një trumcaku për të fluturuar nga pema në pemë, është pikërisht Ai i Cili u jep engjëjve fletë për të fluturuar nga Venusi për te Jupiteri dhe nga Jupiteri në Saturn. Për më tepër, engjëjt nuk përkufizohen për tek e

[143] Kur'an, 35:1

veçanta, ashtu siç ngjet me banorët e tokës; ato nuk kufizohen në një vend të veçantë. Me fjalën: مَثْنٰى وَثُلٰثَ وَرُبٰعَ *"Dy, tri a katër (fletë)",* ai sugjeron se ata mund të jenë të pranishëm në të njëjtën kohë në katër yje apo më shumë; ai jep detaje. Kështu nëpërmjet përshkrimit të "pajisjes së engjëjve me fletë" që është një ngjarje e pjesshme, ai tregon madhështinë e fuqisë absolute Hyjnore universale dhe të përgjithshme, si dhe verifikon dhe e vërteton atë me përmbledhjen:

إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

"Sepse All-llahu është i Gjithëfuqishëm *mbi gjithçka."*

❍ **Pika e dhjetë e elokuencës:** Ndonjëherë ndodh që një vërset përmend aktet e mosbindjes dhe gjynahet e njeriut dhe atëherë e ndalon atë me kërcënime të ashpra. Pastaj, me qëllim që të mos e çojë rreptësia e kërcënimeve në dëshpërim të thellë e këputje shprese, vërseti përfundon me disa Emra Hyjnorë të cilët tregojnë mëshirën e Tij dhe e ngushëllojnë atë.

Për shembull:

قُلْ لَوْ كَانَ مَعَهُ آلِهَةٌ كَمَا يَقُولُونَ إِذًا لَابْتَغَوْا إِلَىٰ ذِي الْعَرْشِ سَبِيلًا ۝ سُبْحَانَهُ
وَتَعَالَىٰ عَمَّا يَقُولُونَ عُلُوًّا كَبِيرًا ۝ تُسَبِّحُ لَهُ السَّمَاوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ
إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ وَلَٰكِنْ لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ إِنَّهُ كَانَ حَلِيمًا غَفُورًا ۝

"Thuaju: Po të kishte patur zota e perëndi të tjerë bashkë me Të, siç thonë ata, atëherë ata sigurisht do të kishin kërkuar të gjenin një rrugë drejt Zotit të Fronit më të lartë (për të kërkuar kënaqësinë e Tij, për t'iu afruar Atij). Lavdi, Madhështia dhe Lavdia i takojnë Atij! Larg nga të gjitha trillimet e shpifjet që i ngjisin e thonë për Të (më i Larti pa kufi)"! "E lavdërojnë dhe e ngrenë në lavdi e madhështi Atë shtatë qiejt dhe toka dhe gjithë ç'është në to dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij, por ju nuk e kuptoni lavdërimin e tyre. Me të vërtetë që Ai është gjithnjë tepër i Durueshëm, vazhdimisht Falës i Madh."[144]

[144] Kur'an, 17:42-44

Ky vërset thotë: "Thuaj, në qoftë se Zoti, siç thoni ju, do të kishte pasur ortakë në Mbretërinë e Tij, pa dyshim do të shtriheshin duart e tyre tek Froni i Hyjnisë dhe do të shfaqeshin shenjat e ndërhyrjes në prishjen e rregullit e të sistemit, por çdo krijesë, qoftë tërësore apo e pjesshme, e madhe apo e vogël, nga shtatë nivelet e qiejve gjer te organizmat mikroskopikë, lavdërojnë përmes gjuhës së shfaqjeve të treguesve dhe të skalitjeve të të gjithë Emrave Hyjnorë, të cilët demonstrohen nga çdo krijesë; ato lavdërojnë e madhërojnë të Gjithëlavdishmin e Vetëm i Cili tregohet përmes atyre Emrave të bukur dhe deklarojnë se Ai është Një i Vetëm, pa ortakë e i pangjashëm. Po, qielli e shenjtëron Atë dhe dëshmon për Njësinë e Tij me fjalët e tij prej dritash nga diejt e yjet dhe me urtësinë e rregullin që ato shfaqin; gjithashtu atmosfera e lavdëron dhe e shenjtëron Atë përmes zërit të reve, fjalëve të rrufesë, vetëtimës dhe pikave të shiut; toka e lavdëron dhe e deklaron se Ai është Krijuesi i Vetëm i Gjithëlavdishëm përmes fjalëve të saj të gjalla të njohura si: kafshët, bimët dhe qëniet; gjithashtu ajo e lavdëron Atë dhe dëshmon Njësinë e Tij përmes fjalëve të të gjitha pemëve të saj, gjetheve, luleve dhe frutave të saj. Në të njëjtën mënyrë, së bashku me vogëlsinë dhe pjesshmërinë e tyre, krijesat më të vogla dhe qëniet më të pjesshme lavdërojnë të Gjithëlavdishmin e Vetëm i Cili tregohet nga Emra të shumtë të përgjithshëm që ato shfaqin dhe dëshmojnë Njësinë e Tij përmes skalitjeve që ato mbajnë."

Kështu, ky vërset pohon se i gjithë kozmosi e madhëron përnjëherësh e me një gjuhë dhe i nënshtrohet Krijuesit të Gjithëlavdishëm dhe i bindet plotësisht Atij nëpërmjet detyrës së adhurimit; ndërsa njeriu i cili është esenca e universit dhe rezultati i tij, kalifi (zëvendësi) i Zotit xh.sh. në tokë dhe fruti i butë i kozmosit bën të kundërtën e të gjithë kozmosit, mohon Zotin xh.sh. dhe i përshkruan ortakë Atij. Sa e shëmtuar është kjo punë e tij? Dhe sa ndëshkim të rreptë meriton ai për këtë shkelje të rëndë! Por me qëllim që të mos bie njeriu në dëshpërim të thellë e të humbë shpresën, ky vërset tregon urtësinë e mosshkatërrimit të universit dhe mosrënien e tij mbi kokën e njerëzimit nga ana e *Krijuesit Nënshtrues*, për shkak të mosbindjes së shëmtuar, si kjo shkelje e rëndë, dhe thotë:

إِنَّهُۥ كَانَ حَلِيمًا غَفُورًا *"Me të vërtetë që Ai është gjithnjë tepër i Durueshëm, vazhdimisht Falës i Madh".* Ai tregon me këtë

përmbledhje urtësinë e shtyrjes për më vonë të dënimit dhe lë të hapur derën e shpresës.

Kështu, ju mund të kuptoni nga këto dhjetë tregues të mrekullisë, se në përmbledhjet tek përfundimet e vërseteve janë spërkatjet e shumta të udhëzimit dhe shkreptimat e mrekullisë.

Gjenitë më të mëdhenj midis studiuesve të retorikës kanë kafshuar gishtërinjtë e tyre me çudi e admirim absolut për këto stile të veçanta dhe kanë deklaruar se:

Kjo nuk ***është fjalë njeriu*** dhe kanë besuar me siguri të plotë se, إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ *"Është vetëm shpallje që i frymëzohet."*[145] Kjo do të thotë se së bashku me treguesit e lartëpërmendur, shumë cilësi të mëtejshme që nuk janë përfshirë në diskutimin tonë, janë përfshirë në disa vërsete të tjera, në renditjen e të cilëve një shenjë mrekullie është e qartë, saqë edhe të verbërit mund ta shikojnë atë...

❑ **Rrezatimi i Tretë i Dritës së Dytë:**

Kur'ani nuk mund të krahasohet me ndonjë fjalë apo ligjeratë tjetër. Është sepse fjala është e kategorive të ndryshme dhe në lidhje me epërsinë, fuqinë, bukurinë dhe hollësinë ajo ka katër burime: I pari është **folësi**, i dyti është **personi të cilit i adresohet**, i treti është **qëllimi** dhe i katërti është **forma (stili).** Burimi i tij nuk është vetëm forma të cilën e kanë treguar gabimisht letrarët. Kështu, merr në konsideratë se **"kush e tha atë? Kujt ia tha? Përse e tha? Dhe në çfarë forme e tha?"** Mos merr në konsideratë vetëm fjalët e të ndalosh aty. Meqenëse fjala e merr fuqinë e saj nga këto katër burime dhe në qoftë se burimet e Kur'anit do të studiohen me kujdes, atëherë shkalla e elokuencës së tij, epërsisë dhe bukurisë do të kuptohen. Po, meqenëse fjala shikon dhe merr fuqi nga folësi, nëse është urdhëresë e ndalesë, ajo përfshin gjithashtu dëshirën dhe fuqinë e folësit në përputhje me shkallën e tij. Atëherë ajo zhduk rezistencën, ka një efekt elektriciteti dhe rritet në përpjesëtim me epërsinë dhe fuqinë e fjalës.

Merr, për shembull, vërsetin: يَا أَرْضُ ابْلَعِي مَاءَكِ وَيَا سَمَاءُ أَقْلِعِي

[145] Kur'an, 53: 4

"O tokë! Gëlltite ujin tënd! Dhe o qiell! Përmbaje (shiun tënd)!"[146]

Domethënë, "O tokë! Detyra jote është përmbushur, gëlltite ujin tënd. O qiell! Tani s'mbetet më nevojë, ndalo së dhëni shi!"

Dhe për shembull: فَقَالَ لَهَا وَلِلْأَرْضِ ائْتِيَا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا قَالَتَا أَتَيْنَا طَائِعِينَ

"Dhe Ai i tha atij dhe tokës: Ejani të dyja ju me dëshirë a pa dëshirë." Ato të dyja (toka dhe qielli) thanë: Ne vijmë me dëshirë e të nënshtruara."[147] Domethënë, "O tokë! O qiej! Ju doni apo s'doni, ju në çdo mënyrë jeni të nënshtruara ndaj urtësisë dhe Fuqisë Sime. Ju shfaqeni nga mosqënia dhe vini në vendin e ekspozitës së artit Tim në ekzistencë." Dhe ato u përgjigjën: "Ne vijmë me nënshtrim e bindje të plotë; nëpërmjet Fuqisë Tënde ne kryejmë çdo detyrë që Ti na ke treguar." Atëherë, merre me mend fuqinë dhe lartësinë e këtyre urdhrave të vërtetë dhe efektivë të cilët përmbajnë fuqi e dëshirë, pastaj shikoji fjalët e njerëzve si urdhri i pakuptim vijues me qëniet e pajeta:

اُسْكُنِي يَا أَرْضُ وَانْشَقِّي يَا سَمَاءُ وَقُومِي أَيَّتُهَا الْقِيَامَةُ

"Ji e palëvizur o tokë, çohuni o qiej, bëhu o Kijamet!"

A mund të krahasohet kjo fjali me dy urdhrat e mëparshëm!.. A ka ndonjë krahasim midis urimeve që burojnë nga dëshirat me zell të tepruar të njeriut dhe urdhresave që burojnë nga ato dëshira dhe urdhërit të urdhëruesit të një autoriteti real! A mund të ketë ndonjë krahasim midis fjalëve të tilla dhe midis komandës efektive "Përpara marsh!.. të një komandanti të plotfuqishëm të një ushtrie të madhe! Sepse në qoftë se një urdhër i tillë do të dëgjohej nga një ushtar i thjeshtë, atij s'do t'i jepej rëndësi. Këta dy urdhëra ndonëse janë të njëjtë në formë, por në kuptim ata janë aq të ndryshëm, si komanda e një ushtari të thjeshtë me atë të komandantit të një ushtrie.

Dhe, për shembull vërsetet: إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ

[146] Kur'an, 11:44
[147] Kur'an, 41:11

"Sigurisht që urdhri i Tij, kur Ai do një gjë, është vetëm se Ai t'i thotë asaj"bëhu! Dhe ajo është e bërë (në çast)."[148]

Dhe: وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَٰٓئِكَةِ ٱسْجُدُوا۟ لِـَٔادَمَ *"Dhe (kujto) kur Ne u thamë melekëve"Bini në sexhde para Ademit*."[149] Shikoje fuqinë dhe lartësinë e dy urdhërave në këto dy vërsete, dhe pastaj shiko foljen e njeriut nga ky lloj urdhri. A nuk është raporti i krahasimit midis atyre të dyve si xixa e një xixëllonje me dritën e diellit?

Ashtu si me qëllim që të përshkruajë aktin e tij për syrin e veshin, një pronar i vërtetë e përshkruan veprimin e tij ndërsa është duke e kryer atë; dhe një artist i vërtetë e shpjegon artin e tij ndërsa ai e punon atë; dhe një dhurues i vërtetë i shpjegon mirësitë e tij ndërsa ai i dhuron ato. Domethënë, me qëllim që t'i përgjigjet veprimi i tij fjalës së tij, pra të kombinohen fjala e puna, secili thotë: "Shiko! Unë e kam bërë këtë dhe po e bëj këtë në këtë mënyrë. Unë e bëra atë për këtë arsye dhe kjo do të jetë kështu dhe jam duke bërë kështu..." Në këtë mënyrë shpjegon njëherësh veprimin e tij për syrin dhe veshin.

Për shembull:

أَفَلَمْ يَنظُرُوٓا۟ إِلَى ٱلسَّمَآءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنَٰهَا وَزَيَّنَّٰهَا وَمَا لَهَا مِن فُرُوجٍ ۝ وَٱلْأَرْضَ
مَدَدْنَٰهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَٰسِىَ وَأَنۢبَتْنَا فِيهَا مِن كُلِّ زَوْجٍۭ بَهِيجٍ ۝ تَبْصِرَةً وَذِكْرَىٰ
لِكُلِّ عَبْدٍ مُّنِيبٍ ۝ وَنَزَّلْنَا مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءً مُّبَٰرَكًا فَأَنۢبَتْنَا بِهِۦ جَنَّٰتٍ وَحَبَّ ٱلْحَصِيدِ ۝
وَٱلنَّخْلَ بَاسِقَٰتٍ لَّهَا طَلْعٌ نَّضِيدٌ ۝ رِّزْقًا لِّلْعِبَادِ وَأَحْيَيْنَا بِهِۦ بَلْدَةً مَّيْتًا كَذَٰلِكَ ٱلْخُرُوجُ ۝

"A nuk e kanë parë qiellin mbi ta, si Ne e kemi ndërtuar atë dhe zbukuruar, dhe s'ka asnjë të çarë në të? Edhe tokën! Ne e kemi shtrirë atë dhe kemi vendosur në të male që qëndrojnë fort, si dhe kemi sjellë në të çdo lloj bime të mrekullueshme në çift. Një ndriçim dhe përkujtues për çdo rob që i kthehet All-llahut me pendim. Dhe Ne zbresim ujë të bekuar nga qielli, pastaj Ne rrisim në të kopshte dhe drithë që rritet e korret. Edhe hurma të larta me vile të renditura palë.

[148] Kur'an, 36:82
[149] Kur'an, 2:34

Rizk (furnizim e mirësi) për robët (e All-llahut); dhe Ne i japim jetë me të (shiun) tokës që është e vdekur: Kësisoj do të jetë ringjallja (e të vdekurve)"[150]

A mund të ketë ndonjë krahasim midis këtyre përshkrimeve, këtyre akteve, të cilat shndrisin si yje, si frutat e Parajsës në yjësinë e kësaj sureje në qiejt e Kur'anit, dhe kjo duke përmendur nivelet e provave brenda tyre nëpërmjet retorikës, dhe kështu duke provuar ringjalljen e të vdekurve, dhe që është përfundimi i saj me frazën:

كَذَٰلِكَ ٱلْخُرُوجُ

"Kësisoj do të jetë ringjallja e të vdekurve" duke i heshtur kështu ata që mohojnë ringjalljen te fillimi i sures; a mund të ketë ndonjë krahasim midis kësaj dhe midis diskutimeve të njerëzve rreth akteve të ngatërruara që kanë pak lidhje me to? Madje nuk është as krahasimi i pikturave të luleve nëpërmjet kopjimit, dhe i luleve të gjalla reale. Për të shpjeguar plotësisht kuptimin e këtyre vërseteve Kur'anore, أَفَلَمْ يَنظُرُوا *"A nuk e kanë parë ata"?* deri tek كَذَٰلِكَ ٱلْخُرُوجُ *"Kësisoj do të jetë ringjallja (e të vdekurve)"* do të zgjatej tej mase, kështu ne do të mjaftohemi këtu vetëm me një tregues të shkurtër e do të kalojmë në çështjen tonë.

Meqenëse në fillim të sures, jobesimtarët e mohojnë ringjalljen, Kur'ani ka një pjesë të gjatë parapërgatitore me qëllim që t'i detyrojë ata ta pranojnë atë: "A nuk i shikoni qiejt mbi ju, që Ne i kemi ngritur në një mënyrë kaq madhështore e të mirorganizuar? Dhe a nuk e shihni si Ne e kemi zbukuruar atë me yje, me diellin dhe hënën, dhe si Ne nuk kemi lejuar asnjë të çarë apo defekt në të? Dhe a nuk e shihni se si Ne e kemi shtrirë tokën për ju dhe me çfarë urtësie e kemi pajisur e mobiluar atë? Ne kemi ngulur malet në të dhe e kemi mbrojtur atë nga vërshimi e shkelja e detit. Dhe a nuk e shihni se si Ne e kemi krijuar çdo lloj bime e çdo gjë të kultivuar në tokë, të bukur e të çdo ngjyre, dhe si Ne e kemi zbukuruar çdo pjesë të saj me to? Dhe a nuk shihni ju si Ne zbresim shi me bollëk nga qiejt dhe me të Ne krijojmë kopshte e pemishte, drithëra, pemë të larta e frutdhënëse, si hurmat e shijshme dhe si Unë i bëj ato të rriten dhe me ato u dërgoj rizk, furnizim e

[150] Kur'an, 50: 6-11

mirësi, robërve të Mi? A nuk e shihni se Unë me shi sjell në jetë tokën e vdekur? Unë krijoj me mijëra ringjallje nga gjërat e kësaj bote. Ashtu siç i nxjerr Unë me fuqinë Time këto bimë nga toka e vdekur, kështu do të jetë dalja juaj në ditën e ringjalljes; në ditën e kijametit, toka do të vdes ndërsa ju do të ringjalleni." Atëherë a mund të ketë ndonjë krahasim midis shpjegimeve elokuente që shtjellojnë këto vërsete për të provuar ringjalljen që vetëm një të mijtën e të cilave ne mundëm të tregojmë, dhe midis fjalëve që paraqet njeriu për të mbështetur një pretendim?

Nga fillimi i kësaj trajtese gjer këtu, në përpjekje për ta bërë armikun kryeneç të pranojë mrekullinë e Kur'anit përmes një arsyetimi e gjykimi të drejtë, e njohur si "vërtetësia e sigurtë", ne kemi lënë të fshehura shumë nga të drejtat e Kur'anit. Ne e kemi sjellë atë diell midis qirinjve dhe kemi nxjerrë krahasime. Ne e kemi përmbushur detyrën e sigurimit të së vërtetës, dhe e kemi provuar mrekullinë e tij në formën më brilante. Tani në një ose në dy fjalë, në emrin e 'realitetit' dhe jo në emrin e "verifikimit shkencor" ne do të tregojmë pozitën e vërtetë të Kur'anit e cila është përtej krahasimit.

Në të vërtetë, krahasimi i fjalëve të tjera me ato të Kur'anit është ai i reflektimit të yjeve shumë të vegjël që shihen nëpër copa qelqi, me atë të vetë yjeve. Si munden fjalët e Kur'anit që secila pasqyron e tregon një të vërtetë të qëndrueshme, të krahasohen me kuptimet që pikturon njeriu me fjalët e tij në pasqyrat e vockëla të mendimeve dhe të ndjenjave të tij? Si munden që fjalët e gjalla, si jeta e engjëjve të pastër, fjalët e Kur'anit që inspirojnë e sjellin dritat e udhëzimit dhe që janë fjalët e Krijuesit të Gjithëlavdishëm të diellit e të hënës, të krahasohen me fjalët thumbuese të njeriut me substancat e tyre prej magjie e me finokëri të sajuara, të cilat burojnë nga dëshirat e ulëta? Krahasimi i parazitëve dhe i insekteve helmues me engjëjt e bekuar dhe me qëniet shpirtërore të ndritshme është ai i fjalëve të njeriut dhe i atyre të Kur'anit. Fjala e Njëzet e Pestë së bashku me njëzet e katër Fjalët e mëparshme i kanë provuar këto të vërteta. Ky pretendimi ynë nuk është i paprovuar. Prova e tij është përfundimi i lartpërmendur.

Po, si munden fjalët e Kur'anit, që secila prej tyre është si një arkë e xhevahireve të udhëzimit, që secila është si një burim i të vërtetave të besimit, dhe minerali i themeleve të Islamit, të ardhura nga Froni i të Gjithëmëshirshmit të Vetëm, të zbritura nga sipër e matanë gjithësisë

për tek njeriu, dhe që përmbajnë njohuri Hyjnore, fuqi e dëshirë dhe që janë fjalime parapërjetësie, si munden fjalët e tij të krahasohen me fjalët e kota të njeriut, të trilluara, të padobishme, eksituese dhe ushqyese të dëshirave të ulëta? Vërtet, si mundet Kur'ani i cili është si *Pema e Tubas*, që ka shpërndarë degët e saja në të gjitha anët e botës së Islamit me të gjitha cilësitë e saj, shenjat, plotësimet, të gjitha urdhëresat e principet në formën e gjetheve, dhe i shfaq me aq freski e bukur, nëpërmjet ujit të jetës së asaj peme, dijetarët dhe shenjtorët e tij të pastër, secili si një lule, dhe prodhon të gjitha plotësimet e të vërtetave kozmike e Hyjnore si frutat; përsëri si një pemë frutmbajtëse prodhon farëra të shumta brenda fruteve të saj, secili si një parim e program për veprimet dhe shfaq të vërteta në vijim të pandërprerë, si mundet kjo të krahasohet me fjalët e njeriut rreth të cilave ne dimë!..

أَيْنَ الشَّرَامِنَ الثُّرَيَّا

"Ku është toka dhe ku janë plejadat?"

Megjithëse për njëmijë e treqind e pesëdhjetë vjet, Kur'ani i Gjithurtë ka përhapur e shfaqur të gjitha të vërtetat e tij në tregun e universit, dhe gjithësecili, të gjithë kombet, të gjitha vendet kanë marrë disa prej xhevahireve dhe të vërtetave të tij dhe vazhdojnë të marrin, pavarësisht nga kjo, as ai familjaritet, të mësuarit me të, as ai bollëk, as kalimi i kohës dhe as ato ndryshime të mëdha, nuk i kanë dëmtuar të vërtetat e Tij të vlefshme dhe stilet e Tij të holla; as nuk i kanë shkaktuar Atij të vjetërohet e të thahet, as ta bëjnë që të humbasë vlerën e Tij dhe as nuk e kanë shuar bukurinë e Tij. Kjo situatë, në vetvete, është një aspekt mrekullie.

Në qoftë se dikush do të paraqitej tani e të vendoste disa nga të vërtetat e Kur'anit në një renditje fëmijërore sipas tekave të veta, dhe në qoftë se ai do t'i krahasonte këto me disa nga vërsetet e Kur'anit me qëllim që t'i kundërshtojë ato, duke thënë: "Unë kam thënë fjalë të ngjashme e të përafërta me ato të Kur'anit," ai do të ishte krejtësisht idiot... si në shembullin e mëposhtëm:

Në qoftë se një njeri i zakonshëm, një ndërtues i një shtëpie të zakonshme, i paaftë për të kuptuar skalitjet e larta të Mjeshtrit që ka ndërtuar një pallat të shkëlqyer, gurët e të cilit janë xhevahire të larmishëm dhe që e ka zbukuruar atë me skalitje harmonike, që shikojnë tek skalitjet e larta të të gjithë pallatit dhe tek lidhja e tyre me

gurët, në qoftë se ai njeri i thjeshtë, i cili nuk kishte fare pjesë tek të gjitha ato xhevahire dhe tek zbukurimi i pallatit, do të hynte në pallat e të shkatërronte skalitjet e larta të gurëve të çmuar dhe t'i jepte atij një formë, një rregull të ngjashëm me atë të një shtëpie të zakonshme në përputhje me dëshirat e tij foshnjarake, dhe t'i bashkangjiste ca rruaza për të kënaqur shikimin e tij fëmijëror, duke thënë: Shikoni! Unë kam aftësi më të madhe, më shumë pasuri dhe më shumë xhevahire të çmueshëm se sa ndërtuesi i pallatit, krahasimi do të ishte ai i artit të një farkëtari, i cili është duke folur përçart e që ka kaluar në çmenduri.

● **DRITA E TRETË:**

Drita e tretë përbëhet nga tre Rreze.

■ **Rrezja e parë:** Një aspekt i rëndësishëm i mrekullisë së Kur'anit u shpjegua në *Fjalën e Trembëdhjetë.* Ai është përfshirë këtu me qëllim që të marrë vendin e tij midis aspekteve të tjera të mrekullisë, midis vëllezërve të tij. Ai është siç vijon: Në qoftë se ti dëshiron të shikosh e të vlerësosh se si secili nga vërsetet e Kur'anit, ashtu si yjet ndriçues që përhapin dritën e mrekullisë e të udhëzimit, zhdukin e largojnë errësirën e mosbesimit, përfytyroje veten tënde në periudhën e injorancës para se të shpallej Kurani dhe në shkretëtirën e egërsisë e të barbarizmit, ku gjithçka ishte e mbuluar me perdet e pajeta të natyrës nën errësirën e injorancës e të pakujdesisë. Atëherë, papritmas, nga gjuha e lartë e Kur'anit, ti dëgjon vërsete si:

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ۞ يُسَبِّحُ لِلَّهِ مَا فِي
السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ الْمَلِكِ الْقُدُّوسِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ ۞

"Gjithë ç'është në qiej dhe gjithë ç'është në tokë lavdërojnë All-llahun, Mbretëruesi i papërballueshëm (i gjithçkaje), i Shenjti, i Gjithëfuqishmi, i Gjithurti."[151] *"Gjithë ç'është në qiej dhe në tokë lavdërojnë All-llahun dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, i Gjithurti."*[152]

dhe vërsete të ngjashëm me këto. Pastaj shiko se si krijesat e pajeta apo të fjetura të botës vijnë në jetë në mendjet e atyre që dëgjojnë

[151] Kur'an, 62:1
[152] Kur'an, 57:1

tingullin e سَبَّحَ ... يُسَبِّحُ *"...e lavdërojnë dhe e ngrejnë në lavdi e madhështi..."*, shiko si zgjohen, ngrihen dhe përmendin Emrat e Zotit!

Dhe tek tingulli i: تُسَبِّحُ لَهُ السَّمٰوَاتُ السَّبْعُ وَالْاَرْضُ *"Shtatë qiejt dhe toka dhe gjithçka brenda tyre e lavdërojnë dhe e ngrejnë në lavdi e madhështi Atë..."*[153] Yjet në ato qiej të zinj, secili një copë e pajetë zjarri, dhe krijesat e shkreta në faqen e tokës paraqesin shikimin e mëposhtëm për ata që dëgjojnë:

Qielli shfaqet si një gojë dhe të gjitha yjet secili si një urtësi duke shprehur fjalët e duke përhapur dritat e së vërtetës. Globi tokësor, me atë jehonë qiellore, shfaqet si një kokë e madhe; toka e deti si dy gjuhë, të gjitha kafshët e bimët si fjalët e lavdërimit dhe të madhërimit. Kështu, duke kaluar me përfytyrimin tënd tek ai shekull, ti do të vlerësosh pikat e holla të mrekullisë në ato vërsete Kur'anore. Ndryshe ti do të privoheshe nga kënaqësia e pikave të holla në vërset. Po, në qoftë se ti do t'i shikoje vërsetet Kuranore të cilët i kanë përhapur dritat e tyre që nga ajo periudhë kohe, dhe se shekulli ynë është ndriçuar qysh prej asaj epoke nga dritat e Kur'anit dhe se ato u bënë të njohura e të pranuara botërisht me kalimin e kohës, dhe se ai shekull u ndriçua edhe me dritat e tjera të Islamit dhe e mori ngjyrën e ditës nga dielli i Kur'anit, përndryshe në qoftë se ti do t'i shikoje vërsetet nëpërmjet perdes së familjaritetit, të mësuarit me të, dhe me vështrim të përciptë, padyshim që ti nuk do të shihje se çfarë lloj errësire zhduk e largon secili vërset dhe sa i ëmbël është recitimi i mrekullisë së tij. Ti nuk do ta vlerësoje këtë lloj të mrekullisë midis llojeve të shumtë të tij.

Në qoftë se ti dëshiron të shikosh një nga shkallët më të larta të shpjegimit të mrekullueshëm të Kur'anit, vështro përmes teleskopit të këtij krahasimi, siç vijon:

Le të përfytyrojmë një pemë të çuditshme, të shtrirë gjërësisht, shumë të lartë dhe jashtë mase të shpërndarë e cila është fshehur nën një perde të së padukshmes dhe e fshehur në një nivel të fshehtësisë. Është e qartë se duhet të jetë një lidhje, një harmoni dhe një balancim midis pemës dhe të gjitha pjesëve të saj, si degët, frutat, gjethet dhe

[153] Kur'an, 17; 44

lulet, njëlloj si midis gjymtyrëve të njeriut. Secila nga pjesët e saja merr një formë dhe i jepet një trajtë në përputhje me natyrën e pemës. Kështu, në qoftë se dikush do të shfaqej e do të vizatonte një pikturë në maje të perdes duke u korresponduar anëtarëve të pemës e cila nuk është parë asnjëherë (dhe akoma nuk shikohet), pastaj vijëzon e kufizon çdo anëtar, dhe nga degët për tek frutat, dhe nga frutat për tek gjethet vizaton një formë në mënyrë të përpjesëtuar dhe mbush me vizatimet hapësirën midis burimit të saj dhe skajeve të fundit që janë në një distancë të pafundme nga njëra-tjetra duke treguar ekzaktësisht trajtën dhe formën e anëtarëve të saj, sigurisht nuk do të mbetet asnjë dyshim, se artisti e shikon pemën e fshehur me një sy që depërton e përfshin të padukshmen, dhe atëherë ai e pikturon atë.

Në të njëjtën mënyrë, njoftimet dalluese të Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm që lidhen me realitetin e qënieve të ndryshme të mundshme (domethënë, në lidhje me realitetin e pemës së krijimit e cila shtrihet nga fillimi i botës për tek limitet më të largëta të Ahiretit, përhapet nga toka për tek Froni Hyjnor dhe nga grimcat e vockëla për tek dielli) –ato shpjegime– e kanë ruajtur përpjesëtimin dhe përshtatshmërinë midis anëtarëve në një shkallë të tillë që i kanë dhënë çdo anëtari e çdo fruti një formë aq të përshtatshme, saqë për vizatimet e Kur'anit, të gjithë dijetarët e saktë kanë deklaruar nga përfundimi i verifikimeve dhe hetimeve të tyre duke thënë **Mashaall-llah**, *çfarë çudirash ka dashur Zoti*! **BarekAll-llah**, *sa të mëdha janë bekimet e Zotit*! Dhe kanë thënë: **"*Je vetëm ti që e zgjidh dhe e sqaron misterin e universit dhe që zbulon enigmën e krijimit, o Kur'an i gjithurtë!*"**

وَلِلَّهِ الْمَثَلُ الْأَعْلَىٰ

"...Dhe për All-llahun është krahasimi më i lartë ..."[154]

Dhe nuk ka ndonjë gabim në krahasim - le t'i paraqesim e përshkruajmë Emrat Hyjnorë, Atributet, aktet dhe veprat Hyjnore si *Pema e ndritshme e Tubasë*, sfera e madhështisë së të cilës shtrihet nga parapërjetësia për tek paspërjetësia dhe limitet e gjërësisë së të cilës përfshijnë e rrethojnë hapësirën e pafundme. Limitet e akteve të saj shtrihen nga,

[154] Kur'an, 16:66

يَحُولُ بَيْنَ الْمَرْءِ وَقَلْبِهِ ۞ فَالِقُ الْحَبِّ وَالنَّوَى

"...Dhe (All-llahu) ndërhyn ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij..."[155]*, "Vërtet që është All-llahu Ai i Cili bëri që të çahet dhe të rritet fara e grurit dhe e frutave.."*[156] deri tek

وَالسَّمَاوَاتُ مَطْوِيَّاتٌ بِيَمِينِهِ ۞ خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ

"Dhe qiejt të mbështjellë në Dorën e Tij të Djathtë"[157]*, "(Zoti) i Cili krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë..."*[158]

Kur'ani e ka përshkruar atë realitet të ndritshëm, të vërtetat e atyre Emrave dhe Atributeve, aktet e veprimet së bashku me të gjitha degët e tyre, sythat dhe frutat, në një mënyrë aq të harmonizuar, aq të përshtatshme për njëra-tjetrën, pa prishur njëra-tjetrën, pa dëmtuar shkallën e njëra-tjetrës apo largësinë mes njëra-tjetrës, saqë të gjithë ata që kanë depërtuar tek realiteti i gjërave dhe kanë penetruar tek të fshehtat e misteret, dhe të gjithë Evlijatë, të urtit, të pastërtit të cilët kanë udhëtuar në botën e dimensioneve të brendshme të gjërave kanë deklaruar, duke thënë me habi **Subhanall-llah** *Lavdi Zotit,* përpara atij shpjegimi dallues dhe e kanë konfirmuar atë duke thënë: ***"Sa e drejtë është kjo! Sa e përputhshme me realitetin, sa e bukur dhe sa e denjë!"***

Merr, për shembull, gjashtë shtyllat e besimit, që janë si një degë e vetme e atyre dy pemëve të fuqishme që shikojnë drejt të gjithë sferës së ekzistencave të ndryshme të mundshme dhe sferës së domosdoshmërisë: Kur'ani e vizaton atë me të gjitha degët dhe sythet e atyre shtyllave, deri tek frutat dhe lulet duke ruajtur harmoninë, përshtatshmërinë dhe përpjesëtimin ndërmjet tyre. I përshkruan ato në një mënyrë aq të balancuar dhe i ilustron ato në një mënyrë aq simetrike, saqë mendja njerëzore është e pafuqishme që ta kapë atë dhe mbetet e habitur tek bukuria e tij. Prova që bukuria e përshtatshmërisë, e lidhjes perfekte, e balancimit të plotë është ruajtur midis pesë shtyllave të Islamit që janë më të hollat e sythave të degëve të besimit;

[155] Kur'an, 8:24
[156] Kur'an, 6:95
[157] Kur'an, 39:67
[158] Kur'an, 7:54

madje ai ka ruajtur detajet më të holla, pikat më të vogëla të etikës, qëllimet më përfundimtare, urtësinë më të thellë dhe frutat më të vegjël, -prova e këtyre- është plotësimi i rregullit të sheriatit më të madh, Islami, i cili buron nga thëniet vendimtare, nga kuptimet, treguesit, dhe nga aluzionet e Kur'anit gjithëpërfshirës; ato formojnë një provë të pakundërshtueshme e vendimtare dhe dëshmitarë të drejtë që nuk mund të dyshohen. Kjo do të thotë se shpjegimet e Kur'anit nuk mund t'i atribuohen njohurisë së pjesshme të njeriut dhe sidomos dikujt që është analfabet. Por ato shpjegime mbështeten mbi një njohuri gjithëpërfshirëse dhe janë fjalët e Një të Vetmi i Cili është i aftë t'i shikojë të gjitha gjërat njëkohësisht, dhe i vëzhgon në një moment të gjitha të vërtetat ndërmjet parapërjetësisë dhe paspërjetësisë. *Në këtë ne besojmë*...

■ **Rrezja e dytë:** Filozofia njerëzore që u përpoq të sfidojë urtësinë e Kur'anit e ta kundërshtojë atë, ka rënë shumë poshtë para urtësisë së lartë të Kur'anit, siç është shpjeguar e ilustruar me krahasime në *Fjalën e Dymbëdhjetë* dhe siç është provuar edhe në *Fjalët e tjera.* Kështu ne ia referojmë lexuesit ato, dhe tani po japim një krahasim tjetër nga një këndvështrim tjetër, siç vijon:

Filozofia dhe shkenca njerëzore e shikojnë botën si të qëndrueshme e të vazhdueshme. Ato i diskutojnë natyrën e qënieve dhe veçoritë e tyre në detaje; mirëpo në qoftë se ato flasin për detyrat e tyre para Krijuesit të tyre, flasin për to shkurtazi. Mjaft thjesht, ato flasin vetëm për skalitjen dhe zbukurimin e shkronjave të librit të universit dhe nuk i japin rëndësi kuptimit të tij. Ndërsa Kur'ani e shikon botën si rrjedhëse, të përkohshme, mashtruese, udhëtuese, të paqëndrueshme dhe që pëson ndryshime. Ai flet shkurtazi për natyrën e qënieve dhe për veçoritë e tyre sipërfaqësore e materiale, por ai përmend në detaje detyrat e përndritura të adhurimit me të cilat ato janë ngarkuar nga Krijuesi. Ai tregon, si e në çfarë aspektesh i tregojnë krijesat Emrat e Tij dhe bindjen e tyre para urdhrit krijues Hyjnor. Kështu, ne do të shikojmë ndryshimet midis filozofisë njerëzore dhe urtësisë së Kur'anit në lidhje me këtë çështje të shikimit të gjërave në mënyrë të shkurtuar, ose në detaje dhe do të shikojmë se cila është e vërteta e pastër dhe realiteti.

Ashtu si ora e dorës në dorën tonë e cila duket si të ishte e qëndrueshme, por brendësia e saj është në ndryshim të përhershëm

përmes lëvizjes së funksioneve dhe tronditjes së vazhdueshme të rrotave të dhëmbëzuara dhe të veglave të holla... në të njëjtën mënyrë së bashku me stabilitetin e saj të dukshëm, kjo dynja e cila i ngjason një ore gjigante të Fuqisë Hyjnore është në rrotullim të përhershëm brenda lëvizjes, ndryshimit, përkohshmërisë dhe zhdukjes. Në të vërtetë, meqenëse "Koha" ka hyrë në dynja, nata e dita janë si akrep me dy koka që numëron sekondat e asaj ore gjigante; vitet janë si një akrep që numëron minutat e saj, ndërsa shekujt numërojnë orët e saj. Kështu, koha e hedh dynjanë në valët e zhdukjes dhe të tatëpjetës. Ajo ia dorëzon të gjithë të shkuarën e të ardhmen mosekzistencës dhe lë në ekzistencë vetëm kohën e tashme. Së bashku me këtë formë që koha i jep dynjasë, në lidhje me hapësirën ajo është gjithashtu si një orë e paqëndrueshme dhe që pëson ndryshim, sepse atmosfera –si hapësirë– është në ndryshim të shpejtë dhe kalon shpejt nga një gjendje për tek një tjetër, saqë ndonjëherë ndodh që në një ditë të vetme atmosfera mbushet e zbrazet me re. Atmosfera, me ndryshimet e saja të shpejta, jep një ndryshim si ai i akrepit që numëron sekondat.

Toka që është si një dysheme e shtëpisë së dynjasë, meqenëse me jetën e vdekjen dhe me kafshët e bimët, fytyra e saj ndryshon shumë shpejt si një akrep minutash, ajo tregon se ky aspekt i botës është gjithashtu kalimtar e i përkohshëm. Ashtu si toka që në lidhje me fytyrën e saj është në ndryshim të përhershëm, po ashtu brendësia e saj është në ndryshim e lëkundje që përfundojnë me shfaqjen dhe zhdukjen e maleve; ky aspekt i botës gjithashtu po kalon avash drejt zhdukjes, ashtu si një akrep që numëron orët. Sa për qiellin i cili është si një tavan i shtëpisë së botës, ndryshimet që ndodhin në të –si hapësirë– qoftë përmes lëvizjes së trupave qiellorë, shfaqjes së kometave, ndodhjes së eklipseve të diellit e të hënës, apo rënies së yjeve, e të tjera, tregojnë se qiejt gjithashtu nuk janë të qëndrueshëm e të përhershëm, por ato po shkojnë drejt plakjes dhe shkatërrimit. Ndryshimi i tij është i avashtë e i ngadalshëm si akrepi që numëron ditët e një jave, por në çdo aspekt ai demonstron se është kalimtar, i përkohshëm dhe i orientuar drejt shkatërrimit.

Kështu, dynjaja në lidhje me veten është ngritur mbi këto shtatë shtylla. Këto shtatë shtylla e trondisin vazhdimisht atë. Por kur dynjaja, e cila është në lëvizje e duke u tronditur, shikon tek Krijuesi i saj, lëvizja e ndryshimi është veprimi dhe funksioni i Penës së Fuqisë me

qëllim që të shkruajë mesazhet e të Përjetshmit të Vetëm. Dhe ato gjendje të ndryshueshme janë pasqyrat e Emrave Hyjnorë që duke u ripërtërirë e rifreskuar vazhdimisht, shfaqin me piktura e vizatime gjithnjë të ndryshme treguesin e cilësive të Emrave. Dhe gjithashtu, në lidhje me veten, dynjaja është edhe brenda lëkundjeve, shpejton drejt vdekjes dhe shkon drejt shkatërrimit. Megjithëse në realitet ajo është duke u larguar si uji që rrjedh, por për shikimin e pavëmendshëm ajo shfaqet të jetë e ngrirë. Nëpërmjet konceptit të "natyrës", ajo është bërë e dendur dhe e turbullt, si dhe është bërë një perde duke fshehur Ahiretin, botën tjetër. Kështu, përmes shqyrtimit dhe hetimit filozofik, shkencës natyrore, argëtimeve eksituese të qytetërimit të shthurur dhe pasioneve të tij dehëse, filozofia e sëmurë e ka shtuar gjendjen e ngrirë të botës dhe plogështinë, si dhe ka bërë një pakujdesi më të dendur, ka shtuar patejdukshmërinë dhe turbullirën. Kjo ka shkaktuar që Krijuesi dhe bota tjetër të harrohen.

Ndërsa Kur'ani i gjithurtë me vërsetet e tij,

اَلْقَارِعَةُ مَا الْقَارِعَةُ ۞ اِذَا وَقَعَتِ الْوَاقِعَةُ ۞ وَالطُّورِ وَكِتَابٍ مَسْطُورٍ

"E ç'është (Dita) e zhurmës dhe e klithmës"?[159]*; "Kur të bjerë ndodhia e madhe (Dita e Kijametit)"*[160]*; "Betohem për Turin (malin Sinai)"!; "Për librin e skalitur (libri i All-llahut ku Ai ka shkruar gjithçka)"*[161] e shprish dhe e gërhanon këtë botë si pambuk në lidhje me qënien e saj dynja, dhe e flak atë tutje. Dhe përmes shpjegimeve të tij si,

اَوَلَمْ يَنْظُرُوا فِي مَلَكُوتِ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ ۞ اَفَلَمْ يَنْظُرُوا اِلَى السَّمَآءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنٰهَا ۞ اَوَلَمْ يَرَ الَّذِينَ كَفَرُوا اَنَّ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضَ كَانَتَا رَتْقًا

"A nuk shohin në sundimin e qiejve e të tokës"?[162]*; "A nuk e kanë parë qiellin mbi ta, si Ne e kemi ndërtuar atë..."*[163]*; "A nuk e kanë ditur ata që mohojnë se qiejt dhe toka ishin të bashkuar së bashku si*

[159] Kur'an, 101:1-2
[160] Kur'an, 56:1
[161] Kur'an, 52:1-2
[162] Kur'an, 7:185
[163] Kur'an, 50: 6

një njësi e vetme krijimi, para se Ne i ndamë?"[164] ai i jep botës tejdukshmëri dhe heq e zhduk turbullirën e saj.

Dhe përmes shprehjeve të tij ndriçuese si,

اَللّٰهُ نُوْرُ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ ۞ وَمَا الْحَيٰوةُ الدُّنْيَآ اِلَّا لَعِبٌ وَلَهْوٌ

"All-llahu është Drita e qiejve dhe e tokës",[165] *"Dhe jeta e kësaj bote nuk është asgjë tjetër veçse lojë dhe zbavitje"*[166], ai e shkrin atë dynja të ngrirë e të plogët.

Me shprehjet e ashpra të tij për vdekjen si,

اِذَا السَّمَآءُ انْفَطَرَتْ

"Kur qielli të çahet"[167],

اِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ

"Kur dielli të mbështillet e të humbë dritën dhe të përmbyset",[168]

اِذَا السَّمَآءُ انْشَقَّتْ ۞ وَنُفِخَ فِي الصُّوْرِ فَصَعِقَ مَنْ فِي السَّمٰوٰتِ وَمَنْ فِي الْاَرْضِ اِلَّا مَنْ شَآءَ اللّٰهُ

"Kur qielli të plasë"[169]*; "Dhe do t'i fryhet Surit (borisë) dhe gjithkush që është në qiej e gjithkush që është në tokë do të shuhen, përveç atij që do All-llahu (ta përjashtojë)"*[170],

ai copëton mashtrimin dhe iluzionin se dynjaja është e përhershme.

Përmes goditjeve gjëmimtare si rrufeja të tilla si,

---

[164] Kur'an, 21:30
[165] Kur'an, 24:35
[166] Kur'an, 6:32
[167] Kur'an, 82:1
[168] Kur'an, 81:1
[169] Kur'an, 84:1
[170] Kur'an, 39: 68

يَعْلَمُ مَا يَلِجُ فِي الْأَرْضِ وَمَا يَخْرُجُ مِنْهَا وَمَا يَنْزِلُ مِنَ السَّمَاءِ وَمَا يَعْرُجُ فِيهَا وَهُوَ مَعَكُمْ
أَيْنَ مَا كُنْتُمْ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ۞ وَقُلِ الْحَمْدُ لِلَّهِ سَيُرِيكُمْ آيَاتِهِ فَتَعْرِفُونَهَا
وَمَا رَبُّكَ بِغَافِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ ۞

"Ai di çfarë hyn në tokë, dhe çfarë del prej saj dhe çfarë zbret nga qielli, edhe çfarë ngjitet në të. Dhe Ai është me ju kudo që të jeni. Dhe All-llahu është Gjithëvëzhgues për gjithçka që ju punoni"[171]*; "Dhe thuaju: Gjithë lavdërimet dhe falënderimet i takojnë All-llahut! Ai do t'ju tregojë juve shenjat e Tij dhe ju do t'i dalloni ato. Dhe Zoti yt nuk është i pavetëdijshëm për çfarë ju veproni."*[172] ai shpërndan e zhduk pakujdesinë e lindur nga koncepti i "natyrës."

Kështu, nga fillimi gjer në fund, vërsetet e Kur'anit të cilët kthehen në drejtim të universit veprojnë sipas këtij parimi. Ato zbulojnë dhe e tregojnë realitetin e dynjasë ashtu siç është. Duke treguar se sa e shëmtuar është dynjaja e shëmtuar ai e largon fytyrën e njeriut prej saj dhe nxjerr në pah fytyrën e bukur të botës së bukur, e cila shikon tek Krijuesi. Ai e lidh syrin e njeriut me të. Ai udhëzon për tek urtësia e vërtetë dhe për tek njohuria duke dhënë mësim kuptimet e librit të universit, dhe duke shikuar pak tek shkronjat dhe skalitjet. Ai nuk lejon që të harrohet kuptimi, ashtu siç bën filozofia e dehur, as nuk e bën njeriun të dashurohet pas të shëmtuarës, e të harxhojë kohën e tij në gjëra të pakuptimta për shkak të zbukurimit të shkronjave.

■ **Rrezja e tretë:** Në rrezen e dytë ne treguam rënien e filozofisë njerëzore para urtësisë së Kur'anit dhe mrekullinë e urtësisë së tij. Tani në këtë rreze, ne do të tregojmë shkallën e urtësisë dhe të shkencës para urtësisë Kur'anore të dijetarëve të pastër, evlijave –shenjtorëve- dhe të ndriçuarve midis filozofëve dhe *Ishrakijunëve* të cilët që të gjithë janë studentët e Kur'anit, dhe do të japim tregues të shkurtër për mrekullinë në këtë aspekt. Treguesi më i vërtetë për lartësinë e Kur'anit të gjithurtë dhe prova më e qartë e së vërtetës së tij dhe e drejtësisë, dhe shenja më e fuqishme e mrekullisë së tij është kjo: Duke ruajtur të gjitha shkallët e të gjitha hapësirave të Njësisë Hyjnore së

[171] Kur'an, 57:4
[172] Kur'an, 27: 93

bashku me domosdoshmëritë e tyre e duke i shpjeguar ato, Kur'ani ka ruajtur dhe nuk e ka prishur balancën e tyre; ka ruajtur balancën e të gjitha të vërtetave të larta Hyjnore, ka grumbulluar të gjitha dekretet e diktuara e të kërkuara nga Emrat e Bukur Hyjnorë dhe ka ruajtur përshtatshmërinë dhe përpjesëtimin e ndërsjellë midis atyre dekreteve. Ai ka sjellë së bashku me një balancim perfekt Aktet Hyjnore. Kështu, kjo ruajtje, ky balancim dhe grumbullim është një veçori e cila sigurisht nuk është e pranishme në veprat e njeriut, as në rezultatet e mendimit të mendimtarëve më të mëdhenj të njerëzimit. Kjo nuk gjendet askund në veprat e Evlijave të cilët kanë depërtuar tek fytyra e qënieve që shikojnë Krijuesin e tyre, as në librat e *Ishrakijjunëve* të cilët kanë kaluar në kuptimin e brendshëm e të fshehur të gjërave, as në njohurinë e shpirtërorëve të cilët kanë penetruar në botën e së padukshmes. Por ata sikur kanë praktikuar një ndarje të punës dhe është sikur çdo grup të aderonte e të përkrahte vetëm një ose dy degë të Pemës së madhe të realitetit; secili e preokupon vetveten vetëm me frutat e saj ose me gjethet e saj. Ata ose nuk dinë asgjë për degët e tjera, ose ndryshe nuk shqetësohen e nuk tregojnë interes për to. Në të vërtetë, realiteti absolut nuk mund të kapet nga shikime e pikëpamje të kufizuara e të ngushta. Një shikim universal si Kur'ani është i domosdoshëm me qëllim që ta kapë atë. Sigurisht ata instruktohen nga Kur'ani, por me një mendje të pjesshme e të kufizuar ata nuk mund të shohin plotësisht veçse një ose dy anë të realitetit të përgjithshëm, dhe merren me ato anë dhe kufizohen me to. Ata prishin balancën e realitetit ose përmes teprisë dhe ekstremit, ose përmes neglizhencës dhe si rrjedhojë, prishin raportin dhe harmoninë e tij. Kjo e vërtetë u shpjegua me një krahasim të çuditshëm në Degën e Dytë të Fjalës së Njëzet e Katër, dhe tani ne do ta tregojmë çështjen me një krahasim tjetër:

Për shembull, le të supozojmë se një thesar i madh, plot me xhevahire të ndryshëm është në fund të detit. Palombarët u zhytën në thellësitë për të kërkuar xhevahiret e thesarit. Meqenëse sytë e tyre janë të mbyllur, ata nuk kuptojnë çfarë ndodhet atje veçse përmes përdorimit të shkathët të duarve të tyre. Një diamant relativisht i gjatë vjen në dorën e njërit prej tyre. Palombari kujton se i gjithë thesari përbëhet nga diamantë të gjatë si shtylla. Kur ai dëgjon për xhevahire të tjerë nga shokët e tij, ai imagjinon se ato janë plotësues e dytësorë për diamantët që ai gjeti dhe janë faqet e gurëve të çmuar dhe

zbukurimet e tij. Në dorën e një tjetri kalon një rubin sferik, ndërsa një tjetër gjen një copë katrore prej qelibari, e kështu me radhë. Secili nga ata beson se xhevahiri që ai shikon me dorën e tij –jo me sy– është origjinal dhe esencial në atë thesar si dhe pjesa më e madhe e tij. Dhe supozon se gjërat për të cilat ai dëgjon janë pjesë shtesë e detaje të tij. Kështu, balanca e të vërtetave prishet dhe raporti i ndërsjellë dhe harmonia gjithashtu prishen. Ngjyra e shumë të vërtetave ndryshon dhe, me qëllim që të shikojnë ngjyrën e vërtetë të realitetit, ata detyrohen të përdorin interpretime të detyrueshme dhe shpjegime të ndërlikuara. Disa herë ata shkojnë aq larg deri në mohim e mospranim. Kushdo që lexon librat e filozofisë *Ishrakijjune* dhe veprat e sufive të cilat mbështeten në ndriçimet dhe vizionet pa i peshuar ato me peshat e Sunnetit të pastër, padyshim do ta konfirmojë këtë pohimin tonë. Me fjalë të tjera, megjithëse veprat e tyre u përkasin të vërtetave të ngjashme me ato të Kur'anit dhe merren nga mësimet e Kur'anit, mirëpo për shkak se nuk janë Kur'an, ato janë kështu difektoze e të mangëta.

Kur'ani Gjithurtësi i cili është deti i të vërtetave, vërsetet e tij gjithashtu janë palombarë për të zbuluar atë thesar nën det, mirëpo sytë e tyre janë të hapur dhe rrethojnë e përfshijnë të gjithë thesarin. Ato shikojnë çfarë ndodhet në thesar dhe çfarë nuk ndodhet.

Ato përshkruajnë dhe e shpjegojnë atë me një harmoni të tillë, me një rregull dhe me një përshtatshmëri e përpjesëtim, saqë ato tregojnë bukurinë e vërtetë dhe përkryerjen. Për shembull, Kur'ani ashtu siç sheh madhështinë e Hyjnisë e shprehur nga këto vërsete,

وَالْأَرْضُ جَمِيعًا قَبْضَتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَالسَّمَاوَاتُ مَطْوِيَّاتٌ بِيَمِينِهِ ۚ
يَوْمَ نَطْوِي السَّمَاءَ كَطَيِّ السِّجِلِّ لِلْكُتُبِ

"...Dhe e gjithë toka do të jetë e mbërthyer nga Dora e Tij dhe qiejt të mbështjellë në Dorën e Tij të Djathtë."[173] *"Edhe Ditën kur Ne do t'i mbështjellim qiejt si letër e shkruar (e mbështjellë tub për shkrime)."*[174]

[173] Kur'an, 39:67
[174] Kur'an, 21:104

gjithashtu, ato e shikojnë Mëshirën Gjithëpërfshirëse të shprehur nga këto vërsete:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَخْفَىٰ عَلَيْهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ ۝ هُوَ الَّذِي يُصَوِّرُكُمْ فِي الْأَرْحَامِ كَيْفَ يَشَاءُ ۝ مَا مِن دَابَّةٍ إِلَّا هُوَ آخِذٌ بِنَاصِيَتِهَا ۝ وَكَأَيِّن مِّن دَابَّةٍ لَّا تَحْمِلُ رِزْقَهَا اللَّهُ يَرْزُقُهَا وَإِيَّاكُمْ ۝

"Vërtet, asgjë nuk i fshihet All-llahut, as në tokë dhe as në qiej[175]*"; "Ai është i Cili ju formëson në mitra ashtu siç Ai dëshiron"*[176]*; "Nuk ka asnjë krijesë të gjallë që Ai të mos e ketë mbërthyer pas balukeve të ballit (ta ketë nën sundimin e Tij të plotë)"*[177]*; "Dhe sa shumë krijesa të gjalla nuk mbartin dot ushqimin e tyre! All-llahu është i Cili i ushqen ata dhe ju"*[178]*;*

dhe ashtu siç shikojnë ato dhe tregojnë shtrirjen e gjërë të krijueshmërisë së shpehur nga,

خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَجَعَلَ الظُّلُمَاتِ وَالنُّورَ

"I Cili krijoi qiejt dhe tokën, solli errësirën dhe dritën..."[179]*,*

po ashtu ato shikojnë dhe tregojnë mendimet gjithëpërfshirëse Hyjnore të shprehura nga,

خَلَقَكُمْ وَمَا تَعْمَلُونَ

"Ndërsa All-llahu ju ka krijuar ju dhe çfarë ju bëni e veproni (veprat tuaja)"![180]

Pastaj ashtu siç ato shikojnë të vërtetën e madhe të shprehur nga,

يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا

[175] Kur'an, 3:5
[176] Kur'an, 3:6
[177] Kur'an, 11:56
[178] Kur'an, 29:60
[179] Kur'an, 6:1
[180] Kur'an, 37:96

"...Si Ai e ringjall tokën pas vdekjes së saj"[181], shikojnë të vërtetën madhështore të shprehur nga,

وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ

"Dhe Zoti yt frymëzoi edhe bletën"[182]

në të njëjtën kohë, tregon të vërtetën e gjërë të mbretërimit e të komandimit nga,

وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ وَالنُّجُومَ مُسَخَّرَاتٍ بِأَمْرِهِ

"Dielli, hëna dhe yjet i janë nënshtruar urdhrit të Tij."[183]

Ato shikojnë e tregojnë mëshirën, të vërtetën rregulluese, të shprehur nga,

أَوَلَمْ يَرَوْا إِلَى الطَّيْرِ فَوْقَهُمْ صَافَّاتٍ وَيَقْبِضْنَ مَا يُمْسِكُهُنَّ إِلَّا الرَّحْمَٰنُ
إِنَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ بَصِيرٌ

"A nuk i shohin ata zogjtë sipër tyre duke hapur krahët e tyre e duke i palosur ato? Askush nuk i mban ato përveç të Gjithëmëshirshmit (All-llah). Vërtet që Ai është Gjithëshikues i çdo gjëje."[184]

dhe të vërtetën e gjërë të shprehur nga,

وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا

"Froni i Tij shtrihet mbi qiej dhe tokë dhe Ai nuk ndjen aspak lodhje në ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre."[185]

dhe të vërtetën ruajtëse të shprehur nga,

وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ

[181] Kur'an, 30: 19
[182] Kur'an, 16:68
[183] Kur'an, 7:54
[184] Kur'an, 67:19
[185] Kur'an, 2:255

"Dhe Ai është me ju kudo që të jeni"[186],

dhe të vërtetën gjithëpërfshirëse të shprehur nga,

هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

"Ai është i Pari dhe i Fundit i Jashtmi dhe i Brendshmi dhe Ai është i Gjithëditur për çdo gjë"[187] , dhe afërsia e shprehur nga,

وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنسَانَ وَنَعْلَمُ مَا تُوَسْوِسُ بِهِ نَفْسُهُ وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ

"Dhe sigurisht që Ne e kemi krijuar njeriun dhe Ne e dimë se çfarë i pëshpërit atij vetvetja (epshi i vet). Dhe Ne jemi më afër tij se sa vena e qafës së tij"[188]

dhe e vërteta e lartë e treguar nga,

تَعْرُجُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ إِلَيْهِ فِي يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُ خَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ

"Melekët dhe Ruhu (meleku Xhebrail) ngjiten tek Ai në një ditë, përmasat e së cilës janë pesëdhjetëmijë vjet."[189],

dhe e vërteta gjithëpërfshirëse e shprehur nga,

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنكَرِ وَالْبَغْيِ

"Vërtet që All-llahu urdhëron drejtësi, të bërit mirë, zemërgjërësi e bujari ndaj gjakut e farefisit dhe Ai ndalon të gjitha veprat e turpshme, padrejtësinë e mosbindjen."[190]

Vërsetet e Kur'anit shikojnë e tregojnë në detaje secilën nga gjashtë shtyllat e besimit në lidhje me këtë botë dhe botën tjetër, me veprimin dhe njohjen. Ato shikojnë e tregojnë qëllimisht e seriozisht secilën nga pesë shtyllat e Islamit dhe të gjitha parimet të cilat

[186] Kur'an, 57:4
[187] Kur'an, 57:3
[188] Kur'an, 50:16
[189] Kur'an, 70: 4
[190]

sigurojnë lumturi në këtë botë dhe në tjetrën. Ato ruajnë balancën e tyre, përjetësojnë përshtatshmërinë e tyre, dhe një formë e mrekullisë së Kur'anit vjen në ekzistencë nga burimi i bukurisë dhe i hijeshisë e cila vjen nga përshtatshmëria dhe përpjesëtimi i ndërsjellë i tërësisë së atyre të vërtetave.

Për shkak të këtij misteri të madh, megjithëse studiuesit e teologjisë janë studentët e Kur'anit, dhe një pjesë nga ata kanë shkruar me mijëra vepra –disa prej tyre me dhjetë vëllime– secili mbi shtyllat e besimit, mirëpo për shkak se, si *Muë'tezilitet,* ata preferuan arsyen mbi njohurinë e transmetuar e të përcjellur, ata nuk kanë qenë të mundur të shprehin me qartësi atë çfarë tregojnë dhjetë vërsete Kur'anore, t'i provojnë ato në mënyrë vendimtare, apo të binden seriozisht në lidhje me to. Është tamam sikur ato kanë hapur një tunel nën male shumë të largëta që prej tyre të sjellin ujë për te skajet më të largëta të botës nëpërmjet tubave, domethënë nëpërmjet zinxhirit të shkaqeve, pastaj e këpusim zinxhirin atje, dhe atëherë vërtetuan njohjen e Zotit dhe ekzistencën e Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, që janë të domosdoshme si uji i jetës! Ndërsa vërsetet e Kur'anit, secili mund të nxjerrë ujë nga çdo vend ashtu si Shkopi i Musait a.s. dhe hapin një dritare nga çdo gjë dhe bëjnë të njohur Krijuesin e Gjithëlavdishëm. Ne tashmë e kemi provuar këtë realitet në trajtesën arabisht **"Katreh"** dhe në Fjalët e tjera të cilat rrjedhin nga oqeani i Kur'anit. Gjithashtu, për shkak të këtij misteri se meqenëse të gjithë udhëheqësit e grupeve heretike e të humbura të cilët kanë kaluar tek natyra e brendshme e gjërave (batin) pa ndjekur Sunnetin e profetit Muhammed a.s.m. dhe duke u mbështetur në vizionet e tyre, janë kthyer duke pas bërë gjysmën e rrugës dhe, duke u bërë udhëheqës të komunitetit kanë formuar sekte, dhe kanë qenë të pamundur të ruajnë harmoninë dhe balancën e të vërtetave Kur'anore, kanë rënë në risi (bidat) e çudhëzim dhe kanë shtyrë një komunitet njerëzish në këto rrugë të gabuara. Kështu, pafuqia e plotë e të gjithë këtyre demonstron mrekullinë e vërseteve të Kur'anit.

* * *

PËRFUNDIM

Dy shkreptima nga mrekullitë e Kur'anit të përmendura në piklën e katërmbëdhjetë të *"Fjalës së nëntëmbëdhjetë"* janë urtësia e përsëritjes në Kur'an, të cilat imagjinohen prej disave si gabim, si dhe urtësia e përmbledhjes së tij në lidhje me shkencat fizike, dhe atje u shpjegua se të dyja ishin burime për shkreptimat e mrekullisë. Gjithashtu, një shkreptimë nga mrekullia e Kur'anit, e cila shndrit mbi mrekullitë e profetëve në Kur'an, është demonstruar qartë në Stacionin e Dytë të Fjalës së Njëzet. Dhe si në këto, shumë shkreptima të mrekullisë janë përmendur në Fjalët e tjera dhe në trajtesat e mia arabisht.

Dhe kështu, duke i vlerësuar ato si të mjaftueshme, këtu ne do të themi vetëm këtë, që një mrekulli tjetër e Kur'anit është se, ashtu si të gjitha mrekullitë e profetëve që demonstrojnë një shenjë të mrekullisë së Kur'anit, gjithashtu në të gjitha mrekullitë e tij, Kur'ani është një mrekulli e Profetit Muhammed a.s.m., dhe të gjitha mrekullitë e profetit Muhammed a.s.m. janë një mrekulli e Kur'anit, të cilat demonstrojnë lidhjen e Kur'anit me All-llahun e Gjithëfuqishëm. Dhe me shfaqjen e asaj lidhje, secila nga fjalët e tij bëhet një mrekulli, sepse, atëherë, një fjalë nga fjalët e tij mund të përmbajë kuptimin e Pemës së të vërtetave, si një farë; dhe mund të lidhet me të gjithë anëtarët e një të vërtete të madhe, si qendra e zemrës; dhe meqenëse ajo mbështetet në njohurinë gjithëpërfshirëse dhe në dëshirën e pafund, ajo mund të shikojë gjëra të panumërta së bashku me shkronjat e tyre, tërësitë, situatat dhe pozitat. Kështu, për shkak të këtij misteri, studiuesit e shkencës së shkronjave pretendojnë se kanë nxjerrë plot një faqe me sekrete vetëm nga një shkronjë e vetme e Kur'anit, dhe e provojnë çfarë ata pretendojnë për ekspertët e asaj shkence.

Tani, kujtoji të gjitha dritat, rrezet, shkreptimat, rrezatimet e flakërimat nga fillimi i kësaj trajtese gjer këtu dhe konsideroji ato së bashku! Si një përfundim vendimtar, ato recitojnë e shpallin me një zë të lartë pretendimin e bërë tek fillimi, i cili është:

قُلْ لَئِنِ اجْتَمَعَتِ الْاِنْسُ وَالْجِنُّ عَلٰٓى اَنْ يَّاْتُوْا بِمِثْلِ هٰذَا الْقُرْاٰنِ لَا يَاْتُوْنَ بِمِثْلِهٖ
وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيْرًا
سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَآ اِلَّا مَا عَلَّمْتَنَآ اِنَّكَ اَنْتَ الْعَلِيْمُ الْحَكِيْمُ
رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَآ اِنْ نَّسِيْنَآ اَوْ اَخْطَاْنَا ۞ رَبِّ اشْرَحْ لِيْ صَدْرِيْ ۞
وَيَسِّرْ لِيْٓ اَمْرِيْ ۞ وَاحْلُلْ عُقْدَةً مِّنْ لِّسَانِيْ ۞ يَفْقَهُوْا قَوْلِيْ
اَللّٰهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ اَفْضَلَ وَاَجْمَلَ وَاَنْبَلَ وَاَظْهَرَ وَاَطْهَرَ وَاَحْسَنَ وَاَبَرَّ
وَاَكْرَمَ وَاَعَزَّ وَاَعْظَمَ وَاَشْرَفَ وَاَعْلٰى وَاَزْكٰى وَاَبْرَكَ وَاَلْطَفَ
صَلَوَاتِكَ وَاَوْفٰى وَاَكْثَرَ وَاَزْيَدَ وَاَرْقٰى وَاَرْفَعَ وَاَدْوَمَ سَلَامِكَ صَلَاةً
وَسَلَامًا وَرَحْمَةً وَرِضْوَانًا وَعَفْوًا وَغُفْرَانًا تَمْتَدُّ وَتَزِيْدُ بِوَابِلِ
سَحَآئِبِ مَوَاهِبِ جُوْدِكَ وَكَرَمِكَ وَتَنْمُوْا وَتَزْكُوْا بِنَفَآئِسِ شَرَآئِفِ لَطَآئِفِ
جُوْدِكَ وَمِنَنِكَ اَزَلِيَّةً بِاَزَلِيَّتِكَ لَا تَزُوْلُ اَبَدِيَّةً بِاَبَدِيَّتِكَ لَا تَحُوْلُ عَلٰى
عَبْدِكَ وَحَبِيْبِكَ وَرَسُوْلِكَ مُحَمَّدٍ خَيْرِ خَلْقِكَ النُّوْرِ الْبَاهِرِ اللَّامِعِ وَ
الْبُرْهَانِ الظَّاهِرِ الْقَاطِعِ وَالْبَحْرِ الذَّاخِرِ وَالنُّوْرِ الْغَامِرِ وَالْجَمَالِ الزَّاهِرِ وَ
الْجَلَالِ الْقَاهِرِ وَالْكَمَالِ الْفَاخِرِ صَلَاتَكَ الَّتِيْ صَلَّيْتَ بِعَظَمَةِ ذَاتِكَ عَلَيْهِ وَعَلٰٓى
اٰلِهٖ وَصَحْبِهٖ كَذٰلِكَ صَلَاةً تَغْفِرُ بِهَا ذُنُوْبَنَا وَتَشْرَحُ بِهَا صُدُوْرَنَا وَتُطَهِّرُ بِهَا
قُلُوْبَنَا وَتُرَوِّحُ بِهَآ اَرْوَاحَنَا وَتُقَدِّسُ بِهَآ اَسْرَارَنَا وَتُنَزِّهُ بِهَا خَوَاطِرَنَا
وَاَفْكَارَنَا وَتُصَفِّيْ بِهَا كُدُوْرَاتِ مَا فِيْ اَسْرَارِنَا وَتَشْفِيْ بِهَآ
اَمْرَاضَنَا وَتَفْتَحُ بِهَآ اَقْفَالَ قُلُوْبِنَا

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ
وَآخِرُ دَعْوَاهُمْ أَنِ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ۞ آمِينَ آمِينَ آمِينَ

"Thuaj: Nëse njerëzimi dhe xhindet do të mblidheshin të gjithë bashkë që të nxirrnin ngjasimin e këtij Kur'ani, ata nuk do ta bënin dot përngjasimin e tij edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin."[191] *"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."*[192] *"Zoti ynë! Mos na ndëshko në qoftë se harrojmë, apo biem në gabime."*[193] *"O Zoti im! Ma hap mua gjoksin tim! Dhe lehtësoma detyrën time; dhe zgjidhma nyjen nga gjuha, që ata të kuptojnë fjalën time."* [194] *O Zot! Jepi bekime shkëlqesisë sonë Muhammedit a.s.m., si dhe familjes së tij, shokëve të tij dhe vëllezërve të tij. Dhe jepu atyre paqe."Zoti ynë mos na i lër zemrat tona të shmangen nga e vërteta pasi Ti na ke udhëzuar dhe na dhuro mëshirë nga Mëshira Jote. Vërtet Ti je Dhuruesi më i Madh."*[195] *"Dhe duaja e fundit e tyre do të jetë: e Gjithë lavdia i takon Zotit të të gjitha botëve."Amin, Amin, Amin.*[196]

* * *

[191] Kur'an, 17:88
[192] Kur'an, 2:32
[193] Kur'an, 2:286
[194] Kur'an, 20:25-28
[195] Kur'an, 3:8
[196] Kur'an, 10:10

SHTOJCA E PARË

[Kjo shtojcë është përfshirë në Fjalën e Njëzet e pestë për shkak të pozitës, ajo është shkalla e Shtatëmbëdhjetë e vendqëndrimit të Parë të Rrezes së Shtatë]

Udhëtari i palodhshëm e i pangopur, i cili mësoi qëllimin e jetës në këtë dynja dhe esencën e jetës që është imani dhe kërkon të gjejë Krijuesin nëpërmjet universit, tani i drejtohet zemrës së tij dhe i thotë: le të shqyrtojmë librin e njohur, Kur'anin e shpjegimit të mrekullueshëm, i cili është fjala e Atij që ne po kërkojmë, është fjala më e vyer, më e ndritshme dhe është libri më i vërtetë e Sundues në ekzistencë, e që ka sfiduar në çdo shekull këdo që nuk ka pranuar t'i nënshtrohet. Le të shikojmë çfarë thotë ai, por së pari ai filloi të hulumtojë duke thënë se na duhet të vërtetojmë se ky libër është nga Krijuesi ynë.

Meqenëse ky udhëtar jeton në periudhën aktuale, ai së pari shikon **Risale-i Nurin**, Shkreptimat shpirtërore të mrekullisë së Kur'anit. Ai pa se njëqind e tridhjetë pjesët e **Risale-i Nurit** janë në vetvete drita dhe komentimi bazë i çmuar i vërseteve Kur'anore pasi ato zbulojnë pikat e tyre të holla dhe dritat e tyre ndriçuese, ose japin shpjegime të thella të përmbajtjes së atij libri. **Risale-i Nuri** lufton trimërisht për të shpërndarë të vërtetat e Kur'anit në të gjitha drejtimet. Në këtë shekull ateist e kryeneç askush nuk mund ta godasë atë ç'ka vërteton se Kur'ani është udhërrëfyes i **Risale-i Nurit**, burimi i tij, autoriteti dhe dielli i tij. **Risale-i Nuri** vërteton se Kur'ani është Fjala qiellore nga Zoti i Madhëruar dhe jo fjalë njeriu. Midis qindra provash në pjesët e ndryshme të **Risale-i Nurit**, prova e vetme e përfshirë në Fjalën e Njëzet e Pestë dhe tek fundi i *Letrës së Nëntëmbëdhjetë*, vërteton dyzet aspekte të mrekullisë së Kur'anit në një mënyrë të tillë që kushdo që e sheh atë, duke mos shfaqur aspak kritikë e kundërshtim, admiron argumentet e tij dhe shpreh habi e lëvdata vlerësuese. Udhëtari e la këtë aspekt për **Risale-i Nurin** ta provojë se Kur'ani është i mrekullueshëm, pra është Fjala e vërtetë e All-llahut, duke u kthyer vetëm te një tregues i shkurtër i përbërë nga pak pika, të cilat tregojnë madhështinë e Kur'anit.

● **Pika e parë:** Kur'ani, siç dihet, është mrekullia e pejgamberit tonë Muhammedit *a.s.m.* me të gjitha mrekullitë dhe të vërtetat treguese të vërtetësisë së tij, po ashtu edhe Muhammedi *a.s.m.* është mrekullia e Kur'anit me të gjitha mrekullitë e tij, me provat e profetësisë, me plotësimin e njohurive të tij dhe është provë vendimtare për qënien e Kur'anit si fjalë e Zotit të Lartësuar.

● **Pika e dytë:** Kur'ani e transformoi krejtësisht jetën shoqërore, ndriçoi horizontet dhe i mbushi ato me lumturi e vërtetësi; ai shkaktoi një revolucion të madh në nefset, në zemrat e njerëzve, në shpirtërat, në mendjet, në individët, në jetën sociale e politike dhe bëri që këtë revolucion ta përjetësonte në një mënyrë të tillë saqë për katërmbëdhjetë shekuj, në çdo minut, gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë vërsetet e tij të lexohen me ndjenjën e respektit më të thellë, nga gjuhët e më shumë se njëqind milionë njerëzve, duke i edukuar ata dhe duke ua pastruar shpirtërat dhe zemrat. Për shpirtërat, ai ka qenë mjeti i zhvillimit dhe i përparimit; për mendjet ka qenë një orientim e dritë; për jetën vetë jeta dhe lumturia. Sigurisht një libër i tillë është i pakrahasueshëm e i pashoq, është një çudi, një mahnitje e një mrekulli.

● **Pika e tretë:** Kur'ani që nga ajo kohë e deri në ditët tona, ka treguar një elokuencë të tillë saqë shkaktoi zhvlerësimin dhe rënien poshtë të poemave të njohura si *"**Shtatë poemat e varura**",* të cilat ishin poemat e poetëve më elokuentë. Ato qenë shkruar me ar dhe u varën në muret e Qabes. Por, zhvlerësimi i tyre arriti deri në atë pikë saqë e bija e Lebidit, kur po zbriste poemën e babait të saj nga muri i Qabes, tha: ***"E krahasuar me vërsetet e Kur'anit, kjo nuk ka më vlerë!"***

Një poet nomad kur dëgjoi vërsetin Kur'anor:

فَاصْدَعْ بِمَا تُؤْمَرُ

"Atëherë shpalle hapur atë që je urdhëruar."[197]

menjëherë ra në sexhde. Njerëzit e pyetën: "A u bëre Musliman?" Ai tha: "Jo, Unë u përkula në sexhde përpara elokuencës së këtij vërseti."

[197] Kur'an, 15: 94

Me mijëra studiues e letrarë të tillë, gjenitë e shkencës së retorikës, si Abdulkahir Xhurxhani, Sekkaki dhe Zemahsheriu, kanë konstatuar me unanimitet se ***"Elokuenca e Kur'anit është përtej kapacitetit njerëzor dhe është e paarritshme."***

Kur'ani, gjithashtu qysh nga koha që zbriti vazhdon të sfidojë duke i ftuar në fushë të betejës të gjithë letrarët egoistë dhe oratorët arrogantë. Ai u tha atyre në një mënyrë të llogaritur për të thyer arrogancën e tyre. "*Ejani, prodhoni një sure të vetme si Kur'ani, ose përndryshe pranoni humbjen dhe poshtërimin në këtë botë dhe në tjetrën."* Pavarësisht nga kjo sfidë, oratorët kryeneçë të asaj periudhe e braktisën rrugën e shkurtër të bërjes së një sureje të vetme si Kur'ani, dhe në vend të saj zgjodhën rrugën e gjatë të luftës duke vënë në rrezik vetveten dhe pronat e tyre. Kjo provon se rruga e shkurtër nuk mund të merret.

Me miliona libra në gjuhën arabe janë në qarkullim, disa të shkruara nga miqtë e Kur'anit, me qëllim që t'i ngjasojnë dhe ta imitojnë atë, të tjerët të shkruara nga armiqtë e tij, me qëllim që të konfrontohen e ta kritikojnë atë. Sikur njeriu i zakonshëm ta dëgjonte kur këndohet e recitohet Kur'ani, do të detyrohej të thonte se asnjë nga ato libra nuk është në gjendje ta arrijë nivelin e Kur'anit, dhe natyrisht do të shprehej: Kur'ani nuk u ngjason këtyre librave të tjerë, as nuk është i të njëjtës shkallë si ato. Atëherë, Ai duhet të jetë ose poshtë tyre në elokuencë ose lartë tyre. "Askush, asnjë jobesimtar, dhe madje asnjë idiot në botë nuk mund të thotë se ai është poshtë tyre. Domethënë, shkalla e tij e elokuencës është mbi të gjithë." Njëherë një njeri lexoi ajetin:

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

"All-llahut i jep lavdërim gjthçka është në qiejt e në tokë",

pastaj tha: "Unë nuk shoh ndonjë elokuencë të mrekullueshme në këtë vërset." Atij iu tha: "Kthehu prapa tek ajo periudhë, ashtu si udhëtari, dhe dëgjo vërsetin siç u recitua atje." Atëherë, ai duke e përfytyruar veten e tij të jetë atje para shpalljes së Kur'anit, shikoi se të gjitha qëniet në botë jetonin në një hapësirë boshe, të pafund e të pakufizuar, në një botë të paqëndrueshme e kalimtare, në konfuzion, në errësirë, në mungesë vetëdije e qëllimi. Papritmas, ai dëgjoi këtë vërset të shpallur

nga gjuha e Kur'anit. Ky vërset hoqi perden nga ana ballore e Kozmosit dhe ndriçoi faqen e globit; kjo folje e parapërjetësisë, ky urdhër i përjetshëm dhe ky instruksion iu dha të gjitha qënieve të vetëdijshme sipas shekujve duke iu shfaqur atyre në një mënyrë të tillë, që Kozmosi u bë si një xhami e madhe. I gjithë krijimi, me në krye qiejt e tokën, është futur në përmendjen dhe kujtimin e All-llahut dhe shpall lavdinë e Tij me vitalitet, me gëzim e kënaqësi duke përmbushur funksionin e vet. Të gjithë këtë udhëtari ynë e shikoi. Kështu, duke provuar e shijuar shkallën e elokuencës së këtij vërseti dhe duke krahasuar vërsetet e tjera të tij, me analogji, ai kuptoi një nga mijëra arsyet e shëndosha për pushtimin e gjysmës së globit dhe të një të pestës së njerëzimit nga elokuenca e pashoqe e Kur'anit për vazhdimësinë e pandërprerë të sovranitetit të tij të respektuar e madhështor për katërmbëdhjetë shekuj.

● **Pika e katërt:** Kur'ani ka demonstruar një ëmbëlsi të vërtetë të tillë saqë kur edhe përsëritja e sendit më të ëmbël ngjall mërzitje, Ai, Kur'ani, nuk shkakton mërzitje tek ai që nuk i është prishur zemra dhe shija. Por leximi i shpeshtë i tij e shton ëmbëlsinë dhe kënaqësinë. Kjo çështje është e vetëkuptueshme tek të gjithë njerëzit që nga koha e shpalljes së tij. Madje është bërë proverbiale se recitimi i përsëritur i Kur'anit, shton ëmbëlsinë; Kur'ani, për më tepër, tregon një freski të tillë, rinim dhe origjinalitet saqë edhe pse ka jetuar për katërmbëdhjetë shekuj dhe ka kaluar nëpërmjet shumë duarve, ai ruan freskinë e tij në një mënyrë sikur të ishte zbuluar pikërisht në atë moment. Çdo shekull e shikon Kur'anin të urdhërojë një brez të ri tamam sikur t'i drejtohet atij shekulli në veçanti. E ngjashme me këtë, çdo degë e të mësuarit, edhe pse e mban Kur'anin vazhdimisht në anën e saj me qëllim që të përfitojë nga Ai, dhe përjetësisht ndjek të njëjtën metodë apo referencë, shikon se Kur'ani mban e ruan origjinalitetin e stilit të Tij dhe metodën e komentimit.

● **Pika e pestë:** Kur'ani ka njërin krah në të shkuarën dhe njërin në të ardhmen. Rrënjët e tij dhe njëri krah janë të vërteta të pranuara me unanimitet e të shpallura nga pejgamberë të mëparshëm të cilët e vërtetojnë dhe e përforcojnë atë edhe me gjuhën e gjendjes së koinçidencës. Po kështu evlijatë, shenjtorët dhe të drejtët janë frutet që kanë fituar përparimin jetik nga pema e Kur'anit. Të gjithë sufitë e vërtetë dhe shkencat e vërteta të Islamit tregojnë vitalitetin, begatinë

dhe vërtetësinë e asaj peme të bekuar me evolucionin e tyre vital dhe me jetën nën mbrojtjen e krahut të dytë të Islamit, të gjitha këto dëshmojnë se Kur'ani është vërtetësi, përmbledhje e vërtetësive dhe është një mrekulli e pakrahasueshme.

● **Pika e gjashtë:** Gjashtë drejtimet e Kur'anit janë të gjitha dritëdhënëse; ato të gjitha demonstrojnë vërtetësinë dhe saktësinë. Poshtë tij janë shtyllat e argumentit e të provës; sipër tij shkëlqejnë shenjat e mrekullisë; përpara tij dhe qëllimi i tij është lumturia e të dyja botëve; prapa është pika e mbështetjes së tij, të vërtetat e shpalljes qiellore; në të djathtën është vërtetimi nëpërmjet dëshmive të nxjerra nga mendje të shëndosha të panumërta; në të majtën është qetësia, siguria serioze dhe nënshtrimi i sinqertë i zemrave të shëndosha dhe ndërgjegjjeve të pastërta. Të gjashta këto, duke u marrë së bashku, provojnë se, Kur'ani është kështjella e fortë qiellore e tokësore e mrekullueshme, që nuk mund të sulmohet. Atëherë, gjithashtu, Kontrollori i këtij kozmosi, që rregulli i vazhdueshëm i sjelljes së të Cilit është të tregojë bukurinë në krijim, të mbrojë mirësinë e drejtësinë dhe të shkatërrojë e të zhdukë mashtruesit dhe shpifësit, ka nënshkruar faktin se Kur'ani është e vërteta dhe e drejta, se ai nuk është fjala e njeriut dhe nuk ka të meta. Zoti e ka mbështetur Kur'anin dhe e ka vërtetuar me çfarë i dha pozitën me dominim më të lartë, më të respektuar dhe shkallën më të lartë të nderimit në botë.

Pastaj Pejgamberi i nderuar, Muhammedi a.s.m. burimi i Islamit dhe interpretuesi i Kur'anit, besoi në të dhe e respektoi më shumë se çdo njeri tjetër.

Ndonjëherë shpallja i vinte atij ndërsa ishte në një gjendje midis gjumit dhe zgjimit dhe i pandikueshëm nga fjalë të tjera, dhe fjalët e tjera nuk mund të arrijnë asnjë shkallë të tij dhe nuk i ngjasojnë. Por pavarësisht nga natyra e tij analfabete, ai shtjellonte pa ngurrim dhe me besimin më të madh shpalljet e vërteta, lidhur me të shkuarën dhe të ardhmen nëpërmjet Kur'anit. Këtë ai e bën nën shqyrtimin e syve të vëmendshëm dhe asnjë gabim e dredhi nuk u vërejt tek ai. Ai besoi dhe me të gjithë fuqinë pranoi çdo urdhëresë të Kur'anit dhe asgjë nuk mundi ta lëkundte atë; kjo gjithashtu përbën një provë për natyrën e vërtetë e qiellore të Kur'anit, për faktin se ajo është fjala e bekuar e Krijuesit të Gjithëmëshirshëm.

Lidhja e përshpirtshme e një të pestës së njerëzimit ose madje e pjesës më të madhe të tyre me atë Kur'an që është para nesh, përkushtimi i zellshëm dhe vëmendja e madhe që ata kanë për urdhërat e tij dhe dashuria e pastër për të. Fakti se me dëshminë e shumë treguesve, vizioneve, zbulesave, që edhe xhindet, engjëjt dhe qëniet shpirtërore mblidhen si fluturat dashuruese të dritës kudo që Kur'ani recitohet, ky është një tregues që Kur'ani është libri më i pranuar gjërësisht në Kozmos dhe zë vendin më të lartë të respektit.

Fakti që të gjitha klasat e njerëzve, nga më e ulta e më e paditura gjer te më e larta dhe e shkolluara marrin shumë përfitime nga mësimi i Kur'anit dhe kapin të vërtetat e tij më të thella, vetë fakti që çdo klasë shkollarësh, në lidhje me qindra nga degët e ndryshme të shkencës islame dhe veçanërisht interpretuesit e sheriatit më të madh, studiuesit e përpiktë të parimeve të fesë dhe të teologjisë, i nxjerrin të gjitha përgjigjet dhe nevojat nga Kur'ani sipas shkencës që ata studiojnë, kjo është një provë se Kur'ani është burimi i të vërtetës dhe minerali i realitetit.

Midis letrarëve arabë, njerëz të shquar në retorikë, ata që nuk kanë përqafuar Islamin kanë dështuar në përpjekjen që të prodhojnë një sure apo një pjesë si elokuenca e atyre të Kur'anit, vetëm si elokuenca e qënies së Kur'anit një nga shtatë aspektet e mrekullisë së tij, pavarësisht dëshirës së tyre të madhe për ta sfiduar Kur'anin. Përveç kësaj, retoricienë të shquar dhe studiuesit e talentuar që kanë dëshiruar të fitojnë famë duke ngritur kundërshtime, nuk kanë qenë në gjendje të përballen me asnjë aspekt të mrekullisë së Kur'anit, dhe heshtja e tyre nga paaftësia dëshmon se Kur'ani është një mrekulli përtej kapacitetit njerëzor.

Vlera, lartësia dhe elokuenca e fjalëve matet duke ditur se ***nga kush erdhën, kujt i erdhën dhe për çfarë qëllimi erdhën.*** Nga kjo pikëpamje, ***Kur'ani është i paarritshëm dhe i pakrahasueshëm, sepse Kur'ani është një mesazh dhe fjalë nga Zoti, Krijuesi i të gjitha botëve, është një fjalim që nuk mund të imitohet në asnjë mënyrë, nuk ka shenjë që të mund të tregojë mundësinë e mashtrimit e të shtirjes. Ai iu drejtua atij, i cili u dërgua për të përfaqësuar të gjithë njerëzimin ose madje të gjitha krijesat; më të dëgjuarit dhe më të famshmit të llojit njerëzor, fuqia dhe gjërësia e besimit të të cilit i dha ngritje Islamit madhështor dhe e ngriti atë te rangu i Kâb-i Kavsejnit,***

sa largësia e dy harqeve ose edhe më afër. Kur'ani shpjegon e qartëson besimin më të lartë e të gjërë, sqaron të gjitha çështjet që lidhen me lumturinë në këtë botë dhe në tjetrën, përfundimin e Kozmosit, qëllimet Hyjnore dhe të gjitha të vërtetat e Islamit; ai tregon çdo anë të universit duke e kthyer ashtu si dikush që kthen hartën apo orën para tij, duke i mësuar njeriut Shpikësin e tij, Krijuesin Fuqiplotë, nëpërmjet periudhave dhe transformimeve të tij. Atëherë, natyrisht është e pamundur të prodhosh si Kur'anin e shpjegimit të mrekullueshëm e të arrish shkallën e tij të mahnitshme.

Atëherë, gjithashtu, karakteristikat e larta të Kur'anit, pikat e tija të holla, veçoritë e tij të larta, misteret dhe kuptimet e tij të thella si dhe parashikimet e tij të shumta për sa i përket të panjohurës me llojet e tyre të ndryshme të pranuara dhe të vërtetuara me prova e dëshmi nga mijëra studiues ekspertë të nivelit të lartë intelektual dhe të mendjemprehtësisë të cilët kanë shkruar komente për Kur'anin në tridhjetë, dyzet ose shtatëdhjetë vëllime; sidomos hollësitë e Kur'anit të vërtetuara secila me argumente në njërën nga njëqind e tridhjetë pjesët e **Risale-i Nurit**, në mënyrë të veçantë *"Trajtesa e mrekullive të Kur'anit*", "Stacioni i Dytë i Fjalës së Njëzetë" e cila nxjerr shumë nga mrekullitë e qytetërimit prej tekstit të Kur'anit, si shembulli i trenave dhe avionit. Rrezja e parë (treguesit e Kur'anit) që shfaq treguesit e **Risale-i Nurit** dhe elektricitetin që gjendet në Kur'an, tetë trajtesat e shkurtëra (të quajtura tetë misteret) që tregojnë shkallën e sistemit të hollë - tek shkronjat e Kur'anit dhe sa shumë sekrete e kuptime kanë ato, dhe trajtesat e shkurtëra që tregojnë pesë aspektet e mrekullisë së vërsetit të fundit të sures *el-Fet'h*. Shfaqja e çdo pjese nga pjesët e **Risale-i Nurit** është një e vërtetë nga të vërtetat e Kur'anit dhe është dritë nga dritat e tij. E gjithë kjo që u tha është një tregues i veçantisë së Kur'anit, i faktit se ai është mrekulli e mahnitje, se ai është gjuha e botës së padukshme, e ardhur në botën e dukshme; Fjala e Krijuesit, Njohësit të së panjohurës. Për shkak të këtyre karakteristikave dhe veçorive të lartëpërmendura të Kur'anit të treguara në gjashtë pika, gjashtë drejtime e gjashtë stacione, madhështia e tij, pushteti i Tij ndriçues dhe shkëlqimi e autoriteti i shenjtë i tij, kanë ndriçuar vazhdimisht faqen e tokës për një mijë e treqind vjet dhe kanë marrë respektin më të madh. Është pikërisht për shkak të këtyre veçorive që çdo shkronjë e Kur'anit ka fituar dallimin e dhënies, të paktën dhjetë shpërblime, dhjetë të mira e dhjetë frute të përjetshme. Madje çdo

shkronjë e disa vërseteve dhe sureve bën të fitosh njëqind, njëmijë ose më shumë nga frutat e përjetshme të Ahiretit dhe në disa kohë të bekuara drita, shpërblimi dhe vlera e secilës shkronjë rritet nga dhjetë deri në qindra.

Udhëtari e perceptoi këtë dhe iu drejtua zemrës së tij. Kur'ani që është kështu mrekulli në çdo aspekt përmes konsensusit të sureve të tij, përmes harmonisë dhe pajtimit të vërseteve, përputhjes së dritave, mistereve të tij dhe korrespondencës së frutave dhe efekteve të tij, dëshmon ekzistencën, Njësinë, atributet dhe Emrat e Ekzistuesit të domosdoshëm në një mënyrë të tillë e të qartë saqë dëshmi e prova të pakufishme nga të gjithë njerëzit e besimit të vërtetë mund të thuhet të kenë ardhur nga ajo dëshmi.

Një aluzion i shkurtër për mësimin në lidhje me Njësinë Hyjnore dhe me besimin, të cilin udhëtari e nxori nga Kur'ani, u tha në **Shkallën e Shtatëmbëdhjetë të Vendqëndrimit të Parë.**

لَآ اِلٰهَ اِلَّا اللّٰهُ اَلْوَاجِبُ الْوُجُودِ اَلْوَاحِدُ الْاَحَدُ الَّذِي دَلَّ عَلٰى وُجُوبِ وُجُودِهِ
فِي وَحْدَتِهِ اَلْقُرْاٰنُ الْمُعْجِزُ الْبَيَانِ اَلْمَقْبُولُ الْمَرْغُوبُ لِاَجْنَاسِ الْمَلَكِ وَالْاِنْسِ
وَالْجَانِّ اَلْمَقْرُوءُ كُلُّ اٰيَاتِهِ فِي كُلِّ دَقِيقَةٍ بِكَمَالِ الْاِحْتِرَامِ بِاَلْسِنَةٍ مِأَتِ مِلْيُونٍ
مِنْ نَوْعِ الْاِنْسَانِ اَلدَّائِمُ سُلْطَنَتُهُ الْقُدْسِيَّةُ عَلٰى اَقْطَارِ الْاَرْضِ وَالْاَكْوَانِ
وَعَلٰى وُجُوهِ الْاَعْصَارِ وَالزَّمَانِ وَالْجَارِي حَاكِمِيَّتُهُ الْمَعْنَوِيَّةُ اَلنُّورَانِيَّةُ عَلٰى
نِصْفِ الْاَرْضِ وَخُمُسِ الْبَشَرِ فِي اَرْبَعَةَ عَشَرَ عَصْرًا بِكَمَالِ الْاِحْتِشَامِ .. وَكَذَا
شَهِدَ وَبَرْهَنَ بِاِجْمَاعِ سُوَرِهِ الْقُدْسِيَّةِ اَلسَّمَاوِيَّةِ وَبِاتِّفَاقِ اٰيَاتِهِ اَلنُّورَانِيَّةِ
الْاِلٰهِيَّةِ وَبِتَوَافُقِ اَسْرَارِهِ وَاَنْوَارِهِ وَبِتَطَابُقِ حَقَائِقِهِ وَثَمَرَاتِهِ وَاٰثَارِهِ
بِالْمُشَاهَدَةِ وَالْعِيَانِ

* * *

ÇËSHTJA E DHJETË E TRAJTESËS SË FRUTEVE TË BESIMIT QË ËSHTË RREZJA E NJËMBËDHJETË

NJË LULE E EMIRDAGUT

Një përgjigje shumë e fuqishme për kundërshtimet që ngrihen kundra përsëritjes në Kur'an.

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Për shkak të gjendjes sime të mjerueshme, kjo çështje është disi e ngatërruar dhe e pagjashme. Por unë kuptova se nën këto shprehje të ngatërruara, sigurisht ndodhej një lloj shumë i vlefshëm i mrekullisë, por fatkeqësisht unë nuk isha i aftë për ta shprehur atë. Megjithatë, sado të pangjyra të jenë shprehjet, meqenëse lidhen me Kur'anin, ato janë edhe "Adhurim në formë reflektimi" edhe "sedef" për një xhevahir të shenjtë, të lartë e të ndritshëm. Diamanti në dorë është ai që duhet të shikohet dhe jo sedefi a mbulesa e tij e grisur. Gjithashtu, unë shkrova në një a dy ditë gjatë muajit të Ramazanit ndërsa isha shumë i sëmurë dhe në gjendje të mjerueshme e pa ushqim, nga domosdoshmëria, në mënyrë të përmbledhur e shkurt, dhe duke përfshirë të vërteta e prova të shumta në një fjali të vetme. Prandaj, të mos merren në konsideratë mangësitë e saja. [198]

Vëllezërit e mi të dashur e besnikë!

Ndërsa po lexoja Kur'anin e shpjegimit të mrekullueshëm në muajin e Bekuar të Ramazanit, po reflektoja thellë në kuptimet e tridhjetë e tre vërseteve që aludojnë për Risale-in Nurin në Rrezen e parë, ku cilido vërset prej atyre që më dilte para, unë shikoja se faqja, fleta dhe tregimi i vërsetit gjithashtu shikonin tek Risale-i Nuri dhe tek studentët e tij, nga këndvështrimi i marrjes së tyre një pjesë prej tregimit dhe kuptimit, e sidomos prej vërsetit të *Dritës* tek sureja *En-*

[198] Ashtu si Çështja e Dhjetë e frutit të burgut të Denizlit, ajo është një lule e vogël e shndritshme e Emirdagut dhe e këtij muaji të Ramazanit të Bekuar. Duke shpjeguar një shembull urtësie për përsëritjen në Kur'an, ajo i largon iluzionet helmuese të njerëzve të çudhëzimit.(Autori)

Nur; ato vërsete tregojnë e aludojnë me dhjetë gishtërinjtë për Risale-in Nurin; gjithashtu edhe vërsetet e errësirës që vijnë pas atij vërseti, tregojnë e aludojnë drejtpërdrejt për ata që e luftojnë dhe e kundërshtojnë Risale-in Nurin; këto madje, u japin atyre një pjesë më të madhe. Unë kuptova mjaft qartë se ky "stacion" ngrihet nga veçantia për tek përbotshmëria, dhe se një pjesë e asaj përbotshmërie është Risale-i Nuri dhe studentët e tij në këtë shekull.

Vërtet, në lidhje me gjërësinë, lartësinë dhe gjithëpërfshirjen që merr Fjalimi i Kur'anit nga stacioni i gjërë Absolut i Hyjnisë universale, i Folësit të parapërjetësisë, dhe nga stacioni i madh i atij të cilit iu adresua ky libër në emër të të gjitha qënieve nga stacioni i gjërë i udhëzimit të të gjithë njerëzimit në të gjithë shekujt, dhe nga stacioni i shpjegimit më të lartë e gjithëpërfshirës të ligjeve Hyjnore që lidhen me Dynjanë e Ahiretin, me qiejt e tokën, dhe me parapërjetësinë e paspërjetësinë, ato ligje që i përkasin Hyjnisë së Tij si Krijues i universit dhe që përfshijnë të gjitha qëniet; ky fjalim shfaq një mrekulli të tillë të lartë e një gjithëpërfshirje, saqë si niveli i tij i thjeshtë e i dukshëm, që u bën qejfin e i bën të ndihen të nderuar mendjet e thjeshta të njerëzve të zakonshëm –të cilët janë pjesa më e madhe që Kur'ani u adresohet –po ashtu edhe niveli i tij më i lartë– shtresa më e kulturuar dhe e arsimuar–, marrin pjesë prej tij.

Ai sikur i adresohet çdo shekulli e çdo klase të njerëzimit, jo si një pjesë e historisë apo si një mësim nga një tregim historik, por si një pjesë e një parimi universal, sikur ai të shpallej rishtas. Dhe në mënyrë të veçantë kërcënimet e tij të përsëritura shpesh:

اَلظَّالِمِينَ ۞ اَلظَّالِمِينَ

"*për keqbërësit... për keqbërësit*"

dhe paralajmërimet e tij të ashpra për ardhjen e fatkeqësive qiellore e tokësore për shkak të gjynaheve të tyre dhe padrejtësive –përmes këtyre dhe ndëshkimit që u ra popujve të Adit, Themudit dhe Faraonit, ai– me këtë përsëritje- u tërheq vëmendjen për padrejtësitë e pakrahasueshme të këtij shekulli, dhe nëpërmjet përmendjes së shpëtimit të profetëve, si shpëtimi i Ibrahimit a.s. dhe i Musait a.s., ai u jep ngushëllim e qetësi besimtarëve të cilëve u bëhet padrejtësi.

Vërtet, për të gjitha kohët e shkuara dhe epokat e shekujt e kaluar që, nga pikëpamja e pakujdesisë dhe e çudhëzimit, formojnë një vend të lemerishëm e të tmerrshëm të mosekzistencës dhe një varrezë të dhimbshme e të rrënuar, ***Kur'ani i Shpjegimit të Mrekullueshëm*** i tregon çdo shekulli dhe çdo klaseje njerëzore, në formën e faqeve të gjalla instruktive, botët e çuditshme që jetojnë e që janë të pajisura me shpirtëra, dhe botët ekzistuese të Krijuesit Furnizues të cilat lidhen me ne; me një mrekulli të lartë ai ndonjëherë na përcjell neve tek ato kohë dhe disa herë i sjell ato kohë tek ne. Duke gjallëruar e duke i dhënë jetë universit, që nga pikëpamja e çudhëzimit është i pajetë, i mjerë, i vdekur dhe një zonë e shkretë e pafund duke u rrotulluar përmes ndarjes e tatëpjetës, me të njëjtën mrekulli, ky i njëjti **Kur'an i kalibrit të fuqishëm**, i sjell në jetë ato qënie të vdekura, i bën ato të bisedojnë me njëra-tjetrën si nëpunës të ngarkuar me detyra dhe të shpejtojnë për të ndihmuar njëri-tjetrin; ai i instrukton njerëzimin, xhindet dhe engjëjt me urtësinë e vërtetë, të shndritshme e të kënaqshme. Atëherë, ai me siguri fiton shquarsi, dallueshmëri të shenjta Hyjnore e tituj të lartë nderi, si ndodhja e dhjetë të mirave dhe meritave në secilën nga shkronjat e tij dhe ndonjëherë njëqind, njëmijë apo mijëra merita; dhe sikur xhindet e njerëzit të mblidheshin bashkë, qënia e tyre të paaftë për të nxjerrë si shembulli i tij; dhe fjala e tij krejtësisht e përshtatshme me të gjithë njerëzimin e me të gjitha qëniet; dhe qënia e tij i skalitur gjithmonë me entuziazëm e dëshirë të fortë në zemrat e miliona *hafizëve*; mosdhënia e tij mërzitje nga përsëritjet e tij të shpeshta e të shumta; dhe pavarësisht shumë vendeve e fjalive të tij të mbuluara e të fshehura, vendosja e tij në mënyrë të plotë në mendjet e fëmijëve delikatë; dhe qënia e tij i këndshëm si uji i Z*emzemit* në veshët e të sëmurëve dhe të atyre që janë në grahmat e vdekjes, të cilët shqetësohen edhe nga fjala më e vogël; dhe dhënia e tij lumturi për studentët e tij në këtë botë dhe në tjetrën.

Dhe rrjedhshmëria e stilit të tij, i cili, duke iu përmbajtur e respektuar plotësisht qënien analfabet të përçuesit të tij, nuk lejon fjalë të fryra, artificializëm apo shtirësi, dhe zbritja e tij direkt nga qiejt e demonstron një mrekulli të tillë. Gjithashtu ai tregon një mrekulli të hollë në hijeshinë dhe udhëzimin e mendjeve të thjeshta të njerëzve të zakonshëm duke u bërë qejfin atyre –të cilët përbëjnë shumicën e klasave të njerëzimit– përmes zbritjes e begenisë në shprehjet e tij me qëllim që t'u afrohet shkallëve të tyre të të kuptuarit, e duke hapur

përpara tyre fletët e qarta, që shfaqen në mënyrë të vetëkuptueshme si qiejt e toka... dhe duke dhënë mësim mrekullitë e çuditshme të fuqisë dhe rreshtat kuptimplotë të urtësisë nën ato gjëra të zakonshme.

Dhe me qëllim që të bëjë të ditur se ai është gjithashtu një libër lutjeje e faljeje, libër thirrjeje, përmendjeje dhe libër i Njësisë Hyjnore të cilat kërkojnë përsëritje, ai demonstron një llojë mrekullie duke bërë të kuptueshme në një fjali të vetme dhe në një tregim të vetëm, përmes përsëritjeve të tij të këndshme, kuptime të shumta të ndryshme për klasa të shumta të ndryshme të njerëzimit. Gjithashtu, me qëllim që të bëjë të njohur se gjërat më të vogla e më të holla në ngjarjet e zakonshme janë brenda shikimit të Mëshirës së të Gjithëmëshirshmit, brenda sferës së rregullimit të Tij dhe Dëshirës së Tij, ai demonstron një lloj mrekullie duke u dhënë rëndësi edhe ngjarjeve më të vogla që u ndodhën sahabëve, shokëve të profetit Muhammed a.s.m. në themelimin e Islamit dhe në kodifikimin e sheriatit dhe me to ai shfaq rregulla Hyjnore që veprojnë në univers si dhe ligje gjithëpërfshirëse. Përveç kësaj, ai shfaq se ato ngjarje të pjesshme të cilat janë si farëra në themelimin e Islamit e të sheriatit në përgjithësi, do të prodhonin në vijim të kohërave frutat më të rëndësishëm.

Në lidhje me përsëritjen, duke qenë e domosdoshme për shkak të përsëritjes së nevojës, përsëritja e disa vërseteve që, si përgjigje e pyetjeve të shumta të përsëritura gjatë një periudhe njëzet vjeçare dhe që instruktoi nivele të ndryshëm dhe të shumtë njerëzish, nuk është gabim. Ai përsërit fjali që kanë mijëra rezultate dhe përsërit udhëzime që janë përfundime të dëshmive të pafund, të cilat përshkruajnë një revolucion e ndryshim të madh, të tmerrshëm e gjithëpërfshirës që duke shkatërruar plotësisht universin e madh dhe duke ndryshuar formën e tij tek Dita e Gjyqit të madh, do të zhdukë Dynjanë dhe do të themelojë Ahiretin madhështor në vend të tij dhe do të provojë se të gjitha të pjesshmet e të tërat duke filluar nga atomet gjer tek yjet janë në Dorën e Qënies së Vetme, Krijuesit, dhe nën drejtimin e Tij. Ai gjithashtu i përsërit tek shpjegimi i inatosjes Hyjnore dhe i zemërimit Hyjnor ndaj gjynaheve, padrejtësive të njeriut, te shkelja dhe kundërshtimi i qëllimit të krijimit për shkak të rezultatit të krijimit të universit, ato padrejtësi e gjynahe shkaktojnë trazirën e qënieve dhe bëjnë të zemërohen toka, qiejt dhe elementet; të përsërisësh vërsete të tilla nuk është gabim, por mrekullia më e fuqishme dhe elokuenca më e

lartë; është një elokuencë e një stil i ndritur e i qartë që i korrespondon ekzaktësisht kërkesave të rrethanave.

Për shembull, siç është shpjeguar në Shkreptimën e Katërmbëdhjetë të Risale-i Nur, fjalia

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ

"Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti",

duke qenë një vërset i vetëm dhe duke u përsëritur njëqind e katërmbëdhjetë herë në Kur'an, është një e vërtetë e madhe e cila lidh Fronin Hyjnor me tokën dhe ndriçon kozmosin dhe i nevojitet gjithkujt në çdo kohë; ajo sikur të përsëritej me miliona herë, akoma do të kishte nevojë për të. Për të lind nevoja e dëshira jo vetëm çdo ditë si buka, por çdo minut si ajri e drita.

Dhe për shembull, vërseti,

إِنَّ رَبَّكَ لَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ

"Dhe siguricht Furnizuesi yt është i Lartë në Fuqi, i Gjithëmëshirshmi",

që përsëritet tetë herë në Suren, طٰسٓمٓ (sure el-Shuara). Duke e përsëritur këtë të vërtetë që ka fuqinë e mijëra të vërtetave për shkak të rezultatit të krijimit të universit dhe në Emrin e Hyjnisë universale Absolute, duke përmendur shpëtimin e profetëve, historitë e të cilëve tregohen në sure dhe ndëshkimet e popujve të tyre, kjo përsëritje bëhet me qëllim që të sqarojë se Dinjiteti Hyjnor kërkon torturimin e atyre popujve zullumqarë e tiranë dhe se Mëshira Hyjnore, gjithashtu, kërkon shpëtimin e profetëve, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta. Atëherë, ky vërset sikur të përsëritej me mijëra herë, akoma do të shfaqej nevoja e malli për të. Përsëritja këtu është një elokuencë e hollë dhe një mrekulli e lartë e mahnitshme.

Dhe për shembull, vërseti,

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ

"Atëherë pra, cilën nga mirësitë e Zotit tuaj ju (njerëz dhe xhinde) e mohoni!"[199] i cili përsëritet në suren *Er-Rrahman*,

po ashtu edhe vërseti,

وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ

"Mjerë ajo Ditë për mohuesit (e Ditës së ringjalljes)"[200],

në suren *El-Murselat*, bërtasin në fytyrën e të gjithë shekujve duke kërcënuar njerëzimin dhe xhindet dhe shpallin qartë në zonat e qiejve e të tokës se mohimi i mirësive të Zotit nga xhindet e njerëzit, mosbesimi, mosmirënjohja dhe padrejtësitë e tyre shkaktojnë zemërimin e universit dhe e bëjnë tokën e qiejt të inatosen kundër atyre që prishin rezultatet e Krijimit të botës, që mohojnë e i përgjigjen me mospërfillje Madhështisë së rregullit Hyjnor dhe që shkelin në mënyrë agresive të drejtat e të gjitha krijesave. Atëherë, në qoftë se një mësim kaq i përgjithshëm, që lidhet me mijëra të vërteta dhe që ka fuqinë e rëndësinë e mijëra çështjeve, do të përsëritej me mijëra herë, akoma do të ndihej nevoja për të, për përmbledhjen e tij madhështore dhe për elokuencën e bukur e të mrekullueshme.

Dhe për shembul, përsëritja e frazës,

سُبْحَانَكَ يَا لَا إِلَٰهَ إِلَّا أَنْتَ أَلَامَانُ أَلَامَانُ خَلِّصْنَا وَأَجِرْنَا وَنَجِّنَا مِنَ النَّارِ

Lavdia të takon Ty, nuk ka zot tjetër përveç Teje! Mëshirë! Mëshirë! Na ruaj, na mbro e na shpëto nga zjarri i Xhehenemit!

te duatë e profetit Muhammed a.s.m. të quajtura ***Xhevshen el-Kebir***, të cilat i përshtaten të vërtetës së Kur'anit dhe është një lloj i përmbledhjes që buron prej tij. Meqenëse ai përmban të vërtetën më të madhe si Njësia dhe më të rëndësishmen e tre detyrave më të mëdha të krijesave përpara Hyjnisë, përmendjet e Zotit, lavdërimet, dhe shenjtërimin e Tij; dhe meqenëse çështja më e madhe e njerëzimit është shpëtimi i tij nga Ferri e mjerimi, dhe synimi më i domosdoshëm i adhurimit dhe i pafuqisë njerëzore është duaja, atëherë edhe sikur ajo të përsëritej me mijëra herë, do të ishte akoma pak.

---

[199] Kur'an 55:13
[200] Kur'an, 77:15

Kështu, përsëritja në Kur'an shikon e synon parime të fuqishme si këto: Ndonjëherë, madje në një faqe, në lidhje me kërkesat e pozitës dhe nevojës për shpjegim dhe në lidhje me kërkesat e elokuencës, ai shpreh të vërtetën e Unitetit Hyjnor ndoshta njëzet herë, në mënyrë të qartë e të nënkuptuar. Përsëritja nuk shkakton mërzi, por ajo ngjall një fuqi mallëngjimi dhe një ëmbëlsi për përsëritjen e leximit. Përmes përsëritjes elokuenca shton fuqi e lartësi pa shkaktuar mërzi e lodhje. Është shpjeguar në Risale-in Nur me prova vendimtare se sa me vend, të përshtatshme dhe të pranueshme, për sa i përket retorikës, janë përsëritjet në Kur'an.

Urtësia dhe kuptimi i sureve të Kur'anit të Shpjegimit të Mrekullueshëm që u shpallën në Mekë nga ato që u shpallën në Medine, në lidhje me elokuencën, mrekullinë e thukëtinë e stilit, është siç vijon: Në Mekë rreshti i parë i atyre të cilëve Kur'ani u adresohej dhe i atyre që e kundërshtonin atë ishin idhujtarët e kurejshit që ishin analfabetë e të paditur, kështu një stil kaq i fuqishëm e i lartë në lidhje me retorikën ishte i domosdoshëm. Atëherë në shumicën e sureve që u shpallën në Mekë, duke i përsëritur e duke i shprehur shtyllat e besimit dhe shkallët e Njësisë Hyjnore me përmbledhjen më të fuqishme, më të lartë e të mrekullueshme, ai provon aq fuqishëm krijimin e parë, ringjalljen, All-llahun dhe Ahiretin, jo vetëm në një faqe të vetme, në një vërset, fjali apo fjalë, por ndonjëherë në një shkronjë përmes mjeteve gramatikore, si duke ndryshuar vendet e fjalëve apo të fjalive, duke bërë një fjalë të pashquar, si dhe përmes heqjes e përfshirjes, saqë gjenitë dhe udhë-heqësit e shkencës së retorikës e takuan dhe e shikuan atë me habi. Risale-i Nuri, "Fjala e Njëzet e Pestë" dhe veçanërisht shtojcat e saj, të cilat provojnë shkurtimisht dyzet aspektet e mrekullisë së Kur'anit; gjithashtu komenti i Kur'anit *Isharatul-ixhaz* nga Risale-i Nuri arabisht në mënyrë të mrekullueshme provon aspektin e mrekullisë së Kur'anit në lidhje me renditjen e fjalëve të tij. Në fakt, ato dy trajtesa kanë provuar se në suret që u shpallën në Mekë dhe në vërsetet e tyre janë stilet më të larta të elokuencës dhe mrekullia më e lartë dhe e përmbledhur.

Sa për suret që u shpallën në Medine dhe vërsetet, meqenëse rreshti i parë i atyre të cilëve ato iu adresuan dhe i atyre të cilët i kundërshtuan ato ishin *njerëzit e librit* –çifutët dhe krishterët– të cilët e pranojnë ekzistencën e Zotit, atëherë rregullat e elokuencës, stilet e udhëzimit

dhe bazat e thirrjes për te e drejta kërkonin që fjalimi, i cili u adresohej *njerëzve të librit* –çifutëve dhe krishterëve– t'i përgjigjej realitetit të situatës së tyre; kështu, çfarë kërkohej nga ato rregulla nuk ishte shpjegimi i parimeve të larta dhe i shtyllave të besimit në një stil të thjeshtë, të qartë e të hollësishëm, por shpjegimi i çështjeve të veçanta të sheriatit dhe i urdhëresave të tij, të cilat ishin shkak kundërshtie dhe origjinat e shkaqeve të çështjeve dytësore dhe të ligjeve të përgjithshme. Kështu, në suret që u shpallën në Medine dhe në vërsetet, përmes shpjegimeve në stil të detajuar, të qartë e të thjeshtë dhe në mënyrë të pakrahasueshme shpjegimi tipik për Kur'anin, ai në pjesën më të madhe përmend brenda atyre çështjeve të veçanta dytësore një përmbledhje të fuqishme e të lartë, një konkluzion e provë, një fjali që lidhet me Njësinë Hyjnore, me Emrat Hyjnore ose me Ahiretin; e bën çështjen e veçantë të sheriatit të përgjithshme dhe siguron se ajo përputhet me besimin tek Zoti xh.sh.**.** Ajo pozitë e qartë e ndriçon atë pjesë, e lartëson dhe e përgjithëson. Risale-i Nuri i ka provuar cilësitë, pikat e holla dhe elokuencën e lartë në përmbledhjet e përfundimet, të cilat shprehin Njësinë Hyjnore dhe që vijnë kryesisht te fundet e vërseteve, si,

إِنَّ ٱللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۞ إِنَّ ٱللَّهَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ۞ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ
۞ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلرَّحِيمُ ۞

"Në të vërtetë Zoti është i Gjithëfuqishmi mbi gjithçka." "Sigurisht Zoti ka njohuri për gjithçka", "Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, i Gjithurti", "Ai është i Larti në Fuqi i Gjithëmëshirshmi."

Në shpjegimin e Rrezatimit të Dytë në Dritën e Dytë tek Fjala e Njëzet e Pestë, dhjetë prej shumë pikave të holla e prej cilësive të atyre përmbledhjeve e përfundimeve, ai ka provuar për kryeneçët se tek ato ndodhet një mrekulli më e lartë. Po, në shpjegimin e atyre çështjeve dytësore të sheriatit dhe të ligjeve të jetës sociale, ai i ngre shikimet e atyre të cilëve u adresohet për tek çështjet e larta e të përgjithshme, dhe e transformon stilin e thjeshtë në stil të lartë, tamam sikur ai e kalon lexuesin nga mësimi i sheriatit për tek mësimi i Njësisë Hyjnore, kjo vërteton se Kur'ani është një libër sheriati, rregullash dhe urtësie; gjithashtu ai është libër i parimeve të fesë dhe i besimit, libër lutje, mendimi e thirrje. Dhe përmes mësimit të shumë qëllimeve të

udhëzimit Kur'anor në çdo pjesë, ai shfaq një elokuencë brilante e të mrekullueshme, të ndryshme nga ajo e sureve që u shpallën në Mekë.

Ndonjëherë në dy fjalë, për shembull, te رَبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ *"Zoti i të gjitha botëve"* dhe رَبُّكَ *"Zoti yt"*, ku përmes frazës رَبُّكَ *"Zoti yt"* ai shpreh Njësinë Hyjnore dhe përmes رَبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ *"Zoti i të gjitha botëve"* shpreh Unitetin Hyjnor. Duke ditur se Njësia përmban Unitetin. Madje ai stil elokuence mund të shikojë tek një fjali e vetme dhe të tregojë, si shembull, depërtimin e Njohurisë së Tij tek vendosja e grimcës në beben e syrit dhe vendosja e diellit në mes të qiellit, dhe tek gjithëpërfshirja e Fuqisë së Tij e Cila vendos me një vegël të vetme çdo gjë në vendin e vet, duke e bërë diellin sikur të ishte një sy për qiellin.

Dhe për shembull, pas vërsetit, خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ *"I Cili krijoi qiejt e tokën",*

duke ndjekur vërsetin, يُولِجُ ٱلَّيْلَ فِى ٱلنَّهَارِ وَيُولِجُ ٱلنَّهَارَ فِى ٱلَّيْلِ

"Ai ndërfut natën te dita, dhe Ai ndërfut ditën te nata."[201]

Ai thotë: وَهُوَ عَلِيمٌۢ بِذَاتِ ٱلصُّدُورِ *"Sigurisht që Ai është i Gjithëdituri i asaj që është në gjokse (në zemrat e njerëzve)."*[202]

Ai thotë: ***"Brenda madhështisë së krijimit të tokës e të qiejve, Ai njeh e rregullon gjithashtu mendimet e zemrës."*** Dhe përmes shpjegimit të këtij lloji e transformon atë nivel të thjeshtë e të paditur dhe veçanërisht diskutimin që marrin parasysh mendjet e njerëzve të zakonshëm, në një bisedim të lartë, tërheqës e të përgjithshëm për qëllimin e udhëzimit.

***Një pyetje*:** "Meqenëse për arsye se një e vërtetë e rëndësishme ndonjëherë nuk është e dukshme për shikimet sipërfaqësore dhe,

[201] Kur'an, 35:13
[202] Kur'an, 35:38

meqenëse në disa pozita lidhja nuk njihet në shprehjen e përmbledhjes së lartë që i përket Njësisë Hyjnore apo një parimi të përgjithshëm midis një ngjarjeje të pjesshme e të zakonshme, disa e imagjinojnë se ka mangësi në elokuencë. Për shembull, duke përmendur parimin shumë të lartë, وَفَوْقَ كُلِّ ذِي عِلْمٍ عَلِيمٌ *"Por përmbi të gjithë ata që janë të pajisur me dije, është Një i Gjithëdituri (All-llahu)."*[203]

te Hazreti Jusufi a.s., duke strehuar vëllanë e tij me marifet, kjo nuk shfaqet të jetë në ruajtje me elokuencën. Cili është kuptimi i tij dhe urtësia në të?"

***Përgjigjja*:** Në shumicën e sureve të gjata dhe në ato me gjatësi mesatare që secila është si një Kur'an i vogël, dhe në shumë faqe e pjesë nuk ndiqen vetëm dy apo tre qëllime prej katër qëllimeve të Kur'anit, që janë: *Njësia Hyjnore, profetësia, ringjallja dhe drejtësia me ibadetin*, por secila përmban natyrën e Kur'anit dhe katër qëllimet përnjëherësh. Domethënë, secila prej tyre është libër përmendjeje, besimi, reflektimi, libër sheriati, urtësie dhe libër udhëzimi. Dhe kështu, meqenëse secila përshkruan treguesit madhështorë të Hyjnisë dhe gjithëpërfshirjen e të gjitha gjërave, duke qenë një lloj recitimi i librit madhështor të universit, në çdo diskutim dhe ndonjëherë në një faqe të vetme, Kur'ani ndjek shumë qëllime; ndërsa duke dhënë mësim në njohjen e Zotit, në shkallët e Njësisë Hyjnore dhe në të vërtetat e besimit, edhe në qoftë se me një lidhje të dobët në dukje, ai hap një subjekt tjetër udhëzuesi në pjesën vijuese dhe i bashkangjit lidhje të fuqishme të dobtës. Kështu, stili i korrespondon plotësisht diskutimit që kërkon ajo pozitë dhe rrit nivelin e elokuencës.

***Një pyetje e dytë*:** "Cilat janë urtësia dhe qëllimi i Kur'anit që i provon me mijëra herë Ahiretin, Njësinë Hyjnore dhe shpërblimet e dënimet e njeriut, që tërheq vëmendje për tek ato në mënyrë të qartë, të nënkuptuar e me aluzione dhe i jep ato mësim në çdo sure, në çdo faqe dhe në çdo diskutim?"

***Përgjigjja*:** Kur'ani i jep mësim njeriut dhe i tërheq vëmendjen për tek çështjet më të rëndësishme, më domethënëse e më të mëdha që ndodhin midis krijesave e mundësive, dhe për ndryshimet e historisë së

[203] Kur'an, 12:76

universit që lidhet me detyrën e njeriut dhe me mjetet e mjerimit të tij apo të lumturisë – njeriu i cili mori përsipër detyrën e amanetit, si ***kalif***, zëvendës i Zotit në tokë–, dhe në të njëjtën kohë Kur'ani zhduk dyshimet e shumta që i vijnë njeriut pa ndërprerje, dhe dërrmon mohimet e llojeve të tërbuara dhe kokëfortësinë. Kështu, Kur'ani e bën njeriun t'i mbështesë e t'i besojë ato revolucione të mëdha dhe që t'u parashtrojë atyre çështjet thelbësore më të domosdoshme të cilat janë aq të mëdha sa revolucionet e ndryshimet, atëherë në qoftë se Kur'ani tërheq vëmendjen e tij për tek ato me mijëra herë dhe me miliona herë, kjo nuk do të quhej kurrë tepri në elokuencë, dhe ato diskutime duhet të lexohen pasi nuk ka më të rëndësishme e më të mëdha se sa ato. Ato nuk shkaktojnë mërzi, dhe nevoja nuk mbaron për t'i përsëritur e lexuar me miliona herë.

Për shembull, meqenëse vërseti,

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِن تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۚ

"Vërtet se ata të cilët besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi, për ta do të jenë kopshtet e begatë nën të cilët rrjedhin lumenj (në Xhnenet). "Ata do të banojnë aty përherë."[204]

ia tregon të vërtetën e njoftimeve të lumturisë së përgjithshme njeriut të mjerë, i cili në çdo minut takon realitetin e vdekjes dhe ky sihariq e shpëton njeriun nga përfytyrimi për vdekjen si një ekzekutim i përjetshëm. Kështu e shpëton atë –botën e tij dhe të gjithë ata që ai i do– nga asgjësimi, madje ai u jep atyre një sovranitet të përhershëm dhe i bën të përfytyrojnë një lumturi të përjetshme. Kështu, në qoftë se ky vërset do të përsëritej me miliarda herë, përsëritja e tij nuk do të konsiderohej kurrë tepri, edhe sikur të vlerësohej sa universi, përsëri elokuenca nuk e humbet vlerën e saj. Kështu, ti shikon se Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm i cili i trajton shembujt e këtyre çështjeve të vlefshme dhe orvatet të bindë ata të cilëve ai u adresohet, duke vërtetuar me prova vendimtare ndodhjen e revolucioneve dhe ndryshimet e mëdha që do ta shkatërrojnë formën aktuale të universit dhe i bën ato para tyre të lehta e të qarta sikur të

[204] Kur'an, 5:85

ishte ndryshimi i një shtëpie dhe trasnformimi i formës së saj; Kur'ani i mrekullueshëm sigurisht tërheq vëmendjen me mijëra herë për tek këto çështje –në mënyrë të qartë, të nënkuptuar e me aluzione–, dhe kjo nuk është e tepërt, por përtërin mirësinë, ashtu siç përtërihen nevojat esenciale të bukës, ilaçit, ajrit dhe dritës.

Dhe për shembull, siç është provuar në mënyrë vendimtare në **Risale-in Nur**, urtësia e përsëritjes në Kur'an:

إِنَّ ٱلْكَٰفِرِينَ فِى نَارِ جَهَنَّمَ ۞ وَٱلظَّٰلِمِينَ لَهُمْ عَذَابًا لِّيمٌ

"Vërtet që për keqbërësit është një ndëshkim i dhimbshëm"[205], *"Për ata që mohuan (All-llahun) për ta do të jetë zjarri i Xhehennemit."*[206]

dhe vërsete të tjera, kërcënimi e paralajmërimi si këto të cilët përsëriten me ashpërsi, egërsi e dhunshëm është se mosbesimi i njeriut është një tejkalim e një shkelje e tillë kundër të drejtave të universit e të shumicës së krijesave, dhe ai shkakton zemërimin e qiejve e të tokës dhe bën të inatosen elementet, saqë ato japin goditje me stuhi, shtrëngata e tufane mbi mohuesit e mbi keqbërësit. Dhe sipas deklarimit të qartë të vërseteve,

إِذَآ أُلْقُوا۟ فِيهَا سَمِعُوا۟ لَهَا شَهِيقًا وَهِىَ تَفُورُ ۞ تَكَادُ تَمَيَّزُ مِنَ ٱلْغَيْظِ

"Kur ata të flaken në të (Zjarr), ata do të dëgjojnë të marrë frymë (tmerrësisht) duke u djegur në flakë", "Ai pothuaj shpërthen me vrull..."[207]

Xhehennemi zemërohet keq me ata mohues të padrejtë e të ligj, saqë arrin shkallën e shpërthimit me furi e tërbim. Kështu, në qoftë se Monarku i universit do ta përsëriste në urdhërat e Tij, me zemërim të madh e me ashpërsi, atë krim (mohimin) dhe ndëshkimin e tij me mijëra, miliona apo miliarda herë, akoma ajo nuk do të ishte aspak tepri dhe as mangësi në elokuencë. Duke parë atë krim të përgjithshëm dhe atë shkelje e agresion ndaj të drejtave të pakufishme, dhe sipas urtësisë së shfaqjes së rëndësisë së të drejtave dhe përkujdesjes

[205] Kur'an, 14:22
[206] Kur'an, 35:36
[207] Kur'an, 67:7-8

Hyjnore dhe duke nxjerrë në pah shëmtinë e pafund në mosbesim dhe në ligësinë e atyre mohuesve, ajo nuk përsëritet për humbjen e njeriut dhe vogëlsinë e tij, por për madhësinë e mëkatit të mohuesit dhe madhësinë e krimit të tij të padrejtë.

Pastaj ne shikojmë se me qindra miliona njerëz që prej njëmijë vjetësh, i kanë lexuar çdo ditë ato vërsete të Kur'anit, jo me mërzi, por me dëshirë të madhe, me mall e nevojë. Vërtet, çdo ditë, gjithë kohën, për gjithkënd, një botë zhduket dhe dera e një bote të re hapet për ta. Në përsëritjen e لَآ إِلَٰهَ إِلَّا اللَّهُ *"Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut"* me mallin e nevojës për të, me mijëra herë, me qëllim që të ndriçohet secila nga ato botëra kalimtare dhe të shkëlqejnë me dritën e besimit, ajo e bën atë fjali Njësie لَآ إِلَٰهَ إِلَّا اللَّهُ sikur të ishte një llambë ndriçuese në qiellin e atyre botëve, ditëve dhe e atyre perdeve të ndryshueshme... Në të njëjtën mënyrë, sipas urtësisë së vlerësimit nëpërmjet leximit të Kur'anit, dënimet e atyre krimeve dhe kërcënimet e rrepta të Monarkut të Parapërjetësisë, të cilat dërrmojnë kokëfortësinë e tyre dhe përmes veprimit për të shpëtuar nga kryengritja e shpirtit, që të mos i zhysë në errësirrë ato perde të shumëfishta kalimtare dhe botët e përkohshme shtegtuese, që të mos i bëjnë të shëmtuara imazhet e tyre që reflektohen në pasqyrat e jetëve të tyre dhe që të mos kthejnë kundra tyre ato shikime shoqëruese miqësore të cilat mund të dëshmojnë në favor të tyre, e jo kundra, Kur'ani i përsërit ato në mënyrën më domethënëse. Madje edhe djajtë mposhten e ikin nga imagjinata që të jenë pa vend këto kërcënime kaq të fuqishme, të ashpra e të përsëritura të Kur'anit. Ai tregon se torturat e Xhehennemit janë thjesht drejtësi për mohuesit të cilët nuk u kushtojnë vëmendje atyre.


Dhe për shembull, duke përsëritur shumë herë tregimet e Musait a.s. të cilat përmbajnë shumë shembuj urtësie dhe dobi si Shkopi i Musait, dhe gjithashtu urtësia në përsëritjen e tregimeve të profetëve, paqja dhe bekimet e Zotit xh.sh. qofshin mbi ta, është që të demonstrojë se profetësitë e të gjithë profetëve të tyre janë një provë e profetësisë së Muhammedit a.s.m.. Në përputhje me urtësinë e pamohueshme të pikëpamjes së realitetit të profetësisë së këtij Personaliteti, dhe meqenëse jo gjithkush ka gjithmonë kohë apo aftësi për të lexuar gjithë Kur'anin, ashtu si shtyllat e rëndësishme të besimit, ai i përsërit ato tregime me qëllim që t'i bëjë të gjitha suret e gjata dhe

ato me gjatësi mesatare, secilën si një Kur'an të vogël. T'i përsërisësh ato nuk është tepri, por në të vërtetë, ajo kërkohet nga elokuenca, dhe jep mësim se ngjarja e shfaqjes së Muhammedit a.s.m. është ngjarja më e madhe e njerëzimit dhe çështja më e rëndësishme e universit.

Është treguar në mënyrë vendimtare në Risale-i Nur e me prova e tregues të shumtë se përmes dhënies së pozitës më të lartë Personit të profetit Muhammed a.s.m. në Kur'an, dhe duke e bërë مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللهِ "*Muhammedun resulull-llah," Muhammedi është i dërguari i Tij*- i cili përmban katër nga shtyllat e besimit të shoqëruara me لَآ اِلٰهَ اِلَّا اللهُ *"Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut*," se profetësia e Muhammedit a.s.m. është e vërteta më e madhe në univers, se Personi i Muhammedit a.s.m. është më i nderuari i krijesave dhe personaliteti i tij universal kolektiv dhe rangu i tij i shenjtë i njohur si e vërteta Muhammedane është dielli më rrezatues i dy botëve, dhe vlera e tij për këtë pozitë të jashtëzakonshme është provuar gjithashtu. Njëra nga mijëra provat është kjo. Sipas parimit, اَلسَّبَبُ كَالْفَاعِلِ *"Shkaku është si vepruesi"* me barasvlerën e të gjitha veprave të mira të kryera nga i gjithë komuniteti i tij në të gjitha kohët duke hyrë në librin e tij të punëve të mira, drita që ai solli duke ndriçuar të gjitha të vërtetat e kozmosit; kënaqësia që ai u jep jo vetëm xhindeve, njerëzve, melekëve dhe gjallesave, por gjithashtu edhe universit, qiejve e tokës; dhe lutjet e bimëve të ofruara nga gjuha e prirjes dhe e gatishmërisë së gjendjeve të tyre, dhe lutjet e kafshëve të ofruara nëpërmjet gjuhës së nevojës së tyre të natyrshme; dhe komuniteti i drejtë i atij personaliteti duke i çuar atij *salavate* e duke bërë prej lutjeve të mëshirës me salat e selam, dhe përfitime shpirtërore të milionave –dhe së bashku me qëniet shpirtërore e madje miliardat– nga lutjet e pamohueshme janë pranuar, siç dëshmojmë aktualisht me sytë tonë; dhe meqenëse secila nga shkronjat e Kur'anit –që i kalojnë të treqindmijët– fitojnë nga dhjetë, njëqind deri në njëmijë mirësi e fruta prej dritave të pafundme, duke hyrë në librin e veprave të tij vetëm me recitimin e Kur'anit nga i gjithë komuniteti i tij, Dituria e të Gjithëditurit të Vetëm i së Padukshmes parapriu dhe shikoi se realiteti Muhammedan i cili është një personalitet shpirtëror kolektiv, në të ardhmen do të ishte si Pema Tuba e Parajsës. Ishte në përputhje me pozitën që Ai i dha atij një rëndësi të tillë të madhe në Kur'an, dhe në dekretet e Tij tregoi se

arritja e ndërmjetësimit të tij –*shefa'atit*– do të jetë vetëm duke ndjekur e aderuar tek Sunneti i tij i nderuar që është çështja më e rëndësishme që lidhet me njeriun. Dhe nga koha në kohë ai mori në konsideratë personalitetin e tij njerëzor dhe gjendjen njerëzore në jetën e tij të hershme, e cila ishte si bërthama e Pemës madhështore të Tubasë.

Kështu, meqenëse të vërtetat e përsëritura në Kur'an janë të kësaj vlere, të gjitha natyrat e shëndosha do ta dëshmonin se, në përsëritjet në Kur'an, është një mrekulli shpirtërore e fuqishme dhe e gjërë; veçse në qoftë se një person është goditur nga një sëmundje e zemrës dhe nga një sëmundje e ndërgjegjjes për shkak të plagëve të materializmit dhe që përfshihet nën rregullin:



Kur syri është sëmurë dritën s'e duron,
As goja me plagë ujin s'e shijon.

* * *

DY SHTOJCA, TË CILAT FORMOJNË NJË PËRFUNDIM TË KËSAJ ÇËSHTJES SË DHJETË

E para: Dymbëdhjetë vjet më parë unë dëgjova se një ateist i tmershëm e kryeneç kishte nxitur një komplot kundër Kur'anit nëpërmjet pasjes së tij të përkthyer. Ai tha: "Kur'ani duhet të përkthehet që të njihet se çfarë malli është." Me fjalë të tjera, duke thënë, le të shohë gjithkush përsëritjet e tij të panevojshme dhe le të lexohet përkthimi në vend të tij, ai kurdisi një komplot të tmerrshëm. Megjithatë provat e pamohueshme të Risale-i Nurit provuan në mënyrë vendimtare se *një përkthim i vërtetë i Kur'anit është i pamundur dhe gjuhët e tjera*, përveçse gjuhës së pasur Arabe *nuk mund t'i ruajnë veçoritë e Kur'anit dhe pikat e holla të elokuencës së tij*. Përkthimet e rëndomta e të pjesshme të njeriut kurrë nuk mund të zënë vendin e fjalëve të mrekullueshme të Kur'anit, që çdo shkronjë e të cilit fiton nga dhjetë deri në njëmijë merita; prandaj, leximi i përkthimit nuk mund të bëhet në vend të tij nëpër xhami. Duke u shpërndarë gjithandej Risale-i Nuri e asgjësoi atë komplot të tmershëm. Unë e mora me mend se ai ishte për shkak të përpjekjeve prej idioti e të çmenduri të hipokritëve për të shuar diellin e Kur'anit, për llogari të djallit, duke i fryrë atij si fëmijët idiotë, pasi morën mësim prej atij ateisti; unë u inspirova që ta shkruaj këtë *"çështjen e dhjetë"* ndërsa isha në një ngushticë të madhe dhe në situatën më të dëshpëruar. Por unë nuk e di realitetin e situatës meqë kam qenë i pamundur të takohem me të tjerët.

Shtojca e dytë: Pas lirimit tonë nga burgu i Denizlit, po rrija një ditë në katin e sipërm të hotelit të famshëm "Shehir." Vallëzimi shumë i hollë, i hijshëm e joshës i gjetheve, i degëve, dhe i rrënjëve të shumë plepave në kopshtet e bukur përballë meje, secili në lëvizje të dalldisur e në ekstazë, si një rreth dervishësh, me prekjen e flladit, më lëndoi zemrën time të dëshpëruar e të zymtë për shkak të ndarjes nga vëllezërit e mi dhe që kisha mbetur i vetmuar. Papritmas, më erdhën ndërmend stinët e vjeshtës e të dimrit dhe një pakujdesi më mposhti. Kështu më erdhi aq keq për ato plepa të bukur e për ato krijesa të gjalla që përkundeshin me gaz e hare, saqë m'u mbushën sytë me lot. Me

këtë kujtues të ndarjeve dhe të mosqënies nën perden e zbukuruar të universit, dëshpërimi i botës –i mbushur plot me vdekje e ndarje rëndoi mbi mua. Atëherë, papritmas, Drita të cilën e solli e Vërteta Muhammedane a.s.m. më erdhi në ndihmë dhe i transformoi atë dëshpërim e dhimbje të pafundme në gëzim. Vërtet që i jam përjetësisht mirënjohës Qënies së Muhammedit a.s.m. për ndihmën e ngushëllimin që prekën atë gjendje në atë kohë. Një shembull i vetëm i shkëlqimeve të pafund të asaj Drite ishte shpëtim për mua, për të gjithë besimtarët dhe për gjithkënd. Ajo ishte kështu:

Ai shikim i pavëmendshëm i shfaqi ato krijesa të bekuara e të bukura në atë periudhe kohe të ishin pa funksion e qëllim dhe lëvizjen e tyre të ishte jo nga gëzimi, por sikur ato dridheshin nga mosekzistenca dhe ndarja duke u shkallmuar për tek shuajtja. Ai shikim i shkujdesur më preku aq shumë ndjenjat e dëshirës për qëndrueshmëri të përhershme, për përmallimin ndaj gjërave të mira, për dashurinë e ekzistencës, për dhembshurinë ndaj llojit njerëzor dhe për dashurinë e jetës, saqë ai e transformoi dynjanë në një llojë Ferri shpirtëror dhe mendjen në një instrument torture. Atëherë, mu në atë pikë, Drita që Muhammedi a.s.m. kishte sjellë si dhuratë për njerëzimin, ngriti perden; ajo shfaqi në vend të shuajtjes, mosqënies, asgjësimit, mungesës së qëllimit, kotësisë, përkohshmërisë dhe ndarjes kuptime e shembuj urtësie sa numri i gjetheve të atyre plepave.

Risale-i Nuri ka provuar se rezultatet e detyrat mund të ndahen në tri lloje:

Lloji i parë është i orientuar e shikon tek Emrat e Krijuesit të Gjithëlavdishëm. Ashtu si një mjeshtër i aftë, i cili në qoftë se prodhon një makineri të çuditshme do të duartrokitej e vlerësohej nga të gjithë për shpikjen e tij dhe do të thonin për të ***Masha'All-llah, Barekall-llah,*** po ashtu ajo makineri me rolin e saj e përshëndet mjeshtrin e saj dhe e lavdëron atë nëpërmjet gjuhës së gjendjes së saj, e duke shfaqur në mënyrë perfekte rezultatet e synuara prej saj. Të gjitha qëniet e gjalla dhe të gjitha gjërat janë makineri të tilla si ajo; ato duartrokasin Mjeshtrin e tyre përmes lavdërimeve të tyre.

Lloji i dytë i shembujve të urtësisë orientohet për tek shikimet e gjallesave dhe të qënieve të vetëdijshme. Secila nga qëniet bëhet një objekt i këndshëm studimi e libër njohurie. Ato i kanë kuptimet e tyre në sferën e ekzistencës në mendjet e qënieve të vetëdijshme, format e

tyre i kanë në memoriet e tyre, tek tablotë në Botën e Shëmbëllesës dhe në regjistrat e Botës së Padukshme. Atëherë, ato lënë botën e dukshme e tërhiqen për te bota e padukshme. Domethënë ato lënë ekzistencën e dukshme dhe fitojnë shumë ekzistenca që i përkasin kuptimit të së padukshmes dhe njohurisë.

Po, meqenëse All-llahu xh.sh. ekziston dhe dituria e Tij përfshin e rrethon gjithçka, atëherë në pikëpamjen e realitetit, në botën e besimtarëve, sigurisht nuk ndodhen mosqënie, shuarje, asgjë, asgjësim dhe përkohshmëri. Ndërsa bota e jobesimtarëve është plotë mos-ekzistencë, ndarje, asgjësim e përkohshmëri. Thënia në gjuhën e gjithësecilit:

"Për ata të cilët Allahu ekziston, gjithçka ekziston, ndërsa për ata që Allahu nuk ekziston, për ta nuk ekziston asgjë**,"** e sqaron këtë fakt.

Përmbledhja: Besimi ashtu siç e shpëton njeriun nga asgjësimi i përhershëm në kohën e vdekjes, gjithashtu ai shpëton botën private të gjithësecilit nga errësira e asgjësimit dhe e asgjësë. Ndërsa mosbesimi, dhe sidomos në qoftë se ai është mosbesim absolut, me vdekjen e çon njeriun dhe botën e tij private në mosekzistencë, dhe e flak atë në Ferr – si errësirë. Ai i transformon kënaqësitë e jetës në dhimbje e helme të ashpra.

Le të kumbojnë veshët e atyre që preferojnë jetën e kësaj bote mbi atë të Ahiretit! Le të vijnë ata e të gjejnë një zgjidhje për këtë, ose le të hyjnë në besim e të shpëtojnë veten e tyre nga kjo humbje e tmerrshme!...

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. vërtet që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti"[208]

Nga vëllai juaj që ka shumë nevojë për duatë tuaja dhe që ju do juve jashtë mase

Said Nursi

[208] Kur'an, 2:32

LETRA E NËNTËMBËDHJETË

Kjo trajtesë përshkruan më shumë se treqind mrekulli. Dhe ndërsa përshkruan profetësinë e Muhammedit a.s.m., ajo është një keramet në tre ose në katër aspekte, të cilat burojnë nga mrekullia e profetësisë së Tij.

• *I PARI:* Megjithëse është më shumë se njëqind faqe për së gjati dhe bazohet mbi hadithe e tregime, kjo u shkrua në një mënyrë të jashtëzakonshme në male e në kopsht duke u mbështetur krejtësisht në memorie e pa iu referuar ndonjë libri. Për më tepër, kjo u plotësua për afro katër ditë duke punuar dy a tre orë në çdo ditë dhe u realizua për dymbëdhjetë orë gjithësej.

• *I DYTI:* Pavarësisht nga gjatësia që ka, kjo punë nuk i shkaktoi mërzi shkruesit të saj dhe as mungesë kënaqësie lexuesit të saj. Në fakt kjo nxiti një zjarr dhe entuziazëm të tillë pikërisht tek shkruesit tanë, të cilëve u mungonin ato ndjenja në këto kohë të vështira e pikëlluese, saqë brenda një viti në këtë rrethinë u shkruan me dorë shtatëdhjetë kopje. Ata që ishin të vetëdijshëm për cilësinë e trajtesës dolën me përfundimin se kjo vepër ishte një keramet -provë, ndodhi e jashtëzakonshme- që buroi nga mrekullia e profetësisë së Muhammedit a.s.m..

• *I TRETI:* Në kopjet e shkruara me dorë nga tetë shkrues të ndryshëm të cilët nuk patën komunikim me njëri-tjetrin, duke përfshirë midis tyre njërin i cili ishte shumë i papërvojë e i pavetëdijshëm për *Tevaffuk* -koinçidencën-[209], po kështu ishte edhe përpara se ne të bëheshim të vetëdijshëm për fenomenin, fjalët që i referoheshin Profetit të Nderuar a.s.m. përkonin e 'koinçidonin' në një shkallë të tillë gjatë gjithë trajtesës; po ashtu edhe në pjesën e pestë tek fjalët që i referoheshin Kur'anit, saqë ndonjë i cili është i drejtë e i paanshëm në shkallën më të vogël, nuk do ta gjykonte këtë si rezultat të rastësisë. Në fakt, cilido që do ta shikonte këtë, pa dyshim do të përfundonte me mendimin se ky ishte një mister që lidhet me të Padukshmen dhe një keramet që buron nga mrekullia e Muhammedit a.s.m..

Parimet e shpjeguara në fillim të kësaj trajtese kanë një rëndësi shumë të madhe. Sa për hadithet Profetike që u përmendën, ato pranohen si autentike, të sakta, nga autoritetet e hadithit dhe ato hadithe raportojnë fenomenin më të vërtetuar që i përket profetësisë së Muhammedit a.s.m.. Tani për të numëruar meritat e kësaj trajtese do të duhej një trajtesë tjetër po kaq e gjatë, prandaj ne u bëjmë ftesë atyre që dëshirojnë, ta lexojnë ketë sikur vetëm një herë...

[209] Tevaffuk (koinçidencë): Korrespondencë e paparamenduar e shkronjave ose fjalëve në rreshta ose në modele në një ose në disa faqe. (Përkthyesi.)

KUJTESË: Në këtë trajtesë unë kam treguar shumë hadithe, pavarësisht se nuk kisha libra për t'iu referuar. Nëse do të ketë ndonjë gabim në shprehjen e haditheve, unë kërkoj që ato të korrigjohen ose të konsiderohen si "Parafraza të hadithit", sepse sipas mendimit dominues, "Të tregosh kuptimin e haditheve është e lejueshme". Domethënë: Tregimtari mund të përmend kuptimin e hadithit në fjalët e Tij. Atëherë duke qenë gjendja kështu, hadithet me ndonjë gabim të mundshëm në shprehje duhet të vlerësohen si parafraza.

MREKULLITË E MUHAMMEDIT

Alejhis-salatu ves-selam



deri në fund të sures...

"Me Emrin e Atij të Cilit i takon lavdërimi. Dhe s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij."[210]

Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

Ai është i Cili ka çuar të Dërguarin e Tij (Muhammedin a.s.m.) me udhëzimin dhe Fenë e Vërtetë, që Ai ta shpallë e ta bëjë atë përmbi të gjitha fetë. Dhe i Gjithëmjaftueshëm është All-llahu si Dëshmues. Muhammedi a.s.m. është i Dërguari i All-llahut... deri në fund të versetit.

[Meqenëse "Fjala e Nëntëmbëdhjetë" dhe "Fjala e Tridhjetë e Një" flasin për profetësinë e Muhammedit a.s.m. duke e provuar atë me dëshmi vendimtare, ne ua lëmë atyre Fjalëve verifikimin e atij subjekti dhe, si shtojcë e tyre, ne do të tregojmë këtu në "Nëntëmbëdhjetë Shenja" disa nga shkreptimat e asaj të vërtete të madhe.]

[210] Kur'an, 17: 44

SHENJA E PARË

Pronari e Padroni i këtij universi sigurisht bën gjithçka me njohuri, vendos çdo punë me urtësi, drejton çdo gjë me gjithëshkim e vëzhgim, trajton gjithçka me gjithëdituri dhe rregullon çdo gjë me qëllim që të shfaqë shembujt e urtësisë dhe qëllimet e dobitë që janë të dukshme në çdo gjë. Atëherë, meqenëse Bërësi e di, natyrisht Ai që di, do të flasë. Meqenëse Ai do të flasë, sigurisht Ai do t'u flasë atyre që kanë vetëdije e mendim dhe atyre që do ta kuptojnë Fjalën e Tij. Meqenëse Ai do t'u flasë atyre që kanë mendim, sigurisht, Ai do t'u flasë njerëzve, natyra dhe vetëdija e të cilëve janë më gjithëpërfshirëset midis qënieve të përgjegjshme. Meqenëse Ai do t'i flasë njerëzimit, sigurisht Ai do t'u flasë atyre që janë më të plotësuarit e këtij lloji dhe atyre që janë më të denjë për t'iu adresuar. Dhe meqenëse Ai do t'u flasë atyre që janë më të plotësuarit e më të vlefshmit për t'iu adresuar, pra atyre që kanë moralin më të lartë dhe atyre që do të drejtojnë humanizmin, atëherë Ai natyrisht do t'i flasë Muhammedit a.s.m. për të cilin, njëlloj si miqtë e armiqtë, dëshmojnë se Ai është njeriu me pozitën më të lartë humane e me moralin më të mirë, të cilin e ndjek një e pesta e njerëzimit, sundimit shpirtëror të të cilit i është nënshtruar gjysma e globit, me rrezatimin e dritës së të cilit është ndriçuar për trembëdhjetë shekuj e ardhmja e njerëzimit, për të cilin bien vazhdimisht në salevate e japin bekime besimtarët, segmentet ndriçuese të humanizmit, duke u lutur për të për lumturi e mëshirë dhe në zemrat e tyre kanë admirim e dashuri për të dhe me të cilin ata ripërtërijnë besimin e besës pesë herë në ditë. Sigurisht Ai do t'i fliste dhe foli me Muhammedin a.s.m.; Ai do ta bënte atë Profet; dhe vërtetë e bëri; Ai do ta bënte atë udhërrëfyes e model për njerëzimin, dhe me të vërtetë e bëri.

* * *

SHENJA E DYTË

Profeti më i Nderuar a.s.m. njoftoi profetësinë e Tij dhe i paraqiti njerëzimit një dekret të tillë si Kur'anin e Iartësisë më të madhe; Ai shfaqi rreth një mijë mrekulli të dukshme sipas dijetarëve e historianëve të vërtetë. Ndodhja e atyre mrekullive, në tërësinë e tyre, është aq e sigurtë sa vetë fakti i deklarimit të profetësisë së Tij. Në realitet, siç tregohet edhe nga fjalët e jobesimtarëve më kryeneçë që citohen në vende të ndryshme të Kur'anit të gjithurtë, madje edhe vetë ata nuk mund ta mohonin ndodhjen e mrekullive të Tij, por vetëm i quajtën ato -ruajna Zot!- magji, me qëllim që të kënaqnin apo të mashtronin ndjekësit e tyre.

Mrekullitë e Muhammedit a.s.m. kanë sigurinë e vërtetimit nga konsensusi i shkallës së njëqindtë. Mrekullia, në vetvete, është konfirmimi nga Krijuesi i kozmosit për shpalljen e profetësisë së Tij. Ajo, mrekullia, ka efektin e fjalëve, صَدَقْتَ *"Ti ke folur të vërtetën!"* Robi im ka folur të vërtetën, prandaj ndiqeni atë! Supozo se ti the në asamblenë e një Sundimtari, ndërsa po vështrohesh nga ana e tij, se "Sundimtari më ka caktuar mua për filan pozitë" dhe, në kohën kur ata të kërkuan provë për pretendimin tënd, fjala "po", "E kam caktuar me atë pozitë" e shfaqur nga sundimtari, do të të mbështeste në mënyrë të mjaftueshme. A nuk është ajo një dëshmi vërtetësie për ty? Po në qoftë se Sundimtari do të ndryshonte praktikën e Tij, qëndrimin dhe ligjet për hir tënd e të lutjes tënde? A nuk do të ishte ky një konfirmim më i fuqishëm dhe më i sigurt për pretendimin tënd se sa fjala "po"?

Në të njëjtën mënyrë, Profeti i Nderuar a.s.m. pretendoi: *"Unë jam i dërguari i Krijuesit të Universit". Prova ime është se Ai do të ndryshojë ligjet e Tij të pathyeshme për hir të kërkesës e lutjes sime. Tani shikoni tek gishtat e mi! Ai u shkakton atyre të shpërthejnë ujë si një burim me pesë rubineta. Shikojeni hënën! Ai e çan atë në dysh me një shenjë të gishtit tim. Vështrojeni atë pemë se si vjen tek unë për të më vërtetuar e për të më dëshmuar. Shikojeni këtë ushqim! Pavarësisht se është mezi i mjaftueshëm për dy ose tre veta, ai ngop dyqind ose treqind njerëz". Dhe kështu me radhë.. Profeti i Nderurar a.s.m. demonstroi me qindra mrekulli të ngjashme me këto.*

Megjithatë, dëshmitë e vërtetësisë së Profetit a.s.m. dhe provat e profetësisë së Tij nuk përkufizohen vetëm në mrekullitë e Tij. Të gjitha veprat e punët e Tij, fjalët e Tij, qëndrimi, sjellja e Tij morale, mënyra, karakteri i Tij dhe paraqitja, të gjitha vërtetojnë seriozitetin e vërtetësinë e Tij. Në të vërtetë, shumë njerëz si Abdullah Ibn Selam, dijetar i shquar i bijve të Israilit, e besoi Profetin e Nderuar a.s.m. vetëm nëpërmjet shikimit dhe tha: ***"Asnjë gënjeshtër nuk mund të fshihet në këtë fytyrë! As mashtrimi nuk gjendet në të!"***

Pavarësisht se shumë studiues të cilët e kanë hulumtuar çështjen si dhe kanë dalë me përfundimin se provat e profetësisë së Muhammedit a.s.m. dhe mrekullitë e Tij numërohen rreth një mijë, megjithatë ndodhen me mijëra e ndoshta me qindra mijëra nga provat e profetësisë së Tij, si dhe qindra e mijëra njerëz me mendime të ndryshme e kanë vërtetuar profetësinë e Tij me qindra mijëra rrugë e mënyra. Vetëm Kur'ani i gjithurtë demonstron një mijë prova të profetësisë së Tij a.s.m., përveç dyzet aspekteve të Tij të mrekullisë.

Meqenëse profetësia është një fenomen i humanizmit dhe se qindra e mijëra individë, të cilët jetuan më parë dhe kaluan, shpallën profetësinë dhe demonstruan mrekulli si prova e konfirmim për to, nuk ka dyshim se profetësia e Muhammedit a.s.m. është më superiorja se e të gjitha të tjerëve, sepse çfarëdo dëshmish, cilësish e atributesh që patën profetët si Musai a.s. dhe Isai (Jezusi) a.s., me të cilat ato njiheshin si profetë dhe ishin mjetet e mesazheve të tyre, ato veçori u poseduan në mënyrën më të plotë e gjithëpërfshirëse nga Muhammedi

a.s.m.. Dhe meqenëse shkaqet dhe mjetet e autoritetit Profetik ishin të pranishme tek Personi i Muhammedit a.s.m. në një mënyrë më të plotë, atëherë padyshim Ky autoritet duhet të gjendej tek Ai më i sigurt se sa autoriteti i të gjithë profetëve të tjerë.

* * *

SHENJA E TRETË

Mrekullitë e Profetit më të Nderuar a.s.m. ishin shumë të larmishme. Meqenëse mesazhi i Tij ishte i përbotshëm e gjithëpërfshirës, ai dallohej me mrekulli që lidheshin gati me të gjitha llojet e krijimit. Ashtu si një toger i lartë i një sundimtari të njohur, i cili duke mbajtur shumë dhurata të çmueshme futet në një qytet ku jetojnë njerëz të ndryshëm, që do t'i bëhej pritja nga përfaqësuesit e çdo grupi të tyre të cilët do të brohoritnin për të e do t'i uronin *"mirëseardhje"* me gjuhën e Tij, *po ashtu, togeri i lartë i Sulltanit të parapërjetësisë e të paspërjetësisë, Muhammedi a.s.m. me ardhjen e të cilit u nderua universi si një i dërguar për banorët e tokës, duke sjellur me vete dritën e së vërtetës dhe dhurata shpirtërore të dërguara nga Krijuesi i universit të cilat lidheshin me të vërtetat e të gjithë universit, me secilën specie të krijimit duke filluar nga uji, shkëmbinjtë, pemët, kafshët e qëniet njerëzore deri tek hëna, dielli e yjet, secila i uroi Atij mirëseardhje dhe brohoriti profetësinë e Tij, gjithësecila në gjuhën e vet e çdonjëra duke mbajtur një nga mrekullitë e Tij.*

Sigurisht do të kërkonte një punë voluminoze për t'i përmendur të gjitha mrekullitë e Tij, por meqenëse dijetarë të përpiktë e verifikues kanë shkruar shumë vëllime në lidhje me provat e profetësisë së Tij, ne këtu shkurtazi do të tregojmë tregues të përgjithshëm të mrekullive të cilat janë të sigurta e të pranuara nga raportime të sakta.

Dëshmitë e profetësisë së Muhammedit a.s.m. ndahen në dy kategori kryesore:

• ***E Para:*** Quhet *"Irhasat"* dhe përfshin ngjarjet e jashtëzakonshme që ndodhën para kohës dhe në kohën e lindjes së Tij..

• ***E dyta:*** Është grupi që i përket të gjitha dëshmive të tjera të profetësisë së Tij dhe përmban dy nënndarje:

E para, janë ato çudira që u shfaqën pas largimit të Tij nga kjo dynja me qëllim që të vërtetojnë e konfirmojnë profetësinë e Tij. *E dyta,* janë ato të shfaqura në periudhën e bekuar të jetës së Tij, dhe kjo gjithashtu ka dy pjesë: *Njëra:* Janë dëshmitë e profetësisë së Tij që u shfaqën në personalitetin e Tij, në qënien e Tij të brendshme e të jashtme, në sjelljen e Tij morale e në plotësimet e Tij. *E dyta:* Janë mrekullitë e shfaquara në botën e jashtme, domethënë në horizont e në gjithësi. Edhe kjo ka dy degë: *Njëra,* janë ato që lidhen me Kur'anin dhe me shpirtësinë. *Tjetra,* janë ato që lidhen me materializmin dhe krijimin. Kjo dega e fundit përsëri ndahet në dy kategori:

Kategoria e parë Janë mrekullitë që u shfaqën gjatë periudhës së misionit të Tij Profetik, ose për të thyer kokëfortësinë e jobesimtarëve, ose për të shtuar besimin e besimtarëve. Kjo kategori ka njëzet lloje të ndryshme të tilla si, çarja më dysh e hënës, vërshimi i ujit nga gishtërinjtë e Tij, ngopja e një numri të madh njerëzish me pak ushqim, folja me pemët, me shkëmbinjtë e me kafshët etj. Secila nga këto lloje ka gjithashtu disa shembuj, dhe kështu ka, në kuptim, fuqinë e vërtetimit me konsensus.

Kategoria e dytë Përfshin ngjarje për të cilat Ai i parashikoi para se ato të ndodhnin nëpërmjet mësimeve të Krijuesit dhe u shfaqën e u bënë realitet ashtu siç Ai i parashikoi. Tani duke filluar me këtë kategorinë e fundit ne do të përmbledhim një listë prej tyre. [211]

* * *

[211] Fatkeqësisht, unë nuk munda t'i shkruaj ashtu siç pata synuar. Unë shkrova ashtu siç m'i diktoi zemra ime, pa zgjedhje dhe nuk munda të përshtatem plotësisht me renditjen e këtij klasifikimi.

SHENJA E KATËRT

Nuk ka limit për njoftimet që dha Profeti Muhammed a.s.m. në lidhje me të Padukshmen nëpërmjet instruktimit të të Gjithëdijturit të Vetëm, Njohësit të së padukshmes. Ne i kemi përmendur llojet e këtyre raportimeve në "Fjalën e Njëzet e Pestë" e cila flet për mrekullinë e Kur'anit ku e shpjeguam dhe e provuam atë. Prandaj, njoftimet që lidhen me të padukshmen rreth kohëve të kaluara, rreth profetëve të mëparshëm, rreth të vërtetave që lidhen me Hyjninë, Universin dhe me botën tjetër, ne ia referojmë asaj fjale (për shpjegimin e tyre). Ndërsa këtu do të tregojmë disa shembuj rreth shumë parashikimeve të Tij të sakta në lidhje me shokët e Tij, familjen e Tij dhe me ummetin -komunitetin- e Tij. Por, së pari, për një kuptim të plotë të temës, ne do të pohojmë e shpjegojmë "*Gjashtë parime*" përmes një parathënieje:

• ***Parimi i Parë:*** Të gjitha gjendjet dhe veprimet e Profetit më të Nderuar a.s.m. dëshmuan vërtetësinë dhe profetësinë e Tij. Por kjo nuk do të thotë se të gjitha gjendjet e veprimet e Tij duhet të jenë mrekulli, sepse Zoti i Gjithëfuqishëm e dërgoi atë në formën e qënies humane me qëllim që Ai të ishte një udhëheqës e drejtues për qëniet njerëzore në çështjet e tyre sociale dhe në veprimet e aktet përmes të cilave ata të arrinin lumturinë në të dyja botët; dhe me qëllim që Ai t'u zbulonte qënieve njerëzore mrekullitë e Artit të Krijuesit xh.sh. dhe Fuqinë e gatshme që përbën themelin e të gjitha ndodhive, që në dukje janë të zakonshme, por në realitet janë mrekulli të Fuqisë Hyjnore. Atëherë, në qoftë se Ai do ta kishte braktisur gjendjen njerëzore në aktet e Tij e të bëhej i jashtëzakonshëm në të gjitha aspektet, Ai nuk do të kishte qenë një udhëheqës, as nuk do t'i kishte mësuar qëniet njerëzore me veprimet, gjendjet dhe me sjelljet e Tij. Prandaj Ai u nderua me mrekullitë me qëllim që të provojë profetësinë e Tij përballë jobesimtarëve kokëfortë dhe, herë pas here kryente mrekulli kur e kërkonte nevoja. Por mrekullitë e Tij asnjëherë nuk ndodhën në një mënyrë të qartë të tillë që ta detyronin gjithësecilin të besonte me dëshirë apo pa dëshirë, sepse në përputhje me qëllimin e provave dhe sprovimeve që njeriu duhet të vuajë, rruga duhet t'i tregohet pa ia hequr dëshirën a vullnetin e tij të lirë. *Dera e mendjes duhet të mbetet e hapur, dhe liria e saj nuk duhet t'i rrëmbehet nga duart. Por në qoftë se mrekullitë do të kishin ndodhur në një mënyrë kaq të dukshme, mendja nuk do të kishte pasur zgjedhje; atëherë Ebu Xhehli do të kishte besuar ashtu siç bëri Ebu Bekri, qymyri do të kishte pasur vlerën e diamantit dhe asnjë qëllim nuk do të kishte mbetur për provimin dhe përgjegjshmërinë.*

Ekziston diçka që të ngjall çudi, ndërsa mijëra njerëz të racave të ndryshme hynë në besim vetëm duke shikuar vetëm njërën nga mrekullitë e Profetit të Nderuar a.s.m., një provë të vetme të profetësisë së Nderuar të Tij, ose një fjalë të Tij, ose thjesht duke parë fytyrën e Tij, kurse disa njerëz fatkëqinj në ditët e sotme pa humbasin rrugën sikur ato mijëra prova të profetësisë se Tij nuk ishin dëshmi të mjaftueshme në një kohë që të gjitha ato na kanë ardhur përmes transmetimeve autentike e me prova të sigurta dhe kanë bërë që mijëra studiues të saktë, mendimtarë e dijetarë të ndryshëm, të pranojnë besimin.

• ***Parimi i Dytë:*** Profeti më i Nderuar a.s.m. ishte një qënie njerëzore; pra Ai veproi si qënie njerëzore. Ai gjithashtu ishte një mesazhier e profet dhe, përsa i përket profetësisë së Tij, Ai ishtë një interpretues e i Dërguar i All-llahut. Profetësia e Tij bazohej në realitetin e shpalljes. Dhe shpallja është dy llojësh:

I Pari: "Është shpallje e qartë". Në këtë rast Profeti Fisnik a.s.m. është thjesht një interpretues e njoftues dhe jo tjetër, duke mos pasur asnjë pjesë a ndërhyrje tek diçka në të. Kur'ani dhe disa hadithe të shenjta përfshihen në këtë lloj shpallje...

I Dyti: "Është shpallje e nënkuptuar". Esenca dhe përmbledhja e saj gjithashtu bazohet në shpallje ose në inspirim, por shpjegimi i saj dhe përshkrimi iu lanë Profetit të Nderuar a.s.m.. Kur shpjegonte e përshkruante një zbulim të tillë, Ai ndonjëherë mbështetej përsëri në shpallje ose në inspirim, ose ndonjëherë e shpjegonte me intuitën e Tij personale a.s.m.. Kur mbështetej tek interpretimi i vet, Ai ose bazohej tek fuqia perceptuese që i ishte dhënë për shkak të misionit Profetik, ose fliste si qënie njerëzore në përputhje me zakonin, traditën dhe nivelin e të kuptuarit të përgjithshëm.

Kështu, jo të gjitha detajet e çdo hadithi duhet domosdoshmërisht të burojnë nga shpallja e pastër, as shenjat e larta të profetësisë nuk duhet të kërkohen në mendime të tilla dhe as veprimet e Tij, ashtu siç kërkohen nga pjesëmarrja e Tij në gjendjen njerëzore, meqë disa të vërteta i zbuloheshin Atij në formë të shkurtuar e abstrakte dhe Ai vetë i përshkruante ato në dritën e intuitës së Tij; prandaj sipas kuptimit të përgjithshëm, metaforat dhe nënkuptimet në përshkrimet e Tij ndonjëherë mund të kenë nevojë për shpjegime, ose madje për interpretime. Në fakt ndodhen disa të vërteta të cilat mendja njerëzore mund t'i kapë vetëm nëpërmjet krahasimit. Për shembull, njëherë në prani të Profetit a.s.m. u dëgjua një zë i lartë. Profeti a.s.m. tha: *"Ky është zëri i një shkëmbi që është rrokullisur për shtatëdhjetë vjet dhe tani ka arritur thellësinë më të ulët të zjarrit (pra në fund të Xhehennemit)"*. Një orë më vonë erdhën lajmet se: "Një burrë, i cili u ishte afruar të shtatëdhjetave të jetës së Tij, kishte vdekur e shkuar në Xhehennem." Kështu, duke shpjeguar ngjarjen, Profeti a.s.m. e kishte sqaruar nëpërmjet një krahasimi elokuent.

• *Parimi Tretë:* Në qoftë se ndonjë hadith i transmetuar është në formën e *Tevattur* ai është i padiskutueshëm. Hadithet *Tevattur*, janë dy llojesh:[212]

I pari: Janë ato raportime rreth të cilave ka një "Konsensus të qartë";

I dyti: Është "Konsensusi në kuptim"; i dyti gjithashtu është dy llojesh:

I pari përfshin hadithet në lidhje me të cilët konsensusi është i nënkuptuar "me heshtje". Për shembull: Në qoftë se një njeri në një komunitet tregon një ngjarje përpara popullit të tij dhe dëgjuesit nuk e kundërshtojnë atë, domethënë ata i përgjigjen atij duke qëndruar në heshtje; kjo nënkupton pranimin e tyre për atë raportim. Në mënyrë të veçantë, në qoftë se ai komunitet është i tillë që nuk do të pranonte ndonjë gabim, që do ta konsideronte çdo gënjeshtër si veprim të dënueshëm, që është i gatshëm të kritikojë dhe, përveç kësaj, tregon një interes në ngjarjen e raportuar, natyrisht heshtja e Atij komuniteti dëshmon fuqishëm për ngjarjen e ndodhur.

Lloji i dytë i "Konsensusit në kuptim" është ai që ndodh kur njerëz të ndryshëm tregojnë një ngjarje të veçantë. Për shembull, "një *okka*[213] ushqim ushqeu dyqind njerëz"; në versione të ndryshme, një njeri e përshkruan në një mënyrë, ndërsa një tjetër e përshkruan në një mënyrë tjetër, por të gjithë pajtohen me unanimitet për ndodhjen e ngjarjes. Kështu, ndodhja e kësaj ngjarjeje të sigurt mbështetet nga "Konsensusi në kuptim" dhe është e sigurt. Ndodhja e saj e vërtetë nuk dëmtohet nga ndryshimet në detaje. Megjithatë, përveç kësaj, ndodhen disa kohë kur një Raportim i dhënë nga një person i vetëm shpreh sigurinë e konsensusit nën rrethana të caktuara. Dhe ndonjëherë ndodh që një Raportim i vetëm shpreh sigurinë kur mbështetet nga dëshmi të tjera të jashtme.

---

[212] *Tevattur*, është lloji i raportimit që është transmetuar nga autoritete të shumta dhe rreth të cilit nuk ka vend për dyshim, domethënë është një raportim për të cilin ka një konsensus mendimi. (Përkthyesi).

[213] një *okka* =1300gr.

Shumica e raportimeve që lidhen me mrekullitë dhe dëshmitë e profetësisë së Profetit më Fisnik a.s.m., të cilat na kanë ardhur, janë ose të kategorisë së "Konsensusit në kuptim", ose të "Konsensusit të nënkuptuar me heshtje". Sa për të tjerat, megjithëse janë njoftime nga një person i vetëm, ato gjithashtu kanë sigurinë e "Konsensusit" meqenëse ato kanë marrë pranimin e autoriteteve shumë të përpikta të hadithit. Midis atyre autoriteteve ishin ato gjeni që u quajtën *"el- Hafidh"* të cilët kishin ngulitur në kujtesë të paktën njëqind mijë hadithe, të cilët për pesëdhjetë vjet e kryenin faljen e namazit të sabahut me avdesin e jacisë dhe që prodhuan gjashtë libra të saktë hadithesh -Kutubus-sitte- të kryesuara nga ato të Buhariut dhe të Muslimit.

Pa dyshim, çdo raportim i shqyrtuar me hollësi e i pranuar nga ata, nuk mund të jetë i pamjaftueshëm për sigurinë e "Konsensusit", sepse ata fituan një familjaritet me hadithet e Profetit Fisnik a.s.m., dhe u bënë aq të lidhur ngushtë me stilin e lartë të Tij dhe me mënyrën, saqë ata mund të dallonin që me shikimin e parë hadithin e rremë *"Meudu"* midis qindra raportimeve dhe e mohonin atë duke thënë: *"Ky nuk mund të jetë hadith Profetik, ai nuk ka fjalët e Tij".* Meqenëse ata ishin të aftë të njihnin cilësinë e çmuar të hadithit, ashtu si një argjendar me përvojë, atëherë nuk kishte mundësi për të ngatërruar ndonjë fjalë tjetër me atë të Profetit. Megjithatë, disa hulumtues e kërkues të tillë si Ibnu el-Xheuzi shkuan në ekstrem në kritikën e tyre duke i vlerësuar shumë hadithe të sakta si të rreme. Prapëseprapë, kjo nuk do të thotë se *"Kuptimi i çdo hadithi të rremë apo meudu është gabim ose fjalë e keqe,"* por ajo do të thotë se *"Vetë fjala nuk është ajo e Profetit Alejhis-salatu ves-selam."*

Pyetje: Cila është dobia e përmendjes së zinxhirit të transmetimit të një hadithi saqë, edhe në qoftë se nuk kërkohet për rastin e një ngjarjeje të mirënjohur, ata thonë: "Filani informoi filanin, etj."?

Përgjigje: Dobitë e Tij janë shumë; dhe njëra dobi është se përmendja e zinxhirit të transmetimit tregon bashkëveprimin e studiuesve të vërtetë të besueshëm e të saktë të hadithit dhe unanimitetin e autoriteteve dalluese, emrat e të cilëve janë përfshirë. Secili prej dijetarëve dhe autoriteteve nënshkroi si të ishte për saktësinë e hadithit dhe vendosi vulën e Tij në të.

Pyetje: Përse nuk u transmetuan ndodhitë e mrekullive nëpërmjet shumë zinxhirëve në formën e 'konsensusit' e me theksim aq të madh, ashtu si ai i urdhëresave themelore të ligjit të shenjtë, sheriatit?..

Përgjigje: Sepse shumica e urdhëresave të sheriatit janë të nevojshme nga shumica e njerëzve në shumicën e kohëve, pasi ato të gjitha janë të aplikueshme si detyra obliguese për të gjithë. Por jo gjithkush ka nevojë të dijë për çdo mrekulli; edhe sikur të kishte nevojë, do të ishte e mjaftueshme për të sikur ta dëgjonte vetëm një herë. Në fakt, është si një lloj obligimi, zbatimi i të cilit nga disa do të shfajësonte të tjerët; është krejtësisht e mjaftueshme për mrekullitë të njihen vetëm prej disave.

Për këtë arsye, edhe në qoftë se ndodhja dhe realiteti i një mrekullie do të ishte dhjetë herë më e sigurt se ndodhja e një urdhëreseje të sheriatit, ajo përsëri do të na vinte ne nëpërmjet një ose dy tregimtarëve, ndërsa urdhëresa do të na transmetohej nga dhjetë ose njëzet persona.

• ***Parimi i katërt:*** Ngjarjet e së ardhmes të cilat i parashikoi Profeti më i Nderuar a.s.m. nuk ishin ngjarje të veçuara. Ai parashikoi ngjarje të përgjithshme që ndodhin vazhdimisht në një mënyrë të veçantë. Domethënë, në çdo raportim të tillë Ai shfaqi një aspekt të ndryshëm të njërit prej disa fenomeneve. Prandaj, është për shkak se kur tregimtari i kombinon këto dy aspekte të ndryshëm, ato mund të duken të papajtueshme me realitetin.

Për shembull, ka tregime të ndryshme që lidhen me Hazreti Mehdiun, secili me detaje e përshkrime të ndryshme. Megjithatë, siç u shpjegua në një degë të *"Fjalës së Njëzet e Katërt"*, Profeti Muhammed a.s.m. dha sihariqet duke u mbështetur në shpallje për një Mehdi,

i cili do të vinte në çdo shekull për ta ruajtur moralin shpirtëror të besimtarëve, që do t'i ndihmonte ata të mos binin në dëshpërim e këputje shprese përballë fatkeqësive e do të bashkonte zemrat e besimtarëve me njerëzit e Ehli-bejtit -familjes së Profetit a.s.m.-, të cilët përbëjnë një zinxhir brilant në botën e Islamit. I ngjashëm me Mehdiun e madh që është premtuar të vijë para kijametit në fund të kohës, një Mehdi nga familja e Profetit a.s.m. ose më shumë, është gjetur në çdo shekull. Në të vërtetë, një nga ata u gjet midis kalifatit Abasid të cilët ishin nga pasardhësit e Ehlibejtit; ai u gjet të kishte veçoritë e Mehdiut të madh.

Në këtë mënyrë, cilësitë e përfaqësuesve të Mehdiut dhe të udhëheqësve shpirtërorë të cilët ishin Mehditë që duhej ta paraprinin Mehdiun e madh dhe ishin shembujt dhe paraprijësit e tij, u ngatërruan me vetë cilësitë e Mehdiut të madh dhe, njoftimet që i përkasin atij u shikuan të papajtueshme me njëra-tjetrën.

لَا يَعْلَمُ الْغَيْبَ إِلَّا اللهُ

• **Parimi i pestë:** Megenëse *"Askujë përveç All-llahut xh.sh. nuk e njeh të padukshmen."* Profeti i Nderuar Muhammed a.s.m. nuk mund ta dinte atë vetë. All-llahu xh.sh. i komunikoi Profetit lajme nga e padukshmja dhe atëherë Ai i bëri ato të njohura. Megenëse Zoti i Gjithëfuqishëm është i Gjithurtë e i Gjithëmëshirshëm, urtësia dhe mëshira e Tij kërkojnë që shumica e çështjeve të së padukshmes të jenë të mbuluara ose të errëta, sepse në këtë botë ngjarjet e papëlqyeshme për qëniet njerëzore janë të shumta. Njohuria e mëparshme e ndodhjes së atyre ngjarjeve do të ishte e dhimbshme.

Për këtë arsye, vdekja dhe ora e caktuar -exheli- është lënë e errët dhe fatkeqësitë që do t'u bien qënieve njerëzore mbeten pas perdes së të padukshmes. Përsëri, si rezultat i urtësisë dhe mëshirës së Tij, Zoti i Gjithëfuqishëm nuk e informoi tërësisht e as në detaje Profetin e Tij a.s.m. rreth ngjarjeve të tmerrshme që do t'u binin Ehlibejtit dhe Sahabëve pas vdekjes së Tij[214], me qëllim që të mos dëmtohej mëshira e Tij tej mase e butë për komunitetin e Tij dhe që të mos dëmtohej dashuria e Tij e fortë për familjen e Tij. Për disa qëllime Hyjnore, Ai i bëri të ditur Atij disa nga këto ngjarje domethënëse, por jo me të gjithë tmerrin e tyre. Sa për ngjarjet e pëlqyeshme, Ai ia komunikoi ato Profetit a.s.m., ndonjëherë në vija të përgjithshme e ndonjëherë në detaje. Dhe Profeti a.s.m., me radhë, ua bëri të ditur shokëve të Tij.

Kështu, ato parashikime na u transmetuan ne në mënyrë të përpiktë nga dijetarët e hadithit të cilët ishin tek lartësia e përkushtimit fetar, tek drejtësia, vërtetësia dhe që i frikësoheshin shumë paralajmërimit të hadithit Profetik,

وَمَنْ كَذَبَ عَلَيَّ مُتَعَمِّدًا فَلْيَتَبَوَّأْ مَقْعَدَهُ مِنَ النَّارِ

"Çfardo që, me paramendim, thotë gënjeshtër në lidhje me mua, duhet të përgatitet për një vend në zjarr."

dhe i frikësoheshin paralajmërimit të vërsetit Kur'anor:

---

[214] Treguesi se All-llahu xh.sh. nuk e njoftoi të Dërguarin e Tij plotësisht rreth pjesëmarrjes së Aishes r.a. në Betejën e Devesë ishte me qëllim që dashuria e tij e thellë dhe dhembshuria ndaj saj të mos lëndoheshin. Ai, në fakt, u tha grave të tij: "Ah sikur ta dija se cila nga ju do të marrë pjesë në atë ngjarje". Më vonë All-llahu xh.sh. e njoftoi në një far mase për çështjen, saqë njëherë i tha Hazreti Aliut r.a.: فَارْفَقْ وَبَلِّغْهَا مَأْمَنَهَا *"Një ngjarje do të ndodhë midis teje dhe Aishes..."*

فَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ كَذَبَ عَلَى اللهِ

"Kush bën atëherë më tepër padrejtësi sesa ai i cili shpif gënjeshtër kundër All-llahut?"

• *Parimi i gjashtë:* Disa cilësi dhe aspekte të Profetit më të Nderuar a.s.m. janë përshkruar në librat e historisë e të biografisë; mirëpo shumica e atyre cilësive lidhen me humanizmin e Tij, pasi në realitet, personaliteti shpirtëror dhe natyra e shenjtë e kësaj qënie të bekuar janë aq të larta e të ndritshme, saqë cilësitë e përshkruara në libra qëndrojnë shumë larg kalibrit të lartë të Tij, sepse sipas rregullit, اَلسَّبَبُ كَالْفَاعِلِ *(sfikafku është si "egzekutori"*, çdo ditë, madje edhe në këtë moment, sasia e adhurimit që kryhet nga i gjithë komuniteti i Tij i shtohet regjistrit të plotësimeve të Profetit a.s.m.. Ai është gjithashtu në çdo ditë objekti i salevateve të panumërta prej komunitetit të Tij të madh. Kjo është përveç qënies së Tij objekti i mëshirës së pakufishme Hyjnore në mënyrë të pafund dhe me një kapacitet të pafund për ta marrë atë. Ai në të vërtetë është rezultati i frutit më të përkryer të universit; është interpretuesi dhe i dashuri i Krijuesit të kozmosit. Pra, natyra e vërtetë e Tij, në tërësinë e saj dhe, e vërteta e të gjitha plotësimeve të tij nuk mund të përfshihen në cilësitë humane të regjistruara në librat e historisë e të biografisë. Sigurisht lartësia e asaj Qënie të bekuar së bashku me Hazreti Xhebrailin dhe Mikailin si dy ndihmësa në anën e Tij në betejën e Bedrit nuk gjendet në formën e një personi duke bërë pazar me një beduin në një vend tregtie për çmimin e një kali e duke sjellur Hudheifen si dëshmitarin e Tij të vetëm.

Me qëllim që të mos bie në gabim, njeriu duhet ta ngrejë kokën përtej cilësive të zakonshme të Profetit që lidhen me pjesëmarrjen e tij në gjendjen njerëzore dhe, në vend të saj, të shikojë natyrën e tij të vërtetë dhe kalibrin e tij brilant që i përket rangut të profetësisë. Përndryshe, njeriu ose do të tregonte mosrespektim, ose do të fuste dyshime tek vetvetja. Kushtoji vëmendje krahasimit të mëposhtëm që ta kuptosh këtë mister.

Supozo se një bërthamë e një peme hurme është vendosur nën dhé, ka nxjerrë filizë dhe është bërë një pemë e madhe prodhuese dhe akoma vazhdon të bëhet më e gjatë e më e gjérë. Ose supozo që veza e një palloi është ngrohur dhe një zog u çel prej saj dhe u bë një pallua i stolisur bukur dhe i praruar kudo me shenjën e Fuqisë dhe akoma po bëhet më i madh dhe më i bukur. Tani, ekzistojnë cilësi, veçori dhe elemente të balancuara me saktësi që i përkasin bërthamës dhe vezës, por nuk janë aq të mëdha e kuptimplote sa e atyre të pemës e të zogut që dalin prej tyre. Kështu, duke përshkruar cilësitë e pemës dhe të zogut së bashku me ato të farës e të vezës, njeriu duhet të drejtojë vëmendjen nga fara për tek pema dhe nga veza për tek zogu me qëllim që mendja e njeriut ta gjejë të pranueshëm përshkrimin. Përndryshe, në qoftë se ti pretendon duke thënë: "Unë kam siguruar mijëra hurma nga ajo farë", ose "kjo vezë është mbreti i të gjithë zogjve që flutürojnë në botën e ajrit", ti do t'i ftoje të tjerët të kundërshtojnë e mohojnë fjalët e tua.

Humanizmi i Profetit më të Nderuar a.s.m. të Zotit xh.sh. mund t'i ngjasojë asaj bërthame ose veze, ndërsa natyra e Tij esenciale e ndriçuar me funksionin e profetësisë i ngjason Pemës Tuba të Parajsës dhe Zogjve të Parajsës. Për më tepër, natyra e Tij esenciale është duke lëvizur vazhdimisht drejt një plotësimi më të madh. Pranday, në kohën kur ti mendon për njeriun që debatoi në treg me një beduin, ti duhet gjithashtu ta drejtosh syrin e përfytyrimit tek ajo qënie brilante e cila duke ngarë *Refrefin (Burakun)*, la prapa Xhebrailin dhe arriti distancën e *Kabe Kavsejnit (dy harqeve)*. Përndryshe, ti ose do të tregosh mosrespekt ndaj Tij, ose do të dështosh për të bindur nefsin tënd urdhërues për të ligë.

* * *

SHENJA E PESTË

Ne do të përmendim në këtë shenjë disa shembuj hadithesh që lidhen me çështjet e së padukshmes:

• Na ka ardhur nëpërmjet një zinxhiri autentik transmetimi i shkallës së "Konsensusit", se Profeti i Nderuar a.s.m. deklaroi nga predikatorja në prani të sahabëve të Tij duke thënë:

اِبْنِي حَسَنٌ هٰذَا سَيِّدٌ سَيُصْلِحُ اللّٰهُ بِهِ بَيْنَ فِئَتَيْنِ عَظِيمَتَيْنِ

"Ky nipi im Hasani është një prijës i njerëzve, me anë të të cilit Allëllahu xh.sh. do të pajtojë dy grupe të mëdhaja".

Dyzet vjet më vonë, kur dy ushtritë e mëdha të Islamit u ndeshën me njëra-tjetrën, Hazreti Hasani, Zoti qoftë i kënaqur me të, bëri paqë me Hazreti Muaviun r.a.. Kështu u provua parashikimi i gjyshit të tij të nderuar, paqa dhe bekimet e Zotit qofshin mbi Të.

• *I dyti*: Sipas një hadithi tjetër autentik, Profeti i Nderuar a.s.m. i tha Hazreti Aliut:

سَتُقَاتِلُ النَّاكِثِينَ وَالْقَاسِطِينَ وَالْمَارِقِينَ

"Ti do të luftosh të pabesët, të drejtët dhe devijuesit,"

duke parashikuar kështu betejat e Devesë, të Siffinit dhe ato të zhvilluara kundër havarixhëve.

• Profeti i tha përsëri Hazreti Aliut kur Aliu po shfaqte dashurinë për Hazreti Zubeirin: *"Ai (Zubeiri) do të luftojë kundra teje, por ky veprimi i tij do të jetë padrejtësi."*

• Profeti gjithashtu u tha grave Tij të pastërta: "Njëra midis jush do të marrë përgjegjësinë e një kryengritjeje; shumë njerëz rreth saj do të vriten;"

وَتَنْبَحُ عَلَيْهَا كِلَابُ الْحَوْأَبِ

"Dhe qentë (e Hauebes) do të lehin rreth saj."

Të gjitha këto hadithe të sakta e autentike janë parashikimet e provuara pas tridhjet viteve të luftërave të Hazreti Aliut kundra Hazreti Aishes, Zubeirit dhe Tal'hasë gjatë luftës së Devesë, kundra Muavijës në Siffin dhe kundra Havarixhëve në Haraura dhe Nehrevan.

• Profeti gjithashtu informoi Hazreti Aliun r.a. rreth *një njeriu i cili do ta lyente mjekrën e Aliut me gjakun e kokës së tij*. Hazreti Aliu e njihte personin; ai ishte Abdurrahman Ibn Mulxhem el-Harixhiu.

• Profeti i Nderuar a.s.m. gjithashtu përmendi një njeri të dalluar me një shenjë të veçantë, Dhul'Thadia, se do të ishte midis të vrarëve të Havarixhëve. Kur personi në fjalë u gjet i vrarë, Hazreti Aliu e tregoi atë si një provë e drejtësisë së kauzës së tij dhe duke njoftuar në të njëjtën kohë mrekullinë e Profetit të Nderuar a.s.m..

• Sipas një hadithi tjetër autentik që tregohet nga Umm Seleme dhe nga të tjerët, Profeti i Nderuar a.s.m. gjithashtu parashikoi se "Hazreti Husejni do të vritej në Taff (Kerbela)."

Pesëdhjetë vjet më vonë ndodhi kjo ngjarje e dhimbshme, e cila e vërtetoi parashikimin Profetik.

• Ai gjithashtu parashikoi në mënyrë të përsëritur se pas kalimit të Tij në botën tjetër, familja e Tij, Ehlibejti, يُلْقَوْنَ قَتْلاً وَتَشْرِيدًا *"do të përballej me vrasje, fatkeqësi, internime dhe dëbime disa herë."* Pikërisht ajo që Ai kishte parashikuar, më vonë u bë realitet.

Në lidhje me këtë, mund të bëhet një ***pyetje*** e rëndësishme:

"Megjithëse Hazreti Aliu, me trimërinë e tij të jashtëzakonshme dhe me njohurinë e tij të thellë, përveç lidhjes farefisnore me Profetin e Nderuar a.s.m., me Profetin e Zotit xh.sh., ishte shumë i merituesheëm për të qenë Kalif, pse nuk i paprinu të tjerët në drejtimin e kalifatit dhe, përse Islami përjetoi një trazirë të tillë gjatë kalifatit të tij?.."

Përgjigje: Një drejtues i madh shpirtëror nga Ehlibejti raportohet të ketë thënë: "Profeti i Nderuar Muhammedi a.s.m. kishte dashur që Hazreti Aliu r.a. të ishte kalif, por Atij i ishte bërë e ditur nga e padukshmja se: *"Vullneti i Zotit të Gjithëfuqishëm ishte ndryshe. Ai, atëherë, e braktisi dëshirën e Tij duke ia dorëzuar vetveten vullnetit të Allt-llahut,"* Një nga arsyet pse vullneti i Zotit ishte ndryshe, mund të ketë qenë se:

Pas kalimit të Profetit të Nderuar a.s.m. nga kjo botë, kur sahabët kishin nevojë më shumë se kurrë për bashkim e unitet, në qoftë se Hazreti Aliu do ta kishte marrë në dorë drejtimin, kjo me shumë mundësi do të kishte shkaktuar tek shumë njerëz e fise tendencën për të konkuruar, për shkak të natyrës së tij të rreptë, të patrembur, asketik, heroik, me një karakter të pavarur dhe të njohur shumë për guximin (siç ishte rasti gjatë kalifatit), këto veçori do të shkaktonin konkurencë e si rredhojë do të rezultonte në përçarje e grupime midis besimtarëve.

Një arsye tjetër e shtyrjes së kalifatit të Hazreti Aliut është siç vijon: Në kohën e kalifatit të tij, komuniteti Musliman i cili ishte zhvilluar me shpejtësi përmes përzierjes së shumë fiseve e popujve të cilët përvetësuan veçori e tipare të tilla që reflektuan opinionet e shtatëdhjetë e tre sekteve për të cilat Profeti i Nderuar Muhammed a.s.m. kishte parathënë e njoftuar se ato do të zhvilloheshin në kohën e vet; atëherë përballë trazirave të tilla dikush ishte i nevojshëm me fuqi të mrekullueshme, me guximin, respektueshmërinë e mendjeprehtësinë e Hazreti Aliut r.a., dhe duhej dikush që të kishte fuqinë e Hashimive e të Ehlibejtit me qëllim që t'i bënte ballë Kryengritjes. Dhe në të vërtetë, ai veproi kështu në mënyrë të përshtatshme me parashikimin e Profetit të Nderuar Muhammed a.s.m. i cili i kishte thënë atij: *"Unë kam luftuar për shpalljen e Kur'anit, kurse ti do të luftosh për shpjegimin e tij!"*

Një arsye tjetër për këtë shtyrje është se pa Hazreti Aliun r.a., pushteti i dynjasë kishte shumë mundësi t'i bënte mbretërit Emevitë që të çudhëzoheshin krejtësisht, por ata duke qenë të përballur me Hazreti Aliun r.a. dhe Ehlibejtin dhe duke iu dashur të shfaqeshin njëlloj me ta dhe, për të ruajtur prestigjin e tyre para muslimanëve, të gjithë udhëheqësit e dinastisë Emevije, edhe në qoftë se jo ata vetë, në çdo ngjarje, për shkak të nxitjeve dhe rekomandimeve në drejtim të ndjekësve dhe të mbështetësve të tyre, punuan me të gjithë fuqinë e tyre për të ruajtur e përhapur të vërtetat e Islamit, të besimit dhe të dekreteve Kur'anore. Kështu, ata prodhuan mijëra interpretues të përpiktë të sheriatit, dijetarë hadithi dhe shenjtorë e studiues të pastër. Po të mos kishte qenë zelli i fortë fetar, shenjtëria dhe virtytshmëria e Aliut dhe e Ehlibejtit, do të kishte qenë e mundur që Emevitët qysh në fillim të ishin çudhëzuar krejtësisht, ashtu siç ndodhi me Abasidët.

Gjithashtu mund të bëhet pyetja: "Përse kalifati Islam nuk qëndroi tek Ehlibejti në një kohë që ata ishin më të merituesheëm e më të përshtatshmit për të?"

Përgjigje: Sundimi i dynjasë është mashtrues, *kurse Ehlibejti është caktuar të ruante dekretet e Kur'anit dhe të vërtetat e Islamit. Me qëllim që të mos mashtrohej nga pushteti, ai që duhej ta mbante atë dhe kalifatin duhej të ishte i pamëkate si një profet ose aq zemërpastër, shpirtëror e jomaterialist ashtu si katër kalifët e lartë, si Umer Ibn Abdul Aziz dhe si Mehdiu i Abasidëve.* Në fakt, kalifati i shtetit Fatimi i cili u ngrit me emrin e Ehlibejtit në Egjipt, sundimi i El-Muvahiddin në Afrikë, dhe shteti i Safavidëve në Iran treguan se sundimi i dynjasë për Ehlibejtin ishte i papërshtatshëm, sepse ai i bëri ata të neglizhonin në detyrën e tyre parësore e cila ishte mbrojtja e fesë dhe shërbimi i Islamit. Nga ana tjetër, kur hoqën dorë nga sundimi i dynjasë, ata në mënyrë të shkëlqyer e shumë të suksesshme i shërbyen Islamit dhe Kur'anit.

Tani shiko! Nga drejtuesit e shenjtërisë të cilët e kanë prejardhjen nga Hazreti Hasani r.a. veçanërisht Katër Drejtuesit shenjtorë dhe mbi të gjithë Abd el-Kadir Gejlani që është Gauth el-A'dham dhe imamët e linjës së Hazreti Hysejnit, sidomos Zejnel'abidin dhe Xha'fer es-Sadik, gjithësecili u bë si një Mehdi shpirtëror; ata larguan padrejtësinë dhe errësirën si dhe shpërndanë dritat e Kur'anit dhe të vërtetat e besimit. Duke vepruar kështu, secili tregoi se ishte një trashëgimtar i vërtetë i paraardhësit të Tij fisnik.

Atëherë mund të pyetet: "Cila është urtësia e konfliktit të përgjakshëm e të tmerrshëm që goditi Islamin e bekuar në periudhën e ndritshme të kalifëve të lartë, pasi nuk ishte e merituershme që ata drejtues shpirtërorë të goditeshin me ato fatkeqësi, dhe çfarë aspekti i Mëshirës Hyjnore është në këtë?"

Përgjigje: *Ashtu si stuhitë e forta me shira në pranverë të cilat lëvizin potencialet e shumëllojshmërisë së bimëve, farërave e pemëve dhe i bëjnë ato të zhvillohen, ku secila lulëzon në mënyrën e saj të veçantë dhe kryen detyrat e brendaqenësishme në natyrën e saj, po kështu konflikti që u ra Sahabëve dhe pasardhësve të tyre lëvizi potencialet e tyre në veprim të cilat ishin të gjitha të ndryshme ashtu si farërat; kjo i nxiti ata duke u thirrur: "Islami është në rrezik! Po bie zjarri, po digjet!"; kjo u futi frikën të gjitha grupeve dhe i bëri ata të nxitojnë për të mbrojtur Islamin. Secili grup sipas aftësisë së tij mori në sup njerën nga detyrat e shumta të Komunitetit Islam dhe luftoi me seriozitetin më të madh. Disa duke punuar për ruajtjen e haditheve Profetike, disa të tjerë për ruajtjen e Sheriatit, disa për ruajtjen e të vërtetave të besimit e kështu me radhë; pra çdo grup mori një detyrë të veçantë. Ata luftuan në zbatimin e detyrave të Islamit. Shumë lule shumëngjyrëshe u çelën. Nëpërmjet stuhisë, farërat u hodhën tek të gjitha qoshet e botës së gjerë të Islamit; gjysma e globit u transformua në lulishte me trëndafila. Por fatkeqësisht, së bashku me trëndafilat u shfaqën në lulishte edhe gjembat e sekteve devijuese.*

Ishte sikur Dora e Fuqisë Hyjnore ta trondiste atë epokë në zemërim, e vërtiti atë me një forcë të madhe dhe entuziazmoi njerëzit e zellit. Nëpërmjet forcës qendërike të asaj levizje, shumë interpretues mendjendritur të ligjit të sheriatit, shkollarë dritëdhënës të hadithit, hafiza të shquar të Kur'anit, udhëheqës shpirtërorë, studiues të talentuar dhe njerëzit e pastërtisë u larguan e u detyruan të emigronin në vendet më të largëta të botës së Islamit. Ajo u ngjall entuziazëm të gjithë njerëzve të Islamit nga lindja në perëndim dhe i zgjoi ata për tek thesaret e Kur'anit. Tani le të kthehemi tek subjekti ynë.

Ka mijëra ngjarje që Profeti i Nderuar a.s.m., Profeti i Zotit xh.sh. i parashikoi dhe ndodhën ashtu siç u parashikuan. Ne këtu do të përmendim vetëm disa nga ato.

Shumica e atyre që do të përmendim janë të pajtueshme me Gjashtë Librat e mirënjohur -Kutubus-sitte- dhe me librat më të saktë të haditheve, e në mënyrë të veçantë me Buhariun dhe Muslimin. Ka një 'Konsensus në kuptim' për sa i përket raportimeve, ndërsa të tjerët, për shkak se janë verifikuar nga studiues të përpiktë, gjithashtu mund të konsiderohen ta kenë këtë sigurí.

• Sipas një rrëfenje autentike e të sigurt, tregohet se Profeti i Nderuar a.s.m. u tha sahabëve të Tij: *"Ju do të jeni fitimtarë kundra të gjithë armiqve tuaj, do të dilni me sukses në pushtimin e Mekës,*

Hajberit, Damaskut, Irakut, Persisë dhe Jeruzalemit dhe do të ndani midis jush thesaret e sundimtarëve të perandorive më të mëdha, fizantinëve dhe persianëve." Ai nuk e tha këtë si hamendje apo si mendim personal; Ai e tha atë ashtu siç e kishte parë dhe, ajo çfarë tha Ai, u bë realitet ashtu siç u parashikua. Kjo ishte pavarësisht nga fakti se në kohën kur bëri parashikime, Ai duhej të emigronte në Medine me një grusht ndjekësish dhe, e gjithë bota duke përfshirë këtu edhe rrethinat e Medinesë ishin armiqësorë ndaj Tij.

• Ai gjithashtu në mënyrë të përsëritur deklaroi sipas një rrëfenje autentike e të sigurt:

عَلَيْكُمْ بِسِيرَةِ الَّذَيْنِ مِنْ بَعْدِيْ اَبِي بَكْرٍ وَعُمَرَ

"Ju dialet të ndiqni rrugën e atyre që vijnë pas meje, të Ebu Bekrit dhe Umerit."

Me këtë Ai tregoi se Ebu Bekri dhe Umeri do të jetonin pas Tij, se ata të dy do të ishin kalifë dhe do ta drejtonin Kalifatin në një mënyrë që do të kënaqte Zotin xh.sh. dhe Profetin dhe, se Ebu Bekri do ta drejtonte Kalifatin për një afat të shkurtër, ndërsa Umeri do ta drejtonte atë për një periudhë më të gjatë dhe do të kishte sukses në shumë pushtime.

• Gjithashtu Ai deklaroi duke thënë:

زُوِيَتْ لِيَ الْاَرْضُ فَاُرِيْتُ مَشَارِقَهَا وَمَغَارِبَهَا وَسَيَبْلُغُ مُلْكُ
اُمَّتِيْ مَا زُوِيَ لِيْ مِنْهَا

"Toka u shtri para meje dhe shkaet e saja perëndimore e lindore m'u shfaqën mua; mbretërimi, sundimi i ummetit tim do të shtrihet më atë që m'u shfaq."

Dhe fjalët e Tij u provuan të vërteta.

• Sipas një rrëfenje të saktë e autentike, përpara luftës së Bedrit, Profeti i tregoi një nga një vendet ku udhëheqësit e Kurejshit do të vriteshin, duke thënë:

هٰذَا مَصْرَعُ اَبِيْ جَهْلٍ هٰذَا مَصْرَعُ عُتْبَةَ هٰذَا مَصْرَعُ اُمَيَّةَ هٰذَا مَصْرَعُ فُلَانٍ وَفُلَانٍ

"Ebu Xhehli do të vritet këtu, Utbe këtu, Umaja këtu, etj.," dhe shtoi: "Unë do ta njoh Ubej ibn Halifën me duart e mia."

Të gjitha parashikimet e Tij u provuan të vërteta.

• Përsëri sipas një rrëfenje autentike e të sigurt, Profeti i njoftoi shokët e Tij rreth Betejës së famshme të Mu'tas afër Damaskut- një distancë prej një udhëtimi njëmujor nga ku Ai ishte- tamam sikur Ai po i shikonte shokët e Tij duke luftuar në betejë dhe tha:

اَخَذَ الرَّايَةَ زَيْدٌ فَاُصِيبَ ثُمَّ اَخَذَهَا اِبْنُ رَوَاحَةَ فَاُصِيبَ ثُمَّ اَخَذَهَا
جَعْفَرُ فَاُصِيبَ ثُمَّ اَخَذَهَا سَيْفٌ مِنْ سُيُوفِ اللّٰهِ

"Zejdi ka marrë flamurin dhe është goditur; tani Ibnu Revaha e ka marrë flamurin dhe u godit; tani Xha'fer e ka marrë flamurin dhe u godit; ndërsa tani, një nga shpatat e Zotit (xh.sh. dhe th. Halidi) e ka marrë atë".

Dy a tre javë më vonë Jaë'la Ibn Muneb'bih u kthye nga fusha e betejës, dhe në praninë e tij Profeti i Nderuar a.s.m. përshkroi detajet e betejës, dhe ndërkohë Ja'la u betua në Zotin se: *"Çfarë kishte ndodhur në betejë ishte tamam siç e kishte parashikuar Profeti i Nderuar Muhammed* a.s.m.*."*

• Sipas një hadithi të saktë e autentik, Profeti i Nderuar a.s.m. tha:

إِنَّ الْخِلَافَةَ بَعْدِي ثَلَاثُونَ سَنَةً ثُمَّ تَكُونُ مُلْكًا عَضُوضًا
وَإِنَّ هٰذَا الْأَمْرَ بَدَأَ نُبُوَّةً وَرَحْمَةً ثُمَّ يَكُونُ رَحْمَةً وَخِلَافَةً ثُمَّ يَكُونُ
مُلْكًا عَضُوضًا ثُمَّ يَكُونُ عُتُوًّا وَجَبَرُوتًا

"Pas meje, Kalifati do të zgjasë tridhjetë vjet, atëherë do të jetë një mbretëri lakmitare." "Fillimi i kësaj çështje është profetësi e mëshirë, atëherë do të jetë mëshirë e Kalifat, pastaj ajo do të jetë mbretëri lakmitare, dhe më vonë do të jetë arrogancë e tiranë."

Ai kështu parashikoi periudhën e kalifatit të katër kalifëve dhe plotësimin e kësaj periudhe me gjashtë muajt e kalifatit që drejtoi Hazreti Hasani, dhe në vazhdim do të ishte kalimi i kalifatit në monarki, dhe monarkia do të rrethohej, rrënohej e brehej nga intrigat e tirania. Dhe në të vërtetë u bë realitet tamam ajo që u parashikua.

• Përsëri sipas një rrëfenje autentike, Ai deklaroi:

يُقْتَلُ عُثْمَانُ وَهُوَ يَقْرَأُ الْمُصْحَفَ وَإِنَّ اللّٰهَ عَسَى أَنْ يُلْبِسَهُ قَمِيصًا وَإِنَّهُمْ يُرِيدُونَ خَلْعَهُ

"Osmani do të vritet ndërsa do të jetë duke lexuar Kur'an." "Dhe ka të ngjarë se Zoti do t'i veshë Atij një këmishë në atë kohë, (do të bëhet Kalif) ndërsa ata dëshirojnë t'ia heqin atë. Rrëzimi i tij gjithashtu mund të kërkohet."

Këto ngjarje gjithashtu ndodhën të gjitha tamam siç u parashikuan.

• Gjithashtu sipas një rrëfenje autentike, "Ndërsa Profeti i Nderuar a.s.m. po vendoste kupa, Abdullah ibn Zubejr shijoi nga gjaku i Tij i bekuar. Atëherë Profeti i tha:

وَيْلٌ لِلنَّاسِ مِنْكَ وَوَيْلٌ لَكَ مِنَ النَّاسِ

"Mjerë njerëzit prej teje dhe i mjerë ti prej njerëzve."

duke parashikuar se Abdullahi do t'i udhëhiqte muslimanët me një trimëri të jashtëzakonshme, dhe për shkak të tij do t'u binin njerëzve fatkeqësi të llahtarshme. Ajo çfarë parashikoi, ndodhi tamam: Gjatë sundimit të Emevive, Zubejri shpalli kalifatin e tij në Mekë, luftoi heroikisht në shumë beteja derisa në fund zullumqari Haxh-xhaxh e sulmoi atë me një forcë të madhe dhe, duke vazhduar një betejë të rreptë, heroi i shquar u martirizua.

• Përsëri sipas një rrëfenje autentike, Profeti i Nderuar a.s.m. parashikoi vecoritë e dinastisë Emevite dhe sundimin tiranik të shumë mbretërve të saj, duke përfshirë Jezidin, Velidin e Hazreti Muaviun, që do të merrnin drejtimin e muslimanëve. Ai kështilloi drejtësi e urtësi dhe tha:

وَإِذَا مَلَكْتَ فَاسْجِحْ

Kur të drejtosh, vepro me vetëpërmbajtje."

Ai parashikoi se dinastia Abaside do të shfaqej pas Emevitëve për të qëndruar në fuqi për një kohë të gjatë dhe tha:

يَخْرُجُ وَلَدُ الْعَبَّاسِ بِالرَّايَاتِ السُّودِ وَيَمْلِكُونَ اَضْعَافَ مَامَلَكُوا

"Do të shfaqet shteti Abasid dhe do të vazhdojë sundimin për një kohë të gjatë." Të gjitha parashikimet u bënë realitet.

• Sipas një rrëfenje autentike, Profeti i Nderuar a.s.m. gjithashtu tha:

وَيْلٌ لِلْعَرَبِ مِنْ شَرٍّ قَدِ اقْتَرَبَ

"Mjerë arabët për të keqen që është afruar",

duke sugjeruar me këtë turbullirat e konfliktet e tmerrshme që do të shkaktoheshin nga Xhengiz dhe Hulagu dhe shkatërrimin prej tyre të shtetit Abasid. E gjitha kjo u provua e vërtetë.

• Sipas një rrëfenje autentike, kur Sa'ad Ibn Ebi Vek'kas ishte shumë i sëmurë, Profeti i Nderuar a.s.m. i tha:

لَعَلَّكَ تُخَلَّفُ حَتّٰى يَنْفَعَ بِكَ اَقْوَامٌ وَيَسْتَضِرَّ بِكَ اٰخَرُونَ

"Ka të ngjarë që ti do të përmirësohesh e të shpëtosh me qëllim që disa njerëz do të mund të përfitojnë nga ti dhe disa të tjerë do të dëmtohen nga ti",

kështu Ai parashikoi se ai do të bëhëj një komandant i madh që do të arrinte shumë fitore dhe shumë njerëz do të përfitonin prej tij duke hyrë në palën e Islamit. Kurse pushtetet e tyre do të shkatërroheshin prej dorës së tij. Fjalët e Tij u provuan të vërteta; Sa'adi udhëhoqi ushtritë muslimane, shfarosi perandorinë Persiane dhe i bëri shumë popuj të arrinin udhëzimin, rrugën e Islamit.

• Gjithashtu sipas një rrëfenje autentike, Nexhashiu, sundimtari Abisinas, i cili kishte pranuar besimin më herët, vdiq në vitin e shtatë të hixhretit; Profeti i Nderuar a.s.m., Profeti i All-llahut xh.sh. i njoftoi shokët e Tij për këtë. Ai, madje, kreu faljen e xhenazes për të. Një javë më vonë erdhën lajmet duke vërtetuar vdekjen e Nexhashiut pikërisht në të njëjtën ditë ashtu siç pati thënë Profeti.

• Sipas një rrëfenje autentike, kur Profeti a.s.m. ishte me shokët më të afërt në majën e malit të Uhudit (ose të Hirasë), mali nisi të dridhej. Ai i tha:

اُثْبُتْ فَاِنَّمَا عَلَيْكَ نَبِيٌّ وَصِدِّيقٌ وَشَهِيدٌ

"Mos lëviz! Sepse sipër teje është një profet, një i vërtetë dhe një martir".

Duke parashikuar kështu martirizimin e Hazreti Umerit, Osmanit dhe Aliut. Ajo që u tha, gjithashtu u bë realitet.

Toni, o njeri fatkeq e i mjerë që të ka vdekur zemra! Ti ndoshta thua se Muhammedi a.s.m. ishte vetëm një njeri mendjemprehtë dhe i mbyllt syte ndaj Atij dielli të së vërtetës! Nga pesëmbëdhjetë llojet e ndryshme të mrekullive të Tij, ke dëgjuar vetëm një të qindën e

një lloji që lidhet me parashikimet e Tij të cilat kanë sigurinë e 'Konsensusit në Kuptim'. Ti nuk ke dëgjuar veçse një pjesë të vogël që i përket të padukshmes... Atëherë edhe pasi njeriu t'i dëgjojë këto mrekulli thotë për personin e tyre se Ai është një gjeni dhe zbulon të ardhmen me mendjeprehtësinë e Tij ? Supozo se edhe ne thamë ashtu si ti, se ai është një gjeni! A do të mundej një njeri i tillë me mendjemprehtësinë e njëqind gjenive të kishte parë ndonjëherë në mënyrë të gabuar? Ose, a do të mundej që ai ndonjëherë ta kishte poshtëruar veten duke e raportuar atë në mënyrë të padrejtë? A nuk do të ishte marrëzi e idiotizëm të mos u kushtosh vëmendje atyre që parashikon Ky gjeni i qindfishtë në lidhje me lumturinë në të dyja botët?

* * *

SHENJA E GJASHTË

• Sipas një rrëfenje autentike, Profeti i Nderuar a.s.m. i tha Hazreti Fatimesë r.a.:

أَنْتِ أَوَّلُ أَهْلِ بَيْتِي لُحُوقًا بِي

"Ti do të jeshë e para nga familja ime që do të ndërrosh jetë pas meje [pas vdekjes sime]." Gjashtë muaj më vonë ndodhi ajo çfarë Ai tha.

• Dhe Ai gjithashtu i tha Ebu Dherrit:

سَتُخْرَجُ مِنْ هٰذَا وَتَعِيشُ وَحْدَكَ وَتَمُوتُ وَحْدَكَ

"Ti do të dëbohesh prej këtu [Medineje], do të jetosh i vetmuar dhe do të ndërrosh jetë i vetmuar." E gjitha kjo u bë realitet pas njëzet vitesh.

• Një herë Profeti a.s.m. u zgjua në shtëpinë e Umm Haramit (hallës së Enes Ibn Malikut), dhe duke buzëqeshur i tha:

رَأَيْتُ أُمَّتِي يَغْزُونَ فِي الْبَحْرِ كَالْمُلُوكِ عَلَى الْأَسِرَّةِ

"Unë pashë Ummetin (Komunitetin) tim duke bërë luftë në rrugë të Zotit në dete si mbretër të ulur mbi fronë." Umm Harami i tha: "Bëj lutje, o i Dërguari i Zotit xh.sh., që të jem edhe unë me ta." Profeti i tha: *"Ti do të jesh."*

Pas dyzet vjetësh ajo e shoqëroi burrin e saj Ubadeh Ibn Samit në pushtimin e Qipros. Ajo vdiq atje dhe varri i saj që nga ajo kohë vizitohet nga besimtarët. Kështu ajo çfarë parashikoi, u provua e vërtetë.

• Dhe - gjithashtu sipas një rrëfenje autentike - ai deklaroi:

يَخْرُجُ مِنْ ثَقِيفَ كَذَّابٌ وَمُبِيرٌ

"Nga fisi Thakif një gënjeshtar do të pretendojë profetësi, dhe do të shfaqet një tiran i etur për gjak."

Me këtë Ai dha njoftime për Muhtarin e lig, i cili pretendoi profetësi dhe për Haxhxhaxhin Mizor i cili vrau qindra e mijëra njerëz.

• Dhe, sipas një rrëfenje autentike, Ai tha:

سَتُفْتَحُ الْقُسْطَنْطِينِيَّةُ فَنِعْمَ الْأَمِيرُ أَمِيرُهَا وَنِعْمَ الْجَيْشُ جَيْشُهَا

"Stambolli do të pushtohet dhe sa i bekuar është Emiri i saj dhe sa e bekuar është ushtria që do ta pushtojë atë."

Ai kështu dha lajmet se Stambolli do të pushtohej nga duart e muslimanëve dhe se Hazreti Sulltan Mehmet Fatihu (pushtuesi) do të arrinte rangun më të lartë shpirtëror. Parashikimi i Tij përsëri u provua i vërtetë.

• Dhe gjithashtu, sipas një rrëfenje autentike, Ai tha:

إِنَّ الدِّينَ لَوْ كَانَ مَنُوطًا بِالثُّرَيَّا لَنَالَهُ رِجَالٌ مِنْ أَبْنَاءِ فَارِسَ

"Në qoftë se feja do të varej në plejadën (yje), burra nga Persia do ta arrinin atë."

duke treguar se dijetarë të pashoqë dhe shenjtorë, si Ebu Hanifeja do të shfaqeshin nga Irani.

• Përveç kësaj Ai parashikoi Imam Shafijun, duke thënë:

عَالِمُ قُرَيْشٍ يَمْلَأُ طِبَاقَ الْأَرْضِ عِلْمًا

Një dijetar nga Kurejshi do të shfaqet e do ta mbushë tokën me dituri."

• Sipas një rrëfenje autentike, Profeti a.s.m. tha:

سَتَفْتَرِقُ أُمَّتِي ثَلَاثًا وَسَبْعِينَ فِرْقَةً النَّاجِيَةُ وَاحِدَةٌ مِنْهَا
قِيلَ مَنْهُمْ قَالَ مَا أَنَا عَلَيْهِ وَأَصْحَابِي

"Ummeti (komuniteti) im do të ndahet në shtatëdhjetë e tre degëzime (sekte), dhe vetëm njëri prej tyre do ta arrijë shpëtimin." Ai u pyet: *"Kush janë ata që do të shpëtojnë?"* Profeti u përgjigj: *"Janë ata që do të më ndjekin mua dhe shokët e mi," duke kuptuar Ehli-sunneh vel' xhema at.*

• Dhe gjithashtu Ai deklaroi se,

اَلْقَدَرِيَّةُ مَجُوسُ هٰذِهِ الْأُمَّةِ

"Kadentë janë Mexhusët e këtij komuniteti,"

duke parashikuar shfaqjen e sektit *Kaderi* i cili do të ndahej në degëzime të ndryshme dhe do të mohonte kaderin, (caktimin, paracaktimin Hyjnor). Ai gjithashtu parashikoi *Refoztët* të cilët do të prodhonin sekte të ndryshme.

• Dhe -përsëri sipas një rrëfenje autentike- Ai i tha Hazreti Aliut: *"Shembulli yt është si ai i Isait (Jezusit) a.s.; ti do të jesh shkak për shkatërrimin e dy grupeve prej njerëzve; njëri grup për shkak të dashurisë së tepruar, dhe njëri grup për shkak të armiqësisë së tepruar." Krishterët për shkak të dashurisë së tepruar për Isain (Jezusin) kaluan limitet dhe e quajtën atë -ruajna Zot! - 'biri i Zotit', ndërsa çifutët për shkak të armiqësisë së tyre shkuan në një ekstrem tjetër duke mohuar profetësinë dhe virtytin e Tij . E ngjashme me këtë, disa njerëz gjithashtu do të rrezikojnë humbje për shkak të dashurisë së tepruar ndaj teje, dhe tha:*

لَهُمْ نَبْزٌ يُقَالُ لَهُمُ الرَّافِضَةُ

"Disa të tjerë do të jenë tej mase armiqësorë kundra teje. Ata janë Havarixhët dhe përkrahësit ekstremist të Emevitëve, të cilët janë "Nasiba."

Në qoftë se pyetet këtu: Dashuria për Ehlibejtin është urdhër Kur'anor dhe u inkurajua shumë nga vetë Profeti a.s.m.. Atëherë dashuria e Shiitëve mund të shërbejë si një shfajësim për ta meqenëse dashuria e thellë mund t'i ngjasojë dehjes. Përse atëherë Shi'itët dhe veçanërisht Refazitët nuk mund të përfitojnë nga dashuria e tyre, dhe përse dashuria e tyre përshkruhet nga Profeti si e tepruar?

Përgjigjja: Dashuria është dy llojesh:

I Pari është të duash diçka apo dikë për kuptimin që ajo gjë ose ai tregon.

Kjo do të thotë, ta duash Hazreti Aliun, Hasanin, Husejnin dhe Ehlibejtin në Emrin e All-llahut xh.sh. e për hir të Profetit të Tij të Nderuar a.s.m.. Kjo lloj dashurie e shton dashurinë ndaj Profetit të Nderuar a.s.m. dhe bëhet mjet ndërmjetësues për dashurinë e Zotit të Gjithëfuqishëm. Kështu, kjo dashuri është e tejeshme dhe teprimi i saj nuk është i dënueshëm apo agresiv dhe as nuk bën thirrje për qortim e armiqësi ndaj të tjerëve.

Lloji i dytë i dashurisë merr cilësitë si objekt, domethënë është të duash ndonjë gjë apo ndonjë njeri për vetë atë gjë apo për vetë atë njeri. Në të, njeriu nuk mendon për Profetin a.s.m., por la kushton dashurinë Hazreti Aliut për shkak të trimërisë së tij dhe Hazreti Hasanit e Husejnit për shkak të madhështisë së tyre dhe të cilësive të larta, edhe nëse ai nuk e njeh Zotin apo Profetin. Kjo dashuri nuk është një mjet i dashurisë për Zotin xh.sh. e për Profetin e Nderuar a.s.m.; Përveç kësaj, kur është e tepruar, ajo rezulton në qortim e armiqësi për të tjerët, ashtu siç u përmend në hadith. Për shkak të këtij lloji dashurie të tepruar ndaj Hazreti Aliut, disa njerëz e mbajtën vetveten të distancuar nga Hazreti Ebu Bekri dhe Umeri dhe ranë në humbje. Dashuria e tyre negative, në të vërtetë, është burimi i fatkeqësisë.

• Dhe - sipas një rrëfenje autentike- Profeti deklarot:

إِذَا مَشَوُا الْمُطَيْطَاءَ وَخَدَمَتْهُمْ بَنَاتُ فَارِسَ وَالرُّومِ رَدَّ اللهُ
بَأْسَهُمْ بَيْنَهُمْ وَسَلَّطَ شِرَارَهُمْ عَلَى خِيَارِهِمْ

"Kur vajzat e perandorëve t'u shërbejnë ju, atëherë lufta e fatkeqësia do të mbodhim mes jush dhe Zoti xh.sh. do të bëjë të sundojnë të këqinjtë e tyre mbi të mirët!" Pas tridhjet vjetësh parashikimet e Tij u bënë realitet.

• Dhe -përsëri, sipas një rrëfenje autentike, ai deklarot:

وَتُفْتَحُ خَيْبَرُ عَلَى يَدَيْ عَلِيٍّ

"Kështjella e Hajbert do të pushtohet nga duart e Aliut."

Si një mrekulli e profetësisë së Tij dhe përtej parashikimit, ditën e nesërme Hazreti Aliu hoqi portën e kështjellës së Hajberit me duart e tija, e përdori atë si mburojë dhe mori kështjellën. Kur pushtimi u realizua, ai e hodhi portën për tokë; porta ishte aq e madhe sa që tetë burra të fuqishëm, ose sipas një versioni tjetër dyzet vetë u përpoqën ta ngrenin atë nga toka, por nuk munden.

• Gjithashtu Profeti parashikoi betejën e Siffinit ndërmjet Hazreti Aliut dhe Muaviut duke thënë:

لَا تَقُومُ السَّاعَةُ حَتّٰى تَقْتَتِلَ فِئَتَانِ دَعْوَاهُمَا وَاحِدَةٌ

"Ora e fundit nuk do të vijë derisa dy grupe me një pretendim të vetëm të luftojnë njëri-tjetrin."

• Dhe gjithashtu Ai deklaroi:

اِنَّ عَمَّارًا تَقْتُلُهُ الْفِئَةُ الْبَاغِيَةُ

"Një grup rebelësh do të vrasin Ammarin."

Kur Ammari u vra në betejën e Siffinit, Hazreti Aliu e tregoi këtë si provë se përkrahësit e Muaviut ishin rebelë; por Muaviu e interpretoi atë ndryshe, edhe Amr Ibn As gjithashtu tha: *"Rebelët janë vrasësit, e jo të gjithë ne."*

• Dhe gjithashtu Ai tha:

اِنَّ الْفِتَنَ لَا تَظْهَرُ مَا دَامَ عُمَرُ حَيًّا

Sa të jetë gjallë Hazreti Umeri, asnjë kryengritje nuk do të shpërthejë midis jush." Dhe kështu ndodhi.

• Dhe para se të pranonte fenë, Sehl Ibn-Amr njëherë u zu rob në një betejë. Hazreti Umeri i tha Profetit të Nderuar a.s.m.: *"Më lejo t'ia shkul dhëmbët, sepse ai, me fjalim e tij retorike, po nxit Kurejshët dëshpërimi të bëjnë luftë kundra meje."* Profeti i Nderuar a.s.m. iu përgjigj:

وَعَسٰى اَنْ يَقُومَ مَقَامًا يَسُرُّكَ يَا عُمَرُ

"Ka gjasa që ai të marrë një pozitë që do të të kënaqë ty, o Umer."

Në fakt, në kohën kur Profeti i Nderuar a.s.m. u nda nga kjo jetë, vdekja e të Cilit shkaktoi panik e turbullirë, Syhejli me elokuencën e tij të mirënjohur, i qetësoi e i ngushëlloi sahabët në Mekë me një predikim; ndërsa në Medine, Ebu Bekri es-Siddiku -i drejti-, me qëndrueshmërinë e tij të madhe gjithashtu, po jepte një predikim shumë të rëndësishëm për të ngushëlluar Sahabët. Çuditërisht, të dy predikimet i ngjasuan në një far mase njëri-tjetrit përsa i përket përpilimit të tyre.

• Profeti a.s.m. i tha njëherë Surakas:

كَيْفَ بِكَ اِذَا اُلْبِسْتَ سُوَارَيْ كِسْرٰى

"Ti do të veshësh dy byzylykët e Kisras."

Shteti i Kisras u rrëzua gjatë kalifatit të Hazreti Umerit. Kur arritën bizhuteritë e xhevahiret e Kisras, Hazreti Umeri ia veshi ato Surakas, duke thënë

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ الَّذِي سَلَبَهُمَا كِسْرَى وَأَلْبَسَهُمَا سُرَاقَةَ

"Lavdi Zotit xh.sh. që ia hoqi këto Kisras e ia veshi Surakas."

Kjo vërtetoi parashikimin e Profetit.

- Dhe gjithashtu ai tha që:

إِذَا ذَهَبَ كِسْرَى فَلَا كِسْرَى بَعْدَهُ

"Me t'u zhdukur Kisra, Persiani, nuk do të ketë më Kisra pas tij !"

Ngjarja ndodhi ashtu siç e parashikoi.

• Dhe Ai i tha përfaqësuesit të Kisras: *"Kisra tani është vrarë nga i biri i tij Shiroja Parviz."* Kur përfaqësuesi e verifikoi dhe mësoi se ai ishte vrarë pikërisht në atë kohë, atëherë ai përqafoi Islamin. Emri i përfaqësuesit në disa rrëfenja vjen si Firuz.

• Dhe, sipas një rrëfenje autentike Ai përmendi një letër sekrete që Hatib Ibn Balta ia kishte dërguar Kurejshit. Ai dërgoi Hazreti Aliun dhe Mikdadin për ta marrë atë, duke i thënë: *"Ndodhet një person në filan vend duke mbajtur filan letër. Merreni atë dhe silleni këtu"*. Ata shkuan dhe e sollën pikërisht letrën të cilën Ai e kishte përshkruar nga tamam ai vend. Ai e thirri Hatibin dhe e pyeti: *"Pse veprove në këtë mënyrë?"* Hatibi i kërkoi falje dhe profeti e pranoi arsyetimin e tij.

• Dhe, përsëri sipas një rrëfenje autentike në lidhje me Utba Ibn Ebi Lehebin, Profeti bëri lutje:

يَأْكُلُهُ كَلْبٌ اللهِ

"*U ngrëntë (u kafshoftë) ai prej qenve të Zotit xh.sh.",*

duke parashikuar fatin e tmerrshëm të Utbas. Pas një kohe, ndërsa ishte në rrugë për në Jemen, Utba Ibn Leheb u gllabërua nga një luan. Të dyja, mallkimi dhe parashikimi i Profetit a.s.m., u vërtetuan kështu.

• Dhe, transmetohet në një hadith të saktë se, pasi pushtoi Mekkën, Profeti urdhëroi Hazreti Bilall el-Habeshiun të ngjitej lartë në tarracën e Qabes që të bënte thirrjen e Ezanit për falje, ndërkohë Ebu Sufjani, Attab Ibn Asid, dhe Harith Ibn Hisham, të cilët ishin drejtuesit e Kurejshit, po rrinin ulur aty pranë dhe bisedonin. Attabi Tha: *"Sa me fat ishte babai im që nuk qe i pranishëm në këtë moment"*. Harithi tha me përbuzje për Hazreti Bilalin: *"A nuk mundi Muhammedi të gjente dikë tjetër përveç këtij korbi të zi për të kryer detyrën e*

muezinit?" Ebu Sufjani tha: *"Unë kam frikë të them ndonjë gjë, sepse Ai do të njoftohet për çfarëdo që them unë, madje në qoftë se nuk do ta njoftonte atë ndonjë gjë tjetër, shkëmbinjtë e Bathës (emri i vjetër i Mekës) do ta njoftonin Atë".* Në të vërtetë, pak më vonë, Profeti i Nderuar a.s.m. i takoi rastësisht ata dhe u përmendi bisedën e tyre fjalë për fjalë. Ndërkaq pikërisht në atë moment, Attabi dhe Harithi ranë në shehadet, u bënë muslimanë.

Shiko o mohues pa zemër që nuk e njeh Atë! Dy drejtuesit kryeneçë të Kurejshit u bënë besimtarë vetëm nga ky njoftim i vetëm i Tij, që i përket të Padukshmes. Sa e prishur duhet të jetë zemra jote, sepse ti po dëgjon me mijëra mrekulli që kanë sigurinë e "Konsensusit në Kuptim" si ky, ndërsa ti akoma nuk je i kënaqur plotësisht...! Megjithatë le t'i kthehemi subjektit tonë.

• Dhe, sipas një rrëfenje autentike, Abbasi u zu rob nga Sahabët në betejën e Bedrit. Kur ai u pyet për shpërblesën (për lirim), ai u tha se nuk kishte para. Ndërkohë Profeti i Nderuar a.s.m. i tha: *"Ti dhe gruaja jote Umm Fadl e fshehët atë shumë parash* -[duke i dhënë shumën ekzakte]- *në filan vend".* Abbasi e konfirmoi këtë duke thënë: *"Ky ishte një sekret dhe dihej vetëm nga ne të dy".* Atëherë ai u bë musliman.

• Dhe gjithashtu, sipas një rrëfenje autentike, një magjistar i rrezikshëm çifut i quajtur Lebid, njëherë kurdisi një magji të fortë e efektive për të sfilitur e shqetësuar Profetin e Nderuar a.s.m.. Ai mbështolli flokun dhe perin rreth një krehëri, i bëri magji dhe e hodhi në një pus. Profeti i Nderuar a.s.m. u tha shokëve të Tij, duke përfshirë edhe Hazreti Aliun, që të shkonin tek filan pus e ta sillnin magjinë. Ata shkuan dhe e gjetën atë tamam siç u ishte përshkruar. Dhe ndërsa ata e çmbështollën dhe, sa herë që zgjidhnin një nyje, shqetësimi i Profetit të Nderuar a.s.m. pakësohej.

• Dhe, përsëri sipas një rrëfenje autentike, njëherë Profeti i Nderuar a.s.m. dha lajmet e fatit të tmerrshëm të një apostati, felështuesi, të një grupi që përfshinte persona të tillë të rëndësishëm si Ebu Hurejren dhe Hudhejfen, duke thënë:

ضِرْسُ أَحَدِكُمْ فِي النَّارِ أَعْظَمُ مِنْ أُحُدٍ

"Njëri nga ju do të hyjë në zjarr me një dhëmballë më të madhe se Mali i Uhudit".

Ebu Hurejreja transmetoi: "Unë u frikësova, sepse më vonë vetëm dy mbeten nga ai grup, njëri prej të cilëve isha unë. Më në fund, personi tjetër u vra në betejen e Jemames si një nga ndjekësit e Musejlemes". Kështu e vërteta e parashikimit të Profetit u vërtetua.

• Dhe transmetohet përmes një zinxhiri të saktë njoftimesh se Umejri dhe Safvani para se të bëheshin muslimanë, njëherë vendosën të vrisnin Profetin a.s.m. për një shpërblim të mirë që u ishte ofruar. Kur Umejri arriti në Medine me synim që ta vriste Profetin a.s.m.; Profeti i Nderuar a.s.m. e pa dhe e thirri atë dhe duke vendosur dorën e Tij në kraharorin e Umejrit, e njoftoi se çfarë kishte planifikuar ai me Safvanin. Umejri u përgjigj, "Po;" dhe u bë musliman.

Të ngjashme me ato që u përmendën më lartë, shumë parashikime të cilat Profeti i dha në lidhje me të Padukshmen, janë regjistruar në Gjashtë Librat e mirënjohur autentikë të hadithit -Kutubus-sitte-, së bashku me zinxhirët e transmetuesve. Sa për ndodhitë që u përmendën në këtë vepër të Risalein-Nurit, ato janë të sigurta me shkallën e "Konsensusit në kuptim" që transmetohen tek librat e Buhariut e të Muslimit, të cilët pranohen nga dijetarët si burimet më të sigurta pas Kur'anit; gjithashtu ato përmenden tek Koleksionet e tjera si Tirmidhiu, Nesaiu, Ebu Davudi, Mustedrek *el-Ha-kim, Musned el-Ahmed Ibn Hanbel dhe Delail el-Bejhaki.*

Tani o mohues mendjelehtë! Mos i merr këto pa seriozitet, duke thënë: "Muhammedi Arab ishte njeri i zgjuar!," sepse parashikimet e sakta të Profetit Muhammed a.s.m., në lidhje

me të Padukshmen nuk mund të shpjegohen veçse në njërën nga këto dy mënyra: Ti ose do të supozoje se, *"Ky person i bekuar kishte një vizion shpues të tillë dhe ishte një gjeni shumë i madh, i Cili shikoi dhe njohu të shkuarën, të ardhmen dhe të gjithë botën; shikoi tindjen, perëndimin dhe të gjithë universin, dhe zbuloi çfarë ndodhi në të shkuarën dhe çfarë do të ndodhë në të ardhmen; mirëpo një cilësi e tillë nuk mund të gjendet në një qënie njerëzore, por në qoftë se do të gjendej, ajo sigurisht do të ishte një çudi, një dhuratë që iu dha Atij nga Krijuesi i gjithësisë, e cila do të ishte në vetvete më e madhja e mrekullive; ose ti të duhet ta besosh këtë person të bekuar se është një nëpunës e një student i Një të Vetmi, i Cili vëzhgon e drejton çdo gjë, i Cili komandon të gjitha epokat, të gjitha speciet dhe botët e qënieve në Kozmos dhe që në regjistrin e madh të të Cilit është regjistruar çdo gjë. Kështu që, Ai mund t'ia tregojë e t'ia komunikojë ato studentit të Tij kurdo që Ai dëshiron. Prandaj Muhammedi Arab a.s.m. u mëson të tjerëve ashtu siç mësohet Ai vetë nga Zoti i Përjetësisë.*

• Dhe -tregohet në një rrefenjë autentike se- kur Profeti e caktoi Hazreti Halid Ibn Velidin për të bërë luftë kundër Ukajdirit- kryetarit të Daumat el-Xhandal, Ai e informoi Halidin se:

إِنَّكَ تَجِدُهُ يُصَيِّدُ الْبَقَرَ

"Ai do ta gjente Ukajdirin në një gjueti të një bualli të egër dhe, se ai do të kapej rob pa asnjë rezistencë.

Hazreti Halidi e kapi rob Ukajdirin pikërisht kështu".

• Dhe -sipas një Hadithi autentik, kur Kurejshët varën në murin e Qabesë një letër në të cilën ishin shkruar fjalë kundra Beni Hashimit, Profeti u tha atyre që: *"Kjomëbat e kanë ngrënë letrën, përveç fjalëve që përmbajnë Emrat e Allë-llahut xh.sh."* Ata e kontrolluan letrën dhe e gjetën në të njëjtën gjendje siç u ishte përshkruar.

• Dhe -sipas një hadithi autentik- Profeti tha që: *"Do të shfaqet një epidemi e madhe gjatë pushtimit të Bejtul'Makdis (Jerusalemit)."* Kur Jerusalemi u pushtua gjatë Katifatit të Hazreti Umerit, një epidemi e përhapur gjërë shkaktoi për tre ditë vdekjen e shtatëdhjetëmijë njerëzve.

• Dhe, përsëri, sipas një rrëfenje autentike, Profeti parashikoi se Basra dhe Bagdadi do të vinin në ekzistencë, të cilat në atë kohë nuk ishin ndërtuar; parashikoi se thesari i botës do të hynte në Bagdad, se Turqit dhe populli që jetonin në brigjet e Detit Kaspik do të luftonin me Arabët dhe se shumica e tyre, më vonë do të hynin në fenë Islame dhe, se në mesin e Arabëve ata do të vinin e t'i sundonin. Ai tha:

يُوشِكُ أَنْ يَكْثُرَ فِيكُمُ الْعَجَمُ يَأْكُلُونَ فَيْئَكُمْ وَيَضْرِبُونَ رِقَابَكُمْ

"Persianët [joarabët] pothuajse do të mbisundojnë në mesin tuaj, duke konsumuar plaçkat tuaja të luftës e duke ju mafiur juve".

• Ai gjithashtu tha:

هَلَاكُ أُمَّتِي عَلَى يَدِ أُغَيْلِمَةٍ مِنْ قُرَيْشٍ

"Shkatërrimi i Komunitetit tim do të jetë prej duarve të të këqinjve nga Kurejshi," duke sugjeruar turbullirën e shkaktuar nga drejtuesit e këqinj Emevitë, të tillë si Velidi e Jezidi.

• Ai, për më tepër, parashikoi se apostazia -felëshimi- do të ndodhte në treva të tilla si Jemame.

• Dhe gjatë luftës së famshme të Hendekut, Ai deklaroi:

إِنَّ قُرَيْشًا وَالْأَحْزَابَ لَا يَغْزُونِي أَبَدًا وَأَنَا أَغْزُوهُمْ

"Që tani e në vazhdim, unë do të bëj sulme mbi Kurejshët dhe mbi konfederatat e tyre, e jo ata mbi mua!"

Edhe ky paralajmërim gjithashtu u vërtetua.

• Dhe, sipas një Hadithi të saktë, Ai dy muaj para vdekjes së Tij, tha se:

إِنَّ عَبْدًا خُيِّرَ فَاخْتَارَ مَا عِنْدَ اللَّهِ

"Njëmë mufis shërbëtorëve të Zotit i është dhënë dëshira për të zgjedhur dhe ai zgjodhi atë që është me Zotin", kështu e njoftoi vdekjen e vet.

• Dhe rreth Zejd Ibn Suvahanit, Ai tha:

يَسْبِقُ عُضْوٌ مِنْهُ إِلَى الْجَنَّةِ

"Njëra nga gjymtyrët e tij do t'i paraprijë atij në Parajsë."

Ne Betejën e Nihavandit, njëra nga duart e tij iu pre, dhe në të vërtetë shpirtërisht ajo dorë e martirizuar arriti më përpara në Xhennet.

Ngjarjet që kemi përmendur deri tani, të cilat lidhen me të Padukshmen, përfshijnë vetëm njërën nga dhjetë llojet e tij të ndryshme të mrekullisë. Por vetëm nga ky lloj, ne nuk kemi përmendur as një të dhjetën. Përveç asaj që është përmendur këtu, katër lloje të ndryshme mrekullie që lidhen me parashikimet e së Padukshmes janë përshkruar shkurtazi në "Fjalën e Njëzet e Peste", e cila bën fjalë për mrekullinë e Kur'anit. Tani konsideroji llojet e përmendura këtu së bashku me katër llojet e tjera për të cilat Ai bëri parashikime, nëpërmjet gjuhës së Kur'anit, dhe ti do të shikoje se çfarë provash vendimtare, të padiskutueshme, të forta, brilante dhe të qëndrueshme për profetesinë e Tij përbëjnë ato. Në të vërtetë, kushdo që zemra dhe mendja e të cilit nuk janë prishur, do të besonte me siguri, se:

Personaliteti i Muhammedit a.s.m. është Profeti që i bën parashikimet për të padukshmen nga i Gjithëlavdishmi Absolut, Krijuesi i çdo gjëje dhe Njohësi i Vetëm i së Padukshmes dhe prej Atij lajmërohet...

* * *

SHENJA E SHTATË

Ne do të japim në këtë shenjë disa shembuj nga mrekullitë e Profetit a.s.m. që lidhen me **bereqetin, shtimin në efekt të ushqimit të Tij.** Ato janë të sigurta me shkallën e 'Konsensusit në Kuptim'. Por, përpara se të hyjmë në subjekt, një parathënie do të ishte e përshtatshme.

Parathënie

Secili nga **shembujt e mëposhtëm të mrekullive të bereqetit** tregohen nëpërmjet zinxhirëve të ndryshëm autentikë të transmetimit. Një pjesë e këtyre shembujve tregohet nga gjashtëmbëdhjetë mënyra transmetimi. Shumica e tyre u shfaqën në prani të grupeve të mëdha dhe u treguan nga persona të vërtetë të shumtë të mirënjohur e të shquar midis atyre që ishin të pranishëm. Për shembull: Njëri prej tyre tregon: "Shtatëdhjetë burra hëngrën prej një *"saë"* sasie të vogël prej katër grushtash ushqimi dhe u ngopën të gjithë." Kështu, shtatëdhjetë burrat e dëgjojnë këtë rrëfenjë të cilën e tregon njëri prej tyre dhe, ndërkohë ata nuk e kundërshtojnë e nuk e mohojnë. Me fjalë të tjera, ata e konfirmojnë këtë ndodhi me heshtje, sepse në qoftë se në atë epokë të së vërtetës e të realitetit, Sahabët të cilët ishin simpatizantët e së vërtetës, të seriozitetit e të ndershmërisë, po të kishin parë edhe gënjeshtrën më të vogël, padyshim ata do ta kishin refuzuar e mohuar atë. Por ngjarjet që do të përmendim u treguan nga shumë, ndërsa të tjerët që ishin të pranishëm tek ato, i konfirmuan me heshtje. Prandaj, secila nga këto ngjarje ka sigurinë e "Konsensusit në Kuptim".

Për më tepër, si librat e historisë, ashtu edhe librat e biografisë së Profetit të Nderuar a.s.m. dëshmojnë se sahabët, pasi mësuan përmendësh Kur'anin, punuan me të gjithë fuqinë e tyre për të mësuar përmendësh e për të ruajtur hadithet, domethënë, për të mësuar e ruajtur veprat dhe fjalët e Profetit të Nderuar Muhammed a.s.m. dhe veçanërisht ato që lidhen me urdhëresat e Sheriatit ose me mrekullitë, duke i kushtuar vëmendjen më të madhe saktësisë së tyre. Ata kurrë nuk neglizhuan edhe për aspektin më të vogël të jetës së Tij, të veprave dhe të gjendjeve. Ky dhe fakti që ata i regjistruan, dëshmohen nga librat e hadithit.

Përveç kësaj, në epokën e lumturisë ata regjistruan e shënuan shumë nga hadithet që u përkasin rregullave të sheriatit dhe mrekullive të Tij. 'Shtatë Abdullahët' në mënyrë të veçantë i regjistruan ato me shkrim, sidomos Abdull-llah Ibn Abbas i njohur si "Interpretues i Kur'anit" dhe Abdull-llah Ibn Amr Ibn A'si tridhjet apo dyzet vjet më vonë. Dhe me mijëra nga studiuesit e saktë të gjeneratës që vijuan Sahabët regjistruan me shkrim hadithet dhe mrekullitë. Dhe akoma më vonë, kryesisht katër interpretuesit e mëdhenj të sheriatit dhe me mijëra dijetarë të saktë të hadithit i transmetuan dhe i ruajtën me anë të shkrimit e të regjistrimit. Pastaj dyqind vjet pas Hixhretit, autorët e gjashtë librave të saktë të hadithit - Kutubus-sitte-, me në krye Buhariun dhe Muslimin, ndërmorën detyrën e ruajtjes së tyre. Më vonë u shfaqën mijëra kritikë të ashpër, të tillë si Ibn Xheuzi, i cili identifikoi njoftime të rreme, të cilat ishin futur nga mohuesit, mendjelehtët dhe injorantët, tek raportimet e sakta. Pastaj dijetarë të përpiktë e të devotshëm si Xhelalud'din Es-Sujuti, i cili u nderua shtatëdhjetë herë me bisedimin me Profetin e Nderuar a.s.m. që iu shfaq atij në gjendje zgjimi, dalloi diamantet e haditheve të sakta nga fjalët e tjera dhe nga shpikjet.

Kështu ngjarjet dhe mrekullitë që do të flasim, na kanë ardhur nga duar të shumta të besuara e të fuqishme dhe na kanë arritur në gjendje të shëndoshë e të saktë.

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ هَذَا مِنْ فَضْلِ رَبِّي

"E Çfarë lavdie i takon Allë-llahut. Kjo është nga mirësia e Krijuesit tim."

Për këtë arsye; "Mendja e njeriut duhet të çlirohet nga mendimi se mos ndoshta këto ngjarje janë shtrembëruar apo ngatërruar qysh nga ajo kohë deri tek koha e tanishme!" dhe të bindet se këto ngjarje nuk janë shtrembëruar apo ngatërruar nga ajo kohë gjer tek koha e tanishme!"

Mrekullitë e sigurta që lidhen me shtimin e ushqimit;

• ***Shembulli i parë:*** Gjashtë Librat e saktë të hadithit, të kryesuara nga Buhariu dhe Muslimi, tregojnë me unanimitet se gjatë ceremonisë me rastin e martesës së Profetit të Nderuar a.s.m. me Hazreti Zejneben, nëna e Hazreti Enesit, Umm Sulejm, përgatiti duke fërguar në vaj dy grushta hurmash, dhe me anë të Hazreti Enesit ia dërgoi atë Profetit a.s.m.. Ndërkohë Profeti i tha: *"Shko e i bëj ftesë filanit e filanit* [duke cilësuar me emra disa persona] *si dhe fto cilindo që do të takosh rastësisht në rrugën tënde."* Enesi i ftoi ata që u cilësuan me emra dhe ata që takoi në rrugë. Rreth treqind Sahabe erdhën dhe mbushën dhomën (Suffen) dhe paradhomën. Atëherë filloi t'i ftojë ata:

تَحَلَّقُوا عَشَرَةً عَشَرَةً

"Bëhuni dhjetë nga dhjetë në formë rrethi!",

dhe vendosi dorën e Tij të bekuar mbi atë sasi të vogël ushqimi, bëri lutje dhe u tha: "Urdhëroni!". Të gjithë ata treqind njerëz, hëngrën dhe u ngopën. Pastaj i tha Enesit: "Ngrije ushqimin!". Enesi tha: "Unë nuk mund të dalloja se a kishte më shumë ushqim kur unë e vendosa (në fillim), apo kur e ngrita atë (në fund)"

• ***Shembulli i dytë:*** Ebu Ejjub el-Ensari, mikpritësi i Profetit, tregon: Kur Profeti i Nderuar a.s.m. e nderoi shtëpinë e tij, Ebu Ejjubi tha: Kam përgatitur ushqim sa për dy veta, i cili do të mjaftonte për Profetin e Nderuar a.s.m. dhe për Ebu Bekër es-Siddikun. Profeti i tha atij:

اُدْعُ ثَلَاثِينَ مِنْ أَشْرَافِ الْأَنْصَارِ

"Fto treqind burra nga Ensarët e shquar!" Treqind burra erdhën dhe hëngrën. Pastaj i tha:

اُدْعُ سِتِّينَ *"Fto njëqind gjashtëdhjetë burra".* Unë i ftova, edhe ata gjithashtu erdhën dhe hëngrën.

اُدْعُ سَبْعِينَ *"Fto njëqind shtatëdhjetë veta"* Unë i ftova; ata erdhën dhe kur mbaruan së ngrëni, kishte mbetur akoma ushqim në tasa. Të gjithë ata që erdhën përqafuan Islamin dhe bënë betimin e besëlidhjes pasi panë këtë mrekulli. Njëqind e tetëdhjetë burra hëngrën nga ushqimi që ishte përgatitur për dy vetë.

• ***Shembulli i tretë:*** Raportohet përmes shumë zinxhirëve të trans-metimit, nga Hazreti Umer ibn Hattabi, Ebu Hurejreja, Seleme ibn Akva dhe Ebu Amrat el-Ensariu se:

Në një ekspeditë ushtria u bë shumë e uritur. Ata ia përcollën çështjen Profetit të Nderuar a.s.m. dhe ndërkohë Ai u tha atyre:

"Grumbullojeni çfarëdo ushqimi që ka mbetur në duaet (çantat) tuaja!" Gjithësecili solli nga një sasi të vogël hurmash dhe i vendosën në një hasër. Më e shumta që ata grumbulluan së bashku ishte katër grushta hurmash.

Seleme tregon: "Unë e vlerësova sasinë dhe ajo mezi arriti masën e një dhie të gjunjëzuar (të ulur)."

Atëherë Profeti i Nderuar a.s.m. bëri dua për t'u shtuar ushqimi duke thënë:

"Gjithkush të sjellë pjatën e tij!"

Ata vrapuan me shpejtësi dhe erdhën. Asnjë enë nuk mbeti pa u mbushur dhe madje një sasi teproi.

Një transmetues Sahabi ka thënë:

"Unë kuptova nga rrjedha e shtimit të këtij bereqeti se sikur të vinte e gjithë bota, ushqimi do të kishte qenë i mjaftueshëm edhe për ata..."

• ***Shembulli i katërt:*** Me në krye Buhariun dhe Muslimin, librat e saktë sqarojnë se Abdur-Rahman Ibn Ebu Bekër es-Siddik, thotë: "Ne, njëqind e tridhjetë Sahabët ishim me Profetin e Nderuar a.s.m. në një ekspeditë. Brumi i bukës ishte përgatitur për një sasi rreth një *Saë* që përbëhet nga katër grushta, u sakrifikua një dhi e u poq. Vetëm mëlçitë dhe veshkat u bënë qofte. Dhe betohem në Zotin se, nga ai mish i pjekur (mëlçitë e veshkat) iu dha nga një copë e vogël gjithësecilit. Mandej Profeti i Nderuar a.s.m. e vuri mishin e pjekur në dy tasa. Pasi ne të gjithë kishim ngrënë e ishim ngopur, kishte mbetur akoma prej atij ushqimi. Ushqimin që teproi e ngarkova mbi deve."

• ***Shembulli i pestë:*** Siç shënohet në librat e saktë të haditheve, Hazreti Xhabir El-Ensari duke u betuar, tregon: "Gjatë ekspeditës Ahzab, në ditën e shquar të Hendekut, ndonëse njëmijë njerëz hëngrën prej një peshe sa (një *Saë*) buke thekri dhe një keci të pjekur, prapëseprapë ushqimi teproi. Hazreti Xhabiri thotë: "Atë ditë ushqimi ishte gatuar në shtëpinë time dhe, pasi ishin larguar një mijë njerëzit, tenxhereja akoma po ziente me mish në të dhe buka po bëhej nga brumi; sepse Profeti e kishte lagur brumin dhe tenxheren me ujin e gojës së Tij të bekuar duke u lutur për bereqet -bollëk."

Kështu, Xhabiri, duke u betuar në Zotin xh.sh., e njofton mrekullinë e bereqetit në prani të njëmijë Sahabëve duke shfaqur lidhjen e tyre me të. Domethënë kjo ndodhi është e sigurtë sikur ta transmetonin një mijë burra.

• ***Shembulli i gjashtë:*** Sipas një rrëfenje autentike nga i famshmi Ebu Talha, xhaxhai i Hazreti Enesit, i cili i kishte shërbyer Profetit, thuhet se: Profeti i Nderuar a.s.m. ushqeu shtatëdhjetë-tetëdhjetë njerëz me një sasi të vogël buke thekri që Enesi e kishte sjellur nën krahun e tij. "*Thyejeni bukën në copa të vogla*!", urdhëroi ai dhe u lut për bereqet për shtim. Meqë shtëpia ishte e ngushtë, ata vinin dhjetë e nga dhjetë dhe shkonin duke qenë të ngopur."

• ***Shembulli i shtatë:*** Tregohet si autentike në librat e saktë të tillë, si: Shifa el-Sherif dhe Muslimi, se Hazreti Xhabir el-Ensari ka thënë: Njëherë një njeri i kërkoi Profetit të Nderuar a.s.m. ushqim për familjen e tij. Profeti i Nderuar a.s.m. i dha atij një gjysëm peshe elbi. Për një kohë të gjatë, ai hëngri nga elbi së bashku me familjen e tij dhe me miqtë. Ata shikojnë se ushqimi nuk kishte mbaruar dhe, ndërkohë ata e peshuan atë për të parë se sa shumë ishte pakësuar. Pas asaj, bekimi i bereqetit ishte larguar dhe elbi nisi të pakësohej me shpejtësi. Ndërkaq personi në fjalë shkoi tek Profeti i Nderuar a.s.m. dhe i tregoi çfarë kishte ndodhur. Ai iu përgjigj dhe i tha:

لَوْلَوْ تَكَلَّهُ لَأَكَلْتُمْ مِنْهُ وَلَقَامَ بِكُمْ Domethënë: *"Në qoftë se ti nuk do ta kisha pesëluar, ai bukim do t'u mjaftonte për të gjithë jetën."*

• ***Shembulli i tetë:*** Sipas librave të saktë të tillë si Tirmidhi, Nesa'i, Bejhakiu, dhe Shifa el-Sherif, Samura Ibn Xhundub thotë: "Profetit të Nderuar a.s.m. iu soll një enë në të cilën kishte mish. Nga mëngjesi gjer në mbrëmje erdhën shumë grupe njerëzish dhe hëngrën prej tij."

Në përputhje me shpjegimin që ne dhamë në parathënien e kësaj pjese për bereqetin, Ky nuk është vetëm tregimi i Samures, por Samure ishte si përfaqësuesi i atyre grupeve të cilët hëngrën prej atij ushqimi dhe ai e raportoi këtë rrëfenjë në vend të tyre.

• ***Shembulli i nëntë:*** Tregohet gjithashtu nga studiues të besueshëm të tillë si autori i mirënjohur i Shifa el-Sherif, i famshmi Ibn Ebi Shejba dhe Tabarani, se Hazreti Ebu-Hurejreja thotë: *Profeti i Nderuar a.s.m. më urdhëroi, që t'u bëja ftesë As'habu el-Suf'fa, mërgimtarëve të varfër Mekkas*, të cilët e kanë bërë vendin jashtë xhamisë si shtëpinë e tyre, dhe të cilët numërohen më shumë se njëqind. Kështu unë shkova, i kërkova dhe i tubova së bashku. Një tabaka me ushqim u vendos përpara nesh dhe ne hëngrëm aq sa deshëm. Atëherë ne u ngritëm, pjata mbeti plot ashtu siç ishte kur u vendos në fillim, vetëm shenjat e gishtave ishin të dukshëm në ushqim.

Kështu kjo ngjarje transmetohet nga Hazreti Ebu Hurejreja në emrin e të gjithë njerëzve të Suffasë e që mbështetet nga konfirmimi i tyre. Prandaj ngjarja është aq e sigurtë tamam sikur ta kishin transmetuar të gjithë njerëzit e Suffas. A do të ishte e mundur, në qoftë se ky lajm do të ishte në kundërshtim me të vërtetën e të drejtën, që ata njerëz të drejtë e të plotësuar të mos e mohonin apo të mos e kundërshtonin atë?

• ***Shembulli i dhjetë:*** Sipas një rrëfenje autentike nga Hazreti Imam Aliu, "Njëherë Profeti i Nderuar a.s.m. grumbulloi njerëzit e Beni Abd el-Muttalib. Ata ishin rreth dyzet veta, duke përfshirë disa që do të mund të hanin një deve të vogël e të pinin një okë qumësht në një vakt. Megjithatë Ai kishte përgatitur për ata vetëm një grusht ushqim. Të gjithë hëngrën e u ngopën dhe ushqimi mbeti tamam ashtu siç kishte qenë më parë. Më vonë, Ai solli qumësht me një enë prej druri që ishte i mjaftueshëm vetëm për tre ose katër persona. Ata pinë derisa shuan etjen e u ngopën dhe qumështi mbeti sikur nuk ishte pirë."

Ky është një shembull i mrekullisë së bereqetit të ushqimit dhe është aq i sigurtë si guximi e besnikëria e Hazreti Aliut!

• ***Shembulli i njëmbëdhjetë:*** Sipas një rrëfenje autentike me rastin e martesës së Hazreti Aliut me Fatime ez-Zehra, Profeti i Nderuar a.s.m. e urdhëroi Bilal el-Habeshiun duke i thënë: "Sill bukë të bërë prej katër-pesë grushtash mielli, gjithashtu therr një deve të vogël!" Bilali tregon: "Unë e solla ushqimin. Ndërkohë Ai vendosi dorën e Tij në të për ta bekuar. Më vonë, Sahabët arritën në grupe, hëngrën dhe u larguan. Nga ushqimi i mbetur Ai përsëri bëri dua për bereqet; pastaj nga ai ushqim, Ai dërgoi një tas plot për secilën nga gratë e Tij duke u thënë se ato duhej të hanin e të ushqenin cilindo që do t'u shkonte për vizitë atyre."

Po, një bollëk i tillë i bekuar ishte me të vërtetë i nevojshëm për një martesë të tillë të bekuar!..

• ***Shembulli i dymbëdhjetë:*** Hazreti Imam Xhafer es-Sadik tregoi nga babai i tij Imam Muhammed el-Bakër dhe ai nga babai i tij Imam Zejn el-Abidin, dhe ai nga Imam Aliu, se Fatime ez-Zehra kishte përgatitur mjaft ushqim për veten e për Aliun. Atëherë ajo dërgoi Aliun që të ftonte Profetin e Nderuar a.s.m. për të ardhur e të hante me ta. Ai erdhi dhe i urdhëroi që të dërgojnë nga një pjatë ushqimi për secilën nga gratë e Tij. Pasi u la mënjanë një pjatë ushqimi për veten, për Aliun, Fatimenë dhe për fëmijët e tyre, hazreti Fatimeja thotë: "Ne e ngritëm tenxheren, ushqimi ishte plot për t'u derdhur. Pastaj ne hëngrëm prej tij për një kohë të gjatë, aq sa deshi All-llahu."

Përse nuk e besoni këtë mrekulli të bereqetit ashtu sikur ta kishit parë me sytë tuaj, pasi ai vjen nga ky zinxhir i lartësuar e brilant transmetimi? Edhe vetë shejtani nuk do të mund të gjente arsye për ta mohuar atë.

• ***Shembulli i trembëdhjetë:*** Autoritete të sakta të tilla si, Ebu Davudi, Ahmed Ibn Hanbel dhe Imam Bejhakiu transmetojnë nga Dukajn el-Ahmas Ibn Sa'id el-Muzejn dhe nga Nu'man Ibn Muker-rin el-Ahmasi el-Muzejn, i cili me gjashtë vëllezërit e tij u nderua me bisedimin e Profetit dhe ishte një Sahabe. Dhe nëpërmjet Xheririt përmes shumë zinxhirëve të transmetimit, nga Umer Ibn el-Hatab se Profeti i Nderuar a.s.m. e urdhëroi Umer Ibn el-Hattabin duke i thënë: *"Pajisi me furnizime për një udhëtim katërqind kalorës nga fisi Ahmasi!"* Hazreti Umeri u përgjigj: *"Ja Resulall-llah! -O i Dërguar i Zotit! Ajo që ne kemi në dorë është disa sa'ë (pesha), e barasvlershme me një deve të vogël të ulur (të gjunjëzuar)"*. Profeti a.s.m. i tha: *"Shko dhe jepua atë atyre!"* Kështu ai shkoi dhe nga ajo gjysëm peshe hurmash u dha katërqind kalorësve furnizime të mjaftueshme dhe deklaroi që: "Ajo peshë mbeti, siç ishte më parë, pa u pakësuar."

Kështu, kjo mrekulli e bereqetit ndodhi në lidhje me katërqind njerëzit dhe me Hazreti Umerin në veçanti. Ata janë prapa tregimeve duke i mbështetur ato, dhe heshtja e tyre i konfirmon ato. Prandaj mos i injoro ato njoftime vetëm për shkak se ato tregohen prej pak individëve, sepse edhe sikur ngjarja të ishte njoftuar vetëm nga një individ i veçantë, ajo ende do të kishte sigurinë e "Konsensusit në Kuptim"

• ***Shembulli i katërmbëdhjetë:*** Të gjithë librat e saktë të hadithit, me në krye Buhariun dhe Muslimin, tregojnë se: Kur vdiq babai i Hazreti Xhabirit, ai kishte rënë në borxhe. Kreditorët e tij ishin çifutë. Xhabiri u ofroi kreditorëve të gjithë pasuritë e plaçkat e babait të tij (për të shlyer borxhin), por ata nuk ia pranuan. Fruti i prodhuar nga pemishtja e tij për shumë vite nuk ishte i mjaftueshëm të paguante borxhin. Profeti i Nderuar a.s.m. tha: *"Këputeni dhe mblidheni të gjithë frutin në pemishte!"* Ata vepruan kështu dhe, ndërkohë Profeti i Nderuar a.s.m. eci përreth të vjelave dhe bëri lutje. Atëherë Xhabiri ua dha shumën e të vjelave që i korrespondonte borxhit të babait. Ajo që mbeti ishte aq shumë sa prodhimi vjetor i pemishtes. Dhe sipas një rrëfenje tjetër, ishte e barabartë me shumën që ai u dha kreditorëve. Çifutët u çuditën e u mahnitën nga kjo.

Ja, kjo mrekulli e qartë bereqeti nuk u njoftua vetëm nga pak tregimtarë si Hazreti Xhabiri, por shumë njerëz që patën lidhje me të e përshkruan dhe e treguan atë duke i dhënë shkallën e "Konsensusit në Kuptim".

• ***Shembulli i pesëmbëdhjetë:*** Dijetarë të saktë, me në krye Tirmidhiun dhe Imam Bejhakiun, treguan përmes një zinxhiri të shëndoshë të autoriteteve nga Ebu Hurejreja se Ai tha: Gjatë një ekspedite -sipas një rrëfenje tjetër ajo e Tebukut- ushtria u bë shumë e uritur. Profeti i Nderuar a.s.m. pyeti: هَلْ مِنْ مَزِيدٍ *"A ka dicka? A ka më?"*. Unë thashë: "Kam ca hurma në duqet -çantat- e mia", (sipas një rrëfenje tjetër ishin pesëmbëdhjetë). Ai i tha: *"Silli ato këtu!"* Unë ia çova ato. Ndërkohë, Ai futi dorën tek ato dhe mori një grusht. Atëherë Ai i vendosi në një pjatë dhe bëri një dua për shtimin e tyre. Pastaj Ai i thirri ushtarët në grupe dhjetëshe dhe ata të gjithë hëngrën nga ato. Në fund Ai tha:

خُذْ مَا جِئْتَ بِهِ وَافْبِضْ عَلَيْهِ وَلَا تَكُبَّهُ

"Merre atë që solle, mbaje dhe mos e këlle përmbys."

Unë futa dorën time në çantë dhe në dorë ishin aq hurma sa sasia që pata sjellur. Më vonë, gjatë kohës që ishte gjallë Profeti i Nderuar a.s.m., Ebu Bekri, Umeri dhe Osmani, unë hëngra nga ato hurma". (Tregohet përmes një zinxhiri tjetër transmetimi: "Unë i dhashë disa pesha nga ato hurma për t'u përdorur "në rrugë të Zotit." Më vonë çanta që mbante hurmat u plaçkit në kohën kur u vra Osmani.")

Ebu Hurejreja ishte një student besnik i rëndësishëm dhe një dishepull midis njerëzve të Suffasë, i Shkollës së Shenjtë të mësuesit të universit, i krenarisë së botës. Përveç kësaj, Profeti a.s.m. ishte lutur për fuqinë e tij të memories. Atëherë mrekullia e bereqetit që ai njoftoi, e cila ndodhi në një tubim të madh si ekspedita e Tebukut, duhet të jetë aq e shëndoshë dhe e sigurt sa fjala e të gjithë ushtrisë...

• ***Shembulli i gjashtëmbëdhjetë:*** Vërtetohet në librat e saktë të Buhariut e në librat e saktë të të tjerëve, përmes një rrëfenje autentike se Ebu Hurejreja njëherë ishte i uritur, kështu ai ndoqi Profetin e Nderuar a.s.m. për tek shtëpia e Tij. Atje ata panë se një goté me qumësht ishte sjellë si dhuratë. Profeti i Nderuar a.s.m. i tha atij: *"Thirri të gjithë njerëzit e Suffasë!"* Nga zemra thashë: "Unë mund ta pi vetë gjithë qumështin, pasi isha më i nevojshmi për të." Por meqenëse ishte urdhri i Profetit, unë i solla njerëzit e Suffas, të cilët numëroheshin më shumë se njëqind. Ai më urdhëroi: "Jepu atyre të pijnë qumështl". Unë i dhashë gjithësecilit një pas një dhe secili nga ata piu deri sa u ngop. Pastaj Ai më tha që:

بَقِيتُ أَنَا وَأَنْتَ فَاشْرَبْ

"Pjesa e mbetur është për mua e për ty." Ndërsa unë piva, Ai vazhdoi të më thonte, *"Pi!"* edhe më shumë, derisa unë i thashë: "Betohem në të Gjithëlavdishmin e Vetëm, i Cili të dërgoi me të vërtetën se unë jam tej mase i ngopur dhe s'mbeti vend të pi më". Atëherë Ai piu pjesën e mbetur duke thënë Bismillah *me Emrin e All-Ilahut* e duke i bërë falënderime Atij." Qoftë e bekuar njëqind mijë herë ajo për Ty, o i Dërguari i Zotit!

Kjo mrekulli e sigurt, e qartë, aq e pastër dhe e ëmbël sa vetë qumështi, transmetohet nga të Gjashtë Librat -Kutubus-sitte- në rrëfenjat e tyre të shëndosha me në krye Buhariun i cili mbante në kujtesë pesëqind mijë hadithe.

Për më tepër, ai transmetohet nga një student i shquar, besnik e brilant i shkollës së bekuar të Muhammedit a.s.m. dhe i shkollës Suffa, Ebu Hurejreja, i cili gjithashtu e përmendi si dëshmitar okulist, ose më mirë, ai përfaqësoi të gjithë studentët e tjerë të Suffas. Atëherë, ai që nuk e pranon këtë raportim tamam sikur ta kishte parë vetë, natyrisht, ai ose është i prishur në zemër ose e ka lënë mendja! Është krejtësisht e sigurt që një person i tillë i vërtetë si Hazreti Ebu Hurejreja, i cili ua kushtoi gjithë jetën e tij hadditheve të Profetit dhe fesë dhe i cili e dëgjoi dhe e transmetoi vetë hadithin:

وَمَنْ كَذَبَ عَلَيَّ مُتَعَمِّدًا فَلْيَتَبَوَّأْ مَقْعَدَهُ مِنَ النَّارِ

"Kushdo që, me paramendim, tregon gënjeshtër në lidhje me mua, duhet të përgatitet për një vend në zjarrin e Xhehennemit".

-a mundet që një njeri i tillë- të ketë treguar një ngjarje të pabazuar ose një thënie që do të kundërshtonte të vërtetën dhe realitetin, apo të kishte shkaktuar dyshim në lidhje me vlerën dhe sigurinë e të gjitha hadditheve të tjera të cilat ai i kishte mësuar përmendësh? kurrësesi!.. Ruajna Zot!..

O Krijuesi ynë! Për hir të bereqetit që Ti i ke dhënë Profetit Tënd më të Nderuar a.s.m., dhuro bekime dhe bereqet mbi mirësitë që na ke dhënë, qofshin shpirtërore apo materiale!..

Një Pikë e Rëndësishme:

Është e vetëkuptueshme se, kur grumbullohen së bashku, gjërat e dobëta bëhen të forta, fijet e holla përdridhen dhe bëhen litar i fortë; dhe litarët mbështillen së bashku dhe atëherë asnjëri nuk mund t'i këpusë ato. Në këtë Shenjë, nga pesëmbëdhjetë llojet e ndryshme të mrekullisë, ne kemi treguar vetëm një e cila lidhej me bekimet e bereqetit. Dhe të pesëmbëdhjetë shembujt që ne kemi dhënë, mezi përbëjnë një të pesëmbëdhjetën e këtij lloji. Megjithatë, secili nga shembujt e përmendur është në vetvete një provë me mjaft fuqi për të vërtetuar profetësinë. Edhe në qoftë se do t'i supozonin disa si të dobëta -duke supozuar të pamundurën- përsëri nuk do të ishte me vend që t'i gjykosh ato si të tilla, meqenëse çdo gjë që bashkohet me të fortën, gjithashtu bëhet e fortë.

Kur konsiderohen së bashku, pesëmbëdhjetë shembujt e dhënë lartë përbëjnë një mrekulli të madhe e të fortë nëpërmjet fuqisë së sigurt e të padyshimtë të fuqisë së "Konsensusit në Kuptim". Dhe kur kjo mrekulli bashkohet me katërmbëdhjetë mrekullitë e tjera të bereqetit, të cilat nuk janë përmendur këtu, ajo manifeston një mrekulli shumë të lartë që është e pathyeshme si bashkimi i litarëve të fortë. Tani shtoua këtë mrekulli të lartë katërmbëdhjetë llojeve të tjera të mrekullisë dhe shiko se çfarë prove të sigurtë vendimtare e të parefuzueshme japin ato për profetësinë e Muhammedit a.s.m.. Kështu, shtylla e profetesisë së Muhammedit a.s.m. e përbërë nga një bashkim i tillë mrekullish, ka fuqinë e një shtylle sa mali. Tani ti e ke kuptuar se sa e paarsyeshme është kur e gjykon si të paqëndrueshme e të mundshme për të rënë ajo lartësi -ai qiell i qëndrueshëm- për shkak të dyshimeve që burojnë nga mungesa e konceptimit të çështjeve dhe shembujve të veçantë. Sigurisht, ato mrekulli që lidhen me shtimin e bereqetit tregojnë se: *Muhammedi a.s.m. ishte nëpunësi i dashur dhe shërbëtori i nderuar i të Gjithëmëshirshmit dhe i Gjithëbujarit i Cili krijon ushqimin, rizkun, dhe me të i siguron të gjitha qëniet. Në kundërshtim me praktikën e Tij, Ai i dërgon atij banketa me shumëllojshmëri ushqimi nga asgjëja, nga thjeshtë e Padukshmja.*

Është e njohur se Gadishulli Arabik është një vend ku uji dhe bujqësia janë të pakta e të pamjaftueshme. Për këtë arsye, njerëzit e saj dhe veçanërisht Sahabët në ditët e para të Islamit vuajtën skamjen dhe pamjaftueshmërinë. Ata shpeshë goditeshin gjithashtu me mungesë uji, me etje. Për shkak të kësaj, rëndësia e mrekullive të dukshme të Muhammedit a.s.m. lidhej me ushqimin e me ujin. Përveç qënies mrekulli, të cilat provojnë pretendimin e Tij të profetësisë, këto mrekulli e çudira ishin për shkak të nevojës, dhe njëkohësisht si dhurata Hyjnore, si mirësi Hyjnore dhe si nderime nga i Gjithëlavdishmi i Vetëm për Profetin më të Nderuar a.s.m., sepse ata që i panë mrekullitë, e kishin pranuar profetësinë e Tij. Megjithatë, ndërsa mrekullitë ndodhnin, besimi i tyre rritej e bëhej më i ndritshëm.

* * *

SHENJA E TETË

Kjo pjesë tregon mrekulli të cilat u shfaqën në lidhje me ujin.

Parathënie

Ngjarjet që ndodhën midis grupeve të njerëzve, në goftë se raportohen individualisht dhe nuk kundërshtohen nga të tjerët, kjo tregon saktësinë e raportimeve, sepse pikërisht për arsye të natyrës së vet, njeriu është i prirur ta quaj gënjeshtër "gënjeshtër". Në mënyrë të veçantë, në goftë se njerëzit në çështje gjenë Sahabët, të cilët ishin më intolerantët ndaj me gënjeshtrën se kushdo tjetër, në goftë se ngjarjet lidheshin me Profetin e Nderuar a.s.m. dhe në goftë se tregimtari ishte një Sahabe i shquar, atëherë tregimtari sigurisht e jep raportimin e tij në emër të të gjithë atyre që genë dëshmitarë në ngjarjen. Megjithatë, secila nga mrekullitë, duke përfshirë ujin që do ta përmendim më poshtë, u transmetuan përmes shumë kanaleve që u lanë në besim nga shumë Sahabe për mijëra studiues të saktë të gjeneratës vijuese, të cilët, me radhë, na kaluan ato të verifikuara autentikisht interpretuesve të mëdhenj të sheratit të shekullit të dytë. Ata gjithashtu i morën ato me seriozitetin e me ndërtimin më të plotë, i pranuan dhe na dorëzuan dijetarëve të përpiktë të shekujve vijues. Kështu, hadithet kanë arritur kohët tona duke kaluar përmes mijëra duarsh të fuqishme e të besueshme. Për më tepër, tekstet e hadithëve të regjistruara në epokën e lumturisë (epokën e Profetit të Nderuar a.s.m.), u dorëzuan në formën më të saktë, dërisa ato arritën studiuesit brilantë të shkencës së hadithit, si Buhariu e Muslimi. Dhe ata përmes verifikimit dhe klasifikimit të përpiktë i grumbulluan së bashku ato hadithe që ishin autentikë e të sakta duke na i paraqitur ne e duke na udhëzuar për tekë e sakta.

جَزَاهُمُ ٱللَّهُ خَيْرًا كَثِيرًا

"Zoti ua shpërbleftë me të mira atyre!"

Kështu, vërsimi i ujit nga gishtërinjtë e Profetit të Nderuar a.s.m., dhe ndërkohë shumë njerëz pinë prej tij, ka sigurinë e konsensusit. Prandaj është e pamundur që ai grumbullim i madh të cilët e rrëfyen atë ngjarje të kenë rënë dakord mbi gënjeshtër. Atëherë, kjo mrekulli ishte shumë e sigurtë. Për më tepër, ajo u përsërit tri herë në prani të tre grumbullimeve të mëdha. Shumë dijetarë të sakte, kryesisht Buhariu, Muslimi, Imam Malik, Imam Shuajb dhe Imam Katade i regjistruan nga rrëfenja autentike e të sakta prej shumë Sahabëve, para së gjithash, prej atyre që i shërbyen Profetit si Hazreti Enesi, Hazreti Xhabiri dhe Hazreti Ibn Mes'udi, se sa një i bollshëm kishte vërsiuar prej gishtërinjve të Profetit të Nderuar a.s.m., dhe se një ushtri pin prej tij. Nga shumë rrëfenja të këtij llloji mrekullie, ne do të përmendim këtu vetëm njëtë shembuj.

• ***Shembulli i parë***: Librat e saktë të hadithit, veçanërisht ato të Buhariut e të Muslimit, raportojnë nga një rrëfenjë autentike prej Hazreti Enesit: "Rreth treqind prej nesh ishim së bashku me Profetin e Nderuar a.s.m. në vendin e quajtur Zavra. Ai na urdhëroi të kryenim avdesin për faljen e *Asrit* -ikindisë, pasditës- por ne nuk mundëm të gjenim fare ujë. Ndërkohë Ai na tha të sillnim pak ujë, gjë të cilën e bëmë. Ndërkaq zhyti duart e Tij të bekuara në të dhe unë pashë ujë të vërshonte nga gishtërinjtë e Tij si një burim. Treqind burra bashkëshoqërues e kryen avdesin dhe pinë ujë prej tij."

Hazreti Enesi e tregon këtë ngjarje në emrin e treqind burrave. Atëherë, a është e mundur që ata treqind burra të mos marrin pjesë, me kuptim, në këtë ngjarje dhe a do të ishte e mundur që ata të mos e përgënjeshtronin në qoftë se kjo ngjarje nuk do të kishte ndodhur me të vërtetë?

• ***Shembulli i dytë:*** Siç tregohet tek librat e saktë, e para së gjithash tek Buhariu e Muslimi, se Hazreti Xhabir Ibn Abdullah el-Ensari tha: "Ne, një mijë e pesëqind njerëz ishim të etur gjatë Betejës së Hudejbies. Profeti i Nderuar a.s.m. mori avdes nga një çantë uji prej lëkure e quajtur *Kirba*, atëherë Ai zhyti në të dorën e Tij dhe ndërkohë unë pashë se uji po vërshonte nga gishtërinjtë e Tij si një burim. Një mijë e pesëqind burra pinë nga ai dhe mbushën çantat e tyre të ujit." Njëherë, Salim ibn Ebi Xha'd e pyeti Xhabirin: "Sa veta ishit ju atje?" Ai u përgjigj: "Uji do të kishte qenë i mjaftueshëm edhe sikur të kishin qenë njëqind mijë njerëz, por ne ishim një mijë e pesëqind."

Kështu, tregimtarët e kësaj mrekullie të qartë, në të vërtetë, numërohen një mijë e pesëqind veta, për nga kuptimi, pasi natyra e njeriut është e prirur t'i thotë gënjeshtrës gënjeshtër. Sa për Sahabët e Profetit të Nderuar a.s.m. të cilët sakrifikuan fiset e popujt e tyre, baballarët e nënat, jetët e tyre dhe gjithçka kishin në pronësi për hir të së vërtetës e të realitetit, ata nuk mund të kishin qëndruar të heshtur përballë një gënjeshtre, sidomos në dritën e paralajmërimit të dhënë nga hadithi: *"Kushdo që, me paramendim, tregon gënjeshtër në lidhje me mua duhet të përgatitet për një vend në zjarrin e Xhehennemit."* Meqenëse ata qëndruan të heshtur në lidhje me këtë njoftim, ata e pranuan atë dhe, në të vërtetë, iu bashkuan Xhabirit, duke e konfirmuar atë.

• ***Shembulli i tretë:*** Përsëri siç transmetohet në librat e saktë të hadithit, me në krye Buhariun dhe Muslimin, Hazreti Xhabiri raportoi: Gjatë betejës së Buvat, Profeti i Nderuar a.s.m. e urdhëroi: نَادِ بِالْوُضُوءِ *"Bëj thirrje për avdes!"* Ata thanë se nuk kemi ujë. Ndërkohë, Profeti i Nderuar a.s.m. tha: "Gjeni një sasi të vogël!" Ne sollëm një sasi shumë të vogël. Ai e mbajti dorën sipër ujit ndërsa po recitonte diçka që unë nuk munda ta dëgjoj dhe atëherë Ai urdhëroi: رِدْنَا بِجَفْنَةِ الرَّكْبِ *"Sillëni govatën e madhe të karvanit!"* Ata e sollën atë tek unë dhe ndërkohë unë e vendosa përpara Profetit të Nderuar a.s.m.. Ai vendosi duart e Tij në govatë dhe shpërndau gishtat e Tij. Unë e derdha atë sasi shumë të vogël uji në duart e Profetit a.s.m. dhe pashë ujë të shumtë të vërshonte nga gishtërinjtë e Tij të bekuar duke mbushur govatën. Ndërkaq unë u bëra thirrje atyre që kishin nevojë për ujë. Kur ata të gjithë kishin kryer avdesin me ujin dhe kishin pirë prej tij, unë i thashë Profetit a.s.m. se nuk kishte më njeri tjetër. Atëherë, Ai ngriti duart e Tij duke e lënë govatën të mbushur buzë për buzë.

Kështu, kjo mrekulli e qartë e Muhammedit a.s.m. ka sigurinë e "Konsensusit në Kuptim", sepse meqenëse Hazreti Xhabiri ishte më i spikaturi në çështje, ai kishte të drejtë ta rrëfente e ta njoftonte atë në emër të gjithësecilit.

Gjithashtu, Ibn Mes'udi e tregon ekzaktësisht të njëjtën gjë në rrëfenjën e tij: "Unë pashë ujë të vërshonte nga gishtërinjtë e Profetit të Nderuar a.s.m. ashtu si të vërshonte prej një burimi."

Në qoftë se një grup i vërtetë e i mirënjohur Sahabësh, i cili përbëhej nga Hazreti Enesi, Xhabiri dhe Ibn Mes'udi, ku secili prej tyre tha: "Ne e kemi parë atë", atëherë a do të ishte e mundur që ata të mos e kenë parë? Tani kombinoji këto tre shembuj dhe shiko se sa mrekulli e fortë dhe e qartë është ajo dhe si, në qoftë se do të kombinoheshin të tre zinxhirët e transmetimit, ajo e provon vërshimin e ujit nga gishtërinjtë e Tij si "Konsensusi i vërtetë".Në realitet, madje edhe Hazreti Musai a.s. duke e bërë ujin të vërshojë nga dymbëdhjetë vende të ndryshme në një shkëmb nuk mund të barazohej me ujin që vërshoi nga dhjetë gishtërinjtë e Muhammedit a.s.m., sepse uji mund të çurgojë nga shkëmbi, shembujt si ky duhet të gjenden midis ngjarjeve të zakonshme, por nuk ka barasvlerë e krahasim për ujin duke vërshuar me bollëk, si prej burimit të *Keutherit*, nga mishi e kocka.

• ***Shembulli i katërt:*** Imam Maliku në librin e tij të çmuar *"Muvatta"* rrëfen nga Sahabeja i shquar Muadh Ibn Xhebel se: "Gjatë luftës së Tebukut, ne hasëm me një burim që rrjedhte me aq pakicë si një fije e hollë spangoje. Profeti i Nderuar a.s.m. urdhëroi: *'Grumbulloni pak*

nga uji!' Ata e mblodhën pak në pëllëmbat e duarve të tyre. Profeti i Nderuar a.s.m. i lau në të duart dhe fytyrën e Tij dhe atëherë ne e kthyem atë tek burimi. Befas grykëderdhja e burimit u hap dhe uji vërshoi, ai ishte i mjaftueshëm për të gjithë ushtrinë."

Madje një rrëfyes tjetër, Imam Ibn Is'hak deklaroi: "Uji brufulloi nga burimi poshtë tokës duke bërë një buçitje si rrufe gjëmimtare. Ndërkaq Profeti i Nderuar a.s.m. i tha Muadhit:

يُوشِكُ يَا مُعَاذُ إِنْ طَالَتْ بِكَ حَيَاةٌ أَنْ تَرَىٰ مَا هٰهُنَا قَدْ مُلِئَ جِنَانًا

"Nëse do të kesh jetë të gjatë, ti do të shohësh se fy ujë i mrekullueshëm do ta transformojë këtë vend në kopsht." Dhe me të vërtetë, ashtu ai u bë.

• ***Shembulli i pestë:*** Buhariu rrëfen nga Hazreti El-Ber-ra' dhe Muslimi nga Hazreti Seleme Ibn Akva, si dhe libra të tjerë autentikë të hadithit tregojnë me unanimitet se: "Gjatë Ekspeditës së Hudejbijes ne ndeshëm me një pus. Ne ishim katërqind vetë, ndërsa uji në pus mezi mjaftonte për pesëdhjetë vetë. Ne e nxorëm ujin dhe nuk lamë kurgjë. Ndërkohë Profeti i Nderuar a.s.m. erdhi e u ul në krye të pusit. Ai kërkoi një kovë uji dhe ne ia sollëm. Ndërkaq Ai futi në kovë ca nga jarga e Tij e bekuar, bëri lutje dhe e zbrazi ujin në pus. Papritmas pusi u mbush dhe shkumëzoi me ujë duke u mbushur deri në grykë. E gjithë ushtria piu derisa u ngop, u dhanë uji edhe kafshëve të tyre si dhe rimbushën çantat e tyre të ujit."

• ***Shembulli i gjashtë:*** Përsëri autoritetet më brilante të shkencës së hadithit, si Muslimi dhe Ibn Xharir el-Tabari, dhe librat autentikë të hadithit, tregojnë nga një rrëfenjë e shëndoshë nga i famshmi Ebu Katade, se: "Ne po shkonim për të ndihmuar drejtuesit që po martirizoheshin në betejën e dëgjuar të Mut'as. Unë kisha një kirba (çantë uji) me vete. Profeti i Nderuar a.s.m. urdhëroi:

اِحْفَظْ عَلَيَّ مِيضَأَتَكَ فَسَيَكُونُ لَهَا نَبَأٌ عَظِيمٌ

"Mbaje me kujdes çantën e ujit, do të kesh nevojë të madhe për të."

Pastaj ne filluam të goditeshim nga etja. Ne ishim shtatëdhjetë e dy njerëz, (sipas Tabariut, treqind). Profeti tha: *'Ma sill çantën tënde të ujit!'* Unë veprova kështu, Ai mori çantën dhe vendosi buzat e Tij në grykën e saj, unë nuk e di nëse Ai fryu në të apo jo. Atëherë shtatëdhjetë e dy njerëz erdhën e pinë nga çanta dhe mbushën çantat e tyre. Kur e mora çantën përsëri, ajo ishte tamam ashtu siç ia kisha dhënë.

Shikoje këtë mrekulli vendimtare të Profetit të Nderuar a.s.m. dhe thuaj:

اَللّٰهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلَيْهِ وَعَلٰى اٰلِهٖ بِعَدَدِ قَطَرَاتِ الْمَاءِ

"O Zot! Jepi Atij dhe familjes së Tij bukuritë e pafundme të ujit!

• ***Shembulli i shtatë:*** Librat autentikë me në krye Buhariun e Muslimin rrëfejnë nga Hazreti Imran Ibn Husejni se: "Në një udhëtim, ne dhe Profeti i Nderuar a.s.m. ishim pa ujë. Ndërkohë, Ai më tha mua dhe Aliut: *"Ndodhet një grua në aksh e në filan vend së bashku me kafshën e saj e cila është ngarkuar me dy çanta plot ujë. Prandaj shkoni e thërriteni atë."* Aliu dhe unë shkuam dhe e gjetëm gruan dhe ujin pikërisht tek vendi i përshkruar dhe e sollëm. Mandej urdhëroi: *"Zbrazni pak ujë në enë"* Ne e zbrazëm dhe Ai u lut për shtimin e bereqetit. Mandej e vuri ujin mbi kafshën në një çantë uji prej lëkure e quajtur *Kirba*. Atëherë, Ai urdhëroi gjithësecilin të vinte e të mbushte çantën e tij të ujit. Të gjithë njerëzit erdhën, pinë dhe mbushën çantat e tyre të ujit. Pastaj Ai dha porosi që të mbliditet diçka për gruan. Ata grumbulluan ca ushqim, e futën në një rrobe dhe e ngarkuan në devenë e saj.

Imrani Tha: "Unë përfytyrova se dy çantat e ujit po mbusheshin vazhdimisht." Ndërkaq Profeti i Nderuar a.s.m. i tha asaj gruaje:

اِذْهَبِي فَاِنَّا لَمْ نَأْخُذْ مِنْ مَائِكِ شَيْئًا وَلٰكِنَّ اللّٰهَ سَقٰيْنَا

"Ti mund të shkosh tani. Ne nuk morëm ujë nga ti, por All-llahu xh.sh. *na dha ujë nga Thesari i Tij."*

• ***Shembulli i tetë:*** Dijetarët e hadithit, kryesisht Ibn Huzami në *Sahihin* e tij, rrëfen nga Hazreti Umeri: "Në mbetëm pa ujë gjatë ekspeditës së Tebukut. Disa njerëz, madje therrën devetë e tyre, i shtrydhën të përbrendshmet (e deveve) dhe e pinë ujin e devesë. Ebu Bekri es-Siddiku i kërkoi Profetit të Nderuar a.s.m. të bënte lutje. Profeti i Nderuar a.s.m. ngriti duart e Tij dhe përpara se Ai t'i kishte ulur duart, u grumbulluan retë dhe ra një shi i tillë saqë ne mbushëm enët tona. Atëherë shiu ndaloi dhe ai nuk kishte rënë përtej limiteve të ushtrisë." Domethënë, asnjë rastësi nuk u ndërlikua në këtë ndodhi, por ajo është vetëm një mrekulli e Profetit a.s.m..

• ***Shembulli i nëntë:*** Tregohet nga Amr Ibn Shuajb, nipi i Abdullah Ibn Amr Ibn A's mbi të cilët ata mbështeten për shpjegimet e hadithit, dhe katër imamët transmetojnë nga një rrëfenjë e shëndoshë se: "Përpara misionit të Tij Profetik, Profeti i Nderuar a.s.m. njëherë erdhi me një deve tek vendi i quajtur Dhul Hixhaz pranë Arefatit me xhaxhain e Tij Ebu Talibin. Ebu Talibi tha: "Unë jam i etur". Profeti i Nderuar a.s.m. zbriti nga deveja dhe goditi tokën me këmbën e Tij. Ndërkohë doli uji dhe Ebu Talibi piu prej tij." Megjithëse njëri nga dijetarët hulumtues deklaroi se kjo ngjarje duhet të konsiderohet si e kategorisë *Irhasat*, meqë ajo ndodhi përpara profetësisë, prapëseprapë shpërthimi i burimit të Arafatit pas kalimit të një mijë viteve konsiderohet keramet -prova, çudira- Hyjnor për Profetin Muhammed a.s.m..

Kështu, mrekullitë që lidhen me ujin, edhe në qoftë se nuk arrijnë nentëdhjetë shembuj të ngjashëm me këto nëntë shembuj, por ama ato janë raportuar nëpërmjet nëntëdhjetë rrëfenjash të ndryshme. Shtatë shembujt e parë janë aq të shëndoshë e të sigurt si 'Konsensusi në Kuptim'. Sigurisht dy të fundit nuk mbështeten nga rrëfenjat e tregimtarëve të shumtë apo nga një zinxhir i fortë transmetuesish, por duke mbështetur e konfirmuar ngjarjen në shembullin e tetë siç rrëfehej nga Hazreti Umeri, është një mrekulli tjetër e njoftuar nga librat autentikë të hadithit duke përfshirë Bejhakiun dhe Hakimin; ai është siç vijon:

"Umeri i kërkoi Profetit të Nderuar a.s.m. që Ai të lutej për shi, sepse ushtria kishte nevojë për ujë. Profeti i Nderuar a.s.m. ngriti duart e Tij dhe menjëherë retë u grumbulluan dhe shiu ra i mjaftueshëm për nevojat e ushtrisë dhe, atëherë retë u davaritën." Sikur retë të ishin nëpunëse të ngarkuara për t'i dhënë ujë vetëm ushtrisë; ato erdhën, zbrazën shi të mjaftueshëm për nevojën e saj dhe atëherë ikën.

Ashtu siç mbështetet kjo rrëfenjë dhe provon në mënyrë vendimtare shembullin e tetë, gjithashtu edhe studiuesi i famshëm Ibnu el-Xheuzi, i cili ishte tej mase ekstrem në verifikimin e haditheve, madje duke i mohuar e duke i vlerësuar shumë hadithe të sakta si të rreme, pra edhe ky dijetar tha se "kjo ngjarje ndodhi pikërisht tek lufta e shquar e Bedrit." Ai deklaroi se ky vërset,

وَيُنَزِّلُ عَلَيْكُمْ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً لِيُطَهِّرَكُمْ بِهِ

"Dhe Ai t'i shkaktoi shiun të zbriste mbi ju nga qielli që t'i ju pastrojë ju me të." *(Kur'an 18:11)* referohet kësaj ngjarje. Megjithëse çështja është kështu, sigurisht, nuk mbetet më vend për dyshim. Për më tepër, ka ndodhur në mënyrë të përsëritur zbritja e shiut me lutjen e Profetit para se Ai të ulte duart e ngritura dhe, në vetvete, ajo ishte një mrekulli që u përkasin raportimeve mbi të

cilat ka ‘Konsensus’. Gjithashtu rrëfehet me ‘Konsensus’ se disa herë Profeti ngrinte duart e Tij për shi ndërsa ishte në hutbe -predikatore- dhe shiu binte para se Ai t’i ulte duart.

* * *

SHENJA E NËNTË

Një nga llojet e ndryshme të mrekullisë së Profetit të Nderuar a.s.m. është se ashtu si qëniet humane, edhe pemët u bindeshin urdhërave të Tij, që duke lëvizur nga vendet e tyre vinin te Ai. Gjithashtu ka "Konsensus në Kuptim" në njoftimet e këtyre mrekullive, si ato të vërshimit të ujit nga gishtërinjtë e Tij. Ato janë transmetuar në forma të shumta dhe përmes shumë kanaleve.

Në të vërtetë, konsensusi në lidhje me pemët, të cilat duke lënë vendet e tyre e duke ardhur te Ai, mund të konsiderohen si 'konsensus i qartë', sepse sahabët më të mirënjohur të tillë si Hazreti Aliu, Hazreti Ibn Ab'basi, Hazreti Ibn Mes'udi, Hazreti Ibn Umer, Hazreti Ja'la Ibn Murra, Hazreti Xhabiri, Hazreti Enes Ibn Maliku, Hazreti Burejda, Hazreti Usameh Ibn Zejd dhe Hazreti Gajlan Ibn Seleme, secili njoftoi, me siguri, të njëjtën mrekulli. Me qindra studiues të tabiinëve -gjeneratës vijuese të sahabëve- transmetuan mrekullinë nga njëri prej sahabëve të lartëpërmendur nëpërmjet një linje të ndryshme transmetimi, është sikur të na e transmetonin në formën e 'Konsensusit të shumëfishtë'. Kështu, mrekullia e pemëve dhe e drurëve ka, në mënyrë vendimtare e të pakundërshtueshme, sigurinë e 'Konsensusit në Kuptim'.

Tani ne do të përmendim vetëm disa shembuj të kësaj mrekullie të madhe, ndonëse ajo u përsërit disa herë.

• ***Shembulli i parë:*** Ibn Maxheh dhe Darimi transmetojnë nga Hazreti Enes Ibn Malik dhe Aliu, si dhe Bezzari dhe Imam Bejhekiu nga Hazreti Umeri, të tre sahabët kanë thënë: Profeti i Nderuar a.s.m. u dëshpërua shumë nga mohimi i jobesimtarëve dhe tha:

يَارَبِّ اَرِنِي اٰيَةً لَا اُبَالِي مَنْ كَذَّبَنِي بَعْدَهَا

"O Krijuesi im! Më jep një shenjë që të mos shikoj më askënd që më kundërshton" (që të mos shqetësohem për atë që më përgënjeshtron).

Sipas Enesit, Hazreti Xhebraili gjithashtu ishte i pranishëm. Ndërkohë, me instruksionin e Xhebrailit, Profeti i Nderuar a.s.m. i thirri një peme në anën e luginës dhe ajo erdhi pranë Tij. Ai atëherë i tha pemës: *kthehu prapa*! Ajo u kthye dhe vendosi vetveten në vendin e saj.

• ***Shembulli i dytë:*** Në *Shifa el-Sherif***,** Kadi Ijadi, dijetari kryesues i Magribit, rrëfen nga Hazreti Abdullah Ibn Umer përmes një zinxhiri të lartë e të shëndoshë tregimtarësh: "Në një ekspeditë, një beduin iu afrua Profetit të Nderuar a.s.m.. Profeti i tha: أَيْنَ تُرِيدُ *"Ku po shkon?"* Beduini iu përgjigj: "Te familja ime". Profeti i tha: هَلْ لَكَ إِلَى خَيْرٍ مِنْ ذَلِكَ *"A nuk dëshiron diçka më të mirë se ajo?* Beduini i tha: "Çfarë është ajo?" Profeti tha:

أَنْ تَشْهَدَ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ

"Që ti të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut, Ai është Një, Ai nuk ka shok dhe se Muhammedi a.s.m. është shërbëtori i Tij dhe Profet."

Beduini i tha: "Kush të dëshmon për këtë që ti thua?" Profeti tha: هَذِهِ الشَّجَرَةُ السَّمُرَةُ *"Pema pranë luginës do të dëshmojë."* Ibn Umeri tha: Duke u tundur, pema çau tokën dhe erdhi te Profeti i Nderuar a.s.m.. Ndërkohë Profeti i Nderuar a.s.m. i kërkoi pemës që të dëshmojë tri herë; ajo në secilën herë dëshmoi për vërtetësinë e Tij. Dhe kur Profeti a.s.m. e urdhëroi, ajo u kthye dhe u vendos në vendin e saj.

Sipas një rrëfenje autentike të Ibn Sahib el-Aslami, Hazreti Burejda njofton: "Kur ne ishim me Profetin a.s.m. në një ekspeditë, erdhi një nomad e i kërkoi Profetit a.s.m. një shenjë, domethënë një mrekulli. Profeti a.s.m. i tha:

قُلْ لِتِلْكَ الشَّجَرَةِ رَسُولُ اللهِ يَدْعُوكِ

"I thuaj asaj peme se e thërret Profeti i All-llahut!

Ndërkaq ai ia bëri me shenjë pemës; atëherë ajo duke u tundur nga e djathta e nga e majta, shkuli veten nga toka me rrënjët e saj dhe erdhi në prezencën e Profetit duke thënë:

اَلسَّلَامُ عَلَيْكَ يَا رَسُوْلَ اللّٰهِ *"Paqja qoftë mbi Ty, o Profet i All-llahut"* Beduini tha: Tani le të shkojë ajo tek vendi i saj! Ndërkohë, Profeti e urdhëroi dhe ajo iku. Atëherë nomadi i tha: "Më lejo të bëj sexhde para teje!" Profeti tha: "*Askush nuk lejohet të bëjë një veprim të tillë*", Beduini tha: Atëherë do të puth duart dhe këmbët e tua. Profeti e lejoi.

• ***Shembulli i tretë:*** Muslimi dhe librat autentikë të hadithit tregojnë se Xhabiri ka thënë: "Ne ishim së bashku me Profetin e Nderuar a.s.m. në një ekspeditë kur Ai kërkonte një vend për t'iu përgjigjur nevojës së Tij natyrore. Nuk kishte vend të mbyllur. Kështu Ai shkoi në drejtim të pemëve, u kap tek degët e njërës nga ato dhe i tërhoqi. Duke iu bindur Atij, pema shkoi së bashku me të tek pema tjetër. Ajo ishte si një deve e bindur që drejtohet nëpërmjet frerëve të saj. Duke i sjellur së bashku të dyja pemët, ai tha:

اِلْتَئِمَا عَلَيَّ بِاِذْنِ اللّٰهِ *"Bashkohuni së bashku mbi mua me lejen e All-llahut!"*

Të dyja pemët u bashkuan së bashku dhe formuan një maskim. Pasi kreu nevojën natyrore pas tyre, i urdhëroi të kthehen dhe ndërkohë ato u kthyen në vendet e tyre."

• Sipas një rrëfenje tjetër, përsëri Hazreti Xhabiri tha: Profeti më urdhëroi:

يَا جَابِرُ قُلْ لِهٰذِهِ الشَّجَرَةِ يَقُوْلُ لَكِ رَسُوْلُ اللّٰهِ اِلْحَقِي بِصَاحِبَتِكِ
حَتّٰى اَجْلِسَ خَلْفَكُمَا

Domethënë: *"Thuaju atyre pemëve të bashkohen për nevojën e Profetit."*

Unë u thashë atyre kështu dhe ato u bashkuan. Atëherë, ndërsa unë po prisja, Profeti i Nderuar a.s.m. u shfaq dhe bëri shenjë nga e majta dhe e djathta me kokën e Tij. Dhe ndërkohë të dyja pemët u kthyen tek vendet e tyre.

• ***Shembulli i katërt:*** Usameh Ibn Zejd, njëri nga komandantët trim dhe një nga shërbëtorët e Profetit të Nderuar a.s.m. njofton në një rrëfenjë autentike dhe thotë që: "Ne ishim së bashku me Profetin e Nderuar a.s.m. në një ekspeditë. Nuk kishte vend të veçuar e privat në të cilin mund t'i përgjigjeje nevojës natyrore. Ndërkaq Ai pyeti:

هَلْ تَرَىٰ مِنْ نَخْلٍ أَوْ حِجَارَةٍ

"A mund të shikoni ndonjë pemë apo shkëmb?"

Unë iu përgjigja, po, unë mundem. Ndërkohë urdhëroi:

اِنْطَلِقْ وَقُلْ لَهُنَّ إِنَّ رَسُولَ اللَّهِ يَأْمُرُكُنَّ أَنْ تَأْتِينَ لِمَخْرَجِ رَسُولِ اللهِ وَقُلْ لِلْحِجَارَةِ مِثْلَ ذٰلِكَ

"Folu atyre dhe u thuaj të bashkohen së bashku për nevojën e Profetit; gjithashtu, thuaju shkëmbinjve të grumbullohen së bashku si një mur."

Unë shkova dhe u thashë ashtu siç Ai urdhëroi. Unë betohem se pemët u bashkuan dhe shkëmbinjtë formuan një mur. Profeti i Nderuar a.s.m. pasi fshehu vetveten, përsëri urdhëroi:

قُلْ لَهُنَّ يَفْتَرِقْنَ

"Thuaju atyre të veçohen!" Unë betohem tek i Gjithëlavdishmi i Vetëm, në Dorën e të Cilit është qënia ime, se pemët e shkëmbinjtë u veçuan dhe u kthyen në vendet e tyre."

Këto dy ngjarje të cilat u njoftuan nga Hazreti Xhabir Ibn Usameh, u raportuan gjithashtu nga Ja'la Ibn Mura, Gajlan Ibn Seleme eth-Thekafi dhe nga Hazreti Ibn Mes'udi në betejën e Hunejnit.

• ***Shembulli i pestë:*** Tregohet nga Imam Ibn el-Furek i njohur si dijetari më i rëndësishëm i kohës së tij dhe "Shafiu i dytë" për përsosmërinë e tij në interpretim. "Ndërsa ishte duke udhëtuar mbi kalë në një natë gjatë ekspeditës së Taifit, Profetin e Nderuar a.s.m. e mori gjumi. Ndërsa ishte në atë gjendje, një pemë *Lote -Sidre-* u shfaq para Tij (d.m.th. ia bllokoi rrugën). Për t'i bërë rrugë Atij e për të mos plagosur kalin e Tij, pema u ça në dysh dhe, Profeti i Nderuar a.s.m., duke qenë në kalë kaloi midis dy pjesëve të pemës; pema ka mbetur si dy trungje në atë pozicion të nderuar deri në kohën tonë.

• ***Shembulli i gjashtë:*** Hazreti Ja'la Ibn Mura tregon në një rrëfenjë autentike: "Gjatë një ekspedite, një pemë e quajtur Talha ose Semura erdhi e kaloi përreth Profetit të Nderuar Alejhis-salatu ves-selam në formë إِنَّهَا اسْتَأْذَنَتْ أَنْ تُسَلِّمَ عَلَيَّ kthye tek vendi i saj. Profeti i Nderuar a.s.m. tha: *"Pema i kërkoi leje All-llahut xh.sh. që të më përshëndeste mua."*

• ***Shembulli i shtatë:*** Studiuesit e hadithit tregojnë nga Ibn Mes'udi përmes një rrëfenje autentike: "Kur xhindet e Nusajbin erdhën te Profeti i Nderuar a.s.m. në vendin e quajtur *Batn el-Nahl* me qëllim që të gjejnë udhëzim, një pemë e informoi atë për ardhjen e tyre". Gjithashtu, Imam Muxhahidi tregon nga Ibnu Mes'udi në hadith: "Xhindët kërkuan një provë për profetësinë e Tij, ndërkohë Profeti i Nderuar a.s.m. e urdhëroi një pemë dhe ajo e la vendin e saj, erdhi te Ai dhe pastaj u kthye në vendin e vet". Ajo mrekulli e vetme ishte e mjaftueshme për sojin e xhindeve.

Atëherë, në qoftë se një qënie njerëzore nuk beson, në një kohë që ka dëgjuar një mijë mrekulli si kjo, a nuk do të ishte më i humbur se sa ai shejtan i cili përshkruhet në Kur'an nga xhindet:

يَقُولُ سَفِيهُنَا عَلَى اللهِ شَطَطًا

"S'ka dyshim se ai idioti ynë fliste të pavërteta ndaj All-llahut."[215]

• ***Shembulli i tetë:*** Tirmidhiu njofton në *Sahihun* e tij nga Hazreti Ibn Abbasi përmes një rrëfenje të shëndoshë se: "Profeti i Nderuar a.s.m. i tha një nomadi:

أَرَأَيْتَ إِنْ دَعَوْتُ هٰذَا الْعِذْقَ مِنْ هٰذِهِ النَّخْلَةِ أَتَشْهَدُ أَنِّي رَسُولُ اللهِ

"A do të dëshmosh se unë jam i Dërguari i Zotit xh.sh. në qoftë se një degë e asaj peme vjen te unë kur t'i thërras?"

[215] Kur'an, 72: 1

Ai u përgjigj: “Po”. Profeti i Nderuar a.s.m. i thirri degës. Ajo u këput nga maja dhe erdhi në afërsi të Profetit të Nderuar a.s.m.. Mandej Profeti e urdhëroi dhe ajo u kthye në vendin e vet.”

Si këto tetë shembuj, ndodhen shumë shembuj të tjerë që tregohen përmes shumë zinxhirësh transmetimi. Shtatë ose tetë fije litari formojnë një kabllo të fortë kur mblidhen së bashku. E ngjashme me këtë, këto mrekulli që lidhen me pemët të cilat u njoftuan nga autoritetet e sahabëve më të mirënjohur e të saktë, pra me shumë zinxhirë transmetimi, sigurisht kanë fuqinë e “Konsensusit në Kuptim” dhe realisht të ‘Konsensusit të Vërtetë.’ Në fakt, ato marrin formën e “Konsensusit” kur kalojnë nga sahabët tek Tabiinët. Në mënyrë të veçantë, librat e saktë të hadithit të tillë si, Buhariu, Muslimi, Ibn Hibbani dhe Tirmidhiu formuan zinxhirë shumë të fuqishëm që të çojnë prapa te koha e sahabëve. Ata kështu i ruajtën ato dhe, duke lexuar cilindo hadith tek Buhariu, është sikur ta dëgjoje atë drejtpërdrejt nga sahabët.

Në qoftë se pemët, ashtu siç u pa tek shembujt e lartëpërmendur, e njohin profetësinë e Tij, e vizitojnë Atë, e përshëndesin e u binden urdhërave të Tij, atëherë si ato krijesa të pajeta, të paarsyeshme të cilat e quajnë vetveten qënie njerëzore nuk e njohin e nuk i besojnë Atij? A nuk janë atëherë ata më të pavlefshëm se sa një pemë e thatë dhe se sa një copë e thatë druri i denjë për zjarr?

* * *

SHENJA E DHJETË

Ajo që mbështet mrekullitë që lidhen me pemët e që njoftohen në formën e "Konsensusit" është mrekullia e حَنِينُ الْجِذْعِ *"Vajtimit – rënkimit- të trungut të thatë"*. Po, rënkimi i trungut në xhaminë e Profetit a.s.m. përpara një turme të madhe sahabesh, për shkak të ndarjes së tij të përkohshme nga Profeti a.s.m. konfirmon dhe përforcon shembujt e mrekullisë që lidhen me pemët, sepse trungu gjithashtu, ishte prej druri; lënda ishte e njëjta. Megjithatë, raportimet e vetë kësaj mrekullie formojnë një konsensus, ndërsa të tjerat janë kështu si një grup në një klasë, shumica e tyre individualisht ose ndarazi nuk e arrijnë shkallën e "Konsensusit të Qartë."

Kur po mbante një predikim në xhaminë e bekuar, Profeti i Nderuar a.s.m. mbështetej në një trung të thatë palme (hurme), por kur u bë predikatorja, ai filloi të jepte predikim nga ajo. Pastaj trungu rënkoi e vajtoi si një deve; i gjithë xhemati e dëgjoi atë. Vetëm kur Profeti i Nderuar a.s.m. zbriti nga predikatorja për te ai dhe, kur vendosi dorën e Tij sipër trungut duke i folur e duke e ngushëlluar, trungu ndaloi rënkimin. Kjo mrekulli e Muhammedit a.s.m. u tregua përmes zinxhirësh të shumtë transmetimi, me shkallën e "Konsensusit".

Në të vërtetë, mrekullia e حَنِينُ الْجِذْعِ *"rënkimit të trungut"* është shumë e njohur dhe e përhapur dhe raportimi i saj i përket "Konsensusit të Vërtetë." Me qindra autoritete të hadithit nga gjenerata vijuese e transmetuan mrekullinë nëpërmjet pesëmbëdhjetë zinxhirëve të transmetimit nga një grup i shquar sahabësh dhe ajo u kaloi shekujve vijues. Prej atij grupi, ishin shkollarët e shquar midis sahabëve dhe ekspertëve kryesues të hadithit të tillë si: Hazreti Enes Ibn Malik dhe Hazreti Xhabir Ibn Abdullah el-Ensari të dy shërbyes të Profetit a.s.m., Hazreti Abdullah Ibn Umer, Hazreti Abdullah Ibn Abbas, Hazreti Sehl Ibn Sa'd, Hazreti

Ebu Sa'id el-Hudri, Hazreti Ubej Ibn Ka'b, Hazreti Burejda dhe Hazreti Ummu'l Mu'minin Umm Seleme, nëna e besimtarëve. Secili, në krye të zinxhirit të transmetimit, ia njoftoi këtë mrekulli komunitetit të Tij. Me në krye Buhariun dhe Muslimin, librat autentikë të hadithit dhanë raportimet e kësaj mrekullie të madhe, në lidhje me të cilën ka një konsensus njoftimesh së bashku me linjat e saja të transmetimit, për gjeneratat pasardhëse.

• Hazreti Xhabiri në zinxhirin e tij të transmetimit thotë: "Profeti i Nderuar a.s.m. mbështetej tek një trung druri i thatë i quajtur جِذْعُ النَّخْلِ *'trungu i palmës'* ndërsa jepte predikim në xhami. Trungu nuk mundi të duronte kur u bë predikatorja dhe kur Profeti filloi ta përdorte atë për predikim; trungu nisi të rënkojë e të vajtojë si një deve barrëse." Në rrëfenjën e tij Hazreti Enesi thotë: "Trungu rënkonte si një buall duke i shkaktuar xhamisë të dridhej." Në rrëfenjën e tij, Sehl Ibn Sa'ad thotë: "Dhe vajtimi u shtua midis njerëzve nga rënkimi i trungut."

Në rrëfenjën e tij, Hazreti Ubej Ibn Ka'b thotë: "Trungu qau aq shumë, saqë u ça", ndërsa në një rrëfenjë tjetër Profeti i Nderuar a.s.m. tha:

إِنَّ هٰذَا بَكَىٰ لِمَا فَقَدَ مِنَ الذِّكْرِ

"Trungu po vajton për shkak se po ndahet nga recitimi i Emrave të All-llahut xh.sh. dhe nga përmendja e All-llahut gjatë predikimit."

Përsëri një rrëfenjë tjetër njofton se:

لَوْلَمْ أَلْتَزِمْهُ لَمْ يَزَلْ هٰكَذَا إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيٰمَةِ تَحَنُّنًا عَلَىٰ رَسُولِ اللّٰهِ

"Në qoftë se unë nuk do ta kisha përqafuar e ngushëlluar atë, ai do të kishte qarë për shkak se po ndahej nga i dërguari i All-llahut deri në kijamet"

Në rrëfenjën e tij, Hazreti Burejda tregon: "Kur trungu nisi të rënkojë, Profeti i Nderuar a.s.m., vendosi dorën e Tij mbi të dhe tha:

إِنْ شِئْتَ أَرُدُّكَ إِلَى الْحَائِطِ الَّذِي كُنْتَ فِيهِ تَنْبُتُ لَكَ عُرُوقُكَ وَيَكْمُلُ
خَلْقُكَ وَيُجَدَّدُ خُوصُكَ وَثَمَرُكَ وَإِنْ شِئْتَ أَغْرِسُكَ فِي الْجَنَّةِ
يَأْكُلُ أَوْلِيَاءُ اللهِ مِنْ ثَمَرِكَ

"Në qoftë se dëshiron, unë do të të kthej ty tek zabeli nga i cili erdhe, ku rrënjët e tua do të rriten, ti do të lulëzosh dhe do të prodhosh fruta të rinj, ose nëse dëshiron, unë të mbjell ty në Xhennet (Parajsë) dhe miqtë e Zotit xh.sh., evlijatë, shenjtorët do të hanë nga frutet e tua."

Ndërkohë e dëgjoi trungun, edhe njerëzit prapa mundën ta dëgjonin ndërsa ai foli duke thënë:

اِغْرِسْنِي فِي الْجَنَّةِ يَأْكُلُ مِنِّي أَوْلِيَاءُ اللهِ فِي مَكَانٍ لَا يَبْلَى

"Më mbill mua në Xhennet - Parajsë!, ku nuk ka kalbëzim, me qëllim që shërbëtorët e dashur të Zotit të Gjithëfuqishëm të mund të hanë nga fruti im".

Profeti i Nderuar a.s.m. tha: قَدْ فَعَلْتُ *"Kështu do të veproj"* dhe shtoi: اِخْتَارَ دَارَ الْبَقَاءِ عَلَى دَارِ الْفَنَاءِ *"Trungu ka preferuar botën e përjetshme mbi atë të përkohshmen."*

Ebu Is'hak Isfarani, njëri nga autoritetet më të mëdha në shkencat Islame, rrëfeu: "Profeti i Nderuar a.s.m. nuk shkoi tek trungu, por trungu erdhi tek Ai me komandën e Tij. Mandej me urdhërin e Tij, trungu u kthye te vendi i vet."

Hazreti Ubej Ibn Ka'b thotë: "Pas kësaj ngjarje të jashtëzakonshme, Profeti i Nderuar a.s.m. urdhëroi që: "Trungu të vendosej nën predikatore". Ai u vendos atje dhe qëndroi në atë vend deri kur Xhamia e Bekuar u hodh përdhe para se të rindërtohej. Atëherë Hazreti Ubej Ibn Ka'b e mori trungun dhe e mbajti deri sa u kalb.

Dijetari i shquar Hasan el-Basriu qante ndërsa ua mësonte këtë ngjarje të mrekullueshme studentëve të tij dhe u thonte atyre: "Kur një copë druri shfaqi dashuri e mallëngjim për Profetin e Nderuar a.s.m..., atëherë ju padyshim duhet të ndjeni më shumë dashuri se sa ai...".

Sa për ne, ne themi: Po, dhe dashuria e mallëngjimi për të tregohet duke ndjekur sunnetin e Tij të ndritur dhe sheriatin e shenjtë.

Një Pikë e Rëndësishme: Në qoftë se thuhet: "Përse mrekullitë e tjera të cilat shfaqeshin në lidhje me ushqimin -i cili ngopi një mijë njerëz me katër grushta ushqim në betejën e Hendekut, dhe një mijë e pesëqind njerëz të tjerë me ujë që vërshoi nga gishtërinjtë e bekuar, përse nuk u treguan nëpërmjet shumë zinxhirësh transmetimi ashtu si mrekullia e rënkimit të trungut, ndonëse dy mrekullitë e mëparshme ndodhën në prani të grupeve të mëdha?.."

Përgjigjja: Mrekullitë që u shfaqën ishin dy llojesh: lloji i parë shfaqeshin në duart e Hazreti Pejgamberit a.s.m. me qëllim që t'i bënte njerëzit ta pranonin profetësinë e Tij. Rënkimi i trungut ishte prej atij lloji. Ajo ndodhi vetëm si një provë, një afirmim i profetësisë, për t'ua shtuar besimtarëve 'besimin', për t'i nxitur shtiracakët tek sinqeriteti e besimi dhe për t'u sjellur besimin jobesimtarëve. Për këtë arsye, secili, i ulëti e i larti, e shikoi atë mrekulli, dhe një vëmendje e madhe iu kushtua transmetimit të sajë. Megjithatë, mrekullitë që lidhen me ushqimin dhe ujin ishin keramete -prova, çudira- më shumë se sa mrekulli, ose më shumë si mirësi Hyjnore se sa keramete, ose më shumë se sa mirësi, ato ishin gosti të dhuruara nga i Gjithëmëshirshmi i Vetëm për shkak të nevojës. Sigurisht, ato ishin prova të pretendimit të Tij të profetësisë dhe mrekulli, por qëllimi i tyre themelor ishte ky: ushtria ishte e uritur, kështu Zoti i Gjithëfuqishëm siguroi një gosti për një mijë njerëz, e cila u realizua nga një grusht ushqimi, prej thesarit të Tij nga e Padukshmja, ashtu siç krijon Ai njëmijë pesha hurmash nga një bërthamë e vetme. Dhe për një ushtri që luftonte në rrugën e Tij, Ai bëri që të vërshonte uji, si uji i Keutherit, nga gishtërinjtë e Komandantit të Madh dhe u dha atyre të pinë.

Për këtë arsye, të gjithë shembujt e mrekullive që lidhen me ushqimin e me ujin, nuk arrijnë shkallën e mrekullisë së rënkimit të trungut. Megjithatë, në tërësinë e tyre, llojet e ndryshme të këtyre dy mrekullive janë aq të shumta e të njoftuara me unanimitet aq sa rënkimi i trungut. Pastaj jo gjithkush mund ta shohë pikërisht

bereqetin e ushqimit dhe vërshimin e ujit nga gishtërinjtë, por sheh rezultatin e tij. Kurse kushdo që ishte i pranishëm në xhami e dëgjoi rënkimin e trungut. Prandaj ajo u përhap gjërësisht.

Në qoftë se thuhet: Të gjitha veprimet dhe sjellja e Profetit të Nderuar a.s.m. u njoftuan e u transmetuan nga sahabët me kujdesin e me rëndësinë më të madhe; atëherë, përse mrekulli të tilla të mëdha tregohen vetëm nëpërmjet dhjetë ose njëzet zinxhirësh, kur ato duhet të ishin njoftuar nëpërmjet njëqind zinxhirëve? Gjithashtu, pse raportohen shumica e njoftimeve nga Hazreti Enesi, Xhabiri dhe Ebu Hurejreja, ndërsa nga Hazreti Ebu Bekri dhe Umeri transmetohen pak?

Përgjigjja: Përgjigjja për pjesën e parë të pyetjes është dhënë në Parimin e Tretë të Treguesit të Katërt. Për sa i takon pjesës së dytë, ashtu siç shkon dikush që ka nevojë për ilaçe te doktori, për t'u konsultuar për probleme ndërtimi shkon tek inxhinieri ndërtimor dhe, nëse ka nevojë për të mësuar çështje sheriati, pyet myftiun, e kështu me rradhë; gjithashtu disa nga dijetarët midis sahabëve ishin të ngarkuar me detyrën për t'u transmetuar dhe përcjellur shekujve vijues hadithet e Profetit a.s.m., duke punuar me gjithë fuqinë e tyre për këtë qëllim. Po, Hazreti Ebu Hurejreja ia dedikoi të gjithë jetën për të mësuar përmendësh hadithet, ndërsa Hazreti Umeri, botës së politikës e të kalifatit. Kështu, Umeri raportoi shumë pak hadithe duke e lënë atë në besim e duke u mbështetur tek personat si, Ebu Hurejreja, Enesi e Xhabiri, për t'ia mësuar komunitetit musliman. Për më tepër, sahabeja rrëfyes i mirënjohur, i vërtetë, i sinqertë, i ndershëm e i besuar, i cili tregon një ngjarje përmes një zinxhiri, mendohej e gjykohej si i mjaftueshëm dhe nuk mbeti nevojë për një tjetër për ta transmetuar atë. Kjo është arsyeja pse disa ngjarje domethënëse u transmetuan vetëm nëpërmjet dy ose tre zinxhirëve të transmetimit.

* * *

SHENJA E NJËMBËDHJETË

Ndërsa Shenja e Dhjetë shpjegoi mrekullitë e Profetit a.s.m. që lidheshin me pemët, Shenja e Njëmbëdhjetë do të përshkruajë se si **shkëmbinjtë dhe malet midis krijesave të pajeta**, gjithashtu demonstruan mrekullitë Profetike. Këtu ne, nga shumë shembuj, do të përmendim shtatë apo tetë:

• ***Shembulli i parë:*** Transmeton Buhariu dhe dijetari i madh i Magribit Hazreti Kadi Ijadi në veprën e tij *Shifa esh-Sherif*, nëpërmjet një rrëfenje autentike nga Hazreti Ibn Mes'udi, Shërbyesi i Profetit a.s.m. i cili thotë: "Ndërsa po hanim së bashku me Profetin e Nderuar a.s.m., ne e dëgjonim ushqimin të jepte lavdërim për Zotin xh.sh.."

• ***Shembulli i dytë:*** Librat e saktë të hadithit njoftojnë nga Enesi dhe Ebu Dherri përmes një rrëfenje autentike se, Hazreti Enesi (shërbyesi i Profetit) tha: "Ne ishim së bashku me Profetin e Nderuar a.s.m. kur Ai mori një grusht gurësh të vegjël dhe ndërkohë ato nisën të lavdërojnë Zotin xh.sh. në dorën e Tij të bekuar. Atëherë Ai i vendosi ato në dorën e Ebu Bekrit, të vërtetit, dhe përsëri ato lëvduan Zotin xh.sh.. Në linjën e tij të transmetimit, Ebu Dheri, el-Gifari thotë: "Atëherë Ai i vendosi ato në dorën e Hazreti Umerit dhe përsëri ato lavdëruan All-llahun xh.sh.; pastaj Ai i mori ato dhe i vendosi në tokë, atëherë ato mbetën të heshtur. Ndërkohë, Ai i mori ato përsëri dhe i vendosi në dorën e Hazreti Osmanit ku përsëri ato filluan të bëjnë lavdërime për Zotin xh.sh.". Ebu Dherri dhe Hazreti Enesi tregojnë: "Ai i vendosi ato në duart tona dhe heshtën."

• ***Shembulli i tretë:*** Vërtetohet nëpërmjet një rrëfenje të vërtetë nga Hazreti Aliu, Hazreti Xhabiri dhe Hazreti Aisheja es-Siddika se "Shkëmbinjtë dhe malet i thonin Profetit të Nderuar a.s.m.:

اَلسَّلَامُ عَلَيْكَ يَا رَسُوْلَ اللّٰهِ *"Paqja qoftë mbi ty o Profet i All-llahut!."*

Në zinxhirin e rrëfenjës së Hazreti Aliut ajo thotë: "Kurdo që ne shkonim në rrethinat e Mekës, në ditët e hershme të profetësisë së Tij, pemët dhe shkëmbinjtë që takonim, thonin:

اَلسَّلَامُ عَلَيْكَ يَا رَسُوْلَ اللّٰهِ *"Paqja qoftë mbi ty o i dërguari i Zotit!"*

Ndërsa në zinxhirin e tij të transmetimit, Hazreti Xhabiri thotë: "Sa herë që Profeti i Nderuar a.s.m. kalonte pranë një guri ose peme, ato bënin sexhde para Tij, domethënë, shfaqnin bindje ndaj Atij dhe deklaronin:

اَلسَّلَامُ عَلَيْكَ يَا رَسُوْلَ اللّٰهِ *"Paqja qoftë mbi ty o i dërguari i Zotit!"*

Në njërën nga rrëfenjat e Xhabirit, Profeti i Nderuar a.s.m. tha:

اِنِّي لَأَعْرِفُ حَجَرًا كَانَ يُسَلِّمُ عَلَيَّ

"Unë e njoh një shkëmb që më përshëndeste mua."

Disa thanë se ai aludonte për – El Haxher el Esved- *Gurin e Zi të Qabesë*.

Në linjën e saj të transmetimit, Hazreti Aisheja tha; Profeti i Nderuar a.s.m. tha:

لَمَّا اسْتَقْبَلَنِي جِبْرَائِيْلُ بِالرِّسَالَةِ جَعَلْتُ لَا أَمُرُّ بِحَجَرٍ وَلَا شَجَرٍ
اِلَّا قَالَ اَلسَّلَامُ عَلَيْكَ يَا رَسُوْلَ اللّٰهِ

"Kur Xhebraili më solli mesazhin, sa herë që kaloja pranë një shkëmbi ose një peme, veçse thonte: "Paqja qoftë mbi Ty, o i dërguari i Zotit xh.sh.!"

• ***Shembulli i katërt:*** Njoftohet përmes një rrëfenje autentike nga Hazreti Abbasi se, "Profeti i Nderuar a.s.m. i mbuloi Abassin dhe katër djemtë e tij (Abdullahin, Ubejdullahin, Fadlin dhe Kusemin) me një copë rrobe të quajtur "*Mulaet",* e cila u lut:

يَا رَبِّ هٰذَا عَمِّيْ وَصِنْوُ اَبِيْ وَهٰؤُلَاءِ بَنُوْهُ فَاسْتُرْهُمْ مِنَ النَّارِ
كَسَتْرِيْ اِيَّاهُمْ بِمُلَائَتِيْ

"O Krijuesi im! Ky është xhaxhai im; mbroji nëpërmjet meje këto djemtë e tij dhe mbuloji ata që të mos i prekë Zjarri, ashtu siç po i mbuloj me këtë rrobe! Tavani, dera dhe muret e shtëpisë u bashkuan në lutje duke thënë: amin! amin!"

• ***Shembulli i pestë:*** Librat e saktë, veçanërisht Buhariu, Ibn Habbani, Davudi dhe Tirmidhiu me unanimitet njoftojnë nga Hazreti Enesi, Ebu Hurejreja, Osman *Dhun'nurejn* dhe Sa'd Ibn Zejdi, njëri midis të dhjetëve të cilëve u është premtuar Xhenneti (Parajsa) se: "Profeti i Nderuar a.s.m. u ngjit në malin e Uhudit së bashku me Ebu Bekrin es-Siddik, Umerin el-Faruk dhe Osmanin Dhun'nurejn; Mali Uhud, ose për shkak të madhështisë së tyre, ose nga vetë gëzimi e lumturia e tij, filloi të dridhej e të trazohej. Profeti i Nderuar a.s.m. tha:

اُثْبُتْ يَا اُحُدُ فَاِنَّمَا عَلَيْكَ نَبِيٌّ وَصِدِّيقٌ وَشَهِيدَانِ *"Mos lëviz! sepse mbi ty janë një profet, një Siddik, i vërteti, dhe dy shehidë - martirë-!"*

Ky hadith, jep lajme nga e padukshmja se Hazreti Umeri dhe Osmani do të martirizoheshin.

Si shtojcë e këtij hadithi , tregohet se: Kur Profeti i Nderuar a.s.m. emigroi nga Mekka i ndjekur nga jobesimtarët, ata u ngjitën në malin e quajtur *Thebir*. Thebiri tha: "Zbrisni prej meje, o Profet i Zotit xh.sh., unë kam frikë se Zoti xh.sh. do të më ndëshkojë mua në qoftë se ata të godasin ty sipër meje."

Atëherë mali *Hira* i thirri Atij: يَا رَسُولَ اللّٰهِ اِلَيَّ *"Eja tek unë, o Profet i All-llahut!"* Për këtë arsye, njerëzit e intuitës ndjejnë frikë mbi malin *Thebir* dhe një ndjenjë sigurie mbi malin *Hira*.

Siç mund të kuptohet nga ky shembull, këto male të mëdha janë secili si një shërbëtor i veçantë i Zotit xh.sh.. secili ngre lart dhe e lëvdon Atë; secili e njeh Atë dhe e do; secili është i ngarkuar me detyra. Ato nuk janë pa qëllim apo pa Pronar.

• ***Shembulli i gjashtë:*** Njoftohet përmes një rrëfenje autentike nga Hazreti Abdullah Ibn Umeri: "Ndërsa po mbante një predikim nga predikatorja, Profeti i Nderuar a.s.m. recitoi vërsetin:

وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ وَالْأَرْضُ جَمِيعًا قَبْضَتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ
وَالسَّمَاوَاتُ مَطْوِيَّاتٌ بِيَمِينِهِ

"Ata nuk e çmuan Zotin xh.sh. me atë madhështinë që i takon: Në ditën e Kijametit e gjithë toka do të jetë në grushtin e Tij dhe qiejt do të jenë të mbështjellur në Dorën e Tij të djathtë." (Kur'an, 39:67),

dhe tha:

إِنَّ الْجَبَّارَ يُعَظِّمُ نَفْسَهُ وَيَقُولُ أَنَا الْجَبَّارُ أَنَا الْجَبَّارُ أَنَا الْكَبِيرُ الْمُتَعَالُ

"Zoti, Madhështori, e lartëson Vetveten duke thënë: "Unë jam Madhështori! Unë jam i Gjithëfuqishmi! Unë jam i Lartësuari!"

Ndërsa Ai e tha këtë, predikatorja u drodh e u trondit aq shumë saqë ne u trembëm se do t'i shkaktonte Profetit të Nderuar a.s.m. të binte."

• ***Shembulli i shtatë:*** Raportohet përmes një rrëfenje autentike nga Hazreti Ibn Abbasi, i njohur si "Dijetari i Komunitetit musliman" dhe interpretuesi i Kur'anit, dhe nga Ibn Mes'udi, shërbyesi i Profetit dhe njëri nga shkollarët e mëdhenj të sahabëve, se ata thanë: "Në pushtimin e Mekkës ndodheshin treqind e gjashtëdhjetë idhuj brenda dhe rreth Qabesë, të mbërthyer e të ngulur me plumb tek gurët. Atë ditë Profeti i Nderuar a.s.m. bënte me shenjë me një shkop që Ai mbante në drejtim të çdo idhulli me radhë dhe duke thënë:

جَاءَ الْحَقُّ وَزَهَقَ الْبَاطِلُ إِنَّ الْبَاطِلَ كَانَ زَهُوقًا

"Erdhi e vërteta e u zhduk gënjeshtra; në të vërtetë gënjeshtra gjithmonë zhduket." (Kur'an, 17:81)

çdo idhull rrëzohej, kur Ai ia bënte me shenjë; në qoftë se i drejtohej idhullit nga fytyra, ai binte prapa; dhe nëse i drejtohej nga prapa, idhulli binte në fytyrë. Kështu, ato të gjithë u përmbysën dhe u rrëzuan përtokë."

• ***Shembulli i tetë:*** Ky është një tregim i shquar i priftit –murgut- të mirënjohur Bahira. Para fillimit të profetësisë së Tij, Profeti i Nderuar a.s.m. udhëtonte drejt Damaskut për tregti së bashku me xhaxhain e Tij Ebu Talibin dhe me disa të tjerë nga fisi i Kurejshit. Ata pushuan kur erdhën afër kishës së Bahiras. Murgu Bahira, i cili ishte oshënar dhe nuk përzihej me njerëzit, papritmas u shfaq. Ai e pa Muhammedin, të Besuarin a.s.m., midis karvanit dhe tha: *"Ai është Prijësi i botëve; Ai do të jetë Profet"*. Kurejshët pyetën: *"Si e di ti?"* Murgu i shenjtë u përgjigj: *"Unë pashë një re të vogël mbi karvan ndërsa ju po vinit. Kur ju u ulët, reja lëvizi drejt Tij dhe lëshoi hijen e saj sipër Tij. Unë, gjithashtu, pashë pemët e shkëmbinjtë të përkulnin veten e tyre para Tij, që një gjë të tillë ato e bëjnë vetëm përpara profetëve."*

Ndodhen të paktën tetëdhjetë shembuj të të njëjtit lloj, si këto tetë shembuj. Kur bashkohen, këto tetë shembuj formojnë një zinxhirë aq të fortë sa që asnjë dyshim nuk mund ta thyejë apo ta lëkundë atë... Duke e marrë si një tërësi, ky lloj mrekullie, domethënë folja e qënieve të pashpirta me qëllim që të dëshmojnë profetësinë e Tij, shpreh të njëjtën siguri si "Konsensusi në Kuptim". Secili shembull merr fuqi më të madhe se sa më vete nga fuqia e tërësisë. Po, një shtyllë e hollë bëhet e fuqishme kur bashkohet me shtylla të trasha. Duke u bërë ushtarë e duke iu bashkuar ushtrisë, një burrë i dobët e i pafuqishëm bëhet aq i fortë sa që mund të sfidojë një mijë burra.

* * *

SHENJA E DYMBËDHJETË

Kjo përbëhet nga tri shembuj që lidhen me Shenjën e Njëmbëdhjetë, por që janë shembuj të rëndësisë më të madhe.

- ***Shembulli i parë:*** وَمَا رَمَيْتَ إِذْ رَمَيْتَ وَلَٰكِنَّ اللَّهَ رَمَىٰ

"Dhe kur ti gjuajte, nuk ishe ti ai që gjuante, por ishte All-llahu Ai që gjuajti," (Kur'an, 8: 17)

Siç vërtetohet nga kërkimet e të gjithë komentatorëve të Kur'anit, dhe nga njoftimet e studiuesve të hadithit, ky vërset i referohet ngjarjes së mëposhtme gjatë luftës së Bedrit:

Profeti i Nderuar a.s.m. mori një grusht dhè e gurë të vegjël dhe ua hodhi ato fytyrës së ushtrisë së jobesimtarëve duke thënë: شَاهَتِ الْوُجُوهُ *U shformofshin fytyrat tuaja!"* "Sapo hynë këto fjalë në veshët e atyre të gjithëve, شَاهَتِ الْوُجُوهُ *U shformofshin fytyrat tuaja!",* pavarësisht se ajo ishte një frazë e vetme, po ashtu si dhe grushti i dheut hyri në sytë e secilit prej jobesimtarëve, gjithësecili u preokupua me sytë e vet dhe, ndonëse ishte në sulm, ushtria iku bishtlagur e mori arratinë nga fusha e betejës.

• Gjithashtu, gjatë luftës së Hunejnit, autoritetet e hadithit me në krye Imam Muslimin, njoftojnë se: Ashtu si në luftën e Bedrit, kur jobesimtarët po organizonin një sulm të rreptë, Ai përsëri u hodhi një grusht dhè, duke thënë: شَاهَتِ الْوُجُوهُ *"U shformofshin fytyrat tuaja!* Secilit vesh i hynë nga një fjalë شَاهَتِ الْوُجُوهُ me lejen e All-llahut, në fytyrën e secilit arriti një grusht dhè. Ata duke qenë të zënë me sytë e tyre, u tërhoqën dhe ikën nga beteja. Meqenëse kjo ngjarje e jashtëza-konshme e Bedrit dhe e Hunejnit nuk është brenda fuqisë së njeriut dhe shkaqeve të zakonshme, Kur'ani i Shpjegimit të Mrekullueshëm deklaroi:

وَمَا رَمَيْتَ إِذْ رَمَيْتَ وَلَٰكِنَّ اللَّهَ رَمَىٰ

"Dhe kur ti gjuajte, nuk ishe ti ai që gjuante, por ishte All-llahu Ai që gjuajti." (Kur'an, 8: 17)

Domethënë, "Ngjarja është jashtë fuqisë njerëzore. Ajo ndodhi, jo nëpërmjet aftësisë njerëzore, por në një mënyrë të jashtëzakonshme, me anë të fuqisë Hyjnore."

• **Shembulli i dytë:** Librat e saktë, me në krye Buhariun e Muslimin, tregojnë se: Gjatë ekspeditës së Hajberit, një grua çifute poqi një dhi duke e mbushur atë me një helm shumë të fortë. Ajo atëherë ia dërgoi Profetit të Nderuar a.s.m.. Sahabët sapo kishin filluar të hanin, kur papritmas, Profeti tha:

ارْفَعُوا أَيْدِيَكُمْ إِنَّهَا أَخْبَرَتْنِي أَنَّهَا مَسْمُومَةٌ

"Hiqni duart! Ajo (dhia) më njofton mua se është e helmuar!"

Gjithësecili tërhoqi dorën. Por Bishr Ibn el-Bara kishte ngrënë një kafshatë dhe vdiq nga efektet e helmit të rëndë. Profeti i Nderuar a.s.m. dërgoi dikë për ta thirrur çifuten me emrin Zejneb dhe e pyeti: "Pse veprove kështu?" Gruaja fatzezë tha: "Unë gjykova se, në qoftë se Ti do të ishe Profet, ajo nuk do të të dëmtonte, ndërsa po të ishe mbret, ajo do t'i shpëtonte njerëzit prej teje." Sipas disa rrëfenjash, Profeti urdhëroi dhe, në disa nuk urdhëroi që ajo të ekzekutohej. Dijetarët e vërtetë kanë thënë se vetë Profeti nuk urdhëroi që ajo të vritej, por e la për familjen e Bishrit dhe, ishin ata që e vranë atë.

Tani dëgjo disa pika që tregojnë aspektet e mrekullisë në këtë ngjarje të jashtëzakonshme:

• *Pika e parë:* Sipas një rrëfenje, disa prej sahabëve, gjithashtu, e dëgjuan dhinë duke folur.

• *Pika e dytë:* Sipas nj[illegible]tjetër, Profeti i Nderuar a.s.m., pasi i lajmëroi, tha*: "Thoni* بسم الله *Bismil-lah (me Emrin e All-llahut), e pastaj hani; helmi nuk do të ketë efekt dëmtues."*

Ibn Haxher el-Askalani nuk e pranon këtë rrëfenjë, ndërsa të tjerët e pranojnë.

• *Pika e tretë:* Çifutët tradhtarë donin t'i jepnin një goditje të befasishme Profetit të Nderuar a.s.m. dhe sahabëve të Tij të afërm, por duke u njoftuar për këtë nga e Padukshmja, paralajmërimi u provua i vërtetë, dhe komploti i tyre u zbulua dhe u asgjësua. Dhe kur Muhammedi a.s.m. nga i cili sahabët nuk kishin dëgjuar kurrë një thënie të pavërtetë, tha: "*Kjo dhi më tregon mua*." gjithësecili e besoi atë me bindje aq të sigurt sikur ata ta kishin dëgjuar vetë dhinë.

• ***Shembulli i tretë:*** Kjo përbëhet nga tre ngjarje të një mrekullie të Muhammedit a.s.m., e cila i ngjason "Dorës Ndriçuese" dhe "Shkopit" të Musait Alejhis-selâm.

• *Ngjarja e parë:* Imam Ahmed Ibn Hanbeli, duke shpjeguar e vërtetuar një rrëfenjë nga Ebu Said el-Hudri, njofton: "Në një natë të errët e të stuhishme, Profeti i Nderuar a.s.m. i dha Katade Ibn el-Nu'manit një shkop duke i thënë: "*Ky shkop do të ndriçojë dhjetë jard (*1 jard = 91,4 cm.) *rreth e qark teje. Ti do të shikosh një hije të zezë kur të arrish në shtëpinë tënde, ajo hije është djalli. Prandaj flake atë jashtë shtëpisë e përzeje*"

Katadeja e mori shkopin dhe u nis. Ai lëshoi dritë si dora ndriçuese e Musait. Ai pastaj erdhi tek shtëpia, ku pa figurën me hije dhe e dëboi."

• *Ngjarja e dytë:* Ndërsa duke luftuar idhujtarët gjatë betejës së madhe të Bedrit, ajo betejë që është burim çudirash, Uk'kash Ibn Muhas'sin el-Esedi e kishte shpatën e tij të thyer. Profeti i Nderuar a.s.m. i dha atij një kërrabë të trashë në vend të shpatës duke i thënë: "Lufto me këtë!" Papritmas, me lejen e Zotit xh.sh., kërraba u bë një shpatë e bardhë e gjatë, dhe ai luftoi me të. Ai vazhdonte ta mbante

shpatën te personi i tij deri kur ra shehid -martir- gjatë luftës së Jemames. Kjo ngjarje është e sigurt, sepse gjatë gjithë jetës së tij ai e mbajti shpatën me krenari dhe ajo shpatë u bë e mirënjohur me emrin: "*El-Avn"* (Ndihmë). Kështu dy provat e kësaj ngjarje janë krenaria e Uk'kashës; gjithashtu janë krenari edhe emri i shpatës "*El-Avn"* "Ndihmë"*,* edhe fama e saj e përhapur gjërësisht.

• *Ngjarja e tretë:* Njoftohet nga autoritetet e hadithit si Ibn Abd el-Barr, një studiues i shquar i njohur si dijetari i kohës, se në luftën e Uhudit, shpata e Abdullah Ibn Xhahsh, kushëriri i Profetit të Nderuar a.s.m., u thye. Profeti i Nderuar a.s.m. i dha atij një shkop që u bë një shpatë në dorën e tij. Ai luftoi me të, dhe pas luftës, ai produkt mrekullie mbeti shpatë.

Në *"Sijerin"* e tij, i mirënjohuri Ibn el-Sej'jid En-Nas tregon se disa kohë më vonë, Abdullahu ia shiti shpatën një njeriu me emrin Buga el-Turki, për dyqind lira. Kështu, këto dy shpata ishin secila mrekulli si Shkopi i Musait. Por, ndërsa nuk mbeti asnjë aspekt mrekullie tek shkopi pas vdekjes së Musait, këto dy shpata mbetën mrekulli pas vdekjes së Profetit Muhammed a.s.m..

* * *

SHENJA E TREMBËDHJETË

Një tjetër nga Mrekullitë e Muhammedit a.s.m. nga e cila ndodhën shumë shembuj që raportohen me unanimitet, është se **të sëmurët e të plagosurit shëroheshin përmes frymës së Tij të bekuar.** Raportimet e këtij lloji mrekullie janë si një e tërë, "Unanimisht në Kuptim". Disa nga shembujt e këtyre mrekullive gjithashtu konsiderohen të jenë "Unanimisht në Kuptim". Edhe në qoftë se të tjerat janë njoftime të veçanta, por meqenëse ato janë treguar e konfirmuar si autentike nga autoritetet e sakta të shkencës së hadithit, ato japin sigurinë e diturisë. Ne do të përmendim disa shembuj të mrekullive prej shumë shembujsh:

• ***Shembulli i parë:*** Dijetari i shquar i Magribit, Kadi Ijadi, në veprën e tij: *"Shifa el-Sherif",* tregon përmes një zinxhiri të lartë të autoriteteve dhe linjave të shumta të transmetimit se Sa'ëd Ibn Ebi Vek'kas, shërbyesi i Profetit të Nderuar a.s.m. dhe komandant, dhe kryekomandant i ushtrisë së Islamit në kohën e Hazreti Umerit, çliruesi i Iranit dhe njëri nga të përgëzuarit me Xhennet, tha: "Unë isha në anën e Profetit të Nderuar a.s.m. gjatë luftës së Uhudit. Profeti i Nderuar a.s.m. gjuajti me shigjeta kundër jobesimtarëve deri sa harku i tij u thye. Atëherë Ai m'i dha mua shigjetat duke më thënë t'i gjuaja ato. Shigjetat që Ai m'i dha, ishin pa maja (koka), d.m.th. pa puplat që i ndihmojnë shigjetat të fluturojnë. "Ai po më urdhëronte t'i gjuaja," gjë të cilën e bëra dhe ato fluturuan si shigjeta fluturuese duke qëlluar trupat e jobesimtarëve e duke i shpuar ata. Në atë pikë, Katade Ibn Nu'man u qëllua në sy nga një shigjetë duke ia nxjerë syrin nga vendi, kështu ajo qëndronte mbi fytyrën e tij. Profeti i Nderuar a.s.m. e mori syrin në dorën e Tij të bekuar e shëruese dhe e vendosi në gropën e syrit; ai u shërua sikur të mos i kishte ndodhur asgjë. Dhe u bë më i miri i të dy syve të tij.

Kjo ngjarje u bë shumë e njohur. Madje një nip i Katades njëherë e prezantoi vetveten te Umer Ibn Abdul'Aziz duke i thënë: "Unë jam nipi i atij, që kur Profeti i Nderuar a.s.m. e vendosi syrin e tij në gropën e syrit pasi i kishte dalë, ai befasisht u shërua dhe u bë syri i tij më i mirë." Ai këtë e shprehu në varg duke prezantuar vetveten te Hazreti Umeri në atë mënyrë. [216]

• Gjithashtu tregohet përmes një rrëfenje autentike se gjatë betejës, e njohur si, *Jeum al-Dhikarat*, Ebu Katade u qëllua në fytyrë nga një shigjetë. Profeti i Nderuar a.s.m. e preku fytyrën e tij me dorën e Tij të bekuar. Ebu Katade tha: "Unë nuk ndjeva fare dhimbje dhe as plaga nuk u qelbëzua."

• ***Shembulli i dytë:*** Librat autentikë të hadithit, me në krye Buhariun dhe Muslimin, raportojnë se Profeti i Nderuar a.s.m. e kishte caktuar Ali el-Hajdarin si flamurtar gjatë luftës së Hajberit, por sytë e tij i dhimbnin rëndë për shkak të sëmundjes. Në momentin që vendosi jargën e Tij kuruese në sytë e tij, ato u shëruan pa lënë asnjë shenjë bezdie. Në mëngjesin e së nesërmes, Aliu pushtoi Kështjellën e Hajberit, duke lëvizur portën shumë të rëndë e duke e përdorur atë si mburojë në duart e tij.

• Gjatë të njëjtës betejë, këmba e Seleme Ibn el-Akva u qëllua dhe u hap nga një shpatë; Profeti i Nderuar a.s.m. i fryu asaj dhe këmba menjëherë u shërua.

• ***Shembulli i tretë:*** Autoritetet për jetën e Profetit me në krye Nesaiun, njoftojnë nga Othman Ibn Hunejf se Othmani tha: "Një njeri i verbër erdhi te Profeti i Nderuar a.s.m. dhe i tha: "Lutju All-llahut që të më shërohen sytë e të mund të shikoj!" Profeti i Nderuar a.s.m. i tha:

أَنَا ابْنُ الَّذِي سَالَتْ عَلَى الْخَدِّ عَيْنُهُ فَرُدَّتْ بِكَفِّ الْمُصْطَفَى أَحْسَنَ الرَّدِّ
فَعَادَتْ كَمَا كَانَتْ لِأَوَّلِ أَمْرِهَا فَيَا حُسْنَ مَا عَيْنٍ وَيَا حُسْنَ مَا رَدِّ

فَانْطَلِقْ وَتَوَضَّأْ ثُمَّ صَلِّ رَكْعَتَيْنِ وَقُلِ اللّٰهُمَّ إِنِّي أَسْئَلُكَ وَأَتَوَجَّهُ إِلَيْكَ
بِنَبِيِّ مُحَمَّدٍ نَبِيِّ الرَّحْمَةِ يَا مُحَمَّدُ إِنِّي أَتَوَجَّهُ بِكَ إِلَى رَبِّكَ أَنْ يَكْشِفَ عَنْ بَصَرِي
اَللّٰهُمَّ شَفِّعْهُ فِيَّ

"Shko e merr avdes, atëherë fal dy rekate e thuaj: "O Zot unë të kërkoj Ty dhe drejtohem tek Ty për hir të Profetit Muhammed, Profetit të mëshirës. O Muhammed, unë drejtohem te Krijuesi yt për hir Tënd dhe nëpërmjet teje, duke kërkuar që të më zbulojë shikimin. O Zot! Bëje atë ndërmjetësin tim!" Ai shkoi dhe e bëri këtë, dhe kur ai u kthye, ne shikuam se sytë e tij ishin hapur dhe mund të shihnin shumë mirë.

• ***Shembulli i katërt:*** Një autoritet i madh, Imam Ibn Veheb, tregon se: Heroit Muavvidh Ibn Afra, njërit nga katërmbëdhjetë martirët e luftës së Bedrit, i ishte prerë dora nga Ebu Xhehli, i mallkuari, ndërsa po luftonin kundra njëri-tjetrit. Ai e mori dorën me dorën tjetër të tij dhe shkoi te Profeti i Nderuar a.s.m.. Profeti i Nderuar a.s.m. e vendosi dhe e mbërtheu dorën në vendin e saj dhe shpërndau jargën e Tij sipër saj. Menjëherë dora u shërua. Muavvidhi shkoi përsëri të luftojë dhe vazhdoi të luftonte deri sa u martirizua.

• Imam Xhelil Ibn Veheb, gjithashtu njofton: "Gjatë të njëjtës betejë, Hubejb Ibn Jesaf u godit në shpatull nga një shpatë saqë ai mori një plagë të rëndë, dhe në një pjesë të saj shumë keq. Profeti i Nderuar a.s.m. e ktheu prapa atë pjesë duke e bashkuar me krahun e me shpatullën, pastaj i fryu dhe ajo u shërua.

Atëherë, sigurisht këto dy ngjarje janë të ndara e raportime të veçuara, por në qoftë se një autoritet si Ibn Vehheb i konsideron ato të jenë të shëndosha dhe, në qoftë se ato ndodhën gjatë betejës si ajo e Bedrit e cila ishte një burim mrekullish dhe, në qoftë se ka shumë shembuj që u ngjasojnë këtyre dy ngjarjeve, sigurisht mund të thuhet se ato ndodhën me siguri.

Në të vërtetë, gjenden ndoshta njëmijë shembuj të vërtetuara në hadithe autentike se dora e bekuar e Profetit të Nderuar a.s.m. ishte shëruese për atë.

Një Pjesë që ia vlen të shkruhet me Ar e Diamant

Po, siç u shkrua më lart: Gurët e vegjël lartësonin e lavdëronin Zotin xh.sh. në dorën e Tij; dhe në përputhje me vërsetin, وَمَا رَمَيْتَ إِذْ رَمَيْتَ *"**Kur ti gjuajte, nuk ishe ti ai që gjuante, por All-llahu ishte Ai që gjuajti**", dheu dhe gurët e vegjël në të njëjtën dorë dukę u bërë si raketa e predha kundra armikut dhe dukę i shpartalluar ata; dhe sipas vërsetit* وَانْشَقَّ الْقَمَرُ *"**dhe Hëna u ça më dysh**", çarja e hënës me një shenjë të gishtave të së njëjtës dorë, vërshimi i ujit nga dhjetë gishtërinjtë dhe furnizimi me ujë i një ushtrie... dhe e njëjta dorë, dukę qenë shëruese për të sëmurët e të plagosurit, e gjitha kjo tregon se çfarë mrekullie e çuditshme e Fuqisë Hyjnore ishte ajo dorë e bekuar.*

Tamam sikur pëllëmba e asaj dore të ishte një vend i vogël midis miqsh për përmendjen e Zotit xh.sh.. Po të futeshin në të edhe gurët e vegjël, ato lartësonin Zotin xh.sh. dhe recitonin Emrat e Tij; ndërsa përballë armiqve, ajo pëllëmbë ishte një depo e vogël municioni, saqë kur futeshin në të guralecët e dheu, ato transformoheshin në raketa e predha.

Për të sëmurët e të plagosurit ajo ishte si një farmaci e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm, e cila ishte ilaç për çfarëdolloj sëmundjesh që të binin. Kur ngrihej me lavdi, ajo çante hënën dukę i dhënë asaj formën e dy harqeve, ndërsa kur ajo ulej me bukuri, bëhej si një burim mëshire me dhjetë rubineta dukę zbrazur ujin si burimi i Keutherit.

Në qoftë se dora e vetme e këtij Profeti të bekuar ishte mjeti i atyre mrekullive të çuditshme, atëherë a nuk duhet të kuptohet qartë se sa i pranueshëm është Ai para Krijuesit të Universit dhe sa besnik është Ai për çështjen e Tij, dhe sa me fat janë ata që deklarojnë besëlidhjen me Të?

***Një pyetje*:** Thuhet që Ti përshkruan shumë gjëra si të raportuara me unanimitet. Por shumicën e tyre ne po e dëgjojmë për herë të parë. Atëherë raportimet e shumta e unanime, a mund të injorohen e të mbeten aq të fshehta?

***Përgjigje*:** Ndodhen shumë gjëra në lidhje me të cilat ka një konsensus në raportimet e ndryshme të tyre dhe të cilat janë të vetëkuptueshme për dijetarët e sheriatit, por janë të panjohura për të tjerët. Për dijetarët e hadithit ndodhen shumë gjëra, të cilat për poetët nuk kanë madje as statusin e raportimeve të veçuara apo të izoluara, e kështu me radhë. Ekspertët e të gjitha shkencave shpjegojnë teoritë dhe aksiomat e shkencës së tyre dhe njerëzit e zakonshëm mbështeten tek ato dhe, ose u nënshtrohen atyre, ose bëhen një nga ata në studimin e asaj shkence dhe gjejnë çfarë gjetën ata. Tani ngjarjet, raportimet e të cilave ne i përshkruajmë si duke formuar "Konsensusin e Vërtetë", "Konsensusin në Kuptim", ose të cilat shprehin siguri si "Konsensus" janë treguar se janë kështu si nga dijetarët e hadithit, dijetarët e sheriatit, shkollarët e parimeve të fesë dhe nga shumica e niveleve të tjera të dijetarëve. Në qoftë se njerëzit e zakonshëm në pakujdesinë e tyre, ose injorantët, të cilët mbyllin sytë e tyre ndaj të vërtetës nuk e njohin këtë, natyrisht faji është i tyre.

• ***Shembulli i pestë:*** Duke e shpjeguar e vërtetuar atë, Imam Bagavi tregon se: "Tek beteja e Hendekut, këmba e Ali Ibn El-Hakam u thye nga goditja e një jobesimtari. Profeti i Nderuar a.s.m. e fërkoi atë. Në momentin që e bëri këtë, ajo u shërua, sa që ai nuk zbriti as nga kali i tij."

• ***Shembulli i gjashtë:*** Dijetarët e hadithit me në krye Imam Bejhakiun njoftojnë se: "Imam Aliu ishte shumë i sëmurë. Në dhimbjen e tij, ai po rënkonte dhe lutej për vetveten. Profeti i Nderuar a.s.m. erdhi dhe tha: اَللّٰهُمَّ اشْفِهِ *"O Zot! Jepi atij shërim,"* dhe e preku Hazreti Aliun me këmbë. Ndërkohë e urdhëroi atë të ngrihej në

këmbë. Imam Aliu deklaroi duke thënë: "Unë nuk kam vuajtur kurrë më nga ajo sëmundje."

• ***Shembulli i shtatë:*** Ky është një tregim i mirënjohur i Shurahbil el-Xhufi. Ai kishte një tumor në pëllëmbën e dorës së tij, saqë ai nuk mund të mbante as shpatën e tij e as frerat e kalit të tij. Profeti i Nderuar a.s.m. e fërkoi tumorin me dorën e Tij të bekuar dhe i bëri masazh; asnjë shenjë tumori nuk mbeti.

• ***Shembulli i tetë:*** Gjashtë fëmijë, secili më vete, arritën një nga mrekullitë e Profetit Muhammed a.s.m..

• **I Pari:** Ibnu Ebi Shejba, -një dijetar shumë i përpiktë e i mirënjohur i hadithit-, rrëfen se një grua e solli fëmijën te Profeti i Nderuar a.s.m.. Fëmija pati një dhimbje; ai nuk mund të fliste dhe ishte i metë. Profeti i Nderuar a.s.m. e shpërlau gojën e Tij me ujë dhe lau duart, atëherë ai ia dha ujin gruas duke i treguar asaj "t'ia jepte atë fëmijës për ta pirë." Pasi fëmija e kishte pirë atë, nuk mbeti asgjë nga sëmundja e nga dhimbja e tij. Dhe ai u bë aq inteligjent e i përplot saqë la prapa edhe më të ndriturit e bashkëkohësve të vet.

• **I Dyti:** Sipas një rrëfenje autentike, Hazreti Ibn Abbasi ka thënë: "Një fëmijë i çmendur u soll te Profeti i Nderuar a.s.m.. Ai vendosi dorën e Tij të bekuar në kraharorin e tij dhe fëmija papritmas nxori (volli) një gjë të vogël të zezë si një kastravec. Fëmija u shërua dhe shkoi."

• **I Treti:** Imam Bejhakiu dhe Nesaiu tregojnë përmes një zinxhiri të saktë transmetimi se një fëmijë i quajtur Muhammed Ibn el-Hatib ishte djegur nga një tenxhere -tigan- me ujë të valuar dhe i gjithë krahu i tij u dogj. Ndërkohë Profeti i Nderuar a.s.m. e preku krahun e tij dhe duke shpërndarë jargën e Tij sipër krahut të djegur, në të njëjtin çast ai u shërua.

• **I Katërti:** Një fëmijë i rritur, por memec erdhi te Profeti i Nderuar a.s.m.. Ai e pyeti fëmijën: *"Kush jam unë?"* Fëmija, i cili kishte qenë memec që kur kishte lindur, u përgjigj:

أَنْتَ رَسُولُ اللهِ *"Ti je Profeti i All-llahut xh.sh.!"* dhe nisi të flasë.

• **Fëmija i Pestë:** Xhelalud'din Sujuti, i cili u nderua me bisedën e Profetit të Nderuar a.s.m. në shumë raste duke qenë në gjendje zgjimi, dhe që ishte dijetari kryesues i kohës së tij, duke shpjeguar e vërtetuar një rrëfenjë, njofton: "Sapo u lind një person i shquar me emrin Mubarak el-Jemameh u dërgua nga një burrë te Profeti i Nderuar a.s.m.. Profeti i Nderuar a.s.m. iu drejtua fëmijës me dashamirësi dhe, ndërkohë fëmija foli:

أَشْهَدُ أَنَّكَ رَسُولُ اللهِ *"Dëshmoj se Ti je i dërguari i All-llahut".*

Profeti i Nderuar a.s.m. i tha: Barekall-llah *"Zoti të bekoftë".* Fëmija kurrë më nuk foli në foshnjërinë e tij dhe, më vonë u bë i njohur si "Mubarak el-Jemame" -i bekuari Jemame-, meqenëse ai kishte qenë objekt i kësaj mrekullie e të Dërguarit dhe i lutjes së Tij Profetike.

• **Fëmija i Gjashtë:** Një herë, një i ri i pasjellshëm ndërpreu faljen e Profetit të Nderuar a.s.m. duke kaluar para Tij ndërsa Ai po falej. Profeti i Nderuar a.s.m. tha اَللّٰهُمَّ اقْطَعْ أَثَرَهُ *"O Zot! shkurtoja hapat e tij!"* Pas kësaj, fëmija qe i pamundur të ecte, si një dënim për sjelljen e tij të keqe.

• **Fëmija i shtatë:** Një grua e pacipë, që ishte me natyrë si fëmijë, i kërkoi Profetit të Nderuar a.s.m. një copë nga buka që Ai po hante. Ai i dha asaj ca bukë, por ajo tha: "Jo, unë dua një copë nga buka në gojën tënde." Ai ia dha asaj edhe atë dhe, pasi hëngri kafshatën, ajo u bë gruaja më e druajtur dhe me ndjesi më të madhe turpi në Medine.

Nuk ndodhen tetëdhjetë, por ndoshta tetëqind shembuj të tjerë të kësaj mrekullie që u ngjasojnë tetë shembujve të lartëpërmendur. Shumica e të cilëve tregohen në librat e haditheve dhe në librat e biografisë së Profetit.

Po, meqenëse dora e bekuar e Profetit të Nderuar a.s.m. ishte si farmacia e mjekut Llukmanit të Urtë; dhe jarga, ishte si çezmeja e ujit

të jetës së Hazreti Hizrit, dhe fryma e Tij qetësuese e shëruese ishte si ajo e Hazreti Isait (Jezusit) a.s., sigurisht shumë njerëz do ta gjenin atë dorë mjet shpëtimi; meqenëse njerëzit goditeshin nga shumë fatkeqësi të ndryshme, natyrisht ata paraqiteshin shumë tek Profeti i Nderuar. Të sëmurët, fëmijët dhe të çmendurit erdhën në grupe të mëdha, të gjithë u shëruan dhe shkuan. Ebu Abdurr-rrahman el-Jemani, i njohur si "Tavus", madje është ai që bëri dyzet herë haxhin, dhe për dyzet vjet kreu faljen e sabahut me avdesin e faljes së jacisë së mbrëmjes paraprirëse, dhe ishte njëri që u takua me shumë sahabe, dhe ishte njëri nga Imamët më të mëdhenj të gjeneratës që i pasoi ata (Tabiinët), deklaroi e bëri njoftim të sigurt se: "Sa shumë të çmendur erdhën te Profeti i Nderuar a.s.m., dhe Profeti i Nderuar a.s.m. me të vënë dorën e Tij në kraharorët e tyre, ata të gjithë u shëruan; asnjë nuk mbeti pa u shëruar."

Atëherë, meqenëse një imam i madh i tillë si ai, i cili pati lidhje direkte me epokën e lumturisë, bëri deklarata të tilla të përgjithshme e të sigurta, sigurisht asnjë nga të sëmurët që erdhën tek Ai nuk mbeti pa u shëruar. Pasi gjetën shërim, Atë e kërkuan me mijëra.

* * *

SHENJA E KATËRMBËDHJETË

Nga llojet e mrekullive të Profetit a.s.m. ndodhet një lloj i madh, është ai i çudirave që u shfaqën si rezultat i lutjeve të Tij. Ky lloj është i sigurt, dhe ka një "Konsensus të Vërtetë" në njoftimet e shumta të tyre. Shembujt e atij lloji janë aq të shumtë saqë nuk llogariten dhe, shumica e këtyre kanë arritur shkallën e "Konsensusit", ose janë bërë të mirënjohur si të tillë. Të tjerët janë njoftuar nga autoritete të tilla saqë kanë të njëjtën siguri si e "Konsensusit" të mirënjohur. Si shembuj, ne do të përmendim vetëm disa nga shembujt e shumtë të këtij lloji mrekullie që janë shumë të mirënjohur e më të afërt me shkallën e "Konsensusit", duke dhënë disa pjesë të secilit shembull.

• ***Shembulli i parë:*** Fakti se lutjet e vazhdueshme e të përsëritura të Profetit të Nderuar a.s.m. për shi gjithmonë pranoheshin me shpejtësi, është transmetuar nga autoritetet e haditheve, kryesisht nga Imam Buhariu dhe Imam Muslimi. Kishte raste kur në predikatore Ai ngrinte duart e Tij për lutje për të rënë shi dhe, madje para se Ai t'i ulte ato, shiu fillonte të binte. Siç u përmend lart, një ose dy herë kur ushtria ishte e goditur nga etja, retë vinin e zbraznin shi. Para misionit të Tij Profetik, madje gjatë fëmijërisë së Tij, gjyshi i Profetit të Nderuar a.s.m., Abdul Muttalibi, shkonte të lutej për shi, për hir të fytyrës së bekuar të Tij, dhe shiu binte. Fakti u bë i shquar përmes një poeme të Abdul Muttalibit.

• Dhe pas vdekjes së Profetit, Hazreti Umeri u lut duke e bërë Hazreti Abbasin ndërmjetës, duke thënë: *"O Zoti im! Ky është xhaxhai i të Dashurit Tënd". Na sjell shi për hir të Tij!"* Dhe shiu binte.

• Dhe Imam Buhariu e Muslimi tregojnë gjithashtu se: Profetit të Nderuar a.s.m. iu kërkua për të rënë shi. Ai u lut dhe ra një shi i tillë saqë ata u detyruan t'i kërkonin Atij të lutej për t'u ndalur. Ai u lut dhe shiu menjëherë pushoi.

• ***Shembulli i dytë:*** Është pothuajse aq i mirënjohur sa ato ngjarje rreth të cilave ka shumë njoftime me unanimitet, se kur numri i sahabëve dhe i besimtarëve nuk kishte arritur akoma dyzet vetë, Profeti i Nderuar a.s.m., në mënyrë të fshehtë, ndërsa po kryente adhurimin e tij, u lut:

اَللّٰهُمَّ اَعِزَّ الْاِسْلَامَ بِعُمَرَ بْنِ الْخَطَّابِ اَوْ بِعُمَرَ بْنِ الْهِشَامِ

"O Zot! Forcoje Islamin ose nëpërmjet Umer Ibn El-Hattabit, ose me anë të Umer Ibn Hisham (Ebu Xhehilit)".

Mbas një ose dy ditësh, Hazreti Umer Ibn Hattabi erdhi në besim dhe ishte shkak për krenarinë e për mbështetjen e Islamit, saqë ai fitoi titullin e lartë "el-Faruk" (dalluesi midis të vërtetës dhe gënjeshtrës).

• ***Shembulli i tretë:*** Profeti a.s.m. u lut për sahabe të shquar për disa qëllime të ndryshme. Lutjet e Tij u pranuan të gjitha në një mënyrë aq të mahnitshme, saqë kerametet -provat, çudirat- e këtyre lutjeve arritën gradën e mrekullisë. Për shembull, Buhariu dhe Muslimi si dhe të tjerët tregojnë se Profeti u lut për Ibnu Abbasin siç vijon:

اَللّٰهُمَّ فَقِّهْهُ فِي الدِّيْنِ وَعَلِّمْهُ التَّأْوِيلَ

"O Zot Jepi atij njohuri në fe dhe mësoja atij interpretimin."

Kjo lutje u pranua në një mënyrë të tillë saqë Ibn Abbasi fitoi titullin e lavdishëm: "Interpretuesi i Kur'anit" dhe arriti shkallën e lartë dhe u quajt: "Dijetari i komunitetit musliman." Kur ai ishte ende shumë i ri, Umeri e përfshinte atë në mbledhjet e dijetarëve fetarë dhe të sahabëve kryesues.

• Gjithashtu, shkruesit e librave të haditheve të saktë, me në krye Imam Buhariun dhe Muslimin, tregojnë se nëna e Enesit iu përgjërua Profetit të Nderuar a.s.m. duke i thënë: "Lutu që shërbyesi yt Enesi të jetë i bekuar me pasuri të shumtë dhe me pasardhës." Profeti a.s.m. u lut duke thënë:

اَللّٰهُمَّ اَكْثِرْ مَالَهُ وَوَلَدَهُ وَبَارِكْ لَهُ فِيمَا اَعْطَيْتَهُ

"O Zot! Shumoje pasurinë e tij dhe fëmijët dhe bekoje në atë që i ke dhuruar."

Afër fundit të jetës së tij, Hazreti Enesi tha duke u betuar: "Unë kam varrosur njëqind nga pasardhësit e mi me duart e mia. Asnjë nuk ka qenë aq me fat sa unë lidhur me pasurinë dhe pronat. Ju mund të shihni se pasuria ime është e shumtë. Të gjitha këto janë rezultati i lutjes së Profetit Muhammed a.s.m. për bekim e begati."

• Gjithashtu, dijetarët e hadithit, me në krye Imam Bejhakiun, tregojnë se Profeti i Nderuar a.s.m. u lut që njëri prej dhjetë të përgëzuarve me xhennet, Abdurrahman Ibn Auf të bekohej me shtim pasurie. Me anë të bekimit të asaj lutje, ai fitoi një pasuri të tillë saqë në një rast ai dhuroi shtatëqind deve së bashku me ngarkesat e tyre në rrugën e Zotit xh.sh.. Dhe tha: Shikojeni bekimin -bereqetin- e duasë së Profetit a.s.m. dhe thoni "Barekall-llah," *sa të mëdhaja janë bekimet e All-llahut xh.sh....*

• Gjithashtu, tregimtarët e haditheve, me në krye Imam Buhariun, tregojnë se Profeti i Nderuar a.s.m. u lut që Urva Ibn Ebi Xha'd të kishte përfitime në tregtinë e tij. Urva tha: "Ndonjëherë unë shkoja në vendin e tregut në Kufa dhe kthehesha në shtëpi në darkë duke pas bërë përfitim të dyzetmijëfishtë". Imam Buhariu thotë: "Në qoftë se merrte edhe dhèun në dorën e tij, ai do të nxirrte fitime edhe prej tij!"

• Gjithashtu, Ai u lut që Hazreti Abdullah Ibn Xhafer të fitonte bollëk -bereqet- në pasuri dhe u bë aq i pasur saqë u bë mjaft i dëgjuar për të. Ai gjithashtu u bë aq i dëgjuar për bujarinë e tij, aq sa ishte i famshëm për pasurinë që e arriti nëpërmjet lutjes së Profetit për bekimin e shumicës.

Ka shumë shembuj të këtij lloji mrekullie, por ne i konsiderojmë ato katër shembujt e përshkruar lart si të mjaftueshëm.

• Gjithashtu, Imam Tirmidhiu tregon se: "Profeti i Nderuar a.s.m. u lut për pranimin e lutjeve të Sa'd Ibn Ebi Vek'kasit, duke thënë:

اَللّٰهُمَّ اَجِبْ دَعْوَتَهُ *"O Zot! Pranoje lutjen e Sa'dit!"*

Pas asaj, në atë shekull, gjithësecili i frikësohej mallkimit e nëmës së Sa'dit dhe, pranimi i lutjeve të tij u bënë të famshme.

• Në një rast tjetër, u lut për të mirënjohurin Ebu Katade që ai të mbetej i ri dhe tha:

أَفْلَحَ اللهُ وَجْهَكَ اَللّٰهُمَّ بَارِكْ لَهُ فِي شَعْرِهِ وَبَشَرِهِ

"E lulëzoftë Zoti xh.sh. fytyrën tënde! O Zot, Bekoje flokun dhe lëkurën e tij."

Kur Ebu Katadeja ndërroi jetë në moshën e të shtatëdhjetave, ai ishte si një djalë pesëmbëdhjetëvjeçarë. Kjo tregohet përmes një rrëfenje të shëndoshë.

• Gjithashtu, tregimi i famshëm i poetit Nabiga. Ai recitoi një nga poemat e tij përpara Profetit të Nderuar a.s.m. e cila vazhdonte:

بَلَغْنَا السَّمَاءَ مَجْدُنَا وَسَنَائُنَا ۞ وَإِنَّا نُرِيدُ فَوْقَ ذٰلِكَ مَظْهَرًا

Domethënë: "Lavdia dhe lartësia jonë kanë arritur në qiell, ne dëshirojmë ta ngjisim edhe më lartë".

Profeti i Nderuar a.s.m. iu përgjigj me shaka: إِلَى أَيْنَ يَا أَبَا لَيْلَى ؟ *"Ku? Përtej qiejve?"* Nabiga u përgjigj: إِلَى الْجَنَّةِ يَا رَسُولَ اللهِ "Në Xhennet, o i dërguari i Zotit."

Atëherë, ai recitoi një nga poemat e tij domethënëse dhe Profeti i Nderuar a.s.m. u lut:

لَا يَفْضُضِ اللهُ فَاكَ *"All-llahu mos e prishtë gojën tënde!"*

Për shkak të bekimit të kësaj lutjeje të Profetit, ai nuk pati të dalur as edhe një dhëmb të vetëm edhe kur ishte njëqind e njëzet vjeç. Sa herë që atij i dilte një dhëmb, shfaqej një tjetër në vend të tij.

• Gjithashtu tregohet përmes një rrëfenje autentike se Profeti u lut për Imam Aliun:

اَللّٰهُمَّ اكْفِهِ الْحَرَّ وَالْقَرَّ *"O Zot! Mbroje atë nga nxehtësia dhe nga i ftohti!"*

Me anë të bekimit të kësaj lutje, Imam Aliu vishte rroba verore në dimër dhe rroba dimërore në verë. Ai thonte: *"Unë kurrë nuk vuaj nga nxehtësia apo nga i ftohti në sajë të asaj lutjeje."*

• Gjithashtu Profeti a.s.m. u lut për Hazreti Fatimen:

اَللّٰهُمَّ لَا تُجِعْهَا *"O Zot! Mos i jep asaj dhimbje urie!"*

Dhe Hazreti Fatimeja thonte: "Unë kurrë nuk kam vuajtur nga uria pas asaj lutje."

• Gjithashtu, Tufejl Ibn Amr i kërkoi Profetit të Nderuar a.s.m. një mrekulli që t'ua tregonte popullit të tij. Profeti i Nderuar a.s.m. u lut: اَللّٰهُمَّ نَوِّرْ لَهُ *"O Zot!, Ndriçoje atë!"*, dhe një dritë u shfaq midis syve të tij. Më vonë ajo u transferua tek fundi i shkopit të tij dhe ai u bë i mirënjohur si "*Dhun'nur*" (poseduesi i dritës). Këto ngjarje janë të gjitha nga hadithet e shquara që janë të sigurta.

• Gjithashtu Ebu Hurejreja njëherë iu ankua Profetit të Nderuar a.s.m. duke i thënë: "Unë vuaj nga harresa." Profeti i Nderuar a.s.m. i tha atij të përhapte një copë rrobe. Ndërkohë Ai bëri ca lëvizje me dorën e Tij të bekuar sikur po merrte disa sende të padukshme e duke i vendosur ato në rrobe, e përsëriti atë dy apo tri herë dhe atëherë e urdhëroi atë ta mblidhte rrobën... "Ebu Hurejreja më vonë u betua se nëpërmjet misterit të kësaj lutjeje shpirtërore të Profetit a.s.m. ai nuk harroi kurrë ndonjë gjë." Kjo ngjarje është gjithashtu midis haditheve të mirënjohura.

• ***Shembulli i katërt:*** Ne do të përshkruajmë këtu pak ngjarje në lidhje me mallkimet e nëmat e Profetit të Nderuar a.s.m.:

• *I pari:* Shahu Persian, Parvizi, e grisi letrën që iu dërgua atij nga Profeti. Kur Profeti i Nderuar a.s.m. mori lajmet e kësaj, u lut: اَللّٰهُمَّ مَزِّقْهُ *"O Zot, grise atë ashtu siç grisi letrën time!"* Si rezultat i këtij mallkimi, djali i Kisras, Parviz Shirvija e preu atë copë-copë me një thikë. Dhe Sa'd Ibn Ebi Vakkasi e shqyu mbretërinë e tij, saqë asnjë pjesë e perandorisë Sasanide nuk mbeti në sovranitetin e tij.

Megjithatë, Kajseri, perandori i Bizantit dhe mbretërit e tjerë nuk u zhdukën meqë ata respektuan letrat e Profetit a.s.m..

I dyti: Një ngjarje pothuajse e mirënjohur si ato të raportuara me unanimitet, për të cilat aludojnë disa vërsete kur'anore, është kjo: "Në ditët e para të Islamit, Profeti i Nderuar a.s.m. po kryente lutjet në el-Mesxhid el-Haram (në Xhaminë e shenjtë, Qabe), kur krerët e Kurejshit u mblodhën dhe e keqtrajtuan atë. Në atë kohë, Ai i mallkoi ata. Ibn Mes'udi deklaroi: "Unë betohem se në betejën e Bedrit, i pashë kufomat e të gjithë atyre që e kishin keqtrajtuar Profetin dhe që morën mallkimin e tij."

I treti: Profeti a.s.m. u lut kundër një fisi të madh Arab i quajtur Mudarijja që të vuanin thatësirën dhe zinë e bukës. I gjithë shiu pushoi dhe thatësira ndodhi. Atëherë Kurejshi, një degë e Mudarijjas, ndërmjetësuan tek Profeti i Nderuar a.s.m., dhe Ai u lut. Ndërkaq, shiu erdhi dhe i dha fund thatësirës. Kjo ngjarje është gjithashtu e mirënjohur në shkallën e raportimeve me unanim.

• ***Shembulli i pestë:*** Fakti se mallkimet kundra njerëzve të veçantë, pranoheshin e realizoheshin në mënyrë të tmerrshme ilustrohet nga shumë shembuj. Ne do të tregojmë tre nga këto përmes shembullit:

• *I Pari:* Ai shfaqi mallkimin e mëposhtëm kundër Utba Ibn Ebi Leheb:

اَللّٰهُمَّ سَلِّطْ عَلَيْهِ كَلْبًا مِنْ كِلَابِكَ

"O Zot, bëj që ai të sundohet nga një qen prej qenëve të Tu!"

Pak kohë më vonë, Utba u nis për një udhëtim gjatë të cilit një luan e kërkoi atë midis karvanit dhe e shqyu copash. Kjo ngjarje ishte e famshme dhe rrëfehet si autentike nga autoritetet e hadithit.

• *I dyti:* Ky është Muhal'lim Ibn Xhus'sama. Ai padrejtësisht vrau Amir Ibn Azbatin, por Profeti i Nderuar a.s.m. e kishte dërguar Amirin si komandant i një force për të luftuar në rrugë të Zotit xh.sh. edhe Muhal'limi ishte bashkë me të. Kur lajmet e kësaj mbërritën tek Profeti i Nderuar a.s.m., Ai u zemërua dhe e mallkoi atë duke thënë:

اَللّٰهُمَّ لَاتَغْفِرْ لِحَلِمٍ *"O Zot, mos i jep falje Muhal'limit!"*

Muhal'limi vdiq një javë më vonë. Ata e vendosën në varrin e tij, por varri e flaku jashtë; e varrosën atë në disa vende të ndryshme, por çdo herë varri e refuzonte. Në fund ata ndërtuan një mur të fortë midis dy shkëmbinjve dhe në këtë mënyrë kufoma u strehua.

• *I treti:* Njëherë Profeti i Nderuar a.s.m. pa një burrë duke ngrënë me dorën e tij të majtë. Ai e urdhëroi duke i thënë: كُلْ بِيَمِينِكَ *"ha me dorën e djathtë*, por burri u përgjigj: لَآ اَسْتَطِيعُ *"Unë nuk mundem me dorën e djathtë".* Profeti i Nderuar a.s.m. e mallkoi: لَا اسْتَطَعْتَ *"Tani e tutje ti nuk do të jesh i mundur ta ngresh atë."* Dhe pastaj vërtet që ai qe i pamundur ta ngrente dorën e djathtë.

• ***Shembulli i gjashtë:*** Këtu ne do të përmendim disa ngjarje të cilat janë të sigurta midis shumë çudirave që rezultojnë nga lutjet e Profetit të Nderuar a.s.m., dhe nga prekja e Tij:

E para: Profeti i dha hazretit Halid Ibn Velidit, i njohur si Sejfullah (shpata e Zotit), disa nga qimet e flokut të Tij dhe u lut për fitoren e tij në betejë. Hazreti Halidi i vendosi ato në kapelen e tij. Si rezultat i qimeve dhe bekimeve të lutjes, nuk pati ndonjë betejë në të cilën ai luftoi në atë kohë, veçse doli fitimtar.

E dyta: Selman el-Farisiu pati qenë më parë një skllav i çifutëve. Padronët e tij i kishin kërkuar një shpërblesë shumë të lartë, duke i thënë: "Që të fitosh lirinë tënde, ti duhet të mbjellësh treqind palma (hurma arabie), dhe pasi ato të bëjnë fruta, na jep ne dyzet *okkas* flori përveç frutit". Ai shkoi tek Profeti i Nderuar a.s.m. dhe ia shpjegoi situatën e tij. Atëherë Profeti i Nderuar a.s.m. mbolli me dorën e vet treqind palma në krahinën e Medines; vetëm njëra nga ato u mboll nga dikush tjetër. Në atë vit, të gjitha treqind palmat bënë kokrra, me përjashtim të njërës e cila u mboll nga personi tjetër. Profeti i Nderuar a.s.m. e shkuli dhe po të njëjtën palmë e mbolli përsëri. Atëherë edhe ajo gjithashtu bëri kokrra. Ndërkaq, Ai fërkoi ca nga jarga e Tij mbi një

copë floriri, që kishte masën e një veze pule, i bëri asaj një lutje dhe ia dha atë Selmanit duke i thënë të shkojë dhe t'ua japë çifutëve. Selman el-Farisiu shkoi e u dha atyre dyzet *okkas* flori nga ajo copë, ndërsa ajo vetë mbeti në gjendjen e sajë origjinale. Kjo ngjarje e mrekullueshme, e cila u tregua nga autoritetet më të besuara e të respektuara ishte ngjarja më domethënëse në të gjithë jetën e Hazreti Selmanit .

E treta: Një sahabeh e quajtur Umm Malik, i jepte gjalp, si dhuratë, Profetit të Nderuar a.s.m. nëpërmjet një kaceku, çantë prej lëkure, e quajtur *Ukka*. Në një rast, Profeti i Nderuar a.s.m. bëri një lutje mbi të, ndërsa po ia kthente kacekën asaj dhe i tha "që të mos e zbrazte e të mos e shtrydhte atë." Umm Maliku e mori *Ukkan* dhe që nga ajo kohë e në vazhdim, si rezultat i bekimit të duasë së Profetit, gjalpi gjendej në të sa herë që fëmijët e saj kërkonin. Kjo gjendje vazhdoi për një kohë të gjatë deri sa ata e shtrydhën atë, dhe bekimi u zhduk.

• ***Shembulli i shtatë:*** Ndodhen shumë shembuj për ujin që bëhej i ëmbël dhe lëshonte një erë të këndshme si rezultat i lutjes së Profetit të Nderuar a.s.m. dhe i prekjes së tij. Ne do të përmendim dy-tre si shembull:

• *I pari:* Dijetarët e hadithit, me në krye Imam Bejhakiun, raportojnë se pusi i njohur si "Bi'r el-Kuba" thahej disa herë, por për shkak se Profeti i Nderuar a.s.m. zbrazi në pus ujin me të cilin kishte marrë avdes, dhe në sajë të lutjes që i bëri, uji i atij pusi u shumua dhe kurrë nuk u tha më.

• *I dyti:* Dijetarët e hadithit, duke përfshirë Ebu Nuajmin në veprën e tij, Delail el-Nubuv'veh (Dëshmitë e Profetësisë), njoftojnë se kur Profeti i Nderuar a.s.m. pështyu brenda pusit tek shtëpia e Enesit dhe u lut, ai u bë uji më i ëmbël i Medines.

• *I treti:* Ibnu Maxheh tregon se një kovë plot me ujë nga burimi i Zemzemit u soll te Profeti i Nderuar a.s.m.. Ai mori pak nga ai në gojën e Tij dhe atëherë e zbrazi atë në kovë. Ndërkohë kova lëshoi një erë myshku.

• *I* katërti*:* Imam Ahmed Ibn Hanbeli njofton se një kovë plot me ujë u nxor nga pusi. Pasi Profeti i Nderuar a.s.m. kishte futur ca nga jarga e Tij në kovë dhe e derdhi atë në pus, ai filloi të lëshonte një erë të ëmbël si myshku.

• *I pesti:* Hammad Ibn Seleme, i cili ishte një njeri i drejtë dhe ishte i besuar e i pranuar nga Imam Muslimi dhe nga dijetarët e Magribit, njofton se Profeti i Nderuar a.s.m. mbushi një kacek me ujë dhe i fryu asaj ndërsa ishte duke u lutur. Ai atëherë e lidhi atë dhe ua dha disave prej sahabëve duke u thënë: "*Mos e hapni veçse kur ju duhet të merrni avdes*!" Kur ata e hapën kacekën për të marrë avdes, panë qumësht të pastër me kajmak tek hapja e saj.

Kështu, këto pesë shembuj janë treguar nga autoritetet e mirënjohura e të rëndësishme. Së bashku me ato që janë përmendur këtu, ato provojnë ndodhjen e këtij lloji mrekullie aq me siguri sa ato rreth njoftimeve të ndryshme për të cilat ka "Konsensus në kuptim".

• ***Shembulli i tetë:*** Ndodheshin shumë shembuj shterpësie e për dhi shterpa, të cilat prodhuan qumësht me aq bollëk në sajë të prekjes e të lutjeve të Profetit të Nderuar a.s.m.. Ne do të përmendim vetëm dy ose tri të cilat janë të mirënjohura e të sigurta si shembuj:

• *I pari:* Të gjithë librat e besueshëm të biografisë tregojnë se kur Profeti i Nderuar a.s.m. dhe Ebu Bekir es-Siddiku po emigronin për në Medine, ata erdhën tek shtëpia e Umm Ma'bad, e quajtur Atike Bint Halid El-Huzaij'ja. Atje ndodhej një dhi shumë e dobët, shterp dhe e thatë. Profeti i Nderuar a.s.m. e pyeti Umm Ma'badin: *"A nuk ka qumësht kjo?"* Ajo u përgjigj. "Ajo nuk ka gjakë në trupin e saj, e si të japë qumësht?". Profeti i Nderuar a.s.m. i lëmoi ijet e thithet e saja dhe u lut. Atëherë tha: *"Sill një enë dhe mile atë."* Ata e molën dhe pasi Profeti i Nderuar a.s.m. dhe Ebu Bekir es-Siddiku kishin pirë, të gjithë njerëzit e shtëpisë pinë deri sa u ngopën. Dhia u bë e fortë dhe mbeti kështu e bekuar.

• *I dyti:* Ky është një tregim i shquar i Shat Ibn Mes'udit. Para se të bëhej musliman, Ibnu Mes'udi punonte si bari për disa njerëz. Profeti i Nderuar a.s.m. shkoi me Ebu Bekir es-Siddikun (të Drejtin), tek vendi

ku ishin Ibn Mes'udi dhe dhitë e tij. Profeti i Nderuar a.s.m. i kërkoi Ibn Mes'udit pak qumësht. Por, kur ai u përgjigj se ato nuk ishin pronë e tij, por pronë e dikujt tjetër, Profeti i Nderuar a.s.m. i tha të sillte një dhi shterp e të thatë. Kështu ai solli një dhi e cila nuk ishte çiftëzuar që prej dy vjetësh. Profeti i Nderuar a.s.m. lëmoi thithat e saja me dorën e Tij dhe u lut. Atëherë ata e molën dhe fituan qumësht të ëmbël të cilin e pinë. Ibnu Mes'udi u bë besimtar pasi dëshmoi këtë mrekulli.

• *I treti:* Ky është një tregim i mirënjohur i dhive të Halima Sa'dijas, nënës së gjetur, domethënë mëndeshës së Profetit të Nderuar a.s.m.. Ishte thatësirë ku gjendej fisi dhe kafshët ishin të dobëta e pa qumësht. Ato nuk mund të gjenin për të ngrënë sa t'u mjaftonte. Por, kur u dërgua Profeti i Nderuar a.s.m. atje, tek mëndesha e Tij, nëpërmjet bekimit që Ai solli, dhitë e Halime Sa'dijes ktheheshin në mbrëmje me stomakët dhe gjitë e tyre plot. Kurse dhitë e të tjerëve nuk ishin kështu.

Ndodhen shumë shembuj të tjerë në librat e biografisë të ngjashme me këto që u përmendën, por këto shembuj janë të mjaftueshëm për qëllimin tonë.

• ***Shembulli i nëntë:*** Ne do të tregojmë këtu pak nga shumë shembuj çudirash të cilat u shfaqën pasi Profeti i Nderuar a.s.m. kishte prekur fytyrat dhe kokat e disa njerëzve dhe u lut.

• *I pari:* Ai kaloi dorën e Tij sipër kokës së Umer Ibn Sa'dit dhe u lut. Kur ky vdiq në moshën tetëdhjetë vjeçare, nëpërmjet bekimit të asaj lutje, nuk kishte as edhe një qime të vetme të bardhë në kokën e tij.

• *I dyti:* Ai vendosi dorën e Tij mbi kokën e Kajs Ibn Zejd dhe u lut. Me anë të bekimit të lutjes dhe efektit të prekjes së Tij, kur Kajsi mbushi njëqind vjeç, koka e tij ishte e bardhë përveç asaj pjese ku Profeti i Nderuar a.s.m. e kishte vënë dorën e Tij e cila kishte mbetur tërësisht e zezë.

• *I treti:* Abdurrahman Ibn Zejd Ibn El Hattab ishte edhe i vogël edhe i shëmtuar. Profeti i Nderuar a.s.m. preku kokën e tij me dorën e Tij dhe u lut. Me anë të bekimit të lutjes së Tij, Abdurrahmani fitoi shtatin më të lartë dhe formën më të bukur.

• *I katërti:* A'idh Ibn Amr, mori një plagë në fytyrë gjatë betejës së Hunejnit. Profeti i Nderuar a.s.m. ia fshiu gjakun në fytyrën e tij me dorën e vet. Pjesa e fytyrës së tij që e kishte prekur Profeti i Nderuar a.s.m. fitoi një shkëlqim vezullues, të cilin dijetarët e hadithit e përshkruan si كَغُرَّةِ الْفَرَسِ *"ngjashmëri e një flakërimi të bardhë i një kali brymës (i mushkëllyer)."*

• *I pesti:* Ai kaloi dorën e Tij mbi fytyrën e Katade Ibn Selmanit dhe u lut, dhe fytyra e Katades filloi të shndërisë si një pasqyrë.

• *I gjashti:* Kur Zejnebi, vajza e Nënës së Besimtarëve, Umm Seleme, dhe vajza e gjetur (thjeshtëra) e Profetit të Nderuar a.s.m. ishte fëmi, Profeti i Nderuar a.s.m. spërkati ca nga uji i avdesit në fytyrën e saj. Me prekjen e ujit, fytyra e Zejnebes fitoi një bukuri të jashtëzakonshme.

Ndodhen shembuj të shumtë të ngjashëm me këto, shumica e këtyre janë transmetuar nga dijetarët kryesues të hadithit. Edhe në qoftë se ne do ta supozonim secilin nga këto shembuj si një njoftim i veçantë e i dobët, por si një tërësi, ato akoma demonstrojnë një mrekulli absolute të Muhammedit a.s.m. e cila ka sigurinë e "Konsensusit në Kuptim", sepse në qoftë se një ngjarje tregohet në shumë forma të ndryshme, ndodhja e ngjarjes bazë bëhet e sigurt. Madje në qoftë se secila formë është vetë e dobët, ajo ende provon ngjarjen bazë.

Për shembull, një zhurmë u dëgjua; disa njerëz thanë se një shtëpi është shkatërruar, të tjerët thanë se ajo ishte një shtëpi e ndryshme e kështu me radhë. Secila rrëfenjë mund të jetë një raportim i veçantë, i dobët e i pavërtetë, por ngjarja bazë ishte se një shtëpi ishte shkatërruar e kështu me radhë... ajo ishte e sigurt dhe ata pajtoheshin unanimisht në lidhje me të. Megjithatë gjashtë shembujt që ne

renditëm lartë ishin edhe autentikë dhe disa prej tyre u bënë të mirënjohura. Supozo që ne do ta konsideronim secilën nga këto të dobët. Prapëseprapë, së bashku, të gjitha do të demonstrojnë sigurinë e ekzistencës së një mrekullie absolute të Profetit Muhammed a.s.m. ashtu si shkatërrimi absolut i shtëpisë në krahasim.

Kështu, Profeti i Nderuar a.s.m. realizoi mrekulli të sigurta e të qarta nga çdo kategori. Shembujt e tyre janë format ose shembujt e atyre mrekullive të përgjithshme e absolute. Ashtu si dora e Profetit të Nderuar a.s.m., gishtërinjtë, jarga, fryma dhe folja, d.m.th. lutja e Tij që ishin mjetet e mrekullive të shumta, gjithashtu aparatet e tjera të holla, shqisat dhe ndjenjat e Profetit të Nderuar a.s.m. ishin mjete të shumë çudirave. Librat e biografisë e të historisë i kanë përshkruar ato e i kanë treguar në sjelljen e Tij, në formën e Tij, në gjymtyrët dhe në ndjenjat e Tij, të cilat ishin dëshmi të shumta për profetësinë e tij.

* * *

SHENJA E PESËMBËDHJETË

Ashtu si shkëmbinjtë, pemët, hëna e dielli që secili prej tyre shfaqën mrekulli duke vërtetuar profetësinë e Tij si dhe e njohën atë, gjithashtu.. *kafshët, të vdekurit, xhindet dhe engjëjt* e njohën atë Personalitet të Bekuar dhe vërtetuan profetësinë e Tij, sepse secila nga ato specie të qënieve duke treguar një numër mrekullish, demonstruan se e njohën Muhammedin a.s.m. dhe deklaruan vërtetimin e profetësisë së Tij.

Shenja e pesëmbëdhjetë përmban tre degë:

Dega e Parë: Bota e kafshëve e njohu Profetin e Nderuar a.s.m. dhe shfaqi mrekullitë e Tij. Ndodhen disa shembuj të kësaj dege. Këtu, si shembuj, ne do të përmendim vetëm ato të cilat janë të mirënjohura e të sigurta me shkallën e "Konsensusit në Kuptim" ose janë pranuar nga dijetarët e besueshëm, ose janë vlerësuar të pranueshme nga ummeti musliman.

- **Ngjarja e parë:** Kjo është e mirënjohur me shkallën e "Konsensusit në Kuptim" dhe lidhet me dy pëllumbat që erdhën dhe pritën tek hyrja e shpellës së Hirasë si dy rojtarë, ku Profeti i Nderuar a.s.m. dhe Ebu Bekir es-Siddiku -i Vërteti- u fshehën nga jobesimtarët që i gjurmonin dhe, merimanga duke e mbuluar hyrjen me një cergë -rrjetë- të trashë si një mbajtëse perdeje. Ubejj Ibn Halef, njëri nga krerët e Kurejshit, të cilin Profeti i Nderuar a.s.m. e vrau me duart e Tij në betejën e Bedrit, e shikoi te shpella. Kur shokët e tij sugjeruan që të hynin në shpellë, ai u përgjigj: "Pse duhet ta bëjmë atë? Unë shoh një rrjetë të madhe merimangeje e cila shfaqet të ketë qenë qysh para se të lindte Hazreti Muhammedi a.s.m.. Dhe shiko! Ato dy pëllumba janë atje. A mund të qëndronin ato atje nëse gjendej dikush në shpellë?"

Në një shembull të ngjashëm me këtë, një lloj pëllumbi i bekuar hodhi hije mbi kokën e Profetit të Nderuar a.s.m. gjatë pushtimit të Mekës që u tregua nga Imam Xhelil Ibn Veheb.

• Gjithashtu, sipas një rrëfenje të shëndoshë, Aishe es-Siddika tregon: "Ne kishim një zog në shtëpinë tonë që quhej 'Daxhin' i ngjashëm me pëllumbin. Kur Profeti i Nderuar a.s.m. ishte i pranishëm, ai rrinte i qetë, por sapo Profeti i Nderuar a.s.m. të largohej nga shtëpia, zogu fillonte të hidhej lart e poshtë pa pushim." Domethënë zogu i bindej Profetit të Nderuar a.s.m. duke qëndruar i qetë në prani të Tij.

• **Ngjarja e dytë:** Ky është një tregim i jashtëzakonshëm i ujkut që transmetohet nga pesë-gjashtë kanale i cili është treguar nëpërmjet një numri zinxhirësh transmetimi nga disa sahabe të mirënjohur dhe është si "Konsensusi në Kuptim". Shkurtazi: Ebu Said el-Hudri, Seleme Ibn el-Akva, Ibnu Ebi Veheb, Ebu Hurejreja dhe Uhban, një bari i cili u përfshi në një ngjarje, tregojnë përmes shumë zinxhirësh transmetimi se "Një ujk rrëmbeu një dhi dhe bariu e shpëtoi atë nga ujku. Ujku i tha bariut: "A nuk e ke frikë All-llahun xh.sh..? Ti më privove nga ushqimi im!" Bariu murmuriti nëpër dhëmbë: "Sa e çuditshme! A mund të flasin ujqërit?" Ujku i tha: "A të të them diçka që do të të çudisë edhe më shumë?" Atje përtej kodrës është dikush që ju thërret ju për në Xhennet. Ai është një Profet, por ju nuk e njihni atë!" Megjithëse të gjitha linjat e transmetimit bien dakord për foljen e ujkut, në njoftimin e tij i cili ka një linjë të fortë, Ebu Hurejreja thotë: Bariu i tha ujkut: "Unë do të shkoj ta shikoj atë, mirëpo, kush do të kujdeset për dhitë e mia?" Ujku u përgjigj: "Unë do të kujdesem për to". Kështu bariu ia dorëzoi tufën ujkut dhe shkoi për të parë Profetin e Nderuar a.s.m., i besoi Atij dhe u kthye tek tufa e dhive të tij. Bariu e gjeti ujkun dhe asnjë dhi nuk ishte humbur. Atëherë ai e therri njërën për ujkun sepse ishte bërë mësuesi i tij."

Sipas një zinxhiri transmetimi, njëri nga krerët e Kurejshit, Ebu Sufjani dhe Safvani panë një ujk që po gjurmonte një gazelë. Gazela u fut brenda në Qabe. Atëherë ujku u largua. Personat e lartëpërmendur u çuditën nga kjo. Ndërkohë ujku foli dhe lajmëroi

profetësinë e Muhammedit a.s.m.; ata u habitën. Atëherë Ebu Sufjani i tha Safvanit: “Nëse e përmend këtë ngjarje në Mekë, frikohem se gjithkush do të bashkohej me Muhammedin dhe Mekka do të boshatisej.”

Shkurtazi: Tregimi i ujkut jep një bindje të plotë dhe është aq i sigurt sa ato raportime me unanimitet rreth të cilave ka ‘Konsensus në Kuptim’.

• **Ngjarja e tretë:** Kjo është rrëfenja e devesë e cila u tregua me unanimitet nëpërmjet pesë ose gjashtë zinxhirësh transmetimi nga sahabe të shquar, të tillë si Ebu Hurejre, Salabe Ibn Malik, Xhabir Ibn Abdullah, Abdullah Ibn Xhaëfer dhe Abdullah Ibn Ebi Afva, të cilët janë në krye të zinxhirëve. Një deve iu afrua Profetit të Nderuar a.s.m., përkuli veten e saj para Tij sikur po e përshëndeste dhe foli. Sipas numrit të linjave të transmetimit, deveja ishte zemëruar në një kopsht dhe ishte egërsuar duke sulmuar cilindo që i afrohej. Kur u shfaq Profeti i Nderuar a.s.m., ajo i erdhi Atij, u përkul si në shenjë respekti dhe ra në gjunjë. Profeti i Nderuar a.s.m. i vuri një fre dhe deveja i tha Atij: “Ata më përdorën në punën më të rëndë dhe tani duan të më therrin. Kjo është arsyeja përse unë u egërsova.” Profeti a.s.m. e pyeti pronarin e saj nëse kjo ishte e vërtetë, dhe pronari u përgjigj: “Po.”

• Gjithashtu, Profeti i Nderuar a.s.m. kishte një deve që quhej Adba. Pasi Profeti i Nderuar a.s.m. ndërroi jetë, nga dëshpërimi deveja as nuk hëngri e as nuk piu deri sa ngordhi . Një numër i autoriteteve të rëndësishme, duke përfshirë Ebu Is’hak Isfaranin treguan se deveja i foli Profetit të Nderuar a.s.m. rreth një çështjeje të rëndësishme.

• Në një shembull tjetër, në një rrëfenjë autentike, deveja e Xhabir Ibn Abdullahut u rraskapit në një udhëtim dhe nuk mundi të vazhdonte më. Profeti i Nderuar a.s.m. i dha asaj një goditje të lehtë. Deveja mori një gëzim e shkathtësi të tillë nga ajo goditje e lehtë e Profetit, saqë për shkak të shpejtësisë së saj, ajo nuk mund të kapej dhe as frerat e saj nuk mund të mbaheshin; këtë e njofton Hazreti Xhabiri.

• **Ngjarja e katërt:** Autoritetet e hadithit, me në krye Imam Buhariun, njoftojnë se një natë armiku hodhi parrulla se do të sulmonin jashtë Medines. Kalorës trima dolën për të hetuar. Në rrugë ata panë dikë duke ardhur. Ata vështruan dhe panë se Ai ishte Profeti i Nderuar a.s.m.. Ai u tha atyre: "Nuk ka asgjë". Ai i kishte hipur kalit të shquar të Ebu Talhasë, meqenëse guximi e kurajoja e shenjtë e shtynte Atë dhe kishte shkuar para çdo njeriu tjetër; وَجَدْتُ فَرَسَكَ بَحْرًا dhe atëherë u kthye. Ndërkohë Ai i tha Ebu Talhasë: *"Kali yt është shumë i shpejt e i palëkundur,"* ndërsa më parë ai kishte qenë shumë i ngadalshëm. Pas asaj nate, nuk kishte më kalë që të hynte në garë në ecje me të.

• Në një rast tjetër, siç tregohet në një rrëfenjë autentike, ndërsa ishte gjatë një udhëtimi në kohën për falje, Profeti i Nderuar a.s.m. e urdhëroi kalin e Tij të ndalojë, duke i thënë, "Ndalo!" Kali ndaloi dhe deri kur Ai kishte mbaruar së faluri, nuk bëri as lëvizjen më të vogël.

• **Ngjarja e pestë:** Safina, shërbyesi i Profetit të Nderuar a.s.m. u urdhërua prej Tij të shkonte tek guvernatori i Jemenit, Muadh Ibn Xhebel. Ai u nis dhe në rrugë u takua me një luan. Safina i tha atij: "Unë jam shërbyesi i Profetit të Nderuar a.s.m.!" Mbi këtë, luani bëri një zë sikur të thonte diçka dhe e la pa e shqetësuar atë. Sipas një rrëfenje tjetër, Safina humbi rrugën e tij. Ndërsa duke u kthyer, ai ndeshi me një luan. Luani jo vetëm që nuk e shqetësoi, por ia tregoi atij rrugën.

• Gjithashtu, tregohet nga Hazreti Umeri i cili tha: "Një beduin erdhi tek Profeti i Nderuar a.s.m.. Ai mbante në dorën e tij një zhapik -hardhucë-, që në arabisht quhet "Dabb". Ai i tha: "Në qoftë se ky zvarranik -kafshë- dëshmon për Ty, unë do të besoj në Ty; përndryshe unë nuk do të të besoj". Profeti i Nderuar a.s.m.., ia kërkoi këtë kafshës, dhe zhapiku dëshmoi profetësinë e Tij në mënyrë shumë të qartë."

• Gjithashtu, Nëna e besimtarëve, Umm Seleme tregon: Një gazel foli me Profetin e Nderuar a.s.m. dhe dëshmoi profetësinë e Tij.

Kështu, ndodhen shumë shembuj të ngjashëm me këto. Ne përshkruam pak, të cilat janë të mirënjohura e të sigurta. Për ata që nuk e njohin e nuk i binden Profetit të Nderuar a.s.m., ne themi këtë*:*

O njeri! Merr mësim nga këto... Luani e ujku e njohën e iu bindën Atij. Atëherë, duhet të përpiqesh të mos biesh më poshtë se sa ujku dhe kafshët e tjera!..

Dega e dytë: Kjo lidhet me kufomat -të vdekurit-, xhindet dhe engjëjt të cilët e njohin Profetin e Nderuar a.s.m.. Ka pasur shumë ndodhi nga ky. Ne do të përshkruajmë disa shembuj të cilët janë të mirënjohur dhe janë raportuar nga dijetarë të besueshëm. Së pari, do të përmendim shembujt rreth kufomave. Sa për xhindet dhe engjëjt, njoftimet e shumta që lidhen me to, janë me unanimitet dhe shembujt e tyre nuk janë një, por me mijëra.

Atëherë po japim shembujt e të vdekurve që kanë folur:

• ***Shembulli i parë i kësaj:*** Hasan el-Basriu, një nga studentët më besnik e të rëndësishëm të Imam Aliut dhe autoriteti më i madh i shkencave eksternale dhe ezoterike (dije të jashtme e të fshehta) për kohën e tabiinëve- gjeneratës vijuese të sahabëve- tregon: "Një burrë erdhi duke qarë tek Profeti i Nderuar a.s.m.. Ai tha: "Unë kisha një vajzë të vogël; ajo vdiq në aksh -filan- rrëke aty pranë. Unë e lashë atë atje. Profetit të Nderuar a.s.m. i erdhi keq për personin dhe i tha të shkonin së bashku. Ata shkuan dhe Profeti a.s.m. i thirri vajzës së vdekur duke i thënë emrin e saj. Menjëherë vajza e vdekur u përgjigj: لَبَّيْكَ وَسَعْدَيْكَ *"Unë jam prezent dhe i përgjigjem thirrjes tënde me kënaqësi"*. Profeti i Nderuar a.s.m. e pyeti atë: "A dëshiron të kthehesh tek babai e nëna jote?" Ajo u përgjigj: "Jo, unë kam gjetur diçka më të mirë këtu!"

• ***Shembulli i dytë:*** Autoritete të rëndësishme, si Imam Bejhakiu dhe Imam Ibn Adijj, tregojnë nga Enes Ibn Malik se Enesi tha: "Një grua e moshuar kishte një djalë të vetëm i cili befas vdiq. Gruaja e drejtë ishte shumë e dëshpëruar dhe u lut. "O Zot, unë e lash shtëpinë time dhe emigrova këtu vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde e për

të bërë besëlidhje me Profetin e Nderuar a.s.m. e për t'i shërbyer Atij. Për hir të Profetit Tënd, ma kthe djalin tim, i cili ishte i vetmi person që kujdesej pas meje." Enesi tha: "Njeriu i vdekur u ngrit dhe erdhi e hëngri me ne."

Në rreshtat e mëposhtëm nga poema e shquar, Kaside el-Burda, Imam el-Busiri i referohet kësaj ngjarje të jashtëzakonshme:

لَوْنَاسَبَتْ قَدْرَهُ اٰيَاتُهُ عِظَمًا ۞ اَحْيَى اسْمُهُ حِيْنَ يُدْعٰى دَارِسَ الرِّمَمِ

"Në qoftë se shenjat dhe mrekullitë e Profetit a.s.m. do t'i korrespondonin vlerës dhe madhështisë së tij, thjesht përmendja e emrit të tij do të ngjallte jo vetëm ata që kanë vdekur tani, por edhe kockat e kalbura."

• ***Shembulli i tretë:*** Imam Bejhakiu dhe të tjerët tregojnë nga Abdullah Ibn Ubejdullah el-Ensari se Abdullahi tha: "Unë isha i pranishëm kur Thabit Ibn Kajs Ibn Shammas u martirizua në betejën e Jemames dhe u varros. Ndërsa ai po futej në varr, papritmas një zë erdhi nga ai duke thënë:

مُحَمَّدٌ رَسُوْلُ اللّٰهِ وَاَبُوْبَكْرٍ الصِّدِّيْقُ وَعُمَرُ الشَّهِيْدُ وَعُثْمَانُ الْبَرُّ الرَّحِيْمُ

"Muhammedi është Profeti i All-llahut, Ebu Bekri është es-Siddik (i Drejti), Umeri është martiri, dhe Uthmani është i përshpirtshmi, i dhembshuri."

Ne e zbuluam dhe e shikuam: Ai ishte i vdekur e i pajetë, megjithatë ai po parashikonte martirizimin e Hazreti Umerit, madje përpara se ai të merrte kalifatin.

• ***Shembulli i katërt:*** Imam Taberani dhe Ebu Nuajmi në veprën e tij *Dela'il el-Nubuv'veh*, tregojnë nga Nu'man Ibn Beshir se: Zejd Ibn Harixhe papritmas ra i vdekur në treg. Ne e morëm trupin e tij për tek shtëpia e tij. Në atë mbrëmje midis perëndimit të Diellit dhe faljes së jacisë, ndërsa gratë po qanin rreth e qark tij, ai thirri: اَنْصِتُوا.. اَنْصِتُوا.. *"Heshtni! Heshtni!"* Atëherë duke thënë me një gjuhë të qartë:

مُحَمَّدٌ رَسُوْلُ اللّٰهِ اَلسَّلَامُ عَلَيْكَ يَا رَسُوْلَ اللّٰهِ

"Muhammedi është i Dërguari i All-llahut! Paqja qoftë mbi Ty o Profet i Zotit xh.sh.!",

ai foli me shumë elokuencë për një kohë. "Ne e shikuam, ai ishte i vdekur, pa jetë."

Atëherë, në qoftë se kufomat e pajeta e vërtetojnë profetësinë e Tij, ndërsa të gjallët nuk veprojnë kështu, sigurisht ata janë "më të vdekur" se sa të vdekurit dhe më të pajetë se sa kufomat!...

Përsa i përket engjëjve duke u shfaqur e duke i shërbyer Profetit të Nderuar a.s.m. dhe, xhindet duke i besuar Atij e duke iu nënshtruar Atij, këto fakte janë treguar të shumtë e me unanimitet. Ato janë pohuar qartë në shumë vërsete Kur'anore. Në luftën e Bedrit, sipas Kur'anit, pesëmijë engjëj i shërbyen Atij si ushtarë në vijën e parë të luftimeve, ashtu si sahabët. Në të vërtetë, ata engjëj fituan shquarsi midis engjëjve ashtu si sahabët që luftuan në atë betejë.

Ndodhen dy aspekte për t'u marrë në konsideratë në këtë çështje:

Aspekti i parë: Është fakti se ekzistenca e llojeve të ndryshme të xhindeve e të engjëjve është aq e sigurt sa ajo e varieteteve dhe e specieve, e kafshëve dhe e qënieve njerëzore, dhe se ato kanë lidhje me ne. Ne e kemi provuar këtë në formë vendimtare tek "Fjala e Njëzet e Nëntë" me aq siguri sa dy edhe dy bëjnë katër, dhe ia referojmë provën e tyre asaj Fjale**.**

Aspekti i dytë: Është se individë të komunitetit të Profetit të Nderuar a.s.m. i shikojnë ato dhe flasin me to, si një mrekulli e Tij.

Kështu, dijetarët kryesues të hadithit, me në krye Imam Buhariun e Muslimin, tregojnë me unanimitet se "Njëherë një engjëll, domethënë, Hazreti Xhebraili, u shfaq në formën e një njeriu të veshur në të bardhë. Ai iu afrua Profetit të Nderuar a.s.m., i Cili po rrinte ulur midis sahabëve dhe e pyeti:

مَا الْإِسْلَامُ ، وَمَا الْإِيمَانُ ، وَمَا الْإِحْسَانُ

"Ç'është Islami, ç'është Imani (besimi) dhe ç'është ihsani (mirësia)? Shpjegoji ato!"

Profeti i Nderuar a.s.m. i shpjegoi ato dhe sahabët u grumbulluan atje dhe morën mësim të vlefshëm dhe e panë qartë personin. Megjithëse u duk si udhëtar, ai nuk shfaqi shenjën e udhëtimit. Ai papritmas u ngrit e u zhduk. Atëherë, Profeti i Nderuar a.s.m. tha:

"Ai ishte Xhebraili, erdhi me qëllim që t'ju japë mësim juve!"

• Gjithashtu, autoritetet e hadithit tregojnë përmes rrëfenjave të sakta e autentike të shkallës së "Konsensusit në Kuptim" se "Sahabët e shikuan Hazreti Xhebrailin me Profetin e Nderuar a.s.m. shumë herë në formën e Dihijas, i cili ishte shumë i pashëm.

Për shembull, Umer Ibn Abbas, Usama Ibn Zejd, Harithi, Aishe es-Siddika dhe Umm Seleme, vërtetuan dhe treguan me siguri duke thënë: "Ne shpesh e pamë Hazreti Xhebrailin me Profetin e Nderuar a.s.m. në formën e Dihijas". A do të ishte e mundur që njerëz të tillë të thonin se e kemi parë, në qoftë se nuk do ta kishin parë?

• Gjithashtu, Pushtuesi i Iranit (Persisë), Sa'd Ibn Ebi Vakkas, i cili ishte njëri midis të Dhjetëve që janë përgëzuar me Xhennet, tregon në një rrëfenjë autentike: "Në betejën e Uhudit, ne pamë dy persona të veshur në të bardhë në të dyja anët e Profetit të Nderuar a.s.m. duke e ruajtur atë si rojtarë. Ne kuptuam se ata ishin engjëjt, Hazreti Xhebraili dhe Mikaili." A do të ishte e mundur që, kur një hero i tillë i Islamit thotë që i "Pashë" ato, të mos i ketë parë?

• Gjithashtu Ebu Sufjan Ibn el-Harith Ibn Abdul Muttalib, kushëriri i Profetit, tregon në një rrëfenjë autentike: "Në luftën e Bedrit, ne pamë kalorës të veshur në të bardha midis qiellit dhe tokës".

• Gjithashtu, Hazreti Hamzai iu përgjërua Profetit të Nderuar a.s.m. që ta shihte Xhebrailin. Atëherë Ai ia tregoi atë Hamzait në Qabe, por ai nuk mundi ta përballonte atë shikim dhe ra në tokë pa ndjenja.

Kishte shumë ndodhi si këto të engjëjve që shikoheshin. *Të gjitha ato demonstruan një lloj të mrekullisë së Muhammedit a.s.m. dhe treguan se engjëjt gjithashtu ishin si flutura të magjepsura pas dritës së profetësisë së Tij .*

Ndërsa në lidhje me xhindet, jo vetëm sahabët, por ndodh shpesh që edhe njerëzit e zakonshëm të komunitetit musliman të takohen me ta dhe i shikojnë.

Por, njoftimet më të sigurta e autentike na jepen neve nga dijetarët kryesues të hadithit të cilët thonë se Ibn Mes'udi tregoi: "Unë i pashë xhindet në natën që ata pranuan Islamin tek Batn el-Nahl. Unë i krahasova ato me burrat e Zutit, këta janë një fis shtatëlartësh Sudanezë, pra xhindet u ngjasonin atyre.

• Gjithashtu, ndodhet një ngjarje në lidhje me Hazreti Halid Ibn Velidin që është e mirënjohur dhe është vërtetuar dhe e pranuar nga dijetarët më të mëdhenj të hadithit. Kur idhulli i quajtur Uzza u shkatërrua, një xhind u shfaq prej tij në formën e një gruaje të zezë. Halidi e preu atë në dysh me shpatën e tij. Profeti i Nderuar a.s.m. në lidhje me këtë tha: "Ata e adhuronin atë brenda idhullit Uzza, tani ajo nuk mund të adhurohet më."

• Gjithashtu, është një rrëfenjë nga Hazreti Umeri: Ai tha: "Ndërsa ne ishim me Profetin e Nderuar a.s.m., një xhind i quajtur "Hame" erdhi në formën e një burri të vjetër duke mbajtur një shkop; ai e pranoi islamin. Profeti i Nderuar a.s.m. i mësoi atij ca nga suret e shkurtëra të Kur'anit, të cilat i dëgjoi dhe atëherë ai u largua". Disa dijetarë hadithi patën qenë në dyshim për këtë ngjarjen e fundit, por më të rëndësishmit e tyre e deklaruan atë si autentike.

Në çdo situatë, është e panevojshme ta përshkruajmë në hollësi këtë lloj, pasi shembujt e tij janë të shumtë. Ne vetëm do të shtonim këtë:

• Nëpërmjet dritës së Profetit të Nderuar a.s.m., përmes edukimit të tij dhe duke e ndjekur atë, me mijëra dijetarë shpirtërorë e studiues të pastër si Shejh Abd el-Kadir Gejlani janë takuar e kanë

folur me engjëjt dhe xhindet. Fakti ka arritur në shkallën e "Konsensusit" njëqind herë më shumë nëpërmjet shembujve të panumërt. Po, anëtarët e ummetit (komunitetit) të Muhammedit a.s.m. duke qenë në kontakt me engjëjt dhe xhindet dhe duke folur me ta, kjo ndodh nëpërmjet drejtimit dhe mësimit të mrekullueshëm të Profetit të Nderuar a.s.m..

Dega e tretë: Mbrojtja dhe ruajtja e Profetit të Nderuar a.s.m. ishte një mrekulli e qartë dhe shumë shembuj të saj tregohen nga e vërteta e qartë e vërsetit:

وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ

"Dhe All-llahu do të të mbrojë ty nga njerëzit." (Kur'an, 5: 79)

Sigurisht, kur Profeti i Nderuar a.s.m. u shfaq, Ai nuk po sfidonte vetëm një grup apo një popull, ose disa sundimtarë apo një fe, por Ai po sfidonte i vetëm të gjithë mbretërit dhe popujt e të gjitha feve. Dhe megjithatë derisa Ai vdiq, ndërroi jetë, në qetësinë e lumturinë më të plotë e u ngjit tek mbretëria qiellore, për njëzet e tre vjet Ai ishte pa rojtar apo mbrojtës dhe u zbulua para shumë komploteve e intrigave me xhaxhain e Tij; armiqtë, fisi i Tij dhe populli ishin armiqësorë kundër Tij. Kjo tregon se çfarë të vërtete të fuqishme shpreh vërseti Kur'anor وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ *"Dhe All-llahu do të të mbrojë ty nga njerëzit".* Dhe çfarë pike e fortë mbështetjeje ishte ajo. Ne do të përmendim vetëm ca ngjarje të klasifikuara si të sigurta, si shembuj:

• **Ngjarja e parë:** Dijetarët e hadithit e të biografisë së Profetit raportojnë me unanimitet se Kurejshët u mblodhën për të bërë një marrëveshje të sigurt për të vrarë Profetin e Nderuar a.s.m.. Ndërkohë atyre u vjen Iblisi (shejtani) në formën e njeriut dhe u sugjeroi atyre që të merrej një person nga çdo fis me qëllim që të parandalonte konfliktin midis Kurejshit– dhe ata formuan një grup afërsisht dyqind veta nën drejtimin e Ebu Xhehlit dhe të Ebu Lehebit; ata organizuan një sulm të befasishëm mbi shtëpinë e Profetit të Nderuar a.s.m.. Hazreti Aliu ishte bashkë me Profetin e Nderuar

a.s.m.. Profeti i tha Aliut të flinte atë natë në shtratin e Tij. Profeti i Nderuar a.s.m. priti deri sa Kurejshët erdhën dhe rrethuan plotësisht shtëpinë, atëherë Ai doli dhe u hodhi një grusht dhè mbi kokat e tyre dhe, asnjë prej tyre nuk e shikoi Atë. Ai kaloi përmes tyre dhe u largua. Kur Ai mbërriti tek shpella e Hirasë, dy pëllumba dhe një merimangë u bënë rojtarët e Tij dhe e mbrojtën Atë kundra të gjithë Kurejshitëve.

• **Ngjarja e dytë:** Ndodhi, sigurisht, se kur ata të dy dolën nga shpella e u nisën në drejtim të Medines, u ndoqën nga një burrë shumë guximtar i quajtur Suraka, i cili, për një shpërblim të madh, kishte qenë dërguar nga krerët e Kurejshit për t'i vrarë. Profeti i Nderuar a.s.m. dhe Ebu Bekir es-Siddiku e kishin parë Surakën duke ardhur kur ata dolën nga shpella. Ebu Bekri pati qenë i mërzitur kur ishte në shpellë, por Profeti i Nderuar a.s.m. e qetësoi dhe i tha siç i pati thënë në shpellë:

لَا تَحْزَنْ إِنَّ اللَّهَ مَعَنَا *"Mos u dëshpëro, All-llahu është me ne!"*

Ai e vështroi Surakën; Thundrat e kalit të tij ishin ngulur në rërë. Ndërkohë Suraka u lirua dhe nisi përsëri duke i ndjekur. Atëherë përsëri kali mbeti i shtangur e i mbërthyer, dhe diçka si tym po ngrihej nga ku thundrat e kalit ishin ngulur. Në këtë pikë, Suraka kuptoi se: Ishte përtej fuqisë së tij dhe fuqisë së çdo njeriu tjetër që ta dëmtonte Atë. Ndërkohë ai thirri: "Mëshirë". Profeti i Nderuar a.s.m. e çliroi atë, por i tha të kthehet prapa dhe e urdhëroi të mos linte askënd që t'i ndiqte. Atëherë ai u largua.

• Në lidhje me këtë ngjarje, ne gjithashtu duhet të përmendim nga një burim i saktë se një bari i njohu ata dhe menjëherë u nis për në Mekë që të informojë Kurejshët. Por, me të arritur në Mekë, ai harroi pse kishte ardhur. Nuk ka rëndësi se sa shumë u përpoq, por ai nuk mundi të kujtohej. Ai u detyrua të kthehej, dhe më vonë ai kuptoi se ishte bërë ta harronte atë.

• **Ngjarja e tretë:** Dijetarët kryesues të hadithit tregojnë nëpërmjet shumë zinxhirësh transmetimi se: Në betejën e Gatfanit

dhe Anmarit, një kryetar trim i fisit të tij i quajtur Guras, erdhi vjedhurazi në afërsi të Profetit të Nderuar a.s.m.. Shpata e tij ishte gati në dorë. Ndërkohë ai i tha Profetit të Nderuar a.s.m.: "Kush do të të shpëtojë ty nga unë? Profeti u përgjigj*: "All-llahu!"* Pastaj u lut:

اَللّٰهُمَّ اكْفِنِيهِ بِمَا شِئْتَ *"O Zot, më shpëto mua nga ai në qoftë se Ti kështu dëshiron!"*

Papritmas, Gurasi mori një goditje nga e padukshmja midis shpatullave dhe shpata e tij ra përtokë. Profeti i Nderuar a.s.m. e mori shpatën në dorë dhe i tha: *"Tani kush të shpëton ty nga unë?",* pastaj e fali atë. Personi i lartëpërmendur u kthye tek fisi i tij. Gjithësecili u çudit për luftëtarin trim e guximtar dhe e pyetën atë se çfarë i kishte ndodhur dhe, përse nuk kishte bërë asgjë. Ai iu përgjigj atyre: "Ja se si ndodhi: Unë tani kam ardhur nga më i miri i njerëzve."

• Në një ngjarje të ngjashme me këtë në luftën e Bedrit, një hipokrit iu afrua nga prapa Profetit të Nderuar a.s.m. kur askush nuk ishte i vetëdijshëm për të. Sapo e ngriti dorën për ta goditur, Profeti i Nderuar a.s.m. u kthye dhe e shikoi atë, burri u drodh dhe shpata e tij i ra në tokë.

• **Ngjarja e katërt:** Kjo është e mirënjohur pothuajse me shkallën e "Konsensusit në Kuptim" dhe jepet nga shumica e komentatorëve të Kur'anit si shkaku i shpalljes së këtij vërseti Kur'anor:

إِنَّا جَعَلْنَا فِي أَعْنَاقِهِمْ أَغْلَالًا فَهِيَ إِلَى الْأَذْقَانِ فَهُمْ مُقْمَحُونَ ﴿٨﴾ وَجَعَلْنَا مِنْ بَيْنِ
أَيْدِيهِمْ سَدًّا وَمِنْ خَلْفِهِمْ سَدًّا فَأَغْشَيْنَاهُمْ فَهُمْ لَا يُبْصِرُونَ

"Sigurisht, Ne kemi vendosur zinxhirë rreth qafave të tyre deri tek nofullat e tyre, kështu që kokat e tyre detyrohen të rrinë lart (dhe ata nuk mund të shohin). "Dhe Ne kemi vënë një pengesë përpara tyre dhe një pengesë prapa tyre, dhe për më tepër, Ne i kemi mbuluar, kështu që ata nuk mund të shohin."

• Gjithashtu, kjo tregohet nga komentatorët më të shquar dhe dijetarët e hadithit. Ata njoftojnë se Ebu Xhehli bëri një be duke thënë: "Unë do ta godas Muhammedin me një gurë në qoftë se e

shikoj atë duke bërë sexhde". Ai mori një gur të madh dhe shkoi ta gjente. Ai ngriti duart e tij për ta hedhur gurin kur e pa Profetin të rënë në sexhde, por duart i mbetën shtang në pozicionin e tyre të ngritura. Kur Profeti i Nderuar a.s.m. e plotësoi faljen e u largua, atëherë u liruan duart e Ebu Xhehlit. Ai mundi t'i lëvizë duart ose për shkak se e lejoi Profeti i Nderuar a.s.m., ose për shkak se nuk ishte më nevoja që ato të mbeteshin ashtu.

• Një ngjarje tjetër e ngjashme, një burrë nga i njëjti fis si Ebu Xhehli, Velid Ibn Mugire sipas një rrëfenje, shkoi në Qabe me një gurë të madh në dorën e tij për ta goditur Profetin e Nderuar a.s.m. ndërsa Ai ishte duke bërë sexhde, por sytë e personit u mbyllën dhe nuk mundi ta shihte Profetin e Nderuar a.s.m. në Xhaminë e Qabesë, as nuk qe i mundur të shikonte njerëzit të cilët e kishin dërguar atë; ai mundi vetëm të dëgjojë zërat e tyre. Kur Profeti i Nderuar a.s.m. e mbaroi faljen, sytë iu hapën, sepse nuk ishte më e nevojshme të rrinin të mbyllur.

• Gjithashtu, tregohet përmes një rrëfenje autentike nga Ebu Bekri es-Siddiku, i Drejti, se pasi ishte shpallë sureja تَبَّتْ يَدَآ أَبِى لَهَبٍ *rreth Ebu Lehebit*, gruaja e tij, حَمَّالَةَ الْحَطَبِ *"bartësja e druve"*, Umm Xhemil, erdhi tek Qabeja me një gurë në dorën e saj. Ajo e pa Ebu Bekir es-Siddikun, i cili po rrinte ulur pranë Profetit të Nderuar a.s.m. dhe e pyeti: "O Ebu Bekir! Ku është shoku yt? Unë kam marrë vesh se Ai më ka përqeshur. Në qoftë se do ta shoh, do ta godas në gojë me këtë gurë." Ajo nuk mundi ta shohë Hazreti Pejgamberin a.s.m., ndonëse Ai po rrinte ulur pranë tij. Natyrisht, një bartëse e druve të zjarrit si ajo nuk do të mundej të hynte në praninë e një mbreti të madh si Ky, i Cili ishte nën mbrojtjen Hyjnore, e ta shikonte Atë. Si do të ishte e mundur kjo?

• **Ngjarja e pestë:** Tregohet përmes një rrëfenje autentike se Amir Ibn Tufejl dhe Erbed Ibn Kajs komplotuan për të vrarë Profetin e Nderuar a.s.m.. Amiri tha: "Unë do ta mbaj Atë të zënë, ndërsa ti godite." Ata shkuan, por Erbedi nuk bëri asgjë. Amiri më vonë i tha atij se përse nuk e kishte goditur. Erbedi u përgjigj: "Si të mundesha? Sa

herë që synoja ta godisja, unë të shihja ty midis nesh, si mund të të godisja ty?"

• **Ngjarja e gjashtë:** Tregohet nëpërmjet një rrëfenje autentike se në betejën e Uhudit apo të Hunejnit, Shajba Ibn Uthman el-Haxhebijje, babain dhe xhaxhain e të cilit i kishte vrarë Hazreti Hamzai, erdhi zvarrë pa u ndier mbi Profetin e Nderuar a.s.m. për të marrë hak. Kur po ngrinte shpatën e tij të nxjerrur, ajo papritmas i ra nga dora e tij. Profeti i Nderuar a.s.m. u kthye dhe e pa atë dhe vendosi dorën mbi kraharorin e tij. Shejbe më vonë tha: "Në atë moment nuk kishte njeri në botë që ta doja më shumë se Atë" dhe i besoi. Profeti i Nderuar a.s.m. i tha atij të shkonte e të luftonte. Shejbe tha: "Unë shkova dhe luftova përkrah Profetit të Nderuar Alejhis-salatu ves-selam. *Në qoftë se do të kisha ndeshur edhe babain tim në atë moment, unë do ta kisha goditur!"*

• Gjithashtu, në ditën e pushtimit të Mekkës, një burrë i quajtur Fedale u afrua tek Profeti i Nderuar a.s.m. me qëllim për ta goditur. Profeti i Nderuar a.s.m. e shikoi dhe i tha duke i buzëqeshur: "çfarë i the vetes tënde?" Duke u lutur për mëshirë ndaj tij, që ai të falej, Fedale u bë besimtar dhe tha: "Në atë moment nuk kishte asnjë njeri të dashur në botë që ta doja më shumë se Muhammedin a.s.m.."

• **Ngjarja e shtatë:** Sipas një rrëfenje të shëndoshë, çifutët komplotuan me qëllim për të vrarë Profetin e Nderuar a.s.m., duke hedhur një shkëmb të madh ndërsa Ai ishte i ulur. Profeti i Nderuar a.s.m. në atë moment u ngrit me anë të mbrojtjes Hyjnore; kështu komploti i tyre u asgjësua.

Kishte shumë ngjarje të ngjashme me këto shtatë të lartëpërmendurat. Dijetarët e hadithit, me në krye Imam Buhariun dhe Muslimin, tregojnë nga Hazreti Aisheja se pasi u shpall vërseti:

وَاللهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ *"Dhe All-llahu do të të mbrojë Ty nga njerëzit",*

Profeti i Nderuar a.s.m. u thonte herë pas herë atyre që e ruanin:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ انْصَرِفُوا فَقَدْ عَصَمَنِي رَبِّي عَزَّ وَجَلَّ

"O njerëz, më lini mua, sepse Zoti, Madhështori dhe i Gjithëfuqishmi më mbron mua!" (d.m.th.) s'kam nevojë të më mbroni, sepse Krijuesi im më mbron."

Kështu, nga fillimi e gjer tani, kjo Trajtesë tregon se: Çdo specie e qënies, çdo botë e krijimit në univers e njohu Profetin e Nderuar a.s.m. dhe u lidh me Të. Mrekullitë e Tij u shfaqën nga çdo lloj prej krijesave të gjithësisë, sepse Personaliteti i Muhammedit a.s.m. ishte nëpunës e mesazhier nga All-llahu xh.sh., por në lidhje me cilësinë e Tij, Zhvillues i krijesave dhe Krijues i gjithësisë, ashtu si çdo zyrë apo departament i qeverisë që njeh e pranon një zyrtar të një rangu të lartë, një inspektor të mbretit dhe kudo që të hyjë gjen mikpritje të ngrohtë sepse ai është i urdhëruar nga ana e Mbretit madhështor, në qoftë se do ta supozonim se ai ishte vetëm inspektor i drejtësisë, atëherë vetëm ai departament i qeverisë do ta njihte atë, kurse zyrat e tjera, 'jo'. Dhe kështu, kuptohet se të gjitha botët dhe sferat e sundimit Hyjnor, çdo specie e grup duke filluar nga engjëjt e deri tek mizat e merimangat e njohën dhe e pranuan Atë ose u njoftuan për Të. Domethënë, Ai ishte Hatemu'l Enbija (Vula e Profetëve) dhe Mesazhieri i Krijuesit të të gjitha botërave. Dhe profetësia e Tij ishte më gjithëpërfshirëse se sa e profetëve të mëparshëm, pasi nuk është për një popull të veçantë, por mesazh i përbotshmërisë.

* * *

SHENJA E GJASHTËMBËDHJETË

Çudirat që ndodhën para misionit të Tij Profetik, por konsiderohen prej treguesve dhe provave të profetësisë së Tij quhen *Irhasat*. Ato ndahen në tre lloje:

Lloji i parë:

Ky lloj i *Irhasatit* përfshin lajmet e profetësisë së Muhammedit të dhëna nga Kur'ani; Teurati, Inxhili (Bibla), Zeburi (Psalmet e Davudit) dhe nga Suhufet (Shkrimet e shpallura) të profetëve të tjerë, ashtu siç u deklaruan nga Kur'ani. *Në të vërtetë, meqenëse ato libra janë shkrime të shenjta të shpallura dhe meqenëse ata të cilët i sollën ato ishin profetë, është e domosdoshme dhe e sigurt se ata do ta përmendnin Atë që do të zëvendësonte fetë e tyre, që do të ndryshonte formën e universit dhe që do të ndriçonte gjysmën e globit me dritën që Ai solli. A do të ishte e mundur që ato libra, të cilët nuk neglizhojnë as për ngjarjet më të pjesshme, të mos lajmëronin për fenomenin më të rëndësishëm të njerëzimit, Profetësinë e Muhammedit a.s.m.?* Po, meqenëse do të flisnin për Të, ata ose do ta denonconin Atë si gënjeshtër e të shpëtonin fetë e tyre nga shkatërrimi dhe librat e tyre nga shfuqizimi, ose do ta vërtetonin Atë dhe me anë të Atij personaliteti të së vërtetës të shpëtonin fetë e tyre nga bestytnitë dhe nga ndryshimi. Tani miqtë dhe armiqtë bien dakord se nuk ka shenjë të ndonjë përgënjeshtrimi të tillë në ato libra. Atëherë ka shenja vërtetimi. Dhe meqenëse ka vërtetim të sigurt dhe, meqenëse ka një arsye të sigurt dhe një shkak themelor për një vërtetim të tillë, ne gjithashtu do të demonstrojmë nëpërmjet tre provave vendimtare ekzistencën e këtij vërtetimi.

• **Prova e parë:** Profeti i Nderuar a.s.m. u thotë atyre përmes gjuhës së Kur'anit: "Shkrimet tuaja të shenjta më përshkruajnë e më

vërtetojnë mua; ato më mbështesin mua në gjërat që unë them. Ai i sfidon ata me vërsete të tilla, si:

[قُلْ فَأْتُوا بِالتَّوْرَاةِ فَاتْلُوهَا إِن كُنتُمْ صَادِقِينَ] [فَمَنْ حَاجَّكَ فِيهِ مِن بَعْدِ مَا جَاءَكَ مِنَ الْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا نَدْعُ أَبْنَاءَنَا وَأَبْنَاءَكُمْ وَنِسَاءَنَا وَنِسَاءَكُمْ وَأَنفُسَنَا وَأَنفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَل لَّعْنَتَ اللَّهِ عَلَى الْكَاذِبِينَ]

Thuaj, *"Silleni Teuratin dhe lexojeni atë, në qoftë se jeni njerëzit e së vërtetës!"*[217]

Thuaj, *"Ejani , le të mblidhemi së bashku, djemtë tonë e djemtë tuaj , gratë tona e gratë tuaja, vetet tona dhe vetet tuaja; atëherë le të lutemi me seriozitet e të kërkojmë me lutje mallkimin e Zotit mbi ata që gënjejnë!"*[218]

Pavarësisht fyerjes së vazhdueshme të Tij kundra tyre në vërsete të tilla si këto, asnjë dijetar çifut apo prift Kristian nuk qe i mundur të tregojë se Ai kishte bërë ndonjë gabim, sepse po të kishte pasur ndonjë gabim, sa do i vogël i këtij lloji, ata jobesimtarë të shumtë, kryeneçë e xhelozë dhe ata çifutë shtiracakë, dhe e gjithë bota e mosbesimit do ta kishin shpallur Atë gabim gjithandej. Gjithashtu Ai tha:

"Ose ju do të gjeni ndonjë gabim timin, ose unë do t'ju luftoj juve deri në shkatërrim!" Ata zgjodhën luftën, emigrimin dhe mjerimin. Domethënë, ata nuk mundën të gjenin ndonjë gabim, sepse po të kishin gjetur, ata do të kishin qenë të shpëtuar.

• **Prova e dytë:** Fjalët e Teuratit, të Inxhilit (Biblës) dhe të Zeburit (Psalmet) nuk e kanë mrekullinë e atyre të Kur'anit. Ato gjithashtu janë përkthyer vazhdimisht dhe shumë fjalë të huaja janë përzier me to. Gjithashtu, fjalët e komentatorëve dhe interpretimet e tyre të gabuara janë ngatërruar me vërsetet e tyre. Përveç kësaj, shtrembërimet e injorantëve dhe të dashakëqinjve janë shkrirë tek to.

[217] Kur'an, 3: 93
[218] Kur'an, 3: 61

Në këto mënyra, ndryshimet dhe modifikimet janë shumuar në ato libra. Në fakt, Shejh Rahmetullah el-Hindi, dijetari i mirënjohur, u provoi dijetarëve Çifutë dhe priftërinjve me mijëra ndryshime në to. Megjithatë, pavarësisht këtyre ndryshimeve, në kohët tona, i shquari Husejn Xhisri (All-llahu e mëshiroftë) prej atyre librave nxori njëqind e dhjetë tregues të Profetësisë së Muhammedit a.s.m. dhe i përfshiu ato në veprën e tij Risale el-Hamidije. Kjo u përkthye në turqisht nga i ndjeri Ismail Hakki i Manastirit; kushdo që dëshiron, mund t'i referohet asaj vepre.

• Gjithashtu, shumë dijetarë Çifutë e Kristianë njohën dhe pranuan se: *Atributet e Muhammedit a.s.m. qenë shkruar në librat e tyre. Perandori i famshëm romak, Herakliu, i cili vetë ishte jomusliman vërtetoi dhe tha: "Isai (Jezusi) a.s. njoftoi për ardhjen e Muhammedit a.s.m.."*

• Gjithashtu, një sundimtar tjetër Romak i quajtur Mukavkis, guvernatori i Egjiptit, dijetarë të shquar çifutë dhe udhëheqës të tillë si Ibn Surija, Zubejr Ibn Barija, Ibn Ahtab dhe vëllai i tij Ka'b Ibn Esed, ndonëse mbetën jomuslimanë, pranuan duke thënë: "Po, Ai përshkruhet dhe përmendet në librat tonë."

• Gjithashtu disa nga dijetarët e famshëm çifutë dhe priftërinjtë Krishterë e flakën kryeneçësinë e tyre kur panë cilësitë e Muhammedit a.s.m. të përshkruara në Teurat e në Inxhil dhe i besuan Atij. Ata, atëherë, ua treguan ato referime dijetarëve të tjerë Çifutë e Krishterë dhe i bindën ata. Midis tyre ishin i shquari, Abdull-llah Ibn Selem, Veheb Ibn Munabbih, Ebu Jasir dy djemtë e Sa'jes, Asidi, Thalaba dhe Shamuli. (Të fundit jetuan në kohën e Tubbasë, sundimtarit të Jemenit. Shamuli u bë besimtar para misionit Profetik të Muhammedit a.s.m. dhe pa e parë ndonjëherë atë, ashtu siç bëri Tubba). Ndërsa ishte miku i fisit Beni Nadir para misionit Profetik, një mistik i quajtur Ibn Hajaban, deklaroi:

قَرِيبٌ ظُهُورُ نَبِيٍّ هٰذَا دَارُ هِجْرَتِهِ

"Një Profet do të shfaqet shpejt dhe ky është vendi tek i cili Ai do të emigrojë."

Ai deklaroi dhe vdiq atje. Më vonë kur ai fis ishte në luftë me Profetin a.s.m., Asidi dhe Thelaba dolën në ballë dhe i bënë thirrje fisit duke thënë:

وَاللّٰهِ هُوَالَّذِیْ عَهِدَ اِلَیْکُمْ فِیْهِ اِبْنُ هَیْبَانْ

"Betohemi në Zotin se Ai është Profeti për të cilin Ibn Hajbani premtoi se do të vinte. Mos e luftoni Atë."

Por ata, anëtarët e atij fisi, nuk u kushtuan vëmendje atyre të dyve dhe pësuan dënimin.

• Gjithashtu, shumë dijetarë Çifutë si Ibn Benjamin, Mihajrik dhe Ka'b el-Ahbar, u bënë besimtarë duke i bërë të heshtin ata që nuk e pranuan besimin.

• Gjithashtu dijetari i famshëm Kristian dhe Murgu (Prifti) Bahira, i cili u përmend lart, u bë musliman. Profeti i Nderuar a.s.m. ishte dymbëdhjetë vjeç kur Ai po udhëtonte drejt Damaskut me xhaxhain e Tij dhe, për hir të Tij, Bahira u bëri ftesë kurejshitëve, dhe u përgatiti ushqim karvanit të Kurejshit. Pastaj kur hodhi vështrimin, pa se reja që lëshonte hije mbi karvanin udhëtues, kishte mbetur në vendin e saj. Atëherë kuptoi se personi të Cilin e kërkonte kishte mbetur tek karvani dhe dërgoi për ta sjellur. Ai i tha Ebu Talibit: *"Kthehu në Mekë! Çifutët janë shumë xhelozë e do të përdorin tradhtinë, sepse cilësitë e Tij përshkruhen në Teurat."*

• Gjithashtu Nestori Abisinas dhe Sundimtari i atij vendi Negusi, besoi kur pa cilësitë e Muhammedit a.s.m. të përshkruara në librat e tyre.

• Gjithashtu, një dijetar i mirënjohur Kristian i quajtur Deghatr u bë besimtar duke parë përshkrimin e Profetit a.s.m.dhe u martirizua kur e shpalli këtë midis Bizantinëve.

• Gjithashtu, prej udhëheqësve krishterë, Harith Ibn Ebi Shumar el-Gasani dhe sundimtarët e shquar dhe drejtuesit fetarë të Damaskut të tillë si Sahib el-Ilja, Herakliu, Ibn Natur dhe el-Xharud, hynë në radhët e Islamit pasi shikuan përshkrimin e Profetit në librat e tyre.

Midis tyre vetëm Herakliu e fshehu besimin e tij për hir të sundimit tokësor.

• Gjithashtu, si këto, Selman el-Farisi, më parë, pati qenë krishter. Ai e kërkoi Profetin e Nderuar a.s.m. pasi shikoi përshkrimin e Tij.

• Gjithashtu një dijetar i shquar i quajtur Tamim, sundimtari i mirënjohur Abisinas Negusi, krishterët abisinas, priftërinjtë e Nexhranit, të gjithë me unanimitet deklarojnë duke thënë. "Ne i pamë përshkrimet e Muhammedit a.s.m. te librat tonë, prandaj i besuam".

• ***Prova e tretë:*** Këtu si shembuj ne do të tregojmë nga Inxhili (Bibla), Teurati dhe nga Zeburi (Psalmet) disa shembuj të vërseteve që lidhen me Profetin tonë a.s.m.

• **I pari:** Në Zebur (Psalmet) është vërseti i mëposhtëm.

اَللّٰهُمَّ ابْعَثْ لَنَا مُقِيمَ السُّنَّةِ بَعْدَ الْفَتْرَةِ

"O Zot, na dërgo ne pas periudhës midis profetëve një që do të vendos një model shembullor.

Këtu fraza: "Mukimu's-Sunne" "...një model shembullor", i referohet Profetit Muhammed, Ahmed.

• Një vërset nga Inxhili thotë:

قَالَ الْمَسِيحُ إِنِّي ذَاهِبٌ إِلَى أَبِي وَأَبِيكُمْ لِيَبْعَثَ لَكُمُ الْفَارَقْلِيطَا

Mesia tha: "Unë do të shkoj tek Ati im dhe Atij juaj, që Ai t'ju dërgojë ju Paraklitin," domethënë Ahmedin, Muhammedin.

• Një vërset tjetër nga Inxhili (Ungjilli) thotë:

إِنِّي أَطْلُبُ مِنْ رَبِّي فَارَقْلِيطًا يَكُونُ مَعَكُمْ إِلَى الْأَبَدِ

"Unë do t'i lutem Atit (Zotit) që t'jua japë ndihmësin, Profetin Paraklit (për të më zëvendësuar), shpirtin e së vërtetës që do të qëndrojë përgjithmonë me ju." (Gjon, 14:16)

Parakliti duke pasur kuptimin: اَلْفَارِقُ بَيْنَ الْحَقِّ وَالْبَاطِلِ *"dalluesi i të mirës nga e keqja",* është emri i Profetit Muhammed në ato libra.

• Një vërset nga Teurati thotë:

إِنَّ اللهَ قَالَ لِإِبْرَاهِيمَ إِنَّ هَاجَرَ تَلِدُ وَيَكُونُ مِنْ وَلَدِهَا مَنْ يَدُهُ
فَوْقَ الْجَمِيعِ وَيَدُ الْجَمِيعِ مَبْسُوطَةٌ إِلَيْهِ بِالْخُشُوعِ

"Sigurisht Zoti i tha Ibrahimit (Abrahamit) se Haxhereja (Hagari) nëna e Ismailit, do të lind fëmijë. Do të shfaqet nga djemtë e saj Njëri, dora e të Cilit do të jetë mbi të gjithë dhe duart e të gjithëve do t'i hapen Atij në respekt."

• Një vërset tjetër në Teurat:

وَقَالَ يَا مُوسَى إِنِّي مُقِيمٌ لَهُمْ نَبِيًّا مِنْ بَنِي إِخْوَتِهِمْ مِثْلَكَ وَأُجْرِي قَوْلِي
فِي فَمِهِ وَالرَّجُلُ الَّذِي لَا يَقْبَلُ قَوْلَ النَّبِيِّ الَّذِي يَتَكَلَّمُ بِاسْمِي فَأَنَا أَنْتَقِمُ مِنْهُ

"Dhe Ai i tha Musait: "O Musa (Mojsi), sigurisht Unë do t'u dërgoj atyre një Profet si ti nga djemtë e vëllezërve të tyre; Unë do të vë fjalën Time në gojën e Tij dhe do të ndëshkoj cilindo që nuk pranon fjalët e Profetit që do të flas në emrin Tim."

• Një vërset i tretë nga Teurati:

قَالَ مُوسَى رَبِّ إِنِّي أَجِدُ فِي التَّوْرَاةِ أُمَّةً هُمْ خَيْرُ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ
لِلنَّاسِ يَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَيُؤْمِنُونَ
بِاللهِ فَاجْعَلْهُمْ أُمَّتِي قَالَ تِلْكَ أُمَّةُ مُحَمَّدٍ

Musai tha: "O Zot! Sigurisht unë kam gjetur në Teurat një komunitet që është më i miri i komuniteteve, i cili do të shfaqet për të mirën e njerëzimit. Ata do të urdhërojnë për tek e mira e do të ndalojnë padrejtësinë; dhe do të besojnë në Zotin; atëherë le të jetë ai

komuniteti im! Zoti xh.sh. *tha: Ai është komuniteti i Muhammedit* Alejhis-salatu ves-selam"

KUJTESË: Në ato libra, emri i Muhammedit a.s.m. jepet në formën Siriakishte, si مُشَفَّح Mushaffah, اَلْمُنْحَمَنَّا Munhamanna, حِمْيَاطَا Himjata, dhe emrat me kuptimin Muhammed në hebreishte. Ndryshe emri i Muhammedit përmendet qartë vetëm në pak vende të cilat gjithashtu u ndryshuan nga çifutët xhelozë.

Një vërset nga Zeburi (Psalmet) e Davudit deklaron:

يَا دَاوُدُ يَأْتِي بَعْدَكَ نَبِيٌّ يُسَمَّى اَحْمَدَ وَمُحَمَّدًا صَادِقًا سَيِّدًا اُمَّتُهُ مَرْحُومَةٌ

"*O Davud! Një Profet do të shfaqet pas teje, i quajtur Ahmed, Muhammed; Ai do të jetë i vërtetë, do të jetë sundimtar dhe komuniteti i Tij do të jetë i falur* .

Një nga shtatë Abdull-llahët, Abdull-llah Ibn Amr Ibn A's, i cili bëri studime të mëdha rreth shkrimeve të shenjta të mëparshme, dhe Abdull-llah Ibn Selam, i cili ishte i pari që pranoi Islamin midis dijetarëve të famshëm Çifutë, dhe dijetari i shquar Ka'b el-Ahbar midis bijve të Israelit, të gjithë treguan në Teurat, i cili atëherë nuk ishte ndryshuar aq sa është sot, vërsetin e mëposhtëm, që pasi i adresohet Hazreti Musait, i adresohet edhe Profetit që do të vinte më pas:

يَا اَيُّهَا النَّبِيُّ اِنَّا اَرْسَلْنَاكَ شَاهِدًا وَمُبَشِّرًا وَنَذِيرًا وَحِرْزًا لِلْاُمِّيِّيْنَ
اَنْتَ عَبْدِي سَمَّيْتُكَ الْمُتَوَكِّلَ لَيْسَ بِفَظٍّ وَلَا غَلِيظٍ وَلَا صَخَّابٍ فِي
الْاَسْوَاقِ وَلَا يَدْفَعُ بِالسَّيِّئَةِ السَّيِّئَةَ بَلْ يَعْفُو وَيَغْفِرُ وَلَنْ
يَقْبِضَهُ اللّٰهُ حَتّٰى يُقِيمَ بِهِ الْمِلَّةَ الْعَوْجَاءَ بِاَنْ يَقُولُوا لَا اِلٰهَ اِلَّا اللّٰهُ

"O Profet, sigurisht Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, përgëzues, paralajmërues dhe mbrojtje për analfabetët. Ti je robi Im dhe Unë të kam vënë Emrin 'i mbështeturi te Zoti xh.sh. Ti nuk do të jeshë i

ashpër, i paepur e zhurmëmadh në tregje, ti as nuk do të kërkosh të keqen me të keqe, por do t'i përgjigjesh me tolerancë e falje. Zoti nuk do të të marrë Ty tek Madhështia e Tij deri sa ti të kesh drejtuar një popull të mbrapshtë duke i bërë ata të thonë: "Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut."

• Një vërset tjetër nga Tevrati:

مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللهِ مَوْلِدُهُ بِمَكَّةَ وَهِجْرَتُهُ بِطَيْبَةَ وَمُلْكُهُ بِالشَّامِ وَأُمَّتُهُ الْحَمَّادُونَ

"Muhammedi është i dërguari i Zotit xh.sh., vendlindja e Tij është Mekka, Ai do të emigrojë për në Tajba (Medine), sundimi i Tij do të jetë në Damask dhe ummeti (komuniteti) i Tij do të lëvdojë Zotin vazhdimisht."

Në këtë vërset, një fjalë Siriakishte me kuptimin "Muhammed" u përmend për fjalën Muhammed.

Këtu është një vërset tjetër nga Teurati: *Ti je robi im dhe i dërguari, Unë të kam vënë Ty emrin:*

أَنْتَ عَبْدِي وَرَسُولِي سَمَّيْتُكَ الْمُتَوَكِّلَ

"I mbështeturi tek Zoti", i cili i adresohet një Profeti që do të vijë pas Hazreti Musait dhe është nga pasardhësit e Ismailit, vëllait të Is'hakut.

Në vërsetin vijues nga Teurati:

عَبْدِي الْمُخْتَارُ لَيْسَ بِفَظٍّ وَلَا غَلِيظٍ

"*Robi im i zgjedhur nuk është i ashpër dhe i paepur*", kuptimi i "Muhtar" (i zgjedhur) është i njëjtë si "Mustafa", një emër i Muhammedit.

Në disa vende të Inxhilit (Ungjillit), një Profet i Cili do të vijë pas Isait (Jezusit) i referohet "Udhëheqësit të botës". Ai përshkruhet si më poshtë:

مَعَهُ قَضِيبٌ مِنْ حَدِيدٍ يُقَاتِلُ بِهِ وَأُمَّتُهُ كَذَلِكَ

"Ai do të ketë me vete një shkop prej hekuri me të cilin Ai do të luftojë; edhe populli i Tij gjithashtu."

Ky vërset tregon se një Profet do të vijë me një shpatë, dhe është i urdhëruar të tund xhihadin. *Kadib el-Hadid* (fjalë për fjale, shkop prej hekuri) që do të thotë, shpatë; dhe kështu do të jetë komuniteti i Tij. Në harmoni me vërsetin e lartëpërmendur biblik dhe duke iu referuar gjithashtu edhe disa vërseteve të tjerë, vërseti i mëposhtëm Kur'anor në fund të kapitullit *el-Fet'h*, gjithashtu deklaron se komuniteti i Tij, ashtu si Ai, do të urdhërohen të tundin xhihadin.

وَمَثَلُهُمْ فِي الْإِنجِيلِ كَزَرْعٍ أَخْرَجَ شَطْئَهُ فَآزَرَهُ فَاسْتَغْلَظَ
فَاسْتَوَىٰ عَلَىٰ سُوقِهِ يُعْجِبُ الزُّرَّاعَ لِيَغِيظَ بِهِمُ الْكُفَّارَ

"Dhe shembulli i tyre në Inxhil është: si një farë e cila nxjerr filizën e saj, pastaj e bën atë të fortë, ajo atëherë bëhet e trashë dhe qëndron drejtë mbi kërcellin e saj, (duke i mbushur) mbjellësit me çudi e gëzim. Si rrjedhojë, ajo i mbush me zemërim jobesimtarët prej tyre."

• Në Kapitullin e Tridhjetë e Tre të Librit të Pestë të Teuratit, është vërseti i mëposhtëm:

"Zoti u afrua nga Sinai, u ngrit mbi ne nga Seiri dhe do të shkëlqejë nga mali Paran."

Në këtë vërset me frazën "*Zoti u afrua nga Sinai*", tregohet profetësia e Musait; me frazën: "*u shfaq lart mbi ne nga Seiri*" (Seiri duke qenë një mal pranë Damaskut), tregohet profetësia e Isait (Jezusit); dhe fraza: "*Ai ndriçoi (e lëshoi dritë) nga mali Faran*" (malet Faran duke qenë malet e Hixhazit), jep lajmet e profetësisë së Muhammedit a.s.m., dhe të gjitha harmonizohen.

Dhe në fund të sures el-Fet'h, duke vërtetuar frazën:

ذَٰلِكَ مَثَلُهُمْ فِي التَّوْرَاةِ *"Ky është shembulli i tyre në Teurat",*

ky është vërseti vijues i Teuratit që lidhet me sahabët e Profetit Muhammed, i Cili do të ndriçonte nga malet Faran:

"*Flamurët e shenjtorëve të bekuar do të jenë me Të, dhe ata do të jenë në të djathtën e Tij*."

Në këtë vërset sahabët përshkruhen si "të bekuarit", domethënë, sahabët e Tij janë të bekuar, njerëz të drejtë dhe të dashurit e Zotit xh.sh..

• Në Kapitullin e Dyzet e Dytë të librit të Pejgamberit Esh'ija, janë vërsetet e mëposhtëm:

"E Vërteta e Madhëruar (All-llahu xh.sh.) do ta dërgojë të zgjedhurin e pastër në Fundin e Kohës -para Kijametit- dhe Atij do t'ia dërgojë Xhebrailin, përmes së cilit do t'ia mësojë Islamin, dhe mandej Ai do t'i mësojë njerëzit ashtu siç e ka mësuar Xhibrili Atë; do t'i prijë njerëzit me drejtësi, e Ai është një Nur -dritë- që njerëzinë do ta nxjerrë prej errësire. Atë që Zoti im më mësoi se ç'do të bëhet, unë jua tregoj juve."

Këtu, vërsetet, në mënyrë të qartë përshkruajnë Muhammedin a.s.m., Profetin në fundin e kohës, para kijametit.

• Në Kapitullin e Katërt të Librit të Profetit Mihaje i njohur me emrin Mishail janë vërsetet e mëposhtëm:

"Në fundin e kohës para kijametit do të shfaqet një komunitet i mëshiruar i cili adhuron "Të vërtetin, All-llahun, dhe preferon malin e Bekuar. Atje grumbullohen njerëz të shumtë prej çdo vendi, të cilët adhurojnë Krijuesin e Vetëm dhe nuk i vënë shok Atij".

Këto vërsete përshkruajnë qartë malin më të bekuar në botë, malin Arefat, dhe adhurimi e thirrja: "Zoti është më i madhi!" nga ata që bëjnë haxhillëkun dhe që ngjiten në atë mal të shenjtë. Dhe Ummeti i Muhammedit është i shquar për të marrë Mëshirën Hyjnore.

• Në Kapitullin e Shtatëdhjetë e dy të Zeburit (Psalmeve), ndodhen vërsetet e mëposhtme:

"Prona e Tij do të shtrihet nga deti deri në det, dhe nga lumenjtë deri në skajin e tokës; prej mbretërve të Jemenit dhe Algjerit Atij do t'i arrijnë dhurata; dhe mbretërit Atij do t'i përulen dhe do të vihen nën udhëheqjen e Tij; në çdo kohë Atij do t'i lexohet salevat dhe çdo ditë do t'i bëhet dua me bereqet. Drita e Tij do të shndëris nga qyteti Medine, emri Tij do të përmendet përjetësisht... emri i Tij ka ekzistuar para se të krijohet Dielli, dhe emri i Tij do të përhapet deri sa të ekzistojë Dielli..."

Këto vërsete përshkruajnë lavdinë e botës, Profetin Muhammed a.s.m., në formën më të qartë.

Përveç Profetit arab, Muhammedit a.s.m., Cili Profet ka ardhur qysh nga Davudi a.s., i cili ka përhapur fenë nga lindja në perëndim, që i bëri mbretërit të paguajnë xhizjen (haraçin), dhe që i bëri sundimtarët t'i nënshtrohen e t'i binden, për të Cilin në çdo ditë një e pesta e njerëzimit këndojnë salevate e bekime, dhe dritat e të Cilit kanë rrezatuar nga Medineja? A ka qenë ndonjë tjetër përveç Muhammedit?

• Përsëri, përkthimi Turqisht i Inxhilit të Gjonit, Kapitulli i Katërmbëdhjetë, vërseti i tridhjetë, thotë:

"Nuk kam se ç'të flas më gjatë me ju, sepse tashmë po vjen Sundimtari i Botës. Unë nuk kam asgjë në krahasim me të!"

Kështu titulli: "Sundimtari i Botës" do të thotë, "Lavdia e botës" që është njëri nga titujt e më të mirënjohurit, Muhammedit arab a.s.m..

• Përsëri në Inxhilin e Gjonit, Kapitulli i Gjashtëmbëdhjetë, vërseti i shtatë, thotë:

"Por më besoni, është më mirë për ju që po shkoj; përndryshe ngushëlluesi nuk do të vinte te ju."

Tani shikoni, kush tjetër përveç Muhammedit arab a.s.m. është Sundimtari i Botës dhe Ngushëlluesi i vërtetë i njerëzve? Po, Lavdia e Botës është Ai, dhe Ai është i Cili do ta shpëtojë njeriun kalimtar nga zhdukja e përjetshme dhe që e ngushëllon Atë."

• Përsëri, vërseti i tetë i Kapitullit të Gjashtëmbëdhjetë në Inxhilin e Gjonit thotë:

"Kur të vijë Ai, do t'u tregojë njerëzve të kësaj bote se janë fajtorë, dhe do t'i mposhtë ata tek mëkati, tek drejtësia e Perëndisë dhe gjyqi i Tij."

Kush tjetër përveç Muhammedit Arab a.s.m. e ka transformuar korrupsionin e botës në drejtësi dhe ka shpëtuar njerëzit nga mëkati i politeizmit (i të përshkruarit ortakë Perëndisë) dhe i ka transformuar politikat dhe sundimin botëror?

Gjithashtu nga Inxhili i Gjonit, vërseti i njëmbëdhjetë i Kapitullit të Gjashtëmbëdhjetë thotë: *"Erdhi koha e ardhjes së Sundimtarit të Botës.* [219]

Sigurisht, "Sundimtari i Botës" është Ahmedi, Muhammedi, sepse Ai njihet si udhëheqës i njerëzimit.

• Gjithashtu në Inxhilin e Gjonit, tek Kapitulli i Dymbëdhjetë, vërseti i trembëdhjetë thotë:

"Por kur Ai, Shpirti i së Vërtetës, vjen, Ai do t'ju udhëzojë të njihni tërë të vërtetën (për mua). Atë që do t'ju tregojë, nuk do ta marrë prej vetvetes; Ai do t'ju thotë atë që dëgjon dhe do t'ju tregojë për gjërat e ardhshme."

Ky vërset është i qartë. Kush përveç Muhammedit Arab a.s.m. i ka thirrur të gjithë njerëzit për tek e vërteta që deklarata e të Cilit mbështetej në shpallje; që ka folur çfarë Ai dëgjoi nga Xhebraili dhe,

[219] *Po! Ai është një sundimtar i tillë i madh saqë Atij i nënshtrohen me dashuri e bindje në çdo shekull treqind e pesëdhjetë milion njerëz, që prej një mijë e treqind e pesëdhjetë vjetësh, zbatojnë urdhërat e Tij, dhe ripërtërijnë me të çdo ditë besëlidhjen duke i çuar salat dhe selam. (autori)*

informoi njeriun në detaje për ringjalljen e të vdekurve dhe për Botën e përtejme? Kush tjetër mund të ishte përveç *Tij*?

Gjithashtu, librat e profetëve të tjerë duke përfshirë emra në Siriakishte e Hebreishte që u korrespondojnë emrave të ndryshëm të Profetit të Nderuar a.s.m. të tillë si: Muhammed, Ahmed, Muhtar. P.sh. në shkrimet e Hazreti Shuajbit, emri i *Tij* është مُشَفَّحْ *Mushaffah*, dhe do të thotë: Muhammed. Në Teurat Ai përmendet si مُنْحَمَنَّا "*Munhamanna*", që përsëri do të thotë Muhammed, dhe si حِمْيَاطَا "*Himjata*", që do të thotë: Profeti i el-Haramit, Qabesë. Në Zebur (Psalmet) Ai quhet: *el-Muhtar*. Përsëri në Teurat emri është اَلْحَاتَمُ اَلْخَاتَمُ *el-Hatam* e*l-Khatam.* Si në Teurat ashtu edhe në Zebur (Psalmet), Ai është مُقِيمُ السُّنَّةِ *Mukim el-Sunneh*, në shkrimet e Ibrahimit (Abrahamit) dhe në Teurat Ai përmendet si مَازْمَازْ *Mazmaz*, dhe përsëri në Teurat si اَحْيَدْ *Ahjed*.

I Dërguari i Nderuar a.s.m. vetë tha:

اِسْمِي فِي الْقُرْاٰنِ مُحَمَّدٌ، وَفِي الْاِنْجِيلِ اَحْمَدُ، وَفِي التَّوْرٰيةِ اَحْيَدُ

"Në Kur'an, emri im është Muhammed; në Inxhil, Ahmed; dhe në Teurat Ahjed." Në fakt, Inxhili (Bibla) i referohet Atij si:

صَاحِبُ الْقَضِيبِ وَالْهِرَاوَةِ "Poseduesi i shpatës dhe i shkopit". Në të vërtetë, Profeti më i madh i Cili mbante shpatën dhe u ngarkua të luftonte në rrugë të Zotit të Madhëruar së bashku me komunitetin e *Tij*, ishte Muhammedi a.s.m.. Inxhili gjithashtu e përshkruan Atë si: صَاحِبُ التَّاجِ "Mbajtësi i kurorës". Po, ky titull është i veçantë për Profetin Muhammed, sepse "kurorë" do të thotë, çallmë, kësulë, sepse në ditët e mëparshme ishin Arabët të cilët si popull të gjithë veshnin çallmën dhe kësulat. Atëherë, kjo sigurisht i referohet Profetit Muhammed a.s.m..

Termi اَلْبَارَقْلِيتْ *Paraklit* në Inxhil ose اَلْفَارَقْلِيتْ *Faraklit* përcaktohen në interpretimin biblik si "Ai që dallon të vërtetën nga gënjeshtra". Atëherë është ermri i Atij që në të ardhmen do të udhëhiqte popullin tek e vërteta."

• Në një vend në Inxhil, Isai (Jezusi) a.s. thotë: "Unë do të largohem që të vijë Sunduesi i Botës". Kush përveç Profetit Muhammed a.s.m. ka ardhur pas Hazreti Isait a.s. që të jetë sundimtari i botës, të dallojë e të ndajë të vërtetën nga e shtrembëra e të udhëheqë njerëzimin në vend të Hazreti Isait a.s.? Domethënë, Hazreti Isai a.s. po i jep gjithmonë komunitetit të *tij* lajme të mira: *"Një tjetër do të vijë, s'mbetet më nevoja për mua. Unë jam pararendësi dhe lajmëtari i Tij."* Duke mbështetur këtë, është vërseti i mëposhtëm Kur'anor:

وَإِذْ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ يَا بَنِي إِسْرَائِيلَ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ مُصَدِّقًا
لِمَا بَيْنَ يَدَيَّ مِنَ التَّوْرَاةِ وَمُبَشِّرًا بِرَسُولٍ يَأْتِي مِنْ بَعْدِي اسْمُهُ أَحْمَدُ ۖ

"Dhe përkujtoni, Isai, biri i Merjemes, tha: 'O bijtë e Israilit! Unë jam i dërguari i Zotit për ju, duke vërtetuar atë që u shpall para meje në Teurat e duke sjellë lajme të gëzueshme për një Profet që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed (i lavdëruari).

*[Shënim] Po, në Inxhil, Isai a.s. (Jezusi) dha lajme të gëzueshme shumë herë, se Udhëheqësi më i madh i njerëzimit do të vinte.

---

*[Shënim]: اُمَّتُهُ الْحَمَّادُونَ. Një eksplorator i famshëm Evlija Çelebiu shikoi në varrin e Hazreti Shemon Saffait një Inxhil të shkruar mbi një lëkurë gazeli, dhe tek ai lexoi vërsetin të shpallur në lidhje me Profetin e Nderuar a.s.m.: ايتون *-Ejtoni - është një djalë i* ازربيون *Azerbejunit nga prejardhja e Ibrahimit;* پروفتون *Peruftoni do të jetë profet;* لوغسلين *Logaslijni nuk do të jetë gënjeshtar;* بنت *Bent - i Tij,* افزولات *Efzulat, vendlindja e Tij do të jetë Mekka;* كه كالوشير *Keh*

Kalushir, Ai do të vijë për drejtësi dhe udhëzim; تونومنين *Tonomenin emri i bekuar i Tij është Mevamit* موامیت *(Shënim: Fjala Mevamit është e ndryshuar dhe e modifikuar nga emri Muhammed - Autori). Mevamit – është Ahmedi, Muhammedi;* ایسفدوس *- Esfidos – ata që e ndjekin* تاکردیس *- Takridis – bëhen themeli i kësaj bote;* بیست بیت *- Bejst Bejt - është sundimtari i botës* (autori).

Me fjalë të tjera, në atë ungjill thuhej: 'Një i ri prej pasardhësve të Ibrahimit, do të jetë profet. Ai nuk do të jetë gënjeshtar, vendlindja e tij do të jetë Meka; ai do të vijë me fetari e devocion; emri i tij i bekuar është Ahmed, Muhammed; ata që do t'i binden atij do të kenë mbarësi në këtë botë dhe në tjetrën.

Fjala e shkruar si 'Mevamit' u modifikua nga Memed, pikërisht një modifikim i Emrit Muhammed.

Ai përmendet me emra të ndryshëm, natyrisht në Siriakishte e Hebraishte të cilat i kanë vërejtur dijetarët e që kanë kuptimin **Ahmed, Muhammed dhe "Dalluesi midis të Vërtetës e të Shtrembërës".** Domethënë, në shumë raste, Isai a.s. shumë herë sihariqoi për ardhjen e Ahmedit a.s.m..

Pyetje: Nëse do të thuhej: "Përse ndodhi që profetët e tjerë vetëm lajmëruan për ardhjen, kurse Hazreti Isai (Jezusi) a.s. e lajmëroi ardhjen e Tij më plotësisht e në formë të sihariqeve?"

Përgjigjja: Sepse Ahmedi a.s.m. e mbrojti Isain a.s. (Jezusin) kundër përgënjeshtrimit të Çifutëve dhe kundra shpifjeve të tyre të ulëta dhe shpëtoi fenë e tij nga ndryshimi e modifikimi. Për më tepër, përballë sheriatit të rëndë të bijve të Israilit, të cilët nuk i besuan Isait, Profeti Muhammed erdhi me një sheriat të lartësuar, i cili ishte i lehtë, gjithëpërfshirës dhe plotësoi mangësitë e sheriatit të Isait. Për këto arsye, Isai dha lajme se *"Sunduesi i Botës do të vijë!"*

Tani është e qartë se në Teurat, në Inxhil, në Zeburin (Psalmet) e Davudit dhe në shkrimet e profetëve të tjerë ndodhen shumë

diskutime për një Profet i Cili do të vinte në kohët e vona, shumë vërsete duke e përmendur Atë.

Ashtu siç treguan shembujt e këtyre, *duke treguar se Ai përmendet në këto libra nën emra të ndryshëm, kush përveç Muhammedit të Nderuar, Profetit të ahirzamanit -kohës afër kijametit- mund të ishte kur këto shkrime të profetëve flasin në mënyrë aq të përsëritur në vërsetet e tyre dhe me një rëndësi të tillë?*

■ **Lloji i dytë:**

Shenjat e Profetësisë që u shfaqën nëpërmjet *irhasatit* gjithashtu përfshijnë ato lajme të ardhjes së Tij të dhëna para misionit të Tij Profetik në atë kohë ndërmjet profetëve nga parashikuesit dhe nga disa njerëz të njohur, si shenjtorë e mistikë të asaj kohe. Ata i botuan pretendimet e tyre dhe ia kaluan gjeneratës pasuese në poezinë e tyre. Këto janë të shumta dhe ne do të përmendim disa që janë të mirënjohura dhe janë pranuar e treguar nga studiuesit e historisë e të biografisë së Profetit të Nderuar a.s.m..

• **I pari:** Një nga sundimtarët e Jemenit i quajtur Tubba, shikoi përshkrimet e Profetit të Nderuar a.s.m. në shkrimet e librave të mëparshëm dhe i besoi Atij. Ai e njoftoi këtë nëpërmjet një poeme, kuptimi i së cilës është siç vijon:


شَهِدْتُ عَلَىٰ أَحْمَدَ أَنَّهُ رَسُولٌ مِنَ اللهِ بَارِي النَّسَمِ
فَلَوْ مُدَّ عُمْرِي إِلَىٰ عُمْرِهِ لَكُنْتُ وَزِيرًا لَهُ وَابْنَ عَمِّ

Unë dëshmoj për Ahmedin a.s.m., që është i Dërguari i Zotit, i Krijuesit të njerëzimit;

Ah sikur të jetoja më gjatë e ta shihja, unë do të isha një ministër e kushëri për të. (Domethënë, unë do të kisha qenë si Aliu.)

• **I dyti:** Kuss Ibn Saida ishte më i mirënjohuri dhe oratori më i rëndësishëm i Arabëve, një monoteist e një njeri me mendje të


ndritur. Para misionit Profetik, ai njoftoi Profetësinë e Tij me këto rreshta poetike:



"Ahmedi do të dërgohet tek ne, është Profeti më i mirë që është dërguar;

Bekimet e Zotit qofshin për Të, thërret një grup udhëtarësh sa herë që niset!"


• **I treti:** Ka'b Ibn Luaji, një nga paraardhësit e Profetit të Nderuar a.s.m. e njoftoi Profetësinë e Muhammedit a.s.m. nëpërmjet inspirimit të mëposhtëm:



"Papritmas, Muhammedi, Profeti do të shfaqet,

duke dhënë lajmet më të vërteta!

• **I katërti:** Sejf Ibn Dhijazan, njëri nga sundimtarët e Jemenit, lexoi përshkrimet e Profetit të Nderuar a.s.m. në shkrimet e vjetra dhe duke i besuar Atij, dëshiroi shumë ta shikonte. Kur Abd el-Muttalibi, gjyshi i Profetit të Nderuar a.s.m., shkoi në Jemen me disa nga Kurejshët, Sejf Ibn Dhijazani i thirri ata dhe u tha:



"Një fëmijë do të lind në Hixhaz, me një shenjë midis shpatullave të Tij duke i ngjasuar një vule. Ai do të jetë udhëheqësi i të gjithë njerëzisë. Atëherë, privatisht i tha Abdul Muttalibit: Ti je gjyshi i Tij," duke parashikuar kështu profetësinë i Tij në një mënyrë të çuditshme me keramet.

• **I pesti:** Veraka Ibn Neufel ishte kushëri i Hatixhes, kur erdhi Shpallja në fillim Profeti i Nderuar a.s.m. ishte shumë i tronditur.

Hatixheja ia përshkroi ngjarjen të shquarit Veraka Ibn Neufelit. Veraka tha: "Dërgoje Atë te unë!" Profeti i Nderuar a.s.m. shkoi te ai dhe sqaroi fillimin e ardhjes së Shpalljes. Veraka tha:

بَشِّرْ يَا مُحَمَّدُ إِنِّي أَشْهَدُ أَنَّكَ أَنْتَ النَّبِيُّ الْمُنْتَظَرُ وَبَشَّرَ بِكَ عِيسَى

"*Lajme të gëzueshme, o Muhammed! Unë dëshmoj se ti je Profeti i pritur që u parashikua nga Isai."* Domethënë, mos u shqetëso! Është vërtet ardhja e shpalljes.

• **I gjashti:** Para misionit Profetik, një mistik i quajtur Askalan el-Himiari i pyeti Kurejshitët kur i pa: "A ka ndonjë midis jush i cili pretendon profetësi? Ata u përgjigjën negativisht. Ai përsëri i pyeti ata në fillim të misionit të Tij Profetik, por këtë herë përgjigjja e tyre ishte pozitive. Atëherë Askalani tha: "Bota është duke e pritur Atë!"

• **I shtati:** Ibn el-Ala, një dijetar i famshëm Krishter para se ta shikonte Profetin, dha sihariqe dhe pastaj erdhi, e shikoi Hazreti Pejgamberin a.s.m. dhe tha:

وَالَّذِي بَعَثَكَ بِالْحَقِّ لَقَدْ وَجَدْتُ صِفَتَكَ فِي الْإِنْجِيلِ وَبَشَّرَ بِكَ ابْنُ الْبَتُولِ

"Betohem në Atë që të ka dërguar Ty me të vërtetë, unë gjeta përshkrimin tënd në Inxhil, dhe besova. Biri i Merjemes, Isai a.s. në Inxhil dha lajme të gëzueshme për ardhjen tënde."

• **I teti:** I përmendur më lartë ishte Negusi (Nexha-shiu), sundimtari Abisinas i cili deklaroi:

لَيْتَ لِي خِدْمَتَهُ بَدَلًا عَنْ هَذِهِ السَّلْطَنَةِ

"Ah! Sikur të kisha qenë më mirë shërbëtori i Muhammedit Arab a.s.m. se sa mbret. T'i shërbeja Atij do të kishte qenë shumë më e lartë se sa kjo mbretëri."

Përveç këtyre lajmeve të dhëna nga këta burra të shquar nëpërmjet inspirimit nga e padukshmja, gjithashtu falltarët dhanë lajme nga e padukshmja për ardhjen e Profetit të Nderuar a.s.m. dhe

të profetësisë së Tij, nëpërmjet xhindeve dhe qënieve shpirtërore. Këto gjithashtu janë të shumta. Ne do të përmendim ca që janë të mirënjohura e që kanë arritur shkallën e "Konsensusit në Kuptim" dhe që tregohen në pjesën më të madhe të librave të historisë e të biografisë së Profetit të Nderuar a.s.m.. Duke ua referuar atyre librave shpjegimet e tyre të gjata, ne do të përmendim vetëm një përmbledhje të tyre.

• *I pari*: Falltari i famshëm, Shikk, i cili kishte vetëm një sy, një krah dhe një këmbë; ai që ishte thjesht një gjysmë njeriu, përsëriti parashikimet në lidhje me Profetësinë e Muhammedit a.s.m. që i kishin kaluar librat e historisë me sigurinë e "Konsensusit në Kuptim".

• *I dyti*: Është falltari i famshëm i Damaskut, Satih, i cili ishte një shëmti, të cilit i mungonin kockat e madje gjymtyrët, fytyra e të cilit ishte në kraharorin e tij dhe i cili jetoi shumë gjatë. Ai kishte një emër shumë të madh në atë kohë për njoftimin korrekt që ai jepte në lidhje me të padukshmen. Madje mbreti persian Kisra, dërgoi një emisar të ditur të quajtur Mujzan për të pyetur Satihun që të interpretonte një ëndërr të çuditshme që ai kishte parë në kohën e lindjes së Muhammedit a.s.m., në të cilën katërmbëdhjetë ballkonet e Pallatit të tij u rrëzuan. Satihu i tha: "Katërmbëdhjetë burra do të sundojnë mbi ju, atëherë perandoria e juaj do të shkatërrohet. Gjithashtu dikush do të vijë, i cili do të shpallë një fe; Ai do ta zhduk si fenë tënde, po ashtu edhe perandorinë". Duke i çuar lajmet e kësaj Kisras, në këtë mënyrë, Satihu parashikoi qartë ardhjen e Profetit të Fundit të Kohës para Kijametit.

• Siç janë shkruar me detaje në librat e historisë e të biografisë së Profetit a.s.m., falltarët si Sevad Ibn Qarib el-Dausi, Hunafir, Af'asija Nexhran, Xhizl Ibn Xhizl el-Kindi, Ibn Halasat el-Dausi dhe Fatima Bint el-Nu'man el Nexharija, parashikuan ardhjen e Profetit të kohës së fundit, duke deklaruar se Ai Profet ishte Muhammedi a.s.m..

• Gjithashtu, njëri nga të afërmit e Hazreti Uthmanit, Sa'd Ibn Bint el-Kurajdh, mori dije nga e padukshmja nëpërmjet parashikimit fallxhor rreth profetësisë së Muhammedit a.s.m.. Në ditët e hershme të Islamit, ai i tha Uthman Dhu el-Nurejnit për të shkuar dhe për të

pranuar besimin. Uthmani veproi kështu dhe hyri në Islam që me shfaqjen e Tij. Sa'd e shprehu ngjarjen me një poemë, kuptimi së cilës është sa vijon:

هَدَى ٱللَّهُ عُثْمَانَ بِقَوْلِي إِلَى ٱلَّتِي ۞ بِهَا رُشْدُهُ وَٱللَّهُ يَهْدِي إِلَى ٱلْحَقِّ

Me anë të fjalëve të mia, Zoti i madhëruar e drejtoi Uthmanin për tek burimi që jep drejtësi; Sigurisht Zoti i Madhëruar drejton për tek e Vërteta.

Ashtu si falltarët, edhe xhindet që ishin të padukshëm, por që zërat e tyre dëgjoheshin, e që quheshin "*Ha'tif*", në mënyrë të përsëritur parashikuan ardhjen e Profetit të Nderuar a.s.m.. Për shembull:

• Një xhind i padukshëm i thirri siç vijon Dhejab Ibn el-Harithit dhe ishte shkaku që ai dhe të tjerët të pranonin Islamin:

يَا ذَيَّابُ يَا ذَيَّابُ إِسْمَعِ ٱلْعَجَبَ ٱلْعُجَابَ
بُعِثَ مُحَمَّدٌ بِٱلْكِتَابِ يَدْعُو بِمَكَّةَ فَلَا يُجَابُ

"O Dhejab! O Dhejab! dëgjo gjënë më të çuditshme, Muhammedi është shfaqur me librin, Ai po thërret në Mekë, ndonëse ata nuk i përgjigjen Atij!"

• Një xhind tjetër i padukshëm i thirri Samia Ibn Karrat el-Gatafanin,

جَاءَ ٱلْحَقُّ فَسَطَعَ وَدُمِّرَ بَاطِلٌ فَٱنْقَمَعَ

"E vërteta ka ardhur me një rrezatim të dukshëm, gënjeshtra u shkatërrua e u zhduk,"

dhe kjo ishte shkak për atë e për disa të tjerë që të besonin.

Mesazhe të tilla dhe lajme të mira të xhindeve të padukshëm janë tej mase të mirënjohura e të shumta. Ashtu si zërat e xhindeve e të falltarëve që e parashikuan atë, gjithashtu idhujt dhe sakrificat

(kafshët) e therrura për idhujt dhanë lajmet e profetësisë së Muhammedit të Nderuar a.s.m.. Për shembull:

• Njëra është historia e famshme: Idhulli i fisit Mezan i cili thirri:

هٰذَا النَّبِيُّ الْمُرْسَلُ جَاءَ بِالْحَقِّ الْمُنْزَلِ

"Ky është Profeti që është dërguar; Ai vjen me të Vërtetën e shpallur,"

duke treguar kështu profetësinë e Muhammedit a.s.m..

• Një tjetër është ngjarja e mirënjohur e cila i shkaktoi Abbas Ibn Merda të pranonte Islamin:

Ndodhej një idhull i quajtur Dimar, i cili një ditë thirri:

اَوْدٰى ضِمَارُ وَكَانَ يُعْبَدُ مُدَّةً قَبْلَ الْبَيَانِ مِنَ النَّبِيِّ مُحَمَّدٍ

"Dimari adhurohej para Shpalljes së Muhammedit a.s.m.; ai çudhëzim nuk mund të vazhdojë më sepse erdhi Shpallja."

• Hazreti Umeri para se pranoi Islamin, dëgjoi një kafshë, të cilën një burrë e sakrifikoi për një idhull, të thirrte:

يَا اَلَ الذَّبِيحِ، اَمْرٌ نَجِيحٌ، رَجُلٌ فَصِيحٌ، يَقُولُ، لَآ اِلٰهَ اِلَّا اللّٰهُ

"O sakrifikues, mjetet e suksesit janë pranë, një burrë elokuent po deklaron: "Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut!"

Ka edhe më shumë shembuj si këto të cilat janë pranuar si autentike dhe njoftohen në libra të besueshëm.

• Dhe ashtu si falltarët, mistikët, xhindet e padukshëm dhe madje idhujt dhe kafshët e sakrifikuara treguan profetësinë e Muhammedit a.s.m., dhe çdo ngjarje ishte shkak që njerëzit të besonin në Të; gjithashtu, përshkrimet me shkrim të vjetër mbi gurë, në varre dhe në gurët e varreve si مُحَمَّدٌ مُصْلِحٌ اَمِينٌ *"Muhammedi është reformatori – autori i së drejtës- dhe i besuari"*, ishin mjete për disa njerëz që të besonin. Po, shprehja مُحَمَّدٌ مُصْلِحٌ اَمِينٌ *'Muhammedi a.s.m. është*

reformatori dhe i besuari' tregon për Profetin Muhammed a.s.m., sepse në kohën pak para se të vinte në jetë Muhammedi a.s.m. ndodheshin vetëm shtatë burra që mbanin këtë emër, por asnjëri nga ata nuk e meritoi epitetin *"i Drejti dhe i Besuari".*

■ **Lloji i tretë:**

Ka *irhasate* që përfshijnë ngjarjet e çuditshme të cilat ndodhën në kohën e në lidhje me lindjen e Profetit të Nderuar a.s.m.. Gjithashtu gjendeshin ngjarje që ndodhën para misionit të Tij Profetik të cilat ishin mrekulli. Ato ishin shumë. Ne do të përmendim disa shembuj të cilat u bënë të mirënjohura e që janë pranuar nga autoritetet e hadithit dhe që saktësia e tyre është e vërtetuar:

• *I pari:* Në natën e lindjes së Profetit, si nëna e Tij, po ashtu edhe nënat e Uthman Ibn As'it dhe e Abdurrahman Ibn Auf'it, të cilat ishin me Të, panë një dritë vezulluese e të përhapur gjërësisht, rreth të cilave ato thanë: *"Në kohën e lindjes së Tij, ne pamë një dritë të tillë saqë ndriçoi për ne lindjen dhe perëndimin."*

• *I dyti:* Atë natë shumica e idhujve në Qabe u përmbysën e ranë përtokë.

• *I treti:* Atë natë Ejvani i famshëm i pallatit të Kisras u trondit e u plasarit dhe katërmbëdhjetë ballkonet e tij u shembën.

• *I katërti:* Atë natë liqeni i vogël i Savas, i cili konsiderohej i shenjtë, u zhyt në tokë, shteroi dhe tek Istahrabati, zjarri duke qenë i ndezur vazhdimisht për një mijë vite dhe të cilin e kishin adhuruar zoroastrianët (mexhusët), u shua.

Kështu këto katër ngjarje treguan se Ai, qysh në momentin e lindjes, do të zhdukte adhurimin e zjarrit, do të shkatërronte pallatin e mbretërve persianë dhe do të pengonte ato gjëra që shenjtëroheshin, por të cilat nuk i lejon All-llahu i Madhërishëm.

• *I pesti:* Megjithëse ato nuk përkonin me natën e lindjes së Tij, disa ngjarje që ndodhën jo shumë kohë përpara lindjes, përfshihen gjithashtu në *irhasatin* e Muhammedit a.s.m.. Njëra është ngjarja e

"*Elefantit"* që përmendet në Kur'an në suren اَلَمْ تَرَ كَيْفَ (*el-Filë).* Ebreheja, mbreti i Abisinisë erdhi që ta shkatërronte Qaben duke ngarë një elefant gjigant i quajtur Mahmudi përpara forcave të tij. Kur ata erdhën afër Mekkës, ishte e pamundur që të lëvizte elefanti. Ata nuk mund ta bënin elefantin të lëvizte përpara dhe u duhej të tërhiqeshin. Ndërsa duke u tërhequr, një tufë zogjsh (Ebabilë) i sulmuan dhe i goditën dhe kështu ata u shpartalluan në mënyrën më poshtëruese. Ky tregim i jashtëzakonshëm është regjistruar në detaje në librat e historisë. Ngjarja ishte një nga provat e profetësisë së Muhammedit të Nderuar a.s.m., sepse ajo ndodhi afër kohës së lindjes së Tij dhe e shpëtoi në mënyrë të jashtëzakonshme nga e padukshmja Qaben e shenjtë, kiblen e Tij, vendlindjen e Tij dhe tokën e Tij amtare nga shkatërrimi i Ebrehesë.

• *I gjashti:* Sipas dëshmisë së Halime Sa'dijes dhe të bashkëshortit të saj, kur i Dërguari i Nderuar a.s.m. ishte me ta në fëmijërinë e Tij, ata shpesh shikuan një re sipër Tij duke e mbrojtur nga dielli. Ata ia treguan këtë gjithkujt dhe kjo ngjarje është e mirënjohur dhe e vërtetuar.

• Gjithashtu, siç dëshmohet nga Murgu Bahira, kur Profeti i Nderuar a.s.m. shkoi në Damask në moshëm dymbëdhjetë vjeçare, ai pa një re duke lëshuar hije mbi kokën e Tij dhe ua tregoi këtë të tjerëve.

• Përsëri para misionit të Tij Profetik, një herë Profeti i Nderuar a.s.m.u kthye nga një udhëtim tregtar që bëri së bashku me shërbëtorin e Hatixhes, Mejsere. Kur Hatixheja, pa dy engjëj duke i bërë hije Profetit të Nderuar a.s.m. si re, ajo ia përmendi këtë shërbëtorit të saj Mejseres, dhe ndërkohë ai u përgjigj: "Unë pashë të njëjtën gjë gjatë udhëtimit tonë."

• *I shtati:* Vërtetohet në një rrëfenjë të shëndoshë se përpara misionit të Tij Profetik, Profeti i Nderuar a.s.m. u ul poshtë një peme. Megjithëse vendi ishte i thatë, ai papritmas u bë jeshil. Degët e pemës anuan mbi kokën e Tij duke u përdredhur prapa e duke i bërë Atij hije.

• *I teti:* Kur Profeti i Nderuar a.s.m. ishte i vogël, banonte në shtëpinë e Ebu Talibit. Ebu Talibi së bashku me familjen sa herë që hanin me Atë, ngopeshin, ndërsa kur Ai nuk ishte i pranishëm, ata nuk ngopeshin. Kjo ngjarje është e mirënjohur dhe e sigurt.

• Gjithashtu Umm Ajmen, e cila u kujdes dhe i shërbeu Profetit të Nderuar a.s.m. kur Ai ishte i vogël, tha: "*Profeti i Nderuar a.s.m. kurrë nuk u ankua që ishte i uritur apo i etur, as kur ishte i vogël e as kur u rrit."*

• *I nënti:* Është si e mirënjohur, ashtu edhe e sigurt se, jo si anëtarët e tjerë të fisit të saj, dhitë dhe devetë e mëndeshës së Tij Halime Sa'dijes, ishin shumë prodhuese e të bollshme.

• Gjithashtu edhe mizat nuk e sulmonin Atë, ato asnjëherë nuk ndalonin në rrobat e Tij apo mbi trupin e Tij të bekuar. Këtë e trashëgoi nga gjyshi i Tij edhe pasardhësi i Tij, Sej'jid Abd-el Kadir Gejlani, (iu shenjtëroftë shpirti), sepse mizat nuk binin as mbi të.

• *I dhjeti:* Pasi lindi Profeti i Nderuar a.s.m. dhe veçanërisht në natën e lindjes së Tij, ishte një shtim i madh në yjet që binin. Siç tregohet me prova vendimtare në Fjalën e Pesëmbëdhjetë, rënia e yjeve është një shenjë dhe një tregues duke bllokuar xhindet dhe shejtanët që të mos marrin lajme nga e padukshmja. Kështu, meqenëse Profeti i Nderuar a.s.m. ishte shfaqur në botë me shpalljen, ishte e domosdoshme të pengohej njohuria rreth së padukshmes që njoftohej nga falltarët, mediumet dhe nga xhindet, të cilat (ato njoftime) ishin të pasakta e të përziera me gënjeshtra; kështu njohuria e tyre të mos shkaktonte ndonjë dyshim rreth shpalljes, dhe të mos i ngjasonte asaj. Përpara misionit Profetik, e shtimja në fall ishte shumë e përhapur. Atëherë, kur u shpall Kur'ani, ua bllokoi atyre rrugën. Në të vërtetë, shumë falltarë e pranuan Islamin, sepse nuk mund t'i gjenin më informatorët e tyre të cilët ishin xhindet. Domethënë, Kur'ani u dha fund atyre. Kurse në këto ditë, një tip i ri i shtimjes në fall është shfaqur në formën e mediumeve midis spiritualistëve të Evropës. Megjithatë, ne nuk do të futemi në këtë çështje tani.

Shkurtazi: *Shumë ngjarje ndodhën dhe shumë individë u shfaqën duke vërtetuar e duke i bërë të tjerët të pohojnë profetësinë e të Dërguarit të Nderuar a.s.m. para fillimit të misionit të Tij. Sigurisht, para shfaqjes së Atij që do të ishte sundimtari i botës.*[220]

Që do të ndryshonte formën shpirtërore të botës, që do ta bënte këtë botë si tokë të kultivuar për botën tjetër, që do të shpallte vlerën e lartë të krijesave të botës, që do t'i tregonte njeriut dhe xhindit rrugën e lumturisë së përhershme, që do të zgjidhte gjëagjëzën e panjohur të botës, që t'i shpjegonte urtësinë në krijimin e saj, që do të dinte e të bënte të njohur qëllimet e Krijuesit të universit, që ta bënte njeriun të njohë e të pranojë Krijuesin. Para se të shfaqej një njeri i tillë, sigurisht çdo gjë, të gjitha speciet dhe botët e qënieve do të gëzoheshin për ardhjen e Tij dhe iu bë e njohur atyre nga Krijuesi i tyre; ato do ta prisnin Atë, do t'i uronin mirëseardhje dhe do ta brohorisnin, dhe në qoftë se ardhja e Tij iu bë e njohur atyre nga Krijuesi i tyre, ato me radhë do ta njoftonin atë, ashtu siç pamë në shenjat dhe në shembujt e lartëpërmendur, se si çdo botë e krijimit tregoi mrekullitë e Tij, sikur t'i uronin Atij mirëseardhje, dhe vërtetuan profetësinë e Tij përmes gjuhës së mrekullisë.

* * *

[220] [shënim]: Ai ishte *Sulltani i 'Leu lake Leu lake'* (për hir të të Cilit u tha: *'Po të mos ishe ti, Unë nuk do ta kisha krijuar gjithësinë').* Me të vërtetë Ai është një sundimtar i madh, sepse sundimi i Tij vazhdon që prej një mijë e treqind e pesëdhjetë vjetësh dhe Ai ka ndjekës në çdo shekull numri i të cilëve është mbi treqind e pesëdhjetë milion njerëz, ka marrë gjysmën e globit nën flamurin e Tij dhe ndjekësit e Tij ripërtërijnë në çdo ditë besëlidhjen me të duke i çuar salat e selam dhe duke iu nënshtruar plotësisht urdhërave të Tij (autori).

SHENJA E SHTATËMBËDHJETË

Pas Kur'anit, mrekullia më e madhe e Profetit të Nderuar a.s.m., ishte personaliteti i Tij, D.m.th., virtytet e larta morale të mishëruara në personin e Tij, për të cilin ranë dakord si miqtë ashtu edhe armiqtë, që në çdo aspekt ato ishin në nivelin më të lartë. Një hero i trimërisë më të madhe, Hazreti Aliu, vazhdimisht thonte: "Sa herë që luftimet bëheshin të rrepta, ne gjenim strehë pas Profetit të Nderuar a.s.m.." Ashtu si kjo, Ai kishte shkallën më të lartë e të paarritshme në të gjitha cilësitë e lavdërueshme. Për këtë mrekulli më të madhe, ne i referojmë lexuesit tek vepra "Shifa el-Sherif", e autorit të shquar të Magribit, Kadi Ijadit, sepse ai e përshkroi dhe e provoi për bukuri këtë mrekulli të cilësive të lavdërueshme morale.

Një mrekulli tjetër e madhe, e cila është vërtetuar nga miqtë e armiqtë njëlloj, është sheriati i Tij i shquar, ngjashmëria e të cilit as nuk ka ardhur përpara, as nuk do të vij pas Tij. Për një shpjegim të pjesshëm të Tij, ne i referojmë lexuesit tonë tek "Fjala e Tridhjetë e tretë"**, "**Letra e Tridhjetë e tretë", tek "Shkreptima e Tridhjet e njëtë", dhe tek "Rrezja e Trembëdhjetë", të cilat i kemi shkruar...

Midis mrekullive të mëdha të Profetit të Nderuar a.s.m., një mrekulli e sigurt, njoftimet e shumta të së cilës janë me unanimitet, është "*Çarja më dysh e Hënës"*. Kjo mrekulli tregohet nëpërmjet shumë zinxhirëve të transmetimit nga shumë sahabe kryesues si, Ibn Mes'udi, Ibn Ab'basi, Ibn Umer, Imam Aliu, Enesi dhe Hudhejfe. Përveç kësaj, Kur'ani ia njofton këtë mrekulli të lartë të gjithë botës me vërsetin Kur'anor: اِقْتَرَبَتِ السَّاعَةُ وَانْشَقَّ الْقَمَرُ *"Ora është afruar dhe hëna u ça më dysh"*[221]

Idhujtarët kryeneçë të Kurejshit në atë kohë nuk mund të mohonin çfarë deklaronte ky vërset: Ata vetëm mundën të deklaronin

[221] Kur'an, 54: 1

se ajo ishte "magji", domethënë edhe jobesimtarët e konfirmuan Çarjen më dysh të Hënës si të sigurt. Për këtë mrekulli të lartë, ne i referojmë lexuesit tek shtojca e "Fjalës së Tridhjetë e një".

Ashtu si Profeti i Nderuar a.s.m. që u tregoi banorëve të tokës mrekullinë e Çarjes së Hënës, gjithashtu Ai u tregoi banorëve të qiejve mrekullinë e Tij më të lartë të Mi'raxhit (ngjitjes së Profetit nëpër qiej). Duke ia referuar atë mrekulli supreme "Trajtesës së Mi'raxhit, Fjalës së Tridhjetë e njëtë", e cila demonstron me prova vendimtare, madje edhe për mohuesit, se sa e vërtetë e ndritshme dhe e lartë ishte ajo mrekulli, ne do të përmendim këtu vetëm udhëtimin e Tij për në Kuds (Jerusalem), pjesën paraprake të mrekullisë së Mi'raxhit, sepse ajo ishte gjithashtu një mrekulli që kur u pyet nga Kurejshët në mëngjesin e së nesërmes, Ai u dha atyre përshkrimin e *Xhamisë Aksa (Bejtul Makdis)* që ishte siç vijon:

Në mëngjesin pas natës së Mi'raxhit, Ai i njoftoi Kurejshët për Mi'raxhin. Ata e refuzuan atë si një gënjeshtër dhe thanë:

فَكَرَبْتُ كَرْبًا لَمْ أَكْرُبْ مِثْلَهُ قَطُّ فَجَلَّاهُ اللهُ لِي بَيْتَ الْمَقْدِسِ وَكَشَفَ الْحُجُبَ بَيْنِي وَبَيْنَهُ حَتَّى رَأَيْتُهُ فَنَعَتُّهُ وَأَنَا أَنْظُرُ إِلَيْهِ

"Në qoftë se Ti, me të vërtetë shkove në xhaminë Aksa në Kuds (Jerusalem), atëherë na i përshkruaj neve dyert e saj, muret dhe gjendjen e saj!" Profeti i Nderuar a.s.m. më vonë, tha: "Unë u mërzita aq shumë nga pyetja e tyre dhe nga mohimi saqë asnjëherë nuk isha shqetësuar ashtu më parë. Papritmas, All-llahu i Madhërishëm ngriti perden midis meje dhe *xhamisë Aksa* dhe ma tregoi atë mua. Unë hodha shikimin tek ajo, e pashë dhe i bëra përshkrimin". Atëherë Kurejshët kuptuan se Ai po jepte përshkrim të saktë e të plotë për Xhaminë El-Aksa.

• Profeti i Nderuar a.s.m., gjithashtu u tregoi Kurejshive se "Gjatë udhëtimit, unë pashë një nga karvanet tuaja. Ai do të arrijë këtu nesër në filan orë". Ata e pritën karvanin, mirëpo ai u vonua një orë. Me qëllim që parashikimi i Profetit të Nderuar a.s.m. të ishte i drejtë, dielli u bllokua një orë, siç konfirmohet nga ata që e hetuan ngjarjen.

Domethënë me qëllim që të provohej e vërtetë ajo që tha Ai, toka ndaloi udhëtimin e saj, detyrën e saj, për një orë, dhe ajo palëvizshmëri u tregua sikur dielli po bllokohej në lëvizjen e tij. *Kështu, toka e fuqishme braktisi detyrën e saj me qëllim që të konfirmonte një deklarim të vetëm të Profetit të Nderuar a.s.m. dhe dielli i fuqishëm e dëshmoi Atë.*

Kështu, ju mund të kuptoni se sa të mjerë janë ata që as nuk e pranojnë Atë, as nuk i binden urdhërave të Tij, dhe sa të lumtur janë ata që e pranojnë e thonë: سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا *"Ne e kemi dëgjuar dhe i jemi bindur!; prandaj thuaj:* اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ عَلَى الْإِيمَانِ وَالْإِسْلَامِ *"Lavdërime e falënderime qofshin për All-llahun, për Islamin dhe besimin!"*

* * *

SHENJA E TETËMBËDHJETË

Mrekullia më e madhe e të Dërguarit të Nderuar a.s.m., ajo mrekulli e përjetshme, është Kur'ani i gjithurtë, i cili përfshin qindra dëshmi të profetësisë së Tij dhe dyzet aspektet e mrekullisë së të Cilit janë provuar. "Fjala e njëzet e pestë" i ka provuar këto dyzet aspekte në afërsisht njëqind e pesëdhjetë faqe. Prandaj duke ia referuar atë mrekulli të lartë, atë thesar mrekullish, asaj Fjale, këtu ne do të shpjegojmë vetëm një ose dy pika.

■ **Pika e Parë:**

Në qoftë se thuhet: Mrekullia e Kur'anit qëndron në elokuencën e Tij. Mirëpo të gjitha klasat e njerëzve të drejtë kanë pjesë të kuptimit të Tij dhe, vetëm një studies i shquar midis mijërave mund ta kuptojë mrekullinë në elokuencën e Tij?

Përgjigjja: Kur'ani i Gjithurtë ka një lloj të ndryshëm mrekullie duke i korresponduar kuptimit të çdo klaseje; ai e tregon ekzistencën e mrekullisë së Tij për gjithësecilin në një mënyrë të ndryshme. Për shembull, për studiuesit e retorikës e të elokuencës, ai shfaq mrekullinë e elokuencës së Tij të jashtëzakonshme.

Për poetët e oratorët ai tregon stilin e Tij të lartë të bukur e origjinal, saqë askush nuk mund ta imitojë; ai kënaq gjithësecilin. Kalimi i kohës nuk i shkakton stilit të Tij të vjetërohet, por përkudrazi, ai gjithmonë mbetet i freskët e i ri. Proza e Tij dhe rendi i fjalëve janë aq të mirërenditura, saqë janë sa të larta, po aq edhe të këndshme.

Edhe për falltarët e për mediumet e tjerë të së padukshmes, ai shfaq mrekullinë e Tij në njoftimet e Tij të jashtëzakonshme lidhur me të padukshmen.

Për historianët ai demonstron mrekullitë e Tij duke dhënë informacione në lidhje me ngjarjet e epokave të kaluara si dhe për

ngjarjet e së ardhmes, të botës së ndërmjetme (Berzah, jetës në varr) dhe të Ahiretit me të vërtetat kozmike.

Për sociologët e për politikanët e shfaq mrekullinë e Tij duke treguar mrekullinë e parimeve të shenjta në Kur'an. Po, Sheriati që buroi nga Kur'ani e shfaq qartë dhe në mënyrë të plotë sekretin e asaj mrekullie.

Gjithashtu ai u tregon atyre që kanë depërtuar në dijen rreth Zotit xh.sh.. në të vërtetat kozmike, mrekullinë duke ua shfaqur të vërtetat e larta të shenjta, dhe i bën ata ta ndjejnë këtë mrekulli; ai tregon mrekullinë e të vërtetave të shenjta Hyjnore në Kur'an, ose ndryshe, ai tregon ekzistencën e asaj mrekullie.

Për sufitë e për shenjtorët, ai e tregon mrekullinë në misteret e fshehura të vërseteve të Tij, të cilat vazhdimisht ngrihen e bien si valët në detin e Kur'anit, e kështu me radhë. Për secilin nga dyzet klasat e njerëzimit, ai hap një dritare dhe e tregon mrekullinë e Tij.

Madje njerëzit e zakonshëm, të cilët vetëm e dëgjojnë recitimin e Kur'anit duke kapur pak prej kuptimit të Tij, pohojnë se Kur'ani nuk i ngjason ndonjë libri tjetër.

Njerëz të tillë thonë: "Kur'ani ose qëndron poshtë të gjithë librave të tjerë që kemi dëgjuar e lexuar, por për këtë gjë nuk mund të pretendojë as edhe një armik, ashtu siç është e pamundur, ose ai është superior mbi ato të gjithë dhe kështu është një mrekulli." Tani, me qëllim që ta ndihmojmë atë njeri të zakonshëm, ne do të shpjegojmë më tej mrekullinë të cilën njeriu i zakonshëm e kuptoi vetëm duke e dëgjuar. Ajo është siç vijon:

Kur Kur'ani i Mrekullueshëm Deklarues u shfaq duke sfiduar të gjithë botën, ai shkaktoi dy lloj ndjenjash të zjarrta në popull:

E Para: Tek miqtë ngjalli dëshirën për ta imituar, domethënë, dëshirën për t'i ngjasuar Kur'anit të dashur të tyre, dhe dëshirën për të folur si ai...

I Dyti: Tek armiqtë ngjalli dëshirën për ta kritikuar e kundërshtuar, domethënë, dëshirën për të shfaqur të pavlefshëm pretendimin e Tij të mrekullisë duke konkuruar me stilin e Tij...

Kështu, për shkak të këtyre dy ndjenjave të forta, miliona libra u shkruan në arabisht dhe duhet të shihen. Tani kushdo që dëgjon më elokuentin e më brilantin e këtyre librave duke u lexuar së bashku me Kur'anin, është i detyruar të thotë se Kur'ani nuk u ngjason ndonjërit prej tyre. Ajo do të thotë se Kur'ani nuk është i të njëjtit nivel me ta. Atëherë, ai duhet të jetë ose më i ulëti midis të gjithë atyre librave, por kjo është krejtësisht e pamundur, madje edhe shejtani nuk do të mund ta pretendonte këtë[222], ose Kur'ani i mrekullueshëm është më i larti i të gjithë atyre librave.

Për më tepër, Kur'ani i gjithurtë e demonstroi mrekullinë e Tij edhe para masave të paarsimuara të popullit, të cilët nuk e kapin kuptimin e Tij, duke mos i mërzitur ata. Në të vërtetë, ata thonë: "Sikur të dëgjonim edhe poemat më të holla e më të mirënjohura dy ose tri herë, ne do të mërziteshim prej tyre; ndërsa Kur'ani kurrë nuk na mërzit; madje, sa më shumë ta dëgjojmë atë, aq më shumë na kënaq. Atëherë ai nuk mund të jetë shkruar nga njeriu."

Dhe për fëmijët që përpiqen ta mësojnë atë përmendësh, Kur'ani i Gjithurtë e tregon mrekullinë duke u vendosur e ngulitur në memoriet e tyre me lehtësinë më të madhe, pavarësisht kokave të tyre të vogla, delikate, të dobëta e të thjeshta dhe, pavarësisht se shumë nga vërsetet dhe frazat e Atij Kur'ani të madh i ngjasojnë njëri - tjetrit dhe që mund të shkaktojnë ngatërresë, në një kohë që ata nuk mund të mësojnë as edhe një faqe të vetme tek librat e tjerë.

Madje edhe për të sëmurët dhe për ata që janë duke vdekur, të cilët shqetësohen edhe nga zhurma apo zëri më i vogël, tingulli i Kur'anit i bën ata të ndjejnë një lloj të mrekullisë së Tij duke qenë aq i ëmbël e i përshtatshëm për ta, si uji i Zemzemit.

---

[222] Hulumtimi i Parë i rëndësishëm i Letrës së Njëzet e gjashtë e sqaron këtë paragraf, (autori).

Shkurtazi: Kur'ani i Gjithurtë demonstron mrekullinë e Tij për dyzet klasat e ndryshme dhe grupet e njerëzve, ose ai i tregon ekzistencës mrekullinë e Tij në dyzet aspekte. Ai nuk neglizhon askënd për të shijuar mrekullinë e Tij. Edhe për ata që mund të kapin vetëm çfarë shikojnë sytë e tyre[223] dhe të cilët nuk kanë vesh për të dëgjuar, as zemër për të ndier, as njohuri për të gjykuar, Kur'ani i bën ata ta ndjejnë, në një mënyrë, mrekullinë e Tij. Kjo është siç vijon:

Në Kur'anin e shkruar me dorë nga bukurshkruesi Hafiz Osmani dhe që më vonë u shtyp, shumë prej fjalëve të Tij shikojnë njëra-tjetrën. Për shembull, në qoftë se një gjilpërë do të kalonte përmes fjalës *"kelb" "qen"* në frazën te وَكَلْبُهُمْ بَاسِطٌ ذِرَاعَيْهِ *"...Ata ishin shtatë, qeni duke qenë i teti..."* në suren (el-Kehf*)*[224]*,* dhe përmes faqes së nëntëshme, nën të, me një shmangie të vogël, ajo do të kalonte përmes fjalës قِطْمِيرٍ "kitmir" në suren *el-Fatir*, duke vërtetuar kështu emrin e qenit. Në një mënyrë të ngjashme, fjalët مُحْضَرُونَ "*Muhdarun", "Ata të gjithë do të sillen para nesh*" , duke qenë njëra mbi tjetrën, ndodh dy herë *në suren Jâ-sîn* dhe në *Saffat* مُحْضَرِينَ dhe مُحْضَرُونَ dhe ato shikojnë njëra-tjetrën; nëse do të shpohej njëra, do të shiheshin të tjerat me një shmangie të vogël. Për shembull, në fund të sures *Sebeë* dhe para sures *Fatir* dy مَثْنَىٰ *"Methna"* shikojnë njëra-tjetrën. Në Kur'an مَثْنَىٰ *"Methna"* përsëritet vetëm tre herë, dhe të shikuarit e njëra-tjetrës së dy fjalëve nuk mund të jetë kurrë rastësi. Ndodhen shumë shembuj të ngjashëm. Madje, një fjalë përkon, me shmangien më të vogël, në pesë ose gjashtë fletë nën të. Dhe unë

[223] Këtu, përmendja e aspektit të mrekullisë së Tij e drejtuar për ata pa veshë, pa zemër e pa njohuri dhe që shikojnë vetëm me sytë e tyre, është tej mase e përmbledhur, e shkurtuar e madje edhe e mangët. Por ajo është treguar shumë qartë e në mënyrë të shkëlqyeshme në "Letrat e Njëzet e nëntë" dhe të "Tridhjetë". Kështu edhe i verbëri mund ta shikojë atë. Ne e kemi shkruar një kopje të Kur'anit që tregon këtë aspekt të mrekullisë, e cila, në dashtë Zoti, do të botohet. Atëherë gjithkush do ta shihte atë.

* "Letra e Tridhjetë" ishte planifikuar e synuar, por ajo e braktisi vendin e saj tek "Shenjat e mrekullisë", ndërsa vetë, asnjëherë nuk u materializua.

[224] Kur'an, 18: 22

kam parë një kopje të Kur'anit në të cilën pjesët e Kur'anit duke shikuar njëra-tjetrën tek faqet përballë ishin shkruar me ngjyrë të kuqe. Në atë kohë unë thashë: "Ajo gjithashtu, tregoi një lloj tjetër mrekullie". Disa kohë më vonë unë pashë se shumë fraza i shikonin të tjerat nga ana e pasme (ose nga e kundërta) e faqeve duke i korresponduar njëra-tjetrës në një mënyrë domethënëse. Kështu, meqenëse renditja e Kur'anit dhe të shkruarit e dorëshkrimit të kopjeve të shtypura të Kur'anit gjithashtu është nëpërmjet udhëzimit të Profetit dhe inspirimit Hyjnor, ai përmban shenjën e një lloji mrekullie, sepse ajo nuk është as vepër e rastësisë dhe as e mendjes njerëzore. Disa herë ndodhen shmangie, por ajo është përgjithësisht gabimi i shtypit, sepse po të kishte qenë shtypi plotësisht në rregull, fjalët do t'u kishin korresponduar njëra-tjetrës ekzaktësisht.

Për më tepër, në çdo faqe të sureve të Kur'anit,të gjata ose me gjatësi mesatare, që u shpallën në Medine, fjala "All-llah" është përsëritur në mënyrën më të mrekullueshme.

Përveç qënies e përsëritur tek e shumta, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë ose njëmbëdhjetë herë tek e njëjta faqe, përsëritjet e dy anëve të së njëjtës faqe ose në faqet përballë njëra-tjetrës, shfaqin lidhje numerike të bukura e domethënëse.[225_226_227_228]

[225]Gjithashtu, për ata që e praktikonin recitimin e Emrave Hyjnorë, lëvdatat dhe lutjen ndaj Zotit të Madhëruar, fjalët e zbukuruara e të rimuara, stili elokuent e artistik dhe shumë veçori të elokuencës së Kur'anit, të cilat të tërheqin vëmendjen, japin një seriozitet të lartë dhe një sens të prezencës Hyjnore dhe një mbledhje të mendjes; ato nuk i prishin këto, në një kohë që përpilimi retorik e artistik, rima dhe kompozimi poetik i atij lloji zakonisht e dobëson seriozitetin, e bën hijeshinë e vet të ndjeshme, turbullon sensin e prezencës Hyjnore dhe tërheq vëmendjen. Në fakt, unë shpesh recitoja lutjen e mirënjohur të Imam Shafiut, e cila është më e holla dhe më seriozja e lutjeve, që është kompozuar në formën më të lartë e të vargëzuar dhe, njëherë ajo ishte shkak për t'i dhënë fund krizës dhe zisë në Egjipt. Duke e lexuar atë, vështrova se, meqenëse ishte në varg dhe e rimuar, ajo turbulloi seriozitetin e lartë të lutjes. Unë e recitoja atë vazhdimisht për tetë apo nëntë vite dhe isha i pamundur të pajtoja vargun dhe rimën me natyrën serioze të saj. Unë kuptova nga kjo se ndodhet një lloj mrekullie në rimimin, përpilimin dhe në cilësitë e fjalëve të Kur'anit të cilat janë të veçanta, natyrale dhe origjinale për të, i cili ruan krejtësisht seriozitetin dhe ndijimin e Prezencës Hyjnore, dhe jo prishjen e tyre. Kështu, madje ata të cilët recitojnë lutjet, Emrat Hyjnorë dhe lavdërimet edhe në qoftë se nuk e kuptojnë këtë lloj mrekullie me mendje, e kapin atë me zemër.

[226] Një aspekt tjetër i mrekullisë së Kur'anit të mahnitshëm është se ai shpreh shkallën më të lartë e brilante të besimit të Profetit të Nderuar a.s.m., i cili shfaqi Emrin më të madh Hyjnor. Ai gjithashtu shpreh e instrukton në një mënyrë natyrale fenë e së vërtetës, e cila duke qenë më e larta, më e gjëra dhe më e shndritshmja, shtjellon të vërtetat e larta, të botërave të ahiretit dhe të Hyjnisë, si një hartë e shenjtë.

Ai përcjell me të gjithë lavdinë dhe madhështinë e Tij të pafund adresimin e Krijuesit të universit, në lidhje me qënien e Tij, Zhvilluesi i të gjitha botërave. Sigurisht, në faqen e komentimit të Kur'anit i cili është kështu, në qoftë se sipas vërsetit :

قُلْ لَئِنِ اجْتَمَعَتِ الْاِنْسُ وَالْجِنُّ عَلٰٓى اَنْ يَّاْتُوْا بِمِثْلِ هٰذَا الْقُرْاٰنِ لَا يَاْتُوْنَ بِمِثْلِهٖ

" Thuaj: Nëse njerëzimi dhe xhindet do të mblidheshin të gjithë bashkë të nxirrnin ngjasimin e këtij Kur'ani, ata nuk do ta bënin dot përngjasimin e tij, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin," sikur të gjitha mendjet e njerëzimit të bashkoheshin e të bëheshin një mendje e vetme, ato nuk mund ta kundërshtonin apo ta kontestonin atë. Si të mundeshin? Ata janë aq shumë larg nga Kur'ani, aq sa largësia e tokës prej plejadave اَيْنَ الثَّرٰى مِنَ الثُّرَيَّا, sepse në pikëpamjen e parimeve të lartëpërmendura, sigurisht është e pamundur të imitohet Kur'ani dhe as të përpilohet si shembulli i tij.

[227] Në fund të çdo faqeje të Kur'anit të Gjithurtë, vërsetet janë të plota dhe mbarojnë me rimim në mënyrë të hollë. Arsyeja është kjo: Kur vërseti i quajtur Mudajene (2: 292) sjell standartin për faqet dhe, suret Ihlas dhe Keuther, standartin për reshtat, kjo cilësi e hollë e Kur'anit të Gjithurtë dhe shenja e mrekullisë së Tij bëhen të dukshme.

[228] Për shkak se isha i detyruar të shpejtoja në shkrim, ne do të mjaftohemi në këtë pjesë me disa tregues tej mase të vegjël dhe me shumë shembuj të shkurtër e shenja të vogla të një rëndësie të lartë e të një kerameti të madh , një gjë e tillë nga pikëpamja e suksesit të Risale-i Nurit është e bukur që ndriçon dhe inkurajon.

Tani ajo e vërtetë e rëndësishme dhe ai keramet inkurajues nën emrin e koinçidencës "tevaafuk", dhe të pesë ose gjashtë llojeve të saj formon një zinxhir kerametesh të Risale-i Nurit, shkreptimat e një lloji të dukshëm të mrekullisë së Kur'anit dhe një burim shenjash për shifrat e së padukshmes. Pastaj, ne kishim një kopje të shkruar të Kur'anit e cila tregoi në shkronja të praruara një shkreptimë të mrekullisë së Tij e cila u shfaq për "koinçidencën" e fjalës "All-llah". Dhe u shkruan tetë pjesë të vogla të quajtura tetë simbolet (Rumuzat Themanijeh) të cilët shpjegojnë lidhjet e dukshme të holla në koinçidencën e shkronjave të Kur'anit dhe aluzionet e tyre në lidhje me të padukshmen.

Gjithashtu u shkruan Pesë Trajtesa, njëra rreth Kerameteve të Gauth el-Gejlani, tre rreth atyre të Aliut dhe një të quajtur Treguesit e Kur'anit të cilët nëpërmjet koinçidencës ose "Tevaffuk", konfirmojnë, miratojnë, lavdërojnë e brohorasin Risale-i Nurin. Domethënë, ajo e vërtetë e rëndësishme u perceptua dhe u shkrua në mënyrë të përmbledhur në të shkruarit e Mrekullive të Muhammedit a.s.m., por për

■ Pika e Dytë

Në kohën e Hazreti Musait a.s. ishte magjia ajo që mbisundonte, kështu mrekullitë më të rëndësishme i ngjasonin asaj. Në kohën e Hazreti Isait (Jezusit) a.s. ishte mjekësia ajo që mbisundonte dhe shumica e mrekullive ishin kryesisht të atij lloji. E ngjashme me këtë, në kohën e Profetit Muhammed a.s.m., në gadishullin Arabik, katër gjëra ishin mbisunduese:

E Para: Elokuenca dhe retorika.

E Dyta: Poezia dhe oratoria.

E Treta: E shtimja fall dhe njoftimet për të padukshmen.

E Katërta: Njohja e ngjarjeve të kaluara dhe kozmologjia.

Kështu, kur u shfaq Kur'ani i Mrekullueshëm Deklarues, ai i sfidoi ato me njohurinë e katër fushave:

Së pari, ai i bëri njerëzit e retorikës e të elokuencës të përkulen para Tij; ata të gjithë e dëgjuan Kur'anin me habi.

Së dyti, ai çuditi poetët e oratorët, domethënë, ata që flisnin mirë e që recitonin poezi të holla i mahniti në një mënyrë të tillë, saqë kafshuan gishtërinjtë e tyre nga habia. Ai i zhvlerësoi krejtësisht vlerën e poemave të tyre më të holla që qenë të shkruara me ar dhe u shkaktoi t'i hiqnin nga muret e Qabes "Shtatë poemat e varura", "el-Mual-leka es-Seb'a", të cilat ishin krenaria dhe lavdia e tyre.

Ai i bëri të heshtnin falltarët dhe magjistarët të cilët dhanë lajmet nga e padukshmja, dhe i bëri ata të harronin njohuritë që kishin marrë. Ai dëboi xhindet e tyre dhe i dha fund të shtimes fall.

---

fat të keq autori e shikoi dhe përshkroi vetëm pjesë të vogla të tij; ai vazhdoi pa e ndjekur atë më tej.

Ai i shpëtoi lexuesit e historisë së popujve të mëparshëm e të kozmologjisë nga bestytnia e gënjeshtra dhe u mësoi atyre faktet e vërteta dhe njohjen ndriçuese.

Kështu, këto katër grupe u përkulën para Kur'anit me çudinë e nderimin më të madh duke u bërë studentët e Tij. Dhe asnjëherë nuk ka mundur askush të përpiqet ta kundërshtojë atë as edhe në një sure të vetme.

Në qoftë se thuhet: Si ta dimë ne që askush nuk ka qenë në gjendje ta kundërshtojë atë, nuk ka mundur të sjellë si shembulli i Kur'anit dhe se përngjasimi i Tij është një çështje e pamundur?

Përgjigjja: Po të kishte qenë e mundur të kundërshtohej, sigurisht dikush do të kishte qenë përpjekur për të, sepse për ta kundërshtuar kishin nevojë të madhe, pasi feja e tyre, pasuritë e tyre dhe familjet e tyre ishin vënë në rrezik. Në qoftë se ata do ta kishin kundërshtuar, do të kishin shpëtuar. Po të kishte qenë i mundur kundërshtimi, ata do ta bënin atë. Dhe po të kishin bërë kështu, meqë përkrahësit, jobesimtarët dhe hipokritët ishin shumë, me të vërtetë shumë, ata me siguri do ta kishin mbështetur një kundërshtim të tillë dhe do ta kishin shpallur gjërësisht, ashtu siç shpallën gjithçka që ishte kundër Islamit. Dhe në qoftë se dikush do ta kishte kundërshtuar Kur'anin dhe ata ta kishin bërë të njohur tek gjithësecili, ajo sigurisht do të kishte qenë regjistruar në librat e historisë me terma vezulluese. Por të gjitha historitë dhe librat janë përpara nesh; përveç ca pjesëve rreth Musejleme Gënjeshtarit, nuk ndodhet asgjë tjetër në asnjërin nga ato. Ndërsa për njëzet e tre vjet, Kur'ani i Gjithurtë, në mënyrë të vazhdueshme, i ka tallur e i sfidoi ata në një mënyrë që do të shtonte kokëfortësinë e tyre. Ai në të vërtetë tha:

"Le të hartojë ndonjë analfabet si Muhammedi, i Besuari, si shembulli i Kur'anit.

Por ju nuk mund ta bëni këtë; atëherë vazhdoni me dikë shumë të ditur e letrar.

Ju as me këtë person nuk mund ta bëni një gjë të tillë. Atëherë më mirë se një njeri të vetëm, grumbulloni së bashku të gjithë shkollarët tuaj dhe burrat e elokuencës dhe le t'i ndihmojnë ata njëri-tjetrit, madje edhe zotrat e rremë, tek të cilët ju besoni, le të japin ndihmë.

Por ju edhe këtë nuk mund ta bëni. Atëherë përdorni veprat letrare të së shkuarës dhe u kërkoni ndihmë atyre për ta kundërshtuar, madje për këtë u bëni thirrje edhe brezave të ardhshëm dhe hartojeni të njëjtën e Kur'anit.

Në qoftë se akoma nuk mundeni, atëherë, jo të hartoni si gjithë Kur'ani, por vetëm dhjetë sure si të Tij;

Në qoftë se edhe kështu nuk mundeni, le të jetë renditja e fjalëve dhe e elokuencës si ato të Kur'anit edhe sikur me histori e tregime të imagjinuara;

Po qe se nuk mundeni ta bëni këtë; atëherë bëni përngjasimin e vetëm të një sureje të vetme;

Sureja të mos jetë e gjatë; bëjeni të ngjashmen e një sureje të shkurtër.

Dhe në rast se nuk mund ta bëni as këtë, atëherë feja juaj, jetët, pasuria dhe familjet tuaja do të jenë në rrezik si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën!"

Kështu, me këto tetë alternativa, Kur'ani i gjithurtë i ka sfiduar e i ka bërë të heshtin njerëzit dhe xhindet, jo për njëzet e tre vjet, por për një mijë e treqind vjet. Madje do të vazhdojë ta sfidojë botën e do të mbetet kështu deri në fundin e botës. Për këto arsye, në qoftë se kundërshtimi do të kishte qenë i mundur, ata jobesimtarë nuk do të kishin zgjedhur rrugën e luftës e të shkatërrimit e të vinin jetët e tyre, pasuritë dhe familjet e tyre në rrezik. Domethënë, për të kundërshtuar ishte e pamundur.

Dhe kështu, a do të mundej ndonjë person inteligjent, veçanërisht njerëzit e gadishullit Arabik në atë kohë, e sidomos Kurejshitët të cilët ishin shumë të zgjuar, të zbulonin veten e tyre, pasurinë dhe familjet e

tyre para rrezikut, e të zgjidhnin rrugën e luftës e të shkatërrimit po të kishin mundur nëpërmjet një letrari të tyre të ndiqnin rrugën e kundërshtimit edhe me një sure Kur'ani, që të shpëtonin kështu vetveten e pasurinë nga sfida e Kur'anit, në qoftë se të përpiluarit e një shembulli si Kur'ani do të kishte qenë i mundur?

Shkurtazi: Ashtu siç tha Xhahidhi i Famshëm: *"Kundërshtimi me fjalë ishte i pamundur, kështu ata u detyruan ta luftonin me shpatë."*

Në qoftë se thuhet: Disa dijetarë të shquar thanë: "Nuk është i mundur jo vetëm kundërshtimi i asnjë vërseti Kur'anor, i asnjë fjalie të Tij dhe i asnjë fjale, atëherë si është i mundur kundërshtimi i një sureje? Askush nuk ka dalë në fushën e kundërshtimit. Atëherë askush nuk e ka kundërshtuar Kur'anin". Por, kjo duket të jetë e ekzagjeruar dhe arsyeja nuk mund ta pranojë atë, sepse shumë nga fjalët e njerëzve u ngjasojnë atyre të Kur'anit. Cila është urtësia për këtë thënie të tyre?

Përgjigjja: Ka dy shkolla mendimi që lidhen me mrekullinë e Kur'anit:

Shkolla dominante dhe e preferuar pohon se cilësitë e holla të elokuencës dhe të kuptimeve të Kur'anit janë përtej fuqisë njerëzore.

Shkolla e dytë pohon se është brenda aftësisë njerëzore të kundërshtosh një nga suret e Kur'anit, por All-llahu i Madhëruar e ka ndaluar këtë si një mrekulli të Muhammedit a.s.m.. Ashtu si një njeri që mund të ngrihet në këmbët e tij, por në qoftë se një Profet i thotë atij se ai nuk do të mundej të ngrihej duke shfaqur mrekulli, dhe personi nuk mundi të ngrihej, atëherë ajo është mrekulli. Ky opinion i pranueshëm quhet "Shkolla e Sarfas". Domethënë, All-llahu i Gjithëfuqshëm i ndaloi xhindet dhe njerëzit për të kundërshtuar me sukses madje edhe një sure të vetme të Kur'anit. Ndërsa, sipas kësaj shkolle, dijetarët që deklarojnë se "asnjë fjalë e vetme e Kur'anit nuk mund të kundërshtohet", në mënyrë të padiskutueshme, është fjalë e drejtë, sepse, meqenëse për shkak të mrekullisë së Tij, All-llahu i Gjithëfuqishëm i ndaloi ato, duke shfaqur mrekullinë, kështu ata as nuk mund t'i hapin gojët e tyre për ta kundërshtuar. Edhe në qoftë se

do të kishin dashur të thonin ndonjë gjë për ta kundërshtuar, ata nuk do të mundeshin ta shqiptonin atë fjalë pa dëshirën e Zotit të Madhëruar.

Megjithatë, sipas shkollës dominante e të preferuar të mendimit, ajo deklaratë e dijetarëve ka aspektin e hollë vijues: Frazat e Kur'anit gjithurtësi dhe fjalët e Tij shikojnë njëra-tjetrën. Ajo ndonjëherë ndodh se një fjalë e vetme shikon dhjetë vende. Në të janë dhjetë lidhje dhe dhjetë pika të holla elokuence. Ne i kemi treguar shembujt e disave prej këtyre në komentin e quajtur *Isharatul Ixhaz,* "Shenjat e mrekullisë", në frazat e sures *El-Fatiha* dhe në fillim të sures *El-Bekareh.*

الٓمٓ ۝ ذَٰلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ

"Elif, Lam, Mim. Ky është libri, në të është udhëzimi i sigurt, s'ka dyshim në të."

Për shembull: Merr një pallat të madh e të zbukuruar. Për të vendosur, në lidhje me të gjitha zbukurimet, një gurë i cili është si pika qëndrore e shumë dekorimeve të ndryshme, kërkohet njohja e plotë për të gjitha ato dekorime dhe për ato zbukurime që mbushin muret e pallatit; dhe të vendosësh një bebe syri në kokën e njeriut, varet nga njohja e lidhjeve të Tij me të gjithë trupin dhe me të gjitha funksionet e mrekullueshme të trupit, së bashku me pozicionin e syrit përpara atyre detyrave. Në të njëjtën mënyrë, më të avancuarit e njerëzve të së vërtetës kanë demonstruar lidhje të shumta në fjalët e Kur'anit dhe në aspektet dhe lidhjet e tyre me vërsetet e me frazat e tjera. Dijetarët e shkollës së *hurufit* (shkronjave), në mënyrë të veçantë, kanë shkuar më tej duke u shpjeguar e demonstruar ndjekësve të tyre një faqe nga kuptimet e fshehta të një shkronje të vetme prej shkronjave të Kur'anit.

Për më tepër, meqenëse Kur'ani është fjala e Krijuesit të të gjitha gjërave, secila nga fjalët e Tij mund të jetë si zemra ose fara. (Domethënë, si një zemër që mishërohen rreth saj kuptimet e misteret, ose si fara e një peme jolëndore).

Kështu, fjalët si ato të Kur'anit, madje edhe frazat ose vërsetet mund të ndodhin në fjalën e njeriut, por një njohuri gjithëpërfshirëse është e domosdoshme që t'i vendosë ato ekzaktësisht ashtu siç janë ato në Kur'an duke marrë në konsideratë lidhjet e shumta.

■ **Pika e Tretë:**

Një refklektim i shkurtër, por i vërtetë mbi natyrën esenciale të Kur'anit të Mrekullueshëm Deklarues, u inspirua njëherë në zemrën time si një mirësi Hyjnore. Tani, unë do të jap poshtë një përkthim të asaj pjese në gjuhën arabe dhe më pas do të japim sqarim:

سُبْحَانَ مَنْ شَهِدَ عَلَىٰ وَحْدَانِيَّتِهِ وَصَرَّحَ بِأَوْصَافِ جَمَالِهِ وَجَلَالِهِ وَكَمَالِهِ
اَلْقُرْآنُ الْحَكِيمُ الْمُنَوَّرُ جَبْهَتُهُ السِّتَّةُ الْحَاوِي لِسِرِّ إِجْمَاعِ كُلِّ كُتُبِ الْأَنْبِيَاءِ
وَالْأَوْلِيَاءِ وَالْمُوَحِّدِينَ الْمُخْتَلِفِينَ فِي الْأَعْصَارِ وَالْمَشَارِبِ وَالْمَسَالِكِ
الْمُتَّفِقِينَ بِقُلُوبِهِمْ وَعُقُولِهِمْ عَلَىٰ تَصْدِيقِ أَسَاسَاتِ الْقُرْآنِ وَكُلِّيَّاتِ أَحْكَامِهِ
عَلَىٰ وَجْهِ الْإِجْمَالِ وَهُوَ مَحْضُ الْوَحْيِ بِإِجْمَاعِ الْمُنْزِلِ وَالْمُنْزَلِ وَالْمُنْزَلِ عَلَيْهِ
وَعَيْنُ الْهِدَايَةِ بِالْبَدَاهَةِ وَمَعْدَنُ أَنْوَارِ الْإِيمَانِ بِالضَّرُورَةِ وَمَجْمَعُ الْحَقَائِقِ بِالْيَقِينِ
وَمُوصِلٌ إِلَى السَّعَادَةِ بِالْعِيَانِ وَذُو الْآثَارِ الْكَامِلِينَ بِالْمُشَاهَدَةِ وَمَقْبُولٌ
الْمَلَكِ وَالْإِنْسِ وَالْجَانِّ بِالْحَدْسِ الصَّادِقِ مِنْ تَفَارِيقِ الْأَمَارَاتِ وَالْمُؤَيَّدُ بِالدَّلَائِلِ

الْعَقْلِيَّةِ بِاتِّفَاقِ الْعُقَلَاءِ الْكَامِلِينَ وَالْمُصَدَّقِ مِنْ جِهَةِ الْفِطْرَةِ السَّلِيمَةِ بِشَهَادَةِ
اطْمِئْنَانِ الْوِجْدَانِ وَالْمُعْجِزَةُ الْأَبَدِيَّةُ الْبَاقِي وَجْهُ إِعْجَازِهِ عَلَى مَرِّ الزَّمَانِ بِالْمُشَاهَدَةِ
وَالْمُنْبَسِطُ دَائِرَةُ إِرْشَادِهِ مِنَ الْمَلَأِ الْأَعْلَى إِلَى مَكْتَبِ الصِّبْيَانِ يَسْتَفِيدُ مِنْ عَيْنِ دَرْسٍ
الْمَلَائِكَةُ مَعَ الصَّبِيِّينَ. وَكَذَا هُوَ ذُو الْبَصَرِ الْمُطْلَقِ يَرَى الْأَشْيَاءَ بِكَمَالِ الْوُضُوحِ
وَالظُّهُورِ وَيُحِيطُ بِهَا وَيُقَلِّبُ الْعَالَمَ فِي يَدِهِ وَيُعَرِّفُهُ لَنَا كَمَا يُقَلِّبُ صَانِعُ السَّاعَةِ
السَّاعَةَ فِي كَفِّهِ وَيُعَرِّفُهَا لِلنَّاسِ فَهٰذَا الْقُرْآنُ الْعَظِيمُ الشَّأْنِ هُوَ الَّذِي يَقُولُ مُكَرَّرًا
اَللّٰهُ لَآ اِلٰهَ اِلَّا هُوَ: فَاعْلَمْ اَنَّهُ لَآ اِلٰهَ اِلَّا اللّٰهُ

Ja kuptimet e këtyre mendimeve që u shprehën në Arabisht:

Të gjashtë aspektet e Kur'anit të Mrekullueshëm janë brilantë e vezullues; As dyshimi e as mosbesimi nuk mund të depërtojnë në të, sepse shpina e Tij mbështetet tek Froni i All-llahut të Madhërishëm; Ndodhet një dritë e shpalljes në atë aspekt. Përpara Tij është qëllimi i Tij dhe lumturia e të dy botëve; Ai ka vendosur dorën e Tij në paspërjetësinë dhe ahiretin, dhe ka xhennetin dhe dritën e lumturisë. Sipër Tij shkëlqen vula e mrekullisë. Poshtë Tij qëndrojnë shtyllat e provës e të dëshmisë. Fytyra e Tij e brendshme është thjesht udhëzim, ndërsa ana e djathtë e Tij i shkakton mendjes ta vërtetojë atë me frazat si: أَفَلَا يَعْقِلُونَ *"A nuk mendojnë ata", Duke u siguruar ushqim shpirtëror zemrave; ana e majtë e Tij i shkakton ndërgjegjjes të dëshmojë bekimet e All-llahut të Madhërishëm. Kështu, nga cilado anë e nga cilido qosh, a munden piratët e dyshimit e të mosbesimit të hyjnë tek Kur'ani i Mrekullueshëm Deklarues?*

Po, Kur'ani i Mrekullueshëm Deklarues përmban kuptimin e Konsensusit të librave të profetëve, të Evlijave dhe të atyre që e vërtetojnë Njësinë Hyjnore, që shekujt e të cilëve, mënyrat dhe temperamentet ishin të gjitha të ndryshme. Domethënë, ata që e kërkuan të vërtetën nëpërmjet mendjes ose zemrës kanë përmendur në librat e tyre urdhërat dhe parimet e përmbledhura të Kur'anit të gjithurtë, në një mënyrë të tillë si t'i vërtetonin ato, kështu ata janë si rrënjët e pemës qiellore të Kur'anit.

Kur'ani i gjithurtë gjithashtu mbështetet në shpallje dhe është shpallje, sepse i Gjithëlavdishmi i Vetëm, i Cili e shpalli atë, demonstroi e provoi se ai ishte shpallje përmes mrekullive të Profetit Muhammed a.s.m.. Dhe Kur'ani i cili gjithashtu zbulon e tregon përmes mrekullisë së Tij se Ai vjen nga Froni Hyjnor. Kushtrimi i Profetit të Nderuar a.s.m., mbi të cilin Ai u zbulua, kur Ai u shpall në fillim dhe gjendja e Tij i pavetëdijshëm gjatë shpalljes së Tij, sinqeriteti i Tij dhe nderimi ndaj Kur'anit të cilat ishin më të mëdha se e çdokujt tjetër, të gjitha demonstrojnë se Kur'ani ishte shpallje që vinte nga parapërjetësia; Ai vinte tek Pejgamberi si mysafir nga Sulltani i Amshuar. Për më tepër, Kur'ani është, në mënyrë të vetëkuptueshme, thjesht udhëzim i pastër, sepse, në mënyrë të dukshme, e kundërta e tij është çudhëzimi i mosbesimit. Ai është gjithashtu, domosdoshmërisht, burimi i dritave të besimit, dhe e kundërta e kësaj, natyrisht është errësirë. Ne e kemi provuar këtë në mënyrë vendimtare në shumë nga "Fjalët".

Për më tepër, Kur'ani, sigurisht është një grumbullim vërtetësish. Iluzioni dhe bestytnia nuk mund të hyjnë në të. Përsosmëritë e larta që formuan Botën e Islamit të cilës ai i dha formë, dhe sheriatin të cilin ai shfaqi, dëshmojnë e provojnë se ai është thjesht e vërteta e pastër dhe nuk përmban kontradikta. Diskutimet e Tij në lidhje me botën e së padukshmes e dëshmojnë këtë gjithashtu, ashtu si ato që lidhen me botën e dukshme.

Pa dyshim, Kur'ani gjithashtu çon për tek lumturia e të dyja botëve dhe e nxit njeriun për tek ajo. Në qoftë se ndonjë e dyshon këtë, le të lexojë Kur'anin njëherë dhe le t'i kushtojë vëmendje çfarë thotë ai. Për më tepër, frutat që prodhon Kur'ani janë të plota e të gjalla. Në çdo rast, rrënjët e pemës së Kur'anit futen e shkrihen në realitetin dhe janë të gjalla. Sepse jeta e frutit tregon jetën e pemës. Shiko sa fruta të përkryera, të gjalla e të shndritshme ka prodhuar ai në çdo shekull si Evlijatë dhe dijetarët e pastër!

Gjithashtu, me një bindje që buron nga shenjat e shumta e të ndryshme, mund të thuhet se Kur'ani pranohet e kërkohet nga

njerëzit, xhindet dhe engjëjt, sepse kur ai recitohet, ata grumbullohen rreth Tij si fluturat rreth dritës.

Pastaj së bashku me qënien e Tij si shpallje Hyjnore, Kur'ani është fuqizuar e përforcuar me prova racionale; unanimiteti i të urtëve e i mendjemprehtëve e dëshmon këtë. Dijetarët e mëdhenj të teologjisë dhe gjenitë e filozofisë si Ibn Sina dhe Ibn Rushd, demonstruan me unanimitet parimet Kur'anore, në përputhje me metodat e provat e tyre.


Kur'ani gjithashtu vërtetohet nga të gjithë natyrat e shëndosha. Meqenëse nuk është aspak i ndryshuar e i korruptuar, natyra njerëzore e konfirmon atë, sepse një ndërgjegje e qetësuar dhe qetësia e zemrës gjenden me anë të dritave të Tij. Domethënë, natyra e paprishur njerëzore e pohon atë përmes dëshmisë së ndërgjegjjes së qetë dhe thotë për Kur'anin nëpërmjet gjuhës së gjendjes: *"Natyrat tona nuk mund të plotësohen pa ty."* Ne e kemi provuar këtë të vërtetë në shumë vende.

Kur'ani gjithashtu duket, në mënyrë të vetëkuptueshme, një mrekulli e përhershme dhe e përjetshme; ai gjithmonë tregon mrekullinë e Tij. Ai kurrë nuk shuhet si mrekullitë e tjera, koha e Tij kurrë nuk mbaron, përkundrazi koha e Tij shtrihet gjer në përjetësi.

Për më tepër, ndodhet një gjërësi e tillë në udhëzimin e Kur'anit saqë si engjëlli Hazreti Xhebrail (a.s), ashtu edhe një fëmijë i ri mund ta dëgjojnë të njëjtin mësim, krah për krah, dhe të dy marrin pjesën e tyre. Dhe një filozof brilant si Ibn Sina mund të studiojë të njëjtin prej leksioneve të tij krah për krah me një recitues të zakonshëm, dhe ata të dy marrin mësimin e tyre. Madje mund të ndodhë se për shkak të fuqisë dhe pastërtisë së besimit të tij, njeriu i zakonshëm mund të përfitojë më shumë se Ibn Sina.

Gjithashtu, ndodhet në Kur'an një sy i tillë që shikon e rrethon të gjithë universin dhe e mban atë përpara Tij si faqet e një libri, duke përshkruar nivelet dhe botët e tij. Ashtu si një orëbërës, i cili e kthen, e hap, tregon dhe përshkruan orën e tij, po kështu bën Kur'ani, sikur të mbante universin në dorën e Tij. Kështu ai është një Kur'an i tillë i

kalibrit më të fuqishëm që deklaron: فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلٰهَ إِلَّا اللّٰهُ *"Mëso se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut dhe shpalle Njësinë Hyjnore".*


اَللّٰهُمَّ اجْعَلِ الْقُرْاٰنَ لَنَا فِي الدُّنْيَا قَرِيْنًا وَفِي الْقَبْرِ مُؤْنِسًا وَفِي الْقِيٰمَةِ شَفِيْعًا
وَعَلَى الصِّرَاطِ نُوْرًا وَمِنَ النَّارِ سِتْرًا وَحِجَابًا وَفِي الْجَنَّةِ رَفِيْقًا وَاِلَى
الْخَيْرَاتِ كُلِّهَا دَلِيْلًا وَاِمَامًا ۞ اَللّٰهُمَّ نَوِّرْ قُلُوْبَنَا وَقُبُوْرَنَا بِنُوْرِ
الْاِيْمَانِ وَالْقُرْاٰنِ وَنَوِّرْ بُرْهَانَ الْقُرْاٰنِ بِحَقِّ وَبِحُرْمَةِ مَنْ اُنْزِلَ
عَلَيْهِ الْقُرْاٰنُ عَلَيْهِ وَعَلٰى اٰلِهِ الصَّلٰوةُ وَالسَّلَامُ مِنَ الرَّحْمٰنِ الْحَنَّانِ اٰمِيْنَ

O Zot! Bëje Kur'anin shoqëruesin tonë në këtë botë, një mik për ne në varr, tek ringjallja një ndërmjetës, në urën e Siratit një dritë, nga zjarri një mbrojtës e perde dhe në Xhennet një udhëzues. O Zot! Ndriçoji zemrat tona dhe varret tona me dritën e besimit e të Kur'anit për hir të, e në nderim të të cilit Kur'ani u zbulua, dhe jepi bekime e paqe Atij, familjes së Tij nga i Gjithëmëshirshmi, Zemërgjëri, Amin!

* * *

SHENJA E NËNTËMBËDHJETË

Është provuar në shenjat e mëparshme, në mënyrën më vendimtare e të padiskutueshme se Profeti i Nderuar a.s.m. ishte i Dërguari i All-llahut të Gjithëfuqishëm. Profetësia e Tij duke u vërtetuar kështu nëpërmjet mijëra dëshmive të sigurta, Muhammedi Arab a.s.m. ishte prova më brilante e përfundimtare e Njësisë Hyjnore dhe e lumturisë së përhershme. Në këtë shenjë ne do të japim një përkufizim të përmbledhur e të shkurtër të asaj dëshmie folëse të shndritshme të asaj prove të qartë, sepse meqenëse Ai është prova dhe, përfundimi i Tij është njohja e Zotit të Madhëruar, ne sigurisht duhet ta njohim provën e të mësojmë mënyrën e dëshmisë së Tij. Dhe kështu me një përmbledhje tej mase të shkurtër, ne do të përshkruajmë se në çfarë mënyrash është Ai provë e Njësisë dhe i drejtësisë së Tij. Ajo është siç vijon:

Ashtu si të gjitha qëniet në univers, Profeti i Nderuar a.s.m. tregoi nëpërmjet Tij ekzistencën e Krijuesit të universit dhe Njësinë e Tij, po ashtu Ai e njoftoi me gjuhën e Tij atë dëshmi të vetë personit të Tij së bashku me dëshminë e dhënë nga të gjitha qëniet. Meqenëse Ai ishte dëshmia, ne do të tregojmë në "Pesëmbëdhjetë Parime" provën, integritetin, vërtetësinë e saktësinë e asaj dëshmie.

• **Parimi i parë:** Kjo provë, e cila tregon Mjeshtrin e universit, me personin e Tij, me gjuhën e Tij, me sjelljen e Tij dhe me fjalët e Tij, është verifikuar nga realiteti i universit dhe ishte e vërtetë, sepse dëshmia për Njësinë Hyjnore e bërë nga të gjitha qëniet është sigurisht vërtetimi për atë Personalitet i cili e njofton atë Njësi. Domethënë kauza që Ai shpall, vërtetohet nga i gjithë universi. Gjithashtu, meqenëse plotësimi i Njësisë Hyjnore, i mirësisë absolute dhe i lumturisë së përjetshme që Ai interpretoi është në harmoni e në përputhje të plotë me bukurinë dhe plotësimin e të gjitha të vërtetave të botës, Ai sigurisht është i vërtetë në kauzën e Tij. Domethënë, Profeti i Nderuar a.s.m. ishte një provë e vërtetë folëse e Njësisë

Hyjnore dhe e lumturisë së përjetshme, i Cili ishte i vërtetë e i verifikuar.

• **Parimi i dytë:** Gjithashtu, meqenëse ajo provë e vërtetë dhe e verifikuar shfaqi me mijëra mrekulli më të mëdha se sa të gjithë profetët e mëparshëm, erdhi me një sheriat që kurrë nuk do të shfuqizohet, dhe thirrja e Tij ishte për të gjithë njerëzit e xhindet, sigurisht Ai ishte kryetari i të gjithë profetëve dhe prandaj u grumbulluan në personalitetin e Tij unanimiteti i të gjitha mrekullive të tyre. Ajo do të thotë se fuqia e konsensusit të profetëve dhe dëshmia e mrekullive formon një mbështetje për vërtetësinë dhe saktësinë e Tij. Ai është gjithashtu Prijësi dhe udhëheqësi i të gjithë Evlijave dhe i dijetarëve të pastër, të cilët fitojnë plotësim përmes edukimit të Tij, udhëzimit dhe dritës së Sheriatit të Tij. Atëherë tek Ai ishin të grumbulluara misteri i kerameteve –çudirave- të tyre, pohimi i tyre me unanimitet dhe fuqia e verifikimeve të tyre, sepse ata ndoqën një rrugë, dyert e së cilës i hapi profesori i tyre, i la ato të hapura dhe atëherë ata gjetën të vërtetën. Atëherë, të gjitha kerametet e tyre, verifikimet dhe konsensusi formojnë një mbështetje për vërtetësinë e profesorit të tyre të shenjtë dhe saktësinë e Tij. Gjithashtu siç u pa në shenjat e mëparshme, prova e Njësisë Hyjnore u pajis me një siguri të tillë, të qartë dhe me mrekulli të sakta dhe çudira "Irhasat" (Irhasat janë ato mrekulli që ndodhen para lindjes dhe në kohën e lindjes së Profetit të Nderuar a.s.m.), dhe profetësia e Tij u provua nga dëshmi të tilla të parefuzueshme, saqë pohimi i tyre nuk mund të kundërshtohej sikur edhe i gjithë universi të bashkohej kundër Tij.

• **Parimi i tretë:** Dhe Ai lajmëtar i Njësisë Hyjnore dhe Ai sihariques i lumturisë së përjetshme i Cili ishte vetë një mrekulli e qartë dhe në vetë personalitetin e Tij të bekuar Ai kishte aq shumë virtyte të larta, dhe kishte aq shumë veçori të lavdërueshme në misionin e profetësisë së Tij saqë edhe armiku më i egër detyrohej t'i vërtetonte ato, pasi ishte i pamundur t'i mohonte. Meqenëse cilësitë më të larta e më të mira morale, atributet më të plota dhe virtytet më të çmueshme e të pranueshme ishin të pranishme në qënien e Tij, në detyrat e Tij, në fenë dhe në sheriatin e Tij, sigurisht ajo qënie ishte shembulli, modeli, personifikimi dhe njeriu i plotësimeve dhe i cilësive

të larta morale tek qëniet. Prandaj, këto plotësime në personin e Tij, në detyrën e Tij dhe në fenë e Tij formojnë një mbështetje aq të fuqishme për vërtetësinë e saktësinë e Tij, saqë në asnjë mënyrë ajo nuk mund të lëkundet.

• **Parimi i katërt:** Dhe ky lajmëtar i Njësisë Hyjnore e i lumturisë, i Cili ishte burimi i plotësimeve dhe mësuesi i virtyteve të larta nuk foli nga vetvetja, por u bë të flasë nga Krijuesi i universit. Ai mori instruksion nga Krijuesi i parapërjetësisë dhe, atëherë e dha mësim tek të tjerët, sepse Krijuesi i kozmosit tregoi përmes mijëra provave të profetësisë së Tij ashtu siç u përmendën në shenjat e mëparshme, nëpërmjet të gjitha atyre mrekullive të cilat Krijuesi i shfaqi përmes dorës së Profetit a.s.m. që: Ai, nuk fliste nga vetvetja, por përcjellte Fjalën e All-llahut të Madhëruar e në rrugën e Tij. Për më tepër, Kur'ani që i erdhi Atij tregoi përmes dyzet aspekteve të mrekullisë, të jashtme e të brendshme, se Ai ishte përçuesi dhe interpretuesi i All-llahut të Gjithëfuqishëm. Gjithashtu, nëpërmjet të gjithë sinqeritetit të Tij, frikës së Tij ndaj Zotit të Madhëruar, seriozitetit, besueshmërisë dhe të gjitha cilësive të tjera të sjelljes, Ai tregoi se nuk po fliste idetë e Tij në emrin e vet, por fliste në emër të Krijuesit të Tij. Përveç kësaj, të gjithë ata që depërtuan tek realiteti, njerëzit e hakikatit, e që i kushtuan vëmendje Atij, e konfirmuan me të vërtetat që ata hetuan e zbuluan; ata kanë besuar me sigurinë e njohjes se Ai nuk fliste nga vetvetja e Tij , por Krijuesi i universit e bëri të flasë e të japë mësim. Prandaj, saktësia dhe vërtetësia e Tij mbështeten nga konsensusi i këtyre katër parimeve të fuqishme.

• **Parimi i pestë:** Ky interpretues i foljes së Parapërjetësisë i shikoi qëniet shpirtërore, bisedoi me engjëjt dhe u dha udhëzim njerëzve e xhindeve. Ai mori njohuri duke tejkaluar botën e njerëzve e të xhindeve dhe madje botët e Shpirtërave e të Engjëjve; pati hyrje e marrëdhënie me botët që shtrihen përtej tyre. Mrekullitë që u përmendën më parë dhe historia e jetës së Tij e cila ka vërtetësinë e "Konsensusit", e gjitha e provon këtë fakt. Atëherë, jo falltarët e mediumet, por as xhindet, as shpirtërat e as Engjëjt nuk mund të ndërhyjnë në sihariqet që Ai jep, madje as Engjëjt më të lartë përveç

Xhebrailit. Në disa raste Ai e la prapa edhe Hazreti Xhebrailin, shokun e Tij.

• **Parimi i gjashtë:** Kjo Qënie, (Prijësi i Engjëjve, i xhindeve dhe i njerëzve) ishte fruti më i shndritshëm e më i plotë i pemës së universit dhe personifikimi i mëshirës Hyjnore, shembulli i dashurisë Hyjnore, prova më e ndritshme e së Vërtetës, llamba më rrezatuese e realitetit, çelësi i enigmës së krijimit, shpjeguesi i urtësisë së botës, lajmëtari i sovranitetit Hyjnor dhe përshkruesi i bukurive të artit Hyjnor, dhe në lidhje me gjithëpërfshirjen e gjendjes së Tij, Ai ishte shembulli më perfekt i plotësimeve të qënieve. Atëherë, këto veçori të Tij dhe personaliteti i Tij shpirtëror tregojnë, në të vërtetë, se Kjo qënie ishte shkaku i parë i ekzistencës së universit. Domethënë, Krijuesi i Universit e pa Atë dhe krijoi universin. Mund të thuhet se: *"Në qoftë se Ai nuk do ta kishte krijuar Muhammedin a.s.m., Ai nuk do ta kishte krijuar universin."* Po, të vërtetat e Kur'anit dhe dritat e besimit që Ai u solli njerëzve dhe xhindeve; virtytet e larta dhe plotësimet e dukshme në qënien e Tij, janë dëshmitarë të prerë të këtij fakti.

• **Parimi i shtatë:** Kjo provë e së Vërtetës dhe kjo llambë e realitetit demonstroi një fe të tillë e një sheriat, saqë Ai përfshin parimet që sigurojnë lumturinë e të dyja botëve. Përveç qënies gjithëpërfshirëse, Ai shpjegon me korrektësinë më të plotë të vërtetat dhe detyrat e universit, Emrat e Krijuesit të universit dhe atributet e Tij. Kështu Islami dhe Sheriati janë aq gjithëpërfshirës e të plotë dhe përshkruajnë universin dhe Krijuesin në një mënyrë të tillë, saqë ndonjë që studion natyrën e tij me kujdes është i detyruar të kuptojë se ajo fe është një deklaratë e manifest, duke përshkruar si Krijuesin e Vetëm që e bëri kaq të bukur universin, po ashtu dhe vetë universin. Ashtu si ndërtuesi i një pallati që shkruan një njoftim që i përshtatet pallatit, me qëllim që të përshkruajë vetveten nëpërmjet atributeve të tij, po ashtu një lartësi e tillë, një gjithëpërfshirje dhe një e vërtetë janë të dukshme në Fenë dhe në Sheriatin e Muhammedit a.s.m. të cilat demonstrojnë se feja e Tij buron nga Pena e të Vetmit i Cili e krijon dhe e rregullon universin. Kushdo që e rregulloi universin kaq mirë, është Ai i Vetëm që rregulloi këtë fe të plotë në sistemimin më

të bukur. Po, rregulli i përkryer në njërën, kërkon rregull të përkryer tek tjetra.

• **Parimi i tetë:** Atëherë, i cilësuari nga atributet e lartëpërmendura dhe i mbështeturi nga prova e mbështetje të fuqishme e të palëkundura, Profeti Muhammed Arab a.s.m. shpalli mesazhin e Tij mbi kokat e njerëzve dhe të xhindeve në emrin e botës së padukshme duke u drejtuar tek bota e dukshme; Ai iu adresua popujve e kombeve duke pritur matanë shekujve të së ardhmes; Ai u thirri të gjithë xhindeve e njerëzve; Ai i bëri të gjitha vendet e kohët të dëgjojnë. Po, edhe ne gjithashtu dëgjojmë!

• **Parimi i nëntë:** Fjalimi i Tij është aq i lartësuar e i fuqishëm, saqë të gjithë shekujt i kushtojnë vëmendje Atij ligjërimi. Po, të gjithë shekujt e dëgjojnë ushtimin e zërit të Tij.

• **Parimi i dhjetë:** Është e dukshme nga mënyra e asaj qënie se Ai shikoi dhe foli me dritën e asaj që pa, sepse në kohët e rrezikut më të madh Ai foli pa nguruar, pa pasur frikë dhe me qëndrueshmërinë më të plotë. Madje Ai sfidoi i vetëm të gjithë botën.

• **Parimi i njëmbëdhjetë:** Dhe me të gjithë fuqinë e Tij, Ai bëri një thirrje të fortë saqë i shkaktoi gjysmës së globit dhe një të pestës së njerëzimit për t'iu përgjigjur zërit të Tij me fjalën "Lebbejk", *ja ku jam, urdhëro*! duke deklaruar: سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا *"Po, ne kemi dëgjuar dhe ne i bindemi!"*

• **Parimi i dymbëdhjetë:** Ai thirri me një seriozitet të tillë dhe dha mësim aq me themel, saqë i skaliti parimet e Tij në fytyrën e shekujve dhe pikërisht në gurët e të gjitha qosheve të botës; Ai i skaliti ato në faqen e kohës.

• **Parimi i trembëdhjetë:** Ai shpalli forcën e urdhëresave që Ai përcolli me një vetëbesim e siguri të tillë, saqë sikur të mblidhej e gjithë bota, nuk mund ta bënin Atë të revokonte apo të mohonte ndonjë rregull të vetëm apo porosi nga ato. Dëshmitar për këtë është e gjithë jeta e Tij dhe biografia e Tij e shquar.

• **Parimi i katërmbëdhjetë:** Ai thirri me një konfidencë e besim të tillë saqë nuk bënte asnjë lëshim në thirrje dhe nuk ngurronte aspak përpara çdo lloj problemi. Me sinqeritet e ndershmëri të plotë, Ai pranoi para çdokujt tjetër porositë që kishte sjellë dhe veproi në përputhje me to dhe i shpalli. Dëshmitarë për këtë ishin zuhdi – asketizmi- i Tij i shquar dhe pavarësia dhe, Ai kurrë nuk u përkul para shkëlqimit të përkohshëm të kësaj bote, të cilat njiheshin nga gjithësecili, nga miqtë e armiqtë.

• **Parimi i pesëmbëdhjetë:** Bindja e Tij ndaj fesë që solli, adhurimi ndaj Krijuesit dhe largimi nga çdo gjë që ishte e ndaluar, të gjitha që Ai kreu ishin në shkallën më të lartë se të çdo njeriu tjetër; këto demonstrojnë prerazi se Ai ishte i dërguari dhe lajmëtari i Sulltanit të para dhe të Paspërjetësisë. Ai ishte shërbëtori më i sinqertë i të Vetmit Krijues dhe Përkthyesi i fjalës së të Përjetshmit.

Përfundimi i pesëmbëdhjetë parimeve është ky: Personi i cilësuar me atributet e lartëpërmendura e shpalli Njësinë Hyjnore me të gjithë fuqinë e Tij, në mënyrë të përsëritur e vazhdimisht, gjatë gjithë jetës së Tij duke thënë:

فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلٰهَ إِلَّا اللهُ

"Atëherë mëso se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut."

اَللّٰهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلَيْهِ وَعَلٰى اٰلِهِ عَدَدَ حَسَنَاتِ أُمَّتِهِ

O Zot! Jepi Atij dhe familjes së Tij bekime e paqe, sa numri i veprave të mira të ummetit të Tij.

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

Lavdia të takon Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti".[229]

* * *

[229] Kur'an, 3: 32

Një Nderim Hyjnor
dhe
Një Shenjë e Mirësisë Hyjnore

Me shpresën e përmbushjes së kuptimit të vërsetit,

وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ

"Por mirësinë e Zotit tënd, tregoje e shpalle"

Unë do të përmend një shenjë të mirësisë dhe të mëshirës së Zotit të Gjithëfuqishëm që ishin të dukshme në shkrimin e kësaj trajtese, me qëllim që ata që e lexojnë të mund të kuptojnë rëndësinë e saj.

Unë nuk e kisha si synim në zemër të shkruarin e kësaj trajtese, sepse "Fjala e Nëntëmbëdhjetë" dhe "Fjala e Tridhjetë e një" qenë shkruar për profetësinë e Muhammedit a.s.m.. Atëherë, papritmas, ndjeva një nxitje të madhe në zemër për ta shkruar atë. Gjithashtu, fuqia ime e kujtesës ishte shuar për shkak të fatkeqësive që kisha vuajtur. Për më të tepër, në përputhje me mënyrën time, unë nuk kisha marrë stilin tim tregimtar, domethënë, "filani (në filan libër) tha", (ose) "Është thënë se" në veprat që pata shkruar. Përveç kësaj, unë nuk kisha libra hadithi, as biografinë e Profetit a.s.m. për t'i përdorur. Megjithatë, duke thënë: "Unë e vendos besimin tim tek Zoti", fillova. Ishte tej mase e suksesshme dhe kujtesa ime më ndihmoi, në një mënyrë që tejkaloi madje atë të Saidit të Vjetër. Tridhjetë deri në dyzetë faqe shkruheshin me shpejtësi në çdo dy ose tri orë. Njëherë u shkruan pesëmbëdhjetë faqe për një orë. Shumica u tregua nga libra të tillë si Buhariu, Muslimi, Bejhakiu, Tirmidhiu, *Shifa el-Sherif*, Ebu Nuajm dhe Tabariu. Zemra ime po dridhej, sepse po të kishte pasur ndonjë gabim në transmetimin e tyre - meqë ato ishin hadithe - ajo do të ishte mëkat. Por ishte e qartë se mirësia Hyjnore ishte e madhe. Hadithet u shkruan, në sajë të Zotit, të shëndosha e të

sakta. Në rast se ndoshta ndodhet ndonjë gabim në fjalët e disa haditheve ose në emrat e tregimtarëve, unë kërkoj që vëllezërit e mi t'i shikojnë ato me tolerancë e t'i korrigjojnë.

Ustadh Said Nursi, mësuesi ynë, diktonte dhe ne shkruanim draftin. Ai nuk kishte libra me vete dhe nuk iu referua asnjërit. Ai, papritmas, diktonte me një shpejtësi të madhe dhe ne shkruanim. Ne shkruanim tridhjetë, dyzetë e ndonjëherë më shumë faqe në dy ose tri orë. Ne formuam bindjen se ky sukses ishte, në vetvete, një keramet që buroi nga mrekullia e Profetit Muhammed, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi Të.

Abdullah Çavush

Studenti i tij në shërbim të përhershëm ndaj tij

Sulejman Sami

Shkruesi i tij i drafteve dhe në shërbim të përhershëm

Hâfiz Hâlid

Shkruesi i drafteve dhe në shërbim të vazhdueshëm ndaj tij

Hâfiz Teufik

Shkruesi i tij i drafteve përfundimtare

* * *

SHTOJCA E PARË PËR

MREKULLITË E MUHAMMEDIT

(Alejhis-salatu ves-selam*)*

["Fjala e Nëntëmbëdhjetë" rreth profetësisë së Muhammedit, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi Të dhe mrekullia e "Çarjes më dysh e hënës" janë përfshirë këtu për shkak të stacionit të tyre.]



"Me fjalët e mia Muhammedin s'e lavdërova,

Por fjalët e mia me Të zbukurova.".

Po, kjo Fjalë është e bukur, por veçoritë dhe cilësitë e Muhammedit a.s.m. që janë më të bukurat e gjërave, janë pikërisht ato që e stolisin këtë Fjalë. Gjithashtu, duke qenë "Shkreptima e Katërmbëdhjetë", kjo fjalë përbëhet nga **"Katërmbëdhjetë Pikla**" të vogëla.

■ PIKLA E PARË

Ndodhen tri gjëra të mëdha e universale të cilat na bëjnë neve të njohur Krijuesin tonë.

E para: është libri i universit, diçka nga dëshmia e të cilit ne e kemi dëgjuar nga trembëdhjetë shkreptimat dhe nga Mësimi i Trembëdhjetë i trajtesës së Methnevi i Nurije Arabisht.

***E dyta**:* është Vula e Profetëve a.s.m., shenja më e madhe e librit të madh të universit.

***E treta**:* është Kur'ani i gjithurtë.

Tani duhet të njihemi me Vulën e Profetëve a.s.m.e cila është prova e dytë e qartë folëse dhe duhet ta dëgjojmë atë.

Po, vështroje personalitetin kolektiv të kësaj prove: **Faqja e tokës është bërë xhamia e tij; Mekka mihrabi i tij, dhe Medineja predikatorja e tij; Profeti ynë, paqja dhe bekimet e Zotit xh.sh qofshin mbi të, kjo provë e qartë, është Imami i të gjithë besimtarëve, është predikuesi i të gjithë njerëzimit, kryetari i të gjithë profetëve, shkëlqesia i të gjithë evlijave, prijësi i rrethit të përmendjes së Zotit xh.sh. i atij rrethi që përfshin të gjithë Pejgamberët dhe Evlijatë... Ai është një pemë vezulluese, rrënjët e gjalla të së cilës janë të gjithë profetët, ndërsa frutat e freskëta janë të gjithë Evlijatë; Çdo pretendim të tij e dëshmojnë të gjithë profetët duke u mbështetur në mrekullitë e tyre; e konfirmojnë dhe e vërtetojnë të gjithë evlijatë, duke u mbështetur në kerametet (provat, çudirat) e tyre, s**epse Ai deklaron dhe pretendon لَآ إِلٰهَ إِلَّا هُوَ *"Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut"* Dhe të gjithë ata recitues dritëdhënës të Emrave Hyjnorë, të rreshtuar në të djathtën e në të majtën, domethënë, në të shkuarën e në të ardhmen, përsërisin të njëjtat fjalë dhe nëpërmjet konsensusit të tyre, në të vërtetë deklarojnë: **"TI FLET TË VËRTETËN DHE AJO QË TI THUA ËSHTË E DREJTË"**, atëherë cila ide e rreme ka fuqi të përzihet në një pretendim që vërtetohet e mbështetet kështu nga mijëra?

■ **PIKLA E DYTË:**

Ashtu siç vërtetohet Kjo provë brilante e Njësisë nga unanimiteti dhe konsensusi i atyre dy krahëve, i krahut të Profetëve dhe i atij të Evlijave, gjithashtu të njëjtën gjë bëjnë qindra tregues në shkrimet e librave të shpallur qiellorë si Teurati e Inxhili–Bibla, [230] dhe me mijëra

[230] Në **"Risale-i Hamidije"** Hysejin Xhisri nxori njëqind e katërmbëdhjetë tregues nga shkrimet qiellore. Në qoftë se këto tregues kanë mbetur edhe pas

shenja që u shfaqën përpara fillimit të misionit të tij, dhe sihariqet e falltarëve dhe e zërave nga bota e padukshme, dhe dëshmia me unanimitet dhe treguesit e mijëra mrekullive të tij, si: **Çarja më dysh e hënës** dhe vërtetësia e sheriatit që e mbështet dhe e konfirmojnë atë. Gjithashtu, në personin e tij, sjelljet e lavdërueshme të cilat ishin në kulmin e plotësimit; dhe në detyrat e tij, besimi i plotë i tij dhe veçoritë e cilësitë e larta që ishin në shkëlqimin më të madh, devocioni i tij dhe frika e jashtëzakonshme ndaj Zotit, adhurimi i jashtëzakonshëm, serioziteti i jashtëzakonshëm dhe qëndrueshmëria e jashtëzakonshme tregojnë fuqinë e besimit të tij të plotë dhe qëndresën e tij të plotë. Të gjitha këto tregojnë aq qartë si dielli, sa besëplotë dhe fetar i palëkundur ishte ai për kauzën e tij, për çështjen e tij më të madhe.

■ **PIKLA E TRETË:**

Po të duash, eja! Le të shkojmë në Gadishullin Arabik, tek **Epoka e Lumturisë!** Në përfytyrimet tona ne do ta shohim atë tek detyrat e tij, kështu le t'i bëjmë një vizitë. Vështro! Ne shikojmë një person të shquar për sa i përket karakterit të tij të hollë dhe formës së tij të bukur. Në dorën e tij është një libër i mrekullueshëm dhe në gjuhën e tij është një adresim i vërtetë. Ai është duke i dhënë njerëzimit një predikim parapërjetësie. Në të vërtetë Ai ua drejton atë njerëzve, xhindëve, engjëjve dhe të gjitha qënieve. Ai zgjidh dhe shpjegon enigmën e çuditshme të misterit të krijimit të botës; Ai zbulon dhe zgjidh gjëegjëzën e ngatërruar e cila është misteri i universit. Ai jep përgjigje të kënaqshme dhe bindëse që bëhen nga të gjitha qëniet dhe që kanë çuditur e preokupuar mendjet: **Kush jeni? Nga vini? Dhe ku po shkoni?**

■ **PIKLA E KATËRT:**

Shiko! Ai përhap një dritë të tillë vërtetësie sa që në qoftë se do ta shikoje universin jashtë sferës ndriçuese të udhëzimit të Tij, do ta shihje atë si një vend zie të përgjithshme, do t'i shihje krijesat e saja si

ndryshimit dhe korruptimit të atyre teksteve, pa dyshim, përmendje e tregues të qartë kanë ekzistuar para modifikimit të atyre librave... (Autori)

të huaja dhe madje si armiq, dhe do t'i shihje qëniet e pajeta si kufoma të lemerishme, dhe qëniet e gjalla si jetimë, duke qarë për shkak të goditjes së zhdukjes e të ndarjes. Tani sodit! Nga drita që Ai përhap, ai vend vajtimi e zie të përgjithshme u shndërrua në një vend ku recitohen Emrat dhe lëvdatat e Zotit me gëzim e dëshirë; qëniet e armiqësuara e të huaja janë bërë miq e vëllezër; kurse qëniet e pajeta e të pagoja që të gjitha kanë marrë formën e nëpunësve të njohur dhe shërbyesve të butë; dhe jetimët që vajtojnë e ankohen, shihen ose duke recituar Emrat e Zotit dhe lavdërimet e Tij, ose duke dhënë falënderime që u çliruan nga detyrimet e tyre.

■ **PIKLA E PESTË:**

Gjithashtu, nëpërmjet dritës së tij, lëvizja dhe zhvendosja e univer-sit, ndryshimet e tij dhe transformimet, pushojnë së qëni të pakuptimta, të kota e lodra të rastësisë; ato ngrihen në nivelin e qënies së tyre si mesazhe Hyjnore, faqe të skalitura me shenjat e krijimit si dhe pasqyra për Emrat Hynorë. Vetë universi u bë libri i urtësisë së të Përjetshmit të vetëm.

Ndërsa dobësia e pakufishme e njeriut, pafuqia e tij dhe nevojat e tij e bëjnë atë më të ulët se sa të gjitha kafshët, dhe mendja e tij që i transmeton dëshpërimet e hidhërimet e së shkuarës dhe ankthet e së ardhmes, e bëjnë atë më të mjerin. Mirëpo kur ndriçohet mendja me atë dritë, njeriu ngrihet mbi të gjitha kafshët e mbi të gjitha krijesat, dhe me ndriçimin e asaj mendjeje, pafuqie e varfërie, dhe me dua, bëhet një sulltan i privilegjuar, dhe me përgjërim ai u ngjit në majen e kalifatit.

Domethënë, po të mos ishte drita e personalitetit të Muhammedit a.s.m., universi, njeriu dhe të gjitha gjërat do të ishin asgjë. Po, sigurisht, një personalitet i tillë është i domosdoshëm në një univers të tillë të mrekullueshëm, përndryshe universi e krijesat nuk do të ishin në ekzistencë, pasi ato nuk do të kishin kuptim për ne.

■ **PIKLA E GJASHTË:**

Kështu, ky personalitet bën të ditur e sihariqon për lumturinë e përjetshme; Ai është zbuluesi dhe njoftuesi i një mëshire të pafund; është lajmëtari dhe vështruesi i bukurive të sovranitetit të Hyjnisë dhe zbuluesi e treguesi i thesareve të Emrave Hyjnorë. Në qoftë se ti e vlerëson atë kështu, domethënë, nga aspekti i adhurimit, ti do ta shikoje Atë modelin e dashurisë, shembullin e mëshirës, lavdinë e njerëzimit dhe frutin më të shndritshëm të pemës së krijimit. Ndërsa po ta shikosh në këtë mënyrë, domethënë, -nga aspekti i profetësisë së Tij-, do ta shohësh Atë të jetë prova e Zotit, llamba e vërtetësisë, dielli i udhëzimit dhe mjeti i lumturisë.

Dhe vështro: Drita e Tij ka ndriçuar nga lindja në perëndim me shpejtësinë e vetëtimës flakëruese, dhe gjysma e tokës dhe një e pesta e njerëzimit ka pranuar dhuratën e udhëzimit të Tij dhe e ka ruajtur atë si vetë jetën. Atëherë si është e mundur që nefsi ynë dhe shejtanët të mos e pranojnë me të gjitha shkallët bazën e të gjitha pretendimeve të atij Personaliteti!.. E cila është: لَآ إِلٰهَ إِلَّا هُوَ *"Nuk ka zot tjetër, përveç All-llahut"*

■ **PIKLA E SHTATË:**

Tani shiko! Ai personalitet nëpërmjet një fuqie të shenjtë çrrënjosi menjëherë zakonet e tyre të egra e barbare dhe traditat me të cilat ata ishin lidhur me fanatizëm. Ai i pajisi ata njerëz të ndryshëm të egër e kokëfortë të atij gadishulli të gjërë me virtytet më të holla dhe i bëri ata mësuesit e botës njerëzore dhe profesorët e kombeve të qytetëruara.

Vështro! Ai nuk ishte një dominim sipërfaqësor, ai pushtoi dhe nënshtroi mendjet e tyre, shpirtërat, zemrat dhe ndjenjat e tyre. Ai u bë i dashuri i zemrave, mësuesi i mendjeve, edukatori i nefseve dhe sunduesi i shpirtërave.

■ **PIKLA E TETË:**

Ju e dini se një zakon i vogël si pirja e duhanit midis një grupi të vogël mund të zhduket përgjithmonë vetëm nga një sundues i fuqishëm me përpjekje të mëdha. Por shiko! Ky personalitet zhduku

shumë zakone të mëdha, të ngulitura në shumë popuj të vështirë e fanatikë, me një fuqi të lehtë në dukje dhe me një përpjekje të vogël për një periudhë të shkurtër kohe, dhe në vendin e tyre, ai rrënjosi cilësi e virtyte të larta që u bënë aq të qëndrueshme sikur ato të kishin qenë përzier me vetë gjakun e tyre dhe me damarët. Ai arriti rezultate të jashtëzakonshme si këto.

Ne ua paraqesim gadishullin Arabik si një sfidë atyre që refuzojnë të shohin dëshminë e Epokës së Bekuar të profetit. Le të marrin ata qindra nga filozofët e tyre e të shkojnë atje e të punojnë për njëqind vjet, a do të mundeshin të bënin një të qindën e asaj që arriti Profeti për një vit?

■ **PIKLA E NËNTË:**

Nëse ti do të ishe njohës i natyrës së njeriut, natyrisht do të kuptoje se nuk është e lehtë për një njeri të mençur që të shfaqë një pretendim të rremë i cili do ta turpëronte kur të dilte në shesh; ai nuk do mund ta thonte atë pretendim pa ngurrim, pa turpërim e shqetësim të cilat tregojnë dredhinë e tij; ai nuk mund ta shprehë as pa shtirje, artificialitet e ngacmim, të cilat tregojnë mashtrimin e tij para shikimeve të armiqve të tij kritikë, madje edhe sikur ky të ishte një person i parëndësishëm, në një detyrë të parëndësishme, në një pozitë të vogël, në një komunitet të vogël dhe për një çështje të vogël. Atëhere, si mund të futet dredhia e të depërtojë kontradikta në pretendimet e këtij personaliteti i cili është një misionar i madh, me një mison të madh, me një pozitë të lartë, që lidhet me një kauzë të madhe, në një kohë kur ai ka nevojë për një mbrojtje të madhe në një komunitet të madh, përballë armiqve të mëdhenj, në një çështje të madhe dhe me një pretendim të madh? Dhe ja! Ai e shfaq atë pretendim dhe e thotë pa u shqetësuar fare nga ndonjë kundërshtar; e shpreh atë pa hezitim, pa frikë e pa shqetësim, me vendosmëri, me seriozitet, në një mënyrë që ngre nervat e armiqve të tij e madje duke i poshtëruar e fyer me shprehje të larta e të fuqishme qëndrimet e tyre. A është e mundur që të ketë hyrë ndonjë dredhi? Ruajna Zot!

إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ

"Kjo nuk është tjetër veçse shpallje e inspiruar[231]"

E vërteta nuk mashtron dhe ai që kap të vërtetën nuk mashtrohet. Rruga e tij që është e vërteta, është e pastër dhe larg çdo mashtrimi. Atëherë a mund të shfaqet ndonjë imagjinatë apo hamendje e ta mashtrojnë atë që e shikon të vërtetën të vërtetë?...

■ **PIKLA E DHJETË:**

Shiko e dëgjo çfarë thotë Ai! Ja! Ai tregon të vërteta të mëdha mahnitëse, aq të nevojshme, aq tërheqëse dhe aq kureshtare dhe i provon çështjet e atyre të vërtetave..

Ju e dini se ajo që e nxit më shumë njeriun është kureshtja. Madje, nëse do të të thuhej ty: "Në qoftë se do të japësh gjysmën e pasurisë dhe gjysmën e jetës, do të zbresë një person nga Hëna ose nga Jupiteri e do të të tregojë gjithçka rreth tyre; Ai do të të tregojë gjithashtu saktësisht rreth të ardhmes tënde dhe çfarë do të të ndodhë ty, unë mendoj se ti do të pranoje që ta jepje gjysmën e jetës e të pasurisë tënde, nëse do të ishe kureshtar. Ndërsa ai personalitet - Profeti Muhammed- tregon për Monarkun i Cili është i Tillë saqë në mbretërinë e Tij, hëna nuk është gjë tjetër veçse si një mizë që fluturon rreth një fluture dhe, kjo flutur e cila është toka që flatëron rreth një llambe, dhe llamba që është dielli, është vetëm njëra midis mijërave në një bujtinë nga mijëra bujtina të Atij Monarku.

Gjithashtu, ai personalitet njofton saktësisht për një botë aq të mrekullueshme dhe për një ndryshim e revolucion aq të çuditshëm sa që, nëse mijëra toka do të ishin bomba e të shpërthenin, ato nuk do të ishin më shumë të çuditshme se sa njoftimi që ai jep për botën tjetër. Nëse dëshiron, dëgjo nga gjuha e tij shembullin e sureve që vijojnë:

إِذَا ٱلشَّمْسُ كُوِّرَتْ ۝ وَإِذَا ٱلسَّمَآءُ ٱنفَطَرَتْ ۝ ٱلْقَارِعَةُ

[231] *Kur'an 53:4*

"Kur dielli (me dritën e tij të shtrirë gjërësisht) të mbështjellet (errësohet)." (Kur'an 81:1) "E kur të çahet qielli"(Kur'an 82:1) "Dhe krisma e kijametit(Dita e zhurmës)"(Kur'an 101:1) të cilat ai reciton.

Ai gjithashtu, vërtetësisht, flet për një të ardhme që është e tillë saqë e ardhmja në këtë botë në krahasim me atë të ardhme është si një mirazh i vogël.

Dhe ai tregon me seriozitetin më të madh për një lumturi që është e tillë saqë të gjitha kënaqësitë e dynjasë në krahasim me atë lumturi, janë si një vetetimë kalimtare e rrufesë e krahasuar me një diell të përjetshëm.

■ PIKLA E NJËMBËDHJETË:

Me siguri, nën perden e dukshme të këtij universi i cili është kështu i çuditshëm e i ngatërruar, neve patjetër na presin çështje që janë më të çuditshme. Prandaj, një personalitet i mrekullueshëm e i jashtëzakon-shëm, një zbulues i mrekullive është i domosdoshëm për të treguar çudirat e ekzistencës. Dhe kjo bëhet e qartë nga sjellja e atij personaliteti -profeti- i cili i ka parë ato, i shikon dhe na e tregon atë që sheh. Ai na mëson drejt e thellë në lidhje me Zotin e qiejve e të tokës, i Cili na furnizon neve me mirësitë e Tij dhe na njofton se çfarë kërkon e çfarë dëshiron Ai nga ne.

Dhe në një kohë kur gjithësecili duhet të lërë gjithçka, të vrapojë e t'i kushtojë vëmendje këtij profeti i cili njofton shumë të vërteta të tjera të domosdoshme si këto që ngjallin kureshtje, por si shpjegohet që shumë njerëz janë shurdha, të verbër e mediokër, të cilët nuk e shohin ketë të vërtetë, nuk e dëgjojnë atë dhe nuk e kuptojnë?

■ PIKLA E DYMBËDHJETË:

Dije se ky profet fisnik ashtu siç është një provë folëse dhe një dëshmi e vërtetë e shkallës së të vërtetës së Njësisë së Krijuesit të qënieve; gjithashtu ai është një provë vendimtare dhe dëshmi e qartë për ringjalljen e të vdekurve dhe për lumturinë e përjetshme. Vërtet, ai personalitet, ashtu si me thirrjen dhe udhëzimin e tij që është shkaku i arritjes së lumturisë së përjetshme dhe mjeti i arritjes së saj,

gjithashtu, me lutjen e tij dhe me adhurimin e tij të devotshëm është shkaku i ekzistencës së asaj lumturie të amshuar dhe mjet i krijimit të saj. Ne e përsërisim këtu këtë mister i cili është përmendur në trajtesën e Ringjalljes tek fjala e dhjetë për shkak të stacionit të tij.

Shiko! Ky personalitet kryen një lutje, një falje aq të madhe saqë duket sikur Gadishulli Arabik, e madje e gjithë toka u bë të falen e të luten për shkak të lutjes së tij madhështore.

Pastaj shiko! Ai e kryen atë lutje me këtë xhemat të madh në një mënyrë të tillë sikur ai është imami në mihrabin e epokës së tij, ndërsa anëtarët më të përkryer e të ndritshëm të njerëzimit nga koha e Ademit gjer në epokën tonë dhe deri në fund të kohës janë duke e ndjekur e duke u thënë **"Amin"** lutjeve të tija.

Dhe shiko! Ai po lutet për një nevojë aq të përgjithshme saqë jo vetëm banorët e tokës, por gjithashtu edhe ato të qiejve, dhe të gjitha qëniet me gjuhët e gjendjeve të tyre bashkohen në lutjen e tij duke deklaruar: **"Po, pranoje, o Zot, duanë e tij dhe plotësoje!"** Edhe ne gjithashtu e kërkojmë atë! Ai lutet me një dëshirë të tillë, me aq keq-ardhje, me shumë përgjërim e me një mënyrë të përshpirtshme dhe me aq nevojë, sa që e bën të gjithë kozmosin të qajë e i bën qëniet të bashkohen në lutjen e tij.

Dhe shiko! Ai lutet për një qëllim të tillë e një synim, të cilat e ngrejnë njeriun, botën, dhe të gjitha krijesat nga shkalla më e ulët, nga inferioriteti, pavlefshmëria e padobishmëria për tek shkalla më e lartë. Domethënë, tek pasja e vlerave, tek qëndrueshmëria dhe tek detyrat e larta. Vështro! Ai përgjërohet dhe lutet për ndihmë e mëshirë në një mënyrë aq të lartë e të ëmbël sikur ai t'i bënte të gjitha qëniet, qiejt e Arshin, të dëgjojnë duke i sjellë ato në dalldi e të thërrasin, **"Amin o Zoti ynë."**

Dhe shiko! Ai e kërkon plotësimin e nevojave të tij nga një Gjithëdëgjues, i Cili është i Gjithëfuqishëm e Gjithëbujar, dhe nga një Gjithëshikues, i Cili është Mëshirëplotë dhe i Gjithëditur; Nga Ai që shikon e dëgjon lutjen më sekrete, prej gjallesës më të fshehur, për nevojën më të maskuar duke iu përgjigjur e duke ia përmbushur

nevojën e saj, duke i pranuar lutjen e duke treguar mëshirë për të, sepse ai i jep çfarë i kërkohet sikur edhe me gjuhën e gjendjes së saj. Ai e jep atë në një mënyrë aq të urtë, gjithëshikuese e gjithëmëshire, sa që nuk lë dyshim se ai furnizim e rregull janë të veçantë për të Vetmin Gjithëdëgjues, Gjithëshikues, Gjithëbujar e Gjithëmëshirues.

■ **PIKLA E TREMBËDHJETË:**

Çfarë dëshiron kjo krenari e llojit njerëzor, i cili po merr pas vetes të gjithë elitën e njerëzimit, që qëndron në maje të botës e duke ngritur duart e tij drejt Arshit më të madh po lutet. Çfarë po kërkon nderi i njerëzimit, kjo qënie e rrallë e kohës, i cili vërtet është lavdia e kozmosit? Dëgjo! Ai po lutet për lumturi të përjetshme, për jetë të pavdekshme e për t'u takuar me Zotin xh.sh; Ai kërkon Parajsë, dhe lutet me të gjithë Emrat e Shenjtë Hyjnorë, të cilët paraqesin bukurinë dhe shkallët e tyre në pasqyrat e qënieve. Madje, në qoftë se nuk do të ishin shkaqet për përmbushjen e atyre kërkesave të panumërta, si: Mëshira, Përkujdesja, Urtësia e Drejtësia, qënia e të cilave kushtëzon mëshirë, urtësi, mirësi e drejtësi për ekzistencën e Ahiretit, si dhe të gjithë Emrat e Shenjtë Hyjnorë të cilët janë shkaqe që i kërkojnë ato, do të mjaftonte lutja e vetme e këtij personaliteti dritëdhënës që Zoti xh.sh. t'i ndërtonte atij dhe pasuesve të tij xhennetin, pasi ndërtimi i të cilit është aq i lehtë për fuqinë Hyjnore sa krijimi dhe ndërtimi i pranverës. Po, ashtu si profetësia e tij që u bë shkak për hapjen e këtij vendi sprovimi e provash, gjithashtu, lutja e tij me robërinë e me përkushtimin e tij ndaj Zotit ishte shkak për hapjen e botës tjetër. A do të pranonte rregulli i përkryer i vëzhguar në univers, për të cilin studiues të nivelit të lartë dhe gjeni të tillë si al-Gazali u shprehën:

لَيْسَ فِي الْإِمْكَانِ أَبْدَعُ مِمَّا كَانَ


"Nuk është e mundur të ekzistojë ndonjë gjë me origjinalitet më të madh në ekzistencë se sa ajo që ekziston."


A do ta pranonin Bukuria pa të meta e artit brenda mëshirës dhe bukuria e pakrahasueshme e Hyjnisë shëmtinë, mizorinë, mungesën e rregullit e të mos dëgjojnë e mos t'u përgjigjen dëshirave e zërave më të parëndësishëm apo të konsiderojnë të parëndësishmen si më të

rëndë-sishme, apo të mos dëgjojnë, të mos kuptojnë e të mos përmbushin dëshirat më të domosdoshme? Ruajna Zot! Njëqind mijë herë ruajna Zot!. Një bukuri të tillë nuk do ta lejonte një shëmti të tillë; ajo nuk do të bëhej e shëmtuar.

Kështu, o shoku im i përfytyruar! Kjo është e mjaftueshme sa për tani. Ne duhet të kthehemi, sepse edhe sikur të qëndronim njëqind vjet në këtë periudhë në Gadishullin Arabik, ne do të kuptonim plotësisht vetëm një të qindën e mrekullive të detyrave dhe të çudirave që kryen ai personalitet dhe ne kurrë nuk do të ishim të ngopur duke e vështruar atë.

Tani eja! Ne do të shikojmë shekujt një nga një, mbi të cilët do të kthehemi ne. Shiko se si çdo shekull është hapur si një lule përmes shkëlqimit që ai ka marrë nga ai Diell i udhëzimit. Ato kanë prodhuar miliona nga frutat e shndritshme si: **Ebu Hanifeja, Shafiiju, Ebu Bajazid Bistami, Shejh Gejlani, Sheh Nakshibendi, Imam Gazali e Imam Rabbani**, dhe duke i lënë për më vonë detajet e vëzhgimit tonë studimor në një kohë tjetër, ne duhet të recitojmë disa bekime e lutje për atë zbulues të mrekullive dhe për atë udhërëfyes, të cilat tregojnë një numër të mrekullive të tij:




وَاَظَلَّتْهُ الْغَمَامَةُ مِنَ الْحَرِّ ۞ وَشَبِعَ مِنْ صَاعٍ مِنْ طَعَامِهِ مِأَتٌ مِنَ الْبَشَرِ
وَنَبَعَ الْمَاءُ مِنْ بَيْنِ اَصَابِعِهِ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ كَالْكَوْثَرِ وَانْطَقَ اللّٰهُ لَهُ الضَّبَّ
وَالظَّبْيَ وَالْجِذْعَ وَالذِّرَاعَ وَالْجَمَلَ وَالْجَبَلَ وَالْحَجَرَ وَالْمَدَرَ صَاحِبِ
الْمِعْرَاجِ وَمَا زَاغَ الْبَصَرُ ۞ سَيِّدِنَا وَشَفِيعِنَا مُحَمَّدٍ اَلْفُ اَلْفِ صَلَاةٍ
وَسَلَامٍ بِعَدَدِ كُلِّ الْحُرُوفِ الْمُتَشَكِّلَةِ فِي الْكَلِمَاتِ الْمُتَمَثِّلَةِ
بِاِذْنِ الرَّحْمٰنِ فِي مَرَايَا تَمَوُّجَاتِ الْهَوَاءِ عِنْدَ قِرَائَةِ كُلِّ كَلِمَةٍ مِنَ الْقُرْاٰنِ
مِنْ كُلِّ قَارِءٍ مِنْ اَوَّلِ النُّزُولِ اِلَى اٰخِرِ الزَّمَانِ وَاغْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا يَا
اِلٰهَنَا بِكُلِّ صَلَاةٍ مِنْهَا اٰمِيْنَ ۞

"Paqja dhe bekimet qofshin mbi profetin tonë MUHAMMEDIN alejhis-salatu ves-selam, mijëra e mijëra herë sa numri i veprave të mira të komunitetit të tij, të cilit iu zbulua Kur'ani, dalluesi i të vërtetës nga gjënjeshtra, nga i Gjithëmëshirshmi e Mëshirëploti nga froni më i lartë; profetësia e të cilit u paralajmërua nga Teurati, Inxhili dhe u tregua nga shenjat e mrekullueshme, nga zërat e xhindeve dhe nga evlijatë e njerëzimit; Bekimet qofshin mbi profetin me shenjën e të cilit u ça më dysh hëna; mbi shkëlqesinë tonë Muhammedin a.s.m.. Paqja dhe bekimet qofshin mbi të mijëra e mijëra herë sa numri i frymëmarrjeve të komunitetit të tij, që me shenjën e të cilit i shkonin nga pas pemët, me lutjen e të cilit binte menjëherë shiu; të cilit i bënte hije reja nga nxehtësia, mbi atë që ngopi me ushqimin e tij njëqind vetë, kur ai ushqim mjaftonte vetëm për një person. Mbi atë që nga gishtat e të cilit vërshoi uji tre herë si burimi i Keutherit, që për hir të tij, Zoti bëri që atij t'i flasin zhapiku, gazela, ujku, trungu, krahu, deveja, mali shkëmbi dhe plisi i dheut; Bekimet qofshin mbi atë i cili bëri miraxhin -ngjitjen në qiell- dhe syri i të cilit nuk u dridh (lëkund), mbi shkëlqësinë dhe ndërmjetësin tonë Muhammedin a.s.m..! Paqja dhe bekimet qofshin mbi të mijëra e mijëra herë sa numri i shkronjave të Kur'anit të formuara në fjalë të paraqitura me lejen e të Gjithëmëshirshmit në pasqyrat e valëve të ajrit tek recitimi i të gjitha fjalëve të Kur'anit prej të gjithë recituesve që nga fillimi i shpalljes së tij gjer në ditën e fundit. Dhe na fal dhe na mëshiro, o Zot, për secilin nga ato bekime. Amin.

[Unë i kam përshkruar dëshmitë për profetësinë e Muhammedit a.s.m., të cilat këtu i kam treguar shkurtazi, në një trajtesë në turqisht e titulluar ***"Shuaat-i Marifetu'n-nebi - Rreze nga njohja e profetit"*** dhe në Letrën e Nëntëmbëdhjetë (Mrekullitë e Profetit). Gjithashtu ndodhen mrekullitë e Kur'anit të gjithurtë që janë përmendur shkurtimisht. Përsëri në një trajtesë në Turqisht të quajtur **"Lemeat"** dhe në "Fjalën e Njëzet e Pestë" unë kam shpjeguar në mënyrë të përmbledhur dyzet mënyra në të cilat Kur'ani është një mrekulli dhe kam treguar dyzet aspekte të mrekullisë së tij. Nga ato dyzet aspekte, vetëm elokuencën e renditjes së fjalëve unë e kam shkruar në dyzet faqe në një komentim Arabisht i quajtur **"Isharatul ixhaz."** Në qoftë se keni nevojë, ju mund t'u referoheni atyre tre veprave.]

■ PIKLA E KATËRMBËDHJETË:

Kur'ani i gjithurtë, deti i mrekullisë dhe mrekullia më e lartë, e provon Profetësinë e Muhammedit a.s.m. dhe Njësinë Hyjnore në mënyrë aq vendimtare saqë nuk lë më nevojë për provë tjetër. Dhe ne do ta japim përkufizimin e tij dhe do të tregojmë një ose dy shkreptima nga mrekullia e tij, të cilat kanë qenë shkak kritike për disa.

Kur'ani i gjithurtë i cili na bën të njohur Krijuesin tonë, është i tillë: **"Kur'ani është interpretues parapërjetësie i librit të universit; është zbuluesi i thesareve të Emrave Hyjnorë të fshehur në faqet e tokës e të qiejve; është çelësi i të vërtetave të fshehura poshtë këtyre rreshtave të ngjarjeve; është thesari i mirësive të Krijuesit Mëshirëplotë dhe i adresimit Hyjnor të parapërjetësisë, që vjen nga bota e të padukshmes, matanë perdes së kësaj bote të dukshme; Është dielli, themeli dhe plani i botës shpirtërore të Islamit; Harta e botës së Ahiretit; Komentuesi i shquar, shpjeguesi i qartë, prova folëse dhe interpretuesi i saktë i Esencës Hynore, i Atributeve dhe i veprave; Është instruktori, urtësia e vërtetë, udhëzuesi i botës së humanizmit; Është libër urtësie e ligji, libër falje e adhurimi, libër urdhëri e thirrje, libër përmendjeje dhe i njohjes Hyjnore; Është libër për të gjitha nevojat shpirtërore dhe një bibliotekë e shenjtë që jep libra të përshtatshëm për rrugët dhe metodat e Evlijave, të**

sinqertëve dhe të dijetarëve, rrugët dhe metodat e të cilëve janë të gjitha të ndryshme.

Merr në Konsideratë shkreptimat e mrrekullisë së Kur'anit në përsëritjet e tij të cilat imagjinohen të jenë gabime në elokuencë. Meqenëse Kur'ani është një libër përmendjeje, libër lutjeje e thirrjeje, përsëritja në të është e dëshirueshme, e në të vërtetë, është esenciale dhe me elokuentja. Nuk është ashtu siç mendojnë të gabuarit, sepse shenja e përmendjes është ndriçimi nëpërmjet përsëritjes. Shenja e duasë është forcim me anë të përsëritjes. Shenja e urdhrit dhe e thirrjes është konfirmim përmes përsëritjes.

Për më tepër, jo gjithkush është i mundur, në çdo kohë ta lexojë krejt Kur'anin, i cili është ilaç e shërim për gjithësecilin në çdo kohë. Por kryesisht është i mundur të lexojë një sure të tij. Prandaj, meqenëse qëllimet më të rëndësishme të Kur'anit përfshihen në suret më të gjata, atëherë secila sure bëhet si një Kur'an i vogël. Domethënë, me qëllim që askush të mos privohet, disa nga qëllimet e tij si: Njësia Hyjnore, ringjallja e të vdekurve dhe historia e Musait a.s., janë përsëritur.

Gjithashtu, ashtu si nevojat trupore, edhe nevojat shpirtërore janë të ndryshme. Njeriu ka nevojë për disa nga ato në çdo frymë; Ashtu si trupi që ka nevojë për ajër, edhe shpirti ka nevojë për fjalën "**H**u - *All-llahu*..." Ndërsa për disa të tjera si "**Bismil-lah** -*Në Emër të Zotit*"... ai ka nevojë në çdo kohë, e kështu me radhë. Kjo do të thotë se përsëritja e vërseteve buron nga përsëritja e nevojës. Dhe ai e bën përsëritjen me qëllim që të tregojë nevojën, që ta zgjojë damarin e nevojës, që ta joshë atë dhe që të lëvizë deshirën dhe oreksin e saj.

Gjithashtu Kur'ani është themeluesi, është themeli i Fesë së Qartë dhe themeli i botës së Islamit. Ai ndryshoi jetën sociale njerëzore dhe është përgjigjja e pyetjeve të përsëritura nga klasat dhe nivelet e ndryshme të njerëzimit. Përsëritja është e domosdoshme për themeluesin me qëllim që të vërtetojë gjërat. Përsëritja është e domosdoshme për t'i mbështetur ato. Konfirmimi, përsëritja dhe përtëritja janë të domosdoshme për t'i përforcuar ato.

Gjithashtu, Kur'ani flet çështje të tilla të mëdha dhe të vërteta të holla të tilla saqë përsëritjet e shumta janë të domosdoshme në format e ndryshme me qëllim që t'i ngulisë ato në zemrat e të gjithëve. Megjithëse, në dukje, ato janë përsëritje, por në përmbajtje çdo vërset ka shumë kuptime, shumë mirësi e shumë aspekte e nivele. Në çdo vend ato përmenden për një kuptim të ndryshëm e për dobi e qëllim të ndryshëm. Gjithashtu, Kur'ani duke qenë i paspecifikuar e i papërmbledhur në disa çështje që lidhen me kozmosin, është një shkreptimë mrekullie për qëllimin e udhëzimit. Ai nuk mund të jetë shkak kritike dhe nuk është i mangët, siç e imagjinojnë disa ateistë.

Në qoftë se pyet: "Pse Kur'ani i gjithurtë nuk flet për qëniet në të njëjtën mënyrë si filozofia? Ai i lë disa çështje në formë të shkurtuara dhe disa të tjera i flet në një mënyrë të thjeshtë e sipërfaqësore me qëllim që të harmonizohet me ndjenjat e tyre, e për të mos lodhur e munduar mendjet e njerëzve të zakonshëm, duke ledhatuar shikimet e përgjithshme. Po përse kjo?"

Duke iu përgjigjur, ne themi: Filozofia është shmangur nga rruga e vërtetë. Ajo është pse'ja... Gjithashtu, natyrisht, ju keni kuptuar nga fjalët e kaluara dhe nga mësimet që ato japin se Kur'ani i gjithurtë flet për universin me qëllim që të bëjë të njohur Esencën Hyjnore, Atributet dhe Emrat Hyjnorë. Domethënë, ai shpjegon kuptimet e librit të universit për të bërë të njohur Krijuesin e Tij. Me fjalë të tjera, ai i shikon qëniet jo për vetveten, por për Krijuesin e tyre. Gjithashtu ai i drejtohet gjithkujt. Ndërsa shkenca e filozofisë i shikon qëniet për vetveten e tyre dhe u drejtohet në veçanti shkencëtarëve.


Prandaj, meqenëse Kur'ani i gjithurtë i bën qëniet dëshmi dhe prova, dëshmia duhet të jetë e dukshme me qëllim që të kuptohet shpejt nga këndvështrimi i përgjithshëm, dhe meqenëse Kur'ani udhëzues u drejtohet të gjitha klasave të njerëzve, atëherë njerëzit e zakonshëm, të cilët formojnë klasën më të madhe në numër, dëshirojnë një udhëzim që lë jashtë ose përmbledh çfarë nuk i detyron ata mbi detyrën e tyre themelore, që nuk ndryshon pa qenë

nevoja gjërat, që në pikëpamjen e tyre sipërfaqësore janë të qarta dhe që t'u afrojë gjërat e holla me anë të krahasimeve me qëllim që të mos i lejojë të bien në gabime e të hyjnë në polemika të paarsyeshme.

Për shembull, Ai flet rreth diellit: ***"Dielli është një llambë rrotulluese ose fener"*** sepse ai nuk flet për diellin për vetveten ose për natyrën e tij, por për shkak se ai është një lloj boshti i një rregulli dhe qendra e një sistemi, dhe se rregulli e sistemi janë pasqyrat e mjeshtërisë së Krijuesit. Ai thotë اَلشَّمْسُ تَجْرِي *"Dielli ec (noton) në sferën e tij"* (Kur'an 36:38). Duke sjellur ndërmend sistemimet e mirëvendosura të fuqisë Hyjnore në ndryshimet e dimrit e të verës, të ditës e të natës, me frazën "*Rrotullohet"* Ai bën të kuptueshëm madhështinë e Krijuesit. Kështu si do që të jetë realiteti i këtij rrotullimi, ai nuk e prek rregullin i cili thuret e vëzhgohet dhe i cili është qëllimi. Ai gjithashtu thotë: وَجَعَلْنَا ٱلشَّمْسَ سِرَاجًا *"Dhe Ai e bëri diellin si një llambë"*[232] Nëpërmjet fjalës *"Llambë"* paraqitet bota në formën e një pallati, dhe se gjërat brenda tij janë zbukurime, domosdoshmëri dhe furnizime të përgatitura për njeriun e për gjallesat, dhe se dielli gjithashtu është një shandan -mbajtëse qirinjsh- i nënshtruar; dhe me përshkrimin e diellit si llambë, Kur'ani bën të ditur mëshirën dhe mirësinë e Krijuesit.

Tani, shiko se çfarë thotë filozofia kryengritëse, idiote e gurgulluese: "Dielli është një trup i madh qiellor me lëndë djegëse. Ai i bën planetët që janë shkëputur prej tij që të rrotullohen rreth tij. Madhësia e tij është aq e kaq, esenca e tij është kështu ashtu, është kjo është ajo!.." Atëherë kjo nuk i jep shpirtit plotësim njohurie, por veçse një frikë të tmerrshme dhe një çudi të trishtueshme. Ajo nuk flet për të siç flet Kur'ani. Nga kjo ju mund të krahasoni vlerën e çështjeve të filozofisë, ana e brendshme e së cilës është bosh dhe e zbrazur, ndërsa ana e jashtme e saj është mburracake e bujshme. Prandaj, mos u mashtro nga shkëlqimi i saj i jashtëm dhe mos shfaq mosrespekt ndaj Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm!..

[232] Kur'an 71:16


اَللّٰهُمَّ اجْعَلِ الْقُرْاٰنَ شِفَآءً لَنَا وَلِكَاتِبِهٖ وَاَمْثَالِهٖ مِنْ كُلِّ دَآءٍ وَمُوْنِسًا لَنَا
وَلَهُمْ فِيْ حَيَاتِنَا وَبَعْدَ مَوْتِنَا وَفِي الدُّنْيَا قَرِيْنًا وَفِي الْقَبْرِ مُوْنِسًا وَفِي الْقِيٰمَةِ شَفِيْعًا
وَعَلَى الصِّرَاطِ نُوْرًا وَمِنَ النَّارِ سِتْرًا وَحِجَابًا وَفِي الْجَنَّةِ رَفِيْقًا وَاِلَى الْخَيْرَاتِ كُلِّهَا
دَلِيْلًا وَاِمَامًا بِفَضْلِكَ وَجُوْدِكَ وَكَرَمِكَ وَرَحْمَتِكَ يَا اَكْرَمَ الْاَكْرَمِيْنَ وَيَا
اَرْحَمَ الرَّاحِمِيْنَ اٰمِيْنَ ۞ اَللّٰهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلٰى مَنْ اُنْزِلَ عَلَيْهِ الْفُرْقَانُ
الْحَكِيْمُ وَعَلٰى اٰلِهٖ وَصَحْبِهٖ اَجْمَعِيْنَ اٰمِيْنَ اٰمِيْنَ ۞

O Zot! Bëje Kur'anin shërim për ne, për shkruesin e kësaj vepre, për shokët e tij, nga të gjitha sëmundjet; Bëje atë shok për ne e për ata në jetët tona, pas vdekjes sonë, në këtë botë, në varr dhe në Gjykimin e fundit; Bëje atë ndërmjetës, dritë në urën e Siratit, mbrojtës nga zjarri, shok në parajsë dhe udhëzues e drejtues për tek të gjitha veprat e mira, nëpërmjet mëshirës Tënde, Bujarisë dhe nderimit Tënd, O Gjithëbujar Absolut dhe O Mëshirues i Plotë! Amin. O Zot! Jepi bekime e paqe atij të cilit iu zbulua Kur'ani plot urtësi, dalluesi midis të vërtetës e të shtrembërës, si dhe familjes së tij dhe sahabëve, të gjithë atyre, Amin, Amin.

KUJTESË: Gjashtë pikat e piklës së Katërmbëdhjetë në Risale-i Nurin Arabisht, veçanërisht gjashtë Pikat e Piklës së Katërt shpjegojnë Pesëmbëdhjetë nga afërsisht dyzet llojet e mrekullisë së Kur'anit të gjithurtë. Duke i gjykuar ato si të mjaftueshme, ne e kemi përkufizuar diskutimin këtu. Nëse dëshiron, mund t'u referohesh atyre, pasi do të gjesh një thesar mrekullish...

* * *

Shtojcë e Fjalës së Nëntëmbëdhjetë dhe e Fjalës së Tridhjetë e Një

RRETH MREKULLISË SË ÇARJES SË HËNËS

(A.S.M.)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

اقْتَرَبَتِ السَّاعَةُ وَانشَقَّ الْقَمَرُ ۝ وَإِن يَرَوْا آيَةً يُعْرِضُوا وَيَقُولُوا سِحْرٌ مُّسْتَمِرٌّ

Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. "Ora është afruar dhe hëna u ça më dysh. Dhe nëse ata shohin ndonjë shenjë, ata largohen e thonë: "Kjo është magji e dukshme"[233]

Filozofët dhe imituesit e tyre të paarsyeshëm e të verbër, të cilët dëshirojnë të eklipsojnë me idetë e mashtrimet e tyre të prishura "Çarjen më dysh të Hënës" e cila është një Mrekulli e Muhammedit a.s.m. që shndrit si Hëna, duke thënë: ***"Në qoftë se do të kishte ndodhur çarja më dysh e Hënës, do ta kishte njohur e gjithë bota dhe do të kishte qenë treguar në të gjithë librat e historisë?"***

Përgjigjja: Meqenëse *"Çarja më dysh e Hënës"* u demonstrua si një dëshmi e Profetësisë dhe ndodhi menjëherë gjatë natës kur njerëzit ishin në gjumë dhe para një tubimi të cilët, megjithëse e dëshmuan një dëshmi të tillë, e mohuan; dhe meqenëse kishte pengesa që bllokonin shikimin e saj, të tilla si mjegulla, retë dhe diferencat e kohës midis pjesëve të ndryshme të botës; dhe meqenëse në atë kohë shkenca e qytetërimi nuk ishin përhapur gjërë dhe vëzhgimi studimor i qiejve ishte shumë i kufizuar dhe vetë ngjarja ishte e jashtëzakonshme dhe e veçantë, atëherë nuk kishte asgjë që të bënte

[233] Kur'ani, 54: 1-2

të domosdoshme që "*Çarja më dysh e Hënës*" duhej të ishte shikuar anembanë botës dhe të kishte hyrë në librat e historisë. Sa për tani, dëgjo **"PESË PIKA"** nga shumë të tilla të cilat do t'i davarisin ato re mashtrimi në lidhje me "Çarjen më dysh të Hënës".

❑ **PIKA E PARË:** Kokëfortësia ekstreme e jobesimtarëve në atë kohë dhe në atë vend është e mirënjohur dhe e regjistruar në histori. Dhe megjithatë, kur Kur'ani i gjithurtë ua njoftoi këtë ngjarje të gjithë botës përmes thënies: وَانْشَقَّ الْقَمَرُ *"Dhe Hëna u ça më dysh",* asnjë nga jobesimtarët të cilët e mohuan Kur'anin, nuk guxuan ta çelin gojën e ta përgënjeshtronin këtë vërset, domethënë, të mohonin ndodhjen e kësaj ngjarje. Në qoftë se ngjarja nuk do të kishte qenë konsideruar si fakt i sigurt nga jobesimtarët në atë kohë, ata do ta kishin marrë vërsetin si pretekst e shkas e do ta mohonin fuqishëm dhe do të sulmonin e rrëzonin pretendimin për profetësi të Muhammedit a.s.m.. Por ama, librat e biografisë së Profetit a.s.m. dhe librat e historisë të cilat e përmendin ngjarjen, nuk tregojnë asgjë që sugjeron se jobesimtarët e mohuan atë.

E vetmja gjë që tregon historia është siç shpjegon vërseti: وَيَقُولُوا سِحْرٌ مُسْتَمِرٌّ *"Dhe ata thonë: Kjo është magji e dukshme",* që tregon se jobesimtarët, të cilët e panë ngjarjen, thanë se ajo është "magji", dhe thanë në qoftë se do ta kishin parë atë karvanët në vendet e tjera gjithashtu, ajo ishte e vërtetë, ose përndryshe, ai do t'u kishte bërë magji. Karvanët që arritën në mëngjesin vijues nga Jemeni dhe nga vendet e tjera njoftuan se: "Ne e pamë një ndodhi të tillë". Pastaj jobesimtarët thanë për Krenarinë e të gjitha botëve a.s.m. se Ruajna Zot!: "magjia e jetimit të Ebu Talibit ka prekur e ka ndikuar qiejt!"

❑ **PIKA E DYTË:** Shumica e dijetarëve më të shquar, si Sa'd Taftazani, kanë deklaruar se: ***"Çarja e Hënës më dysh" është vërtetuar me unanimitet sikur shuajtja e etjes së të gjithë ushtrisë me ujin që vërshoi nga gishtërinjtë e Tij, apo rasti kur i gjithë xhemati patën dëgjuar vajtimin e një trungu druri të thatë tek i cili mbështetej ndërsa mbante predikim, për shkak se po ndahej prej Profetit a.s.m.. Domethënë, këto ngjarje nga grupi në grup, i ka***

transmetuar ashtu një grupacion i madh, saqë një përbetim -ose komplot- për të gënjyer do të kishte qenë i pamundur. "Çarja më dysh e Hënës" është pranuar me "Konsensus në Kuptim", ashtu siç janë pranuar shfaqja e bishtit të kometës "Halej" para njëmijë vitesh dhe ekzistenca e ishullit Cejlon të cilin ne nuk e kemi parë." Dhe kështu, është e paarsyeshme të ushqesh dyshime të pabaza në çështje të tilla të sigurta e të dëshmuara. Është e mjaftueshme se ato mund të ndodhin, ato nuk janë të pamundshme. Dhe sa për çarjen në dysh të hënës, ajo është aq e mundur sa çarja e një mali me një shpërthim vullkanik.

❑ **PIKA E TRETË:** ***Mrekullitë janë për të provuar pretendimet e profetësisë dhe për të bindur ata që i mohojnë ato pretendime; ato nuk janë për t'i detyruar njerëzit të besojnë*****.** Prandaj mrekullitë duhet t'u shfaqen atyre që kanë dëgjuar pretendimin e profetësisë çka i çon ata në bindje e qetësi për vërtetësinë e profetësisë.

Ashtu siç do të ishte kundra urtësisë së të Gjithurtit të Madhërishëm që t'i shfaqte ato gjithandej botës ose në një mënyrë të vetëkuptueshme sa që të gjithë të detyroheshin t'i besojnë, po ashtu do të ishe në kundërshtim me misterin e përgjegjësisë së njeriut. Sepse kjo përgjegjësi kërkon ***"hapjen e derës së mendjes dhe të mos heqë fuqinë e përzgjedhjes, vullnetin e lirë"*****.** Në qoftë se Krijuesi i Gjithurtë do ta kishte lënë mrekullinë e çarjes në dysh të hënës të zgjaste për një ose dy orë kohë me qëllim që t'ia shfaqte atë të gjithë botës e të ishte regjistruar në librat e historisë ashtu siç dëshirojnë filozofët, atëherë ajo do të kishte qenë si të gjitha ndodhitë e tjera (një dukuri e zakonshme astronomike) në qiej dhe nuk do të kishte qenë dëshmi për pretendimin e profetësisë së Muhammedit a.s.m., dhe jo gjë e veçantë për të. Ose ndryshe ajo do të kishte qenë një mrekulli e tillë e vetëkuptueshme saqë do të kishte zhdukur fuqinë e arsyes për të zgjedhur dhe do ta detyronte arsyen ta pranonte atë; dhe dashur pa dashur ajo do ta kishte miratuar profetësinë e Tij. Atëherë do të barazoheshin shpirtërat e ulët si qymiri, si Ebu Xhehli, e do të mbeteshin tek i njëjti nivel si dikush tjetër me shpirt si diamanti, si Ebu Bekir i drejti, kështu misteri i përgjegjësisë së njeriut, do të kishte humbur.

Për shkak të këtij misteri, që: Duke qenë si e çastit në kohë mbrëmje, e në kohë gjumi dhe diferencat e kohës, mjegulla, retë, edhe pengesat e tjera duke e fshehur atë, ajo nuk iu shfaq të gjithë botës dhe nuk hyri në librat e historisë.

❑ **PIKA E KATËRT:** Meqenëse kjo ngjarje ndodhi në çast, natën kur gjithkush po flente, natyrisht ajo nuk u pa gjithandej botës. Madje në qoftë se ndonjë popull do ta kishte parë atë, ata nuk do t'u kishin besuar syve të tyre. Edhe sikur ajo t'i kishte bërë ata të besonin, një ngjarje e tillë domethënëse nuk do të kishte qenë një burim i përhershëm për historinë e së ardhmes nëpërmjet raportimeve individuale të izoluara.

Në disa libra është shkruar se: "Pasi u ça hëna në dy gjysma, ajo ra në tokë", por dijetarët e saktë i kanë refuzuar shtesa të tilla duke thënë se ato ndoshta u shtuan nga hipokritët me qëllim që ta zhvlerësonin e zvogëlonin në asgjë vlerën e kësaj mrekullie të qartë.

Dhe për shembull, ashtu si e njëjta kohë në Angli e Spanjë të cilat atëherë ishin të mbuluara nga mjegullat e injorancës e që do të kishte qenë pikërisht pas perëndimit të diellit, në Amerikë kohë dite, në Kinë e Japoni mëngjes, gjithashtu në vendet e tjera duhet të kishin ekzistuar pengesa të tjera që do ta pengonin atë nga shikimi. Tani konsideroji këta kundërshtarë të paarsyeshëm të cilët thonë se: "Librat e historisë së popujve, si: i Anglisë, i Kinës, i Japonisë dhe i Amerikës nuk e përmendin atë ngjarje. Atëherë ajo nuk ka ndodhur". Një mijë mallkime qofshin mbi kokat e atyre që u lajkatohen jobesimtarëve të poshtër të Evropës!..

❑ **PIKA E PESTË:** "Çarja më dysh e Hënës" nuk ndodhi vetvetiu si pasojë e disa shkaqeve, as si rezultat i rastësisë, as nuk qe një ndodhi natyrore që ndodh përmes ligjeve të zakonshme të natyrës. Por, sigurisht Krijuesi i Gjithurtë i diellit e i hënës i shkaktoi asaj të ndodhë si diçka e jashtëzakonshme, me qëllim që të vërtetojë Profetësinë e të Dërguarit të Tij dhe të ndriçojë pretendimin e Tij.

Ashtu siç e kërkonin misteri i udhëzimit, misteri i përgjegjësisë njerëzore dhe urtësia e profetësisë, ajo u shfaq si një provë bindëse për një popull të veçantë të përcaktuar nga urtësia Hyjnore. Misteri i urtësisë e kërkoi që, ajo të mos u tregohej popujve në çdo anë të botës, të cilët nuk kishin dëgjuar akoma për pretendimin e profetësisë së Muhammedit a.s.m.. Kështu ata i penguan shumë pengesa të tilla si mjegullat, retë dhe diferencat e kohës, dhe fakti se në disa vende hëna nuk kishte lindur, dhe në disa vende të tjera dielli sapo kishte lindur, në disa vende duke qenë mëngjes e në disa vende dielli sa po kishte perënduar; për shkak të këtyre dukurive, ajo nuk u tregua. Në qoftë se mrekullia do të kishte qenë shfaqur tek të gjithë njerëzit e në të gjithë botën, ajo do të kishte qenë shfaqur si një rezultat i shenjës së Muhammedit a.s.m. dhe një mrekulli e profetësisë; atëherë profetësia, do të kishte qenë aq e dukshme saqë gjithësecili do të kishte qenë i detyruar ta vërtetonte atë. Dhe asnjë zgjedhje nuk do të kishte mbetur për arsyen, në një kohë që besimi arrihet përmes zgjedhjes së fuqisë së mendjes. Atëherë misteri i përgjegjësisë njerëzore do të kishte humbur; dhe në qoftë se ajo do të ishte shfaqur si një ndodhi në qiejt, lidhja e saj me profetësinë e Muhammedit a.s.m. do të ishte këputur, e nuk do të mbetej asnjë karakteristikë e veçantë për të.

Shkurtazi: Nuk ka më asnjë dyshim në lidhje me mundësinë se "Çarja më dysh e Hënës" ndodhi; ajo është provuar në mënyrë vendim-tare dhe tani ne do të përmendim gjashtë nga shumë dëshmi duke treguar ndodhjen e saj.[234] Kështu që:

Unanimiteti i sahabëve të Profetit, të cilët ishin të gjithë burrat e drejtësisë, për ndodhjen e asaj ngjarjeje. Unanimiteti i tyre në shpjegimin e vërsetit Kur'anor وَٱنشَقَّ ٱلۡقَمَرُ *"Dhe Hëna u ça më dysh"* si dhe i të gjithë komentatorëve të vërtetë të Kur'anit. Fakti se duke u mbështetur në zinxhirë të ndryshëm të shumtë të autoriteteve dhe në

[234] Shënim: Domethënë,ndodhen gjashtë prova vendimtare lidhur me çarjen më dysh të hënës në gjashtë lloje unanimiteti. Por për fat të keq ne nuk mundëm t'i japim shqyrtimin që i takon këtij vendqëndrimi dhe kështu u la e shkurtuar. (autori)


linja transmetimi, të gjithë dijetarët e hadithеve Profetike dhe transmetuesit e rrëfenjave të shëndosha e treguan ngjarjen. Dëshmia e të gjithë evlijave dhe e të drejtëve, e atyre që morën inspirim dhe që zbuluan misteret e krijimit. Vërtetimi i dijetarëve të shquar dhe i teologëve, rrugët e të cilëve ndryshojnë nga njëra-tjetra.

Fakti se Ummeti i Muhammedit a.s.m. e pranoi ndodhjen e saj dhe ai Ummet nuk bie kurrë dakord mbi një gënjeshtër, por bie dakord vetëm mbi një parim të vërtetuar.

Këto gjashtë dëshmi e provojnë "Çarjen më dysh të Hënës" aq qartë si dielli.

***Përfundim**:* Deri këtu kjo shtojcë ka qenë në emrin e konfirmimit të së vërtetës dhe të heshtjes së atyre armiqve të cilët e mohojnë atë. Fjalitë e saja përmbyllëse do të jenë tani në emrin e së vërtetës dhe për hir të besimit. Po, duke e vërtetuar, foli kështu verifikimi shkencor. Ndërsa e vërteta thotë:

Vula e Divanit të Profetësisë i Cili ishte hëna ndriçuese e qiellit të saj si dhe e vërtetoi shenjtërinë e Tij nëpërmjet Mi'raxhit të Tij. Ky ishte kerameti më i madh dhe mrekullia më e lartë e shenjtërisë e arritur përmes adhurimit të Tij që ishte aq i lartë saqë do ta bënte atë "të dashurin e Zotit". Domethënë, duke udhëtuar me trupin e Tij tokësor përmes qiejve, epërsia e Tij dhe qënia e Tij "I Dashuri i Zotit", iu demonstruan banorëve të qiejve dhe banorëve të botëve të larta. Gjithashtu Krijuesi e çau në dysh Hënën e varur në qiejt dhe e lidhur me tokën me anë të një shenje nga robi në tokë, kështu Ai ua shfaqi banorëve të tokës këtë mrekullinë e Tij duke vërtetuar profetësinë e Atij robi të dashur. Kështu, personaliteti i Muhammedit a.s.m. u ngjit në majën e plotësimeve mbi dy krahët e ndritshëm të profetësisë dhe të shenjtërisë – si dy krahët e ndarë ndriçues të hënës; Ai u ngjit tek (Kab-ë Kavsejn) 'tek distanca e dy harqeve' dhe u bë boshti i krenarisë për banorët e qiejve e të tokës.



"Mbi Të e mbi familjen e Tij qofshin bekimet e paqja aq të shumta sa mbushja e tokës dhe e qiejve". "Lavdia të takon Ty ! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti. Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti."[235]

"O Zot! Për hir të Atij që me shenjën e të Cilit u ça hëna më dysh, bëji zemrën time dhe zemrat e studentëve të sinqertë të Risale-i Nurit si hëna përballë diellit të Kur'anit. Amin. Amin."

* * *

[235] Kur'an 2:32

SHTOJCA E TRETË

NJE PJESË NGA SHTOJCA E TRAJTESËS SË MREKULLIVE TË PROFETIT MUHAMMED A.S.M.

[Kjo lidhet me treguesit e profetësisë së Muhammedit a.s.m. dhe është përgjigjja në formën e një indeksi të përmbledhur për të parën e tre çështjeve dhe vështirësive që erdhën në fundin e Parimit të Tretë të Fjalës së Tridhjetë e Një, Trajtesa e Mi'raxhit.]

Pyetje: Përse u veçua Muhammedi Arab a.s.m. me këtë Mi'raxh të madh?

Përgjigjja: Vështirësia jote e parë: Në Tridhjet Fjalët e kaluara ato janë shpjeguar hollësisht, Kështu ne do të tregojmë këtu vetëm një Tregues të përmbledhur në formën e një indeksi të shkurtuar për plotësimet e Profetit a.s.m. dhe për treguesit e Profetësisë së Tij dhe se Ai ishte më i merituesmi për këtë mi'raxh të madh. Ai ishte siç vijon:

Së pari: Pavarësisht shtrembërimeve të shumta në tekstet e librave të shenjta, si në Teurat, Inxhil e Zebur (Psalmet) gjatë shekujve, një dijetar i saktë si Husejn Xhisri nxori njëqind e katërmbëdhjetë sihariqe duke treguar profetësinë e Muhammedit a.s.m. të cilat ai i shpjegoi në veprën e tij "Risale-i Hamidije".

Së dyti: Është vërtetuar historikisht se ndodheshin shumë para-shikime duke u raportuar saktësisht që njoftuan profetësinë e Muhammedit a.s.m. si dy falltorët e famshëm *Shik* dhe *Satih* pak përpara misionit të Tij Profetik dhe njoftuan faktin se Ai do të ishte Profeti i ahirzamanit -kohës së fundit-.

Së treti: U shfaqën qindra ndodhi të jashtëzakonshme të mirënjo-hura në histori, të quajtura *"irhasat"*, domethënë shenja duke paralajmë-ruar njerëzit për një Profet të ardhshëm; si për shembull, në natën e lindjes së Muhammedit a.s.m. idhujt e Qabesë u rrëzuan

prej vendeve të tyre dhe pallati i famshëm *Ejvani i Kisras së Persisë* u trondit.

Së katërti: Historia dhe biografia e Profetit a.s.m. tregojnë se Ai ngopi e shuajti etjen e një ushtrie me ujë duke vërshuar nga gishtërinjtë e Tij, se në prani të një xhemati të madh në xhami, një trung i thatë, tek i cili mbështetej Profeti a.s.m., rënkoi si një deve për shkak se po ndahej prej Tij kur Ai ngjitej në minber -predikatore-, dhe se Ai dallohej me mijëra mrekulli të dëshmuara nga vërsetet e Kur'anit, të tilla si: وَانْشَقَّ الْقَمَرُ *"Dhe Hëna u ça më dysh",* duke iu referuar çarjes në dysh të hënës dhe të verifikuara nga ata të cilët i hetuan ato.

Së pesti: Kushdo që merr në konsideratë faktet dhe është i drejtë e i paanshëm, nuk mund të ngurrojë për të rënë dakord, ashtu siç është rënë dakord me unanimitet, njëlloj nga miqtë e armiqtë, se cilësitë e mira morale gjendeshin në shkallën më të lartë në personalitetin e Tij, dhe se në përputhje me dëshminë e të gjithë trajtimeve të sjelljeve të Tij me njerëzit, me cilësitë dhe karakterin e shkëlqimit më të madh, të cilat ishin të dukshme në mënyrën që Ai kreu detyrat e Tij dhe njoftoi Fenë Islame, dhe, në harmoni me cilësitë e holla dhe me sjelljen e urdhëruar nga feja Islame, virtytet e lavdërueshme të rregullit më të lartë do të gjendeshin në Sheriatin që Ai solli.

Së gjashti*:* Siç aludohet në Treguesin e Dytë të Fjalës së Dhjetë, është një kërkesë e urtësisë që Hyjnia të shfaqet; dhe që kjo dëshirë e shfaqur Hyjnore takohet tek niveli më i lartë dhe në mënyrën më brilante nga adhurimi gjithëpërfshirës i kryer nga **Muhammedi** a.s.m. në prak-tikimin e fesë së Tij.

Gjithashtu, urtësia dhe e vërteta kërkojnë që Krijuesi i botës të shfaqë bukurinë e Tij në plotësimin e saj të jashtëm nëpërmjet asaj dëshire, dhe ai që i përshtatej asaj dëshire dhe që tregoi dhe e përshkroi bukurinë e Tij në formën më të plotë ishte, në mënyrë të vetëkuptueshme, Personaliteti i **Muhammedit** a.s.m.**.**

Muhammedi a.s.m. *gjithashtu*, domosdoshmërisht, ishte më i ploti i Cili shpalli të gjitha shkallët e Njësisë dhe që iu përgjigj Dëshirës së All-llahut të të gjitha botëve për shpalljen e Njësisë tek nivelet e shumicës.

Dhe siç tregohet nga bukuria e jashtme edhe në qëniet, dhe ashtu siç kërkohet nga e vërteta dhe urtësia, Pronari i gjithësisë dëshiron të shikojë e të shfaqë në pasqyra bukurinë e Tij esenciale të pafundme, dhe përsëri ishte e vetëkuptueshme se ***Muhammedi*** a.s.m.veproi si një pasqyrë dhe e tregoi atë bukuri në formën më rrezatuese, e deshi atë dhe i bëri edhe të tjerët ta donin.

Ai *gjithashtu*, në mënyrë të vetëkuptueshme, ishte më i madhi që bëri të njohur çfarë gjendet në thesaret e fshehura të Krijuesit në botën e padukshme, të cilat janë mbushur me mrekullitë më të çuditshme e me xhevahire shumë të vyer, dhe nëpërmjet tyre përshkruan e njofton plotësimet e Tij, përsëri ishte ***Muhammedi a.s.m.*** Ai i Cili i shfaqi, i përshkroi dhe i tregoi ato në formën më gjithëpërfshirëse.

Dhe meqenëse Krijuesi i universit e ka bërë atë në një mënyrë të tillë që Ai e stolis atë me zbukurime dhe i ka përfshirë krijesat e vetëdij-shme në të, që ata të mund të bëjnë udhëtime dhe ekskursione, që ta shqyrtojnë atë e të nxjerrin mësime, urtësia kërkon se Ai duhet të dëshirojë të bëjë të njohur kuptimet dhe vlerën e veprave të artit për ata që i vështrojnë dhe i hulumtojnë ato. Dhe ishte përsëri, në mënyrë të vetëkuptueshme, **Muhammedi a.s.m.** i Cili në përgjigje të kësaj dëshire të Krijuesit të Universit, nëpërmjet Kur'anit të gjithurtë, veproi si një udhëzues në mënyrën më gjithëpërfshirëse për xhindet dhe njerëzit, dhe në të vërtetë, edhe për qëniet shpirtërore e engjëjt.

Gjithashtu, Sundimtari i Gjithurtë i universit dëshiron,

nëpërmjet një të Dërguari t'i bëjë qëniet e përgjegjshme të zgjidhin

gjëegjëzën e errët që përmban synimin dhe qëllimin e ndryshimit dhe të transformimeve në univers dhe të shpjegojë enigmën e tre pyetjeve të ngatërruara:

- Nga erdhën qëniet?
- Ku do të shkojnë? dhe
- Çfarë janë ato?

Përsëri, në mënyrë të vetëkuptueshme, ishte **Muhammedi a.s.m.**, i Cili në përgjigjje të kësaj dëshire të Sundimtarit të Gjithurtë, përmes të vërtetave Kur'anore, sqaroi misterin dhe zgjidhi enigmën në mënyrën më të qartë e gjithëpërfshirëse.

Gjithashtu, Krijuesi i Gjithurtë i universit deshi të bëjë të njohur vetveten tek qëniet e përgjithshme nëpërmjet të gjitha artifakteve të Tij të bukura dhe për t'i bërë ata ta duan Atë përmes të gjitha mirësive të Tij të çmueshme, dhe me siguri për t'u bërë të njohur atyre, nëpërmjet një të Dërguari, dëshirat Hyjnore dhe çfarë do ta kënaqte Atë si përgjigje ndaj atyre mirësive; dhe përsëri, në mënyrë të vetëkuptueshme, ishte **Muhammedi a.s.m.** i Cili në përgjigjje të kësaj dëshire të Krijuesit të Gjithëmëshirshëm, nëpërmjet Kur'anit, i shpjegoi ato dëshira dhe ato gjëra që e kënaqin Atë me fjalë e vepra në formën më të lartë e më të përkryer.

Gjithashtu, meqenëse Krijuesi i të gjitha botëve i ka dhënë njeriut, i cili është fruti i universit, një gjendje gjithëpërfshirëse që rrethon universin dhe e ka përgatitur atë për adhurim të përgjithshëm, dhe meqenëse e sprovoi atë me gjymtyrët e tij të holla e me ndjenja që orientohen për tek shumësia dhe dynjaja, Krijuesi dëshiron me një

udhëzues ta kthejë fytyrën e njeriut nga shumësia tek Njësia dhe nga e përkohshmja tek e përhershmja. Dhe përsëri, në mënyrë të madhërishme e të vetëkuptueshme, është **Muhammedi a.s.m.** i Cili në përgjigje të kësaj dëshire, nëpërmjet Kur'anit veproi si një udhëzues në mënyrën më të plotë e gjithëpërfshirëse dhe e realizoi detyrën Profetike në mënyrën më të plotë.

Kështu, midis qënieve, më eprore janë qëniet e gjalla, dhe midis gjallesave janë më superiorë qëniet e përgjegjshme; midis qënieve të përgjegjshme janë më superiorë qëniet e vërteta humane, dhe midis qënieve të vërteta humane –Ai që zbatoi detyrat e lartëpërmendura tek niveli më gjithëpërfshirës dhe në formën më të plotë, nuk ka dy-shim se Ai do të ngjitej me Mi'raxhin e Madh– deri në Kab-e Kav-sejn *"në afërsinë e dy harqeve ose më afër".* Dhe do të trokiste derën e lumturisë së përhershme, do të hapte thesarin e Mëshirës dhe do të shikonte të vërtetat e fshehura të besimit. Përsëri Ai Profet do të ishte.

Së shtati: Siç është e qartë në shikim, qëniet janë bërë të bukura me shkallën më të lartë të stolisjes së hollë e të zbukurimit. Dhe një stolisje e një zbukurim i tillë demonstrojnë qartë se Krijuesi i tyre ka një vullnet tej mase të fuqishëm për t'i bërë të bukur dhe ka një qëllim për t'i stolisur. Vullneti për të bërë të bukur e për të stolisur demonstron se Krijuesi, medoemos, zotëron një dëshirë të fortë dhe një dashuri të shenjtë drejt artit të Tij, dhe midis qënieve, ai që shfaq plotësisht në vetveten e tij çudirat më të holla e gjithëpërfshirëse të artit, që i njohu ato, dhe i bëri ato dhe vetveten të njohura e të dashura, që vlerësoi bukuritë që gjenden tek qëniet e tjera, duke deklaruar: **Mashaall-llah!** "*Çfarë çudirash ka dashur Zoti"* dhe që ishte më i dashuri në shikimin e Krijuesit të Tij, sigurisht do të ishte Ai profet, **Muhammedi a.s.m..**

Kështu, Ai që deklaron: **Subhanall-llah** *"(E gjithë lavdia i takon All-lahut!),* **Mashaall-llah** *(Çfarë çudirash ka dashur All-llahu i Madhërishëm!),* **All-llahu Ekber** *(All-llahu është më i madhi!)"* përpara cilësive të holla e të bukura, që i shkëlqen qëniet dhe plotësimet e holla të cilat i ndriçojnë ato, që u shkakton qiejve të tingëllojnë, dhe i

cili nëpërmjet melodisë së Kur'anit e bën universin të buçasë dhe përmes miratimit dhe vlerësimit të Tij, shqyrtimit të Tij, njoftimit, përmendjes së Emrave Hyjnorë, pohimit të Njësisë Hyjnore dhe që e sjell tokën dhe detin të joshura në mallëngjim e ekstazë; Ai përsëri në mënyrë të vetëkuptueshme, është **Muhammedi Alejhis-salatu ves-selam.**

Dhe kështu një Personalitet që sipas kuptimit të :

اَلسَّبَبُ كَالْفَاعِلِ *"Shkaku është si vepruesi",* është thjesht e vërtetë e pastër dhe urtësi e plotë se Ai, në peshoret e të Cilit gjendet barasvlera e të gjitha veprave të mira të kryera nga Ummeti i Tij, që plotësimet shpirtërore të të Cilit marrin fuqi nga salevatet e të gjithë ummetit të Tij, dhe i Cili si rezultat i detyrave që Ai plotësoi në profetësinë e Tij, mori shpërblime shpirtërore dhe shkëlqime të pakufishme të Mëshirës Hyjnore dhe të dashurisë, do të avanconte nga shkalla e Mi'raxhit aq larg sa Xhenneti, tek Sidretul-Munteha, *Pema Lotë*, tek kufiri më i skajshëm, tek Froni Hyjnor, dhe tek Kabë Kavsejni "*distanca e dy harqeve ose më afër".*

اَلْبَاقِي هُوَ الْبَاقِي

Said Nursi

* * *

Teksti arabisht në revistë:

وقد اعترف حتى علماء الغرب بسمو مبادى الاسلام و صلاحها للعالم ..قال عميد كلية الحقوق بجامعة ڤيينا الاستاذ شبول فى مؤتمر الحقوقيين المنعقد فى سنة ١٩٢٧ [انالبشرية لتفتخر بانتساب رجل كمحمد (ع. ص. م) اليها اذ انه رغم اميته استطاع قبل بضعة عشر قرنا ان ياتى بتشريع سنكون نحن الاور و بائين اسعد مانكون لوو صلنا الى قيمة بعد الى عام] و قال برنارد شو [لقد كان دين محمد (ع.ص.م) موضع تقديرى السامى دائما لماينطوى عليه من حيوية مدهشة لانه على ما يلوح لى هوالدين الوحيد الذى له ملكة الهضم لااطوار الحياة المختلفة والذى يستطيع لذلك ان يجذب اليه كل جيل من الناس وارى واجبا ان يدعى محمد (ع. ص. م.) منقذ الانسانية واعتقد ان رجلاً مثله اذا تولى زعامة العالم الحديث نجح فى حل مشكلاته واحل فى العالم السلامة والسعادة (يعنى المسالمة والصلح العمومى) وما اشد حاجة العالم اليوم اليها . . .]

Një përmbledhje e përkthimit:

Madje edhe shkencëtarët dhe filozofët e perëndimit pranojnë lartësinë e parimeve të Islamit dhe vlefshmërinë e tyre për botën.

Dekani i fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Vienës, prof. Sheboli në Kongresin e juristëve që u mbajt më 1927, tha:

"Pa dyshim, njerëzimi do të krenohej duke u lidhur me një burrë si Muhammedi a.s.m., sepse Ai, pavarësisht qënies së Tij analfabet, mundi që para katërmbëdhjetë shekujsh të vendoste një legjislacion - sheriat- për të cilin ne europianët do të ishim shumë të lumtur po të arrinim tek vlera e Tij pas një mijë vitesh.

Tani shprehet Bernard Show, që është i dyzet e pesti në numër nga ata që dëshmojnë. Ai tha:

"Feja e Muhammedit a.s.m. qëndron në një pozitë të lartë vlerësimi të përhershëm. Arsyeja pse ajo qëndron kaq lartë, është se Islami të siguron një jetë të çuditshme e të shëndoshë. Mua më

shfaqet se ajo është feja e vetme që ka pushtetin tretës të periudhave të ndryshme shoqërore, dhe feja e *Muhammedit a.s.m.* është e tillë, sa që mund të tërheqë pas vetes çdo brez njerëzish. Kështu unë besoj dhe shoh të domosdoshme që njerëzia t'i thotë: "Muhammedi a.s.m., shpëtimtari i njerëzimit, dhe fama si Shpëtimtar do t'i takonte vetëm Atij".

Ai gjithashtu tha:

"Unë besoj se: Një burrë si Muhammedi, po të merrte në dorë drejtimin e botës moderne, do të kishte sukses në zgjidhjen e problemeve të saj dhe do t'i sillte botës shpëtimin e lumturinë. (d.m.th. paqen dhe pajtimin e përgjithshëm universal; sa shumë nevojë ka bota për këtë!)

* * *

SHTOJCA E KATËRT

TEKSTI VIJUES ËSHTË MARRË NGA TRAJTESA

EL-AJETUL KUBRA QË PËRMEND PROFETËSINË E MUHAMMEDIT A.S.M.

SHKALLA E GJASHTËMBËDHJETË

[Kjo shkallë erdhi këtu për shkak të përshtatshmërisë së saj me këtë stacion]

Pastaj ai udhëtar nëpër dynja iu adresua mendjes së tij duke i thënë: "Meqenëse unë po e kërkoj Pronarin dhe Krijuesin tim nëpërmjet krijesave të këtij kozmosi, do të ishte më mirë për mua që t'i shkoja për vizitë atij i cili është njeriu më i plotësuar në ekzistencë, më i madhi që të udhëheqë për tek e mira -madje edhe sipas dëshmisë së armiqve të tij- më i shquari midis tyre, më i vërteti në fjalë, më i larti në pozitë dhe më i ndrituri i tyre në mendje; ai është Muhammedi *Sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem*, paqja dhe bekimet e Zotit xh.sh. qofshin mbi të, i cili me virtytet e tij dhe me Kuranin ka ndiçuar katërmbëdhjetë shekuj... Atëherë me qëllim që të nderohem e të privilegjohem me vizitën e tij, dhe të kërkoj shpjegim prej tij lidhur me atë që kërkoj, na duhet që të shkojmë së bashku tek më i miri i shekujve... tek shekulli i lumturisë.. shekulli i profetësisë.. Së bashku me mendjen e tij ai hyri në atë shekull dhe pa se ai ishte bërë në sajë të Tij a.s.m. shekulli i lumturisë së vërtetë për njerëzimin. Sepse nëpërmjet dritës që ai kishte sjellë, i kishte transformuar më primitivët dhe më analfabetët e njerëzve në profesorë dhe mësues të botës.

Dhe kështu, ai iu adresua mendjes së tij duke i thënë: "Para së gjithash ne duhet të njohim diçka rreth madhështisë dhe vlerës së këtij personaliteti të mrekullueshëm, dhe këtë duhet ta arrijmë

nëpërmjet saktësisë së hadithe, thënieve të tij dhe vërtetësisë së njoftimeve të tij, dhe pastaj ta pyesim atë rreth Krijuesit tonë xh.sh...”

Kështu ai nisi të shqyrtojë e hulumtojë, dhe gjeti për vërtetësinë e profetësisë së tij prova vendimtare të panumërta, por ai këtu tregoi vetëm nëntë prej provave më të përgjithshme.

E Para: Përshkrimi i tij me të gjitha virtytet e shquara, me cilësitë dhe veçoritë e lavdërueshme, saqë për to dëshmuan edhe armiqtë e tij... shfaqja e qindra mrekullive prej tij, si: çarja më dysh e hënës me një shenjë të vetme të bërë nga gishti i tij, ashtu siç e shpreh Kurani,

“ Dhe hëna u ça më dysh”.[236]

Shpartallimi i ushtrisë së armiqve për shkak se hyri në sytë e atyre të gjithëve pluhuri i pakët në grushtin e tij që ua hodhi atyre, ashtu siç e tregon vërseti Kuranor,

“Dhe nuk e hodhe ti (pluhurin në sytë e armikut, o Muhammed a.s.m.) kur e lëshove nga grushtet e tua, por e hodhi Allahu”[237].

Dhënia për të pirë ujë ushtrisë së tij të etur nga uji që buroi si burimi i *Keutherit* prej pesë gishtave të tij të bekuar.. si dhe qindra mrekulli të tjera që u shfaqën në duart e tij të cilat na janë transmetuar neve në mënyrë të saktë e të sigurtë, sipas vërseteve të qarta kur’anore ose sipas hadithe që gëzojnë statusin e “*Tavattur*”.

Meqenëse disa prej atyre mrekullive, që janë më shumë se treqind, janë shtjelluar me prova vendimtare në veprën e shquar e të mrekullueshme që titullohet *“Mrekullitë e profetit Muhammed a.s.m.”* -Letra e Nëntëmbëdhjetë-, ne ia lëmë asaj vepre diskutimin e mrekullive, dhe le ta lëmë udhëtarin të vazhdojë së foluri.

Pastaj ai i foli vetes së tij duke i thënë: “Një qënie që përveç të gjitha këtyre veçorive fisnike dhe virtyteve të larta ka të gjitha këto

[236] Kuran 54: 1

[237] Kuran 8:17

mrekulli të ndritshme për t'i demonstruar, sigurisht ai duhet të jetë më i vërteti në fjalë prej të gjithë njerëzve...

Do të ishte krejtësisht e pamundur dhe e pazakonshme që ai të zbriste në dredhi, në gënjeshtër e në iluzion, të cilat janë veprat e njerëzve të ligj.

E Dyta: Qënia e Kuranit i cili është në dorën e tij, duke qënë mrekulli në shtatë mënyra të ndryshme, atë dekret që u lëshua prej Pronarit të Universit, e pranojnë dhe e vërtetojnë më shumë se treqind milion njerëz në çdo shekull. Meqenëse Fjala e Njëzet e Pestë, domethënë trajtesa e "*Mrekullive të Kuranit*" e cila është dielli i Risale-i Nurit, ka provuar me argumente të fuqishëm se ky Kur'an Kerim është mrekulli prej dyzet aspektesh të ndryshëm, dhe se ai është Fjala e Zotit të të gjithë botëve, udhëtari ia referoi asaj trajtese të shquar shpjegimin e hollësishëm të mrekullisë së tij. Pastaj tha:

Besniku i Fjalës së Allahut, interpretuesi i vërtetë i tij, përçuesi i këtij lajmi të madh tek të gjithë njerëzit, dhe i cili është pikërisht e vërteta dhe vetë realiteti, prej tij nuk mund të burojë kurrë ndonjë gënjeshtër, dhe ai nuk do të jetë kurrë objekt dyshimi; sepse kjo do të ishte një shkelje ndaj atij dekreti dhe tradhti ndaj Atij i Cili e lëshoi atë.

E Treta: Ai a.s.m. u dërgua me një sheriat -ligj- të pastër, me një fe të natyrshme, me një adhurim të sinqertë, me një dua të përgjëruar, me një thirrje të gjithanshme dhe me një besim -iman- të ngulitur; as nuk ka pasë si shembulli i asaj për të cilën ai u dërgua dhe as nuk do të ketë; as nuk ka ekzistuar një formë më e plotë se ajo për të cilën ai u dërgua dhe as nuk do të ekzistojë. Sepse 'Sheriati' i cili u shfaq prej një analfabeti a.s.m. dhe -ai sheriat- administroi një të pestën e njerëzimit për katërmbëdhjetë shekuj në një mënyrë të drejtë e të saktë nëpërmjet ligjeve të tij të holla e të shumta, nuk pranon kurrë ndonjë rival.

Po kështu 'islami', i cili u shfaq prej veprave, thënieve dhe prej gjendjeve të brendshme të atij që ishte analfabet a.s.m., nuk ka rival, as nuk ka ardhur dhe as nuk do të vijë si shembulli i tij; sepse në çdo shekull ai- islami- ka qenë për treqind milion njerëz një udhëzues dhe

strehë, mësuesi dhe edukatori i mendjeve të tyre, ndriçuesi dhe pastruesi i zemrave të tyre, shkaku për pastrimin dhe zhvillimin e personave të tyre dhe burimi i progresit dhe i përparimit të shpirtërave të tyre..

Profeti a.s.m. gjithashtu është i pakrahasueshëm në të gjitha llojet e ibadeteve të cilat i përmban feja e tij; devocioni i tij i madh dhe frika e tij e madhe prej Allahut, përpjekja dhe aktiviteti i tij i vazhdueshëm dhe kryerja e detyrave të tij të adhurimit në mënyrë të plotë dhe me vëmendjen më të madhe për dimensionet e tyre më të thella, për misteret më të holla të adhurimit brenda gjendjeve dhe rrethanave më të vështira, dhe përmbushja e atij adhurimi të sinqertë nga ana e profetit Muhammed a.s.m. duke mos imituar askënd, duke kombinuar në mënyrën më të plotë dhe me të gjitha kuptimet e tij fillimin dhe fundin e adhurimit. Nuk ka dyshim se as nuk është parë dhe as nuk do të shihet si shembulli i tij lidhur me kryerjen e ibadeteve.

Gjithashtu ai a.s.m. e përshkruan Krijuesin e tij nëpërmjet ***Xheushan El-Kebir*** -që është njëra prej mijëra duave e lutjeve të tij- e përshkruan Zotin xh.sh. me një shkallë të tillë të lartë njohjeje saqë atë shkallë njohjeje nuk e arritën të gjithë *A'rifinët* -njohësit- dhe *Evliatë* -shenjtorët-dhe ata të gjithë nuk kanë qenë në gjendje as ta arrijnë atë shkallë përshkrimi qysh prej lashtësisë.. Kjo tregon se ai është i pakrahasueshëm në 'dua'. Cilido që do ta shikonte pjesën në fillimin e trajtesës së "*El-Munaxhat*" rreth lutjeve, e cila shtjellon një paragraf të vetëm prej nëntëdhjetë e nëntë paragrafëve të ***Xhaushan e El-Kebir,*** sigurisht do të thonte se kjo dua e shkëlqyeshme -***Xhaushani***- e cila përfaqëson kulmin e njohjes Hyjnore, është e pakrahasueshme -e pashoqe.

Gjithashtu në përcjelljen e mesazhit të tij dhe në thirrjen që u bëri njerëzve për tek e vërteta, ai a.s.m. shfaqi një qëndrueshmëri të tillë, një vendosmëri dhe një guxim të tillë saqë megjithëse shtete dhe fe të mëdhaja, dhe madje edhe vetë populli i tij, fisi dhe xhaxhai i tij e kundërshtuan atë në mënyrën më armiqësore, përsëri ai nuk shfaqi as edhe shenjën më të vogël të ngurimit, të ankthit apo të frikës. Fakti se ai sfidoi me sukses të gjithë botën dhe e bëri islamin profesorin e

botës, gjithashtu provon se nuk ka dhe nuk mund të jetë askush si ai a.s.m. lidhur me komunikimin e mesazhit dhe me thirrjen për tek e vërteta.

Në besimin e tij, ai kishte një fuqi aq të jashtëzakonshme, një siguri aq të mrekullueshme, një gjallëri aq të mahnitshme dhe një bindje aq të lartë duke mbushur me dritë të gjithë botën, saqë nuk mundën të ndikonin tek ai të gjitha idetë, besimet, filozofitë e të urtëve dhe mësimet e udhëheqësve fetarë që dominonin në atë shekull, të gjitha këto nuk qenë në gjendje të ndikonin në besimin e tij as me ndonjë dyshim, ngurrim, dobësim apo me ndonjë iluzion. Po, ato nuk mundën të ndikonin në sigurinë e tij, as në besimin e tij, as në mbështetjen e tij tek Allahu dhe as në qetësinë e tij tek Ai, pavarësisht armiqësisë dhe mohimit të skajshëm të tyre ndaj tij. Për më tepër, frymëzimi, inspirimi i të gjithë atyre që u ngjitën në nivelet shpirtërore dhe në shkallët e besimit prej njerëzve të shenjtërisë dhe të drejtësisë, me në krye Sahabët e nderuar, dhe përfitimi i tyre vazhdimisht duke marrë shkëlqim prej shkallës së besimit të tij dhe që të gjithë ata e shikuan se ai është në më të lartin e niveleve dhe të shkallëve. E gjitha kjo shfaq në mënyrë të vetëkuptueshme se besimi i tij a.s.m. është gjithashtu i pakrahasueshëm dhe i pashoq.

Ndërkaq, udhëtari ynë kuptoi dhe vërtetoi me mendjen e tij se gënjeshtra e dyshimi nuk kanë asnjë vend tek ai i cili solli një sheriat të tillë të shenjtë të pashoq, një islam të tillë të pakrahasueshëm, një adhurim të pastër të parival, një dua të tillë të shkëlqyer të jashtëzakonshme, një thirrje të tillë universale e të gjithanshme dhe një besim të tillë të mrekullueshëm.

Prova e Katërt: Unanimiteti i të gjithë profetëve paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ta, dhe konsensusi i tyre lidhur me pikërisht të vërtetat e besimit është një provë e fuqishme për ekzistencën dhe për Unitetin e Allahut xh.sh.; dhe gjithashtu është një dëshmi e fortë për vërtetësinë dhe profetësinë e këtij profeti a.s.m.. Sepse të gjitha cilësitë e shenjta, mrekullitë dhe funksionet që tregojnë vërtetësinë dhe profetësinë e atyre pejgamberëve a.s. gjendeshin si ato dhe më të plota se ato në atë personalitet a.s.m.,

ashtu siç dëshmohet e konfirmohet nga historia. Të gjithë ata profetë a.s. njoftuan gojarisht, me gjuhën e fjalës -domethënë me Teurat, Inxhil, Zebur dhe me fletët që ndodheshin në duart e tyre- për ardhjen e këtij personaliteti të bekuar dhe sihariquan njerëzit për ardhjen e tij a.s.m. (saqë më shumë se njëzet prej shembujve më vendimtarë të këtyre sihariqeve -lajmeve të gëzueshme- të nxjerra prej shkrimeve të shenjta, prej atyre librave qiellorë, janë shtjelluar dhe provuar në Letrën e Nëntëmbëdhjetë e cila titullohet "*Trajtesa e mrekullive të profetit Muhammed a.s.m.*"). Ashtu siç sihariquan ata për ardhjen e tij a.s.m. po ashtu ata e vërtetojnë atë a.s.m. nëpërmjet gjuhës së gjendjes së tyre -domethënë, nëpërmjet profetësisë dhe mrekullive të tyre- dhe përfundojnë me konfirmimin e tyre për vërtetësinë e thirrjes së tij a.s.m.. Sepse ai është paraprijësi më i plotë, i pari dhe më i plotësuari në misionin e profetësisë dhe në thirrrjen për tek Allahu xh.sh..

Udhëtari kuptoi se ashtu siç tregojnë ata -domethënë ata profetë- nëpërmjet gjuhës së fjalës dhe me konsensus për Unitetin Hyjnor, po ashtu ata dëshmojnë nëpërmjet gjuhës së gjendjes dhe me unanimitet për vërtetësinë e këtij profeti fisnik a.s.m..

Prova e Pestë: Gjithashtu me mijëra Evlija të cilët arritën tek e vërteta, realiteti, plotësimi, kerameti, zbulesat dhe shikimet e dëshmimet nëpërmjet instruktimit dhe udhëzimit të këtij profeti fisnik a.s.m. dhe duke e ndjekur atë, -e gjitha kjo- jep një dëshmi me unanimitet jo vetëm për Unitetin Hyjnor por gjithashtu edhe për vërtetësinë dhe profetësinë e këtij profeti fisnik -për profesorin dhe imamin e tyre.

Përsëri, fakti se ata shikojnë, nëpërmjet dritës së shenjtërisë, disa prej të vërtetave që ai i njoftoi lidhur me botën e padukshme, dhe se ata i besojnë dhe i vërtetojnë të gjitha ato të vërteta nëpërmjet dritës së besimit -ose me njohjen e sigurisë, ose me shikimin e sigurisë, ose me sigurinë absolute- kjo demonstron qartë si dielli shkallën e vërtetësisë së udhëzuesit të tyre më të madh dhe drejtësinë e mësuesit të tyre më të shquar a.s.m.. Kjo gjithashtu u kuptua nga udhëtari ynë.

Prova e Gjashtë: Me miliona dijetarë e shkollarë të pastër, të sinqertë e të saktë dhe gjeni të urtë prej besimtarëve kanë arritur stacionin më të lartë të dijes në sajë të asaj që mësuan prej të vërtetave të shenjta që i solli ky profet fisnik a.s.m. -pavarësisht se ai ishte analfabet- dhe në sajë të asaj që mësuan nga shkencat e larta që buruan prej atyre të vërtetave të shenjta dhe prej Njohjes Hyjnore që ai zbuloi.. Të gjithë këta, ashtu siç provojnë dhe mbështesin me unanimitet dhe me argumentet më të fuqishëm, Unitetin Hyjnor, i cili është themeli i misionit dhe i thirrjes së tij, po ashtu ata dëshmojnë me unanimitet për vërtetësinë e këtij mësuesi më të madh dhe për drejtësinë e këtij profesori më të shquar dhe për saktësinë e fjalës së tij a.s.m.. Atëherë, kjo dëshmia e tyre është një provë e qartë si dita për vërtetësinë e tij dhe për drejtësinë e mesazhit të tij. Risale-i Nuri gjithashtu me pjesët e tij që kalojnë mbi njëqind është veçse një provë e vetme e vërtetësisë dhe e drejtësisë së këtij profeti të dashur a.s.m..

Prova e Shtatë: Grupimi i madh që quhet "***El-A'l Vel As'hab***" "*Familja dhe Sahabët e profetit a.s.m*.", të cilët me intuitën e tyre, me njohurinë dhe me arritjet e tyre shpirtërore janë më të shquarit, më të respektuarit, më të lavdëruarit, më të devotshmit në fe, më symprehtët dhe më të lartësuarit e njerëzve pas profetëve, i hetuan, i studiuan dhe i shqyrtuan me vëmendjen më të madhe, me seriozitet dhe me saktësi, të gjitha gjendjet, mendimet dhe rrethanat e këtij profeti fisnik a.s.m., qofshin ato të fshehura apo të hapura. Pastaj ata erdhën në një konkluzion unanim se ai a.s.m. në dynja ishte, më i vërteti në fjalë, më i larti i tyre në pozitë dhe më i devotshmi e më i kapuri fort pas të vërtetës dhe realitetit. Udhëtari kuptoi se ky vërtetimi i tyre i patundur dhe besimi i tyre i thellë është një provë e ndritshme ashtu siç tregon dita për dritën e diellit.

Prova e Tetë: Ashtu siç tregon ky kozmos autorin e tij, shkruesin dhe formëdhënësin e tij i Cili e krijoi, e administron dhe e rregullon, si dhe nëpërmjet paracaktimit të masës së tij, formimit dhe rregullimit ka autoritet e kontroll mbi të sikur ai të ishte një pallat luksoz ose si një libër i madh, ose si një ekspozitë e mahnitshme ose si një shfaqje madhështore, po ashtu ai padyshim thëret dhe kërkon medoemos ekzistencën e dikujt i cili të shprehë kuptimet që përmban ky libër i

madh, të dijë dhe të bëjë të ditur qëllimet Hyjnore prapa krijimit të universit, të japë mësim urtësitë Hyjnore në ndryshimet dhe në transformimet e tij, të japë instruksion për rezultatet e lëvizjeve të tij funksionale, të shpallë vlerën e tij esenciale dhe plotësimet e qënieve brenda tij. Domethënë, kërkon medoemos një lajmëtar të lartë, një thirrës të vërtetë, një profesor të ditur dhe një njoftues ekspert. Ndërkohë udhëtari kuptoi se kozmosi -me këtë kërkesë- tregon dhe dëshmon për vërtetësinë e këtij profeti fisnik a.s.m. dhe për drejtësinë e tij i cili i përmbushi këto funksione e detyra më mirë se çdokush tjetër, dhe për qënien e tij më i lartësuari dhe i dërguari më besnik i Zotit të të gjitha botëve.

Prova e Nëntë: Ndodhet pas perdes Një i vetëm i Cili dëshiron të demonstrojë me këto artifakte gjeniale e të urta plotësimin e talentit dhe të artit të Tij; dëshiron ta bëjë Vetveten të njohur e të dashur nëpërmjet këtyre krijimeve të panumërta të stolisura e të dekoruara; dëshiron të bëjë të detyrueshme dhënien e falënderimeve dhe të lavdërimeve ndaj Tij nëpërmjet mirësive të panumërta të çmueshme e të kënaqshme të cilat Ai i ka dhuruar.. t'i nxisë njerëzit për tek adhurimi ndaj Hyjnisë së Tij me një adhurim që karakterizohet me dashuri, me mirënjohje dhe me falënderime ndaj këtij furnizimi të përgjithshëm me ushqime jetike dhe përballë këtij zhvillimi e rritjeje, me dhembshuri dhe mbrojtje (saqë Ai përgatit ushqime dhe gosti Hyjnore në një mënyrë të tillë saqë kënaq e ngop edhe më të hollat e shijeve të gjuhëve dhe të gjitha llojet e orekseve)... dhe dëshiron t'i bëjë njerëzit që të besojnë në Hyjninë e Tij, me nënshtrim, përulësi e bindje ndaj Hyjnisë së Tij të Cilën e shfaq me ndryshimin e stinëve, me ndryshimin e natës dhe të ditës dhe nëpërmjet ndryshimeve të të gjitha gjërave të ngjashme me këto, të veprave të Tij madhështore, zhvillimeve të mëdha, aktivitetit të mahnitshëm dhe krijueshmërisë plot urtësi.. Dhe dëshiron të demonstrojë drejtësinë dhe vërtetësinë e Tij në të gjitha kohët duke mbrojtur virtytin dhe të virtytshmit dhe duke shkatërruar të keqen dhe të këqinjtë, duke i asgjësuar me goditje qiellore shtypësit dhe gënjeshtarët.. Nuk ka dyshim se krijesa më e dashur tek Ai i Cili është i mbuluar me të padukshmen, dhe robi e shërbëtori më i vërtetë për Të është ai që ka punuar dhe që u ka shërbyer me sinqeritet qëllimeve të Tij të cilat u përmendën lart; ai që

ka zgjidhur e ka sqaruar misterin më të madh në krijimin e kozmosit dhe që ka zbuluar e shpjeguar enigmën e tij, dhe ai i cili përpiqet e vepron gjithmonë në emrin e Krijuesit të tij, i cili kërkon ndihmë, forcë e sukses vetëm prej Tij në çdo gjë dhe që i merr ato vetëm prej Tij xh.sh.. Atëherë kush do të mund të ishte tjetër kush përveç Muhammed Kurejshiut a.s.m.!

Pastaj udhëtari iu adresua mendjes së tij duke i thënë: "Meqenëse këto nëntë të vërteta dëshmojnë e provojnë vërtetësinë e këtij profeti fisnik a.s.m., atëherë nuk ka dyshim se ai është boshti i krenarisë së botës dhe burimi i nderit të njerëzimit, dhe ai është i denjë dhe i merituesshëm të quhet krenaria e botëve dhe lavdia e bijve të Ademit. Fakti që sovraniteti madhështor i atij dekreti të të Gjithëmëshirshmit i cili është Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm, të cilin ai e mban në dorë, ka pushtuar gjysmën e botës, së bashku me plotësimet e tij individuale dhe me virtytet e larta, tregon se ai është njeriu më i madh në ekzistencë, ai është ky profet madhështor. Dhe fjala më e rëndësishme lidhur me Krijuesin tonë është fjala e tij a.s.m..

Eja o mendja ime, dhe shiko! Themeli i të gjitha thirrjeve të këtij profeti fisnik a.s.m. dhe qëllimi i të gjithë jetës së tij është dëshmia për ekzistencën e Ekzistuesit të domosdoshëm, për të provuar Unitetin e Tij, për të shpjeguar Atributet e Tij Madhështore dhe për të shfaqur Emrat e Tij të bukur; dhe vërtetimi i të gjithë kësaj, shpallja dhe njoftimi mbështeten tek fuqia e dhënë prej qindra mrekullive të tij vendimtare, të ndritshme e të qarta të cilat i shfaqi Allahu nëpërmjet tij dhe prej mijëra të vërtetave themelore të ngulitura të përfshira në fenë e tij.

Domethënë, dielli shpirtëror i cili e ndriçon këtë kozmos dhe argumenti i ndritshëm për ekzistencën e Krijuesit tonë xh.sh. dhe për Unitetin e Tij është ky profet fisnik të cilin e thërrasim ***Habibull-llah,*** *i Dashuri i Zotit*. Ndodhen tre lloje të mëdhaja konsensusi të pagabueshëm që secili prej tyre pohon, konfirmon e mbështet dëshminë e tij a.s.m..

Konsensusi i Parë**:* Konsensusi me unanimitet i bërë prej asaj asambleje të ndritshme, të shquar e të njohur gjithandej botës si: ***"A'L Muhammed", *Familja e profetit Muhammed a.s.m. Ehli Bejti".*


Ajo asamble e ndritshme të cilën e paraprin imam Aliu, Zoti qoftë i kënaqur me të, dhe i cili tha: "Edhe në qoftë se do të ngrihej -hiqej- perdja, siguria ime nuk do të shtohej"; dhe pas tij janë me mijëra Evlija të mëdhenj që kanë intuita të mprehta dhe shikime që depërtojnë tek e padukshmja si shembulli i Shejh Gejlanit -iu shenjtëroftë sekreti i tij- i cili pa Fronin më të lartë dhe formën madhështore të Israfilit ndërsa vetë ishte akoma në tokë.

Konsensusi i Dytë: Konsensusi me unanimitet i bërë prej xhematit të njohur si ***Sahabët*** e nderuar, Zoti qoftë i kënaqur prej tyre, të cilët janë të shquar në të gjithë botën; dhe vërtetimi i tyre me unanimitet dhe me një besim të ngulitur e të fuqishëm për këtë profet fisnik a.s.m. saqë ai i shtyu ata që t'i sakrifikonin edhe shpirtërat e tyre, pasurinë e tyre, baballarët e tyre dhe fiset e tyre; janë ata të cilët e gjetën vetveten midis një populli primitiv dhe në një mjedis analfabet, i zbrazur e i zhveshur nga dukuritë e jetës sociale dhe nga mendimet politike, që nuk kishin udhëzim dhe as ndonjë libër ndriçues; të cilët ishin të zhytur e të humbur në errësirën e periudhës midis profetëve; dhe të cilët në një kohë shumë të shkurtër u bënë profesorët, udhëzuesit, politikanët dhe sundimtarët e drejtë të popujve dhe të shteteve më të civilizuara dhe të përparuara nga ana shkencore, politike dhe shoqërore, dhe e sunduan botën nga lindja në perëndim dhe flamurët e drejtësisë së tyre u valëvitën nga toka dhe deti.

Konsensusi i Tretë: Është vërtetimi dhe konfirmimi i grupit madhështor të dijetarëve të përpiktë të cilët depërtuan thellë në shkencat e tyre dhe që me mijëra dalin e lulëzojnë në ummetin e tij dhe ndjekin metoda e medhhebe të ndryshme; dhe të cilët përparojnë në mënyrë të çuditshme në çdo shkencë dhe punojnë në fusha të ndryshme. Atëherë, vërtetimi i të gjithë këtyre për të me unanimitet dhe me shkallën e njohjes së sigurisë, sa konsensus i madh është!

Udhëtari gjykoi se dëshmia e këtij profeti analfabet a.s.m. për Unitetin Hyjnor nuk është një dëshmi personale dhe e pjesshme, por e përgjithshme, universale e ngulitur dhe e patundur. Edhe sikur të bashkoheshin të gjithë shejtanët që ekzistojnë, ata nuk do të mund ta sfidonin atë. I tillë ishte përfundimi i arritur nga udhëtari.

Në lidhje me mësimin e mësuar në shkollën e dritës nga ai udhëtar nëpër botë, ai udhëtar në jetë, kur ai shëtiti me mendjen e tij në shekullin e lumturisë, ne folëm në fundin e Shkallës së Gjashtëmbëdhjetë të Stacionit të Parë:


لَآ اِلٰهَ اِلَّا اللّٰهُ اَلْوَاجِبُ الْوُجُوْدِ اَلْوَاحِدُ الْاَحَدُ الَّذِيْ دَلَّ عَلٰى وُجُوْبِ وُجُوْدِهٖ
فِيْ وَحْدَتِهٖ فَخْرُ الْعَالَمِ وَشَرَفُ نَوْعِ بَنِيْ اٰدَمَ بِعَظَمَةِ سَلْطَنَةِ قُرْاٰنِهٖ وَحَشْمَةِ وُسْعَةِ
دِيْنِهٖ وَكَثْرَةِ كَمَالَاتِهٖ وَعُلْوِيَّةِ اَخْلَاقِهٖ حَتّٰى بِتَصْدِيْقِ اَعْدَائِهٖ
وَكَذَا شَهِدَ وَبَرْهَنَ بِقُوَّةِ مِائَةِ مُعْجِزَاتِهِ الظَّاهِرَةِ الْبَاهِرَةِ الْمُصَدِّقَةِ الْمُصَدَّقَةِ
وَبِقُوَّةِ اٰلَافِ حَقَائِقِ دِيْنِهِ السَّاطِعَةِ الْقَاطِعَةِ بِاِجْمَاعِ اٰلِهٖ ذَوِي الْاَنْوَارِ
وَبِاتِّفَاقِ اَصْحَابِهٖ ذَوِي الْاَبْصَارِ وَبِتَوَافُقِ مُحَقِّقِيْ اُمَّتِهٖ ذَوِي الْبَرَاهِيْنِ
وَالْبَصَائِرِ النَّوَّارَةِ ۞
اَلْبَاقِيْ هُوَ الْبَاقِيْ

I Qëndrueshmi i Vetëm, Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm!

Said Nursi

* * *

FJALA E DHJETË

Ringjallja dhe Bota Tjetër

Kujtesë

[Arsyeja për shkruajtjen e këtyre trajtesave të mia në formën e metaforave, krahasimeve dhe tregimeve, është për të lehtësuar kuptimin dhe për të treguar se sa të arsyeshme, të përshtatshme , të bazuara e koherente janë të vërtetat e Islamit. Kuptimi i tregimeve përfshihet në të vërtetat tek të cilat ato përfundojnë; çdo tregim është si një aluzion që tregon të vërtetën e tij përfundimtare. Domethënë, ato nuk janë thjesht tregime të sajuara, por të vërteta të sigurta.]

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

فَانظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا إِنَّ ذَٰلِكَ لَمُحْيِي الْمَوْتَىٰ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

"Shihni pra shenjat e Mëshirës së All-llahut, se si Ai e ngjall tokën pas vdekjes së saj. Sigurisht që (All-llahu xh.sh.) do të ngrejë me siguri të vdekurit (Ditën e Ringjalljes) dhe Ai është i Plotëfuqishëm për të bërë çdo gjë."[238]

[238] Kur'an, 30: 50

Vëlla, nëse ti dëshiron një diskutim për Ringjalljen e për Botën tjetër me një gjuhë të thjeshtë e të zakonshme, me një stil të qartë që t'i përshtatet kuptimit të njerëzve të zakonshëm, atëherë shikoje dhe dëgjoje së bashku me nefsin tim krahasimin që vijon.

Njëherë dy njerëz po udhëtonin në një mbretëri aq të bukur si Xhenneti (me atë mbretëri, aludohet për dynjanë). Duke soditur rreth e qark saj, ata panë se njerëzit e saj i kishin lënë të hapura dyert e shtëpive të tyre, të dyqaneve, dhe të vendbanimeve dhe nuk i jepnin rëndësi ruaj-tjes së tyre. Paratë dhe pasuritë mund të kapeshin lehtë me dorë, pa pasur askënd që t'i pretendojë ato.

Njëri prej dy udhëtarëve duke ndjekur nefsin e tij e duke u joshur, lëshoi dorën e tij në çdo gjë që donte, ose duke e vjedhur atë, ose e rrëmbente me forcë. Ai kryente të gjitha llojet e padrejtësive e të marrë-zisë. Asnjë nga njerëzit e asaj mbretërie nuk lëvizi për ta ndaluar atë. Por shoku i tha:

"Çfarë je duke bërë? Ti do të ndëshkohesh dhe do të më flakësh edhe mua në fatkeqësi e mundime. E gjithë kjo pasuri i përket shtetit. Njerëzit e kësaj toke, duke përfshirë edhe fëmijët, janë të gjithë ushtarë ose shërbëtorë të shtetit. Në këto punë ata janë vënë në shërbim si civilë, prandaj ata nuk merren me ty dhe nuk të prekin. Por ligjet këtu janë të rrepta. Mbreti ka vendosur kudo telefonat, dhe agjentët e Tij janë gjith-andej. Prandaj shko shpejt për të kërkuar falje dhe përpiqu që ta zgjidhësh çështjen."

Por, njeriu kokëbosh tha me kryeneçësinë e tij: "Jo, këto nuk janë pronë e shtetit, këto janë pronë vakëfi, dhe nuk kanë ndonjë pronar të qartë ose të dukshëm. Gjithkush mund t'i përdorë si ta shohë të përshtat-shme. Unë nuk shikoj ndonjë arsye që ta ndaloj veten time nga përdorimi i këtyre gjërave të bukura. Unë nuk do të besoj se ato i përkasin ndokujt derisa ta shikoj me sytë e mi. Pra, besoj vetëm atë që më sheh syri." Ai vazhdoi të flasë në këtë mënyrë me shumë sofizma filozofike, dhe këtu një diskutim serioz filloi midis të dyve.

Së pari njeriu kokëbosh tha: “Kush është mbreti këtu? Unë nuk e njoh atë..”

Ndërkaq shoku iu përgjigj: **“Çdo fshat duhet të ketë kryeplakun e vet; çdo gjilpërë duhet të ketë pronarin dhe shpikësin e saj. Dhe siç e di ti, çdo shkronjë duhet të jetë e shkruar nga dikush. Si, atëherë mund të jetë që një mbretëri kaq e madh**e **dhe e mirorganizuar të mos ketë Sundimtar?** Dhe si mundet që kaq shumë pasuri të mos kenë pronar, kur në çdo orë arrin një tren[239] i mbushur me dhurata të çmueshme e me gjëra shumë të vyera, sikur të vinte nga Bota e padukshme dhe i zbraz ato këtu, dhe ikën? Dhe të gjitha shpalljet e komunikatat që duken në çdo vend, të gjitha vulat e stampat që gjenden në të gjithë ato mallra; të gjitha damkat e flamurët duke u valëvitur në çdo anë të mbretërisë, a mund të jenë ato pa pronar? Duket se ti ke mësuar pak nga gjuhët e huaja, por ti nuk mundesh t’i lexosh këto shkrime Islame, dhe ti nuk pranon që të pyesësh as ata që janë të aftë t’i lexojnë e t’i kuptojnë. Atëherë, eja tani që të të lexoj urdhërat dhe komunikatat më të rëndësishme të mbretit.

Ndërkohë njeriu kokëbosh i ktheu përgjigje të prerë: “Mirë, le të supozojmë se ka një mbret; mirëpo çfarë do të mund t’i dëmtonte atij e t’i pakësonte nga magazinat e tij ky përfitimi im i pakët? Prandaj, unë nuk mund të shikoj asgjë këtu që t’i ngjasojë dënimit me burg apo diçkaje tjetër!”

Shoku i tij iu përgjigj: “Kjo mbretëri që shohim, nuk është tjetër, veçse një fushë provimi e testimi dhe një shesh stërvitjesh e manovrash. Përveç kësaj, ajo është një ekspozitë për artet e mrekullueshme të mbretit. Gjithashtu ajo mund të vlerësohet si një bujtinë shumë e përkohshme, një bujtinë pa themele. A nuk sheh se çdo ditë një karvan mbërrin ndërsa një tjetër largohet e zhduket? Ajo është duke u boshatisur e duke u mbushur vazhdimisht. Mbas një kohe e gjithë mbretëria do të ndryshohet; banorët e saj do të largohen për tek një mbretëri tjetër e cila do të qëndrojë përjetë-

[239] Shënim: Kjo aludon për vitin. Pranvera i ngjason një vagoni të mbushur me ushqime që vijnë nga e Padukshmja.

sisht. Atje gjithësecili ose do të shpërblehet ose do të dënohet në përputhje me shërbimet e punët e tij."

Përsëri njeriu tradhtar e kokëbosh ia ktheu me ton të zemëruar: "Unë nuk e besoj atë; a është e mundur që e gjithë kjo mbretëri të zhduket, dhe krijesat e saj të kalojnë në një mbretëri tjetër?"

Atëherë shoku i tij besnik iu përgjigj: "Meqenëse ti je kaq kokëfortë e i pabindur, eja të të parashtroj tregues e argumenta të dobishëm e të panumërt që përmblidhen në ***"Dymbëdhjetë aspekte"***, të cilat do të të vërtetojnë se ka një Gjykatë të Lartë, një botë shpërblimi e mirëbërësie dhe një botë dënimi e burgosjeje, dhe se ashtu siç zbrazet kjo botë pjesërisht në çdo ditë, po ashtu do të vijë dita kur ajo do të boshatiset tërësisht e do të shkatërrohet."

ASPEKTI I PARË:

A është e mundur që në ndonjë mbretëri, dhe veçanërisht në një mbretëri kaq madhështore si kjo, që të mos ketë shpërblim për ata të cilët shërbejnë me bindje dhe të mos ketë dënim për ata që kundërshtojnë? Shpërblimi e dënimi këtu janë pothuajse mosekzistues.

Domethënë, ekziston një Gjykatë e lartë në një vend tjetër.

ASPEKTI I DYTË:

Sodit tek organizimi dhe administrimi i kësaj mbretërie! Shiko se si çdo qënie, duke përfshirë më të varfërin e më të dobëtin, furnizohet me rizk e ushqim të plotë e me bollëk; se si përkujdesja më e mirë u jepet vazhdimisht të sëmurëve dhe atyre që s'kanë përkrahës. Ushqime të shijshme dhe enë, zbukurime të veshura me xhevahire, rroba të qëndisura e tryeza të mëdha të përhapura gjithandej, të gjitha gjenden këtu. Shiko se si gjithësecili u kushton vëmendjen e duhur detyrave të tij, me përjashtim të njerëzve kokëbosh si ti. Asnjë nuk i kalon caqet e tij as edhe një fije. Më i madhi i të gjithë njerëzve po kryen shërbimin e tij me shumë bindje e modesti me një qëndrim nderimi e frike.

Atëherë sundimtari i kësaj mbretërie duhet të ketë një bujari të madhe dhe një mëshirë gjithëpërfshirëse dhe gjithashtu një dinjitet të madh dhe madhështi e nder të lartë. ***Tani dihet se bujaria bën të domosdoshëm bamirësinë; mëshira nuk mund të ndodhë e të jepet pa mirëbërësi;ndërsa dinjiteti i lartë dhe nderi bëjnë të domosdoshëm që të pasjellshmit dhe të panjerëzishmit të ndëshkohen e disiplinohen.***

Por madje as një e mijëta pjesë nga ajo që i përshtatet asaj Mëshire dhe atij dinjiteti të lartë, nuk realizohen në këtë mbretëri. Shtypësi mban fuqinë e tij dhe i shtypuri mban nënshtrimin e tij; ndërkohë të dy largohen e shtegtojnë nga kjo botë.

Domethënë, çështjet e tyre janë shtyrë për tek një Gjykatë e Lartë.

ASPEKTI I TRETË:

Shiko se me çfarë urtësie të lartë e me çfarë organizimi të mahnit-shëm kryhen punët, dhe me çfarë drejtësie të vërtetë e ekuilibri realizohen veprimet! Tani një sistem i lartë e i urtë qeverisjeje bën të domosdoshëm që ata të cilët kërkojnë strehim nën krahun mbrojtës të shtetit duhet të favorizohen, dhe drejtësia kërkon që të mbrohen të drejtat e subjekteve, me qëllim që të ruhet dinjiteti i qeverisë dhe madhështia e pushtetit.

Por, këtu në këtë vend nuk përmbushet as një e një mijëta pjesë e një urtësie dhe e një drejtësie të tillë; për shembull, njerëz kokëbosh si ti, në të shumtat e rasteve largohen të pandëshkuar nga kjo botë.

***Domethënë, padyshim çështjet janë shtyrë për tek një Gjykatë e Lartë*.**

ASPEKTI I KATËRT:

Hidhe vështrimin tek këto xhevahire të rrallë të panumërt që janë shfaqur këtu dhe tek këto ushqime të pakrahasueshme e të shijshme me të cilat janë stolisur tryezat! Ato na tregojnë se Sunduesi i kësaj mbretërie ka një bujari të pakufishme dhe një thesar të pashtershëm. Tani ajo bujari dhe ai thesar kërkojnë përfundimisht një ekspozitë gostie mirësish të për-jetshme ku të përfshihet gjithçka që dëshirohet, dhe kërkojnë gjithashtu që

kënaqësitë dhe shijet që po i përjetojnë të vazhdojnë pandërprerë atje duke mos vuajtur dhimbjen e zhdukjes e të ndarjes, ***sepse ashtu siç është kënaqësi kur pushon dhimbja, gjithashtu zhdukja e kënaqësisë është e dhimbshme!***

Shiko tek këto ekspozita dhe tek këto shpallje që lidhen me to! Dhe dëgjoji këta lajmëtarë duke njoftuar artet e bukura antike të veprave të Monarkut Mrekullibërës dhe duke treguar plotësitë e Tij! Ata po deklarojnë bukurinë e Tij shpirtërore të pashoqe të fshehur dhe po flasin për treguesit e hollë të bukurisë së Tij të maskuar. Domethënë, Ai ka një bukuri të madhe e të habitshme të fshehur dhe një plotësi të pafund. Ky plotësim i patëmetë i fshehur, padyshim kërkon dikë që do ta vlerësonte e ta admironte dhe që duke e parë me kureshtje e habi, thotë: ***Mashaall-llah*!**, kështu duke e shfaqur atë e duke e bërë të njohur.

Sa për bukurinë e pashoqe të fshehur, ajo gjithashtu kërkon të shikojë e të shihet, ose më mirë për ta shikuar vetveten në dy mënyra: E para përbëhet nga të shikuarit e vetvetes në pasqyra të ndryshme, dhe e dyta nga të shikuarit e vetvetes nëpërmjet shikimit të spektatorëve të mahnitur dhe admiruesve të habitur nga ajo, sepse bukuria e fshehur dëshiron të shohë e të shihet, të shikojë veten përjetësisht dhe të shikohet pa ndërprerje. Ajo gjithashtu dëshiron ekzistencë të përhershme për të gjithë ata të cilët e shikojnë atë bukuri të përjetshme me vlerësim të thellë e kënaqësi të madhe. Sepse bukuria e përjetshme kurrë nuk mund të jetë e kënaqur me admiruesin e përkohshëm; për më tepër, një shikues i admiruar që është i destinuar të zhduket pa shpresë për t'u kthyer, do ta gjente dashurinë e tij të transformuar në armiqësi sa herë që ai përfytyron zhdukjen e tij, çudia e respekti do të ktheheshin në përbuzje, sepse njeriu është armik për atë çfarë ai nuk e njeh dhe për atë që nuk mund ta arrijë.

Por, gjithësecili e lë shumë shpejt bujtinën e kësaj bote dhe zhduket duke pas parë vetëm një dritë, ose një hije të zbehtë të atij Plotësimi e të asaj Bukurie vetëm për një rast, dhe duke qenë fare i pakënaqur.

Domethënë, shkohet për tek një vendshikim i përjetshëm...

ASPEKTI I PESTË:

Shiko, është e qartë nga të gjitha këto çështje të mëdha se Mbreti i pashoq zotëron mëshirën më të madhe, sepse Ai bën që të shtrihet ndihma tek çdo i dëmtuar në fatkeqësi, i përgjigjet çdo pyetjeje, dhe kërkese, dhe shiko! Ai me mëshirë përmbush madje edhe nevojën më të ulët për individin më të thjeshtë të nënshtetasve të Tij. Në qoftë se për shembull, këmba e deles së ndonjë bariu do të vritej, Ai do të sillte ndonjë ilaç ose do të dërgonte ndonjë veteriner.

Eja tani, o shoku im, që të shkojmë së bashku tek ai ishull tek i cili janë grumbulluar shumë njerëz. Të gjithë fisnikët e mbretërisë takohen atje. Shiko! Komandanti më fisnik, duke mbajtur një dekoratë të lartë, po mban një fjalim dhe është duke kërkuar disa gjëra nga Mbreti i mëshirshëm. Të gjithë ata që janë të pranishëm, thonë: ***"Po, ne gjithashtu dëshirojmë e kërkojmë pikërisht atë çfarë kërkon Ai"*** dhe vërtetojnë e miratojnë fjalët e tij. Tani, dëgjoji fjalët e atij komandanti të privilegjuar prej Monarkut të tij:

"O Sulltan që na ushqen me mirësitë e Tua! Na trego burimin dhe origjinën e këtyre shembujve dhe hijeve që Ti na i ke treguar. Na afro ne tek vendi i mbretërisë Tënde; mos na lër neve të zhdukemi në këto shkretëtira! Na merr ne te prania Jote dhe na mëshiro! Na ushqe ne atje me mirësitë e shijshme që Ti na bëre të shijojmë nga ato edhe këtu! Mos na torturo me zhdukje e dëbim prej Teje! Mos i lër nënshtetasit e Tu të mallëngjyer, mirënjohës e të bindur ndaj Teje të humbasin për shkak të tekave të tyre dhe mos u shkakto atyre të asgjësohen! A nuk e dëgjon, o shoku im, se çfarë lutjesh po bën Ai?

A do të ishte e mundur që një Monark kaq i mëshirshëm e fuqiplotë të mos i japë çfarë dëshiron të dërguarit të Tij fisnik, në një kohë që Ai ia plotëson, me të gjithë interesimin, kërkesën më të vogël një individi më të vogël prej nënshtetasve të Tij dhe të mos ia përmbushë qëllimet më të larta e më të holla të dashurit të Tij dhe atij komandanti fisnik?

Për më tepër, qëllimi i atij komandanti është qëllimi i të gjithë njerëzve dhe përmbushja e atij qëllimi kërkohet nga kënaqësia, nga mëshira dhe nga

drejtësia e Monarkut, dhe ajo për Të është një çështje shumë e lehtë; ajo nuk është më e vështirë se sa ajo që Ai Monark ka shfaqur tek vendet e përkohshme të kënaqësive që përfshihen në bujtinën e kësaj mbretërie. Atëherë përderisa Ai ka bërë kaq shumë harxhime për këtë periudhë të shkurtër pesë ose gjashtë ditore dhe e ngriti këtë mbretëri me qëllim që të tregojë shembujt e Fuqisë së Tij, sigurisht Ai do të shfaqë te vendi i mbretërisë së Tij thesaret e Tij të vërteta, plotësimet dhe çudirat e Tij dhe do t'i hapë përpara nesh ato shfaqje të tilla saqë mendjet tona do të habiten.

Domethënë, këta të cilët janë dërguar këtu, në këtë vend provimi e testimi, nuk do të lihen në tekat e tyre dhe nuk janë kot, por ata i presin ose pallatet e lumturisë së përjetshme, ose birucat e burgjeve të përhershëm...

ASPEKTI I GJASHTË:

Eja tani, shiko! Të gjithë këto vagona të mëdhenj, këto aeroplanë, makineri, magazina të mbushura dhe këto ekspozita, dhe këto zhvillime dhe aktivitete tregojnë se prapa perdes ekziston dhe drejton një Monark Madhështor[240].

---

[25]. Shënim: Ashtu si një ushtri e madhe në fushën e stërvitjes e të manovrave, ose drejtëpërdrejtë në luftë, që transformohet në një formë që i ngjason një pylli me dushk e ferra sapo të marrë urdhrin "Merrni armët dhe drejtoni bajonetat", dhe ashtu siç shndërrohet e gjithë ushtria në çdo ditë feste e parade ushtarake në një formë që i ngjason një kopshti të zbukuruar e me lule shumëngjyrëshe sapo të marrë urdhrin "mbani simbolet e vishni uniformat", po kështu është çështja me bimët e pavetëdijshme, që janë një lloj i ushtarëve të panumërt të All-llahut xh.sh., ashtu siç janë ushtarët e Tij engjëjt, xhindet, njerëzit dhe kafshët, kur ata marrin urdhërin e كُنْ فَيَكُونُ "***Bëhu!-dhe ajo është bërë (në çast***)!" në luftën e tyre për ruajtjen e jetës, dhe kur urdhërohen me komandën Hyjnore, **"Merrni armët e pajimet tuaja dhe përgatituni për të mbrojtur vetveten",** ato drejtojnë bajonetat e tyre të vockëla të cilat janë pemët gjembake dhe bimët që gjenden anembanë botës, atëherë sipërfaqja e tokës transformohet në një trajtë që i ngjason një ushtrie madhështore duke përparuar me bajoneta të drejtuara.

Një Monarki e tillë kërkon subjekte të denja për Të. Ndërsa ti i shikon të gjithë subjektet e Tij të jenë grumbulluar në këtë bujtinë për udhëtarët, një bujtinë e cila mbushet e zbrazet në çdo ditë. Gjithashtu, mund të thuhet se subjektet e Tij janë mbledhur tani në këtë fushë të provimit e të testimit, veçse fusha ndryshohet në çdo orë, dhe ata qënd-rojnë disa minuta në këtë ekspozitë të madhe për të shikuar modelet e mirësive të vyera të Monarkut dhe produktet e çmueshme të artit të Tij të mrekullueshëm. Por edhe vetë ekspozita ndryshon në çdo minutë. Ata që shkojnë, nuk kthehen, dhe ata që vijnë shkojnë.

Tani kjo situatë dhe kjo rrethanë tregon në mënyrë të prerë se përtej kësaj bujtine të përkohshme dhe matanë këtyre fushave të ndryshueshme dhe prapa këtyre ekspozitave të transformueshme ndodhen pallate të qëndrueshme, banesa të përhershme, kopshte e thesare të mbushura plot me modele e forma të pastërta, të larta e origjinale që ne i shohim në këtë botë. Domethënë, punët dhe veprat në këtë botë nuk janë tjetër veçse për hir të atij shpërblimi që është për ne atje.

Atëherë, Ai këtu na detyron të punojmë, dhe atje na jep shpërblim. Një formë e shkallës së lumturisë e përshtatshme për kapacitetin dhe veprën e mirë që ka bërë gjithësecili, na pret atje...

ASPEKTI I SHTATË:

E ngjashme me këtë, çdo ditë dhe çdo javë e pranverës është si një festival për çdo lloj të botës bimore; dhe çdo grup paraqet vetveten përpara shikimit të Monarkut të përjetshëm dhe përpara dëshmuesve të Tij me zbukurime të veshura me xhevahire që Ai u ka dhënë atyre, sikur të ishte në një paradë, me qëllim që të shfaqë dhuratat e holla që Ai u ka dhënë atyre. Është sikur të gjitha bimët e pemët të dëgjonin një komandë Hyjnore, "Vishni rrobat e zbukuruara me xhevahire të prodhuara nga mjeshtëria e All-llahut xh.sh., dhe dekoret e bëra nga Fuqia e Tij krijuese, të cilat janë lulet dhe frutat... dhe hapni lulet"; Atëherë sipërfaqja e tokës kthehet sikur të ishte një fushim i madh në një ditë festive të shkëlqyeshme, dhe si një paradë madhështore e shndritshme me uniformat e ushtarëve e me stolitë e tyre të zbukuruara me xhevahire. **Një organizim i tillë i urtë e i mirërregulluar, dhe ato zbukurime u tregojnë të gjithë atyre që nuk janë të verbër, se ato vijnë nga komanda e një Monarku, që Fuqia e të Cilit është e pafund, dhe mga urdhri i një Sundimtari të Gjithurtë që urtësia e të Cilit është e pafund.**

Eja, le të shëtisim pak e të shohim çfarë gjendet midis këtyre njerëzve të qytetëruar.

Shiko, në çdo vend e në çdo qoshe janë vendosur aparate të shumta fotografike dhe po bëjnë fotografime, dhe gjithandej ndodhen shkrues të shumtë duke regjistruar çdo gjë. Ata madje shënojnë edhe më të voglën e çështjeve për nga rëndësia dhe më të zakonshmen e ngjarjeve. Tani shiko tek ai mal i lartë! Atje është ngritur një aparat gjigant fotografik, i cili i përket vetë Monarkut[241]. Ai fotografon gjithçka që ndodh në këtë mbretëri. Atëherë mbreti duhet të ketë lëshuar këtë urdhër: "Regjistroni të gjitha veprimet e bëra dhe aktet e kryera në mbretëri." Me fjalë të tjera, Ai Mbret Madhështor i ka të regjistruara të gjitha ngjarjet dhe njëkohësisht të fotografuara. Regjistrimi i saktë të cilin Ai është duke e mbajtur, padyshim duhet të jetë për hir të një dite në të cilën Ai do t'i thërasë subjektet e Tij për të dhënë llogari.

Tani, a do të ishte e mundur që Një Sundimtar Gjithëruajtës, i Cili nuk neglizhon as për gjërat më të rëndomta për më të thjeshtin e nënshtetasve të Tij, të mos regjistrojë veprat më të rëndësishme e më të mëdha të subjekteve të Tij, apo të mos i thërrasë ata për të dhënë llogari, dhe të mos i shpërblejë e të mos i dënojë? Në fund të fundit, midis subjekteve të Tij ishin

---

[241] Shënim: Disa nga të vërtetat e treguara në këtë shembëlltyrë janë shtjelluar në të "Vërtetën e shtatë", megjithatë le të tregojmë këtu se figura e "Aparatit gjigant fotografik këtu i cili i përket Monarkut, është një tregues i **"Leuh el-Mahfudh"** (Leuh el Mahfudh është vendi ku depozitohen dëshirat e paracaktimet e Krijuesit). Realiteti dhe ekzistenca e Leuh el Mahfudhit është provuar në **'Fjalën e Njëzet e Gjashtë'** siç vijon: Një portofol i vogël sugjeron ekzistencën e një libri të madh identitetesh; një dokument i vogël tregon ekzistencën e një regjistri të madh; dhe pikat e vogla tregojnë ekzistencën e një rezervuari të madh uji. Gjithashtu fuqitë ruajtëse të kujtesës së njeriut, frutet e pemëve, farërat dhe bërthamat e frytit duke qenë secila si një portofol i vogël, një Leuh el mahfudh në miniaturë, ose një pikë që rrjedh nga pena e cila shkroi Leuh el-Mahfudhin e Madh, tregojnë, shfaqin e provojnë ekzistencën e Ruajtësit më të Madh, një regjistër më të madh, një Leuh el-Mahfudh më të madh. Në të vërtetë, ato e demonstrojnë këtë dukshëm për mendjen e mprehtë.

edhe ata që kryen vepra fyese kundër lavdisë së Tij në kundërshtim me Krenarinë e Tij, të papranueshme për Mëshirën e Tij, dhe ato veprime mbetën pa u ndëshkuar në këtë botë.

Domethënë, pa dyshim gjyqi i tyre është shtyrë për tek një Gjykatë e Lartë...

ASPEKTI I TETË:

Eja të t'i lexoj ato urdhëra që lëshohen nga Ai Monark. Shiko, Ai në mënyrë të përsëritur bën premtimet e mëposhtme dhe kërcënimet e tmerrshme duke thënë: ***"Unë do t'ju marr nga banesa e juaj e tanishme e do t'ju sjell tek vendi i sundimit Tim." Atje do t'u jap lumturi të bindurve prej jush dhe burgosje të pabindurve. Unë do ta shkatërroj këtë banesë të përkohshme, Unë do të ngre një mbretëri tjetër në të cilën të ketë pallate të përjetshme dhe burgje të përhershëm."***

Ai mund t'i përmbushë fare lehtë premtimet që bën, dhe ajo është shumë e rëndësishme për subjektet e Tij. Për më tepër, do të ishte e papajtueshme me Krenarinë dhe Fuqinë e Tij nëse Ai do ta thyente premtimin e Tij.

Kështu, o njeri i ngatërruar! Ti po pranon gënjeshtrat e imagjinatave të tua, mendjen tënde të turbulluar, mashtrimet e nefsit tënd, por ti po hedh poshtë fjalët e Atij që nuk mund të detyrohet në asnjë mënyrë që të thyejë premtimin, Madhështia e lartë e të Cilit nuk e pranon një pabesi të tillë dhe vërtetësinë e të Cilit e dëshmojnë të gjitha aktet e dukshme. Sigurisht ti meriton një dënim të madh. Ti i ngjason një udhëtari i cili i mbyll sytë ndaj dritës së diellit dhe kërkon orientimin me imagjinatat e tij. Tekat e tij dëshirojnë të ndriçojnë rrugën e tij shumë të errët me dritën e fenerit të kokës së tij, ndonëse ajo dritë është vetëm një shkëndijëz. Ai Monark, sapo ta bëjë premtimin, sigurisht do ta përmbushë atë. Përmb-ushja e premtimit është gjëja më e lehtë për Të, dhe për më tepër, ajo është më e domosdoshmja për ne e për të gjitha gjërat, gjithashtu për Të e për mbretërinë e Tij.

Domethënë, ndodhet një Gjykatë e Lartë dhe një Lumturi e madhe.

ASPEKTI I NËNTË:

Eja tani! Shikoji drejtuesit e këtyre zyrave dhe grupeve.[242] Secili ka një telefon privat për të folur personalisht me Mbretin. Ndonjëherë ata shkojnë drejt te Prania e Tij. Shiko se çfarë thonë ata të gjithë dhe çfarë njoftojnë me unanimitet: Ai Monark ka përgatitur një vend madhështor të shkëlqyeshëm për të shpërblyer ata që bëjnë mirë dhe ka përgatitur një vend tjetër të llahtarshëm për të ndëshkuar keqbërësit. Premtimet e Tij janë energjike dhe kërcënimet e Tij janë më të rreptat. Krenaria dhe Dinjiteti i Tij janë të tilla, saqë Ai kurrësesi nuk do ta poshtëronte Vetveten duke thyer premtimin.

Përçuesit e këtij njoftimi janë aq të shumtë, saqë janë pranuar botërisht. Për më tepër, ata njoftojnë me një unanimitet të fuqishëm konsensusi se vendi dhe selitë e monarkisë së lartë, disa nga shenjat e së cilës janë të dukshme edhe këtu, janë vetëm në një mbretëri tjetër shumë të largët nga kjo. Ndërtesat ekzistuese në këtë fushë testimi e provimi janë vetëm godina të përkohshme dhe më vonë ato do të transformohen në pallate të përjetshme. Kjo tokë e këto vende do të shndërrohen në të tjera, sepse kjo mbretëri madhështore e përjetshme, madhështia e së cilës është e dukshme nga veprat e saj, kurrë nuk mund të gjendet a të bazohet mbi këto çështje kaq kalimtare, të paqëndrueshme, të pa stabilizuara, të parëndësishme, të ndryshueshme, jo të vazhdueshme, të mangëta e të paplota... Përkundrazi, ajo bazohet mbi çështje të denja për të, të përjetshme, të qëndrueshme, të vazhdueshme, të plotësuara dhe madhështore.

Domethënë, ndodhet një botë tjetër, dhe me siguri do të shkohet tek ai vendbanim...

ASPEKTI I DHJETË:

---

[242] Shënim: Kuptimet e provuara në këtë aspekt gjenden tek e **"Vërteta e Tetë"**: Për shembull, me kryetarët e zyrave ne duam të themi profetët dhe evlijatë (shenjtorët). Sa për telefonat, ajo është një lidhje me All-llahun xh.sh. që del nga zemra që është pasqyra e shpalljes dhe ena e frymëzimit. Zemra është si koka dhe veshi i atij telefoni.

Eja shoku im, sot është një festë e madhe, është sanatadita pranverore[243]. Disa ndryshime do të ndodhin dhe gjëra të mrekullueshme do të shfaqen. Në këtë ditë pranverore le të shkojmë për një shëtitje në shkretëtirën e blertë të stolisur me lule të bukura.

Shiko! Edhe njerëz të tjerë gjithashtu janë drejtuar për te ajo. Shiko! Këtu ka diçka të çuditshme për t'u shikuar. Ndërtesat, që të gjitha u rrënuan papritmas; ato morën një formë tjetër! Shiko! Këtu ka një mrekulli, sepse ndërtesat që ishin thjesht rrënoja, papritmas janë shfaqur përsëri këtu, dhe kjo shkretëtirë, dikur e zbrazur, është bërë si një qytet i populluar. Shiko, në çdo orë ajo tregon një skenë të ndryshme, ashtu si një ekran kinemaje dhe merr një formë të ndryshme.

Por shikoje me kujdes çështjen, që të shohësh madhështinë e këtij sistemi të përkryer në këtë ekran tek i cili përzihen skena të shumta dhe ndryshohen me shpejtësi; ato janë skena të vërteta ku çdo gjë zë vendin e duhur me saktësinë e përshtatshmërinë më të madhe. Skenat e imagji-nuara të paraqitura për ne në ekranet e kinemave nuk mund të jenë aq të mirorganizuara sa kjo, dhe me miliona magjistarë të shquar do të ishin të paaftë për ta bërë këtë vepër artistike. Atëherë, ky Mbret të Cilin ne nuk mund ta shohim, duhet të ketë realizuar mrekulli akoma më të mëdha.

O njeri i turbulluar! Ti thua: "Si mund të shkatërrohet kjo mbretëri e madhe e të rindërtohet në një vend tjetër"?

---

[243] Shënim: Ju do ta gjeni atë çfarë aludon ky aspekt tek e **"Vërteta e Nëntë"**. Sanataditaja pranverore aludon për fillimin e stinës së pranverës. Sa për shkretëtirën e blertë të mbuluar me lule, kjo është sipërfaqja e tokës në kohën e pranverës. Skenat e ndryshueshme dhe shfaqjet në ekran janë aluzione për llojet e ndryshme të rizkut dhe të ushqimeve që vijnë në pranverë e në verë për të gjitha krijesat, për kafshët dhe njerëzit, saqë i Gjithëfuqishmi, Autori i Gjithëlavdishëm, i Gjithurti dhe Krijuesi Hirplot, nga fillimi i pranverës gjer në fund të verës, ua sjell ushqimin me rregull, i përtërin me mëshirën më të plotë dhe ua dërgon pandërprerë.

Ti shikon se në çdo orë ndodhin shumë ndryshime e përmbytje, tamam ashtu si ajo shpërngulja nga një botë për tek një tjetër, të cilën mendja jote nuk dëshiron ta pranojë. Nga ky tubim, nga shpërndarja dhe nga këto gjendje mund të nxirret si përfundim se një qëllim i caktuar fshihet brenda këtyre bashkimeve e ndarjeve të dukshme e të shpejta dhe brenda përbërjeve e shkrirjeve... Dhjetë vite harxhime nuk do të jepeshin për një bashkim që është i destinuar të zgjasë jo më shumë se një orë. Kështu, këto rrethana që ne i dëshmojmë nuk mund të jenë qëllimet në vetveten e tyre. Ato janë një lloj i shembëlltyrës së diçkaje përtej vetvetes së tyre, ato janë shembuj ekspozimi këtu. Atëherë Ai Monark i lartë i për-fundon veprat e Tij në një mënyrë aq të mrekullueshme, saqë ato marrin formën dhe atëherë shfaqen, dhe rezultati ruhet e regjistrohet ashtu siç shënohet e regjistrohet çdo aspekt në fushën e manovrave ushtarake. Domethënë, kjo nënkupton se çështjet do veprojnë në Tubimin e madh e do të vazhdojnë mbi bazën e asaj që ndodh këtu. Për më tepër, rezultatet e të gjithë atyre çështjeve që ndodhin këtu do të shfaqen pandërprerë tek Ekspozita e lartë. Të gjitha fenomenet e përkohshëm e të lëkundur që ne i shikojmë tani këtu, do të fitojnë frutin e formës së përjetshme e të qëndrueshme.

Domethënë, të gjitha këto manifestime që ne i vëzhgojmë në këtë botë janë për hir të një lumturie të madhe, të një Gjykate të Lartë, për hir të synimeve të larta akoma të fshehura për ne...

ASPEKTI I NJËMBËDHJETË:

Eja, o shok kokëfortë! Le të hipim në një aeroplan që të shkojmë në lindje ose në perëndim, domethënë; në një tren që shkon në të shkuarën e në të ardhmen, le të shikojmë se çfarë veprash të mre-kullueshme në vende të tjera ka kryer Ai Mbret, Autori i mrekullive.

Ajo çfarë pamë ne këtu midis veprave të mrekullueshme prej ekspozitave, fushave e pallateve, shembuj si këto Ai i ka në çdo vend, veçse ato ndryshojnë për sa i përket artit e formës. O shok**, hidhe vështrimin tek kjo, që të shohësh se çfarë rregulli urtësie, çfarë treguesish të mëshirës së dukshme, çfarë shenjash të drejtësisë së lartë dhe çfarë frutash të Mëshirës gjithëpërfshirëse vërehen në këto banesa të përkohshme, në ato**

fusha të paqëndrueshme dhe në ato ekspozita kalimtare. Ai që nuk e ka humbur krejtësisht shikimin e tij, do të kuptonte me siguri se asnjë urtësi nuk mund të përfytyrohet më e plotë se sa urtësia e Atij Monarku, asnjë përkujdesje më e bukur se sa përkujdesja e Tij, asnjë mëshirë më gjithëpërfshirëse se sa mëshira e Tij dhe asnjë drejtësi më e lavdishme se sa drejtësia e Tij.

Në qoftë se, për hir të argumentit, ashtu siç e imagjinon ti, nuk do të ekzistonin në sferën e mbretërisë së Tij banesa të mira e të përhershme, pallate të larta, vende të qëndrueshme apo banorë dhe njerëz të kënaqur; dhe në qoftë se të vërtetat e urtësisë së Tij, të përkujdesjes, të mëshirës dhe të drejtësisë nuk do të kishin një botë në të cilën të shfaqin plotësisht vetveten, sepse kjo botë e paqëndrueshme nuk është vend që ato të shfaqin plotësisht treguesit e tyre, atëherë ne do të detyroheshin të mohonim urtësinë që ne e shikojmë, të mohonim përkujdesjen që ne e vëzhgojmë, të mohonim mëshirën që është përpara syve tanë dhe të mohonim drejtësinë, shenjat e së cilës janë të dukshme. Mohimi i tyre do të ishte një veprim aq i marrë, si të mohoje diellin, dritën e të cilit ne e shohim qart në mesditë. Ne do të detyroheshim gjithashtu të thonim në lidhje me Atë Autor, prej të Cilit vijnë të gjitha këto akte urtësie që ne i shikojmë, të gjitha këto vepra bujarie dhe të gjitha këto dhurata të mëshirshme, si të ishte një kumarxhi i pavlefshëm ose si një tiran tradhtar –Ruajna Zot! Ruajna Zot!– kjo do të thotë ta kthesh përmbys të vërtetën.

Por t'i kthesh të vërtetat në anën e kundërt, është e pamundur sipas dëshmisë me unanimitet të të gjitha qënieve të arsyeshme, me përjashtim të sofistëve idiotë të cilët mohojnë gjithçka.

Atëherë, ndodhet një botë tjetër përveç kësaj të këtushmes. Në të ndodhet një Gjykatë e Lartë, një vend i lartë drejtësie dhe një vend i lartë shpërblimi tek e cila shfaqet plotësisht kjo mëshirë, kjo urtësi, kjo përkudesje dhe kjo drejtësi...

ASPEKTI I DYMBËDHJETË:

Eja të kthehemi tani, o shoku im. Ne do të flasim me kryetarët dhe oficerët e këtyre grupeve të ndryshme dhe shiko pajimet e tyre; a janë pajisur me ato mjete për hir të një periudhe të shkurtër kohe në këtë fushën e stërvitjes, apo u janë dhënë atyre për hir të arritjes së një jete të gjatë lumturie në një botë tjetër? Le të shohim, mirëpo ne nuk mund ta shikojmë gjithësecilin dhe pajimet e tij; por nëpërmjet shembullit, le të shohim letërnjoftimin dhe regjistrin e këtij oficeri. Në regjistrin e tij janë shënuar rangu i tij, rroga, detyra, kërkesat dhe rregullat.

Shiko! Ky rang nuk i është dhënë atij vetëm për disa ditë, por për një periudhë të gjatë. Në letërnjoftimin e tij është shkruar: "Ti do të marrësh nga thesari i veçantë këtë vlerë në filan ditë." Por data në çështje është shumë e largët dhe nuk do të arrihet veçse pas mbylljes së misionit stërvitor në këtë fushë. Kjo detyrë nuk i përshtatet kësaj fushe të përkohshme dhe nuk harmonizohet me të, por ajo është për të fituar një lumturi të përjetshme tek një vend i lartë në afërsi me Mbretin. Furnizimet e përforcimet, gjithashtu, nuk i janë dhënë atij për disa ditë qëndrimi në këtë bujtinë, ato mund të jenë vetëm për një jetë të gjatë e të lumtur. Të dhënat në letërnjoftimin e tij sqarojnë mjaft qartë se pronari i letërnjoftimit është i destinuar për tek një vend tjetër, dhe se ai po punon për një botë tjetër.

Tani shikoji këto regjistra. Ato përmbajnë udhëzime për mënyrën e përdorimit të armëve dhe pajimeve. Në qoftë se nuk do të kishte pasur një botë tjetër të lartë e të përjetshme përveç kësaj këtu, atëherë ai regjistër me udhëzimet e tij të prera, dhe ai letërnjoftim me të dhënat e tij të sakta që të dy do të kishin qenë të pakuptimtë.

Për më tepër, ai oficer i respektuar, ai komandant fisnik dhe ai kryetar i nderuar do të binin në një shkallë më të ulët se ajo e të gjithë njerëzve; ai do të ishte më i mjeri, më i pafati, më i ulëti, më i hidhëruari, më i varfëri dhe më i dobëti se çdokush tjetër.

Atëherë bëj analogji me këtë, dhe çfarëdo që ti shikon jep dëshmi se pas kësaj bote kalimtare ekziston një botë tjetër e përjetshme...

O shok! Kjo botë e përkohshme është si një fushë bujqësore. Ajo është një vend instruksioni, është një treg. Padyshim, një Gjykatë më e Lartë dhe një lumturi më e madhe do të vijnë pas kësaj. Në qoftë se e mohon këtë, ti gjithashtu do të detyroheshe të mohoje letërnjoftimet e të gjithë oficerëve, regjistrat, pajisjet e tyre dhe rregullat e tyre; në fakt, ti gjithashtu do të detyroheshe të mohoje të gjithë rregullin që ekziston në vend, ekzistencën e qeverisë në të dhe të gjitha masat që merr qeveria. Atëherë, ti nuk do ta meritoje më emrin e njeriut, ose emërtimin e qënies së vetëdijshme. Ti do të ishe më i çmendur se sa sofistët.

Dhe ruhu! Mos imagjino se provat e shpërnguljes së krijimit nga një botë për tek një tjetër janë të kufizuara vetëm tek këto **"Dymbëdhjetë Aspekte."** Ndodhen tregues e prova përtej numërimit, të gjitha duke treguar se kjo botë e paqëndrueshme dhe kjo mbretëri e ndryshueshme do të transformohet në një botë të qëndrueshme e të pandryshueshme. Gjithashtu ka shenja e dëshmi të panumërta se njerëzit do të merren nga kjo bujtinë e përkohshme dhe do të dërgohen tek vendi i përjetshëm i sundimit të të gjitha krijesave.

O shoku im! Eja të të tregoj një provë të veçantë, e cila është më e fortë se sa të gjitha **"Dymbëdhjetë Aspektet"**, të marra së bashku.

Eja tani, shiko! Në mesin e asamblesë së madhe e cila duket nga larg, i njëjti Komandant Fisnik, pronari i dekoratës së madhe të cilin më parë ne e shikuam në ishull, është duke dhënë njoftime. Le të shkojmë e ta dëgjojmë. Shiko! Ai Komandant Fisnik i ndriçur është duke përçuar një Dekret të Lartë dhe e sqaron bukur atë duke u thënë atyre:

"Bëhuni gati! Ju do të udhëtoni për tek një botë tjetër e qëndrueshme, tek një botë e tillë, saqë kjo botë këtu, në krahasim me atë, do të duket si një burg. Ju do të shkoni tek vendi i sundimit të Mbretit tonë dhe atje do të merrni Mëshirën dhe Mirësinë e Tij nëse ju i kushtoni shumë vëmendje këtij dekreti dhe në qoftë se ju i bindeni Atij. Por, në qoftë se ju e kundërshtoni e nuk i bindeni Atij, ju do të flakeni në një burg të tmerrshëm."

I tillë është mesazhi që ai përçon. Në qoftë se ju e shikoni Dekretin Madhështor, do të vëreni se ai mban një vulë të tillë të mrekullueshme, që kurrësesi nuk mund të imitohet. Gjithkush, përveç idiotëve ashtu si ti, e di me siguri se dekreti është nga Mbreti. Për më tepër, Komandanti fisnik mban zbukurime të ndryshme të tilla, saqë çdokush, përveç atyre që janë të verbër si ti, e kupton mjaft mirë se ai është përçuesi i vërtetë i urdhërave të Mbretit.

A do të ishte i mundur kundërshtimi i çështjes së shpërnguljes së kësaj bote për tek një tjetër, për tek e cila bën thirrje ai komandant fisnik, me të gjithë fuqinë që i erdhi, dhe të cilën e përmban ai dekret i lartë që ai e ka marrë? Jo, kurrë nuk është e mundur, veçse në qoftë se do të mohoje gjithçka që ne kemi parë.

Tani, o shok, erdhi radha jote për të folur. Thuaj çfarëdo që të dëshirosh!

– Çfarë mund të them, çfarë mund të thuhet për të kundërshtuar të gjithë këtë? Kush mund të thotë, kur dielli është në mesin e ditës, ku është ai? Ajo që dua të them është: ***El- hamdu lil-lah****, Lavdia i takon All-llahut*, njëqindmijë herë, që kam shpëtuar nga sundimi i tekave të nefsit dhe të hamendjeve të kota dhe që jam çliruar nga një burgim i përhershëm. Unë tani besoj se ka një banesë lumturie në afërsi të Monarkut Madhështor, e ndarë nga kjo bujtinë e ngatërruar dhe e paqëndrueshme e kësaj bote."

Krahasimi, duke treguar të vërtetën e ringjalljes e të botës tjetër, tani është plotësuar. Tani me ndihmën e All-llahut, ne do të kalojmë tek e vërteta më e lartë. Ne do të parashtrojmë **Dymbëdhjetë të Vërteta** të ndërvarura, duke u kerresponduar **"Dymbëdhjetë Apekteve"** të diskutuara lart, pasi të bëjmë një **"Parathënie".**

* * *

PARATHËNIE

[Me anë të disa treguesve, ne ju referojmë disa çështje të shpjeguara tjetërkund, domethënë, në Fjalën e Njëzet e Dy, në Fjalën e Nëntëmbëdhjetë dhe në Fjalën e Njëzet e Gjashtë.]

TREGUESI I PARË:

Në tregimin e mëparshëm ndodhen tre të vërteta për njeriun kokëfortë dhe për shokun e tij besëplotë.

● ***E para**:* Është nefsi im instinktiv dhe zemra ime.

● ***E dyta:*** Studentët e filozofisë dhe nxënësit e Kur'anit Gjithurtësi;

● ***E treta:*** Njerëzit e mosbesimit dhe Ummeti i Islamit.

Mosnjohja e All-llahut xh.sh. i ka bërë të bien në gabimin më të madh e në çudhëzim studentët e filozofisë, njerëzit e mosbesimit dhe nefsin instinktiv.

Ashtu siç tha shoku besëplotë e kështillues, në tregimin e mëparshëm se: "Nuk mund të ketë asnjë shkronjë pa një shkrues dhe asnjë ligj pa një ligjvënës."

Gjithashtu ne themi se: Është e pamundur që të ketë një libër pa shkruesin e tij, dhe sidomos një libër si ky ku në çdo fjalë të të cilit një penë e vogël ka shkruar një libër tjetër të tërë, dhe që në çdo shkronjë të të cilit një penë e hollë ka lënë gjurmët e një poeme; pra kjo do të ishte krejtësisht e pamundur. Po kështu, ky kozmos nuk mund të jetë pa Skalitësin e tij; kjo do të ishte krejtësisht e pamundur.

Sepse kozmosi është saktësisht një libër i tillë, saqë secila nga faqet e tij përfshin shumë libra të tjerë, secila nga fjalët e tij përmban një libër, dhe secila nga shkronjat e tij përmban një poemë. Sipërfaqja e tokës është vetëm se një faqe e vetme e librit të kozmosit. Shiko pra se sa shumë libra përmban ai... Çdo pemë është një fjalë, dhe sa e sa shumë fletë ka ai... Një frut, është një shkronjë; një bërthamë është një pikë. Në atë pikë përfshihet indeksi i të gjithë pemës në gjërësinë e saj. Një libër i tillë si ky mund të jetë skalitur vetëm nga Pena e Autorit të Fuqishëm i Cili gëzon atributet e madhështisë e të bukurisë dhe i Cili është Mbajtësi i urtësisë së pafund dhe i Fuqisë. Domethënë, thjesht vëzhgimi i botës dhe shikimet e saj bëjnë të domosdoshëm këtë besim, me përjashtim të atij që është i dehur nga çudhëzimi...

Dhe ashtu siç nuk mund të jetë një shtëpi pa një ndërtues, e sidomos kjo bujtinë që është stolisur me vepra të mrekullueshme arti, me vizatime të mahnitshme dhe me zbukurime të çuditshme, saqë në çdo gurë të saj mishërohet aq art, sa arti i të gjithë godinës. Asnjë njeri me mend nuk do të pranonte që ndërtesa mund të ishte pa ndërtues, sigurisht ajo kërkon një arkitekt mjeshtër. Për më tepër, brenda ndërtesës, dhoma të vërteta marrin formën dhe ndryshojnë në çdo orë me rregullin më të madh dhe me lehtësinë më të plotë, si lehtësia e ndryshimit të rrobave, ose sikur skenat që kalojnë përmes ekranit të kinemasë. Madje ne mund të themi se dhoma të vogëla të shumta krijohen vazhdimisht në secilën nga ato skena të vërteta.

Në mënyrë të ngjashme, Kozmosi gjithashtu kërkon një Krijues me një urtësi të pafund, Gjithënjohës e të Gjithëfuqishëm. Sepse ky Kozmos madhështor është si një pallat që diellin e hënën i ka si llambat e tij, dhe yjet si qirinjtë e tij; koha është si një litar ose shirit i varur brenda tij, në të cilin Krijuesi i Gjithëlavdishëm në çdo vit lidh e kalon një botë të re dhe na e shfaq ne. Dhe brenda asaj bote që Ai e ka lidhur në atë litar, Ai ripërtërin trajta të mirorganizuara në treqind e gjashtëdhjetë mënyra e forma. Ai vendos treqind e gjashtëdhjetë forma të freskëta e me sistem. Ai i ndryshon ato me rregullsinë më të madhe e me urtësinë. Ai e ka bërë sipërfaqen e tokës një tryezë mirësish të cilën Ai e stolis në çdo pranverë me treqindmijë specie të krijimit, dhe e mbush atë me lloje të panumërta të dhuratave

bujare. Ai e bën këtë në një mënyrë të tillë, saqë ato të gjitha qëndrojnë ndarazi nga njëra-tjetra, krejt të veçuara e të dalluara, pavarësisht qënies së tyre në të njëjtën kohë kaq afër e të përziera. Aspektet e tjera krahasoji me këto... Si është e mundur të mos e vësh re e të mbyllësh sytë përpara ekzistencës së Krijuesit të një pallati të tillë?

Përsëri, të mohosh ekzistencën e diellit, në një ditë pa re në mes të ditës kur shenjat e tij vëzhgohen dhe reflektimi i tij shihet në çdo shkumëzim e fluskë në sipërfaqen e oqeanit, shikohet tek çdo objekt i shndëritshëm në tokën e thatë dhe në çdo grimcë të borës, të bësh një mohim të tillë do të ishte një përçartje si i çmendur. Sepse në qoftë se dikush do të mohonte e refuzonte ekzistencën e një dielli të vetëm e unik, ai do të detyrohej të pranonte ekzistencën e një vargu të plotë diejsh të vegjël, secili real e ekzistent, aq të shumtë sa pikat dhe fluskat e oqeanit, dhe aq të panumërt sa grimcat e borës. Madje do të ishte e domosdoshme të besoje që çdo grimcë e vogël të përmbante një diell të madh, ndonëse grimca është mjaftë e madhe vetëm për të përfshirë vetveten. Madje do të ishte një shenjë akoma më e madhe çmendurie dhe çudhëzimi që dikush të refuzonte pranimin e Atributeve të Plotësimit të Krijuesit të Gjithëlavdishëm, në një kohë që e vështron Kozmosin e mirërregulluar, i cili është duke u ndryshuar vazhdimisht në një mënyrë të urtë e me sistem, dhe që është duke u ripërtërirë pa pushim në mënyrë të disiplinuar. Kjo gjithashtu do të ishte si përçartjet e një të çmenduri, meqenëse atëherë do të bëhej e domosdoshme të besoje e të pranoje që Hyjnia absolute të jetë prezent në të gjitha gjërat, madje tek çdo grimcë.

Sepse; për shembull: Çdo grimcë apo molekulë e ajrit në një farë mënyre është e aftë të hyjë e të japë efektet e saja tek çdo lule, tek çdo frut e tek çdo gjethe, dhe në qoftë se grimca nuk do të ishte e ngarkuar prej Krijuesit të saj me këtë detyrë, atëherë ajo duhet të dinte nga vetvetja strukturën dhe formën e të gjitha objekteve të krijuara me urtësi tek të cilat ajo futet e vepron. Me fjalë të tjera, ajo duhet të posedonte një njohuri gjithëpërfshirëse dhe një fuqi të gjithanshme që të mund ta kryente atë funksion.

Për shembull, çdo grimcë dheu i ka të gjitha mundësitë të bëhet shkas për mbirjen e farërave dhe bërthamave që ekzistojnë dhe për zhvillimin e të gjitha llojeve. Në qoftë se nuk do të ishte e urdhëruar dhe e nënshtruar, atëherë do të duhej që ajo të përfshinte brenda vetes instrumente dhe aparatura jolëndore sa numri i llojeve të ndryshme të pemëve dhe të bimëve, ose do të duhej që t'i jepej asaj një fuqi e mjeshtëri e tillë artistike, që ajo të ishte në dijeni për strukturën e çdonjërës prej tyre dhe të njihte format që secila prej tyre duhet të marrë. Dhe krahasoji me këtë krijesat e tjera që të kuptosh se në të gjitha gjërat ndodhen prova të shumta e të dukshme për Njësinë e All-llahut xh.sh.. ***Të krijosh të gjitha gjërat nga një gjë dhe krijimi i një gjëje nga gjithçkaja është një detyrë e veçantë vetëm për Krijuesin e të gjitha gjërave. Shqyrtoje dhe kushtoji vëmendje vërsetit:***

وَإِن مِّن شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ *"Dhe s'ka gjë që të mos lavdërojë Lartësinë e Tij...,*[244] ***sepse mosbesimi në një Zot të Vetëm e të pashoq do të bënte të domosdoshëm besimin në aq shumë zotra sa numri i krijesave.***

TREGUESI I DYTË:

Në tregimin tonë, përmendëm një nëpunës të afërt fisnik dhe thamë se: "Ai që nuk është i verbër, do të kuptojë nga shikimi i dekoratave dhe i medaljeve se ai personalitet i madh vepron në përputhje me urdhërat e një Monarku dhe është shërbëtori i Tij i zgjedhur." Nëpunësi i zgjedhur është i Dërguari Fisnik (A.S.M.).

Po, Krijuesi i Shenjtë i një kozmosi kaq të stolisur, domosdoshmërisht duhet të ketë një Mesazhier Fisnik, ashtu si dielli që domosdoshmërisht duhet të ketë dritën, sepse ashtu si dielli që nuk mundet veçse të përhapë dritë, po ashtu Hyjnia nuk mundet ta shfaqë Vetveten veçse nëpërmjet dërgimit të profetëve.

---

[244] **Kur'an, 17: 44**

A do të ishte e mundur që një Bukuri e plotësimit më të madh të mos dëshironte ta shfaqë vetveten përmes dikujt që do ta demonstronte dhe ta shfaqte atë!...

A do të ishte e mundur që një Plotësim i një mjeshtërie të bukur artistike të mos dëshironte ta bëjë vetveten të njohur nëpërmjet një lajmëtari që do të tërhiqte për tek Ai Plotësim shikimet e njerëzve?

A do të ishte e mundur që një monarki universale e një Hyjnie Gjithëpërfshirëse të mos dëshironte të shpallë Njësinë e Vet dhe përjetshmërinë gjithandej niveleve të ndryshme përmes një të dërguari që posedon dy krahë? Me dy krahë, me dy aspekte, ne duam të themi se Ai është edhe përfaqësues i niveleve të Krijesave tek prezenca Hyjnore në sajë të adhurimit të tij universal, dhe gjithashtu ai është i dërguar nga Krijuesi i të gjitha botëve, në sajë të afrimitetit të tij me All-llahun xh.sh. dhe të qënies së tij i ngarkuar me mesazhin e Tij.

A do të ishte e mundur që një Zotërues i një Bukurie të natyrshme absolute të mos dëshironte t'i shihte vetë dhe t'ua shfaqte edhe të tjerëve, në pasqyra të shumta, mahnitjet e bukurisë dhe forcën tërheqëse të Hyjnisë së Tij! Domethënë, nëpërmjet një të dërguari të dashur, sepse ai është i dashuri i Tij, duke e bërë vetveten të dashur tek All-llahu, xh.sh., përmes adhurimit të tij të sinqertë, dhe duke vepruar si një shembull, pasqyrë; është një mesazhier, sepse ai e bën të dashur All-llahun, xh.sh., tek krijesat duke shfaqur Hijeshinë e Emrave të Bukur Hyjnorë.

A do të ishte e mundur që Pronari i thesareve të mbushura plot me mrekulli të mahnitshme, të rralla e me gjëra të çmueshme, të mos dëshirojë t'ia shfaqë atë shikimit të njerëzve nëpërmjet një njoftuesi gjenial dhe një përshkruesi elokuent, pra që të zbulojë plotësimet e Tij të fshehura?

A do të ishte e mundur për Atë i Cili e zbukuroi këtë kozmos me krijesat e Tij, që shpreh plotësimet e të gjithë Emrave të Tij të Bukur, e që e bëri atë të ngjashëm me një pallat të stolisur me të gjitha llojet e artit të mrekullueshëm e të hollë, për t'ua shfaqur shikimeve, të mos caktonte një mësues e një udhëzues për të shpjeguar çudirat e krijesave të Tij?

A do të ishte e mundur që Pronari i këtij kozmosi të mos zgjidhte nëpërmjet një të dërguari enigmën e ngatërruar të qëllimit dhe të synimit të të gjitha ndryshimeve që ndodhin në kozmos, dhe shpjegimin e misterit të përfshirë në tre pyetjet e vështira të bëra nga të gjitha krijesat: ***"Cila është origjina jonë? Cili është destinacioni ynë? Dhe cili është qëllimi ynë?, pra nga erdhëm, pse erdhëm dhe ku do të shkojmë?"***

A do të ishte e mundur që Krijuesi i Gjithëlavdishëm, i Cili e bën Vetveten të njohur tek qëniet e vetëdijshme përmes këtyre krijesave të bukura, dhe që e bën Vetveten të dashur përmes mirësive të Tij të çmueshme, të mos u bëjë të qartë qënieve të vetëdijshme nëpërmjet një të dërguari, se çfarë dëshiron Ai prej tyre dhe çfarë do ta kënaqte Atë si përgjigje ndaj atyre mirësive?

A do të ishte e mundur për Krijuesin i Cili e krijoi llojin njerëzor dhe e sprovoi atë me shqisa e aftësi të shumta dhe që i dha atij aftësinë për t'u përfshirë në një adhurim të plotë universal, të mos i drejtojë shikimet e këtij lloji nga shumësia për tek Njësia, nëpërmjet një udhëzuesi e mësuesi?

Ndodhen shumë funksione të tjera të profetësisë, secila nga ato janë prova të qarta dhe sqarojnë se Hyjnia nuk mund të jetë pa profetësi.

A është shfaqur ndonjëherë ndonjë njeri në botë më i denjë e më gjithëpërfshirës për cilësitë dhe detyrat e lartëpërmendura se sa Muhammedi Arab a.s.m.? A na ka treguar ne ndonjëherë koha ndonjë që të jetë më i përshtatshëm e më i denjë se sa ai për rangun e profetësisë dhe për detyrën e komunikimit të mesazhit? Jo, në asnjë mënyrë! Ai është Prijësi i të gjithë të dërguarve, ai është imami i të gjithë profetëve, udhëheqësi i të pastërve, monarku i të gjithë udhëzuesve të drejtësisë, më i ploti i të gjithë krijesave dhe më i afërti nga të afërmit me All-llahun xh.sh..

Përveç treguesve të pafund të profetësisë së tij që burojnë nga më shumë se njëmijë mrekulli, të tilla si çarja më dysh e Hënës dhe vërshimi i ujit nga gishtërinjtë e tij, të cilat i mbështesin me unanimitet të gjithë dijetarët; vetëm mrekullia më e madhe e Kur'anit, e cila është një oqean i të vërtetave dhe një libër i mrekullueshëm në dyzet aspekte të ndryshëm,

është në vetvete e mjaftueshme për ta demonstruar profetësinë e tij në mënyrë aq të qartë si dielli. Ne i kemi vërtetuar afërsisht dyzet aspektet e mrekullisë së tij në Risalei-Nur dhe në mënyrë të veçantë në Fjalën e Njëzet e Pestë. Prandaj, ne këtu po e presim shkurt.

TREGUESI I TRETË:

Të mos mendohet se ky njeri i vogël është shumë i parëndësishëm, dhe se kjo botë e madhe do të mbyllet e do të hapet një botë tjetër vetëm për hir të qënies së tij i sjellur për të dhënë llogari, sepse ky njeri, ndonëse në dukje është shumë i vogël, veçse ama ai është prijësi i të gjitha krijesave, pasi ai posedon një natyrë gjithëpërfshirëse e të gjithanshme... Kështu ai është udhëheqësi i të gjitha krijesave, lajmëtari i mbretërisë së All-llahut xh.sh., përfaqësuesi dhe manifestuesi i adhurimit të gjithanshëm universal.

Gjithashtu askush të mos pyes: Si mundet të gjykohet ky njeri me një dënim të përjetshëm ndonëse ai ka një jetë shumë të shkurtër? Mosbesimi kërkon të zbresë shkallën dhe vlerat e krijesave të cilat janë aq të vlefshme e të larta si letrat e shkruara nga All-llahu xh.sh., kërkon t'i zbresë poshtë në thellësirat e qënies së tyre të pakuptimta e të paqëllimta. Mosbesimi është fyerje për të gjitha qëniet, meqenëse ai mohon e hedh poshtë treguesit, skalitjet dhe shenjat dalluese të Emrave të Shenjtë të All-llahut xh.sh., që janë të dukshëm tek të gjitha krijesat. Mosbesimi kërkon të mohojë të gjitha provat e pafundme që demonstrojnë saktësinë dhe vërtetësinë e All-llahut të Gjithëfuqishëm. Kështu, mosbesimi është një krim i një madhësie të pafund, dhe një krim i pafund meriton një dënim të pafund...

TREGUESI I KATËRT:

Në tregim, ne pamë përmes Dymbëdhjetë Aspekteve se një Mbret i cili kishte një mbretëri të përkohshme –si të ishte një bujtinë– domosdoshmërisht Ai duhet të ketë një mbretëri tjetër të përhershme e të qëndrueshme që të shfaqë Madhështinë dhe Lartësinë e Fuqisë së Tij!..

Gjithashtu, nuk do të ishte e mundur nga asnjë këndvështrim që Krijuesi i Përjetshëm i Cili krijoi këtë botë të përkohshme, të mos krijonte një botë tjetër të përhershme!..

Nuk do të ishte gjithashtu e mundur që Krijuesi i përjetshëm ta krijonte këtë botë të mahnitshme kalimtare dhe të mos krijonte një botë tjetër të qëndrueshme e të vazhdueshme!..

Do të ishte e pamundur gjithashtu, që Krijuesi i Gjithurtë, i Gjithë-fuqishëm, i Gjithëmëshirshëm dhe Shpikësi i kësaj dynjaje, e cila është si një ekspozitë, ose si një fushë testimi, ose si një fushë bujqësore, të mos krijojë gjithashtu një botë tjetër në të cilën do të shfaqen qëllimet e kësaj bote dhe do të zbulohen objektivat e saj!..

Hyrja për tek kjo e vërtetë do të jetë nëpërmjet **"Dymbëdhjetë Dyerve"**, dhe ato Dymbëdhjetë Dyer do të hapen me anë të **"Dymbëdhjetë të Vërtetave"** të tjera. Ne do të fillojmë me më të shkurtrën dhe më të thjeshtën e atyre:

E VËRTETA E PARË

Porta e Hyjnisë dhe e Sovranitetit,

Shfaqja e Emrit Er-Rabb, Mbështetësi.

A do të ishte e mundur që Lavdia e Hyjnisë së All-llahut dhe e Sovranitetit Hyjnor të krijonte një kozmos të tillë si ky, me qëllim që të shfaqë plotësimet e Tij, me qëllime të tilla të larta e me synime fisnike, dhe pastaj të mos vendosë një shpërblim për ata besimtarë të cilët nëpërmjet besimit e adhurimit iu përgjigjën këtyre qëllimeve e synimeve!.. Ose që Ai të mos dënojë ata njerëz të çudhëzuar të cilët mohojnë dhe përbuzin qëllimet e Tij!..

E VËRTETA E DYTË

Porta e Bujarisë dhe e Mëshirës,

Shfaqja e Emrave El-Kerim, Er-Rahim, Gjithëbujari, Mëshirëploti.

A do të ishte e mundur që Sunduesi i kësaj bote, i Cili në veprat e Tij demonstron një bujari të pafund, një mëshirë të pafund, një madhështi të pafund dhe një lavdi të pafund, të mos u japë një shpërblim, në një mënyrë që t'i përshtatet Shpirtmadhësisë dhe Mëshirës së Tij, atyre që veprojnë mirë dhe të mos dënojë, në një mënyrë që t'i përshtatet Madhështisë dhe Lavdisë së Tij, atyre që bëjnë keq!

Po, nëse dikush do të hidhte vështrimin tek natyra e ngjarjeve në këtë botë, do të shikonte se të gjitha qënieve të gjalla duke filluar nga më e dobëta e më e pafuqishmja[245] e duke përfunduar me më të fuqishmen, u jepet ushqimi e rizku në formën më të përshtatshme. Në të vërtetë, më të dobtëve e më të pafuqishmëve u jepet forma më e mirë e ushqimit, dhe atyre që kanë halle e derte u vjen shërimi e dermani në mënyrë të papara-shikueshme. Kjo bujari e mirësi shpërndahet me një zemërgjërësi të lartë të tillë, saqë në mënyrë të vetëkuptueshme, na tregon se është një Dorë e një bujarie të pafund ajo që vepron e drejton çështjet.

Për shembull, në pranverë, të gjitha pemët vishen me rroba aq të bukura si mëdafshi, sikur të ishin Huritë e Xhennetit; Ato vishen e stolisen me lule e fruta, sikur të ishin xhevahire, dhe nxiten e bëhen të na japin asortimente të shumta prej frutave më të mirë e më të shijshëm të bëra me urtësi në degët e tyre të shtrira të cilat janë në duart e tyre të buta e delikate. E ngjashme me këtë, neve na jepet për të ngrënë mjalti më i mirë i ëmbël dhe shërues nga dora e një blete helmuese, ne vishemi me rrobat më

---

[245] Prova vendimtare se ushqimi hallall jepet sipas nevojës dhe nuk merret nëpërmjet ushtrimit të forcës është: bollëku i mjeteve të jetesës së të vegjëlve të cilët nuk kanë fuqi dhe ngushtica e vështirësia e ushqimit të egërsirave; trashësia e peshqëve që nuk kanë zgjuarsi, dhe dobësia e dhelprave dhe e majmunëve që kanë zgjuarsi e dinakëri. Atëherë, ushqimi vjen në raport të kundërt me zgjedhjen dhe me forcën.

Domethënë, sa më shumë që një qenie të mbështetet tek forca dhe tek fuqia e përzgjedhjes, më të vështirë do ta ketë ajo sigurimin e mjeteve të jetesës.

të bukura e më të buta nëpërmjet një insekti që nuk ka duar; dhe brenda një fare shumë të vockël ruhet për ne një thesar i madh mëshire. Kjo, në mënyrë të vetëkuptueshme, tregon se e gjitha kjo është efekti i bujarisë më të bukur dhe i ndjenjës më të hollë të Mëshirës.

Atëherë, gjithashtu, fakti se me përjashtim të njeriut dhe të disa kafshëve të egra, të gjitha gjërat duke filluar nga dielli, hëna e toka, deri tek krijesa më e vogël, i kryejnë funksionet e tyre me përpikërinë më të madhe, nuk kalojnë caqet e tyre as edhe një fije, dhe i përmbahen një bindjeje të përgjithshme me një shpirt e me nderim të madh; kjo na tregon se ato veprojnë me urdhrin e Zotëruesit të Lavdisë e të Dinjitetit të madh.

Gjithashtu është e qartë se mënyra në të cilën të gjitha nënat, në botët bimore, shtazore e njerëzore u shkojnë në ndihmë të dobtëve të tyre dhe fëmijëve të pafuqishëm me ushqimin e butë të qumështit, me një dhembshuri e mëshirë të hollë,[246] padyshim ky është një tregues i Mëshirës gjithëpërfshirëse të All-llahut.

Meqenëse Krijuesi i kësaj bote ka një Bujari kaq të gjërë, një Mëshirë të tillë të pafund dhe një Madhështi e Lavdi absolute... atëherë, Madhështia e Tij absolute dhe Lavdia kërkojnë ndëshkimin dhe disiplinimin e të pasjellshmëve; dhe se Bujaria e Tij e gjërë kërkon mirësi të pafund, dhe Mëshira e Tij e pafund kërkon një mirëbërje që i përshtatet asaj.

Por, në këtë botë kalimtare dhe në këtë jetë të shkurtër, vetëm një e milionta pjesë nga gjithë kjo, si një pikë nga oqeani, realizohet dhe shfaq

---

[246] Fakti që një luaneshë e uritur do të preferonte këlyshin e saj mbi vetveten dhe i jep atij një copë mish që ndryshe do ta kishte ngrënë; Fakti që pula frikacake do të sulmonte një qen apo luan për të mbrojtur zogjtë e saj të vegjël; fakti se pema e fikut ndërsa vetë ushqehet me baltë me qëllim që të prodhojë për të vegjëlit e saj –të cilët janë frutat e saja– qumësht të pastër... kjo në mënyrë të vetëkuptueshme u tregon atyre që nuk janë të verbër se edhe ato veprojnë në përputhje me urdhërat e Qënies së vetme që mëshira, bujaria dhe dhembshuria e të Cilit janë të pafund.

Përsëri, fakti që edhe bimët, edhe kafshët e pavetëdijshme funksionojnë në mënyrën më të urtë e më të vetëdijshme tregon, në mënyrë të pakundërshtueshme, se Një i Gjithëditur Absolut dhe Një i Gjithurtë Absolut është Ai i cili i ka vendosur ato në punë dhe i bën ato të veprojnë në Emrin e Tij...

vetveten. Atëherë duhet të jetë një botë tjetër lumturie që t'i përshtatet asaj Bujarie të gjërë, dhe të harmonizohet me atë Mëshirë të pafund. Ose ndryshe, njeriu duhet të mohonte edhe ekzistencën dhe mëshirën që është e dukshme për ne, dhe kjo do të ishte tamam si të mohoje ekzistencën e diellit, i cili mbush secilën ditë me dritën e tij; sepse, zhdukja e pakthyeshme do ta transformonte mëshirën në fatkeqësi, dashurinë në dhimbje, bekimin në shpagim, mendjen në një instrument mjerimi, kënaqësinë në vuajtje, dhe se pikërisht esenca e dashurisë së All-llahut xh.sh. do të zhdukej.

Gjithashtu, duhet të jetë një botë dënimi e përshtatshme për Lavdinë dhe për Dinjitetin e All-llahut xh.sh., sepse në përgjithësi, shtypësi e lë këtë botë ndërsa ende mban fuqinë dhe kryelartësinë e tij, dhe i shtypuri e lë botën duke qenë akoma i poshtëruar e i nënshtruar. Pastaj që të dy udhëtojnë duke u larguar nga kjo botë pa dënim e pa shpërblim. Atëherë çështjet janë shtyrë për tek Gjykata më e Lartë; pra ata nuk janë lënë pas dore.

Ndonjëherë ndodh që dënimi jepet në këtë botë. Torturat që kanë vuajtur njerëzit kundërshtarë e të pabindur në shekujt e kaluar tregojnë se njeriu nuk lihet në tekat e tij, dhe se ai gjithmonë zbulohet para goditjeve të All-llahut të Madhështisë e të Krenarisë.

Po, a është e mundur që ky njeri të cilit iu besua, midis të gjitha krijesave, një mision i madh dhe që u pajis me kapacitetet më të rëndësishme të bashkëlindura, në qoftë se nuk e njeh All-llahun e tij "me besim", pasi Krijuesi e bëri Vetveten të njohur te ai me të gjitha veprat e Tij të mrekullueshme e të mirorganizuara; në qoftë se njeriu nuk e arrin dashurinë e All-llahut xh.sh. duke u afruar te Ai përmes "adhurimit", pasi All-llahu xh.sh. e bëri Vetveten e Tij të dashur tek njeriu nëpërmjet shumëllojshmërisë së frutave të pafundme të zbukuruara që tregojnë Mëshirën e Tij të gjërë; dhe në qoftë se njeriu nuk do të tregonte respektin dhe madhështinë e duhur me "falënderim dhe mirënjohje", pasi Krijuesi e shfaqi dashurinë e Tij për njeriun dhe Mëshirën e Tij mbi të nëpërmjet mirësive të Tij të shumta... Atëherë, në qoftë se njeriu nuk do ta njihte këtë Krijuesin e tij, si mund të lihet ai në tekat e tij e të mbetet i pandëshkuar, ose

si Krijuesi i Gjithëfuqishëm i Madhështisë dhe i Lavdisë të mos bëjë për njeriun një botë për ndëshkim e shpagim?

Nga ana tjetër, a do të ishte e mundur që *i Gjithëmëshirshmi e Mëshirëploti* të mos përgatisë një botë shpërblimi dhe lumturie të përjetshme për ata besimtarë të cilët i përgjigjen bërjes të njohur të All-llahut të Gjithëmëshirës dhe Zemërgjërësisë së pafund me njohjen e Tij përmes besimit; që i përgjigjen bërjes të dashur të Madhështisë së Tij duke e dashur Atë përmes adhurimit, dhe i përgjigjen Mëshirës së Tij ndaj tyre me nderim e madhërim duke bërë falënderime e duke qenë mirënjohës!

E VËRTETA E TRETË

Porta e Urtësisë dhe e Drejtësisë,

Shfaqja e Emrave El-Hakim, El-A'dilu, i Gjithurti, i Drejti.

A do të ishte e mundur që[247] ***i*** Gjithëlavdishmi Absolut, i Cili e demonstron Sovranitetin e Tij Hyjnor me urtësinë dhe rregullsinë më të lartë dhe me drejtësinë dhe ekuilibrin më të madh që sundon në të gjitha gjërat,

---

[247] Shënim: Fjalia**, "A do të ishte e mundur që?"** në këtë të vërtetë përsëritet shumë herë, sepse ajo shpreh misterin më domethënës. Çudhëzimi dhe mungesa e besimit përgjithësisht burojnë nga zakoni apo shprehia e të imagjinuarit të gjërave të jenë të pamundshme dhe shumë larg peshës së arsyes, dhe kështu i mohon ato.

Tani, në këtë diskutim të Ringjalljes, është demonstruar në mënyrë vendimtare se pamundësia e vërtetë, absurditeti dhe paarsyeshmëria, dhe vështirësia e vërtetë deri në pamundësi i përkasin rrugës së mosbesimit dhe metodës së çudhëzimit, ndërsa mundësia e vërtetë, lehtësia deri në domosdoshmëri dhe arsyeshmëria e vërtetë janë veçoritë e rrugës së besimit dhe të udhës së Islamit.

Shkurtazi: Filozofët kanë rënë në mohim për shkak të vlerësimit të tyre për gjërat si të pamundura, ndërsa Fjala e Dhjetë, diskutimi i ringjalljes, nëpërmjet fjalisë së përsëritur, "A do të ishte e mundur?" tregon se ku qëndron pamundësia, dhe kështu u jep atyre një goditje në gojë.

duke filluar nga grimcat e atomit gjer tek diejt, të mos i trajtojë me mirëbërësi ata besimtarë të cilët kërkojnë strehim nën krahun mbrojtës të Hyjnisë, të cilët besojnë në urtësinë e në drejtësinë e Tij, dhe që veprat e të cilëve janë vetëm për qëllimin e adhurimit të Tij dhe për kënaqësinë e Tij!.. Përsëri, a do të ishte e mundur që Ai të mos i ndëshkonte ata njerëz të pagdhendur e kundërshtarë të cilët nuk besojnë në urtësinë e Tij e në drejtësinë, dhe që ngrenë krye kundër Tij me arrogancë?

Tani, ndërsa njeriu nuk e merr shpërblimin ose dënimin e merituesheëm në këtë jetë të përkohshme në mënyrën që t'i përshtatet asaj urtësie dhe asaj drejtësie, por merr veçse një të një mijën, atëherë kjo është shtyrë për më vonë, pasi shumica e njerëzve të çudhëzuar e lënë këtë botë duke qenë të pandëshkuar, dhe shumica e njerëzve të udhëzimit largohen nga kjo botë pa u shpërblyer.

Domethënë, të gjitha gjërat janë shtyrë për tek një Gjykatë e Lartë Drejtësie, pra tek lumturia më e madhe.

Po, është e qartë se Ai, i Cili e kontrollon këtë botë, vepron kështu në harmoni me një urtësi të pafund. A kërkon ti një provë për këtë? Hidhe vështrimin tek përkujdesja e Krijuesit në ruajtjen e intereseve dhe të dobive tek çdo gjë. A nuk e sheh se dobi të shumta urtësie janë synuar tek të gjitha gjymtyrët, kockat dhe tek venat e njeriut, madje edhe në qelizat e trupit të tij dhe në çdo grimcë e vend të trupit të tij? A nuk shikon se në disa nga gjymtyrët e trupit të tij ndodhen aq shumë dobi urtësie sa frutat që prodhon një pemë? E gjitha kjo tregon se çështjet janë bërë në përputhje me një dorë urtësie të pafund.

Ekzistenca e rregullsisë më të madhe në bërjen e të gjitha gjërave me një krijim mjeshtëror tregon se ato realizohen me një urtësi të pafundme. ***Po, përfshirja e programit të saktë të zhvillimit të një luleje të bukur brenda një fare të vockël dhe shkrimi i fletës së punëve të një peme gjigante, të historisë së jetës së saj dhe të listës së pajisjeve, duhet të jetë e shkruar në bërthamën e saj nga Pena e kaderit jolëndor... kjo na tregon se një penë e urtësisë absolute është në punë.***

Ekzistenca në një shkalle të lartë e një mjeshtërie të hollë artistike në krijimin e të gjitha gjërave provon se ekziston gjithashtu shenja dalluese e Një Krijuesi të Gjithurtë Absolut. Për më tepër, përfshirja e indeksit të të gjitha krijesave, çelësat e të gjitha thesareve të Mëshirës dhe pasqyrat e të gjithë Emrave Hyjnorë në këtë trup të vogël të njeriut, demonstrojnë ekzistencën e urtësisë së pafund brenda asaj mjeshtërie të hollë artistike.

Tani a do të ishte e mundur që urtësia, e cila depërton tek këto zhvillime e çështje Hyjnore, të mos dëshirojë përjetësisht t'u bëjë mirë atyre që kërkojnë mbrojtje nën Krahun e Hyjnisë dhe që shfaqin bindje në besim!?

Dhe, a dëshiron ti një provë se të gjitha gjërat janë bërë me drejtësi dhe ekuilibër? Fakti se të gjitha gjërat janë pajisur me ekzistencë, se atyre u është dhënë forma, dhe se ato janë vendosur në vendin e tyre të përshtatshëm, në përputhje me një drejtpeshim të saktë dhe me masën e duhur, tregon se të gjitha çështjet janë bërë në përputhje me një drejtësi absolute e me ekuilibër.

Dhe e ngjashme me këtë, fakti se të gjitha gjërave u janë dhënë të drejtat e tyre në përputhje me aftësitë e tyre të natyrshme dhe se ato i marrin të gjitha gjërat e domosdoshme të ekzistencës së tyre dhe të gjitha nevojat e qëndrueshme në formën më të përshtatshme, tregon se kjo gjithashtu është shenja dalluese e lënë nga një Dorë e një drejtësie absolute.

Dhe, përsëri, fakti që përgjigjja i jepet gjithmonë çdo lutjeje dhe kërkese të bërë nga gjuha e gjendjes së natyrshme dhe e nevojës natyrale ose e domosdoshmërisë, demonstron ekzistencën e drejtësisë absolute dhe të urtësisë së pafund.

Tani, a do të ishte e mundur që ajo drejtësi dhe ajo urtësi ta neglizhonin atë nevojë të madhe të njeriut, më të lartit të krijesave, e cila është nevoja e qëndrueshmërisë? Në një kohë që ato të dyja i përgjigjen nevojës më të vogël të krijesës më të dobët? A do të ishte e mundur që ato të dyja të mos i përgjigjeshin përgjërimit më të madh që ai dëshiron, dhe kërkesës së tij për ndihmë, dhe të mos ruajnë dinjitetin e Hyjnisë së Tij, të lënë pas dore përmbushjen e të drejtave të shërbëtorëve të Tij!.. Por njeriu, jeta e të cilit

është kaq e shkurtër, nuk e përjeton dhe nuk mundet ta përjetojë esencën e vërtetë të drejtësisë në këtë botë të përkohshme; për këtë arsye çështjet janë shtyrë për një Gjykatë të Lartë, sepse drejtësia e vërtetë kërkon që njeriu i vogël të shpërblehet e ndëshkohet, jo në përputhje me vogëlsinë e tij, por në përputhje me madhësinë e krimit të tij, në përputhje me rëndësinë e natyrës së tij dhe në përputhje me madhështinë e misionit të tij. Meqenëse kjo dynja kalimtare dhe e përkoh-shme është shumë larg nga shfaqja e një urtësie të tillë dhe të një drejtësie për njeriun, i cili është krijuar për përjetësi... Atëherë, padyshim, nga domosdoshmëria, do të jetë një Parajasë e përjetshme dhe një Ferr i përhershëm i Atij të Drejtit, Zotëruesit Madhështor të Bukurisë, i Atij të Gjithurti Hirplotë të Lavdisë.

E VËRTETA E KATËRT

Porta e Zemërgjërësisë dhe e Bukurisë,

Shfaqja e Emrave El-Xhevadu, El-Xhemilu, Zemërgjëri, Hirploti, (i Bukuri).

A do të ishte e mundur që një zemërgjërësi e pafund e një dorëgjërësi, një pasuri e pashtershme dhe thesare të pasosura, një bukuri e pashoqe e përjetshme, dhe një plotësim i patëmetë e i përhershëm, të mos kërkonin ekzistencën e një banese lumturie dhe ekzistencën e një vendi pushimi e gostie, ku të jetonin përjetësisht ata që kanë nevojë për zemër-gjërësi, që janë mirënjohësit e saj dhe shikuesit e përmalluar për Bukuri, dhe admiruesit e saj?

Po, stolisja e faqes së botës me të gjitha këto objekte bukurie, krijimi i Diellit e i Hënës si llambat e saj, mbushja e sipërfaqes së tokës me shumëllojshmërinë e ushqimeve më të shijshme, duke e bërë kështu atë një tryezë mirësish dhe duke i bërë pemët frutore enë e pjata të shumta që përtërihen disa herë në çdo stinë, e gjitha kjo tregon ekzistencën e një zemërgjërësie e dorëgjërësie të pafund.

Një zemërgjërësi e dorëgjërësi e tillë dhe ato thesare të pashtershme mëshire, kërkojnë ekzistencën e një shtëpie gostie dhe të një vendi lumturie që të jenë të përhershme dhe të përfshijnë të gjitha gjërat e dëshirueshme e tërheqëse brenda tyre.

Dhe sigurisht ato kërkojnë që ata të cilët do të gëzojnë një lumturi të tillë duhet të qëndrojnë në atë shtëpi gostie përjetësisht, pa vuajtur dhimbjen e zhdukjes e të ndarjes; sepse, ashtu si pushimi i dhimbjes që është një formë kënaqësie, gjithashtu ndërprerja e kënaqësisë është një formë dhimbjeje; kështu një zemërgjërësi dhe një dorëgjërësi e tillë e refuzojnë në mënyrë të prerë dëmtimin.

Domethënë, çështja kërkon ekzistencën e një Xhenneti të përher-shëm dhe ekzistencën e lutësve të nevojshëm që të banojnë përjetësisht në të, sepse zemërgjërësia e pafund dhe Dorëgjërësia kërkojnë një bamirësi e mirëbërësi të pafund. Mirëbërja dhe bamirësia e pafund kërkojnë, me radhë, mirënjohje e mirësi. Kjo bën të domosdoshme ekzistencën e përjetshme të atyre që marrin të gjitha mirësitë me qëllim që ata të shfaqin falënderimet e tyre dhe mirënjohjen për ato dhurata të përjetshme dhe për ato mirësi të vazhdueshme. Përndryshe një kënaqësi e vogël, të cilën e hidhëron zhdukja e ndarja dhe që zgjat vetëm për një kohë të shkurtër, nuk është e pajtueshme me kërkesat e zemërgjërësisë dhe të dorëgjërësisë.

Dhe pastaj hidhe vështrimin në trevat e ndryshme të botës, secila është si një ekspozitë e Krijuesit Shpikës. Kushtoju vëmendjen Njof-timeve Hyjnore[248] që janë në duart e të gjitha bimëve dhe kafshëve në sipërfaqen e tokës dhe dëgjoji profetët dhe evlijatë, lajmëtarët e Bukurive të Hyjnisë. Ata, njëzëri, tregojnë plotësimet e patëmeta të Krijuesit të Gjithëlavdishëm duke

[248] Po, lulja e bukur që është në skajin më të lartë të stolisjes e të zbukurimit, dhe fruti i shndëritshëm që është në shkallën më të lartë të mjeshtërisë e të perfeksionimit, të cilat varen me një fije të hollë në fundin e degëve të thata si kockë... padyshim kjo është një afishe, një shpallje për të gjitha qëniet e vetëdijshme duke i bërë ata të lexojnë artet e bukura të prodhuara nga një Krijues Mrekullibërës e i Gjithurtë. Ky krahasim vlen jo vetëm për botën bimore, por gjithashtu edhe për botën shtazore...

demonstruar Artet e Tij të mrekullueshme, dhe kështu u bëjnë ftesë njerëzve që t'i shikojnë ato.

Domethënë, Autori i kësaj bote ka plotësimet më të rëndësishme, më të çuditshme dhe të fshehura. Janë pikërisht këto të cilat Ai dëshiron t'i shfaqë nëpërmjet arteve të Tij të mrekullueshëm, sepse plotësimi i patëmetë i fshehur kërkon që t'u shfaqet atyre që do ta vlerësojnë, që do ta admirojnë dhe me habi e shikojnë atë. ***Plotësimi i përjetshëm kërkon shfaqje të përjetshme. Dhe një shfaqje e tillë e përjetshme kërkon, me radhë, ekzistencën e përjetshme të atyre që e vlerësojnë dhe e admirojnë atë, sepse vlera e plotësimit gjithmonë do të mbytej në shikimin e admiruesit të saj, në qoftë se ky admirues është pa ekzistencë të përjetshme.*** [249]

Dhe përsëri, këto krijesa të bukura, artistike, të shndritshme e të stolisura, të cilat mbulojnë sipërfaqen e globit, tregojnë qartazi ashtu siç tregon drita në mes të ditës për ekzistencën e diellit, për hijeshinë dhe tërheqjen e një bukurie të jashtëzakonshme e të pashoqe, dhe tregojnë mahnitjet e holla të hijeshisë së pakrahasueshme e të fshehur. [250]

Çdo shfaqje e asaj Bukurie të Shenjtë të jashtëzakonshme, tregon ekzistencën e thesareve të panumërt të fshehur në secilin nga Emrat e All-llahut xh.sh.. Tani ashtu siç kërkon kjo bukuri, kaq e lartë e pashoqe dhe e

---

[249] Një ndodhi në lidhje me këtë pikë u bë proverb. Një herë një bukuroshe e famshme dëboi nga prania e saj një njeri të zakonshëm i cili ishte dashuruar marrëzisht pas saj. Atëherë, me qëllim që të ngushëllonte vetveten, ai tha: "Sa e shëmtuar është!", duke mohuar kështu bukurinë e saj.

Gjithashtu, një herë një ari qëndroi nën ca pjergulla rrushi, dhe dëshiroi të hante nga ato kokërra të ëmbëla rrushi, mirëpo kur dora e tij nuk i arriti dot, dhe kur i pamundur të ngjitej në pjergull, tha me vete në formë ngushëllimi, se rrushi duhet të jetë i thartë, i pabërë dhe duke hunguruar vazhdoi rrugën e tij.

[250]Megjithëse të gjitha qëniet që veprojnë si pasqyra për bukurinë e All-llahut xh.sh. shuhen e zhduken vazhdimisht, por ato që vijnë pas tyre tregojnë e shfaqin, në format e tyre e në veçori, të njëjtën bukuri e hijeshi, kjo tregon se ato bukuri nuk u përkasin atyre... por shembujt e dukshëm të bukurisë janë shenjat dhe treguesit e një bukurie të jashtëzakonshme e të shenjtë.

fshehur, të tregojë joshjet e saj në një pasqyrë reflektuese, dhe t'i shikojë vlerat e hijeshisë së saj, shkallët dhe masat e bukurisë së saj me një pasqyrë që ka ndjeshmëri e përmallim për të, po ashtu ajo dëshiron të bëhet e dukshme, me qëllim që ta shikojë edhe Vetë atë bukuri nëpërmjet syve të të tjerëve. Domethënë, së pari, ajo dëshiron ta shohë bukurinë e vet duke e shikuar vetveten në pasqyra të ndryshme shumëngjyrëshe. Së dyti, duke e shikuar bukurinë nëpërmjet shikimit të shikuesve të për-malluar dhe admiruesve të habitur të saj.

Domethënë, Bukuria dhe Hijeshia kërkojnë të shohin e të shihen. Bukuria dhe hijeshia kërkojnë ekzistencën e shikuesve të përmalluar dhe të admiruesve të mahnitur. Dhe meqenëse bukuria e hijeshia janë të përjetshme e të përhershme, atëherë shikuesit e tyre dhe admiruesit duhet të kenë jetë të përjetshme.

Një bukuri e përjetshme kurrësesi nuk mund të jetë e kënaqur me një admirues i cili ndjen se do të zhduket -dhe që është dënuar për të mos u kthyer në jetë- ai sapo ta përfytyrojë ndarjen, dashuria e tij transformohet në armiqësi, admirimi i tij kthehet në tallje, dhe respekti i tij transformohet në përbuzje. Një njeri egoist e kokëfortë, ashtu siç është armik i asaj që është e panjohur për të, po ashtu ai kundërshton çdo gjë të cilën dora e tij nuk e arrin. Dhe ushqen armiqësi të fshehur, urrejtje e mohim ndaj asaj bukurie e cila meriton si përgjigje dashuri të pafund dhe përmallim e admirim të pafund. Nga kjo kuptohet sekreti i qënies së jobesimtarit armik i All-llahut xh.sh..

Atëherë, meqenëse Zemërgjërësia dhe Dorëgjërësia e pafund, Hijeshia dhe Bukuria e pashoqe dhe Plotësimi i patëmetë, që të gjitha kërkojnë përjetësinë e mirënjohësve dhe qëndrueshmërinë e admiruesve të përmalluar... Por, ne shikojmë në bujtinën e kësaj dynjaje se gjithësecili largohet shpejt nga kjo botë dhe zhduket duke qenë krejtësisht i pakënaqur duke mos shijuar mirësinë dhe shijen e asaj zemërgjërësie, përveç se të një sasie shumë të pakët e cila është sa për t'i hapur oreksin. Hapet oreksi, por duke mos ngrënë ikën; duke mos parë nga drita e asaj Bukurie dhe Plotsimi, veçse një hije të zbehtë të dritës së saj! Dhe pa u ngopur, ikën.

Domethënë, do të shkohet drejt një vendi të amshuar.

Shkurtazi: ashtu siç tregon kjo botë së bashku me të gjitha krijesat e saj në mënyrë vendimtare, ekzistencën e Krijuesit të Gjithëlavdishëm, po ashtu Atributet e Tij të Shenjta dhe Emrat tregojnë, padyshim, ekzis-tencën e botës së përtejme duke e shfaqur, madje edhe duke e kërkuar.

E VËRTETA E PESTË

Porta e Dhembshurisë dhe e Adhurimit të Muhammedit (A.S.M)

Shfaqja e Emrave El-Muxhibu, Er-Rahimu,

Përgjigjësi i Lutjes, Mëshirëploti.

A do të ishte e mundur për një Krijues që zotëron një Mëshirë e Dhembshuri të pafund, që me mëshirën më të madhe përmbush nevojën më të vogël të krijesave më të ulëta në mënyrën më të paparashikuar, që dëgjon zërin më të mbytur për ndihmë të krijesës më të fshehur, dhe i përgjigjet çdo lutësi, qoftë ai lutës me gjuhën e prirjes së tij të natyrshme ose me fjalë, - a do të ishte e mundur që një Krijues i Tillë të mos përm-bushë nevojën më të madhe të shërbëtorit të Tij më të madh[251], më të

[251]Ai, mbretëria e të cilit ka zgjatur një mijë e treqind e pesëdhjetë vjet, i cili ka përgjithësisht më shumë se treqind e pesëdhjetë milionë nënshtetas, subjektet e të cilit për çdo ditë ripërtërijnë besëlidhjen e tyre me të, për plotësimet e të cilit ata dëshmojnë vazhdimisht, urdhërave të të cilit ata u binden me nënshtrimin më të plotë, që ngjyra shpirtërore e atij personaliteti ka ngjyrosur gjysmën e globit dhe një të pestën e njerëzimit; ai personalitet është i dashuri i zemrave të tyre dhe edukatori i shpirtërave të tyre, atëherë, pa dyshim, ai personalitet është shërbëtori më i madh i Krijuesit të të gjitha botëve.

Gjithashtu, meqenëse shumica e llojeve të qënieve e përshëndesin misionin dhe mesazhin e atij personaliteti, duke mbajtur çdo lloj fruti të mrekullisë së tij, sigurisht, ai personalitet është krijesa më e dashur e Krijuesit madhështor. Gjithashtu, dëshira për përjetësi që ekziston tek të gjithë njerëzit për shkak të vetë prirjes së tyre, ajo dëshirë që e ngre njeriun nga ultësia më e ulët duke e ngjitur tek lartësia më e lartë, sigurisht është më e madhja e dëshirave dhe e kërkesave. Nuk ka dyshim se ai që i

dashurit midis krijesave të Tij, dhe të mos e ndihmonte atë në përmbushjen e lutjes së tij më të lartë?

Po, për shembull: Mirësia që shfaqet në të ushqyerit dhe në rritjen e të dobtëve dhe të vegjëlve të kafshëve tregon se Monarku i kozmosit e ushtron Hyjninë e Tij me Mëshirë të pafund. A do të ishte e mundur që një Dhembshuri e mëshirshme deri në këtë shkallë të mos pranonte lutjen më të këndshme të më të virtytshmit të krijesave! Kjo e vërtetë është shpjeguar në **"Fjalën e Nëntëmbëdhjetë"**, por le t'i kthehemi pohimit tonë për çështjen këtu:

O shok që po i dëgjon këto fjalë së bashku me nefsin tim! Ne thamë tek krahasimi se një takim i madh ndodhi në një ishull dhe se një i dërguar e një komandant i zgjedhur jepte një ligjëratë atje. Me qëllim që të zbulojmë të vërtetën e treguar në krahasim, eja dhe le të zhvishemi nga kufizimet e kohës, le të shkojmë me mendimet e përfytyrimet tona në Gadishullin Arabik tek shekulli i bekuar i profetësisë, me qëllim që ta vizitojmë e ta shikojmë të Dërguarin e nderuar a.s.m. ndërsa ai është duke kryer detyrat e tij me adhurimin më të plotë. Shiko! Ashtu siç është ai personalitet një mjet për arritjen e lumturisë së përjetshme, nëpërmjet profetësisë dhe udhëzimit, po ashtu ai është shkaku për ekzistencën e asaj lumturie dhe mjeti për krijimin e Xhennetit, përmes adhurimit të tij dhe të lutjes.

Tani shiko! Ky profet fisnik po lutet për një lumturi të përjetshme me një falje të lartë e me një adhurim të madh e të gjithanshëm, saqë sikur ky ishull, e madje e gjithë bota po falen e luten së bashku me faljen e tij të lartë, sepse adhurimi i tij përfshin brenda vetvetes jo vetëm adhurimin e komunitetit i cili e ndjek, por gjithashtu edhe adhurimin e të gjithë profetëve të tjerë, në formën e tij esenciale, në sajë të harmonisë dhe përputhshmërisë që ekziston midis atij dhe profetëve.

Për më tepër, ai po drejton një falje të tillë të lartë dhe po bën një lutje në një tubim të tillë madhështor, saqë të gjithë njerëzit më zemërndritur e

---

paraqet ato kërkesa në emër të të gjithëve tek Plotësuesi i të gjitha nevojave, sigurisht ai është më i madhi midis robërve të Tij...

të plotë, nga koha e Hazreti Ademit deri në shekullin tonë dhe gjer në Ditën e Kijametit e ndjekin atë në falje dhe u thonë *Amin* lutjeve të tij![252]

Shiko! Ai po lutet për një nevojë kaq të përgjithshme, për qëndrueshmërinë dhe përjetësinë, saqë jo vetëm njerëzit e kësaj toke, por gjithashtu edhe banorët e qiejve, si edhe tërësia e krijimit marrin pjesë në lutjet e tij dhe në mënyrë të heshtur dhe përmes gjuhës së gjendjes së tyre të natyrshme, thonë: "Po, o All-llah! Jepia dhe pranoje lutjen e tij, edhe ne gjithashtu e dëshirojmë atë.."

Dhe shiko! Ai lutet për një lumturi të përjetshme me një pikëllim aq prekës, me aq përmallim, me aq dëshirë të madhe dhe në një mënyrë aq të përgjëruar, saqë ai e bën të gjithë kozmosin të qajë dhe në këtë mënyrë të marrë edhe ai pjesë në lutjen e tij.

Shiko! ai dëshiron e lutet për një lumturi, për një qëllim të tillë dhe për një synim, saqë ai kërkon që ta shpëtojë njeriun dhe të gjitha krijesat nga rënia në humnerën më të thellë që është asgjësimi i plotë, ta shpëtojë nga humbja, kotësia, pavlefshmëria dhe nga paqëllimshmëria dhe t'i ngrejë ato në majat e vlefshmërisë, përjetësisë, funksionit të lartë, dhe në rangun e qënies së tyre shkrime të shkruara nga All-llahu xh.sh..

Shiko! ai e bën lutjen e tij me një përgjërim aq të madh duke kërkuar ndihmë, dhe i bën duatë me një dëshirë aq të fortë duke kërkuar mëshirë, saqë sikur ai i bën të gjitha qëniet, qiejt dhe madje edhe vetë Fronin e All-

[252] Qysh nga koha kur Profeti, bëri së pari lutjen e tij deri në kohën aktuale, të gjitha salavatet e bekimet që bëhen e i dërgohen atij nga komuniteti i tij janë një lloj "Amini" i përjetshëm për duanë e tij, një formë e pjesëmarrjes së përgjithshme në të. Çdo salat e selam mbi të që bëhet nga antarët e komunitetit mysliman gjatë kryerjes së faljes, gjithashtu duaja e shfaqur pas thirrjes së ikametit, sipas medhhebit Shafii është vetëm se një "Amin" i fuqishëm e i përgjithshëm për lumturinë e përhershme.

Profeti a.s.m. në duanë e tij dëshiron lumturi të përjetshme, dhe pikërisht kjo është ajo të cilën e dëshiron me të gjithë fuqinë e gjuhës së gjendjes së tij të natyrshme, dhe segmentet më ndri-çuese të humanizmit, thonë: "Amin" pas tij. A do të ishte e mundur që një dua e tillë të mos pranohet?

llahut xh.sh. ta dëgjojnë, e të kalojnë në ekstazë, duke i thënë duasë së tij. *"Amin, o All-llah, Amin!"*[253]

Shiko! Ai kërkon lumturi e përjetësi, dhe përmbushjen e tyre e shpreson nga Një Gjithëdëgjues, Gjithëbujar, Fuqiplotë dhe nga një Gjithëshikues, Mëshirëplotë dhe i Gjithëditur, i Cili shikon e dëgjon dëshirën dhe kërkesën më të fshehur të krijesës më të dobët dhe e mbështet me Mëshirën e Tij dhe i përgjigjet asaj edhe sikur ajo të ishte një lutje e bërë nga gjuha e gjendjes së saj të natyrshme. Po, Ai i përgjigjet asaj me njohuri e mëshirë dhe e ndihmon atë me një urtësi të tillë, saqë nuk mbetet më asnjë dyshim, se ajo përkujdesje e jashtë-zakonshme mund të vijë vetëm nga Gjithëdëgjuesi dhe

[253] Në të vërtetë, në asnjë mënyrë nuk do të ishte e mundur që Krijuesi i kësaj bote, me të gjithë administrimin e Tij, të mos shikonte veprat e atij profeti i cili gëzon pozitën më të lartë midis krijesave të tij, në një kohë që Ai Krijues vepron në Kozmos me të gjithë njohurinë e urtësinë, siç shihet qartë...

Gjithashtu në asnjë mënyrë nuk do të ishte e mundur që Ai Krijues i Gjithëditur të qëndronte indiferent ndaj veprave dhe lutjeve të këtij shërbëtori më të zgjedhur dhe të mos i jepte rëndësi.

Gjithashtu, në asnjë mënyrë nuk do të ishte e mundur që Ai Krijues i Githëfuqishëm e i Gjithëmëshirshëm të mos u përgjigjej atyre duave e lutjeve duke qëndruar indiferent.

Po, nëpërmjet dritës së Profetit Muhammed a.s.m., forma e botës ka ndryshuar. Esenca e vërtetë e njerëzimit dhe ajo e të gjitha qënieve në Kozmos u bë e qartë nëpërmjet asaj drite dhe atij ndriçimi; kështu u bë e qartë se krijesat kanë secila mesazhet e Krijuesit të përjetshëm duke shpallur Emrat e bukur Hyjnorë, se ato janë të urdhëruara e të ngarkuara me funksione të ndryshme, se janë krijesa të çmueshme me kuptim e domethënie dhe të destinuara për të shfaqur përjetësi. Po të mos kishte qenë ajo Dritë, ekzistencat do të ishin dënuar me asgjësim të plotë, gjithçka do të ishte e pavlefshme, e pakuptimtë, e padobishme, e kotë, e ngatërruar, rezultat i rastësisë së verbër dhe e zhytur në errësirën e iluzionit**.**

Për shkak të këtij misteri, ashtu siç i thonë njerëzit "Amin" duasë së Profetit a.s.m., gjithashtu të gjitha qëniet e tjera nga sipërfaqja e tokës gjer tek Froni i All-llahut xh.sh., dhe nga dheu gjer tek yjet krenohen me dritën e profetit a.s.m., dhe shpallin lidhjen e tyre me të. Në të vërtetë, vetë shpirti i adhurimit të Profetit a.s.m. nuk është tjetër veçse duaja e lutja. Përsëri, të gjitha lëvizjet dhe shërbimet janë një lloj duaje. Për shembull: zhvillimi i bërthamës deri sa bëhet pemë është një lloj duaje për Krijuesin...

nga Gjithëshikuesi i Vetëm, dhe se ai administrim i hollë mund të vijë vetëm nga Gjithëbujari dhe i Gjithëmëshirshmi i Vetëm...

Le të dëgjojmë se për çfarë po lutet krenaria e qënieve, ai burim nderi i të gjithë njerëzimit, ai person i rrallë në të gjithë krijimin, i cili e udhëheq të gjithë njerëzimin dhe duke qëndruar mbi këtë tokë ngre lart duart e tij drejt Fronit të All-llahut duke u lutur me një dua, e cila në realitetin e saj përfshin esencën e adhurimit të të gjithë njerëzimit.

Shiko! Ai lutet për një lumturi të përhershme për veten e për komunitetin e tij. Ai lutet për përjetësi e Xhennet. Ai i kërkon ato dhe i dëshiron me të gjithë Emrat e Bukur Hyjnorë që shfaqin bukurinë e tyre në pasqyrat e të gjitha qënieve të krijuara. Ti, sigurisht, mund ta shikosh se ai po kërkon ndërmjetësim prej atyre Emrave të Bukur Hyjnorë.

Në qoftë se nuk do të kishte pasur prova dhe shkaqe të panumërta për ekzistencën e botës së përtejme, atëherë një lutje e vetme nga ky profet i lartësuar do të ishte e mjaftueshme për krijimin e Xhennetit [254] gjë e cila është aq e lehtë për Fuqinë e Krijuesit të Gjithëmëshirshëm sa ajo e krijimit të pranverës. Në të vërtetë, Ai i Cili e bëri sipërfaqen e tokës në pranverë një shembull të ringjalljes, dhe me fuqinë e Tij absolute krijon e sjell në të njëqind mijë shembuj nga shembujt e ringjalljes, si mund të ishte e vështirë për Të krijimi i Xhennetit?

---

[254] Shfaqjet e modeleve të mahnitshme artistike janë të panumërta në faqen e tokës, e cila është si një faqe e ngushtë dhe e vogël në krahasim me botën e gjërë të Ahiretit; po kështu, shfaqja e modeleve të ringjalljes dhe të Kijametit në treqind mijë prej krijesave me rregullsi e drejtpeshim, dhe shkruajtja e tyre në atë fletë të vetme me këtë sistem të mrekullueshëm, pa dyshim këto janë më të vështira se sa përgatitja e strukturës së hollë e simetrike të Xhennetit në botën e gjërë të përjetësisë.

Prandaj, mund të thuhet se, krijimi i kopshteve të pranverës së bashku me lulet dhe aromat që ato përmbajnë, është një çështje më e vështirë dhe që ngjall më shumë çudi e habi se sa krijimi i Xhennetit, në krahasim me cilëndo shkallë të Xhennetit që është më e lartë se pranvera.

Atëherë ashtu siç ishte mesazhi i profetit a.s.m. shkak për themelimin e kësaj bote testimi, duke qenë një tregues i thënies لَوْلَاكَ لَوْلَاكَ لَمَا خَلَقْتُ الْأَفْلَاكَ *"po të mos ishe ti, Unë nuk do ta kisha krijuar gjithësinë",* po ashtu adhurimi që ai bëri, u bë shkak për hapjen e botës së lumturisë së përjetshme.

A do të ishte e mundur që Plotësimi i patëmetë i mjeshtërisë artistike i cili huton mendjet, Bukuria e pashoqe e Hyjnisë e shprehur në rregullin e botës, dhe ajo Mëshirë e gjithanshme, të mos i përgjigjeshin lutjes së tij, dhe kështu të toleronin një formë të skajshme të shëmtisë, mizorisë dhe çrregullimit? Domethënë të mos ia përmbushte, të mos ia dëgjonte dhe të mos ia realizonte atij dëshirat më të rëndësishme e më të domosdoshme, në një kohë që Ai dëgjon dëshirat më të vogëla e më të parëndësishme, duke ia plotësuar secilit nevojën e tij? Jo, njëqind mijë herë, jo! Një Bukuri e tillë kurrë nuk do ta pranonte një shëmti të tillë dhe kurrë nuk do të bëhej vetë e shëmtuar. [255]

Atëherë, profeti a.s.m. ashtu siç hapi portat e kësaj bote me profetësinë e tij, po ashtu ai do t'i hapë portat e botës së përtejme me adhurimin e tij.

[255] Është rënë dakord me unanimitet se përmbysja e të vërtetave është e pamundur. Është krejtësisht e pamundur që ndonjë gjë të bëhet po e kundërta dhe e anasjellta e vetvetes, dhe është e pamundur me shkallën e një mijtë që diçka e kundërt, e cila ruan pikërisht natyrën e saj, njëkohësisht të bëhet e njëjtë me të kundërtën e vetvetes ashtu si të kthehej bukuria absolute -ndërsa qëndron dhe ruhet ajo bukuri- në një shëmti reale! Atëherë, transformimi i bukurisë së qartë e të dukshme Hyjnore në të kundërtën e saj, ndonëse ajo e ruan përjetësisht esencën dhe qëndrueshmërinë si një bukuri e tillë, është pamundësia më e çuditshme në vlerësimet e logjikës që ajo të kthehet në shëmti...


عَلَيْهِ صَلَوَاتُ الرَّحْمٰنِ مِلْءَ الدُّنْيَا وَدَارِ الْجِنَانِ ۞ اَللّٰهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلٰى عَبْدِكَ
وَرَسُوْلِكَ ذٰلِكَ الْحَبِيْبُ الَّذِىْ هُوَ سَيِّدُ الْكَوْنَيْنِ وَفَخْرُ الْعَالَمَيْنِ وَحَيَاةُ
الدَّارَيْنِ وَوَسِيْلَةُ السَّعَادَتَيْنِ وَذُو الْجَاهَيْنِ وَرَسُوْلُ الثَّقَلَيْنِ وَعَلٰى آلِهٖ
وَصَحْبِهٖ اَجْمَعِيْنَ وَعَلٰى اِخْوَانِهٖ مِنَ النَّبِيِّيْنَ وَالْمُرْسَلِيْنَ آمِيْن

Bekimet e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm qofshin mbi të, me shkallën e të gjithë asaj që përfshijnë kjo botë dhe Xhenneti. O All-llah! Jepi bekime e paqe shërbëtorit Tënd dhe të dërguarit Tënd, atij të dashuri i cili është shkëlqesia e të dyja botëve, krenaria e të dyja botëve, burimi i jetës në të dyja botët, mjeti i arritjes së lumturisë këtu dhe në botën e përtejme, mbi atë që fluturon mbi dy krahët, mbi atë që është mesazhieri i njerëzve dhe i xhindeve; bekimet qofshin mbi të, mbi familjen e tij dhe mbi të gjithë sahabët e tij, si dhe mbi të gjithë vëllezërit e tij midis profetëve dhe mesazhierëve. Amin!

E VËRTETA E GJASHTË

Porta e Madhështisë dhe e Përjetësisë,

Shfaqja e Emrave El-Xheli'lu, El-Bâki, Madhështori, i Qëndrueshmi.

A do të ishte e mundur që Madhështia e Hyjnisë, e cila i nënshtron e i urdhëron të gjitha qëniet nga diejt deri tek pemët e tek grimcat sikur ato të ishin ushtarë të bindur, të neglizhonte e të mos përqëndronte vëmendjen e saj të plotë mbi qëniet e mjera të përkohshme të cilat kalojnë një jetë kalimtare në bujtinën e kësaj bote.. dhe të mos krijonte një vendbanim të lartë të përhershëm, një botë të përjetshme dhe një tregues të pafund Hyjnie?

Shfaqja e Madhështisë në gjithësi, si në ndryshimin e stinëve.. në lëvizjet madhështore të planetëve në qiej sikur ato të ishin aeroplanë, me nënshtrimet e mahnitshme të të gjitha gjërave, si krijimi i tokës sikur të ishte djepi i njeriut dhe dielli si llambë.. dhe transformimet e mëdha të tilla si ngjallja e stolisja e tokës së vdekur e të thatë, e gjithë kjo na tregon se prapa

perdes ekziston një Hyjni e Lartë dhe se një Monarki Madhështore është në veprim.

Tani një Monarki e tillë Hyjnore kërkon subjekte të denjë për Të; gjithashtu Ajo kërkon një mënyrë të përshtatshme shfaqjeje. Por, hidhe vështrimin tek kjo bujtinë e botës, dhe ti do të shohësh se klasa më e rëndësishme e subjekteve të saj e cila është pajisur me veçoritë më të larta e më gjithëpërfshirëse të detyrave, janë grumbulluar së bashku vetëm përkohësisht në dynja, në gjendjen më të mjeruar. Bujtina mbushet e zbrazet çdo ditë.

Të gjithë subjektet qëndrojnë vetëm përkohësisht në këtë banesë provimi për hir të testimit në shërbimin e tyre. Dhe vetë fusha ndryshohet në çdo orë.

Përsëri, të gjitha subjektet e Monarkisë qëndrojnë vetëm për pak minuta me qëllim që të shikojnë shembujt e mirësive të vyera të Krijuesit të Gjithëlavdishëm, për të parë veprat e Tij të mrekullueshme të artit në ekspozitën e botës me shikimin e një blerësi, dhe prej aty ata atëherë zhduken. Vetë ekspozita ndryshon në çdo minutë. Kush shkon, nuk vjen.. dhe kush vjen, shkon.

Tani, kjo gjendje e rrethanë sigurisht tregon se prapa e përtej kësaj bujtine, kësaj fushe testimi dhe kësaj ekspozite, ndodhen pallate e banesa të përjetshme që shfaqin plotësisht dhe mbështesin Sovranitetin e Përhershëm të All-llahut xh.sh., ndodhen kopshte e vendruajtje thesaresh plot me origjinalet e pastërta e të larta të formave dhe të kopjeve që ne i shohim në këtë botë. Domethënë, lufta dhe përpjekja në këtë botë, është për hir të asaj që na pret neve atje. Këtu Ai na vë në punë, dhe atje Ai na shpërblen. Dhe gjithësecili sipas aftësisë dhe përpjekjes së tij do të ketë një lumturi të madhe -në qoftë se ai nuk do ta humbiste-. Po, do të ishte e pamundur që një mbretëri e tillë e përjetshme të përqëndrohej eksklu-zivisht mbi këto qënie të mjera kalimtare...

Merre në konsideratë këtë të vërtetë nëpërmjet teleskopit të krahasimit vijues: Supozo se ti je duke ecur në një rrugë dhe shikon se në të është një

hotel i madh të cilin e ka ndërtuar një Mbret madhështor për mysafirët e tij. Shuma të pallogaritshme janë shpenzuar për stolinë e për zbukurimin e tij me qëllim që të hyjë gëzimi në zemrat e mysafirëve vetëm për një natë, dhe që ata ta marrin në konsideratë atë çfarë shikojnë.

Dhe numri i vogël i mysafirëve shikon shumë pak nga ato zbukurime, i sodisin ato vetëm për një kohë të shkurtër, duke pas shijuar shumë pak nga kënaqësitë që u ofrohen, dhe vazhdojnë rrugën e tyre pa qenë të ngopur. Por çdo mysafir merr një fotografi nga objektet në hotel nëpërmjet një kamereje të veçantë të tij. Gjithashtu, shërbëtorët e Atij Mbreti Madhështor regjistrojnë me kujdesin më të madh sjelljet e të gjithë mysafirëve dhe e ruajnë regjistrin. Dhe ti po shikon gjithashtu se Mbreti në çdo ditë po shkatërron zbukurimet më të çmueshme dhe po i zëve-ndëson ato me zbukurime të freskëta për mysafirët që arrijnë rishtas.

Edhe pasi ti e sheh të gjithë këtë, a mbetet tek ti ndonjë dyshim për Atë të Cilin e ndërtoi këtë hotel në shtratin e rrugës, dhe pyet: A ka Ai pallate të përhershëm e të lartë.. thesare të pashtershëm e të çmueshëm dhe a është Ai Zotëruesi i një bujarie të përhershme që nuk ndërpritet? Nëpërmjet Bujarisë së shfaqur në hotel, Ai synon të hapë oreksin e mysafirëve të Tij për ato gjëra që Ai i mban në prezencë të menjëhershme dhe për të ngjallur dëshirën e tyre për dhuratat që Ai ka përgatitur për ta.

Gjithashtu, në qoftë se ti do ta shikoje gjendjen e bujtinës së kësaj bote, pa rënë në dehje, ti do të kuptoje ***"Këntë Parimet"*** e mëposhtme:

- ***Parimi i parë:***

Ti do të kuptosh se kjo dynja e ngjashme me atë hotel, nuk ekziston për vetveten e saj... Është e pamundur që ajo të jetojë e ta marrë këtë formë vetvetiu. Ajo është një bujtinë e mirërregulluar që mbushet e zbrazet, dhe është e caktuar me urtësi për ta marrë karvanin e qënieve, i cili në mënyrë të vazhdueshme arrin të zbarkojë para se të largohet përsëri.

- ***Parimi i dytë:***

Dhe ti do të kuptosh gjithashtu se ata banues brenda këtij hoteli janë mysafirë. Krijuesi i tyre Gjithëbujar i fton ata për tek Banesa e Paqes.

● ***Parimi i tretë:***

Dhe ti do të kuptosh, mëtej, se zbukurimet e kësaj bote nuk janë vetëm për kënaqësi, shikim e admirim, sepse ato në qoftë se të japin kënaqësi për ca çaste, shkaktojnë dhimbje, për shkak të ndarjes nga ato për një kohë të gjatë. Ato të japin një shije dhe të mprehin oreksin, por kurrë nuk të ngopin, sepse ose jeta e kënaqësisë është e shkurtër, ose jeta jote është e shkurtër, dhe kështu nuk të majfton për të qenë i ngopur... Domethënë, këto zbukurime me një vlerë shumë të lartë e me kohëzgjatje të shkurtër, duhet të jenë për hir të nxjerrjes së mësimeve me urtësi, [256] dhe për t'i nxitur njerëzit të arrijnë e të marrin origjinalet e tyre të përjetshme. Ato, atëherë, janë për falënderime dhe për qëllime të tjera të larta përtej vetvetes së tyre.

● ***Parimi i katërt:*** Ti do të kuptosh gjithashtu se zbukurimet e kësaj bote[257] janë si modelet dhe format e bekimeve të mirësive të depozituara me Mëshirën Hyjnore në Xhennet për njerëzit e besimit

---

[256] Po, jeta e çdo gjëje është e pakët dhe afati i saj është i shkurtër, megjithëse vlera e të gjitha gjërave është e lartë dhe mjeshtëritë e tyre të holla artistike janë më të lartat e më të bukurat. Kjo nënkupton se çdo gjë është vetëm se një model, një formë e diçkaje tjetër, se ajo ka funksionin e drejtimit të shikimeve të blerësve për tek të vërtetat origjinale. Duke qenë kjo gjendja, mund të thuhet, dhe ashtu është, se zbukurimet e shumëllojshme të jetës së kësaj bote janë modelet e mirësive të Xhennetit, të përgatitura nga mëshira e të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëplotit të Vetëm për shërbëtorët e Tij të dashur.

[257] Po, ndodhen shumë qëllime për ekzistencën e çdo gjëje, dhe rezultate të shumta vijnë nga qënia e saj. Këto nuk janë të kufizuara për këtë botë e për shpirtërat e njerëzve siç e imagjinojnë njerëzit e çudhëzimit, duke qenë të humbur kështu në kotësi e paqëllimshmëri. **Përkundrazi, qëllimet për ekzistencën dhe rezultatet e qënies së të gjitha gjërave lidhen me tre kategoritë e mëposhtme:**

E para dhe më e larta është ajo që drejtohet për tek Krijuesi i saj. Domethënë: paraqitja e çudirave të mrekullueshme dhe e mjeshtërive të holla artistike përpara shikimeve të Dëshmitarit të parapërjetësisë – çka i ngjason një parade ushtarake, ku mjafton për atë shikim jeta e objektit në fjalë, sikur edhe për një çast të vetëm; madje

do të mjaftonin aftësia e asaj gjëje për të shfaqur fuqitë e saja të fshehura që i ngjasojnë qëllimit edhe pa qenë shfaqur ndonjë herë në jetë. Ky qëllim kuptohet plotësisht, për shembull, nga krijesat e holla që zhduken shpejt dhe nga farërat e bërthamat, secila si një vepër arti, që kurrë nuk ka ardhur në jetë, domethënë, kurrë nuk ka mbajtur fruta e lule. Ato të gjitha mbeten të paprekura nga kotësia e nga paqëllimshmëria. Kështu qëllimi i parë i të gjitha gjërave është që të shpallin, nëpërmjet jetës dhe ekzistencës së tyre, mrekullitë e fuqisë dhe shenjat e mjeshtërisë së Krijuesit, dhe t'ia shfaqin ato shikimit të Monarkut të Gjithëlavdishëm.

Kategoria e dytë e qëllimit të ekzistencës dhe e rezultateve të qënieve lidhet me krijesat e vetëdijshme. Çdo gjë është si një Mesazh Hyjnor e mbushur me të vërteta, është një poezi artistike, ose një fjalë urtësie e Krijuesit të Gjithëlavdishëm, të cilën e paraqet Krijuesi përpara shikimeve të engjëjve, të xhindeve, të njerëzve dhe të kafshëve, duke i ftuar ata që ta studiojnë atë. Domethënë, është një objekt për t'u shqyrtuar e për t'u nxjerrë si mësim nga çdo qënie e vetëdijshme që e shikon atë.

Kategoria e tretë e qëllimit të ekzistencës dhe e objektivit të krijesës lidhet me shpirtin e vetë asaj gjëje, si ndjeshmëria e kënaqësisë dhe e gëzimit, kalimi i jetës dhe qëndrueshmëria në të me të gjitha rehatitë.

Për shembull, në qoftë se ne marrim në konsideratë qëllimin e një shërbëtori të ngarkuar me detyrën e drejtimit të ndonjë anije të madhe mbretërore, ne shikojmë se vetëm një e qindta e atij qëllimi lidhet me vetë timonierin, domethënë, me rrogën e vogël që ai merr; ndërsa nëntëdhjetë e nëntë përqind të rezultateve të anijes lidhen me mbretin i Cili e ka në pronësi anijen.

Kështu, në qoftë se qëllimi i orientuar për tek vetë gjëja e tek dynjaja është një, qëllimet që orientohen tek Krijuesi i asaj gjëje janë nëntëdhjetë e nëntë. Në dritën e kësaj shumësie qëllimesh, ne tani mund të shpjegojmë përputhjen dhe pajtueshmërinë absolute midis Urtësisë Hyjnore dhe ekonomisë nga njëra anë, dhe midis Dorëgjërësisë e Bujarisë Hyjnore dhe sidomos dorëgjërësisë, nga ana tjetër, të cilat duken si dy të kundërta e kontradiktore. Në qëllimet më vete të gjërave, Dorëgjërësia dhe Bujaria mbisundojnë, dhe Emri El-Xhevad, Gjithëbujari, shfaqet. Nga kënd-vështrimi i qëllimit të veçantë, frutat dhe kokrrat, në të vërtetë, janë përtej llogaritjes dhe ato demonstrojnë një Bujari të pafundme. Por, në qëllimet e përgjithshme, Urtësia mbisundon dhe Emri El-Hakimu, i Gjithurti, shfaqet. Megjithatë qëllime të shumta ka një pemë, secila nga frutat e saj i përmban ato qëllime të shumta, dhe ato mund të ndahen në tre kategoritë që ne i përmendëm. Qëllimet e tyre të përgjithshme demonstrojnë një urtësi të pafund e një ekonomi të pakufishme. Urtësia e pafund bashkohet me Bujarinë absolute të cilat duken si dy të kundërta.

● ***Parimi i pestë:***

Dhe ti gjithashtu do të kuptosh se të gjitha këto objekte urtësie të përkohshëm, nuk janë krijuar për t'u parë vetëm për një kohë të shkurtër e pastaj të zhduken. Por, ato janë grumbulluar këtu dhe kanë marrë vendin e tyre dhe kërkojnë formën e tyre të dëshiruar, me qëllim që ato të vërehen, që imazhet e tyre të ruhen, që kuptimet e tyre të njihen, dhe rezultatet e tyre të regjistrohen. Kjo është kështu që, për shembull, pamjet e përhershme të mund të qëndisen për njerëzit e përjetësisë dhe që ato të mund t'u shërbejnë qëllimeve të tjera në botën e përjetësisë.

Ti do të kuptosh se gjërat janë krijuar për përjetësi, dhe jo për asgjësim; dhe sa për asgjësimin e dukshëm, ai ka kuptimin e plotësimit të detyrës dhe të çlirimit nga shërbimi, sepse çdo gjë kalimtare ecën përpara drejt asgjësimit nga një aspekt, por qëndron përjetësisht nga shumë aspekte të tjerë.

Hidhe vështrimin, për shembull, tek kjo lule e cila është një Fjalë e Fuqisë së All-llahut xh.sh.– ajo na shikon e na buzëqesh për një kohë të shkurtër dhe pastaj fshihet prapa perdes së asgjësimit. Ajo largohet ashtu sikur një fjalë duke e lënë gojën tënde, por ajo vepron kështu duke ua lënë në besim mijërat e shembujve të saj veshëve të njerëzve. Ajo i bën të përjetshëm kuptimet në mendjet e njerëzve, aq të shumta sa ato mendje. Lulja, gjithashtu duke shprehur kuptimin e saj dhe duke përmbushur kështu detyrën e saj, ikën e largohet. Por, ajo ikën duke lënë në kujtesën e cilitdo, që e shikoi atë, formën e saj të jashtme dhe pasi të ketë lënë esencën

---

Për shembull: Njëri nga qëllimet për ngritjen e një ushtrie është ruajtja e qetësisë dhe e rendit; në qoftë se do ta shihje ushtrinë nga ky këndvështrim, do të vëreje se aty ka një numër më të madh se ai që është i mjaftueshëm. Ndërsa në qoftë se ne e shikojmë ushtrinë duke marrë në konsideratë edhe qëllimet e tjera, si ruajtjen e kufijve kombëtarë, zmbrapsjen e armikut, e të tjera, aty ne do të shikojmë se numri është pothuajse tek limiti i kërkuar. Atëherë masa e saj do të jetë në ekuilibër perfekt me urtësinë e plotë. Kështu "Urtësia" e shtetit do të bashkohej me madhë-shtinë e tij. Dhe në këtë rast, mund të thuhet se ushtria nuk ka më shumë trupa se sa limiti i kërkuar...

jolëndore të saj të brendshme në të gjitha farërat. Është sikur çdo kujtesë e farë, të ishin një kamer për të regjistruar zbukurimin e lules, ose mjet për përjetësinë e saj.

Në qoftë se do të ishte rasti i tillë me një krijesë që është në nivelin më të ulët e të thjeshtë të jetës, atëherë po njeriu i cili është në formën më të lartë të jetës, që posedon një natyrë shumë të lartë e përmbledhëse dhe i cili ka një shpirt të përjetshëm, a nuk është ai i lidhur me qëndruesh-mërinë e përjetësinë? Përsëri, nga fakti se ligjet, secili duke i ngjasuar pjesërisht një shpirti, sipas të cilëve formohen bimë të mëdha të lulëzuara frutëdhënëse dhe përfaqësueset e formave të tyre ruhen e përjetësohen në mënyrën më të rregullt në farërat e vockëla gjithandej ndryshimeve të stuhishme - nga ky fakt mund të kuptohet lehtë se sa i qëndrueshëm e i lidhur ngushtë me përjetësinë është shpirti i njeriut i cili posedon një natyrë tej mase të lartë e gjithëpërfshirëse dhe që, megjithëse i veshur në një trup, është një ligj i vetëdijshëm e i ndritshëm që vjen nga Urdhri Hyjnor.

● ***Parimi i gjashtë:***

Dhe ti do të kuptosh gjithashtu se njeriu nuk është lënë të kullotet ku të dojë ai, me një kapistër të lidhur lirshëm në qafën e tij, përkundrazi, format e të gjitha veprave të tij janë shënuar e regjistruar, dhe rezultatet e të gjitha veprave të tij janë ruajtur për ditën kur atij do t'i bëhet thirrje për të dhënë llogari.

● ***Parimi i shtatë:***

Dhe ti, për më tepër, do të kuptosh se shkatërrimi që godet krijesat e bukura të verës e të pranverës në vjeshtë nuk është një asgjësim përfundimtar, por është një formë shkarkimi nga detyrat e tyre, pas kryerjes së shërbimit[258]. Dhe është gjithashtu një formë boshatisjeje me qëllim që të

[258] Shënim: Po, është e përshtatshme që frutat, lulet dhe gjethet në majat e në degët e një peme, të cilat vijnë nga thesaret e furnizimeve të siguruara prej Mëshirës Hyjnore, të largohen kur ato vjetërohen dhe kur detyrat e tyre janë në fund. Ndryshe, porta do të mbetej e mbyllur për ato që vijnë pas tyre, dhe do të ngrihej një pengesë kundër shtrirjes së Mëshirës së All-llahut xh.sh. dhe kundër shërbimeve për t'u kryer

pastrojë vendin për një krijim të ri që do të vijë në pranverën vijuese, për të përgatitur terrenin e për t'u bërë gati për krijesat që duhet të vijnë e të marrin detyrat e tyre. Së fundi, është një formë e para-lajmërimit Hyjnor për qëniet e vetëdijshme për t'i zgjuar ata nga shkujdesja e cila u shkakton atyre të harrojnë detyrat e tyre dhe nga mpirja e dehur e cila u shkakton atyre të harrojnë detyrimet e tyre për dhënien e falënderimeve.

● ***Parimi i tetë:***

Dhe ti do të kuptosh gjithashtu, se Krijuesi i përjetshëm i kësaj bote të përkohshme ka një botë tjetër të përhershme; dhe për këtë Ai i nxit e i shtyn përpara shërbëtorët e Tij.

● ***Parimi i nëntë:***

Dhe ti do të kuptoje, gjithashtu, se Ky Krijues kaq i Gjithëmëshirshëm do t'u dhurojë shërbëtorëve të Tij të sinqertë në atë botë të gjërë, dhurata të tilla çka syri kurrë nuk ka parë, as veshi kurrë s'ka dëgjuar dhe as imazhi i tyre kurrë nuk ka kaluar në zemrën e ndonjë njeriu. Në këtë ne besojmë...

E VËRTETA E SHTATË

Porta e Mbrojtjes dhe e Ruajtjes,

Shfaqja e Emrave El-Hafidhu, Er-Rekibu, Ruajtësi, Mbikëqyrësi.

A do të ishte e mundur për Atributin *Mbrojtësi*, i Cili ruan e mbron të gjitha gjërat me rregullin dhe ekuilibrin më të madh, gjithçka që është në qiej e në tokë, në tokën e thatë e në oqean, çfarë është e thatë dhe e lagur,

---

nga vëllezërit e tyre (domethënë nga anëtarët e tjerë të species). Për më tepër, me kalimin e rinisë ato bëhen të mjera e të turbulluara keq.

Gjithashtu, pranvera është si një pemë frytdhënëse që, me radhë, është një tregues i Fushës së Ringjalljes. E ngjashme me këtë, bota e njeriut, në çdo shekull, është një pemë frytdhënëse me urtësi e cila të fton për shqyrtim e për të nxjerrë mësime, dhe bota në tërësi, është si një pemë e çuditshme frutat e së cilës dërgohen në tregun e Botës së Përtejme.

e madhe dhe e vogël, e zakonshme dhe e lartë dhe si do që të jenë rezultatet e tyre nëpërmjet llogaritjes, a do të ishte e mundur që ky Atribut Hyjnor të lejonte që veprat dhe aktet e njeriut, të cilit i është dhënë një natyrë e lartë e humane, rangu i qënies së tij *kalif*, dhe detyra e mbajtjes së amanetit më të madh, të mos regjistrohen punët e tij, e të mos kalojnë në sitën e llogarisë, të mos peshohen në peshoren e drejtësisë, të mos dënohet apo të mos shpërblehet në mënyrë të përshtatshme, edhe pse aktet e tij e veprat prekin Hyjninë e përgjithshme? Jo, kurrë nuk do të ishte e mundur!

Po, Ai i Cili administron gjithësinë është Ai që i ruan të gjitha gjërat në rregull e drejtpeshim. Rregulli e drejtpeshimi janë tregues të njohurisë dhe të urtësisë, të vullnetit dhe fuqisë, sepse ne shikojmë se lënda e çdo objekti të krijuar me urtësi formohet në një mënyrë të mir-organizuar e simetrike. Jo vetëm secila nga format që ajo ndryshon gjatë jetës së saj është e mirërregulluar, por tërësia e këtyre formave, gjithashtu, shënohet nga e njëjta rregullsi.

Ne gjithashtu shikojmë se Ruajtësi i Gjithëlavdishëm i ruan format e çdo gjëje, jetës së të cilës i ka ardhur fundi; kur detyra e saj mbaron dhe kur largohet nga bota e dukshme, Krijuesi e ruan atë në kujtesat e njerëzve të cilat u ngjasojnë *Pllakave të Ruajtura*[259] dhe që u ngjasojnë pasqyrave ideale. Ai gjithashtu shkruan e skalit një histori të shkurtër të jetës së tyre në një farë, që është si rezultati e pasoja e të tërës. Kështu Ai bën që të gjitha gjërat të ruhen në pasqyra që u përkasin, si botëve të jashtme, ashtu edhe botëve të brendshme... Për shembull: Kujtesa e njeriut, fruti i pemës, bërthama e frutit, dhe fara e lules, të gjitha këto demonstrojnë gjithësishmërinë dhe gjithëpërfshirjen e ligjit të Ruajtjes.

A nuk shikon se të gjitha lulet e frutat e pranverës së madhe, regjistrat e veprave të tyre në formë të përshtatshme, ligjet e formimit të tyre dhe imazhet e formave të tyre, që të gjitha janë skalitur në hapësirën e kufizuar të një fareje të vockël dhe atje ruhen? Në pranverën vijuese, regjistri i punëve të tyre hapet sipas llogaritjes së hollë që u përshtatet atyre, dhe një botë tjetër e madhe pranverore del në dritë me rregullin më të madh e me

[259] Shënim: Shiko tek shënimi i Aspektit të Shtatë.

urtësinë më të lartë. Kjo demonstron se çfarë gjithë-përfshirje të fuqishme po ushtron *Atributi Ruajtës*.

Duke marrë në konsideratë se rezultatet e gjërave të tilla kalimtare, të zakonshme e të parëndësishme ruhen, atëherë, a do të ishte e mundur që veprat e njeriut të cilat kanë fruta të rëndësishme në botën e së Padukshmes, në Botën e Përtejme dhe në Botën e Shpirtërave dhe tek Hyjnia e Përgjithshme, të mos ruheshin, të mos mbikëqyreshin dhe të mos regjistroheshin si çështje me rëndësi? Jo, kurrë!..

Po, nga kjo shfaqje e këtij Atributi të Ruajtjes mund të kuptohet se Pronari i këtyre krijesave i ka kushtuar vëmendje të madhe rregullit të të gjitha gjërave që vijnë e kalojnë në pronën e Tij. Ai i kushton shumë vëmendje funksionit të Sovranitetit dhe i jep shumë rëndësi Hyjnisë e Mbretërisë. Kështu, Ai regjistron, ose bën të regjistrohen në një shkallë të tillë ndodhitë më të parëndësishme, shërbimet më të vogëla dhe ruan në gjëra të shumta formën e çdo gjëje që ndodh në mbretërinë e Tij.

Ky Atribut i Ruajtjes tregon se padyshim do të hapet një regjistër i rëndësishëm për të gjykuar punët, dhe sidomos për këtë krijesë të nderuar e të respektuar në shumë drejtime, pra për njeriun. Atëherë, padyshim punët e tij të mëdha dhe veprat e tij të rëndësishme do të hyjnë brenda një peshoreje të saktë dhe një llogaritjeje të hollë, dhe fletët e punëve të tyre do të shpërndahen.

Tani, a do ta pranonte ndonjë mendje që të lihet ky njeri, i cili u nderua me çështjen e të qënit "Kalif" dhe me Amanetin, ai që u ngjit në shkallën e drejtuesit dhe të dëshmuesit mbi krijesat me ndërhyrjen e tij në çështjet e ibadetit të shumicës së krijesave dhe të tesbihateve duke shpallur Njësinë Hyjnore në fushat e krijesave të shumta, dhe kështu duke vepruar si një kontrollor e dëshmitar për Gjithësishmërinë e Hyjnisë, a do të ishte e mundur që të lihet ky njeri, të shkojë në varr që të flejë i qetë e pa u zgjuar që të pyetet për veprat e tij të vogëla apo të mëdha dhe pa shkuar tek Fusha e Ringjalljes që të gjykohet tek Gjykata e Lartë? Jo, kurrë!

Si është e mundur që ky njeri të shkojë në asgjësim, dhe si mundet që ai të fshihet në dhé, e të shpëtojë nga i Gjithëfuqishmi dhe nga i Gjithëlavdishmi i Vetëm, Fuqinë e të Cilit e dëshmojnë të gjitha ndodhitë e kohës së shkuar, të cilat dëshmojnë fuqinë e Tij madhështore për ndodhitë e së ardhmes[260], që secila është një mrekulli e Fuqisë së Tij dhe në mënyrë të

[260] Shënim: Po, e Shkuara, e shtrirë nga koha e tanishme deri tek fillimi i krijimit, është mbushur plot ndodhi e ngjarje. Çdo ditë, çdo vit, e çdo shekull që erdhi në ekzistencë është si një rresht, si një faqe, e si një libër i shkruar nga Pena e Paracaktimit; Dora e Fuqisë së All-llahut xh.sh. ka skalitur atje Shenjat e Tij të mrekullueshme me Urtësinë dhe me Rregullin më të madh. E ngjashme me këtë, e Ardhmja, që shtrihet që nga koha e tanishme deri në Ditën e Ringjalljes, deri në Xhennet e deri në përjetësi, është tërësisht brenda mundësive. Domethënë: Ashtu si e Shkuara që përbëhej nga ngjarje të shumta që ndodhën me të vërtetë, po kështu e Ardhmja përbëhet nga ndodhi të mundshme që mund të ndodhin me të vërtetë.

Tani, në qoftë se këto dy zinxhirë të kohës do të krahasoheshin me njëri-tjetrin, kuptohet se ashtu siç krijoi Ai të djeshmen së bashku me ekzistencat e saja, po ashtu, nuk ka dyshim nga asnjë aspekt, se Ai është i aftë të krijojë të nesërmen me të gjitha ekzistencat e saja. Gjithashtu këto krijesa të jashtëzakonshme të kohës së shkuar, e cila është fushë çudirash, janë mrekullitë e Një të Gjithëfuqishmi të Gjithëlavdishëm. Ato dëshmojnë në mënyrë vendimtare se i Gjithëfuqishmi i Vetëm është i aftë të krijojë të gjithë të Ardhmen dhe ndodhitë e saja të mundshme, dhe të shfaqë në të të gjitha çudirat e mrekullitë e saj.

Po, ashtu si Ai i Cili krijon një mollë të vetme, sigurisht është i aftë t'i krijojë të gjitha mollat në botë, madje edhe ta sjellë në ekzistencë pranverën e madhe, sepse Ai i Cili nuk mund ta krijojë pranverën nuk mund ta krijojë mollën, pasi ajo mollë prodhohet në atë punishte; dhe kush mundet të krijojë një mollë të vetme, atëherë, Ai është i aftë të krijojë pranverën, pasi çdo mollë është një shembull i zvogëluar i një peme, madje i një kopshti, ose shembull në miniaturë e gjithësisë. Bërthama e mollës që mban brenda vetvetes historinë e jetës së pemës së saj, nga pikëpamja e mjeshtërisë artistike, është një mrekulli e tillë, saqë Ai i Cili e krijon atë kështu, nuk është i paaftë dhe nuk i mungon absolutisht asgjë.

Kështu, Ai i Cili krijon të sotmen, gjithashtu është i aftë të krijojë Ditën e Ringjalljes, dhe vetëm Ai i Cili krijon pranverën, është i aftë të krijojë ndodhitë e Ringjalljes. Ai që i shfaqi të gjitha botët e së shkuarës dhe i lidhi ato me shiritin e kohës, me të gjithë Urtësinë e Rregullin, pa dyshim Ai është i aftë të shfaqë botëra të tjera e t'i lidhë ato me shiritin e së Ardhmes e t'i shfaqë ato atje dhe do t'i shfaqë. Ne

dukshme, gjithmonë krijon dimër e pranverë dhe, që duke u marrë së bashku, i ngjasojnë Kijametit dhe Ringjalljes.

Meqenëse njeriu nuk thirret për të dhënë llogari e të gjykohet në mënyrë të përshtatshme ndërsa është në këtë botë, atëherë padyshim që ai do të shkojë një ditë në një Gjykatë të Lartë dhe në një lumturi të madhe.

E VËRTETA E TETË

Porta e Premtimit dhe e Kërcënimit,

Shfaqja e Emrave El-Xhemilu, El-Xhelilu, i Bukuri, i Gjithëlavdishmi.

A do të ishte e mundur që Autori i kësaj bote, Zotëruesi i Njohurisë Absolute dhe i Fuqisë Absolute, të mos përmbushë premtimin e përsëritur shpesh dhe kërcënimin që është njoftuar me unanimitet nga të gjithë Profetët dhe që është dëshmuar njëzëri nga të gjithë Evlijatë dhe të sinqertit, dhe kështu do të shfaqte dobësi e injorancë? Ruajna Zot! E gjithë ajo që nënkuptohet nga premtimi i Tij dhe nga kërcënimi nuk është aspak e vështirë për fuqinë e Tij; ajo është tej mase e thjeshtë dhe e lehtë... Ajo për Atë është aq e lehtë si sjellja përsëri në pranverën vijuese krijesat e panumërta të pranverës së shkuar, pjesërisht të njëjtat[261] dhe pjesërisht të ngjashme[262].

---

e kemi provuar në mënyrë të prerë në disa Fjalë dhe veçanërisht tek Fjala e Njëzet e Dy, se "Ai që nuk mundet të krijojë gjithçka, ai nuk mundet të krijojë as edhe një gjë të vetme, dhe Ai që krijon një gjë të vetme, ai mundet të krijojë gjithçka. Gjithashtu, në qoftë se krijimi i gjithçkaje do t'i atribuohej një Krijuesi të vetëm, atëherë krijimi i të gjitha gjërave do të bëhej aq i lehtë, sa krijimi i një gjëje të vetme, dhe kështu vjen lehtësia. Ndërsa, në qoftë se, në të kundërtën, krijimi do t'u atribuohej shkaqeve të panumërta dhe shumësisë, atëherë krijimi i një gjëje të vetme do të bëhej aq i vështirë sa krijimi i gjithçkaje dhe një vështirësi e tillë do të ngrihej në shkallën e refuzimit e të pamundësisë... "

[261]Si rrënjët e pemëve dhe të barishteve

[262]Si gjethet dhe frutat.

Përmbushja e premtimit është e domosdoshme për ne dhe për çdo gjë, gjithashtu ajo është e domosdoshme për Veten edhe për Sovranitetin e Hyjnisë së Tij Hyjnor.

Për Të, thyerja e premtimit, do të ishte kundra Dinjitetit të Fuqisë së Tij dhe do të ishte kontradiktore me Gjithëpërfshirjen e Njohurisë së Tij, sepse thyerja e premtimit mund të burojë vetëm nga injoranca ose nga pafuqia.

O mohues! A e di ti se sa marrëzisht po kryen një krim me mosbesimin tënd e me mohimin? Ti po beson tekat e tua të rreme, mendjen tënde të përçartë dhe nefsin tënd mashtrues, po përgënjeshtron Atë që kurrësesi nuk detyrohet ta thyejë premtimin e Tij nga asnjë aspekt, Lavdia dhe Lartësia e të Cilit asnjëherë nuk mund ta pranojnë thyerjen e Fjalës së Tij, dhe Vërtetësia dhe Realiteti i të Cilit dëshmohen nga të gjitha gjërat dhe objektet e dukshme! Pavarësisht vogëlsisë tënde të pafund, ti po bën një krim të madh të pafund. Padyshim, ti meriton një dënim të madh të përjetshëm. Sipas disa rrëfenjave, që tregohet se "Dhëmballët e disa njerëzve të Xhehennemit janë aq të mëdha sa mali", ato shërbejnë si një tregues i madhësisë së krimit të tyre.

O mohues, ti je si një udhëtar i cili i mbyll sytë e tij ndaj dritës së diellit dhe në vend të asaj drite ndjek imagjinatat e mendjes së tij, pastaj dëshiron që ta ndriçojë rrugën e tij të frikshme përpara vetes me dritën që vjen nga feneri i kokës së tij, e cila në realitet nuk është më e fortë se sa xixa e një xixëllonjeje.

Atëherë, çfarëdo që është premtuar nga All-llahu i Plotëfuqishëm, Fjalët e Vërteta të të Cilit janë këto krijesa që ne i shohim dhe që Shenjat e vërteta dhe elokuente të të Cilit janë zhvillimet dhe ngjarjet e gjithësisë, Ai sigurisht do ta përmbushë premtimin e Tij, do të hapë një Gjykatë të Lartë dhe do të dhurojë një lumturi të madhe.

E VËRTETA E NËNTË

Porta e Dhënies së Jetës dhe e Shkaktimit të Vdekjes,

Shfaqja e Emrave El-Hajju, El-Kajjumu, El-Muhji, El-Mumitu,

I Gjalli i Përjetshëm, Vetekzistuesi i Përhershëm, Jetëdhënësi, Shkaktuesi i vdekjes

A do të ishte e mundur për Atë, i Cili i jep jetë kësaj toke të gjërë të vdekur e të thatë; që duke vepruar kështu demonstron Fuqinë e Tij nëpërmjet sjelljes në jetë më shumë se treqindmijë lloje nga llojet e krijesave, ardhja në jetë e secilit nga ato është aq e jashtëzakonshme sa ajo e njeriut; i Cili, për më tepër, shfaq në këtë dhënie jete Njohurinë e Tij Gjithëpërfshirëse përmes dallimeve dhe diferencimeve të pafundme të çdo krijese që Ai i bën në përzierjen e ngatërruar të të gjitha atyre llojeve; i Cili drejton shikimet e të gjithë shërbëtorëve të Tij për tek lumturia e përjetshme, duke u premtuar atyre Ringjallje me të gjitha dekretet e Tij qiellore; i Cili e shfaq Madhështinë e Hyjnisë së Tij duke bërë që të gjitha krijesat të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, dhe i bëri ato të rrotullohen brenda Rrethit të Tij dhe Vullnetit të Tij, që të ndihmojnë njëri-tjetrin e t'i nënshtrohen Atij; i Cili tregon rëndësinë që Ai i ka dhënë njeriut duke e bërë atë frutin më gjithëpërfshirës, më të çmuarin, më të hollin, më delikatin, më të vlerësuarin e më të vyerin në pemën e krijesave, duke iu adresuar atij e duke ia nënshtruar atij të gjitha gjërat; a do të ishte e mundur që Ky i Gjithëfuqishëm, e i Gjithëmëshirshëm, dhe Ky i Gjithëditur e i Gjithurtë, i Cili i dha këtë rëndësi njeriut, të mos shkaktojë ringjalljen! Të mos shkaktojë Tubimin e të mos i japë përsëri jetë njerëzimit, apo të jetë i paaftë për të vepruar kështu! Apo të mos mundet të hapë dyert e Gjykatës së Lartë e të krijojë Xhennetin e Xhehennemin! Jo, kurrë nuk do të ishte kjo e mundur!..

Në të vërtetë, Rregullatori i Plotfuqishëm i çështjeve të kësaj bote krijon në çdo shekull, në çdo vit e në çdo ditë, në fytyrën e ngushtë e të përkohshme të globit, shenja të shumta, shembuj dhe tregues të Tubimit të madh dhe të Fushës së Ringjalljes.

Shkurtazi: Kështu, në ringjalljen e pranverës, ne shohim se gjatë pesë ose gjashtë ditëve, më shumë se treqindmijë lloje të ndryshme kafshësh dhe bimësh të vogëla apo të mëdha ringjallen dhe shpërndahen. Rrënjët e të gjitha pemëve e bimëve, si dhe disa kafshë vijnë në jetë dhe ngjallen tamam

ashtu siç ishin ato më parë. Të tjerat rikrijohen në një formë aq të ngjashme si të ishin pothuajse të njëjtat. Farërat që në formën e tyre të jashtme, lëndore, shfaqen të jenë shumë të përafërta me njëra-tjetrën, por megjithatë, për gjashtë ditë ose gjashtë javë, ato bëhen të dalluara e të diferencuara nga njëra-tjetra, ndonëse ishin të përziera, dhe atëherë me një shpejtësi e gjërësi të skajshme, me një lehtësi e shumë kollaj vijnë në jetë me rregullin dhe ekuilibrin më të madh. A do të ishte ndonjë gjë e vështirë për Atë i Cili i kryen të gjitha këto vepra, apo të ishte i paaftë për krijimin e qiejve e të tokës për gjashtë ditë! Apo të mos mundej ta ringjallë njeriun me një klithmë të vetme? Jo, kurrë nuk do të ishte e mundur!..

Le të supozojmë se do të ndodhej ndonjë shkrimtar me dhunti të jashtëzakonshme i cili do të mund të shkruante treqindmijë libra në një fletë të vetme shkronjat e të cilëve të ishin fshirë e zhdukur, t'i shkruante pa asnjë gabim, ngatërresë, harresë e mangësi e në formën më të plotë e më të mirë, dhe t'i shkruante të gjithë ato së bashku për një orë të vetme. Dhe në qoftë se dikush do të të thonte: "Ky shkrimtar do të shkruaj nga kujtesa e tij për një minut librin tënd që ka rënë në ujë dhe që është fshirë." Atëherë a do të thoje ti se ai nuk është në gjendje, dhe a nuk do të besoje në aftësinë e tij...?

Ose mendo për një mbret të jashtëzakonshëm, i cili me qëllim që të shfaqë fuqinë e tij, ose për hir të dhënies së një shembulli paralajmërues, ose për të bërë një vend qetësie, zhduk male të tëra me një urdhër të vetëm, i kthen përmbys mbretëritë, dhe e transformon detin në tokë të thatë, pastaj ti i sheh prej tij këto vepra, dhe ndërkohë befas një shkëmb i madh u rrokullis poshtë në një rrjedhë uji dhe bllokoi rrugën e mysafirëve që janë të ftuar për të shkuar për tek gostia në prani të Mbretit, mirëpo janë të pamundur të kalojnë. Në qoftë se dikush do të të thonte ty: "Ai Mbret i Lartë do ta zhdukë apo do ta copëtojë atë shkëmb, sado i madh që të jetë, me një urdhër të vetëm, sepse Ai nuk mund t'i lërë mysafirët e tij në rrugë", a do të thoje ti se Ai nuk do ta zhdukte shkëmbin, apo të thoje se "Ai është i pamundur ta bëjë atë..."?

Ose, në qoftë se dikush, në ndonjë ditë, do të grumbullonte së bashku një ushtri të madhe, dhe ndërkohë të thuhet ty se: "Ai do ta grumbullojë atë me një të rënë të borisë, pasi individët e saj ishin shpërndarë për pushim,

dhe batalioni do të vihej në rresht në një formë të disiplinuar", a do t'i përgjigjeshe duke i thënë, "Unë nuk e besoj atë!" Në qoftë se ti do të thoje diçka nga këto gjëra, sjellja e jote do të ishte vërtet marrëzi...

Në qoftë se ti i ke kuptuar këto tre shembuj, tani vështro më tej dhe shiko se si Projektuesi i parapërjetësisë kthen përpara syve tonë faqen e bardhë të dimrit dhe hap faqet jeshile të pranverës e të verës! Atëherë Ai skalit në faqen e tokës me Penën e Fuqisë dhe të Kaderit në formën më të bukur, më shumë se treqind mijë specie të krijimit. Asnjëra nuk e cënon tjetrën. Ai i shkruan ato të gjitha së bashku, por asnjëra nuk bllokon rrugën e një tjetre. Në përbërjen dhe në formën e tyre, secila mbahet e veçuar nga tjetra pa ndonjë ngatërresë dhe nuk ka gabim në të shkruarit.

Ai Ruajtës dhe i Gjithurti i Vetëm, i Cili ruan e përfshin programin e shpirtit të një peme të madhe në bërthamën më të vockël, jo më e madhe se sa një pikë, atëherë, a do të ishte e lejueshme të pyesësh se si Ai i ruan shpirtërat e atyre që vdesin?

Ai i Gjithëfuqishëm i Vetëm i Cili i shkakton globit të rrotullohet si një guralec në një bahe, a do të ishte e lejueshme të pyesësh se, "Si Ai do ta heqë e zhdukë këtë glob" nga rruga e mysafirëve të Tij, të cilët po udhëtojnë për ta takuar Atë në Botën e Përtejme?

Përsëri, i Gjithëlavdishmi i Vetëm, i Cili nga mosekzistenca krijoi grimcat dhe i rekrutoi ato me urdhërin e كُنْ فَيَكُونُ "*Bëhu!-dhe ajo është bërë (në çast)*" në trupat e të gjitha gjërave të gjalla, dhe kështu krijoi ushtri shumë të disiplinuara, a do të ishte e mundur të pyetet se, "Si Ai do t'i grumbullojë me një klithmë të vetme ato grimca bazë të cilat qenë njohur me njëra-tjetrën dhe ato pjesë themelore që u bashkuan si një batalion i trupit dhe i organizimit të tij? "

Për më tepër, ti do të shikoje me dy sytë e tu vizatime të shumta të bëra nga All-llahu xh.sh. si shenja, si shembuj e tregues të ringjalljes, të ngjashme me ringjalljen e pranverës, vizatime të vëna nga Ai çdo shekull e epokë të botës në ndryshimin e ditës e të natës, madje edhe në shfaqjen e zhdukjen e reve në qiell, si shembuj e tregues ringjalljeje. Në qoftë se ti do ta

përfytyroje veten tënde të kishe jetuar para një mijë viteve dhe pastaj t'i karahasoje me njëri-tjetrin dy krahët e kohës që janë e shkuara dhe e ardhmja, atëherë ti do të shikoje shembuj tubimi e tregues ringjall-jeje aq të shumtë sa shekujt e ditët. Kështu në qoftë se ti, edhe pasi të kesh dëshmuar kaq shumë shembuj e tregues, do ta vlerësoje ringjalljen trupore si të pamundur e të papranuar nga arsyeja, dije se sjellja jote është si një çmenduri.

Shiko se çfarë thotë Dekreti më i Madh rreth kësaj të vërtete që ne po diskutojmë:

فَانْظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا إِنَّ ذَٰلِكَ لَمُحْيِي الْمَوْتَىٰ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

"Shihni pra te pasojat e Mëshirës së All-llahut, se si Ai ringjall tokën pas vdekjes së saj. Sigurisht që (All-llahu, i Cili siç ringjalli tokën pas vdekjes së saj) do të ngrejë me siguri të vdekurit (Ditën e ringjalljes) dhe Ai është i Plotëfuqishëm për të bërë çdo gjë."[263]

Shkurtazi: Nuk ka asgjë që e bën të pamundur Tubimin e Ringjalljes, përkundrazi, çdo gjë e kërkon medoemos atë dhe e thërret.

Po, Ai i Cili i jep jetë kësaj toke të madhe e cila është një ekspozitë çudirash dhe që i shkakton vdekjen asaj si të ishte thjesht një kafshë; i Cili e ka bërë këtë tokë një djep të këndshëm dhe një anije të bukur për njeriun dhe kafshën; i Cili e ka bërë Diellin një llambë që e furnizon me dritë e nxehtësi bujtinën e kësaj bote; i Cili i ka bërë planetët mjete transporti për dërgimin e enjgjëjve të Tij; Një Hyjni e përjetshme dhe madhështore deri në këtë shkallë, dhe një sovranitet gjithëpërfshirës madhështor deri në këtë gradë nuk do të mbeteshin e të përkufizoheshin tek çështjet kalimtare, të paqëndrueshme, të pastabilizuara, të parëndë-sishme, të ndryshueshme, jo të përhershme, të mangëta e të paplota të kësaj bote.

[263] Kur'an, 30: 50

Domethënë, ai sigurisht duhet të ketë një mbretëri tjetër, një mbretëri të denjë për Të, e qëndrueshme, e përhershme, madhështore, e lartë, e stabilizuar, e pandryshueshme dhe e lavdishme, dhe për hir të asaj mbretërie Ai na bën neve të punojmë dhe për tek ajo Ai na thërret. Për transferimin tonë tek ajo mbretëri dëshmojnë të gjithë shpirtërat e ndritur të cilët kanë depërtuar nga paraqitja e jashtme e gjërave për tek realiteti në brendësi dhe që janë nderuar me afrimitetin tek Prezenca Hyjnore; edhe e dëshmojnë të gjithë udhëheqësit shpirtërorë që janë pajisur me zemra të ndriçuara, dhe të gjithë mendjendriturit, të gjithë këta, me unani-mitet, na njoftojnë neve se Ai ka përgatitur për ne një shpërblim e shpagim dhe tregojnë se Ai, në mënyrë të përsëritur, na jep neve premtime të prera dhe paralajmërime të rrepta.

Sa për thyerjen e premtimit, ajo kurrësesi nuk mund të pajtohet me Lavdinë e Shenjtërisë së Tij, sepse thyerja e premtimit është e pathemeltë dhe poshtërim i plotë. E ngjashme me këtë, dështimi për të përmbushur një kërcënim buron ose nga amnistia (falja), ose nga pafuqia. Atëherë mosbesimi është një krim absolut[264] dhe nuk mund të falet... Ndërsa i Gjithëfuqishmi i Vetëm Absolut është shumë lart dhe i përjashtuar nga pafuqia.

Kurse ata të cilët na sjellin dëshmitë dhe njoftimet e tyre, pavarësisht të gjitha ndryshimeve në metodat e tyre, në sjelljet dhe në rrugët, ata janë plotësisht të pajtueshëm dhe kanë rënë dakord me unanimitet për këtë

---

[264] Po, mohimi është një fyerje e përbuzje për të gjitha krijesat, pasi ai i akuzon ato për kotësi e pavlefshmëri, është një mohim i shfaqjes së Emrave të bukur Hyjnorë në pasqyrat e krijesave. Është një përgënjeshtrim i të gjitha krijesave pasi hedh poshtë dëshminë e krijesave për Emrat Hyjnorë. Ai i prish potencialet e mundësitë e njeriut deri në një shkallë të tillë saqë rrëmben prej tij fuqinë për të pranuar të mirën e për t'u reformuar. Gjithashtu, mosbesimi është një padrejtësi shumë e madhe, është një shkelje kundra të gjithë krijesave dhe ndaj të drejtave të Emrave të bukur Hyjnorë.

Kështu mbrojtja e atyre të drejtave dhe natyra e pandreqshme e shpirtit të mohuesit, bëjnë të domosdoshëm që mosbesimi duhet të jetë i pafalshëm. Verseti: إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ "*T'i përshkruash ortakë All-llahut është padrejtësia më e madhe."* (Kur'an, 31: 13) e shpreh këtë kuptim.

çështje themelore. Ata për sa i përket numrit të shumtë të tyre, kanë autoritetin e unanimitetit. Me cilësinë e tyre, ata kanë autoritetin e dijetarëve të konsensusit. Me rangun e tyre, secili është si një yll udhëzues i njerëzimit, është syri i dashur i një grupi dhe objekt krenarie i një kombi. Me rëndësinë e tyre, secili është një ekspert dhe një autoritet në çështje.

Në çdo art apo shkencë, dy ekspertë preferohen mbi mijëra njerëz joekspertë, dhe dy pohues pozitivë preferohen mbi mijëra mohues në përcjelljen e një raportimi. Për shembull, dëshmia e dy njerëzve duke vërtetuar shikimin e Hënës së re në fillimin e muajit të Ramazanit, shfuqizon krejtësisht mohimin e mijëra mohuesve.

Shkurtazi: Në të gjithë botën, nuk ka njoftim më të vërtetë, as pretendim më të qëndrueshëm dhe as realitet më të dukshëm se sa ky... **Domethënë, padyshim bota është një fushë, dhe ringjallja është një lëmë, një korrje. Xhenneti e Xhehennemi janë secila depozita për drithë.**

E VËRTETA E DHJETË

Portat e Urtësisë, Përkujdesjes, Mëshirës dhe e Drejtësisë.

Shfaqja e Emrave: El-Hakimu, El-Kerimu, El-A'dilu, Er-Rahimu.

I Gjithurti, Gjithëbujari, i Drejti dhe Mëshirëploti.

A do të ishte e mundur për Zotëruesin e Gjithëlavdishëm i të gjithë sundimit në këtë bujtinë të paqëndrueshme të botës, në këtë vend të përkohshëm testimi, në këtë arenë interesante për turistët, i Cili shfaqi një urtësi kaq të dukshme, një përkujdesje kaq të qartë, një drejtësi kaq të autoritetshme dhe një mëshirë kaq gjithëpërfshirëse, a do të ishte e mundur që në sferën e mbretërisë së tij dhe në botët e dimensioneve të brendshme të gjërave, të mos ekzistonin banesa të përjetshme me banorë të përjetshëm, vendqëndrime të përjetshme dhe krijesa me banim të përhershëm, dhe të shkonin kot e të zhvlerësoheshin si gjëra të parëndësishme të gjitha të vërtetat e dukshme të kësaj urtësie, të kësaj përkujdesje, të kësaj drejtësie dhe të kësaj mëshire!..

Përsëri, a do të ishte e mundur për Krijuesin e Gjithurtë, i Cili e zgjodhi këtë njeri midis të gjitha krijesave të Tij, dhe e bëri atë marrësin e drejtëpërdrejtë e të plotë të mesazhit nga ana e Tij, e bëri atë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për Emrat e Tij të Bukur, që e lejoi atë të shijonte, vlerësonte e të njihej me të gjitha kënaqësitë e thesareve të Tij të Mëshirës, që ia bëri Vetveten të njohur atij me të gjithë Emrat e Tij, që e deshi atë dhe e bëri Vetveten të dashur te ai.. a do të ishte e arsyeshme që edhe pas të gjithë kësaj të mos e dërgonte Ai i Gjithurtë këtë njeri të mjerë në atë mbretërinë e Tij të përjetshme! E të mos e gëzonte atë në atë banesë të lumturisë së përjetshme pasi Ai i bëri ftesë për tek ajo!..

A do të ishte e arsyeshme që Ai të ngarkonte çdo krijesë, madje sikur ajo të ishte sa bërthama, fara, me një detyrë aq të rëndë sa një pemë, e të vendoste në të shembuj të urtësisë së Tij aq të shumta sa lulet, dhe aspekte të dobishme aq të shumta sa frutat, pastaj t'i bënte qëllimin e ekzistencës së atyre detyrave, urtësive dhe aspekteve të dobishme asgjë më shumë se sa qëllimi i një bërthame që orientohet tek kjo dynja! Domethënë, ta bënte qëllimin e ekzistencës vetëm qëndrimin në këtë botë që është më pak e vlefshme se sa një farë sinapi! Dhe të mos i bënte ato detyra, ato urtësi e aspekte të dobishëm farëra për botën e kuptimit, as tokë kultivuese për botën e përtejme që të prodhojnë atje të vërtetat e tyre dhe rezultatet e vlefshme të denja për ato.

A do të ishte e arsyeshme që të gjitha këto ndryshime të rëndësishme e këto festivale të mëdha të mbeteshin pa qëllim, të ishin pa urtësi e kot? A do të ishte e arsyeshme që Ai të mos i kthente fytyrat e tyre drejt botës së kuptimit dhe botës së përtejme, që ato mund të shfaqin atje qëllimet e tyre të vërteta dhe rezultatet e përshtatshme?

Po, përsëri, a do të ishte e mundur që Ai t'i shfaqte të gjitha ato në kundërshtim me realitetin, ose në kundërshtim me cilësitë e Tij të Shenjta dhe me Emrat e Tij të Bukur**:** ***El-Hakimu, EL-Kerimu, El-A'dilu*** dhe ***Er-Rahimu****" I Gjithurti, Gjithëbujari, i Drejti dhe Mëshirëploti*, dhe të përgënjeshtronte të vërtetat e gjithësisë që karakterizohen nga urtësia, bujaria, drejtësia dhe nga mëshira; të refuzonte dëshminë e të gjitha

krijesave dhe të anulonte treguesit e bërë nga të gjitha krijesat e urta e të përsosura!..

A do ta pranonte arsyeja që Krijuesi t'i ngarkonte njeriun dhe shqisat e tij me detyra aq të shumta sa numri i qimeve të kokës së tij, por t'i jepte atij vetëm se një shpërblim material, një shpërblim jo më të vlefshëm se sa një qime floku! A do të ishte e mundur që Ai të vepronte në një mënyrë që kundërshton drejtësinë e Tij të vërtetë dhe të vepronte në kontradiktë me urtësinë e Tij të vërtetë!..

Përsëri, a është e mundur që All-llahu i Cili e provon dhe e shfaq Vetveten të jetë Zotëruesi i Urtësisë Aboslute, që duke i bashkangjitur çdo gjallese, ose madje çdo gjymtyre, si gjuha, dhe në të vërtetë çdo krijese, shembujt e Urtësisë së Tij dhe burimet e përfitimeve aq të shumta sa rezultatet dhe frutat që Ai ia ka bashkangjitur një peme, dhe pastaj të mos i japë njeriut qëndrueshmëri e përjetësi, dhe të mos i japë atij lumturinë e përjetshme e cila është më e madhja e shembujve të Urtësisë së Tij, më e rëndësishmja e të gjitha burimeve të përfitimit, dhe më e domosdoshmja e të gjitha rezultateve! A do ta linte Ai përjetësinë, takimin me Të në botën e përtejme dhe lumturinë e përjetshme, të cilat e bënë urtësinë urtësi, mirësinë mirësi dhe mëshirën mëshirë; madje ato janë burimi dhe qëllimi i të gjitha urtësive, i mirësive, i përfitimeve dhe i mëshirës.

A do të ishte e mundur që Ai t'i linte ato, t'i neglizhonte e t'i zhyste të gjitha veprat e Tij në një kotësi të plotë e në qënien e tyre të pakuptimta! Dhe t'i shkaktonte Vetvetes, Ruajna Zot!.. t'i ngjasonte një qënieje që ka ndërtuar një pallat madhështor, dhe ka vendosur në çdo gurë të tij mijëra skalitje e stoli dhe në çdo qoshe të të cilit gjenden me mijëra zbukurime, dhe në çdo pjesë të të cilit janë sjellë mijëra mjete e instrumente të çmuara e të domosdoshme shtëpie, pastaj nuk ndërton një çati që ta mbrojë atë, kështu si rrjedhojë gjithçka prishet e shkatërrohet kot së koti! Jo, kjo kurrë nuk mund të jetë e vërtetë! ***Mirësia vjen nga Mirësia Absolute, dhe bukuria vjen nga Zotëruesi i Bukurisë Absolute. Gjithashtu, asgjë e kotë dhe e paqëllimtë nuk mund të vijë nga Zotëruesi i Urtësisë Absolute.***

Po, kushdo që në përfytyrimin e tij i hip anijes së historisë dhe nis lundrimin në drejtim të së shkuarës, ai do të shikonte sa numri i viteve skena të vdekura, vende, tubime e botëra të ngjashme me bujtinën e dynjasë, me fushën e testimit dhe me tubimin e krijimit, në kohën tonë aktuale që ne i shohim. Pavarësisht se ato ndryshojnë nga njëra-tjetra në formë e cilësi, por ato i ngjasojnë njëra-tjetrës për sa i përket rregullit të tyre, në mahnitjet e tyre dhe në mënyrën në të cilën ato shfaqin Fuqinë dhe Urtësinë e Krijuesit.

Në ato vendqëndrime të paqëndrueshme, në ato fusha kalimtare dhe në ato tubime të përkohshme ai gjithashtu do të shikojë veprat e mirërregulluara të një urtësie aq të dukshme, treguesit e një përkujdesjeje aq të qartë, shenjat e një drejtësie aq autokrate, frutat e një mëshire aq gjithëpërfshirëse, saqë ai do ta kuptojë me siguri në qoftë se nuk ka humbur mendjemprehtësinë se: Nuk mund të ketë urtësi më të plotë se sa ajo urtësi e dëshmuar, nuk mund të ketë përkujdesje më të bukur se sa ajo shenjat e të cilës ai i shikon, nuk mund të ekzistojë drejtësi më e lavdishme se sa ajo treguesit e të cilës ai i sheh, dhe nuk mund të ketë mëshirë më gjithëpërfshirëse se sa ajo që frutat e të cilës ai i shikon.

Në qoftë se, po të supozonim të pamundurën, nuk do të ndodheshin banesa të përhershme, as vende të larta, as vendqëndrime të përjetshëm me banorë të përjetshëm, dhe as shërbëtorë të lumtur në mbretërinë e Atij Monarku të Përjetshëm i Cili administron të gjitha çështjet dhe, që në mënyrë të vazhdueshme, e ndryshon bujtinën dhe mysafirët e saj, atëherë do të bëhej e domosdoshme të mohoje të katër të vërtetat gjithëpërfshirëse shpirtërore: drejtësinë, përkujdesjen, urtësinë dhe mëshirën të cilat janë elemente të fuqishme si drita, ajri, uji dhe toka, dhe do të detyroheshe, atëherë, të mohoje edhe ekzistencën e tyre, megjithëse ato janë aq të qarta, si qartësia e atyre elementeve; sepse është e qartë se kjo botë e përkohshme me çfarë përmban ajo nuk mund të jenë një shfaqje e plotë e esencave të tyre të vërteta.

Në qoftë se nuk do të kishte ndonjë vend tjetër, diku tjetër, ku ato të mund të shfaqen plotësisht, atëherë do të bëhej e domosdoshme, me një marrëzi si ajo e atij njeriu i cili mohon ekzistencën e diellit, megjithëse e shikon dritën duke mbushur ditën dhe do të mohonte urtësinë që ne mund

ta shohim në çdo gjë përpara syve tonë, do të mohonte përkujdesjen që ne mund ta vëzhgojmë në vetveten tonë dhe në shumicën e gjërave, do të mohonte këtë drejtësi[265] që shenjat e së cilës shfaqen kaq fuqishëm, dhe do të mohonte këtë mëshirë që ne e shikojmë në çdo vend. Gjithashtu do të duhej të konsiderohej Autori prej të Cilit vijnë këto zhvillime urtësie, këto veprime bujarie dhe këto mirësi të mëshirshme që ne i marrim në univers – do të duhej të vlerësohej - ruajna Zot!, si një tallës e një tiran tradhtar e mashtrues. Është krejtësisht e pamundur që të përmbysen të vërtetat. Madje edhe sofistët idiotë, të cilët mohuan ekzistencën e çdo gjëje dhe madje ekzistencën e vetes së tyre, nuk do t'i afroheshin lehtë përfytyrimit të këtij absurditeti.

Shkurtazi: Duke konsideruar pabarazinë e skajshme –nga njëra anë– midis kësaj gjendjeje të çështjeve që ne i shikojmë së bashku, me bashkimet e mëdha të jetës, me ndarjet e shpejta të vdekjes, me tubimet madhështore, me shpërndarjet e shpejta, me ceremonitë e mëdha dhe me treguesit e mahnitshëm, dhe–nga ana tjetër– midis rezultateve të vogëla që ne i shohim të arrihen pjesërisht në këtë botë kalimtare dhe qëllimeve të përkohshëm e të parëndësishëm të qënieve që i përkasin kësaj bote, ne dalim me përfundimin se mosekzistenca e botës tjetër do të thonte që t'i bashkangjisësh një guri të vogël qëllime të urta aq të mëdha sa mali, dhe një

---

[265] Ndodhen dy lloje drejtësie, njëri është pozitiv dhe tjetri negativ.

Lloji pozitiv është t'i japësh të drejtën e merituesshme atij që i takon. Kjo formë drejtësie ekziston gjithandej botës në formën më të qartë, sepse siç u provua te e **Vërteta e tretë,** se ajo çfarë kërkon çdo gjë dhe ajo çfarë është e domosdoshme për ekzistencën e vazhdimësinë e jetesës së saj, të cilën ajo gjë e kërkon nga Krijuesi i saj, me gjuhën e prirjes së saj të bashkëlindur, me gjuhën e nevojës natyrale, dhe me gjuhën e domosdoshmërisë së saj, ajo gjë i jepet asaj në përputhje me një balancë të veçantë dhe me një kriter të veçantë. Domethënë, kjo formë drejtësie është aq e sigurt sa vetë jeta e vetë ekzistenca.

Lloji i dytë i drejtësisë, negativja, qëndron në ndëshkimin e padrejtësive; ky lloj u jep keqbërësve hakun e tyre nëpërmjet shpagimit e dënimit. Ky tip drejtësie edhe në qoftë se nuk shfaqet plotësisht në këtë botë, mirëpo ndodhen shenja e tregues të panumërt që na lejojnë neve për ta kapur me intuitë e për ta perceptuar natyrën e vërtetë të saj. Për shembull, të gjitha goditjet qortuese dhe kamxhikët ndëshkimorë që u ranë popujve kundërshtarë, nga Adi e Themudi gjer tek popujt kryengritës të këtij shekullit tonë, sigurisht tregojnë se një drejtësi e lartë e sundon botën...

mali të madh t'i bashkangjisësh një qëllim aq të vogël të përkoh-shëm, aq sa një guralec. As mendja dhe as urtësia nuk mund ta gjejnë të pranueshme këtë.

Me fjalë të tjera, kjo mungesë harmonie e përpjesëtimi midis qënieve dhe këtyre çështjeve, nga njëra anë, dhe midis qëllimeve që i përkasin kësaj bote, nga ana tjetër, demonstron me siguri se: ***Të gjitha qëniet i kanë kthyer fytyrat e tyre drejt botës së kuptimit. Atje ato do të japin frutat e tyre të përshtatshëm, dhe sytë e tyre janë fiksuar tek Emrat e shenjtë Hyjnorë. Qëllimet e tyre të fundit i përkasin vetëm asaj bote. Ndërsa substancat e tyre janë të fshehura nën dheun e kësaj bote, lulet e tyre do të shfaqen në Botën e Shëmbëllesës. Njeriu kultivon e kultivohet në këtë botë, sipas aftësisë së tij; të korrat mblidhen në botën e përtejme.***

Po, në qoftë se e shikon aspektin e gjërave i cili orientohet drejt Emrave të Bukur Hyjnorë e drejt botës së përtejme, ti do të shihje se çdo farë që është një mrekulli e Fuqisë Hyjnore, ka një qëllim aq të madh sa një pemë. Çdo lule që është si një Fjalë e Urtësisë Hyjnore[266], ka kuptime aq të shumta sa lulet e një peme. Dhe çdo frut që është si një mrekulli e Mjeshtërisë së All-llahut dhe një poemë e diktuar nga Mëshira e Tij, ka qëllime urtësie aq të shumta sa frutat e një peme. Sa për aspektin e qënies së tyre furnizime e ushqime për ne, ai është një qëllim i vetëm, midis mijëra qëllimeve të urtësisë; ai përmbush qëllimin e tij, shpreh kuptimet e tij, dhe vdes duke u varrosur në stomakun tonë.

Meqenëse këto qënie kalimtare i japin frutat e tyre të përjetshëm në një vend tjetër, lënë atje forma të përjetshme për vetveten, dhe shprehin atje kuptimet e përhershme; meqenëse ato janë përfshirë në lavdërime e dhënie falënderimesh të pafund për Krijuesin, dhe meqenëse njeriu bëhet njeri i

---

[266] **Në qoftë se thuhet:** "Përse shembujt e tu përbëhen kryesisht nga lulet, farërat dhe frutat?.."

Përgjigjja jonë do të ishte se ato janë më të çuditshmet dhe më të hollat e mrekullive të fuqisë së All-llahut xh.sh.. Për më tepër, meqenëse natyralistët, filozofët dhe njerëzit e çudhëzimit kanë qenë të pamundur që ta lexojnë shkrimin e hollë që është shkruar tek ato nga pena e Kaderit dhe e Fuqisë, ata u mbytën tek ato dhe ranë në moçalin e natyrës...

vërtetë sa kohë që ai i shqyrton dhe i shikon këto aspekte të gjërave që janë orientuar drejt botës së përtejme, duke gjetur kështu rrugën e tij të përjetësisë nëpërmjet të përkohshmes meqenëse e gjitha kjo është e vërtetë, atëherë padyshim duhet të jenë disa qëllime të tjera që janë hedhur midis jetës dhe vdekjes dhe të cilat së pari tubohen, e pastaj ndahen.

Nuk ka gabim në këtë krahasim. Gjendja e lartëpërmendur e çështjeve u ngjason rrethanave të formuara e të rregulluara nëpërmjet imitimit e përfaqësimit. Tubimet e shkurtëra dhe shpërndarjet organi-zohen me shpenzime shumë të mëdha vetëm për hir të marrjes së fotografive e filmimeve, të cilat më vonë mund të shfaqen në Kinema.

Kështu, njëri prej qëllimeve të kalimit të jetës individuale dhe shoqërore në një periudhë të shkurtër në këtë dynja, është që ta mund-ësojë marrjen e filmimeve dhe formimin e imazheve, është të mundësojë regjistrimin e rezultateve të punëve tona për t'u shfaqur në Ditën e Llogarisë, për t'u shfaqur tek tubimi i madh dhe për të dhënë frutat e lumturisë më të madhe. Thënia e lartë e Profetit a.s.m., *"Kjo botë është një tokë që kultivohet për botën e përtejme"***,** e shpreh këtë të vërtetë.

Meqenëse bota ekziston dhe brenda kësaj bote ekzistojnë gjithashtu urtësia, përkujdesja, mëshira dhe drejtësia me dëshmitë e tyre të shumta, atëherë padyshim edhe Bota e përtejme ekziston gjithashtu me aq siguri, si siguria e ekzistencës së kësaj bote. Meqenëse çdo gjë në dynja shikon e orientohet për tek jeta e përhershme nga njëri aspekt, atëherë udhëtimi vazhdon drejt asaj bote. Kështu të mohosh botën e përtejme, do të ishte si të mohoje këtë botë me gjithçka që ajo përmban.

Domethënë, ashtu siç e presin njeriun Exheli dhe varri, po ashtu Xhenneti dhe Xhehennemi e presin me padurim arritjen e tij.

E VËRTETA E NJËMBËDHJETË

Porta e Humanizmit dhe Shfaqja e Emrit El-Hakk, i Vërteti.

A do të ishte e mundur që Krijuesi i Cili është i Adhuruari i Vërtetë, ta krijonte këtë njeri e ta bënte shërbëtorin më të nderuar të Hyjnisë së Tij Absolute dhe më të rëndësishmin e Hyjnisë universale në të gjitha botët e Tij, që e bëri atë marrësin më të mendueshëm e të kuptueshëm të urdhër-esave të Tij, e bëri atë pasqyrën më gjithëpërfshi-rëse të shfaqjes së Emr-ave të Tij; që e krijoi atë si mrekullinë më të bukur të fuqisë së Tij, në më të bukurën e formave, me qëllim që të shfaqë Emrin më të Madh dhe që të shfaqë shkallën më të madhe të çdo Emri nga këto Emra të Bukur; e bëri atë më të bukurin e mrekullive të Fuqisë Hyjnore dhe më të pasurin midis krijesave dhe i pajisi ato me balancat dhe instrumentet për të njohur e peshuar çfarë ndodhet në thesaret e Mëshirës Hyjnore, e bëri atë më të nevojshmin e të gjitha krijesave për mirësitë e Tij të panumërueshme, e bëri më të vuajturin e tyre nga asgjësimi, më të dëshirueshmin për qëndrueshmëri, e bëri më delikatin, më të varfërin e më të nevojshmin, më të mjerin e më të zbuluarin ndaj dhimbjeve në jetën e tij të kësaj bote, por më të lartin nga aspekti i aftësisë së tij të natyrshme, në format e në tiparet më të larta.

A do të ishte e mundur që All-llahu i Gjithëfuqishëm ta bënte të gjithë këtë tek njeriu, e pastaj të mos e dërgojë atë tek Bota e përjetshme për të cilën ai është i përshtatshëm e i denjë dhe për të cilën ai është shumë i përmalluar! A do të ishte e mundur që Ai të mohonte kështu të gjithë esencën e humanizmit, e të vepronte në një mënyrë krejtësisht në kundërshtim me vetë vërtetësinë e Tij, e të kryente një akt padrejtësie që syri i së vërtetës do ta vlerësonte të shëmtuar!

Përsëri, a do të ishte e mundur që Sundimtari me drejtësi dhe Mëshirëploti absolut i Cili i dhuroi këtij njeriu një aftësi të natyrshme të lartë ç'ka i mundësoi atij mbajtjen e Amanetit më të Madh, atë Amanet që e refuzuan për ta mbajtur edhe qiejt, toka dhe malet; domethënë e krijoi atë, që me peshat e tij të vogëla dhe me aftësitë e tij, të njihte cilësitë gjithëpërfshirëse, aktet e përgjithshme dhe treguesit e pafund të Krijuesit të tij, që Ai e bëri atë më delikatin, më të lëndueshmin e krijesave; dhe ia besoi atij rregullin e të gjithë jetës bimore e shtazore në tokë, dhe e bëri atë të ndërhyjë në mënyrat e tyre të adhurimit e të lavdërimit ndaj All-llahut; që Ai

e bëri atë një model në shkallë të zvogëluar të zhvillimeve Hyjnore në kozmos; që e bëri atë të shpallë Hyjninë e Tij të lavdishme tek të gjitha qëniet, në fjalë e në vepra; që Ai i dha atij një pozitë më të nderuar se sa pozita e engjëjve dhe i dha rangun e kalifit (zëvendësi i All-llahut në tokë) – a do të ishte e mundur që Ai t'i jepte këtij njeriu gjithë këto detyra dhe pastaj të mos i jepte qëllimin, rezultatin dhe frutin e të gjitha këtyre detyrave, që është lumturia e përjetshme! Dhe ta flakte atë në shkallën më të ulët, si më të mjerin, më fatkeqin, më të poshtëruarin dhe më të vuajturin e të gjithë krijesave të Tij! Dhe ta bënte këtë mendje e cila është një dhuratë e bekuar dritëdhënëse e Urtësisë së Tij, një mjet brilant për arritjen e lumturisë, dhe një instrument fatzi e i errët torture për atë mjerim, duke vepruar kështu në kontradiktë të plotë me urtësinë e Tij absolute dhe në kundërshtim me Mëshirën e Tij të pafund! Jo, kurrë nuk do të ishte e mundur!

Shkurtazi: Ashtu siç pamë në krahasimin e lartpërmendur tek letërnjoftimi i oficerit dhe te regjistri shërbimet e tij, rangun e tij, detyrën, rrogën, veprimet, instruksionet e pajimet, dhe u bë e qartë se ai oficer nuk punon për hir të kësaj fushe beteje të përkohshme, por për atë që ai do të udhëtojë tek një mbretëri e përjetshme, për hir të së cilës ai po përpiqet. Gjithashtu hollësitë e skalitura në librin e zemrës së njeriut, shqisat e shënuara në regjistrin e mendjes së tij dhe pajisjet e përfshira në natyrën e tij, që të gjitha janë orientuar drejt lumturisë së përjetshme; ato i janë dhënë njeriut dhe janë formuar veçse për hir të asaj lumturie të madhe. Dijetarët e përpiktë dhe evlijatë, të cilëve u jepen zbulime nga e padukshmja, kanë mendim unanim.

Përmbledhje: Në qoftë se do t'i thuhej "fuqisë imagjinuese të njeriut", e cila është njëra nga instrumentet e mendjes dhe një nga ilust-ruesit e saj, se: "ty do të të jepet sundimi i kësaj bote dhe stolia e saj, dhe se do të jetosh një milion vjet, por fundi yt është zhdukje e asgjësim", ajo do të reagonte me hidhërim në vend të kënaqësisë në qoftë se nuk do të ndërhynin tekat dhe dëshirat e ulëta të nefsit.

Domethënë, më e madhja e gjërave të përkohshme që është dynjaja dhe çfarë përmban ajo nuk mund të ngopë e kënaqë as edhe aftësinë më të vogël të njeriut, që është imagjinata! Nga kjo shfaqet qartë se ky njeri i

cili ka këtë aftësi të natyrshme, i cili ka shpresa, ka mendime që rrethojnë gjithësinë, dhe dëshira që preferojnë llojet e ndryshme të lumturisë së përjetshme, sigurisht ky njeri u krijua vetëm për përjetësi dhe, së fundi, do të udhëtojë atje. Kjo botë është si një bujtinë për të, dhe një sallë pritje për botën e përtejme...

E VËRTETA E DYMBËDHJETË

Porta e Mesazhit dhe e Shpalljes dhe Shfaqja e

"Bismil-Lahir-Rrahmanirr-Rrahim",

Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.

A do të ishte e mundur për atë, fjalën e të cilit e vërtetuan të gjithë pejgamberët duke u mbështetur në mrekullitë e tyre, dhe të gjithë evlijatë duke u mbështetur në provat dhe në eksperiencat e tyre hirëplote, e dëshmuan vërtetësinë e tij të gjithë dijetarët e pastër duke u mbështetur në hetimet e tyre për të vërtetën... Ai Profet a.s.m. i cili, me të gjithë fuqinë e tij hapi rrugën e botës së përtejme dhe portën e Xhennetit, duke u mbështetur tek fuqia e mijëra mrekullive të sigurta dhe tek mijëra vërsete vendimtare të Kur'anit të gjithurtë, të këtij libri të mrekullueshëm në dyzet aspekte të ndryshme. A do të ishte e mundur që dyshimet e gabuara, të cilat nuk janë më të forta as sa krahu i një mize, të bllokonin rrugën e botës së përtejme dhe portën e Xhennetit të cilat i hapi Profeti Muhammed a.s.m.!

Nga të vërtetat e mëparshme është bërë e qartë se çështja e ringjalljes është një e vërtetë aq e rrënjosur dhe e fuqishme, saqë asnjë fuqi, sado që të jetë, nuk mund ta lëkundë e ta shkulë atë; madje le të jetë ajo fuqi e aftë për të tronditur globin, ta thyente e ta flakte atë, sepse All-llahu i Gjithëfuqishëm e pohon dhe e deklaron atë të vërtetë me kuptimin e të gjithë Emrave të Tij dhe të Atributeve; dhe mesazhieri i Tij fisnik a.s.m. e vërteton atë me të gjitha mrekullitë e dëshmitë e Tij; Kur'ani i gjithurtë e vërteton atë me të gjitha të vërtetat e tij dhe me vërsetet; dhe vetë Kozmosi

e dëshmon atë me të gjitha shenjat e krijueshmërisë që ai përmban dhe me të gjitha zhvillimet plot urtësi që ndodhin brenda tij.

A do të ishte e mundur që të bashkoheshin e të pajtoheshin me Qënien e Domosdoshme të gjitha krijesat, –me përjashtim vetëm të mohuesve– mbi këtë çështjen e ringjalljes, e pastaj të vinin dyshimet e dobëta dhe insinuatat djallëzore që s'kanë fuqi as sa një fije floku, ta lëkundin e ta shkulin atë të vërtetë të rrënjosur fort, e cila i ngjason një mali! Jo, kurrë!..

Mos kujto se provat e ringjalljes janë përkufizuar tek Dymbëdhjetë të Vërtetat që ne i përmendëm lart. Jo, vetëm Kur'ani i gjithurtë, i cili na i ka mësuar këto Dymbëdhjetë të Vërteta, tregon gjithashtu me mijëra aspekte të tjerë të çështjes, ku secili aspekt duke qenë një shenjë e fortë, se Krijuesi ynë do të na transferojë nga kjo botë e përkohshme për tek Bota e përjetshme.

Gjithashtu mos kujto se Emrat Hyjnorë, të cilët logjikisht kërkojnë ekzistencën e ringjalljes, janë përkufizuar tek këto Emra që ne i kemi diskutuar: –***El-Hakimu, El-Kerimu, Er-Rahimu, El-A'dilu, El-Hafidhu***– , *i Gjithurti, Gjithëbujari, Mëshirëploti, i Drejti dhe Ruajtësi*. Përkundrazi, të gjithë Emrat Hyjnorë që shfaqen në rregullsinë e Kozmosit kërkojnë logjikisht ekzistencën e ringjalljes dhe në të vërtetë e bëjnë atë të domosdoshme.

Gjithashtu, mos kujto se shenjat e Kozmosit që tregojnë ringjalljen janë vetëm ato që ne i përmendëm; përkundrazi, në shumicën e qënieve, ekzistojnë apsekte të ndryshëm e cilësi që janë si perde duke u hapur nga e djathta dhe nga e majta. Njëri aspekt jep dëshmi për Krijuesin, dhe aspekti tjetër tregon ringjalljen.

Për shembull, bukuria e qënies së njeriut, i formuar në formën më të bukur, tregon ekzistencën e Krijuesit dhe në të njëjtën kohë – fakti se si së bashku me gjithë aftësitë e tij gjithëpërfshirëse të cilat zhduken për një periudhë të shkurtër, tregon ringjalljen. Saqë, në qoftë se dikush do ta shihte të njëjtin aspekt në dy mënyra të ndryshme, ai do të shikonte se ai aspekt do të demonstronte edhe Krijuesin, edhe ringjalljen.

Për shembull, në qoftë se dikush do të shikonte rregullin plot urtësi, balancën e drejtë, stolisjen e hijshme dhe mirësinë e mëshirshme të natyrshme në shumicën e gjërave, ato tregojnë se vijnë nga Dora e Fuqishme e një Krijuesi të Gjithurtë, Gjithëbujar, i Drejtë dhe i Gjithë-mëshirshëm. Gjithashtu në qoftë se dikush do ta shikonte jetën e shkurtër e të parëndësishme, atë të qënieve të përkohshme, të cilat janë treguesit e këtyre cilësive, pavarësisht fuqisë së tyre dhe pafundësisë, Bota e përtejme shfaqet para atij.

Me fjalë të tjera, të gjitha gjërat, me gjuhët e gjendjeve të tyre, recitojnë dhe bëjnë që edhe të tjerët të recitojnë:

اٰمَنْتُ بِاللّٰهِ وَبِالْيَوْمِ الْاٰخِرِ

"Unë besova në All-llahun dhe në Ditën e fundit."

* * *

PËRFUNDIM

Dymbëdhjetë të vërtetat e mëparshme mbështesin, përforcojnë e përplotësojnë njëra-tjetrën. Duke ardhur së bashku, ato demonstrojnë rezultatin e kërkuar. Atëherë çfarë iluzioni e dyshimi mund të depërtojnë tek ato Dymbëdhjetë Mure të forta, secili si çelik apo diamant, apo që të lëkundin besimin në ringjalljen që është i fortifikuar brenda kështjellës së tij të fortë? Vërseti:

مَاخَلْقُكُمْ وَلَابَعْثُكُمْ اِلَّاكَنَفْسٍ وَاحِدَةٍ *"Krijimi dhe ringjallja e të gjithë njerëzve është aq e lehtë për Fuqinë e All-llahut sa krijimi dhe rringjallja e një njeriu të vetëm."* tregon kuptimin e mëposhtëm: Po, ajo është vërtet kështu. Në një trajtesë të titulluar: **"*Nokta"***, unë shpjegova me hollësi të vërtetën e shprehur nga ky vërset. Këtu ne do të tregojmë vetëm një përmbledhje nëpërmjet disa krahasimeve. Në qoftë se ju dëshironi më shumë hollësi, atëherë referojuni kësaj trajtese të titulluar **"*Nokta."***

Për shembull, وَلِلّٰهِ الْمَثَلُ الْاَعْلٰى Ndërsa "*Për All-llahun është krahasimi më i lartë* "[267], –dhe nuk ka gabim në krahasim–. Dielli, ashtu siç e dërgon, edhe sikur nga vetë dëshira e tij, dritën e tij me lehtësi të plotë tek një grimcë e vetme, po ashtu ai dërgon dritën me të njëjtën lehtësi tek të gjitha gjërat e tejdukshme që janë të pakufishme; dhe kjo me shfaqjen e misterit të *"Dritësisë"*

Dhe në përputhje me misterin e ***"Tejdukshmërisë"*,** bebja e vogël e një grimce të tejdukshme është e barabartë me sipërfaqen e gjërë të oqeanit në marrjen e reflektimit të diellit.

[267] Kur'an, 16: 60

Dhe në përputhje me misterin e *"Rregullit"*, fëmija ashtu siç mund të lëvizë një anije lodër (kukull) me gishtin e tij, po ashtu ai mund ta lëvizë me të njëjtën lehtësi edhe anijen e vërtetë.

Në përputhje me misterin e *"Nënshtrimit"*, një komandant bën që një ushtar i këmbësorisë të ecë me të dhënë urdhrin "ec", po ashtu, me të njëjtën fjalë, ai mund ta bëjë një ushtri të madhe të lëvizë.

Në përputhje me misterin e *"Drejtpeshimit"*, le të imagjinojmë se në hapësirë ekziston një peshore aq e ndjeshme, aq e madhe dhe aq e saktë sa që do ta ndjente peshën e dy arrave nëse ato do të vendoseshin në pjatat e saj, dhe në të njëjtën kohë pikërisht ajo peshore mund të peshojë dy diejt. Tani e njëjta fuqi që i shkakton njërës nga arrat të ngrihet lartë në qiell dhe tjetrës të ulet poshtë, është ajo fuqi që do t'u shkaktonte dy diejve, njërit të ngrihej lart në fron dhe tjetrit të ulej poshtë në tokë.

Meqenëse gjëja më e madhe barazohet me gjënë më të vogël, dhe gjëra të panumërta shfaqen të barabarta me një gjë të vetme në këto krijesa të gjëra të mundshme të kësaj bote -të cilat janë të mangëta, kalimtare e të zakonshme- nëpërmjet mistereve të **"Dritësisë", "Tejdukshmërisë", "Rregullit", "Nënshtrimit",** dhe **"Drejtpeshimit"**, atëherë me siguri do të jenë të barabarta, përpara të Gjithëfuqishmit Absolut, e pakta dhe e shumta, e vogla dhe e madhja, ringjallja e një njeriu të vetëm dhe ringjallja e të gjithë njerëzve me një rënie të vetme të borisë, dhe kjo, për shkak të shfaqjes së misterit të **"Dritësisë"** absolute dhe të Fuqisë absolute të Esencës së Tij që është e pafund; për shkak të shfaqjes së misterit të **"Tejdukshmërisë"** në dimensionet e brendshme të gjërave; për shkak të shfaqjes së misterit të "**Rregullit"** të Urtësisë dhe të Paracaktimit; për shkak të shfaqjes së misterit të **"Nënshtrimit"** të plotë të të gjitha gjërave ndaj urdhërave të Tij krijuese dhe për shkak të shfaqjes së misterit të **"Drejtpeshimit"** të mundësisë, që është barazia e gjërave të mundshme në ekzistencë e në mosekzistencë.

Për më tepër, shkallët e fuqisë e të dobësisë që një gjë posedon, përcaktohen nga ndërhyrja e të kundërtës së asaj gjëje në të. Për shembull, shkallët e nxehtësisë përcaktohen nga ndërhyrja e të ftohtit; shkallët e bukurisë përcaktohen nga ndërhyrja e shëmtisë; fazat e dritës përcaktohen

nga ndërhyrja e errësirës. Por në qoftë se diçka ekziston nga vetvetja dhe nuk është e rastit, atëherë e kundërta e saj nuk mund të ndërhyjë tek ajo, sepse, atëherë, logjikisht, do të duhej të ndodhte bashkimi i dy të kundërtave, gjë e cila është e pamundur.

Domethënë, në diçka që ekziston nga vetvetja, nuk mund të ketë shkallë. Atëherë në qoftë se forca e Zotëruesit të Fuqisë Absolute i përket Esencës së Tij, ajo gëzon Plotësim Absolut dhe nuk është aksidentale ashtu si qëniet e mundshme. Kështu, është e pamundur që e kundërta e saj, që është pafuqia, të ndërhyjë në të. Kështu për All-llahun e Gjithë-lavdisë është aq e lehtë të krijojë një pranverë, sa krijimi i një luleje. Por, në qoftë se krijimi do t'i atribuohej shkakësisë, atëherë krijimi i një luleje të vetme do të ishte aq e vështirë, sa krijimi i pranverës. Për All-llahun xh.sh. është aq e lehtë t'i ringjallë e t'i grumbullojë të gjithë njerëzit, sikur të ringjallte një njeri të vetëm.


E gjitha ajo që kemi shpjeguar deri tani, në lidhje me Ringjalljen dhe të gjitha krahasimet që e tregojnë atë dhe të vërtetat e saj, burojnë nga shkëlqimi i Kur'anit të gjithurtë. Qëllimi i saj i vetëm është vetëm të përgatisë shpirtin për t'u nënshtruar dhe të përgatisë zemrën për të pranuar. I përket vetëm Kur'anit e drejta për të folur, sepse ai është folja e vërtetë dhe e gjithë fjala është Fjala e Tij. Atëherë, le ta dëgjojmë Kur'anin:

فَلِلَّهِ الْحُجَّةُ الْبَالِغَةُ ۖ فَانظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ
مَوْتِهَا إِنَّ ذَٰلِكَ لَمُحْيِي الْمَوْتَىٰ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۖ قَالَ مَن
يُحْيِي الْعِظَامَ وَهِيَ رَمِيمٌ ۖ قُلْ يُحْيِيهَا الَّذِي أَنشَأَهَا أَوَّلَ مَرَّةٍ
وَهُوَ بِكُلِّ خَلْقٍ عَلِيمٌ ۖ يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمْ إِنَّ زَلْزَلَةَ السَّاعَةِ شَيْءٌ

عَظِيمٌ ۝ يَوْمَ تَرَوْنَهَا تَذْهَلُ كُلُّ مُرْضِعَةٍ عَمَّآ أَرْضَعَتْ وَتَضَعُ كُلُّ ذَاتِ حَمْلٍ
حَمْلَهَا وَتَرَى النَّاسَ سُكَارَىٰ وَمَا هُم بِسُكَارَىٰ وَلَٰكِنَّ عَذَابَ اللَّهِ شَدِيدٌ ۝
اَللَّهُ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ لَيَجْمَعَنَّكُمْ إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيَٰمَةِ لَا رَيْبَ فِيهِ وَمَنْ أَصْدَقُ
مِنَ اللَّهِ حَدِيثًا ۝ إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ ۝ وَإِنَّ الْفُجَّارَ لَفِي جَحِيمٍ ۝ إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ
زِلْزَالَهَا ۝ وَأَخْرَجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا ۝ وَقَالَ الْإِنسَانُ مَا لَهَا ۝ يَوْمَئِذٍ
تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا ۝ بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَىٰ لَهَا ۝ يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِّيُرَوْا
أَعْمَالَهُمْ ۝ فَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ۝ وَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ ۝
الْقَارِعَةُ ۝ مَا الْقَارِعَةُ ۝ وَمَا أَدْرَىٰكَ مَا الْقَارِعَةُ ۝ يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ
الْمَبْثُوثِ ۝ وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعِهْنِ الْمَنفُوشِ ۝ فَأَمَّا مَن ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ ۝ فَهُوَ
فِي عِيشَةٍ رَّاضِيَةٍ ۝ وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ ۝ فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ ۝ وَمَا أَدْرَىٰكَ
مَا هِيَهْ ۝ نَارٌ حَامِيَةٌ ۝ وَلِلَّهِ غَيْبُ السَّمَٰوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا أَمْرُ السَّاعَةِ إِلَّا كَلَمْحِ
الْبَصَرِ أَوْ هُوَ أَقْرَبُ إِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۝

Duke dëgjuar këto dhe vërsetet e tjera të qarta të Kur'anit, le të themi, ***"Po, ne besojmë dhe japim miratimin tonë."***

آمَنْتُ بِاللَّهِ وَمَلَٰئِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَبِالْقَدَرِ خَيْرِهِ وَشَرِّهِ
مِنَ اللَّهِ تَعَالَىٰ وَالْبَعْثِ بَعْدَ الْمَوْتِ حَقٌّ وَأَنَّ الْجَنَّةَ حَقٌّ وَالنَّارَ حَقٌّ وَأَنَّ الشَّفَاعَةَ
حَقٌّ وَأَنَّ مُنْكَرًا وَنَكِيرًا حَقٌّ وَأَنَّ اللَّهَ يَبْعَثُ مَنْ فِي الْقُبُورِ أَشْهَدُ أَنْ
لَا إِلَٰهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ



Unë besoj në All-llahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në profetët e Tij, dhe në Ditën e Fundit. Unë besoj se e mira dhe e keqja e paracaktimit janë nga All-llahu i Plotëfuqishëm, se Ringjallja pas vdekjes është një realitet; se Xhen-neti është një realitet, se Ferri është një realitet, se shefa'ati (ndërmjetësimi) është një realitet; se Munker dhe Nekir janë realitet; dhe se All-llahu xh.sh. do t'i ringjallë ata që janë në varreza. Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, dhe unë dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i All-llahut xh.sh.

O All-llah! Jepi bekime frutit më të hollë, më fisnik, më të plotë dhe më të bukur të Tubas (Pemës) së Mëshirës Tënde, atij të cilin Ti e dërgove si mëshirë për të gjitha botët, dhe si mjet për arritjen e frutave më të bukur, më të mira, më të pastërta e më të larta të Asaj Tubaje, degët e së cilës janë shtrirë mbi botën e përtejme e mbi Xhennet; O All-llah! Na mbro neve dhe prindërit tanë nga zjarri dhe na bëj ne dhe prindërit tanë të hyjmë në Xhennet me të drejtit, për hir të Profetit Tënd të zgjedhur. Amin!

O vëlla që po e studion këtë trajtesë me paanshmëri! *Mos thuaj: "Pse nuk mund ta kuptoj menjëherë këtë* ***"Fjalën e Dhjetë"*** *me të gjitha detajet? Dhe mos u dëshpëro për moskuptimin e saj plotësisht, sepse madje edhe një gjeni i filozofisë, për shembull Ibn Sina, ka thënë:*

اَلْحَشْرُ لَيْسَ عَلٰى مَقَايِيْسِ عَقْلِيَّةٍ *"Ringjallja nuk mund të kuptohet me kritere racionale, të arsyeshme."* Gjykimi i tij ishte se ne duhet të besojmë në ringjalljen, por mendja nuk mund të ecë në këtë rrugë.

Gjithashtu, të gjithë dijetarët e Islamit kanë rënë dakord me unanimitet se: "Çështja e ringjalljes është një çështje që mbështetet krejtësisht mbi provat e transmetuara, domethënë argumentet e saj janë transmetime

tradicionalisht; ajo nuk mund të shqyrtohet logjikisht e racionalisht". Natyrisht, një rrugë kaq e thellë dhe njëkohësisht kaq e lartë në kuptim, nuk mund të bëhet menjëherë një rrugë e përgjithshme racionale që të mund ta ndiqte çdo udhëtar. Por me shkëlqimin e Kur'anit të gjithurtë dhe me Mëshirën e Krijuesit Mëshirëplotë që na dhuroi neve ecjen në këtë rrugë të lartë e të thellë, në këtë shekull në të cilin është rrënuar besimi me imitim dhe është prishur dëgjueshmëria e nënshtrimi, ne duhet t'i paraqesim mijëra falënderime Krijuesit Mëshirëplotë për mirësitë e Tij të mëdha, pasi kjo sasi është e mjaftueshme për të shpëtuar besimin tonë dhe për ta siguruar atë. Duke qenë të kënaqur me sasinë që kemi mundur ta kuptojmë, ne duhet të rilexojmë e të kërkojmë të rrisim shkallën e kuptimit tonë.

Një nga arsyet që është e pamundur t'i afrohesh çështjes së Ringjalljes përmes të kuptuarit me mend është se, meqenëse tubimi i madh i Ringjalljes ndodh nëpërmjet shfaqjes së Emrit më të Madh, atëherë vetëm duke parë e demonstruar veprat e mëdha që vijnë nga shfaqja e Emrit më të Madh dhe nga shfaqja e shkallës më të Lartë të çdo Emri prej Emrave të Bukur Hyjnorë, Ato e bëjnë të sigurt vërtetimin e Ringjalljes, dhe ne besojmë në mënyrë të palëkundur se Ringjallja e madhe është aq e kollajt sa pranvera.

Kështu duken çështjet dhe kështu ato tregohen në këtë ***"Fjalën e Dhjetë" (Ringjallja dhe Bota e Përtejme),*** nëpërmjet shkëlqimit të Kur'anit. Po të mos ishte ky shkëlqim, dhe po të lihej mendja jonë në kriteret e saja të vogëla e të ngushta, ajo do të bëhej e pafuqishme dhe do të dënohej të besonte në ringjallje përmes imitimit...

* * *

PJESA E PARË E SHTESËS SË FJALËS SË DHJETË DHE NJË SHTOJCË E SAJ E RËNDËSISSHME


بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ ۞ فَسُبْحَانَ ٱللَّهِ حِينَ تُمْسُونَ وَحِينَ
تُصْبِحُونَ ۞ وَلَهُ ٱلْحَمْدُ فِي ٱلسَّمَٰوَاتِ وَٱلْأَرْضِ وَعَشِيًّا وَحِينَ تُظْهِرُونَ ۞
يُخْرِجُ ٱلْحَيَّ مِنَ ٱلْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ ٱلْمَيِّتَ مِنَ ٱلْحَيِّ وَيُحْيِي ٱلْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَ
كَذَٰلِكَ تُخْرَجُونَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦٓ أَنْ خَلَقَكُم مِّن تُرَابٍ ثُمَّ إِذَآ أَنتُم بَشَرٌ تَنتَشِرُونَ ۞
وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦٓ أَنْ خَلَقَ لَكُم مِّنْ أَنفُسِكُمْ أَزْوَٰجًا لِّتَسْكُنُوٓا۟ إِلَيْهَا وَجَعَلَ
بَيْنَكُم مَّوَدَّةً وَرَحْمَةً ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَءَايَٰتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦ
خَلْقُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَٱخْتِلَٰفُ أَلْسِنَتِكُمْ وَأَلْوَٰنِكُمْ ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَءَايَٰتٍ
لِّلْعَٰلِمِينَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦ مَنَامُكُم بِٱلَّيْلِ وَٱلنَّهَارِ وَٱبْتِغَآؤُكُم مِّن فَضْلِهِۦٓ ۚ إِنَّ
فِي ذَٰلِكَ لَءَايَٰتٍ لِّقَوْمٍ يَسْمَعُونَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦ يُرِيكُمُ ٱلْبَرْقَ خَوْفًا وَطَمَعًا
وَيُنَزِّلُ مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءً فَيُحْيِۦ بِهِ ٱلْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَءَايَٰتٍ
لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ۞ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦٓ أَن تَقُومَ ٱلسَّمَآءُ وَٱلْأَرْضُ بِأَمْرِهِۦ ۚ ثُمَّ إِذَا دَعَاكُمْ
دَعْوَةً مِّنَ ٱلْأَرْضِ إِذَآ أَنتُمْ تَخْرُجُونَ ۞ وَلَهُۥ مَن فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۖ كُلٌّ
لَّهُۥ قَٰنِتُونَ ۞ وَهُوَ ٱلَّذِي يَبْدَؤُا۟ ٱلْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُۥ وَهُوَ أَهْوَنُ عَلَيْهِ ۚ وَلَهُ
ٱلْمَثَلُ ٱلْأَعْلَىٰ فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ۞

Në këtë **"Rrezen e Nëntë"** do të shpjegojmë një argument të fuqishëm dhe një provë më të madhe nga këto vërsete të larta qiellore që vërtetojnë një bosht të besimit dhe polin e tij, dhe nga këto dëshmi të larta të shenjta që provojnë realitetin e ringjalljes.

Ishte një tregues i hollë i përkujdesjes Hyjnore dhe i favorit, që në fundin e veprës së titulluar **"Muhakemat"**, të cilën tridhjetë vjet më parë e shkroi Saidi i Vjetër si parathënie të komentit, *Qëllimi i Dytë*: do të shpjegojmë e komentojmë dy vërsete të Kur'anit që aludojnë për Ringj-alljen.



"Mirëpo, sapo tha: Me Emrin e All-llahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti", aty ndaloi dhe nuk mundi ta shkruajë më. Lavdërime e falënderime aq të shumta sa provat dhe sa dëshmitë për ringjalljen i takojnë Krijuesit Mëshirëplotë që tridhjetë vjet më vonë më mundësoi që ta vazhdoja. Po, nëntë apo dhjetë vjet më parë, All-llahu xh.sh. më dhuroi "Fjalën e Dhjetë" dhe të "Njëzet e Nëntën", dy vepra brilante që përmbajnë prova të fuqishme të shumta dhe interpretimet e të parit prej dy vërseteve në fjalë.



Ato i heshtën ata që e mohuan Ringjalljen. Dhe tani, nëntë apo dhjetë vjet më vonë, pas shpjegimit të atyre dy kështjellave të fortifikuara të besimit në Ringjallje, All-llahu xh.sh. më dhuroi mbarësi për të shpje-guar vërsetin e dytë të lartëpërmendur me këtë trajtesë.

Kështu, *"Rrezja e Nëntë"* përbëhet nga ***"Nëntë Stacione të Larta"*** me një ***"Parathënie"*** të rëndësishme që janë treguar me vërsetet e lartëpërmendura.

* * *

PARATHËNIE

[Kjo parathënie përmban "Dy Pika" që demonstrojnë në mënyrë të shkurtuar një rezultat gjithëpërfshirës prej rezultateve të shumta jetësore dhe të mirësive shpirtërore të besimit në Ringjalljen, duke shpjeguar se sa i domosdoshëm dhe, në të vërtetë, sa esencial është ky besim për jetën njerëzore, dhe veçanërisht për jetën shoqërore. Gjithashtu ne do të sjellim një provë të përgjithshme, prej provave të shumta të ringjalljes duke sqaruar gjithashtu se sa çështje e vetëkuptueshme dhe e padyshimtë është besimi në Ringjallje].

PIKA E PARË

Ne do të tregojmë, si një shembull, katër midis qindra provave të këtij fakti, se besimi në botën e përtejme është pikërisht baza dhe themeli i të gjithë jetës shoqërore dhe individuale të njeriut, themeli i të gjithë lumturisë së tij si dhe i plotësimeve dhe i arritjeve:

● ***Prova e parë:*** Fëmijët, të cilët përbëjnë gati gjysmën e gjinisë njerëzore, mund ta durojnë ndarjen dhe vdekjen që përpara tyre shfaqen aq të tmerrshme e tragjike, vetëm nëpërmjet idesë së Xhennetit. Vetëm nëpërmjet kësaj, ata mund të gjejnë forcë shpirtërore në trupat e tyre të dobët e delikatë dhe mund të gjejnë shpresë që i lejon ata të jetojnë të gëzuar, pavarësisht gjendjes së tyre shpirtërore të prekshme e të lëndueshme të cilët qajnë edhe për shkakun më të vogël e të parëndësishëm.

Për shembull, duke menduar për Xhennetin, fëmija do të thonte: "Vëllai im i vogël apo shoku im i dashur që ka vdekur, është bërë tani një zog i Xhennetit. Ai është duke shëtitur atje dhe po bën një jetë më të mirë se jetën tonë." Ndryshe, vdekjet që ndodhin në rrethin e fëmijëve tek të

mëdhenjt dhe tek të vegjëlit si dhe shfaqja e vdekjes përpara shikimeve të tyre të frikësuara të cilët janë të dobët, do të shkatërronte fuqinë e tyre të rezistencës dhe forcën e brendshme, dhe do të bënte të qanin jo vetëm sytë e tyre, por të gjitha aftësitë e tyre të brendshme, shpirti, zemra dhe mendja. Dhe ata fëmijë të dobët ose do të shkatërroheshin, ose do të bëheshin si kafshë të çmendura e të mjera...

● ***Prova e dytë:*** Të moshuarit, të cilët –nga njëri aspekt– përbëjnë gjysmën e njerëzimit, gjejnë mbështetje e durim ndërsa janë në buzë të varrit vetëm me besimin në botën e përtejme. Vetëm nëpërmjet këtij besimi ata gjejnë ngushëllim për afrimin e zhdukjes së jetës me të cilën ata janë shumë të lidhur dhe të mbylljes së portës së dynjasë së tyre të ëmbël e të bukur. Të moshuarit, që janë bërë si fëmijë e që preken në shpirtërat e në temperamentet e tyre, vetëm nëpërmjet shpresës për jetë të përhershme mund ta përballojnë dëshpërimin e dhimbshëm e të tmerrshëm që buron nga parashikimi i vdekjes dhe i ndarjes. Përndryshe, po të mos ishte ky besim për botën tjetër, këta baballarë e nëna të cilët janë më të meritueshmit për mëshirë e keqardhje, dhe më të nevojshmit për paqen e qetësinë e zemrës, do të përjetonin një turbullirë të shpirtit dhe një trazirë e shqetësim të zemrës, saqë bota do të dukej për ta si një burg i errët i nëndheshëm dhe jeta do të bëhej për ta torturë e rëndë.

● ***Prova e tretë:*** Të rinjtë dhe adoleshentët, të cilët përbëjnë boshtin dhe themelin e jetës shoqërore, nuk do t'i qetësonte ndjenjat e tyre të trazuara, dhe nuk do t'i pengonte ata nga tejkalimi i caqeve për tek padrejtësia e shkatërrimi, nuk do t'i ndalonte nefsin e tyre të stuhishëm dhe pasionet e tyre, dhe nuk do ta siguronte ecjen e tyre më të mirë duke u shërbyer qëllimeve të jetës shoqërore, veçse frika nga zjarri i Xhehen'nemit. Ndërsa po të mos ishte kjo frikë nga ndëshkimi i Xhehennemit, të rinjtë të dehur nga pasionet e tyre të stuhishme do të ndiqnin parimin, "Forca është e drejta", dhe do ta kthenin botën në një Xhehennem për të dobëtit e të pafuqishmit. Ata do ta transformonin jetën e lartë humane në një jetë të ulët e në një gjendje shtazarake.

● ***Prova e katërt:*** Qendra më gjithëpërfshirëse e gjinisë njerëzore në jetën e saj të kësaj bote, burimi më themelor i saj, xhenneti i saj, strehimi

dhe kështjella e lumturisë së kësaj bote është jeta e familjes. Shtëpia e çdo individi është si një botë e vogël për të. Jeta dhe lumturia e jetës së familjes së tij dhe gjallëria e shtëpisë varet nga respekti i ndërsjellë, serioz, i sinqertë e i kushtuar midis të gjithëve, nga përkujdesja e vërtetë dhe nga mëshira që arrin deri në cakun e vetësakrifikimit. Kurrë nuk do të arrihej ky respekt i sinqertë dhe kjo mëshirë e vërtetë e ndërsjellë, veçse me besimin në ekzistencën e marrëdhënieve të përjetshme shoqërore, e mëshirës së përhershme dhe të bashkëshoqërimit të amshuar, në një kohë të pafund, dhe nën hijen e një jete të pakufishme, të cilat i lidhin marrëdhënie të respektuara e të shquara atërore, marrëdhënie të pastërta vëllazërore dhe marrëdhënie të sinqerta e të ngushta shoqërore.

Për shembull, bashkëshorti thotë me vete: "Kjo bashkëshortja ime do të jetë shoqja e përhershme e jetës sime në një botë të përjetshme dhe në një jetë të amshuar. Në qoftë se ajo tani është plakur dhe është bërë e shëmtuar, nuk ka rëndësi, sepse ajo ka një bukuri të përjetshme që do ta shfaqë vetveten në të ardhmen, dhe për këtë unë tani sakrifikoj gjithçka që kërkon ai bashkëshoqërim i përjetshëm, dhe tregoj çdo mëshirë e dhembshuri ndaj saj." Kështu, ai do ta trajtonte bashkëshorten e tij të moshuar me aq dashuri të shumtë, me mëshirë e përkujdesje sikur ajo të ishte një Huri e bukur. Përndryshe, një shoqërim e lidhje e ngushtë që përfundon e zgjat një orë, apo dy orë pas martesës dhe pastaj ndiqet nga një ndarje e përhershme, padyshim do të ishte një shoqërim sipërfaqësor, kalimtar e i pa themel. Ajo nuk do të ishte asgjë më shumë se sa një instinkt epshor i kafshëve dhe se një mëshirë figurative dhe një respekt artificial; gjithashtu do të shfaqeshin interesat e tjera të nefsit si ato të kafshëve dhe pasionet e shfrenuara dhe do ta mposhtnin atë mëshirë e respekt, dhe si rrjedhojë, një xhennet i kësaj bote do të kthehej në një Xhehennem të padurueshëm.

Atëherë, nga qindra rezultate të besimit në Ringjalljen, vetëm njëri rezultat lidhet me jetën shoqërore të njeriut. Në qoftë se aspektet e tjerë që janë me qindra dhe dobitë e këtij rezultati të vetëm do të dilnin si përfundim i deduktueshëm nëpërmjet analogjisë, me këto katër prova të vërteta, do të kuptohej se ndodhja dhe realizimi i realitetit të Ringjalljes është aq e sigurtë

sa e vërteta e lartë e humanizmit dhe sa nevojat e tij të përgjithshme. Ajo madje do të ishte një dëshmi më e qartë se sa nevoja e stomakut për ushqime, madje e dëshmon në mënyrë më të qartë se sa kjo.

Në qoftë se përfundimet e vërtetësisë së ringjalljes do të plaçkiteshin nga gjendja njerëzore, atëherë se esenca e humanizmit –Ringjallja–natyra dhe esenca e të cilit janë të larta, të rëndësishme e të gjalla, do të binin në gjendjen e coftinës, dhe të një strehimi mikrobesh.

Le t'i kushtojnë vëmendje sociologët, politikanët dhe moralistët, të cilët interesohen për çështjet e humanizmit, për moralin dhe për shoqërinë njerëzore, si mendojnë ata ta mbushin këtë zbrazëti, dhe me çfarë do t'i kurojnë ata këto plagë të thella? U kumbofshin veshët e tyre!..

PIKA E DYTË

Pika e dytë na shpjegon në mënyrë shumë të përmbledhur, një provë të vetme, midis provave të panumërta, e cila buron nga dëshmia që shtyllat e tjera të besimit japin për ringjalljen.

Kështu, që të gjitha mrekullitë që tregojnë profetësinë e Muhammedit a.s.m., të gjitha provat e profetësisë së Tij dhe të gjitha dëshmitë e vërtetësisë së Tij, dëshmojnë e vërtetojnë së bashku realitetin e vërtetësisë së ringjalljes, sepse gjatë jetës së Tij të bekuar, ai personalitet i lartë u përqëndru, pas Njësisë së All-llahut xh.sh., tek ringjallja midis të gjitha çështjeve të besimit. Dhe në të vërtetë, mrekullitë dhe provat që tregojnë vërtetësinë e të gjithë profetëve, paqja dhe bekimet e All-llahut qofshin mbi ta, dhe që u shkaktojnë njerëzve t'i vërtetojnë ato, dëshmojnë të njëjtën vërtetësi, e cila është ringjallja.

Dhe gjithashtu, fraza وَبِرُسُلِهِ *"Dhe besojmë në të gjithë Profetët"*, domosdoshmërisht ndiqet nga fraza وَكُتُبِهِ *"Dhe besojmë në Librat e Shpallur Qiellorë",* dhe kjo gjithashtu jep dëshmi për të njëjtën vërtetësi, si më poshtë vijon:

Të gjitha mrekullitë, provat dhe të vërtetat që argumentojnë vërtetësinë e Kur'anit të shpjegimit të mrekullueshëm dëshmojnë e vërtetojnë realizimin dhe ndodhjen e Ringjalljes sepse një e treta e Kur'anit përbëhet nga përmendjet për Ringjalljen, dhe shumica e sureve të shkurtëra fillojnë me vërsete të fuqishme që lidhen me ringjalljen. Kur'ani e shpall këtë të vërtetë me mijëra nga vërsetet e tij të lartë, në mënyrë të qartë e të nënkuptuar. Ai e provon atë dhe e demonstron qartë.

Për shembull:

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ۞ يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمْ إِنَّ زَلْزَلَةَ السَّاعَةِ شَيْءٌ عَظِيمٌ ۞
إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زِلْزَالَهَا ۞ إِذَا السَّمَاءُ انْفَطَرَتْ ۞ إِذَا السَّمَاءُ انْشَقَّتْ
۞ عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ ۞ هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْغَاشِيَةِ ۞

"*Kur dielli të mbështillet dhe të humbë dritën dhe të përmbyset."*[268]

"O njerëz! Kinie frikë All-llahun tuaj! Vërtet që tronditja e Orës (së Gjykimit) është gjë e tmerrshme."[269]

"Kur toka të dridhet me tronditjen e madhe (për të fundit herë)."[270]

"Kur qielli të plasë."[271]

"Kur qielli të çahet."[272]

"Për çfarë po pyesin njëri-tjetrin?"[273]

---

[268] Kur'an, 81: 1

[269] Kur'an, 22: 1

[270] Kur'an, 99: 1

[271] Kur'an, 82: 1

[272] Kur'an, 84: 1

[273] Kur'an, 78: 1

"A të ka arritur ty ngjarja e mbulimit (trishtimi i Ditës së Kijametit)?"[274]

Ashtu si këto vërsete, në fillimin e pothuajse tridhjetë-dyzet sureve, që tregojnë me sigurinë më të madhe se e vërteta e ringjalljes është më e rëndësishmja dhe më esencialja e të vërtetave të humanizmit, po ashtu vërsetet e tjera demonstrojnë me prova bindëse dëshmitë e ndryshme të të njëjtës vërtetësi.

A do të ishte e mundur që besimi në ringjalljen të ishte i pavërtetë, një besim i bërë aq qartë si dielli nga mijëra dëshmi e tregues të tjerë të parashtruar në një libër që mban frutin e të gjitha të vërtetave të shumta shkencore e kozmike që përfshihen në shkencat islame, ndonëse një tregues i vetëm i një vërseti të vetëm do të ishte i mjaftueshëm? A nuk do të ishte mohimi i këtij besimi si të mohoje diellin, e madje si të mohoje ekzistencën e kozmosit? A nuk do të ishte kjo njëqind shkallë e pamundur dhe e kotë?

Një mbret, në ndonjë rast, mund të dërgojë një ushtri në fushën e betejës, thjesht që një tregues i vetëm i tij të mos konsiderohet gënjeshtër; atëherë a do të ishte e mundur që t'i konsiderosh gënjeshtra mijërat e fjalëve, pretendimet dhe kërcënimet e Atij Monarku të Gjithëlavdishëm e t'i konsiderosh ato si të pavërteta?

Tani për provën e kësaj të vërtete të ringjalljes mjafton vetëm një tregues i vetëm nga ai mbret shpirtëror i cili ka sunduar për trembëdhjetë shekuj pa ndërprerje, që ka edukuar shpirtëra të panumërt, mendje, zemra dhe nefse, i ka pastruar ata dhe i ka drejtuar për tek e vërteta dhe realiteti; a nuk do të mjaftonte një tregues i vetëm prej tij për të provuar realitetin e ringjalljes? A edhe pasi të jetë provuar e demonstruar kjo e vërtetë me mijëra dëshmi të qarta, nuk pranohet? A nuk do të ishte injorant e idiot ai që nuk e pranon këtë të vërtetë të qartë? A nuk do të ishte drejtësi e pastër për të ndëshkimi i Xhehennemit?

Dhe gjithashtu, të gjitha Shkrimet Qiellore dhe Librat e Shenjtë, që secili nga ato iu adresua një shekulli e një kohe të caktuar, e vërtetojnë me mijëra

[274] Kur'an, 88: 1

nënshkrime pretendimin e Kur'anit për të vërtetën e ringjalljes, ndonëse shpjegimi i tyre për të është i përmbledhur e shkurt, dhe kjo sipas kohës dhe shekullit të tyre; ajo e vërtetë e sigurt, të cilën e shpjegoi qartë e në mënyrë të detajuar Kur'ani i komentimit të mrekullueshëm, ky libër i cili iu adresua të ardhmes dhe të gjitha epokave.

Ne do të përfshijmë këtu, për shkak se lidhet me temën e ringjalljes, një provë të ringjalljes e nxjerrë nga fundi i *Trajtesës së lutjes"* –Munaxhat–. Kjo provë, duke përmbajtur dëshminë e dhënë për إِيمَانٌ بِالْيَوْمِ الْآخِرِ *"Besimin në Ditën e Ringjalljes",* midis shtyllave të tjera të besimit, dhe veçanërisht për Besimin në Rusul **"të Dërguarit"** e All-llahut xh.sh. dhe në Kutub **"Librat"** e Tij, është e shkurtër por e fuqishme. Ajo mjafton për të larguar të gjitha dyshimet.

Kështu është thënë në **"Munaxhat"**:

"O All-llah i Gjithëmëshirshëm! Nëpërmjet udhëzimit të profetit më të nderuar dhe mësimit të Kur'anit, unë kam kuptuar se të gjithë librat e shenjtë dhe profetët, me në krye Kur'anin dhe profetin më të nderuar, tregojnë e dëshmojnë me unanimitet për shfaqjet e Emrave të Bukur Hyjnorë, plot Madhështi e Bukuri, që shenjat e të Cilëve shihen kudo në këtë dynja e në të gjitha botët, do të vazhdojnë në përjetësi në formë akoma më të shndritshme; se Mirësitë Hyjnore, shfaqjet e mëshirshme dhe shembujt e të cilave ne i shohim në këtë botë kalimtare, do të zgjasin e do të vazhdojnë në mënyrë më të shndritshme në Banesën e Lutmurisë, dhe se ata të përmalluar, të cilët i shikojnë ato në jetën e shkurtër të kësaj bote, me kënaqësi do t'i shoqërojnë me dashuri e mallëngjim dhe do të mbeten përjetësisht së bashku në Botën tjetër.

Dhe për më tepër, të gjithë profetët, me në krye profetin Muhammed a.s.m. dhe Kur'anin e gjithurtë, të cilët kanë në duart e tyre të gjithë shpirtërat e ndriçuar, evlijatë të cilët janë udhëheqësit e të gjitha zemrave të ndritura dhe shërbëtorët e vërtetë të All-llahut xh.sh., që janë burimi i të gjitha mendjeve të mprehta e të ndritura; ata të gjithë e besojnë ringjalljen dhe u japin njerëzve lajmet e gëzueshme për lumturinë e përjetshme. Për

më tepër, ata shpallin e dëshmojnë me besim të fortë se zjarri i Xhehen'nemit ekziston për ata që janë të çudhëzuar, kurse Xhenneti ekziston për ata që janë të udhëzuar drejtë. Ata e bëjnë këtë duke u mbështetur në qindra keramete të qarta dhe në vërsete vendimtare, dhe në premtimet e kërcënimet që Ti, o All-llah, i ke përmendur shumë shpesh në të gjitha shkrimet qiellore dhe në librat e shenjtë, duke u mbështetur në Dinjitetin e Madhështisë Tënde dhe në Mbretërinë e Hyjnisë Tënde, në veprat e Tua madhështore, dhe në Atributet e Tua të shenjta si fuqia, mëshira, përkujdesja, urtësia, madhështia e bukuria, si dhe duke u bazuar në vizionet e tyre të shumta dhe në shikimet e tyre të cilat na përçojnë neve shenjat dhe efektet e botës tjetër, dhe duke u mbështetur në besimin e në bindjen e tyre që janë tek shkalla e njohjes së sigurtë dhe tek shikimi i sigurt i të vërtetës.

"O i Gjithurtë dhe i Gjithëfuqishëm i Vetëm! O i Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë! O Gjithëbujar i Vetëm gjithmon i vërtetë në premtimin Tënd! O i Gjithautoritetshëm i Vetëm dhe i Gjithëlavdishëm, Zotëruesi i Madhështisë, i Shkëlqimit dhe i Lartësisë!."

Ti je i Lartësuar, i Shenjtëruar dhe i Pastruar pafundësisht, Ti je i shpëtuar nga të bërit e shumë evlijave dhe miqve të Tu të sinqertë dhe pastaj ata të shfaqeshin si gënjeshtarë dhe të paraqitej e rreme dëshmia e aq shumë Emrave të Tu të Bukur dhe e pamjeve të Tua; Ti je i lartësuar dhe i shenjtëruar nga refuzimi e dështimi për të kryer atë që është bërë e domosdoshme në mënyrë vendimtare nga Sovraniteti i Hyjnisë Tënde; je i lartësuar nga mospranimi i lutjeve të panumërta dhe i duave për botën e përtejme që bëhen nga shërbëtorët e Tu të shumtë të cilët Ti i do dhe të cilët kërkojnë dashurinë Tënde me besim tek Ti dhe me bindje e nënshtrim ndaj Teje; dhe je i shenjtëruar nga miratimi ndaj mohimit të ringjalljes që bëhet nga njerëzit e humbur e të çudhëzuar të cilët e fyejnë Lavdinë Tënde dhe Madhështinë me mosbesimin e tyre kryengritës dhe me mohimin e tyre ndaj premtimeve të Tua, të cilët tejkalojnë caqet dhe veprojnë në kundërshtim me Madhështinë e Hyjnisë Tënde dhe sulmojnë Mëshirën e Hyjnisë Tënde. Ne e shpallim shenjtërinë e drejtësisë Tënde absolute, të

bukurisë së pafund dhe të mëshirës Tënde të gjërë, dhe e shpallim lartësinë e tyre dhe qënien e tyre larg kësaj padrejtësie e shëmtie të pakufishme.

Ne besojmë me të gjithë fuqinë tonë në të vërtetën dhe në saktësinë e dëshmisë së dhënë nga qindra e mijëra mesazhierë të vërtetë, nga të gjithë profetët, evlijatë, të pastërtit të cilët thërrasin për tek Ty dhe janë dëshmuesit me të gjitha shkallët e sigurisë, që janë lajmëtarët e sovranitetit të All-llahut, e thesareve të mëshirës Tënde të përjetshme, e pasurive të mirësisë Tënde të fshehur në botën e përhershme, dhe për shfaqjet e mahnitshme e të mrekullueshme të Emrave të Bukur të Tu që do të shfaqen plotësisht në Banesën e lumturisë. Treguesit e tyre janë të vërteta e të sakta, parashikimet e tyre janë të vërteta. Ata i mësojnë shërbëtorët e Tu me urdhrin Tënd brenda sferës së të vërtetës, se rrezja më e madhe që shfaqet nga Emri Hyjnor ***"Hakk" "i Vërteti"*** që është burimi, dielli dhe mbrojtësi i të gjitha të vërtetave, është e vërteta më e madhe, domethënë ringjallja. Në këtë ata besojnë dhe atëherë e japin mësim si esencën e të vërtetës.

O All-llah! Për hir të mësimit dhe porosive që ata japin, na dhuro neve dhe Studentëve të Risale-i Nur'it besim të plotë dhe na dhuro përfundim të mirë me iman të jetës sonë, dhe na bëj ne nga ata që përfitojnë prej shefa'atit (ndërmjetësimit) të tyre... **Amin**...

Të gjitha provat dhe dëshmitë që provojnë vërtetësinë e Kur'anit, dhe madje të gjitha librat qiellorë dhe mrekullitë e provat që vërtetojnë profetësinë e të dashurit të Zotit xh.sh. dhe madje atë të gjithë profetëve, tregojnë realitetin e botës tjetër, që është pjesa më e lartë e asaj që pretendojnë librat dhe mesazhierët. Gjithashtu, shumica e provave dhe e dëshmive për ekzistencën dhe Njësinë e Krijuesit, Qënies së Vetme të domosdoshme, dëshmojnë në mënyrë të tërthortë ekzistencën dhe hapjen e banesës së lumturisë dhe të Botës së përjetësisë që është boshti kryesor dhe treguesi i Hyjnisë. Sepse siç do të shpjegohet e demonstrohet më poshtë, ekzistenca e Qënies së Vetme të domosdoshme, të gjitha Atributet e Tij, shumica e Emrave të Tij, dhe Veçoritë e Tij të shenjta dhe Aspekte të tilla, si: "Hyjnia, Përkujdesja, Mëshira, Urtësia e Drejtësia"..., kërkojnë ekzistencën e botës tjetër si një çështje e domosdoshme; ato bëjnë të domosdoshme një

botë të përjetshme në mënyrë të prerë, dhe ato e kërkojnë ringjalljen për qëllimin më të domosdoshëm të dënimit dhe shpërblimit.

Po, meqenëse ka një All-llah, Ekzistues i para dhe i paspërjetësisë, duhet që medoemos të jetë gjithashtu një botë tjetër, ***që është boshti i përjetshëm i Sovranitetit të Tij Hyjnor.*** Dhe meqenëse, Një Hyjni absolute shfaqet në Kozmos dhe veçanërisht tek gjallesat, Një Hyjni madhështore, e Urtë dhe absolute, atëherë gjithashtu duhet të jetë një botë e përjetshme lumturie për të hyrë tek ajo, me qëllim që të ruajë urtësinë e Tij nga kotësia, dhe përkudesjen e Tij nga tradhtia.

Dhe meqenëse, të gjitha këto mirëbërje të pafund, këto bekime, mirësi, bujari, përkujdesje e mëshira që ne i shikojmë me sytë tanë, i tregojnë çdo mendjeje që nuk është e shuar dhe çdo zemre që nuk ka vdekur, domosdoshmërinë e ekzistencës së Një Krijuesi të Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë nga prapa perdes, atëherë duhet patjetër të jetë, ashtu siç është e vërtetë, një jetë e amshuar e cila do të mbrojë mirësitë e Tij kundra talljes, bekimet e Tij kundra mashtrimit, mirëbërjen e Tij kundra armiqësisë, mëshirën e Tij kundra torturës dhe bujarinë e përkujdesjen e Tij kundra tradhtisë. Po, Ai i Cili e bën mirësinë mirësi të vërtetë dhe bekimet bekime të vërteta, pikërisht Ai është burimi i ekzistencës së një jete të përhershme në Botën e Qëndrueshmërisë e të Përjetsisë... Po, medoemos duhet të realizohet kjo.

Dhe meqenëse, *n*ë fillimin e çdo pranvere, Pena e Fuqisë shkruan pa u lodhur në faqen e ngushtë të tokës njëqindmijë libra të ndërthurur, që të gjithë pa gabimin më të vogël, siç duket qartë përpara syve tanë, atëherë Pronari i asaj Pene ka premtuar dhe është betuar njëqindmijë herë se "Unë do të shkruaj dhe do t'ju bëj juve të lexoni një libër të bukur e të përjetshëm, në një vend shumë më të shtrirë se sa ky vend i ngushtë, i përzier e i ngatërruar dhe në një mënyrë shumë më të lehtë se sa ky libër i vogël e i shkurtër i pranverës". Ai Krijues, e përmend atë libër me të gjitha urdhëresat e dekretet e Tij. Domethënë, projekti origjinial i librit padyshim është shkruar; ai do të regjistrohet në shkrim me të gjitha shënimet e tij në Ditën e Ringjalljes. Regjistri i veprave të të gjithëve atëherë do të jetë i shkruar.

Dhe meqenëse toka ka një rëndësi aq të madhe, sa që është bërë zemra e kozmosit; ajo është qendra e tij, pjesa e tij e zgjedhur, rezultati përfundimtar i tij, dhe pikërisht arsyeja për krijimin e tij. Kjo është për shkak të shumësisë së krijesave që gjenden në të, dhe për shkak se ajo është banesa, origjina, punishtja dhe vendi i shfaqjes dhe i ringjalljes së qindra e mijëra llojeve të ndryshme të gjallesave duke ndryshuar vazhdimisht. Pavarësisht vogëlsisë së përmasës së saj, ajo është bërë barazvlerësja e qiejve të gjërë. Kështu ne gjithmonë lexojmë në të gjithë dekretet qiellorë: رَبُّ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضِ *"Mbështetësi (All-llahu) i qiejve dhe i Tokës."*

Biri i Ademit, njeriu, gjithashtu ka një rëndësi të veçantë.

Dhe meqenëse Ai sundon në çdo pjesë të tokës që ne sapo e përshkruam; Ai ushtron kontroll mbi shumicën e krijesave të saj duke nënshtruar rreth vetvetes shumicën e gjallesave, dhe duke i bërë shumicën e objekteve të krijuara të notojnë rreth tij sipas skicës së dëshirave të tij, dhe sipas nevojave të tij të bashkëlindura, dhe i organizon, i ekspozon dhe i stolis. Ai koordinon lloje të çuditshme prej tyre në çdo vend, saqë nuk tërheq vetëm shikimet e njeriut e të xhindit, por tërheq gjithashtu edhe shikimet e banorëve të qiejve dhe ato të të gjithë universit, madje edhe shikimin admirues të Pronarit të universit. Kështu, nga ky këndvështrim, lloji njerëzor fiton një vlerë e rëndësi shumë të madhe, dhe ai për më tepër, demonstron nëpërmjet arteve dhe shkencave të tij, se ai është qëllimi i urtë për krijimin e universit, se është rezultati më i lartë i frutit të madh të krijimit, dhe se ai vepron në tokë si Kalif –zëvendës i All-llahut xh.sh.. Meqenëse në tokë ai shfaq e organizon veprat e mrekullueshme të Krijuesit, është shtyrë dënimi i kundërshtimit të tij dhe i mohimit të tij, dhe i është lejuar jetesa në dynja. Për shkak të veprimeve që kryen, llojit njerëzor i është dhënë shtyrje afati dhe ndihmohet nga All-llahu xh.sh..

Dhe meqenëse, biri i Ademit –njeriu–, duke poseduar natyrën që ne kemi përshkruar, është tej mase i dobët e i pafuqishëm për sa i përket natyrës së tij thelbësore dhe gjendjes së tij. Megjithatë, pavarësisht kësaj dobësie e varfërie dhe nevojave e dhimbjeve të pakufishme para të cilave ai zbulohet, ekziston një Sundues i Gjithëfuqishëm, i Gjithurtë e i Gjithë-

mëshirshëm, i Cili në një mënyrë krejtësisht përtej fuqisë dhe vullnetit të njeriut, e bën këtë glob të madh tokësor një magazinë që përmban çdo lloj minerali e ushqimi që atij i nevojitet, dhe e bën një dyqan të mbushur me të gjithë artikujt që ai dëshiron. Kështu Sundimtari i Vetëm kujdeset për njeriun dhe e ushqen duke i dhururar atij çfarë dëshiron.

Dhe meqenëse, All-llahu xh.sh. i zotëron këto veçori, Ai e do njeriun dhe e bën Vetveten të dashur tek njeriu. Ai është i përjetshëm, dhe ka botëra të përjetshme. Ai i realizon të gjitha gjërat me drejtësi, Ai bën gjithçka me urtësi. Por sovraniteti madhështor dhe Mbretëria e përjetshme e Sundimtarit të parapërjetësisë nuk mund të përfshihet plotësisht brenda jetës së shkurtër të njerëzimit, kësaj toke të përkohshme e kalimtare. Për më tepër, aktet shumë të mëdha të padrejtësisë dhe të mosbindjes që ndodhin midis njerëzve në kundërshtim e në kontradiktë me drejtësinë, dhe në kudërshtim me ekuilibrin dhe bukurinë e kozmosit, tradhtia e tyre, mohimi dhe mosbesimi ndaj Mirëbërësit dhe Furnizuesit të tyre, dhe të gjitha këto mbeten të pandëshkuara në këtë botë, gjithashtu ata i kalojnë në rehati jetët e tyre mizore e tradhtare, ndërsa njerëzit e mjerë e të shtypur i kalojnë jetët e tyre në mjerim. Por, pikërisht esenca e Drejtësisë Absolute, që shenjat e të cilës shihen gjithandej universit, është krejtësisht e kundërt dhe e papajtueshme me idenë e mosringjalljes së mizorëve dhe të tradhtarëve, së bashku me të shtypurit e pashpresë, të cilët janë të barabartë në këtë botë përpara vdekjes!

Dhe meqenëse, Pronari i kozmosit ka zgjedhur e i ka dhënë një rang të lartë dhe rëndësi tokës midis krijesave të universit, dhe zgjodhi njeriun dhe i dhuroi atij një pozitë të lartë midis të gjithë krijesave të tokës. Gjithashtu, Ai ka zgjedhur midis njerëzimit, si miqtë e Tij dhe si objektet e adresimit të Tij profetët, evlijatë dhe dijetarët e pastër, sepse ata janë njerëz të vërtetë të cilët përshtaten plotësisht me qëllimet Hyjnore të krijimit, të cilët e bëjnë vetveten të dashur tek Krijuesi i tyre nëpërmjet besimit e nënshtrimit. Ai i nderon e i fisnikëron ata me mrekulli e me ndihmë Hyjnore, dhe i dënon armiqtë e tyre me goditje qiellore. Ai, zgjodhi midis miqve të Tij të dashur e të shquar imamin, udhëheqësin e tyre dhe simbolin e krenarisë dhe lavdisë së tyre, Muhammedin a.s.m.. Ai ndriçoi me dritën e tij gjysmën e globit

tokësor dhe një të pestën e njerëzimit të lartësuar për shumë shekuj. Është sikur kozmosi të ishte krijuar për hir të tij; të gjitha qëllimet e universit u bënë të qarta nëpërmjet tij, u bënë të dukshëm përmes fesë me të cilën ai u dërgua, dhe u shfaqën qartë me Kur'anin që iu shpall Atij.

Megjithëse ai meritoi dhe ishte i përshtatshëm të merrte shpërblimin për një periudhë të pafund kohe për shërbimet e tij të çmueshme të pafund, që ai kreu shërbime që zakonisht do të merrnin miliona vite për t'u kryer, pavarësisht të gjitha këtyre, atij iu dha një jetë shumë e shkurtër, jo më shumë se gjashtëdhejtë e tre vjeç, dhe ajo gjithashtu kaloi në luftë e mundim. A do të ishte e mundur, e përfytyru-eshme dhe e konceptueshme që të mos ringjallet ai personalitet, së bashku me të gjithë të tjerët si ai dhe më të dashurit e tij? Apo të mos jetë edhe tani i gjallë me shpirtin e tij? Apo të zhduket në një zbrazëtirë të përjetshme? Jo, njëqindmijë herë jo!.. Po, i gjithë universi dhe të gjitha realitetet kozmike kërkojnë ringj-alljen e tij, kërkojnë jetën e tij nga Pronari i kozmosit...

Dhe meqenëse, Trajtesa ***"El-Ajetul Kubra"*** *(Shenja më e Madhe)*, e cila është *Rrezja e Shtatë*, ka vërtetuar me tridhjetë e tre mendime të pajtuara me unanimitet, secili aq i fuqishëm sa një mal, se universi është vepra e një Dore të Vetme, dhe se bota është pronë e vetëm Një të Vetmi. Kanë treguar në mënyrë të vetëkuptueshme se Njësia është boshti i plotësimit Hyjnor. Ato kanë shpjeguar se, me unitet e Njësi, i gjithë universi transformohet dhe fiton aspektin e shërbëtorit të bindur dhe të nëpunësit të nënshtruar të Atij Krijuesi të Vetëm. Gjithashtu, me ardhjen e botës së përtejme dhe me ekzistencën e saj, realizohen plotësimet e All-llahut xh.sh., mbrohen nga rrëzimi dhe mbrohet Drejtësia e Tij Absolute nga tallja e nga tradhtia e plotë, nga kotësia e idiotizmi; merr Mëshira e Tij Gjithëpërfshirëse sferën e saj dhe shpëton nga dhënia e torturimit diskretitues; duket krenaria dhe fuqia e Tij absolute dhe shpëtojnë nga pafuqia e mjerë, si dhe shenjtërohet secili nga Atributet Madhështorë të All-llahut.

Kijameti do të ndodhë me një siguri absolute. Ringjallja do të ndodhë, dyert e banesës së shpërblimit dhe dënimit do të hapen për arsye të ***"Tetë meqenëseve"*** të shtjelluara më lartë, nga qindra pika që lidhen me besimin tek All-llahu xh.sh.. Vetëm atëherë do të përmbushet dome-thënia e vërtetë

e tokës dhe e pozicionimit të saj qëndror, si dhe kuptimi i vërtetë dhe vlera e njeriut. Atëherë drejtësia, urtësia, mëshira dhe Mbret-ërimi i Sundimtarit të Gjithurtë i Cili është Krijuesi dhe Mbështetësi i tokës dhe i njeriut, do të vendosen e shfaqen rishtas. Atëherë miqtë e vërtetë dhe dashuruesit e përmalluar të All-llahut të Përjetshëm do të shpëtojnë nga asgjësimi i përhershëm, dhe më i madhi e më i vlefshmi i atyre miqve do të marrë shpërblimin për shërbimet e shenjta me të cilat ai kënaqi gjithë kozmosin. Atëherë plotësimet e Mbretit të përjetësisë do të shenjtërohen, do të pretendojnë lartësinë e tyre dhe qënien e tyre larg çdo mangësie e defekti; do të lartësohet e largohet Fuqia e Tij nga pafuqia, Urtësia e Tij nga marrëzia, dhe Drejtësia e Tij nga të gjitha llojet e padre-jtësisë.

Shkurtazi: ***Meqenëse All-llahu ekziston, sigurisht edhe Bota e përtejme ekziston.***

Atëherë, tre shtyllat e besimit, që u shtjelluan më lartë, e vërtetojnë dhe dëshmojnë ringjalljen me të gjitha dëshmitë e provat. Gjithashtu, dy shtyllat e mbetura të besimit të përfshira në këto Fjalë:

وَبِمَلَٰٓئِكَتِهِۦ وَبِٱلْقَدَرِ خَيْرِهِۦ وَشَرِّهِۦ مِنَ ٱللَّهِ تَعَالَىٰ

"Dhe (besoj) dhe në engjëjt e Tij, dhe në Paracaktimin Hyjnor (Kaderin), e mira e tij dhe e keqja janë nga All-llahu i Plotëfuqishëm", bëjnë të domosdoshëm ringjalljen dhe dëshmojnë e tregojnë botën e përjetësisë në mënyrën më të fuqishme.

Të gjitha provat, shikimet e dëshmitë e pafund dhe bisedat që provojnë ekzistencën e engjëjve dhe funksionin e tyre të robërisë ndaj All-llahut xh.sh., gjithashtu vërtetojnë në mënyrë të tërthortë ekzistencën e botës së shpirtërave, të botës së padukshme, të botës së përtejme, banesës së lumturisë dhe ekzistencën e Xhennetit dhe të Xhehennemit që do të mbushen me xhinde e njerëz. Sepse engjëjt kanë mundësi me lejen e All-llahut që t'i shikojnë ato botëra e të hyjnë në to, dhe të gjithë engjëjt e afërm me Fronin e All-llahut xh.sh., të tillë si Hazreti Xhebraili, i cili komunikon me njerëz, njoftojnë ekzistencën e atyre botëve që u përmendën

dhe përshkruajnë me unanimitet udhëtimin e tyre nëpër to. Ashtu siç pranojmë pa diskutim ekzistencën e kontinentit të Amerikës, të cilin ne vetë kurrë nuk e kemi parë, nga njoftimet e udhëtarëve që vijnë nga ai kontinent, po ashtu, ne duhet të besojmë me gjithë sigurinë, siç besojmë me të vërtetë, në ekzistencën e botës së përjetësisë së Ahiretit, ekzistencën e Xhennetit e të Xhehennemit, duke u mbështetur mbi njoftimet e dhëna nga engjëjt, njoftime që kanë autoritetin e njëqind rrëfenjave të pakundërshtueshme.

Dhe, përsëri, të gjitha provat e përfshira në ***Trajtesën e Paracaktimit Hyjnor ose Kaderit***, e cila është *Fjala e Njëzet e Gjashtë*, duke vërtetuar shtyllën e Besimit në Paracaktimin Hyjnor, në mënyrë të tërthortë vërteton ringjalljen, shpërndarjen e regjistrave të punëve dhe peshimin e veprave të njeriut që do të ndodhin tek peshorja e madhe. Sepse ngjarjet në ekzistencën e të gjitha gjërave regjistrohen para syve tanë nëpër Pllakat e rregullit e të balancës; biografia e çdo qënie të gjallë është gdhendur në aftësinë e kujtesës së saj, në farishten e saj, dhe në Tablo të tjera të ngjashme; veprat e çdo qënie të pajisur me shpirt, dhe veçanërisht ato të njeriut, janë regjistruar në Pllakat e Ruajtura. Kështu, gjithë ky parapërcaktim nga Kaderi gjithëpërfshirës, ky caktim kaq i urtë, ky regjistrim kaq i përpiktë dhe kjo skalitje kaq e saktë, mund të jetë vetëm për hir të një shpërblimi të përhershëm dhe të një dënimi që do të jepen në Gjyqin e Madh si rezultat i një Gjykate të Lartë. Përndryshe, ai regjistër gjithëpërfshirës e i përpiktë dhe ai regjistrim, do të ishin krejtësisht kot e pa kuptim. Kjo do të ishte në kundërshtim me Urtësinë dhe Realitetin.

Për më tepër, në qoftë se nuk do të ndodhte ringjallja, të gjitha kuptimet e vërtetuara që janë skalitur në librin e universit nga Pena e Paracaktimit Hyjnor do të shkatërroheshin. Kjo do të ishte një gjë krejtësisht e pamundur, do të ishte aq absurde dhe madje një përçartje e tillë, si të mohoje ekzistencën e universit...

Përmbledhje: Pesë shtyllat e besimit, së bashku me të gjitha provat e tyre, tregojnë e kërkojnë ndodhjen dhe ekzistencën e ringjalljes, ekzistencën e botës së Ahiretit, dhe hapjen e dyerve të saj. Ato e dëshmojnë atë dhe e bëjnë të domosdoshme.

Për shkak se ndodhen mbështetje e prova të tilla madhështore e të patundura për të vërtetën e ringjalljes, krejtësisht të denja për madhështinë e saj, Kur'ani i shpjegimit të mrekullueshëm i kushton rreth një të tretën e përmbajtjeve të tij Ringjalljes dhe Ahiretit, dhe e bën atë gurin themeltar për të gjitha të vërtetat e tij dhe ndërton gjithçka mbi bazat e saj...

(Parathënia përfundoi.)

* * *

PJESA E DYTË E SHTOJCËS

[Është "e Para" nga "Nëntë Stacionet" që përmban nëntë nivelet e provave të Ringjalljes të cilat janë treguar në mënyrë të mrekullueshme në versetin e mëposhtëm]

فَسُبْحَانَ اللَّهِ حِينَ تُمْسُونَ وَحِينَ تُصْبِحُونَ ۝ وَلَهُ الْحَمْدُ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ
وَعَشِيًّا وَحِينَ تُظْهِرُونَ ۝ يُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ
وَيُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَكَذَٰلِكَ تُخْرَجُونَ ۝

"Lavdërojeni lart pra All-llahun kur jeni në mbrëmje dhe kur të ngriheni në mëngjes. Dhe të Atij janë të gjitha lavdërimet dhe falënderimet në qiej dhe në tokë; dhe në mbasditen e vonë dhe kur të hyni në kohën kur merr dielli (falja e drekës). Ai nxjerr të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla. Dhe Ai e ringjall tokën pas vdekjes së saj. Dhe kësisoj ju do të nxirreni (prej tokës në Ditën e ringjalljes)."[275]

Prova e qartë dhe dëshmia e shndëritshme e dekretit të All-llahut, që lidhet me ringjalljen e cila përfshihet në këtë vërset, tani do të shpjegohet e shtjellohet në dashtë All-llahu Xh.sh.. [276]

* * *

[275] Kur'an, 30: 17-19

[276] Shënim: I gjithë ky stacion nuk është shkruar akoma.

SIMBOLI I KATËRT I PIKËS SË PESTË I SHKREPTIMËS SË TRIDHJETË

[277] Në veçorinë e njëzet e tetë të jetës, është shpjeguar se: Jeta orientohet tek gjashtë shtyllat e besimit dhe i provon ato; ajo përmban një sërë treguesish për të vërtetat e tyre.

Po, tani rezultati më i rëndësishëm, thelbi dhe arsyeja për krijimin e universit nuk është gjë tjetër veçse jeta; dhe jeta, ajo vërtetësi e lartë, kurrësesi nuk mund të përkufizohet tek kjo jetë kalimtare, e shkurtër, e mangët dhe e mundimshme e kësaj bote. Përkundrazi, qëllimi dhe rezultati i pemës së jetës madhështore, shkëlqimi i së cilës mund të kapet e të nxirret si përfundim i deduktueshëm nga njëzet e nëntë veçoritë e saja; fruti i asaj peme të denjë për madhështinë e saj është jeta e përhershme e botës tjetër; është jeta në botën e amshuar ku madje edhe gurët, pemët dhe dheu do të pajisen me jetë. Përndryshe, do të duhej që pema e jetës, e cila është pajisur me aftësi, me substanca dhe gjymtyrë të holla e të ndryshme tek gjallesat dhe veçanërisht tek njeriu, të mbetej pa frut, pa dobi e pa realitet; njeriu do të mbetej i mjerë, fatkeq e i poshtëruar dhe njëzet shkallë më i ulët se sa trumcaku për sa i përket lumturisë së jetës, megjithëse ai është krijesa më e lartësuar dhe më e nderuar midis gjallesave dhe njëzet shkallë më i lartë se trumcaku.

Gjithashtu, mendja e cila është dhurata më e çmueshme për njeriun do ta plagoste zemrën e tij duke menduar për dhimbjet e së shkuarës dhe për ankthet e frikësimet e së ardhmes; ajo do ta përziente e turbullonte një kënaqësi të vetme me nëntë dhimbje, dhe kështu do të bëhej një fatkeqësi për njeriun. Kjo është njëqind përqind e padrejtë. Kështu jeta e kësaj bote provon në mënyrë vendimtare shtyllën e besimit që është besimi në botën e

[277] Shënim: Por, meqenëse çështja e jetës ka lidhje me ringjalljen, ajo është përfshirë këtu. Përveç kësaj, ajo përmban një aluzion të hollë e të thellë për shtyllën e besimit në Kaderin Hyjnor tek përfundimi i çështjes së jetës.

përtejme përmes së cilës shfaq për sytë tanë në çdo pranverë më shumë se treqind mijë shembuj nga shembujt e ringjalljes.

A do të ishte e mundur për një Krijues të Gjithëfuqishëm, i Cili furnizon e mbështet në kohën e duhur me urtësi, me përkujdesje të madhe e mëshirë, të gjitha instrumentet dhe mjetet e nevojshme për jetën tënde, në trupin tënd, në kopshtin tënd dhe në atdheun tënd; i Cili dëgjon dhe i përgjigjet lutjes private e të veçantë që bëhet për ushqim nga stomaku yt, për hir të jetës e të mbijetesës së tij, i Cili e shfaq pranimin e Tij të asaj lutjeje nëpërmjet shumë ushqimeve të shijshme, a do të ishte e mundur për një Administrues të Tillë të Gjithëfuqishëm që mos të të njohë ty apo mos të të dëgjojë, dhe që Ai të mos përgatisë mjetet e domosdoshme për qëllimin më të madh të llojit njerëzor, ai qëllim i cili është jeta e përhershme? A do të ishte e mundur që Ai të mos pranojë lutjen më të madhe, më të rëndësishme e më të përgjithshme e cila është lutja për qëndrueshmërinë dhe përjetshmërinë e llojit njerëzor duke ndërtuar jetën e amshuar dhe duke krijuar Xhennetin? A do të ishte e mundur që Ai të mos dëgjonte lutjen e fuqishme të këtij njeriu, i cili është krijesa më e lartë në univers, madje ai është monarku i tokës dhe rezultati i saj, atë lutje që bën jehonë gjithandej qiejve dhe tokës, që të mos i kushtojë asaj të njëjtën vëmendje, ose të mos i japë të njëjtën kënaqësi, si stomakut të vogël, a do të ishte e mundur që Ai t'i shkaktonte Urtësisë së Tij të plotë dhe Mëshirës së Tij absolute të mohoheshin? Jo, kurrë, njëqindmijë herë jo!..

Dhe përsëri a do të ishte e pranueshme për Atë që dëgjon zërin më të fshehur të më të voglës së krijesave, që shëron dhimbjen e saj dhe që i vë veshin e ndihmon ankesën e saj, që e ushqen dhe e zhvillon atë me kujdesin më të madh dhe me vlerësimin duke ia nënshtruar asaj krijesën më të madhe në Kozmos, a do të ishte e mundur për Atë që e bën të gjithë këtë të mos dëgjojë zërin gjëmimtar për jetën më të madhe, më të çmueshmen, më të hollën e më të vazhdueshmen? A do të ishte e arsyeshme që Ai të mos i kushtojë vëmendje lutjes së saj më të rëndësishme dhe duave për përjetësi!

Kjo do të ishte si pajisja e një ushtari të vetëm me përkujdesjen më të madhe dhe të injoronte plotësisht një ushtri të madhe të bindur, ose si të shikuarit i një pike dhe të mbyllte sytë para diellit! Ose si të dëgjuarit e

zëzëllimës së një mize dhe mosdëgjimin e gjëmimit të rrufesë! Jo, njëqindmijë herë, jo!..

Dhe përsëri, a do ta pranonte arsyeja për Një të Gjithëfuqishëm të Gjithurtë, mëshira e të Cilit, dashuria dhe përkujdesja janë të pafundme, i Cili e do shumë veprën e Tij artistike, dhe e bën Vetveten të jetë i dashur tek krijesat me veprat e Tij artistike, i Cili i do shumë ata që e duan Atë; a do të ishte e arsyeshme që Ai të asgjësonte jetën e atij që Ai e do, atë që është i dashur për Të, që është i merituesheëm për dashuri, dhe që nga natyra e adhuron Krijuesin e Tij dhe të asgjësonte gjithashtu nëpërmjet vdekjes së përjetshme esencën e jetës dhe thelbin e saj, që është shpirti? Apo të ofendonte e të fyente të dashurin e Vet për të gjithë përjetësinë, apo të plagoste ndjenjat e Tij dhe të bënte që misteri i mëshirës së Tij dhe drita e dashurisë së Tij të mohoheshin? Jo, njëqindmijë herë jo!

Një Bukuri Absolute që ka stolisur krijimin me shfaqjet e saj dhe një Mëshire Absolute që i ka bërë krijesat të gëzohen, janë padyshim të përjashtuara e të pastruara nga shëmti të tilla të pafund, nga një neveri e plotë e nga një padrejtësi e tillë dhe nga një mungesë mëshire.

Përfundim: Përderisa ka jetë në dynja, medoemos ata njerëz të cilët e kuptojnë qëllimin e jetës dhe nuk i keqpërdorin jetët e tyre, do të jenë të merituesheëm për jetën e përhershme në botën e përjetshmërisë dhe në Xhennetin e përjetshëm. Ne në këtë besojmë...

Gjithashtu, shkëlqimi i objekteve të shndëritshme që gjenden në tokë nëpërmjet reflektimit të dritës së diellit, vezullimi i shkurtër i fluskave të vogëla në sipërfaqen e oqeanit përmes shkreptimave të dritës, pastaj shuarja e atij shkëlqimi me zhdukjen e tyre dhe ardhja e fluskave të tjera në vend të tyre, që ashtu si të parat shkëlqejnë, sikur të ishin pasqyra për diej të imagjinuar, që na shfaqin neve në mënyrë të vetëkuptueshme se ato shkëlqime e vezullime nuk janë tjetër veçse një shfaqje reflektuese e një dielli të lartë. Me gjuhët e tyre të ndryshme ato përmendin ekzistencën e diellit dhe e tregojnë atë me gishtat e tyre të shndritshëm.

Po kështu ngjet me shkëlqimin e gjallesave në sipërfaqen e tokës dhe në det, me Fuqinë Hyjnore dhe me shfaqjen e Emrit më të madh ***"El-Muhji"***, "*Jetëdhënësi"*, *i të Gjallit Vetekzistues xh.sh.*, dhe atëherë ato fshihen prapa perdes së të padukshmes duke thënë: **"Ja Hajj!"**, *O i Gjallë i Përjetshëm*!, me qëllim që të bëjnë vend për ato që i ndjekin prapa. Kjo përfaqëson një sërë dëshmish për treguesit e jetës dhe për domosdoshmërinë e ekzistencës së të Gjallit të Përjetshëm Vetekzistues xh.sh.. Gjithashtu, të gjitha provat që dëshmojnë Njohurinë Hyjnore, shenjat e të cilës janë të dukshme në organizimin e të gjitha qënieve; të gjitha dëshmitë që vërtetojnë ekzistencën e një Fuqie që vepron gjithandej universit; të gjitha argumentet që tregojnë vullnetin dhe qëllimin duke sunduar rregullin dhe administrimin e kozmosit; të gjitha shenjat, mrekullitë, e kështu me radhë, që vërtetojnë profetësinë e profetëve, mjetet e Fjalës Hyjnore dhe të Shpalljes Hyjnore, dhe treguesit që dëshmojnë e tregojnë shtatë Atributet e mëdha Hyjnore, të gjithë ato tregojnë dhe dëshmojnë me unanimitet jetën e të Gjallit të përjetshëm, Vetekzistuesit të vetëm të Përhershëm; sepse në qoftë se aftësia e të shikuarit është e pranishme në një gjë, padyshim duhet që ajo të ketë jetë gjithashtu; në qoftë se ajo ka dëgjim, kjo gjithashtu është shenjë jete; në qoftë se në të gjendet aftësia e të folurit, kjo gjithashtu tregon ekzistencën e jetës, dhe nëse do të ndodheshin vullneti e zgjedhja, natyrisht ato janë dukuritë e jetës...

E ngjashme me këtë, Atributet, ekzistenca e të cilave provohet dhe është e vetëkuptueshme në sajë të shenjave të tyre gjithandej kozmosit, të tilla si Fuqia Absolute, Vullneti i gjithanshëm, dhe Njohuria gjithëpërfshirëse, dëshmojnë me të gjitha provat e tyre jetën e të "Gjallit të Përjetshëm Vetekzistues" dhe domosdoshmërinë e ekzistencës së Tij; dëshmojnë për jetën e Tij të amshuar, që vetëm një hije e të cilës ka ndriçuar të gjithë universin dhe një shfaqje e të cilës është e mjaftueshme për të dhënë jetën e botës së përtejme me të gjitha grimcat e saj.

Dhe Atributi Hyjnor i jetës lidhet gjithashtu me shtyllën e ***"Besimit në engjëjt"*** dhe e provon atë nëpërmjet treguesit, sepse përderisa jeta është rezultati më i rëndësishëm i Kozmosit, dhe gjallesat përbëjnë formën më gjerë të përhapur të krijimit, me modelet e saj që shumohen për shkak të

vlerës së tyre; ato në mënyrë të vazhdueshme gjallërojnë bujtinën e kësaj bote me ardhjen dhe me largimin e karvaneve të tyre.

Dhe për më tepër, globi i cili mbushet me kaq shumë specie të qënieve të gjalla, vazhdimisht boshatiset e rimbushet me urtësinë e ripërtëritjes e të shumimit, dhe qëniet e gjalla krijohen në shumësi, madje edhe tek substancat më të ulëta e të prishura, saqë duket si të ishte një ringjallje e vazhdueshme e mikrobeve. Së fundi, meqenëse vetëdija dhe mendja, të cilat janë esenca e distiluar e jetës, dhe shpirti i cili është substanca e saj e hollë dhe e qëndrueshme, meqenëse krijohen gjithashtu gjithandej globit në shumësinë më të madhe, sikur globi tokësor të gjallërohej, të zbukurohej e të bëhej i gëzuar nga jeta, mendja, vetëdija dhe shpirti... në qoftë se do t'i merrnim në konsideratë të gjitha ato që u përmendën më parë, dalim me përfundimin se do të ishte krejtësisht e pamundur që trupat qiellorë, të cilët janë më të hollë, më të shndritshëm, më të mëdhenj e më të rëndësishëm se sa toka, të ishin të vdekura, të palëvizshme, të pajetë e pa vetëdije.

Atëherë, duhet të ekzistojnë e të jenë pajisur me veçorinë e jetës gjallesat e vetëdijshme që mbushin e gjallërojnë qiejt, diejt dhe yjet, që u japin atyre gjallërinë, që shfaqin rezultatin e qëllimit për krijimin e qiejve, dhe marrin adresim nga Krijuesi i Gjithëlavdishëm. Këto krijesa, me një natyrë të përshtatshme për qiejt, me një esencë jete, janë vetëm se engjëjt...

Dhe gjithashtu, sekreti i jetës dhe esenca e saj orientohet tek ***"Shtylla e besimit në profetët"*** dhe e provon atë në mënyrë simbolike. Po, meqenëse universi u krijua për hir të jetës, dhe meqenëse jeta është shfaqja më e madhe, skalitja më e plotë dhe arti më i bukur i të Gjallit të Përjetshëm Vetekzistues i parapërjetshëm, dhe meqenëse jeta e përhershme e Krijuesit e tregon Vetveten vetëm nëpërmjet dërgimit të profetëve dhe shpalljes së librave qiellorë; sepse po të mos ishin librat qiellorë dhe profetët, atëherë jeta e përhershme do të mbetej e panjohur.

Kur një njeri flet, kuptohet se ai është i gjallë... E ngjashme me këtë, janë profetët dhe librat e shpallur qiellorë që bëjnë të qartë e tregojnë për Atë Folës të Gjallë, i Cili urdhëron e ndalon me fjalët e Tij e me adresimet nga

prapa botës së të padukshmes, pas perdes së kozmosit. Ashtu si jeta ekzistuese në kozmos që dëshmon në mënyrë vendimtare domosdoshmërinë e ekzistencës së të Gjallit të Përjetshëm të parapërjetësisë, po ashtu ajo në mënyrë të tërthortë tregon e vërteton ***"shtyllat e besimit në dërgimin e Profetëve dhe në shpalljen e librave qiellorë"***, sepse këto janë rrezet, manifestimet dhe lidhjet e asaj jete të përhershme. Dhe veçanërisht Profetësia e Muhammedit a.s.m. dhe shpallja Kuranore, meqenëse janë si pikërisht vetë shpirti dhe mendja e jetës, atëherë vërtetësia e tyre është aq e padiskutueshme sa ekzistenca e kësaj jete.

Po, ashtu siç është jeta esenca e distiluar e kozmosit, vetëdija dhe ndjeshmëria janë esenca e distiluar e jetës; mendja është esenca e distiluar e vetëdijes dhe e ndjeshmërisë; dhe shpirti, përfundimisht, është substanca e pastër dhe e panjollosur, esenca e qëndrueshme dhe e mëvetësishme, që qëndron pikërisht mu në zemrën e jetës...

Gjithashtu, jeta e profetit Muhammed a.s.m. në aspektet e saja materiale e shpirtërore është thelbi i distiluar prej jetës dhe shpirtit të kozmosit, dhe profetësia e Muhammedit a.s.m. në aspektet e saja të jashtme e të brendshme është esenca e pastër dhe e distiluar e ndjeshmërisë, vetëdijes dhe e mendjes së kozmosit. Madje jeta e Profetit Muhammed a.s.m. në aspektet e saja të jashtme e të brendshme, siç e kanë dëshmuar veprat e Tij, është pikërisht drita dhe esenca e vetëdijes së kozmosit. Shpallja Kur'anore është, gjithashtu, shpirti i jetës së kozmosit dhe mendja e vetëdijes së tij, nëpërmjet dëshmisë së të vërtetave jetike.

Po, po, po!.. Në qoftë se drita e Profetësisë së Muhammedit a.s.m. do të largohej nga kozmosi e të shuhej, kozmosi do të vdiste. Në qoftë se do të largohej Kur'ani, kozmosi do të humbiste normalitetin, dhe globi tokësor do të humbiste vetëdijen e tij dhe koka e tij e trullosur dhe e pamend do të përplasej me ndonjë planet dhe do të ndodhte fundi i botës...

Dhe jeta gjithashtu shikon tek shtylla e **"Besimit në Kaderin"** dhe e provon atë në mënyrë të tërthortë, sepse, meqenëse jeta është drita e

Botës së dukshme, dhe ajo e dominon atë, dhe është rezultati dhe qëllimi i ekzistencës, dhe meqenëse ajo është pasqyra më gjithëpërfshirëse e Krijuesit të universit, shembulli më i plotë, dhe indeksi i aktivitetit Hyjnor, -dhe të mos keqkuptohet krahasimi- meqenëse ajo është një lloj programi, atëherë sigurisht misteri i jetës kërkon medoemos që të jetë gjithashtu Bota e padukshme, domethënë, e shkuara dhe e ardhmja që do të thotë, krijesat e së shkuarës dhe ato të së ardhmes janë të prirura t'i përshtaten rregullit, organizimit, që të njihen e të vështrohen dhe të jenë të parapërcaktuara e të parapërgatitura për t'iu nënshtruar urdhërave krijuese, të cilat nga një këndvështrim, janë jetët e tyre.

Bërthama origjinale e një peme dhe rrënja e saj, gjithashtu farërat që përfshihen në frutat e saja dhe rezultati përfundimtar, të gjitha shfaqin një lloj jete, ashtu si vetë pema; madje ato mbajnë brenda vetvetes ligje jete më të holla se ato të pemës.

Dhe gjithashtu, farërat dhe rrënjët e lëna nga vjeshta e kaluar, para pranverës së tanishme, si dhe farërat që do të lihen nga pranverat vijuese pas kësaj pranvere, ato të gjitha mbajnë ligjet jetike, ashtu si kjo pranverë.

Dhe në të njëjtën mënyrë, të gjitha degët dhe shkarpat e pemës kozmike, secila ka një të shkuar e një të ardhme. Ato kanë një zinxhirë që përbëhet nga fazat e të shkuarës dhe të së ardhmes dhe nga rrethana. Ekzistencat e shumëfishta dhe fazat e çdo specie dhe çdo anëtar i secilës specie, duke ekzistuar në Njohurinë Hyjnore, formon një zinxhir të qënies në Njohurinë e All-llahut xh.sh., dhe ekzistenca e saj e jashtme dhe ekzistenca e saj në Njohurinë e All-llahut xh.sh. është një tregues i jetës së përgjithshme që i tërheq të gjitha aspektet e jetës së saj nga këto Tabela të gjalla e plot kuptim të kaderit Hyjnor.

Po, fakti se Bota e shpirtërave -e cila është njëra formë e botës së padukshme- është mbushur nga esenca e jetës, lënda e jetës dhe nga shpirtërat, që janë substancat dhe esenca e jetës, kërkon e bën të domosdoshme të jetë e shkuara dhe e ardhmja të cilat janë një formë tjetër e Botës së padukshme dhe segmenti i saj i dytë duke u shfaqur, tek ato të dyja, jeta.

Dhe, përveç kësaj, rregulli i plotë, rrethanat domethënëse, rezultatet dhe frutat e gjalla në ekzistencën e një gjëje brenda Njohurisë së All-llahut xh.sh., gjithashtu demonstrojnë shfaqjen e një lloji jete jolëndore.

Po, një shfaqje e tillë e jetës, që është drita e lëshuar nga dielli i jetës së përhershme, nuk mund të përkufizohet tek kjo botë e dukshme, tek kjo kohë e tanishme dhe tek kjo ekzistencë e jashtme. Përkundrazi, secila botë e merr treguesin e asaj drite në përputhje me kapacitetin e saj, dhe kozmosi së bashku me të gjithë botët e tij është i gjallë e ndriçohet nga ai tregues drite. Përndryshe, - siç e shikon syri i çudhëzimit - nën këtë dynja të përkohshme e të dukshme, secila botë do të ishte një kufomë e madhe dhe e tmerrshme dhe një botë e rrënuar e errët.

Kështu, një aspekt i gjërë i shtyllës së ***"Besimit në Kaderin Hyjnor"*** kuptohet përmes misterit të jetës dhe vërtetohet nga ajo. Domethënë, ashtu siç shfaqet jeta dhe gjallëria e botës së dukshme dhe e krijesave aktuale me rregullsinë dhe me rezultatet e tyre, po ashtu krijesat e së shkuarës dhe ato të së ardhmes, të cilat konsiderohen që i përkasin Botës së padukshme, kanë një ekzistencë shpirtërore dhe një lloj jete, dhe një prezencë shpirtërore në Njohurinë e All-llahut xh.sh.. Shenja e kësaj jete dhe prania bëhen të dukshme e të njohura përmes ***Pllakës të Kaderit Hyjnor*** dhe përmes ***të gjitha etapave dhe rrethanave të jetëve të tyre*** të jashtme dhe ekzistencës...

* * *

PJESA E TRETË E SHTOJCËS

Një pyetje që lidhet me ringjalljen: Në Kur'anin Kerim, në mënyrë të përsëritur, vijnë dekrete të tilla si;

إِنْ كَانَتْ إِلَّا صَيْحَةً وَاحِدَةً *"Ishte vetëm një klithmë..."* [278], dhe, وَمَا أَمْرُ السَّاعَةِ إِلَّا كَلَمْحِ الْبَصَرِ *"Çështja e Orës (së fundit) është sa një 'hap e mbyll sytë"*[279], që tregojnë se Ringjallja më e Madhe do të ndodhë në mënyrë të befasishme, në një moment të vetëm, pa kalimin e ndonjë kohe. Por mendjet tona të ngushta kërkojnë ca shembuj konkretë me qëllim që ato të na mundësojnë ne ta pranojmë e dëshmojmë këtë ngjarje të mrekullueshme e të pashoqe.

Përgjigjja: ***"Tri çështje"*** lidhen me ringjalljen: Kthimi i shpirtërave tek trupat e tyre, ringjallja e trupave, dhe rimëkëmbja e trupave.

❑ ***ÇËSHTJA E PARË:***

Një shembull për rikthimin e shpirtërave tek trupat e tyre është si vijon: Ushtarët e një ushtrie tepër të disiplinuar, ndërsa janë të shpërndarë në të gjitha anët për të pushuar, grumbullohen me oshëtimën e borisë ushtarake. Tani, **Suri, Boria e Israfilit**, sigurisht nuk është më pak i fuqishëm se sa borizani i ushtrisë. Gjithashtu shpirtërat e njerëzve që janë në botën e paspërjetësisë dhe në botën e grimcave, të cilët e dëgjuan adre-simin dhe thirrjen,

أَلَسْتُ بِرَبِّكُمْ "*A nuk jam Unë Zoti juaj*", duke ardhur nga parapërjetësia, dhe iu përgjigjën: قَالُوا بَلَىٰ *"Ata thanë: Po, me të vërtetë Ti je,"*[280] janë më të bindur, më të disiplinuar e më të nënshtruar me mijëra herë më shumë se sa ushtarët në atë ushtri. Për më tepër, është provuar me provat më të fuqishme në ***"Fjalën e Tridhjetë"***, se jo vetëm shpirtërat, por, gjithashtu, të gjitha grimcat, formojnë anëtarët e bindur të një Ushtrie Hyjnore.

❑ ***ÇËSHTJA E DYTË:***

---

[278] Kur'an, 36: 29

[279] Kur'an, 16: 77

[280] Kur'an, 7: 172

Një shembull për ringjalljen e trupave. Ashtu si në një qytet të madh, në një natë feste, ku me qindra mijëra drita mund të rigjallërohen e të ndizen nga një stacion i vetëm për një çast, pa kalimin e dukshëm të kohës, po ashtu është e mundur ndezja e qindra miliona dritave prej gjithandej globit tokësor nga një qendër e vetme. Meqenëse një krijesë e All-llahut të Gjithëfuqishëm, si elektriciteti, një shërbëtore ndriçimi e një qirimbajtëse në bujtinën e Tij mund t'i shfaqë këto veçori e fuqi në funksionet e saj, në përputhje me çfarë mësimesh, njoftimesh e disipline merr nga Krijuesi i saj, atëherë ringjallja, gjithashtu, do të ndodh si një '*hap e mbyll sytë*' brenda strukturës së ligjeve të mirërregulluara të Urtësisë Hyjnore, të cilat përfaqësojnë mijëra shërbëtorë të ndritshëm, si elektriciteti.

- ***ÇËSHTJA E TRETË:***

Një shembull për rimëkëmbjen e menjëhershme të trupave.

Mënyra në të cilën rimëkëmben të gjitha gjethet e të gjitha pemëve në formën më të plotë dhe me të njëjtën formë me ato të pranverës së shkuar brenda pak ditëve në fillimin e çdo pranvere, ndonëse janë njëmijë herë më të shumtë se sa anëtarët e llojit njerëzor; mënyra në të cilën rikrijohen të gjitha lulet dhe frutat e të gjitha pemëve njëlloj si ato të pranverës së shkuar, me një shpejtësi të rrufeshme; gjithashtu zgjimi i befasishëm, hapja dhe ardhja në jetë e atyre farërave, bërthamave dhe e rrënjëve të panumërta të cilat janë origjina e asaj pranvere.

Gjithashtu rimëkëmbja e kufomave të pemëve të cilat u ngjasojnë skeleteve të ngritura të të vdekurve, janë një manifestim i urdhrit të menjëhershëm: ***"Ba'thu ba'del mevt*** - ***ringjalljes pas vdekjes";***

Gjithashtu ringjallja, në formën më të mahnitshme, e individëve të panumërt të të gjitha klasave e të kafshëve të vogëla;

Dhe veçanërisht ringjallja e mizave në speciet e tyre, dhe në mënyrë të veçantë, ngritja, rimëkëmbja dhe ringjallja brenda pak ditëve në çdo pranverë, bashkë me llojet e tjera nga anëtarët e kësaj specie të cilat janë më të shumta në numër brenda një viti se sa të gjithë bijtë e racës njerëzore qysh nga koha e Ademit a.s. të cilat na kujtojnë neve avdesin dhe pastërtinë

përmes pastrimit të vazhdueshëm të fytyrave të tyre, të syve dhe krahëve, dhe që na ledhatojnë gjithmonë fytyrat tona.

Atëherë sigurisht, për rimëkëmbjen e trupave njerëzorë në ditën e ringjalljes nuk ndodhet një shembull, por me mijëra shembuj.

Po, meqenëse kjo dynja është banesa e "Urtësisë", dhe Ahireti është banesa e "Fuqisë", atëherë në këtë botë, në përputhje me kërkesat e Emrave të tillë si, ***El-Hakimu, El-Muret'tibu, El-Mudeb'biru, El-Mureb'bi**, i Gjithurti, Organizuesi, Rregulluesi dhe Ushqyesi*", krijimi i gjërave është në një shkallë graduale dhe shtrihet me kohën. Kjo kërkohet nga Urtësia Hyjnore.

Kurse, meqenëse në botën e përtejme "Fuqia dhe Mëshira" janë më të dukshme se sa 'Urtësia', gjërat krijohen në çast, pa pasur nevojë për lëndën, periudhën, kohën e as për pritjen. Kur'ani i shpjegimit të mreku-llueshëm tregon me nënkuptime dhe aludon për faktin se punët që kryhen këtu në këtë botë për një ditë të plotë ose për një vit të tërë, do të plotësohen në botën tjetër në një çast, aty për aty, si shkreptimë ashtu siç dekretohet këtu:

وَمَآ أَمْرُ ٱلسَّاعَةِ إِلَّا كَلَمْحِ ٱلْبَصَرِ أَوْ هُوَ أَقْرَبُ

"*Urdhëri i Orës (i çastit të fundit) është sa një 'hap e mbyll sytë', ose edhe më afër."*[281]

Në qoftë se dëshiron të kuptosh me sigurinë më të plotë se ringjallja do të vijë, ashtu si pranvera e ardhshme, shqyrtoje dhe kushtoji vëmendje ***"Fjalës së Dhjetë"*** dhe ***"Fjalës së Njëzet e Nëntë"***, ku të dyja flasin për ringjalljen. Në qoftë se ti, akoma nuk do ta besoje atë si ardhjen e pranverës vijuese, atëherë më qorto rreptë!..

❑ ***ÇËSHTJA E KATËRT:***

[281] Kur'an, 16: 77

Vdekja e dynjasë dhe ndodhja e Kijametit. Në qoftë se një yll ose një planet do të përplasej me një Urdhër Hyjnor me globin tokësor, i cili është si një bujtinë për ne, ai do ta shkatërronte shtëpinë tonë, domethënë tokën, ashtu siç shkatërohet për një minut një pallat që është ndërtuar për dhjetë vjet...

* * *

PJESA E KATËRT E SHTOJCËS

قَالَ مَنْ يُحْيِي الْعِظَامَ وَهِيَ رَمِيمٌ ۞ قُلْ يُحْيِيهَا الَّذِي أَنْشَأَهَا
أَوَّلَ مَرَّةٍ وَهُوَ بِكُلِّ خَلْقٍ عَلِيمٌ ۞

"Njeriu thotë: 'Kush do t'u japë jetë këtyre kockave kur të jenë kalbur e të jenë bërë pluhur?"

"Thuaj Ti:'Ai do t'u japë jetë atyre, i Cili i krijoi ato për herë të parë! Dhe Ai është për çdo krijesë i Gjithëditur!"[282]

Siç u ilustrua në krahasimin e Tretë tek e Vërteta e Nëntë e Fjalës së Dhjetë, se ndonjë personalitet i madh mund të grumbullojë së bashku përpara syve të tu një ushtri të madhe. Atëherë nëse dikush do të të thonte: "Ai personalitet është i aftë të grumbullojë trupat e ushtrisë së tij me një zë të borisë, të cilët janë shpërndarë për të pushuar, dhe i mbledh ata përsëri në batalion", dhe ndërkohë ti do të thoje, "Unë nuk e besoj atë", a nuk do të ishte përgjigjja dhe mohimi yt një çmenduri e idiotizëm?

[282] Kur'an, 36: 78-79

Gjithashtu, Krijuesi i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëditur, i Cili nga asgjëja i krijoi dhe i vendosi në vendet e tyre me urdhërin e كُنْ فَيَكُونُ "*Bëhu! -dhe ajo është bërë (në çast)*" të gjitha grimcat dhe aspektet e holla të trupave të të gjitha kafshëve dhe të gjallesave të tjera, si të ishin ato një ushtri, me rregullin më të madh dhe me ekuilibrin më të urtë, dhe i Cili krijon në çdo shekull, madje në çdo pranverë, qindra e mijëra nga speciet dhe grupet e ndryshme të gjallesave që mbushin sipërfaqen e tokës, secili grup si një ushtri; a mund t'i bëhet pyetje Këtij të Gjithëfuqishmi e Këtij të Gjithëdituri se si Ai do t'i grumbullojë së bashku, me një rënie të vetme të Borisë së Israfilit, të gjitha grimcat themelore dhe pjesët origjinale që gëzojnë njohje të ndërsjellë përmes nënshtrimit të përbashkët ndaj organizimit të trupit, që i korrespondon një batalioni. A do të mund të thoje ti, "Si mund të jetë kjo? A nuk do të ishte çmenduri nëse do ta konsideroje atë të pagjasë?

Ndonjëherë ndodh në Kur'an, me qëllim që t'i ngulisë në zemër veprat e mrekullueshme që Ai do t'i kryejë në Ahiret, dhe me qëllim që të përgatisë mendjen për t'i pranuar ato, All-llahu i Gjithëfuqishëm përmend veprat e mrekullueshme që Ai i kryen në këtë botë, si një lloj përgatitjeje, ose Ai ndonjëherë përmend veprat e mrekullueshme që do t'i kryejë në të ardhmen dhe në Ahiret në një mënyrë të tillë që ne bindemi me ato përmes analogjisë me vepra të ngjashme të cilat ne i shikojmë në këtë botë. Një shembull jepet nga vërseti.

أَوَلَمْ يَرَ الْإِنسَانُ أَنَّا خَلَقْنَاهُ مِن نُّطْفَةٍ فَإِذَا هُوَ خَصِيمٌ مُّبِينٌ

"A nuk e sheh njeriu se Ne e kemi krijuar atë nga një pikë spermë? Prapëseprapë, kur shih! Ai (paraqitet) kundërshtar i hapur", - deri në fund të sures *Jasin* ... Kështu, Kur'ani i gjithurtë e provon këtu çështjen e ringjalljes në shtatë ose tetë forma të ndryshme.

Kur'ani, së pari, e drejton vëmendjen e njeriut për tek origjina e tij. Ai thotë: ***"Ti shikon se si ke përparuar nga një pikë spermë në një pikë gjaku, nga një pikë gjaku, në një xhungë (copë) mishi, dhe nga një xhungë mishi,***

për tek krijimi i formës njerëzore... Atëherë, si mund ta mohosh krijimin tënd të dytë?.. Ai është njëlloj si i pari, ose më i lehtë për t'u realizuar nga Krijuesi."

All-llahu i Gjithëfuqishëm, gjithashtu, u referohet mirësive të mëdha që Ai i ka dhuruar njeriut me shprehje të tilla si:

الَّذِي جَعَلَ لَكُم مِّنَ الشَّجَرِ الْأَخْضَرِ نَارًا "*(Ai) i Cili nxjerr për ju zjarrin nga pema e gjelbër*."[283] dhe i thotë njeriut: ***"Ai i Cili ua dhuroi juve këto mirësi, nuk do t'ju lë në tekat tuaja, në një mënyrë që ju të hyni në varr për të jetuar pa ju ngritur përsëri."***

Pastaj ai thotë me aluzion: "Ju i shihni se si pemët e vdekura vijnë në jetë dhe bëhen përsëri të gjelbëra. Si ju refuzoni për ta vlerësuar, si një krahasim, rimëkëmbjen e kockave tuaja, të cilat u ngjasojnë druve të thatë, dhe e konsideroni të pamundur që ato të njoftojnë jetën? Pastaj, a do të ishte e mundur që Ai, i Cili krijoi qiejt dhe tokën, të jetë i paaftë për t'i dhënë jetë njeriut e për t'i shkaktuar atij vdekjen, në një kohë që ai është fruti i qiejve dhe i tokës? A do të ishte e mundur për Atë që drejton çështjen e pemës së madhe dhe që kujdeset për të, ta neglizhonte frutin e saj dhe t'ua linte atë të tjerëve? A e imagjinoni ju se lihet kot pema e krijimit, e cila është formuar me urtësi në të gjitha pjesët e saj, dhe të lihej pas dore fruti dhe rezultati i saj i lartë?"

Për më tepër, Kur'ani thotë: Ai i Cili do t'ju japë përsëri jetë në ringjallje është i Tillë që i gjithë kozmosi është si një ushtar i bindur i Tij. Ai kozmos e përul kokën me nënshtrim të plotë, sa herë që dëgjon komandën كُن فَيَكُونُ "*Bëhu!- dhe ajo është bërë (në çast)*."[284]

Krijimi i pranverës për Të është më i lehtë se sa krijimi i një luleje. Krijimi i tërësisë së botës së kafshëve është aq i kollajt për Fuqinë e Tij, si krijimi i një mize. Askush me përçmim nuk mund ta sfidojë Fuqinë e Tij, duke thënë

[283] Kur'an, 36: 80

[284] Kur'an, 2: 117

për Të: مَنْ يُحْيِ الْعِظَامَ "*Kush do t'u japë jetë këtyre kockave kur të jenë kalbur e të jenë bërë pluhur*?"

Pastaj me shprehjen, فَسُبْحَانَ الَّذِي بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ "*Kështu pra, i Lavdëruar është Ai që në Dorën e të Cilit është mbizotërimi i çdo gjëje*,"[285] Ai shpjegon se frerët e të gjitha gjërave janë në Dorën e Tij, dhe çelësi për gjithçka është në zotërimin e Tij; Ai e kthen natën dhe ditën, dimrin e verën, me aq lehtësi sikur ato të ishin fletët e një libri. Ai është Krijuesi i Plotëfuqishëm dhe i Gjithëlavdishëm, i Cili mbyll derën e dynjasë dhe hap atë të Ahiretit, sikur ato të ishin dy shtëpi që mbyllet kjo e hapet ajo. Meqenëse çështja është kështu, atëherë rezultati i të gjitha dëshmive të përmendura është: وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ "*Dhe tek Ai ju të gjithë do të ktheheni*."[286]

Domethënë, Ai do t'ju ringjall juve prej varreve, do t'ju çojë në fushën e ringjalljes, dhe do t'ju gjykojë ju në Praninë e Madhështisë së Tij.

Tani këto vërsete e përgatisin mendjen dhe e bëjnë gati zemrën për të pranuar realitetin e ringjalljes, sepse ato kanë demonstruar krahasime të ringjalljes në veprimet e kësaj bote.

Ndonjëherë Kur'ani përmend veprime që do të realizohen në Ahiret në një mënyrë që tregojnë e tërheqin shikimet për tek krahasimet e tyre në dynja, me qëllim që të mos mbetet vend për dyshim e mohim.

Shembujt janë suret që fillojnë nga këto vërsete:

---

[285] Kur'an, 36: 83

[286] Kur'an, 36: 83

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ *"Kur Dielli të mbështjellet dhe të humb dritën dhe të përmbyset."* deri në fund... إِذَا السَّمَاءُ انفَطَرَتْ *"Kur qielli të plasë."* deri në fund... dhe إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ *"Kur qielli të çahet".*

Në këto sure, All-llahu i Gjithëfuqishëm përmend ndryshimet e mëdha dhe Aktet Hyjnore që do të ndodhin në Kijametin dhe në ditën e ringjalljes, në një mënyrë që njeriu mendon për krahasimet e tyre në këtë botë, të cilat ai i ka parë në vjeshtë dhe në pranverë, dhe atëherë, këto ndryshime që frikësonin zemrën e tij dhe që nuk kapeshin me mendjen e tij, tani i pranon me lehtësi. Mirëpo, për të treguar kuptimin e përgji-thshëm të tre sureve që sapo u përmendën, do të merrte shumë kohë. Atëherë, le të marrim një fjalë të vetme si model për të tërën.

Për shembull me fjalët: إِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ "*Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu do të hapen."*

All-llahu i Gjithëfuqishëm shpreh siç vijon: ***"Në ringjallje do të hapen të gjitha veprat e gjithësecilit, që janë të shkruara, në një fletë."*** Kjo, në vetvete, është e çuditshme dhe krejtësisht përtej perceptimit me logjikë. Por, siç tregon sureja, ashtu si ringjallja e pranverës që është krahasim për çështjet e tjera, gjithashtu hapja e fletëve ka një krahasim vërtet të qartë, sepse çdo frut, çdo kullotë e lulëzuar e çdo pemë, ka veprat e saj, aktet dhe funksionet. Ajo kryen një lloj të veçantë adhurimi, që varet nga mënyra me të cilën ajo lavdëron All-llahun xh.sh. përmes shfaqjeve të Emrave Hyjnorë. Tani, të gjitha punët e saj dhe historia e jetës së saj janë skalitur në të gjitha farërat dhe bërthamat që do të shfaqen në pranverën e ardhshme, dhe në një vend tjetër. Domethënë, me gjuhën e trajtës dhe të formës, farërat bëjnë një përmendje elokuente të origjinave të atyre veprave dhe hapin fletët e punëve bashkë me degët, shkarpurinat, gjethet, lulet dhe frutat. Ai i Cili thotë: إِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ *"Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu do të hapen*", është pikërisht Ai i Cili realizon përpara syve tanë këto akte Urtësie, Ruajtëse, Rregulluese, Ushqyese dhe Hollësie. Krahasoji

çështjet e tjera me këtë përmes analogjisë dhe nxirre të vërtetën si përfundim të deduktueshëm në qoftë se ke aftësi. Le të të japim një ndihmë me shembullin e mëposhtëm.

Vërseti: إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ "*Kur dielli të mbështillet, të humbë dritën dhe të përmbyset*"

Domethënë, fjala *"Kuvviret"* që vjen në vërset, do të thotë *"të mbledhësh dhe të mbështjellësh",* i referohet shembëllesës brilante dhe bën aluzion tek krahasimi i tij në dynja.

***Së pari*:** All-llahu xh.sh. i ka ngritur perdet e mosekzistencës, të eterit dhe të qiejve, e hapi diellin si një xhevahir i cili ndriçon dynjanë si një llambë, dhe e nxori atë nga thesari i Mëshirës së Tij dhe e shfaqi në dynja. Pas përfundimit të kësaj bote, Ai do ta mbështjellë përsëri atë xhevahir në perdet e Tij dhe do ta largojë.

Së dyti: Dielli mund të përshkruhet si një nëpunës i nënshtruar e i ngarkuar me detyrën e përhapjes së artikullit të dritës sipër globit, dhe t'i bëjë atë dhe errësirën të vijnë njëri pas tjetrit. Në çdo mbrëmje, nëpunësi urdhërohet të mbledhë dritën. Ndonjëherë ndodh gjithashtu që tregtia e tij të ulë ritmin kur ai fshihet nga një perde e një reje. Në ndonjë rast tjetër mund të ndodhë që hëna gjithashtu të formojë perde para fytyrës së tij dhe pengon detyrën e tij, tamam sikur ky nëpunës të mblidhte artikujt e tij dhe librat e punëve të tij me këto shkaqe. Atëherë nuk ka dyshim se do të vijë një ditë që ai do të çlirohet nga detyrat e tij.

Madje, edhe në qoftë se nuk do të ketë ndonjë shkak për shkarkimin e tij nga detyra, ndodhen dy njolla të zeza në diell, tani të vogëla, por të prirura për t'u zmadhuar, që një ditë do të zmadhohen deri në një pikë ku dielli do ta marrë prapa, me Urdhrin e All-llahut, dritën që ai tani e mbështjell rreth kokës së tokës, dhe e mbështjell atë rreth kokës së vet. Atëherë do t'i thuhet "Eja, detyra jote në tokë është plotësuar!". Tani Shko në Xhehennem dhe digji atje ata që të kanë adhuruar ty, sepse kështu me pabesi ata fyen një nëpunës të nënshtruar si ti." Me errësirën e tij dhe

fytyrën e frikshme, dielli do të lexojë dekretin, إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ *"Kur dielli të mbështillet, të humbë dritën dhe të përmbyset."*[287]

PJESA E PESTË E SHTOJCËS

Njëqind e njëzet e katër mijë profetë, të cilët, sipas hadithit të profetit, janë pjesa më e zgjedhur e humanizmit, kanë raportuar me unanimitet dhe kanë rënë dakord duke u bazuar në shikimet e drejtëpërdrejta të disave prej tyre, dhe duke u bazuar tek e vërteta absolute e disa të tjerëve, se Bota tjetër ekziston, dhe kanë njoftuar se të gjithë njerëzit do të dërgohen në Ahiret siç ka përmendur prerazi për të Krijuesi.

Gjithashtu, njëqind e njëzet e katër milionë evlija (shenjtorë) të cilët konfirmojnë njoftimet e profetëve nëpërmjet kerameteve dhe shikimeve, japin dëshmi për ekzistencën e Ahiretit në formën e Njohjes së sigurt, dhe gjithashtu japin për ekzistencën e botës së përtejme. Të gjithë Emrat e Krijuesit të Gjithurtë të kozmosit gjithashtu bëjnë të domosdoshme ekzistencën e botës së përtejme nëpërmjet treguesve që ato shfaqin në këtë botë.

Për më tepër, ekzistenca e Ahiretit bëhet e domosdoshme nga Fuqia e përjetshme e pafund, nga urtësia e pakufishme e saktë dhe e amshuar, që sjell në jetë në çdo pranverë kufomat e pemëve të ngritura, të vdekura e të panumërta të shpërdara gjithandej globit tokësor me urdhërin e كُنْ فَيَكُونُ "*Bëhu!- dhe ajo është bërë (në çast)*", duke i bërë ato si

[287] Kur'an, 81: 1

tregues e shenja për بَعْثُ بَعْدَ الْمَوْتِ *"ringjalljen pas vdekjes",* dhe se Ai ringjall treqindmijë specie të ndryshme të grupeve të shumëllojshme të bimëve dhe llojeve të kafshëve, si qindra mijëra shembuj të ringjalljes së madhe.

Ekzistenca e Ahiretit, gjithashtu bëhet e domosdoshme nga një Mëshirë e përhershme dhe nga një përkujdesje e qëndrueshme, që i mbështet në mënyrë të mrekullueshme e të kujdesshme të gjitha gjallesat që qëndrojnë në nevojë të ushqimit, dhe që shfaq në çdo pranverë, në një kohë shumë të shkurtër, shumëllojshmëri të ndryshme të pafund stolisjeje e bukurie. Së fundi, ndodhet një provë e vetëkuptueshme dhe një tregues i dhënë nga një dashuri e fortë e palëkundur dhe e përhershme për përjetësi, ndodhet një dëshirë e zjarrtë për qëndrueshmëri dhe një shpresë për përjetësi, që janë ngulur e vendosur tek njeriu, i cili është fruti më i plotë i këtij kozmosi dhe krijesa më e dashur e Krijuesit të kozmosit, lidhja e të cilit me të gjitha krijesat në kozmos është më e madhja. Nuk ka dyshim se ajo tregon në mënyrë të vetëkuptueshme se ekziston një botë e përjetshme pas kësaj bote të përkohshme, do të jetë një Ahiret, një botë e amshuar lumturie. Atëherë, të gjitha këto prova e dëshmi vërtetojnë prerazi deri në atë shkallë ku pranimi bëhet i domosdoshëm për ekzistencën e Ahiretit, ashtu siç pranojmë ekzistencën e dynjasë. [288]

[288]Po, mund të kuptohet nga ky krahasim se sa e lehtë është të bësh një pohim pozitiv dhe sa e vështirë është të bësh një mohim e refuzim. Në qoftë se, për shembull, dikush do të thonte, "ekziston diku në sipërfaqen e tokës një kopsht i mrekullueshëm, frutet e të cilit janë si kutia qumështi, dhe dikush tjetër do të thonte, jo, nuk ekziston një kopsht i tillë. I pari, pohuesi, duhet vetëm të tregojë vendin e atij kopshti ose të tregojë disa nga frutat e tij, me qëllim që të provojë me lehtësi pretendimin e tij. Ndërsa i dyti, mohuesi, në kontrast, duhet të kontrollojë e të tregojë të gjitha anët e globit tokësor me qëllim që të justifikojë mohimin e tij. Gjithashtu, dëshmia e dy dëshmitarëve të vërtetë do të ishte e mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e Xhennetit, përveç qindra e mijëra treguesve, frutave dhe shenjave të demonstruara nga ata që e vërtetojnë ekzistencën e tij. Ata që e mohojnë atë, duhet të kontrollojnë, të eksplorojnë e shqyrtojnë gjithësinë e pafundme dhe kohën e pafund përpara se ata të mund të provojnë mohimin e tyre, dhe atëherë të demonstrojnë mosekzistencën e Xhennetit. Prandaj, o vëllezërit e mi të moshuar, kuptojeni se sa i lartë

Përmbajtja

…… 1 – 4

Parathënie …… 5 – 10

Me Emrin e Tij të Cilit i takon Lavdërimi ..... 11 – 13

FJALA E NJËZET E PESTË: MREKULLIA E KUR'ANIT

قُل لَّئِنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنسُ وَالْجِنُّ عَلَىٰ أَن يَأْتُوا بِمِثْلِ هَٰذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا

Vërsetet e diskutuara në këtë Fjalë kanë qenë kritikuar nga ateistët ose kanë qenë kundërshtuar në emrin e shkencës, por ama ato janë provuar këtu sipas parimeve shkencore se janë shkreptimat e mrekullisë dhe të elokuencës. ..... 14 - 16

Parathënie: Përkufizimi i Kur'anit, në tre Pjesë: ..... 17 - 20

Drita e Parë: Elokuenca e Kur'anit, e cila është në shkallën e mrekullisë, në dy 'Aspekte' dhe në 'Pesë Pika'. ..... 20 - 58

Rrezja e Dytë: Gjithëpërfshirja e jashtëzakonshme e Kur'anit, në pesë 'Shkreptima', duke përfshirë pesë 'Flakërima'. ..... 58 - 80

Rrezja e tretë: Mrekullia e Kur'anit lidhur me dhënien e njoftimeve të tij nga e padukshmja, ruajtja e rinisë dhe e freskisë së tij gjatë gjithë epokave, dhe adresimi i tij për të gjitha klasat e njerëzimit në mënyrën e duhur, në tre "Rreze" duke përfshirë tre "Rrezëllima", tre Shkallë dhe katër Parime. ..... 80 - 95

Drita e Dytë: Përbëhet nga tre "Rrezatime".

Rrezatimi i Parë: Rrjedhshmëria, përshtatshmëria dhe harmonia e Kur'anit si një tërësi. ..... 95 - 97

Rrezatimi i Dytë: Tetë 'Pikat' e elokuencës "Gjashtë Pengesa" që ndalojnë për të hyrë në të. ..... 97 - 123

Rrezatimi i Tretë: Kur'ani nuk mund të krahasohet me asnjë fjalë tjetër. ..... 123 - 129

Drita e Tretë: Përbëhet nga tre "Rreze".

Rrezja e Parë: Nëpërmjet përhapjes së dritës së udhëzimit dhe të mrekullisë, secili nga vërsetet e Kur'anit largon errësirën e mosbesimit dhe të pakujdesisë. ..... 129 - 133

Rrezja e Dytë: Urtësia e Kur'anit dhe filozofia e njeriut.. ..... 133 - 137

Rrezja e Tretë: Urtësia e studentëve të Kur'anit dhe urtësia e vetë Kur'anit..... 137 - 143

Përfundimi ..... 144 - 146

Shtojca e parë: Madhështia e Kur'anit. ..... 147 - 154

Shtojca e Dytë: Urtësia e përsëritjes në Kur'an; një lule e Emirdagut. ..... 155 – 172

LETRA E NËNTËMBËDHJETË: Trajtesa e mrekullive të Profetit Muhammed a.s.m., kujtesë rreth rrëfenjave të ardhura në trajtesë. ..... 173 - 174

Mrekullitë e Muhammedit A.S.M..... 175

Shenja e parë: Domosdoshmëria e profetësisë së Muhammedit a.s.m.. 176

Shenja e dytë: Mrekullia, në vetvete, është konfirmimi nga Krijuesi i kozmosit për shpalljen e profetësisë së të Dërguarit të Tij..... 177 - 178

Shenja e tretë: Urtësia në qënien e mrekullive të profetit Muhammed a.s.m. të shumta e të larmishme..... 179 - 180

Shenja e katërt: Disa parime për të kuptuar njoftimet që All-llahu xh.sh. i dha të dërguarit të Tij nga e padukshmja.

Parimi i parë: Jo të gjitha gjendjet dhe veprimet e Profetit Muhammed a.s.m. ishin mrekulli....

Parimi i dytë: Shpallja e qartë dhe e nënkuptuar...

Parimi i tretë: Rrëfenjat, raportimet dhe roli i transmetuesve të hadithve...

Cila është dobia e përmendjes së zinxhirit të transmetimit të një hadithi?...

Përse nuk u transmetuan ndodhitë e mrekullive nëpërmjet shumë zinxhirëve në formën e 'konsensusit' e me theksim aq të madh, ashtu si ai i urdhëresave të sheriatit, ligjit të shenjtë?...

Parimi i katërt: Parashikime rreth disa ngjarjeve të përgjithshme që do të ndodhnin në të ardhmen...

Parimi i pestë: Urtësia dhe mëshira e Krijuesit kërkojnë që shumica e çështjeve të së padukshmes të jenë të mbuluara ose të errëta...

Parimi i gjashtë: Njeriu duhet të ngrejë kokën përtej cilësive të zakonshme të Profetit që lidhen me pjesëmarrjen e tij në gjendjen njerëzore dhe, në vend të saj, të shohë natyrën e vërtetë të Profetit a.s.m.... ..... 181 - 189

Shenja e pestë: Parashikimet që bëri profeti lidhur me disa ngjarje të së ardhmes dhe me ato ngjarje që do të godisnin Eh-li Bejtin.

Pse nuk i parapriu Imam Aliu të tjerët në drejtimin e kalifatit?...

Përse kalifati nuk qëndroi tek Eh-li Bejti në një kohë që ata ishin më të merituesshmit e më të përshtatshmit për të?

Cila është urtësia e konfliktit të përgjakshëm e të tmerrshëm që goditi islamin e bekuar në periudhën e ndritshme të kalifëve të lartë?... ..... 190 - 199

Shenja e gjashtë: Mrekullitë e Profetit Muhammed a.s.m. lidhur me parashikimet për të ardhmen.

Dashuria për Eh-li Bejtin.

Dashuria është dy llojesh: *e para* është të duash diçka apo dikë për kuptimin që ajo gjë ose ai tregon, dhe *e dyta* merr cilësitë si objekt... ..... 200 - 210

Shenja e shtatë: Mrekullitë e profetit a.s.m. lidhur me bereqetin e ushqimit të Tij..... 211 - 221

Shenja e tetë: Mrekullitë e Tij lidhur me ujin..... 222 - 228

Shenja e nëntë: Mrekullitë e Tij lidhur me pemët..... 229 - 234

Shenja e dhjetë: Mrekullia e rrënkimit të trungut..... 235 - 239

Shenja e njëmbëdhjetë: Mrekullitë e Tij lidhur me krijesat e pajeta... ..... 240 - 244

Shenja e dymbëdhjetë: Disa shembuj që lidhen me shenjën e mëparshme... ..... 245 - 248

Shenja e trembëdhjetë: Mrekullitë e profetit a.s.m. lidhur me shërimin e të sëmurëve.

Një përshkrim për dorën e bekuar të profetit a.s.m.. .. .. 249 - 256

Shenja e katërmbëdhjetë: Mrekullitë e profetit Muhammed a.s.m. lidhur me duatë e Tij..... 257 - 267

Shenja e pesëmbëdhjetë:

Dega e parë: Bota e kafshëve e njohu profetin Muhammed a.s.m....

Dega e dytë: Kufomat - të vdekurit-, xhindët dhe engjëjt e njohën profetin Muhammed a.s.m....

Dega e tretë: Mbrojtja që All-llahu xh.sh. i bëri profetit a.s.m. ..... 268 - 281

Shenja e gjashtëmbëdhjetë: Çudira që u shfaqën para misionit profetik të Muhammedit a.s.m.

Lloji i parë: Njoftimet që dhanë për Të Teurati dhe Ungjilli...

Prova e parë: Kur'ani i sfidoi ata me vërsetet...

Prova e dytë: Besimi i dijetarëve të shkrimeve të shenjta...

Prova e tretë: Shembuj prej lajmeve të gëzueshme, sihariqeve...

Lloji i dytë: Lajmet për ardhjen e Muhammedit a.s.m. të dhëna prej disa njerëzve të njohur si shenjtorë dhe mistikë të asaj kohe...

Lloji i tretë: Ngjarjet e çuditshme që ndodhën në kohën e lindjes së Tij..... 282 - 305

Shenja e shtatëmbëdhjetë: Mrekullitë e profetit Muhammed a.s.m. lidhur me personin e vet, me sheriatin e Tij të shquar dhe me Miraxhin... ..... 306 - 308

Shenja e tetëmbëdhjetë: Kurani i gjithurtë...

Pika e parë: Shpjegimi se të gjitha klasat e njerëzimit kanë pjesë në kuptimin e mrekullisë së Kur'anit.

Pika e dytë: Kur'ani i sfidoi ekspertët e fushave të ndryshme të njohjes...

Pika e tretë: Një reflektim i shkurtër por i vërtetë mbi natyrën esenciale të kuranit të mrekullueshëm. ..... 309 - 323

Shenja e nëntëmbëdhjetë: Profeti Muhammed a.s.m. ishte prova më brilante dhe përfundimtare e Njësisë Hyjnore...

Një nderim Hyjnor dhe një shenjë e mirësisë Hyjnore...

Shtojca e parë: Pikëla prej personalitetit të profetit Muhammed a.s.m...

Njoftim rreth Kuranit;

Shkreptima e mrekullisë në përsëritjet në Kuran.

Mrekullia e Kuranit në përmendjen e çështjeve kozmike.

Mrekullia e çarjes më dysh të hënës...

Përse u veçua profeti Muhammed a.s.m. me këtë Miraxh të madh?...

Një udhëtim për tek më i miri i shekujve... (prej trajtesës El - Ajetul Kubra)..... 324 - 370

FJALA E DHJETË - RINGJALLJA DHE BOTA TJETËR:

فَانْظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا إِنَّ ذَٰلِكَ لَمُحْيِي الْمَوْتَىٰ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

Një krahasim në formën e 'dymbëdhjetë aspekteve' duke përfshirë provat e ringjalljes së të vdekurve.

Një parathënie që përbëhet nga Katër tregues duke shpjeguar krahasimin dhe duke demonstruar ekzistencën dhe unitetin e All-llahut, funksionin e profetësisë dhe profetin Muhammed a.s.m.; rëndësinë e njeriut dhe domosdoshmërinë e Krijuesit të Përjetshëm të kësaj bote të përkohshme duke krijuar një botë të përjetshme.

'Dymbëdhjetë të Vërteta', që përbëhen nga prova të detajuara të ringjalljes së të vdekurve dhe të Ahiretit të bazuara mbi një numër të Emrave Hyjnorë, dhe një përfundim.

Shtojca e Parë: Një parathënie duke përfshirë dy 'Pika'; e para: Sa esencial është besimi në Ahiretin për jetën shoqërore njerëzore në veçanti; e dyta: Si shtyllat e tjera të besimit e kërkojnë ringjalljen dhe e provojnë atë.

Shtojca e Dytë: Si jeta shikon tek të gjashtë shtyllat e besimit duke përfshirë ringjalljen e të vdekurve, dhe i provon ato në mënyrë të tërthortë.

Shtojca e Tretë: Tre 'Çështjet' duke shpjeguar ndodhjen e menjëhershme të Ringjalljes.

Shtojca e Katërt: Një shpjegim i një numri vërsetesh Kur'anore që përshkruajnë ringjalljen e të vdekurve në fundin e Botës

Shtojca e Pestë: Unanimiteti i përgjithshëm për realitetin e ringjalljes e të Ahiretit. ..... 371 - 480

Permbajtja ..... 481 - 487

është besimi në Botën e Përtejme...

Said Nursi

Po, atëherë, një nga mësimet më të rëndësishme që na mëson vetë Kur'ani i gjithurtë është "***Besimi në Ahiretin***." Ky besim është aq i qëndrueshëm dhe përmban brenda vetvetes një shpresë aq të fortë e një ngushëllim aq të madh, saqë në qoftë se do të grumbulloheshin njëqind mijë pleqëri tek një person i vetëm, ngushëllimi e qetësia që burojnë nga ky besim do të ishin krejtësisht të mjaftueshme, duke thënë:

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ عَلٰى كَمَالِ الْإِيمَانِ "*Lavdia i takon All-llahut, për plotësimin e besimit*", ne njerëzit e vjetër duhet të gëzohemi në pleqërinë tonë...